



Përmbledhje legjislativi mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë

Prishtinë
Dhjetor 2016



Përmbledhje legjislacioni mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë

Prishtinë
Dhjetor 2016

Botim i HANDIKOS (Shoqata e paraplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Kosovës)
Adresa: Prishtinë, Rr: Nekibe Kelmandi, p.n (Qendra e Resurseve për personat me aftësi të kufizuara), Lagjja Veternik
www.handi-kos.org
handikos@handi-kos.org
038 602 328

Mbështetur nga Disability Partnership Finland dhe implemetuar nga HANDIKOS në partneritet me organizatës Kynnysry nga Finlanda



PARATHËNIE

HANDIKOS (Shoqata e paraplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Kosovës), shoqatë e personave me aftësi të kufizuara në vazhden e punës së saj në përparimin e të drejtave dhe pozitës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, vazhdon të punoj në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke marrë pjesë aktive në proceset e hartimit dhe konsultimeve publike të politikave dhe legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara.

HANDIKOS vazhdon të jetë qendër e informimit gjithëpërfshirëse mbi aftësinë e kufizuar në Kosovë, duke publikuar një mori të broshurave, doracakëve, informatorëve dhe udhëzueseve për personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e tyre, përfitimet, jetën e pavarur, kujdesin personal etj.

Me këtë përmbledhje legjislacioni synojmë të rrisim nivelin e njohurive për të drejtat dhe ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me të drejtat dhe përfitimet tjera të personave me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre e cila do ti informoj së pari vetë personat me aftësi të kufizuara, shoqërinë dhe autoritet publike zbatuese të ligjeve.

Kjo përmbledhje legjislacioni përmban të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat drejtpërdrejtë apo indirekt rregullojnë mbrojtjen, të drejtat dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, si dhe vendime dhe dokumente strategjike.

Aktet të cilat rregullojnë mbrojtje, të drejta dhe përfitime vetëm për personat me aftësi të kufizuara, në këtë përmbledhje legjislacioni janë në tërësi, ndërsa aktet tjera të cilat kanë dispozita që trajtojnë edhe personat me aftësi të kufizuara apo janë me interes të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, këtu i gjeni ekstrakte vetëm të atyre dispozitave, me përjashtim të ligjeve të fushës së arsimit të cilat në këtë përmbledhje legjislacioni janë në tërësi.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës është i vetmi publikim zyrtar në Republikën e Kosovës në të cilën publikohen ligjet dhe aktet e tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Andaj, me rastin e aplikimit të ligjeve dhe akteve tjera nga kjo përmbledhje legjislacioni, ju rekomandojmë të shërbehuni edhe me publikimet e Gazetës Zyrtare.

Afrim Maliqi,
Drejtor i HANDIKOS

Përgatitur nga:
Osman SHATRI

PËRMBAJTJA

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008), me amendamente (ekstrakt) - - - - - 7
- Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi - - - - -29
- Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit - - - - - 39
- Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (ekstrakt)- - - - -55
- Ligji Nr. 05/L -025 për Shëndetin Mendor - - - - - 58
- Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme - - - - -72
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2009 për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të aplikimit për realizimin e të drejtës në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, i plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2010 dhe vitin 2014 - - - - - 81
- Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (ekstrakt) - - - - -87
- Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përhershme - - - - -97
- Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.05/2015 për procedurat e lajmërimit, suspendimit nga pagesa dhe kthimin e mjeteve në rastet e keqpërdorimit të pensioneve - - - - - 102
- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/176 Datë: 10.03.2014 (Rritja e pensioneve dhe kompensimeve)- - - - -110
- Ligji Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-078 - - - - - 111
- Rregullore (MPMS) Nr.02/2015 për kriteret dhe procedurat e përkrahjes financiare për subvencione dhe grande - - - - -123
- Udhëzim Administrativ Nr. 03/2010 për procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave në aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara - - - - -134
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2010 për përcaktimin e vendeve të punës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me aftësitë e tyre të punës - - - - -140
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2012 për mënyrat dhe rregullat e mbajtjes së evidencës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara - - - - -144
- Ligji Nr. 04/L – 092 për personat e verbër - - - - -148
- Rregullore (MPMS) Nr. 02/2013 për funksionimin e komisionit mediko-social dhe procedurat e aplikimit për realizimin e të drejtave për personat e verbër - - - - - 154
- Rregullore QRK Nr. 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës - - - - - 159
- Ligji Nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik - - - 166

• Ligji Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-081	173
• Ligji Nr. 2003 / 15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-096 (viti 2012)	195
• Ligji Nr.04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës	205
• Udhëzimi Administrativ nr. 24/2014 shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve	237
• Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2013 Qendrat Burimore-	240
• Udhëzimi Administrativ Nr.18/2013 përdorimi i planit individual të arsimit	251
• Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore	255
• Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2012 Kualifikimet për personelin që punon me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore	259
• Ligji Nr. 05/L -018 për provimin e maturës shtetërore	262
• Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.06/2016 Kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve me nevoja të veçanta-	272
• Ligji Nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës	275
• Ligji Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor	283
• Udhëzimi Administrativ Nr.19/2016 përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë	300
• Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës	302
• Udhëzimi Administrativ Nr. 24/2012 Kategoritë e studentëve për asistencë si dhe kushtet për fitimin e asistencës-	325
• Ligji Nr. 04/L-125 për shëndetësi (ekstrakt)-	328
• Udhëzimi Administrativ (MSh) Nr.06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore (ekstrakt)-	351
• Udhëzimi Administrativ 15/2013 Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësisive të Pacientit	354
• Udhëzimi Administrativ (shëndetësi) Nr.19/2013 Linja telefonike për ankesat e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore-	358
• Udhëzimi Administrativ Nr.03/2012 Për Menaxhimin e Materialit të Inkontinencës për Personat me Aftësi të Kufizuara	361
• Ligji Nr. 04/L -249 për sigurimin shëndetësor (ekstrakt)	363
• Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërtim	377
• SHTOJCA Nr. 1 LEJA E NDËRTIMIT (Ligji për ndërtim)	392
• Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara	394

• Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2013 për përcaktimin e proceduarve dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore si dhe për leje ndërtimore (ekstrakt) - - - - -	468
• Ligji Nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor (ekstrakt) - - - - -	483
• Ligji Nr. 03/L-212 i Punës (ekstrakt) - - - - -	489
• Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës - - - - -	496
• Rregullorja Nr. 31/2012 për procedurat e përkujdesjes për nëpunësit civil për shkak të paaftësisë fizike apo mendore ose problemeve shëndetësore - - - - -	503
• Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256) (ekstrakt) - - - - -	506
• Rregulla Zgjedhore Nr.04/2013 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta (Ekstrakt)- - - - -	520
• Ligji Nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas (ekstrakt) - - - - -	525
• Ligji Nr. 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare - - - - -	534
• Udhëzimi Administrativ QRK - Nr. 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare- - - - -	547
• Ligji Nr. 05/L -028 për tatimin në të ardhurat personale (ekstrakt) - - - - -	555
• Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale (ekstrakt) - - - - -	560
• Strategjia Nacionale për të Drejtat e Dersonave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës (2013-2023) - - - - -	562
• Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Për themelimin e Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara - - - - -	578
• Rregullorja e Punës së Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës - - - - -	580
• Vendimi për Caktimin e Tarifave (ekstrakt) - Taksat për pajisje me dokumente dhe lirim i personave me aftësi të kufizuara), me aneks një Qarkore për për pranimin e Librezave të HANDIKOS-it si dëshmi për lirim nga taksat - - - - -	583

**KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ME AMENDAMENTE**

(EKSTRAKT)

* * * * *

Kapitulli II Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Dinjteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 25 [E Drejta për Jetën]

1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën.
2. Dënimi me vdekje është i ndaluar.

Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal]

Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin:

- (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
- (2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;
- (3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin;
- (4) të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.

Neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar]

Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.

Neni 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar]

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë.
2. Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer punë të detyruar. Punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë.

3. Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar.

Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

- (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
- (2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
- (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
- (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirim të tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për veprë penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;

- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë veprë e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si veprë penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.
3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.

4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirish në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.
4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.
5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.
2. Kontrollat e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm për kohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

Neni 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes]

1. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.
2. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.

3. Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.

Neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë]

1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.
2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.
4. Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit, ose të të drejtave të personave të tjerë.

Neni 39 [Konfesionet Fetare]

1. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë fetare dhe monumentet fetare brenda territorit të saj.
2. Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare.
3. Konfesionet fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirëse në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 40 [Liria e Shprehjes]

1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.
2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]

1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.
2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Neni 42 [Liria e Medieve]

1. Garantohej liria dhe pluralizmi i Medieve.

2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.
3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

Neni 43 [Liria e Tubimit]

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Neni 44 [Liria e Asociimit]

1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.
2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.
3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike.
2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.

Neni 48 [Liria e Artit dhe e Shkencës]

1. Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar.
2. Liria akademike është e garantuar.

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
2. Fëmijët e lindur jashtë martesë, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.
4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]

1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.
2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.
2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.
3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.

Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]

1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.
2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.

Amendamenti 17:

Neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vëndit]

Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vëndit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.

* * * * *

Kapitulli IV Kuvendi i Republikës së Kosovës

Neni 63 [Parimet e Përgjithshme]

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:
 - (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);
 - (2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;
- (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;

- (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;
- (10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;
- (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.

Amendamenti nr. 23

- (15) jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit

* * * * *

Neni 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore]

1. Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet.
2. Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare.

* * * * *

Neni 73 [Pamundësia e Kandidimit]

1. Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:
 - (1) gjyqtarët dhe prokurorët;
 - (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;
 - (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës;

- (4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës;
 - (5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
 - (6) udhëheqësit e agjencive të pavarura;
 - (7) përfaqësuesit diplomatikë;
 - (8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.
 3. Kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre.

* * * * *

Neni 79 [Nisma Legjislative]

Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 80 [Miratimi i Ligjeve]

1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.
3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.
4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.
5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.
6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.

* * * * *

Kapitulli V Presidenti i Republikës së Kosovës

Neni 83 [Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;
- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
- (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;
- (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
- (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
- (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
- (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
- (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;
- (21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;

- (22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
- (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
- (25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
- (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- (27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
- (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
- (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;
- (30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.

Neni 85 [Kualifikimi për Zgjedhjen e Presidentit]

President i Republikës së Kosovës mund të zgjedhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, i cili e ka mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare.

Neni 86 [Zgjedhja e Presidentit]

1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.
2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.
4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.
6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.

Kapitulli VI Qeveria e Republikës së Kosovës

Neni 92 [Parimet e Përgjithshme]

1. Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
2. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj.
3. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

- (1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
- (2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;
- (3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
- (4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
- (5) propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës;
- (7) udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike;
- (8) i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës;
- (9) propozon amendamentimin e Kushtetutës;
- (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (11) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.

Neni 94 [Kompetencat e Kryeministrit]

Kryeministri ka këto kompetenca:

- (1) përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë;
- (2) siguron që të gjitha Ministrinë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare;
- (3) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë;

- (4) ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit;
- (5) kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;
- (6) emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- (7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës;
- (8) së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- (9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;
- (10) kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]

1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.
2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.
5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.
6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.

* * * * *

Neni 97 [Përgjegjësia]

1. Qeveria, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
2. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësive të tyre.

* * * * *

Neni 101 [Shërbimi Civil]

1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

* * * * *

Kapitulli VII Sistemi i Drejtësisë

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

Neni 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]

1. Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj.
2. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor.
3. Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
4. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.
5. Kryetarët e të gjitha gjykatave të tjera emërohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.
6. Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me jurisdiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
7. Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme.

Neni 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]

1. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

2. Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.
3. Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse.
4. Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.
5. Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.
6. Gjyqtarët nuk mund të transferohen kundër vullnetit të tyre, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, për shkak të funksionimit efikas të gjyqësorit ose masave disiplinore.

* * * * *

Neni 111 [Avokatura]

1. Avokatura është profesion i pavarur, e cila ofron shërbime sikur është e rregulluar me ligj.
2. Mënyra e fitimit të së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit, si dhe marrja e kësaj të drejte, rregullohen me ligj.

Kapitulli VIII Gjykata Kushtetuese

Neni 112 [Parimet e Përgjithshme]

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
 - (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
 - (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.
3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

- (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
 - (2) përputhshmëria e referendimit të propozuar me Kushtetutën;
 - (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
 - (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
 - (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.
4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.
 5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.
 6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.
 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
 8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.
 9. Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.
 10. Jurisdiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj.

Neni 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen.
2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.
3. Vendimi për të propozuar shtatë (7) nga gjyqtarët, varet nga miratimi i dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm

dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

4. Nëse mandati i gjyqtarit përfundon para mbarimit të mandatit të rregullt, emërimi i gjyqtarit të ri bëhet në pajtim me këtë nen, me mandat të plotë, pa të drejtë rizgjedhjeje.
5. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, bëhet nga gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të Gjykatës, për mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit.

Neni 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]

1. Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.
2. Gjykata Kushtetuese publikon raportin vjetor.

Neni 116 [Efekti Juridik i Vendimeve]

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.
3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.
4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.

* * * * *

Neni 121 [Prona]

1. Llojet e pronës rregullohen me ligj.
2. Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja mund të sigurojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.
3. Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të sigurojnë të drejta të koncesionit dhe të drejta të tjera për shfrytëzim dhe/ose eksplotim të resurseve në pronësi publike, përfshirë këtu resurset natyrore, dhe të infrastrukturës në pronësi publike.

* * * * *

Neni 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

1. Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.
2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.
3. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj.

Kapitulli X Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial

Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.
2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.
4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124 [Organizimi dhe Funkionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.

* * * * *

Kapitulli XII Institucionet e Pavarura

Neni 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.
3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Neni 133 [Zyra e Avokatit të Popullit]

1. Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj.
2. Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokat i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.
3. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.
4. Avokati i Popullit gëzon imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësive të Avokatit të Popullit.
5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.

Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit]

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Me kërkesën e Kuvendit, Avokati i Popullit duhet të dorëzojë raporte periodike ose tjera Kuvendit. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, Kuvendi duhet t'ia lejojë që të dëgjohet.
3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.
4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

* * * * *

Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.
2. Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.
3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdikcion apeli.
4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

* * * * *

Kapitulli XIV Dispozitat Kalimtare

Neni 162 [Hyrja në Fuqi]

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008.

LIGJI Nr. 05/L -021

PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

2. Ky Ligj është në përputhshmëri me Direktivën e Këshillit 2000/43/KE, të datës 29 qershor 2000, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktivën e Këshillit 2000/78/EC, të datës 27 nëntorit 2000 që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE, të datës 13 dhjetor 2004 Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, si dhe Direktivën 2006/54/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 5 korrik 2006, mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe të profesionit (e amendamentuar) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:

1.1. kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet;

1.2. qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike;

1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës;

1.4. anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve apo në çdo organizatë tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe përfitimet që mundësohen nga organizatat e tilla;

1.5. mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore;

1.6. përparësitë sociale;

1.7. lehtësitë sociale, përfshirë, por pa u kufizuar në ndihmën humanitare;

1.8. arsimin;

1.9. qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasje në forma tjera të pronës (luajtshme dhe paluajtshme);

1.10. qasje dhe furnizim në të mira materiale dhe shërbime të cilat janë në dispozicion për publikun;

1.11. trajtimi i drejtë dhe i barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë;

1.12. qasje dhe pjesëmarrje në shkencë, sport, art, shërbime dhe aktivitete kulturore;

1.13. sigurinë personale;

1.14. pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur;

1.15. qasje në vendet publike, dhe

1.16. çfarëdo të drejta tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 Koncepti i diskriminimit

1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 4 Llojet e trajtimit të pabarabartë

1. Llojet e trajtimit të pabarabartë janë si në vijim:

1.1. **Diskriminimi i drejtpërdrejtë** konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji;

1.2. **Diskriminimi i tërthortë** konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme;

1.3. **Ngacmimi** konsiderohet diskriminim, kur një sjellje e padëshirueshme (që përfshin por, nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes) mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji;

1.4. **Nxitja për të diskriminuar** konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje”.

1.5. **Viktimizimi** konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe ndodhë kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit;

1.6. **Segragacioni** konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, duke përfshirë mbrojtjen e çdo personi që nuk merr pjesë në një ankim për diskriminim po që i cili mendohet ta ketë bërë atë, i cili ndodhë në rastet kur një ose disa persona veçohen nga të tjerët përmes personave fizik, juridik, ose me kombinimin e të dyjave, nga sektori publik, privat apo nga të dy sektorët, dhe ky veçim bëhet mbi një nga bazat e përcaktuara në nenin 1 (një) të këtij Ligji;

1.7. **Diskriminimi në bazë të asociimit** - konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, shënjestrimi i personave që nuk i përkasin një grupi të caktuar por, që janë palë të treta që asociohen me ato grupe;

1.8. **Mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar**, në përputhje me nevojat e tyre specifike konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveçse kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë dhe kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë në konsideratë për këtë qëllim faktorë të tillë si përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrjen në jetën sociale dhe publike dhe garantimin e qasjes në vendin e punës dhe kushte të përshtatshme pune;

1.9. **Diskriminimi në bazë të perceptimit** - konsiderohet diskriminimi sipas nenit një (1) të këtij Ligji, vendosja në objektiv jo të personave që i përkasin një grupi të caktuar, por personave të tretë që perceptohen se i përkasin grupit;

1.10 **Diskriminimi i shumëfishtë**, ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe bazat e shumëfishta interpretohen në përputhje me rrethanat.

2. Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë të bazave të përmendura në nenin një (1), të këtij Ligji konsiderohet diskriminim.

Neni 5

Format e rënda të diskriminimit

Sjellja diskriminuese e cila është motivuar nga më shumë se një bazë apo e cila është kryer më shumë se një herë, apo e cila ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore apo ka pasur pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën konsiderohet formë e rëndë e diskriminimit.

Neni 6

Trajtimi i ndryshëm i përligjur

Pavarësisht nga nenet 3 dhe 4 të këtij Ligji, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat e nenit një (1) të këtij Ligji, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.

Neni 7 Veprimet afirmative

1. Veprimet afirmative janë masa të ndërmarra me qëllim të parandalimit ose kompensimit të pafavorshme të grupeve ose personave të lidhur me ndonjë prej bazave të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.
2. Veprimet afirmative, mund të zbatohen, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar në rastet:
 - 2.1. grupi i shënjestruar duhet të jetë i nënpërfaqësuar në pozitën përkatëse;
 - 2.2. kandidati i grupit të nënpërfaqësuar duhet t'i ketë kualifikimet e njëjta me ato të kundër kandidatit të tij për sa i përket përshtatshmërisë, zotësisë dhe performancës profesionale;
 - 2.3. aplikacioni i secilit kandidatë i nënshtrohet një vlerësimi objektiv i cili duhet të merr parasysh të gjitha kriteret që janë karakteristike për secilin kandidat individual;
 - 2.4. përparësia e dhënë kandidatit të grupit të nënpërfaqësuar nuk mund të jetë automatike dhe i pakushtëzuar por, mund të shpërfilllet nëse arsyet specifike për një kandidat individual mund të shkojnë në favore të tij.
3. Veprimet afirmative nuk konsiderohen diskriminim në kuptim të këtij ligji dhe zbatohen vetëm deri sa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato masa.

Neni 8 Përgjegjësitë e institucioneve të Republikës së Kosovës

Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.

Neni 9 Avokati i Popullit

1. Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.
2. Avokati i Popullit ka këto kompetenca:
 - 2.1. pranon dhe heton parashtrësat e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit;
 - 2.2. ofron asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit dhe ofron informatat e domosdoshme personave që kanë paraqitur një ankesë për diskriminim në lidhje me të drejtat e tyre, për detyrimet dhe mundësitë e gjykatës, si dhe për mjetet tjera mbrojtëse;
 - 2.3. Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga

subjektet e sektorit publik;

2.4. u drejtohet organeve të prokurorisë dhe të hetimit direkt me një kërkesë për fillimin e hetimit të kundërvajtjeve dhe veprave penale dhe kërkon fillimin e procedimit dicitlinor të zbatueshëm;

2.5. informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmer masa për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimin;

2.6. përcjell zbatimin e këtij ligji dhe inicon ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi;

2.7. ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikën e mira në promovimin e barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazat e mbuluara nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore dhe nga ky Ligj, si dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit;

2.8. ofron këshilla, mbështetje dhe udhëzime organizatave jo-qeveritare dhe partnerëve social në praktikën e mira dhe efektive në luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë, në veçanti organizatave që merren me çështjet e barazisë dhe jo-diskriminimin;

2.9. jep mendime në projekt-aktet normative për mbrojtjen nga diskriminimi;

2.10. mbledh të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera, realizon studime, hulumtime dhe trajnime, në lidhje me diskriminimin;

2.11. bashkëpunon me partnerët social, organizatat jo-qeveritare, që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me mekanizmat përkatëse të shteteve tjera që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe me institucionet dhe bashkësitë fetare të regjistruara në Kosovë;

2.12. paraqet raport së paku çdo vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Ligji dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij;

2.13. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi;

2.14. mund të hartojë Kode të Praktikave të Mira, për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë, të cilat, mund të përdoren si pikë referimi në rastet e diskriminimit.

Neni 10

Promovimi dhe bashkëpunimi për avancimin e të drejtave të njeriut

1. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e këtij Ligji, është përgjegjëse që të:

1.1. ofron këshilla për Qeverinë, në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e barazisë;

1.2. monitoron zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit;

1.3. harton politika, strategji dhe plane të veprimit në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi;

1.4. jep mendime për projekt legjislaionin e përgatitur nga Qeveria, në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi dhe të praktikave të qeverisjes së mirë, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;

1.5. mbledhë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera, krijon baza të të dhënave për grupet kryesore të ndjeshme, realizon studime, hulumtime dhe trajnime, në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi;

1.6. bashkëpunon me trupa përkatëse qeveritare të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare, në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi;

1.7. paraqet raport çdo vit, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, për zbatimin e këtij Ligji, dhe gjithashtu mund të hartoj raporte të veçanta për zbatimin e tij;

1.8. bashkëpunon dhe mbështet institucionet tjera të Republikës së Kosovës për të hartuar dhe zbatuar plane të veprimit për barazi dhe jo-diskriminim, integrim të barazisë dhe iniciativa për promovim të barazisë dhe luftim të diskriminimit.

2. Qeveria vendos bashkëpunim me organizatat joqeveritare të cilat kanë interes për të kontribuar në mbrojtjen nga diskriminimi e në veçanti në promovimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 11

Mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në Ministri dhe Komuna

1. Të gjitha ministritë dhe komunat janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij Ligji.

2. Qeveria, sipas propozimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë, me akt nënligjor përcakton mënyrën e koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me Zyrën për Qeverisje të Mirë, të meknizmave institucional për mbrojtje nga diskriminimi.

KREU II

PROCEDURAT NË ORGANET KOMPETENTE

Neni 12

Ankesat kundër diskriminimit te Avokati i Popullit

1. Çdo person apo grup i personave mund t'i parashtrijë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me sjelljen diskriminuese mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Paraqitja dhe trajtimi i ankesave kundër diskriminimit, nga ana e Avokatit të Popullit, kryhet në përputhje me procedurat e specifikuar të ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.

3. Paraqitja e ankimit tek Avokati i Popullit nuk është kusht për të paraqitur një padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.

4. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjerë juridik mund të iniciojnë apo përkrahin ankesat në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave tek Avokati i Popullit.

Neni 13

Paditë për mosmarrëveshjet për diskriminimin

1. Çdo person ose grup i personave që ankohen se kanë qenë të diskriminuar mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji mund të paraqesin padi në gjykatën kompetente.

2. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike mund të iniciojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e obligimeve nga ky ligj.

Neni 14

Procedura para gjykatës

1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente sipas legjislacionit në fuqi nga personi ose grup i personave që ankohen se janë diskriminuar mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.
2. Për personat jorezidentë qofshin të përkohshëm apo të përhershëm, gjykatë kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë.
3. Subjektet kanë mundësi të paraqesin padi për diskriminim sipas këtij ligji, jo më vonë se pesë (5) vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë shkelje.
4. Padiësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me përdorimin e çfarëdo prove dhe metode legjitime, përfshirë por pa u kufizuar, në të dhënat statistikore që mund të dëshmojnë sjelljen diskriminuese përfshirë edhe të dhënat statistikore.

Neni 15 Llogaridhënia

1. Çdo veprim i kryer nga një person, gjatë marrëdhënies së punës, për çdo rast të parashtruar në bazë të këtij Ligji, trajtohet, për qëllimet e këtij Ligji, sikur të jetë kryer nga punëdhënësi i personit, pavarësisht se a është kryer me apo pa njohurinë ose aprovimin e punëdhënësit.
2. Në një rast të parashtruar në bazë të këtij Ligji kundër punëdhënësit për një veprim që pretendohet të jetë kryer nga një punonjës i punëdhënësit, mbrojtje për punëdhënësin do të jetë të dëshmuarit se punëdhënësi ka ndërmarrë hapa të arsyeshëm dhe praktik për të parandaluar punonjësin nga kryerja e atij veprimi apo nga kryerja e veprimeve të tilla.

Neni 16 Veprimet në procedurën kontestimore

1. Çdo person që pretendon që është viktimë e diskriminimit, sipas dispozitave të nenit një (1) të këtij Ligji, ka të drejtë të parashtojë padi kundër të paditurit dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në gjykatën kompetente.
2. Gjykata pasi që merr provat dhe argumentet relevante vërteton se i padituri ka kryer veprime apo mosveprimeve diskriminuese ndaj padiësit mund të vendos që:
 - 2.1. t'i ndalojë të paditurit kryerjen e veprimeve diskriminuese të cilat shkelin ose mund të shkelin të drejtën e padiësit, apo ta detyrojë të paditurin që t'i eliminojë të gjitha veprimet diskriminuese ndaj padiësit;
 - 2.2. të kompensojë dëmin material ose jomaterial të shkaktuar nga shkelja e të drejtave të mbrojtura me këtë Ligj, sipas padisë për dëmshpërblim;
 - 2.3. të urdhërojë masa të përkohshme konform dispozitave të ligjit përkatës mbi procedurën kontestimore (nëse padiësi e ka bërë të besueshme që e drejta e tij/saj për trajtim të barabartë është shkelur, dhe nëse është e nevojshme të urdhërojë një masë me synimin për të eliminuar rrezikun e dëmeve të riparueshme, veçanërisht për shkeljet e rënda të të drejtës për trajtim të barabartë, apo me qëllim të parandalimit të dhunës);
 - 2.4. të urdhërojë afatin kohor më të shkurtër për ekzekutim se sa është përcaktuar me ligjin përkatës mbi procedurën përmbartimore;
 - 2.5. të publikojë në media vendimin gjyqësor, përmes të cilit vërtetohet shkelja e së drejtës për trajtim të barabartë.
3. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë në afat prej shtatë (7) ditësh në Gjykatën e Apelit sipas ligjit përkatës mbi procedurën kontestimore.

4. Kërkesat nga paragrafi një (1) i këtij neni, mund të paraqiten së bashku me kërkesat për mbrojtjen e të drejtave tjera, për të cilat vendoset në procedurë kontestimore, nëse të gjitha kërkesat janë në lidhje të ndërsjellë dhe nëse gjykata e njëjtë ka kompetencë lëndore për to, pa marrë parasysh nëse për ato kërkesa është përcaktuar vendimmarrje në procedurë të përgjithshme ose të veçantë kontestimore.

5. Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dëmshpërblimit zbaton ligjin përkatës për marrdhëniet detyimore, ndërsa me rastin e përmbasimit të vendimit të plotëfuqishëm zbaton dispozitat e ligjit përkatës për procedurën përmbasimore.

6. Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre, përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet materiale si dhe jomateriale, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.

7. Gjatë përcaktimit të lartësisë së kompensimit për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë parasysh nëse çështja përfshinë forma të rënda të diskriminimit.

8. Gjykata gjatë zbatimit të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme zbaton ligjin përkatës mbi procedurën kontestimore.

9. Procedurat gjyqësore në rastet e diskriminimit duhet të trajtohen me urgjencë.

Neni 17

Rastet e diskriminimit të cilat përbëjnë vepër penale

Shkeljet e dispozitave të këtij Ligji, në rastet kur përbëjnë vepra penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 18

Rastet e diskriminimit të cilat prekin grupet e personave

1. Rastet e diskriminimit të cilat prekin grupet e personave mund të inicohen nëpërmjet një veprimi grupor të ndërmarrë në emër të tyre nga një organizatë joqeveritare ose nga Avokati i Popullit, në raste të tilla, nuk kërkohet pëlqimi i anëtarëve të grupit.

2. Këto veprime ligjore dorëzohen në gjykatën kompetente, me pretendimet në vijim:

2.1. të vendos se sjellja e tillë ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë në raport me pjesëtarët e grupit;

2.2. të ndalojë ndërmarrjen e veprimtarive të cilat shkelin apo mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, apo të kryejnë veprimtari të cilat eliminojnë diskriminimin apo pasojat e tij në lidhje me anëtarët e grupit;

2.3. të publikojë në media vendimin i cili vërteton shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë me shpenzimet e të paditurit.

3. Në këto procedura, gjykata vendos sipas paragrafit dy (2) të këtij neni dhe nuk mund të kërkohet kompensimi i dëmit, por në bazë të aktgjykimit në rastin e veprimit grupor, personat të cilët i takojnë grupit në fjalë mund të dorëzojnë padinë dhe të kërkojnë kompensim të dëmit.

Neni 19

Akomodimi i arsyeshëm i personave me aftësi të kufizuara në punësim

1. Me qëllim që të garantohet parimi i trajtimit të barabartë në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, duhet të ofrohet akomodimi i arsyeshëm i personave me aftësi të kufizuara në punësim.

2. Punëdhënësit duhet të ndërmarrin masa të duhura kur është e nevojshme në raste të veçanta që t'i mundësojnë personit me aftësi të kufizuara të ketë qasje, të marrë pjesë apo të avancohet në punësim, trajnim, përveç nëse kjo masë përbën ngarkesë joproportionale për punëdhënësin.

Neni 20

Barra e provave

1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin prova para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

2. Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

3. Paragrafi një (1) i këtij neni nuk zbatohet në procedurën penale dhe procedurën kundërvajtëse.

Neni 21

Procedura e ndërmjetësimit ose pajtimit

Çdo procedurë e ndërmjetësimit ose pajtimit të cilat i parasheh legjislacioni në fuqi, mund të shfrytëzohen sipas zgjedhjes së parashtruesit të kërkesës, për të adresuar shkeljet në bazë të këtij ligji.

Neni 22

Kontrata publike

1. Kontrata publike nga organi publik duhet të shpallet e pavlefshme nga organi i cili bënë shpalljen e fituesit në ato raste ku kontraktuesi në fjalë ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij Ligji.

2. Çdo dispozitë e kontratës publike, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.

3. Çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, e cila është e përfshirë në kontratat apo marrëveshjet individuale apo kolektive, rregullat e brendshme të marrëveshjes, rregullat që rregullojnë asociacionet fitimprurëse apo jofitimprurëse dhe rregullat që rregullojnë organizatat e punëdhënësve, punëtorëve dhe profesioneve të pavarura, janë ose mund të shpallen të pavlefshme apo të ndryshohen.

Neni 23

Dispozita kundërvajtëse

1. Gjobë në shumë prej katërqind (400) deri në gjashtëqind (600) euro, i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, që kryen, fton ose nxit në diskriminim dhe ndihmon në veprimtarinë diskriminuese, sipas bazave të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Gjobë në shumë prej njëmijë e pesëdhjetë (1050) deri në njëmijë e treqind e pesëdhjetë (1350) euro, i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, i cili gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet kryen, fton ose nxit në diskriminim dhe ndihmon në veprimtarinë diskriminuese, sipas bazave të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

3. Gjobë në shumë prej shtatëqind e pesëdhjetë (750) deri më njëmijë e pesëdhjetë (1050) euro, i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi një (1) të këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik, institucionet shtetërore dhe lokale ose organin me autorizime publike, ose individit që në formë të profesionit të regjistruar kryen veprimtari të caktuar, që paraqet diskriminim sipas bazave të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

4. Gjobë në shumë prej katërqind e pesëdhjetë (450) deri në shtatëqind e pesëdhjetë (750) euro, i shqiptohet për kundërvajtje çdo personi i cili fsheh faktet apo informatat e kërkuara nga Organi Administrativ apo Gjykata kompetente.

5. Gjobë në shumë prej njëmijë e pesëdhjetë (1050) deri në njëmijë e treqind e pesëdhjetë (1350) euro i shqiptohet për kundërvajtje, çdo personi, i cili nuk zbaton vendimin e Gjykatës për diskriminim sipas bazave të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

6. Gjobë në shumë prej katërqind e pesëdhjetë (450) deri në shtatëqind e pesëdhjetë (750) euro i shqiptohet për kundërvajtje, secilit që cenon dinjitetin e personit të caktuar ose për krijimin, qasjen apo aplikimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, poshtërues ose frikësues.

7. Gjobë në shumë prej katërqind e pesëdhjetë (450) deri në shtatëqind e pesëdhjetë (750) euro i shqiptohet për kundërvajtje, secilit që do ta sjellë në gjendje të pavolitshme personin që e ka paraqitur diskriminimin, ose në çfarëdo mënyre ka marrë pjesë në veprimin për diskriminim.

8. Gjobë në shumë prej katërqind e pesëdhjetë (450) deri në shtatëqind e pesëdhjetë (750) euro, i shqiptohet për kundërvajtje secilit që me qëllim e sjell në gjendje të pavolitshme personin, që ka qenë dëshmitar në veprimin për diskriminim, ose e ka refuzuar zbatimin e vendimit për sjellje diskriminuese.

9. Mjetet e mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 24

Përgjegjësia individuale

Çdo person mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij Ligji, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka kryer një akt diskriminues në kuptimin e këtij ligji. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e institucioneve shtetërore ose të personit juridik privat.

KREU IV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Vetëdijesimi i publikut

1. Më së largu gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria obligohet të lansojë fushatë promovimi dhe të hartojë një program për vetëdijesimin e publikut lidhur me këtë Ligj.

2. Të gjitha institucionet obligohen që në ueb faqet e tyre të publikojnë të dhënat lidhur me njoftimin e qytetarëve për të drejtat e tyre të cilat mund ti realizojnë në institucionet kompetente.

3. Të gjitha organet publike publikojnë në faqen e tyre të internetit një informatë lidhur me mundësinë për t'ia paraqitur ankesën Avokatit të Popullit përkritazi me diskriminimin, duke dhënë të dhënat personale kontaktuese.

Neni 26

Nxjerrja e akteve nënligjore

Për zbatimin e këtij Ligji Qeveria me propozimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Zyrës Ligjore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, miraton aktet nënligjore, në afat prej gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 27

Shfuqizimi

1. Ky ligj shfuqizon:

1.1. Ligjin Nr. 2004/3 kundër diskriminimit;

1.2. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, që përcaktojnë fushëveprimin e Zyrës Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjimore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës;

1.3. Udhëzimin Administrativ Nr.8/2005 për përshkrimin e detyrave të Njesisë për të Drejtat e Njeriut;

1.4. Udhëzimin Administrativ Nr.04/2007 për Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Kosovës;

1.5. Udhëzimin Administrativ-MAPL-Nr.08/2007 për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, dhe

1.6. Udhëzimin Administrativ (UA) Nr. 04/2006 për zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit.

2. Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.

Neni 28 **Hyrja në fuqi**

Ky Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -021
28 maj 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-014-2015, datë 15.06.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

LIGJI Nr. 05/L -019

PËR AVOKATIN E POPULLIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR AVOKATIN E POPULLIT

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1.Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: autoritetet publike), si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

2.Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar procedurat për emërim dhe shkarkim, kompetencat dhe mënyrën e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe rregullon procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.

Neni 3

Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit

1.Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

2.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të autoriteteve publike.

3. Instrukcioni i Avokatit të Popullit gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligj.

Neni 4 Gjuha e punës

Gjuhë e punës së Instrukcionit të Avokatit të Popullit janë gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

Neni 5 Përbërja e Instrukcionit të Avokatit të Popullit

1. Instrukcioni i Avokatit të Popullit, përbëhet nga:

- 1.1. Avokati i Popullit;
- 1.2. Pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit;
- 1.3. Personeli i Instrukcionit të Avokatit të Popullit.

Neni 6 Kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj zgjedhen personat që i plotësojnë këto kushte:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë arsimim të lartë universitar;
- 1.3. të ketë karakter, ndershmëri dhe moral të lartë;
- 1.4. të ketë eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut;
- 1.5. të mos ushtrojë funksion në parti politike, të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e zgjedhë atë apo anëtar/e i/e kabinetit qeveritar.

Neni 7 Papajtueshmëria

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike e as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale.

2. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj nuk marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.

3. Përveç ndalesave të përcaktuara në nën-paragrafin 1.5 të nenit 6 të këtij ligji dhe paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

4. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij/saj mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi.

5. Avokati i Popullit mund të ushtrojë funksione tjera me autorizim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI II

PROPOZIMI, ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I AVOKATIT TË POPULLIT DHE ZËVENDËSVE TË TIJ/SAJ

Neni 8

Procedura e propozimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

1. Procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të tij.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohe në rast dorëheqjeje, shkarkimi apo vdekjes së Avokatit të Popullit, procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit fillon brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e lirimit të postit.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në media të shkruara dhe elektronike.
4. Në konkurs caktohen kushtet për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) e as më i gjatë se njëzetë (20) ditë.
5. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, Paneli përzgjedhës (në tekstin e mëtejshëm: Paneli), i caktuar nga Komisioni kompetent për të drejtat e njeriut, i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit të paraparë me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedh poshtë kandidaturat që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkurs.
6. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për Avokat të Popullit, duhet të inkurajohet përfaqësimi etnik dhe gjinor.
7. Paneli zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për Avokat të Popullit.
8. Lista e ngushtë përmban tre (3) kandidatë, përveç në rastin kur brenda numrit 3 (tre), ka më shumë kandidatë me pikë të barabarta vlerësuese. Paneli përzgjedhës listën e kandidatëve ia dorëzon Komisionit.
9. Propozimin e Avokatit të Popullit e bënë Komisioni.
10. Komisioni, bashkëngjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur Avokat i Popullit.
11. Propozimi i Komisioni përmban arsyetimin përse Paneli ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.
12. Procedura e zgjedhjes dhe e shkarkimit të Avokatit të Popullit, rregullohet me Rregullore të posaçme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Zgjedhja e Avokatit të Popullit

1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokati i Popullit duhet të zgjedhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve.
3. Në rrethin e parë votohet për kandidatët e propozuar nga Komisioni përkatës i Kuvendit. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fiton shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, dy (2) kandidatët që fitojnë më së shumti vota, i nënshtrohen rrethit të dytë të votimit. Nëse as në rrethin e dytë nuk zgjedhet Avokati i Popullit, kandidati me numrin më të madh të votave nga rrethi i dytë, si kandidat i vetëm i nënshtrohet rrethit të tretë të votimit.
4. Nëse kandidatët marrim numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet derisa njëri prej kandidatëve fiton numrin më të madh të votave.
5. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjedhet në seancën e parë, Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në seancë plenare brenda tridhjetë (30) ditëve në vijim.
6. Në seancën e ardhshme për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, Kuvendi, sipas procedurës në paragrafin 3 të këtij neni voton për kandidatët e tjerë që kanë plotësuar kushtet e konkursit, sipas radhitjes në listën hartuar pas intervistimit nga Komisioni përzgjedhës i Kuvendit, duke përjashtuar kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës për të cilët është votuar në seancën e parë.
7. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjidhet as në seancën e dytë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, Kuvendi përsëri do të shpallë konkurs për Avokat të Popullit.

Neni 10

Procedura për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të popullit

1. Zëvendësit e Avokatit të Popullit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.
2. Propozimi për zëvendësit e Avokatit të Popullit, bëhet nga Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente, sipas konkursit të shpallur nga Institucioni i Avokatit të Popullit.
3. Avokati i Popullit për zgjedhjen e një (1) zëvendësi, i propozon Kuvendit së paku dy (2) kandidatë.
4. Propozimi i Avokatit të Popullit përmban arsyetimin për kandidatët e propozuar.
5. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për zëvendësit e Avokatit të Popullit, duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor. Të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i njërit nga komunitetet dhe gjinisë tjetër që ndryshon nga ajo e Avokatit të Popullit.
6. Zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjedhen nga Kuvendi, me mandat tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.
7. Paragrafi 1,2,4 të nenit 8 të këtij ligji përshtatshëmrisht aplikohen edhe për zëvendësit e Avokatit të Popullit.
8. Avokati i Popullit me Rregullore të brendshme përcakton mënyrën e konkurimit, procedurën e zgjedhjes dhe të propozimit të listës me emrat e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit.
9. Avokati i Popullit, njërin nga zëvendësit e zgjedhur e cakton zëvendës kryesor të tij me rotacion për një mandat një (1) vjeçar.

Neni 11
Marrja e detyrës dhe betimi

1. Avokati i Popullit merr detyrën pasi të ketë dhënë betimin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Teksti i betimit është si në vijim: ***“Unë betohem dhe premtoj solemnisht se do t’i kryej me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që më janë besuar me Kushtetutë dhe me ligj, se do t’i mbroj dhe avancoj të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës”.***

Neni 12
Imuniteti

1. Avokati i Popullit, zëvendësit e tij dhe personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për fjalët e dhëna apo të shkruara, për veprimtari ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësisë të Institucionit të Avokatit të Popullit. Imuniteti funksional vazhdon edhe pas përfundimit të detyrës.

2. Zyrat e Institucionit të Avokatit të Popullit janë të pacenueshme. Arkivat, lëndët, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Institucionit të Avokatit të Popullit, kudo që janë apo nga kushdo që mbahen, janë të pacenueshme dhe gëzojnë imunitet nga kontrolli, marrja, nga kërkimi zyrtar i tyre, nga konfiskimi, nga shpronësimi apo nga çfarëdo ndërhyrje tjetër, qoftë përmes veprimit përmbarues, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

Neni 13
Shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj

1. Avokati i Popullit, dhe zëvendësit e tij/saj mund të shkarkohen për arsytet në vijim:

1.1. paaftësia fizike apo mendore që shkakton pamundësinë e tij për kryerjen e funksioneve të tij;

1.2. ka kryer veprë penale të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës me gjashtë (6) apo më tepër muaj burgim në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;

1.3. nëse kryen veprime në kundërshtim me nën-paragrafin 1.5 të nenit 6 dhe paragrafi 2 të nenit 7 të këtij ligji.

2. Procedura për shkarkimin e Avokatit të Popullit duhet të jetë procedurë e hapur dhe publike, ku Avokatit të Popullit i garantohet e drejta të dëgjohet publikisht.

3. Zëvendës Avokatin e Popullit e shkarkon Kuvendi, me votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Avokati i Popullit kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shkarkojë nga detyra një apo më shumë zëvendës të tij/saj, për shkak të një apo më shumë arsyeve të parapara në këtë ligj.

Neni 14
Përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij/saj

1. Funksioni i Avokatit të Popullit dhe i zëvendësve të tij/saj mbaron:

1.1. me vdekjen e tij;

1.2. kur jep dorëheqje;

1.3.me përfundim të mandatit të Avokatit të Popullit, respektivisht zëvendësve të tij/saj;

1.4. kur shkarkohet.

2. Në rast mungese, vdekje, paaftësie të përhershme ose të përkohshme, dorëheqjes ose shkarkimit, Avokati i Popullit zëvendësohet nga zëvendësi kryesor apo zëvendësit e tjerë. Në rast të mungesës së zëvendësve, Avokatin e Popullit e zëvendëson zyrtari më i lartë i personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

3. Në rast të përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit apo zëvendësi i tij/saj do ta ushtroj funksionin e tij deri në zgjedhjen e Avokatit të ri të Popullit, përkatësisht zëvendësit të ri.

4. Avokati i Popullit për zëvendësit e tij/saj të cilët e kanë përfunduar mandatin e parë ka të drejtë t'i propozoj Kuvendit për vazhdimin edhe të një mandati pa procedura të konkurrimit.

Neni 15

Sigurimi i punës pas përfundimit të mandatit

1. Pas përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit mund të kthehet në funksionin e tij/saj ose punën publike që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë punëdhënësi i mëhershëm duhet t'i sigurojë një punë të paktën në nivelin e njëjtë, dhe që do të gëzonte pagën e barasvlefshme me atë që kishte para zgjedhjes si Avokat i Popullit.

2. Avokatit të Popullit, të cilit i përfundon mandati, ose që për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta vazhdojë punën e mëparshme ose nuk mund të gjejë punë tjetër adekuate, e as që i ka plotësuar kushtet e përgjithshme të pensionimit, gëzon të drejtën e pagës në vlerën e pagës së fundit të pranuar, por jo më gjatë se një (1) vit nga përfundimi i mandatit.

KAPITULLI III

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 16

Kompetencat

1. Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

2. Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Avokati i Popullit mund t'u ofroj shërbime të mira të gjithë banorëve të Republikës së Kosovës si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

4. Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

5. Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve.

6. Nëse Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë apo ndonjë person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtrësë Avokatit të Popullit për ngritjen e procedurës, është i nevojshëm pëlqimi nga personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut. Përgjithësisht, nëse personi i dëmtuar ka vdekur apo nuk është në gjendje të jap pëlqimin për ndonjë arsye tjetër, ky pëlqim duhet të kërkohej nga të afërmit e ngushtë dhe nëse të afërmit e tillë nuk ekzistojnë apo nuk mund të kontaktohen, pëlqimi nuk është i nevojshëm.

7. Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 6 i këtij neni.

8. Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.

9. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

10. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

11. Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit.

12. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.

13. Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazi gjinore dhe legjisllacionin tjetër në fuqi.

14. Mbledh të dhëna statistikore në lidhje me çështjet e diskriminimit dhe barazisë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe i publikon ato.

15. Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë.

16. Bashkëpunon me partnerët social dhe organizatat jo-qeveritare që merren me çështje të barazisë dhe jo-diskriminimit, si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtare me Avokatin e Popullit.

Neni 17

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese

1. Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (në tekstin e mëtejshëm: MKP).

2. Në kuadër të përgjegjësisë si MKP, Avokati i Popullit është i obliguar që:

2.1. të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut;

2.2. në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit të krijojë një mekanizëm të veçantë që do të kryejë të gjitha funksionet e MKP. Personeli i këtij mekanizmi, përveç juristëve duhet të përfshijë profesionistë të fushave të ndryshme, posaçërisht mjekë, psikologë dhe punëtorë social me përvojë në këtë fushë.

3. Ekspertët dhe personat e specializuar të angazhuar nga Avokati i Popullit për nevojat e MKP- së, duhet të kenë të drejtat dhe obligimet e njëjta sikurse personeli tjetër i Avokatit të Popullit, përfshirë të drejtën për të vizituar vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, për fotografim dhe incizim radio dhe audio vizuale, të gëzojnë mbrojtjen nga ndërhyrja e jashtme në punën e tyre, si dhe të drejtën që të mos japin të dhëna, informata apo sqarime për gjetjet e tyre gjatë kryerjes së detyrave të tyre në këtë fushë.

4. Gjatë kryerjes së funksionit si MKP, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin e tyre, si dhe të dhënat personale të këtyre personave.

5. Avokati i Popullit mund të jap rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve, dhe akteve të tjera nënligjore apo administrative, udhëzuesve dhe të praktikave të aplikuara në Kosovë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues.

6. Avokati i Popullit duhet të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues.

7. Avokati i Popullit mund të jap sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.

Neni 18 **Përgjegjësitë**

1. Avokati i Popullit ka këto përgjegjësi:

1.1. të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre;

1.2. të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;

1.3. të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët, si dhe krijimin e një ekipi të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe një programi të përhershëm që fëmijët të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre;

1.4. të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave;

1.5. të rekomandoj qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit;

1.6. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta;

1.7. të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës;

1.8. të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive

themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës;

1.9.t'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;

1.10.të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut;

1.11.Avokati i Popullit, zëvendësit dhe personeli i tij duhet ruajtur fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

1.12.obligimi për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare vlen edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës.

2. Avokati i Popullit mund t'i ofrojë këshilla dhe t'i japë rekomandime çdo personi fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

3. Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.

4. Avokati i Popullit i ndërmer të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme të caktuar nga Avokati i Popullit. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e ankesës së parashtruar sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, nga autoritetet kompetente kërkohet të përgjigjen me ngut.

5. Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.

6. Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet, te çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, duke përfshirë dosjet mjekësore për personat e privuar nga liria, në pajtim me ligj, dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.

7. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të kufizuar të lëvizjes dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.

8. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, sipas detyrës zyrtare, mund të hyjnë në të gjitha hapësirat zyrtare të të gjitha autoriteteve.

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Neni 19

Fillimi i procedurës

Çdo person i cili pretendon se të drejtat apo liritë e tij janë shkelur me ndonjë ligj, veprim apo mosveprim, keqadministrim të autoriteteve, mund të kërkojë nga Institucioni i Avokatit të Popullit fillimin e procedurës.

Neni 20

Forma e paraqitjes së ankesës

1. Çdo ankesë që i parashtrohet Avokatit të Popullit duhet të jetë e nënshkruar dhe t'i ketë shënimet personale të paraqitësit të ankesës si dhe të përmbajë të gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat kjo ankesë bazohet. Paraqitësi i ankesës duhet të deklarojë nëse mjetet juridike janë ushtruar apo jo, dhe nëse po cilat prej këtyre mjeteve janë zbatuar.

2. Çdo ankesë për fillimin e procedurës, si rregull paraqitet me shkrim. Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet në mënyrë elektronike edhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim.

Neni 21

Procedura pas pranimit të ankesës

1. Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit në afat prej dhjetë (10) ditë pune vendos për pranueshmërinë e çështjes si në vijim:

1.1. të shqyrtojë në procedurë të përsheptuar rastin;

1.2. të fillojë hetimin e plotë;

1.3. të hedh poshtë ankesën për shkak se:

1.3.1. nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji;

1.3.2. ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj;

1.3.3. ankesa është anonime dhe e pa dokumentuar;

1.3.4. ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës;

1.3.5. ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit.

1.4. të refuzojë ankesën si të pabazuar.

1.5. të ndërpretë hetimet kur konstaton se rasti është zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër në pajtim me kërkesën e ankuesit.

2. Në të gjitha rastet e mësipërme, Avokati i Popullit e njofton me shkrim palën brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

3. Vendimi i Avokatit të Popullit për të hedhur poshtë apo për të refuzuar ankesën është i formës së prerë.

Neni 22

Rastet e refuzimit të shqyrtimit të ankesës

1. Avokati i Popullit refuzon kërkesën për shkak të arsyeve si në vijim:

1.1. kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi;

1.2. kur kërkesa është jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit;

1.3. kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore, përveç në rastet e specifikuara me këtë ligj;

1.4. kur të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shterur, përpos nëse ai vlerëson se do të jetë e padobishme për paraqitësin e ankesës për të filluar apo vazhduar procedurën, apo nëse vlerëson se individët kanë pësuar dëm të madh apo mund të pësojnë dëm të madh dhe të pa riparueshëm në ndërkohë.

2. Avokati i Popullit duhet të jep arsyetim për shkaqet e refuzimit të ankesës, përveç në rastet kur pala e kundërshton këtë shprehimisht.

Neni 23

Rastet e parashkrimit dhe përjashtimit

1. Avokati i Popullit nuk inicion procedurë për të hetuar shkeljen e të drejtave të njeriut nëse prej datës që pala e ka marrë vendimin e formës së prerë apo është njoftuar lidhur me të dhe deri në dorëzimin e ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë kaluar më shumë se tri (3) vite.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Avokati i Popullit mund të inicojë procedurë edhe pas kalimit të afatit prej tri (3) vite në rast se vlerëson se paraqitësi i ankesës ka qenë i penguar, në rast se shkelja është duke vazhduar, apo në rast se vlerëson se çështja është e rëndësisë së veçantë.

Neni 24

Procedura pas fillimit të hetimit

1. Kur Avokati i Popullit vendos t'i fillojë hetimet në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, vendimin e vet do t'ia komunikojë paraqitësit të ankesës. Gjithashtu, Avokati i Popullit i'a komunikon këtë vendim autoritetit kundër të cilit është paraqitur ankesa në një kohë të arsyeshme sipas vlerësimit të tij. Avokati i Popullit mund të kërkojë informata shtesë lidhur me rastin.

2. Avokati i Popullit cakton afatin brenda të cilit organi duhet t'ia dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më i gjatë se tridhjetë (30) ditë. Kur organi nuk arrin t'i dorëzojë në afatin e paraparë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit, ai pa vonesë duhet t'i paraqesë me shkrim arsyet e vonesës në ofrimin e informatës së kërkuar.

3. Në rast se Avokati i Popullit i vlerëson të pamjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai/ajo ka të drejtë ta procedojë çështjen tek organi më i lartë kompetent, ose t'i paraqesë raport të veçantë Kuvendit, duke i propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

4. Refuzimi apo dështimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.

5. Avokati i Popullit mund të raportojë veprimet e parapara në paragrafin 4 të këtij neni në raportet e tij.

Neni 25
Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit

1. Të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.
2. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.
3. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

Neni 26
Thirrja e dëshmitarëve dhe ekspertëve

Avokati i Popullit mund t'i dërgojë thirrje çdo dëshmitari ose eksperti për ta intervistuar lidhur me rastin që e shqyrton. Personi i thirrur e që punon në institucionet publike është i obliguar t'i përgjigjet thirrjes.

Neni 27
Marrja e vendimit

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e tij/ saj, nxjerrë vendim në të cilin paraqiten konstatimet dhe rekomandimet e tij/saj. Vendimi i tij/saj i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe autoriteteve publike përgjegjëse.

Neni 28
Përgjigjja në kërkesat e Avokatit të Popullit

Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 29
Raporti i Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor.
2. Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Kosovës raportin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues.
3. Kuvendi i Kosovës shqyrton raportin vjetor të Avokatit të Popullit në seancë plenare, gjatë sesionit pranveror.

Neni 30
Publikimi i raporteve të veçanta

1. Avokati i Popullit i paraqet edhe raporte të veçanta për fusha të caktuara të të drejtave të njeriut Kuvendit të Kosovës.
2. Avokati i Popullit mund të publikojë raporte të veçanta edhe përmes mediave.

KAPITULLI V

ZYRA, OBJEKTI, PERSONELI DHE BUXHETI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 31

Selia e Institucionit, paprekshmëria e selisë dhe zyrave të Avokatit të Popullit

1. Selia e Institucionit të Avokatit të Popullit është në Prishtinë.
2. Institucionit të Avokatit të Popullit, Qeveria i siguron objekte të përshtatshme për punë në pronësi publike dhe pajisje të nevojshme për punë, në mënyrë që t'i mundësohet kryerja efektive e funksioneve dhe e përgjegjësive të tij.
3. Avokati i Popullit sipas nevojës mund të hapë zyra tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës.
4. Zyrave regjionale të Institucionit të Avokatit të Popullit, u sigurohen hapësira apo zyra të përshtatshme për punë në objektet publike, nga komunat.
5. Në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit do të funksionojnë njësi të veçanta për mbrojtjen e kategorive të posaçme të të drejtave të njeriut.

Neni 32

Personeli

1. Ndaj të punësuarve tjerë të Institucionit të Avokatit të Popullit zbatohen dispozitat ligjore në fuqi për nëpunësit civil.
2. Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit zgjidhet në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në një proces të hapur dhe transparent, bazuar në kriteret profesionale. Ndaj të punësuarve në IAP, zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit.

Neni 33

Angazhimi i këshilltarëve dhe ekspertëve të jashtëm

Avokati i Popullit, sipas nevojës mund të angazhoj, këshilltarë dhe ekspertë të jashtëm, për t'i shërbyer për një periudhë të caktuar.

Neni 34

Pagat

Pagat në Institucionin e Avokatit të Popullit rregullohen sipas ligjit përkatës për Pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 35

Financimi

1. Institucioni i Avokatit të Popullit financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon atë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës, cili nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm. Buxheti mund të shkurtohet vetëm me miratimin e Avokatit të Popullit.

3. Në rast të shtimit të obligimeve dhe kompetencave të Insitucionit të Avokatit të Popullit me këtë ligj dhe ligje të tjera, kjo përcillet edhe me burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.

4. Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 36

Pranimi i donacioneve

Institucioni i Avokatit të Popullit mund të pranojë donacione shtesë nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, për të cilat njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të cilat nuk ndikojnë në pavarësinë financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe që nuk ndikojnë në pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit ose në të drejtat e tij prej Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Neni 37

Rregulloret e Institucionit

1. Avokati i Popullit nxjerrë Rregulloren e punës, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.

2. Rregulloret e nxjerra nga Avokati i Popullit hyjnë në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Dispozitat kalimtare

1. Avokati i Popullit ka kompetenca edhe për rastet që paraqiten para hyrjes në fuqi të këtij ligji kur nga faktet rezulton vazhdimi i shkeljes së një ose më shumë standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose përbëjnë keqpërdorim të vazhdueshëm të pushtetit.

2. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit nxjerrë Rregulloret e parapara me këtë ligj.

3. Brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit fillon me ushtrimin e kompetencave dhe obligimeve ligjore si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

Neni 39

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji nr.03/L-195 për Avokatin e Popullit dhe të gjitha dispozitat tjera që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 40

Hyrja në Fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -019
28 maj 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-015-2015, datë 15.06.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 03/L-121

PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të rregullimit të mëtejshëm të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I

ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Dispozitat e përgjithshme

**Neni 1
Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon më tej organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kualifikimet tjera përkatëse për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parimet dhe rregullat themelore procedurale dhe çështje tjera organizative.

* * * * *

KREU II

PROCEDURA

1. Dispozitat e përgjithshme procedurale

**Neni 16
Rregulli i përgjithshëm**

1. Dispozitat e kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.

2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese.

**Neni 17
Parimi i Publicitetit**

1. Seancat, përfshirë edhe shpallja e aktgjykimeve janë të hapura për publikun.
2. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të përjashtojë publikun kur vlerëson që është e nevojshme për ruajtjen e:
 - 2.1. sekretit shtetëror, rendit ose moralit publik;
 - 2.2. informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi publik;
 - 2.3. jetës private ose sekretit afarist të palës në procedurë.
3. Procedura për përjashtimi e publikut nga paragrafi 2 mund të iniciohet me kërkesën e palës.
4. Gjatë procesit të këshillimit dhe votimit në kuadër të marrjes së vendimit nga Gjykata Kushtetuese, marrin pjesë vetëm gjyqtarët.

* * * * *

Neni 19 Marrja e vendimeve

1. Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.
3. Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
4. Secili gjyqtar është i obliguar për të votuar për ose kundër vendimit.

Neni 20 Vendimet

1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.
3. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruara, nga kryetari i gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari raportues. Përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtareve përcaktojnë vendimin e gjykatës. Vendimet shpallen publikisht.
4. Vendimi i dërgohet secilës palë sipas detyrës zyrtare dhe shpallet në Gazetën Zyrtare.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese në vendim ka caktuar ndryshe.

Neni 21 Përfaqësimi

Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.

Neni 22 Procedimi i kërkesës

1. Fillimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Kërkesat dorëzohen me shkrim në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria regjistron menjëherë të gjitha kërkesat në regjistrin e Gjykatës Kushtetuese sipas radhës në të cilën janë parashtruar. Kërkesat duhet të jenë të arsyetuara dhe atyre duhet të ju bashkëngjiten provat e nevojshme.

2. Sekretaria ia dërgon nga një kopje të kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Pala kundërshtare ka dyzet e pesë (45) ditë nga pranimi i kërkesës për të dorëzuar në Sekretari përgjigjen e saj në kërkesë së bashku me arsyetimin dhe provat e nevojshme.

3. Sekretari ia dërgon kërkesën dhe përgjigjen në kërkesë gjyqtarit raportues i cili përgatit raportin paraprak lidhur me faktet, lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës. Gjyqtari raportues caktohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.

5. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë gjyqtari raportues ia dërgon kolegjit shqyrtues raportin paraprak. Në rast se përgjigja në kërkesë nuk dorëzohet brenda afatit të paraparë ose sipas natyrës së procedurës së veçantë nuk kërkohet një përgjigje në kërkesë, gjyqtari raportues përgatit raportin paraprak vetëm në bazë të kërkesës.

6. Kolegji shqyrtues vlerëson lejueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues përbëhet nga tre gjyqtarë të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës.

7. Nëse kolegji shqyrtues unanimisht vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e lejueshme, kolegji ia dërgon të gjithë gjyqtarëve propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë. Kolegji shqyrtues merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të siguroj se kopja e propozim-vendimit u është dërguar gjyqtarëve që mund të mos jenë në territorin e Republikës së Kosovës.

8. Nëse brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve prej pranimi të propozim-vendimit gjyqtarët që nuk kanë qenë anëtarë të kolegjit shqyrtues nuk kundërshtojnë këtë propozim-vendim, atëherë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë.

9. Në rast se kolegji shqyrtues vjen në përfundim se kërkesa është e lejueshme apo nëse të paktën njëri prej gjyqtarëve që nuk ka qenë anëtar i kolegjit shqyrtues kundërshton propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa, lënda i dërgohet trupit gjykues. Trupi gjykues gjatë shqyrtimit verbal shqyrton në tërësi lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës dhe merr vendim sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 23 Tërheqja e palës

Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i'u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.

Neni 24 Shqyrtimi verbal

Shqyrtimi verbal kryesohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Procedura e shqyrtimit verbal përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 25 Provat

Procedura e administrimit dhe shqyrtimit të provave përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 26 Bashkëpunimi me organet tjera publike

Të gjitha gjykatat dhe organet publike të Republikës së Kosovës kanë për detyrë të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj.

Neni 27 Masat e përkohshme

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.
2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

Neni 28 Shpenzimet e procedurës

1. Palët i bartin shpenzimet e tyre të procedurës, përveç nëse Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.
2. Pala e cila ka ngritur kërkesë sipas nenit 113, pika 7 të Kushtetutës lirohet nga detyrimi për mbulimin e shpenzimeve të procedurës nëse Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa në fjalë është e lejueshme dhe e bazuar.

KREU III

PROCEDURAT E VEÇANTA

1. Procedura në rastet e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 29 Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.
2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.
3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Neni 30 Afatet

Kërkesa e ngritur ne pajtim me nenin 29 te këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit te kontestuar.

* * * * *

10. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës

Neni 46 Lejueshmëria

Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.

Neni 47 Kërkesa individuale

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48 Saktësimi i kërkesës

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49 Afatet

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

Neni 50 Kthimi në gjendjen e mëparshme

Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.

* * * * *

Neni 58 Hyrja ne Fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Shpallur me dekretin Nr. DL-070-2008, datë 30.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu**

Ligji Nr. 05/L -025

PËR SHËNDETIN MENDOR

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SHËNDETIN MENDOR

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Me këtë ligj përcaktohen procedurat, kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1 **Shëndet mendor** - Shëndeti mendor përcaktohet si gjendje e mirëqenies në të cilin individit realizon potencialin e tij/saj, mund të përballë me streset normale të jetës, mundet të punoj me produktivitet dhe të jap kontribut për veten dhe komunitetin;

1.2. **Çrregullim mendor** - çrregullimi thelbësor i mendimit, ndjenjave, perceptimit, orientimit ose kujtesës që dëmton sjelljen, gjykimin dhe kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës si rezultat i sëmundjes mendore, prapambetjes mendore kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme si dhe çrregullimeve për shkak të abuzimit me alkool dhe droga;

1.3. **Institucion i shëndetit mendor** - Institucioni shëndetësor që ofron mundësitë e diagnostifikimit, trajtimit dhe rehabilitimit të personave me çrregullime mendore;

1.4. **Psikiatër** - mjek specialist i fushës së psikiatrisë ose neuropsikiatrisë;

1.5. **Fëmijë** - personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet:

1.5.1. **I mitur** - personi ndërmjet moshës katëmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;

1.5.1.1. **I mitur i ri** - personi ndërmjet moshës katëmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;

1.5.1.2. **I mitur i rritur** - personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

1.6. **Ekipe multidisciplinare** - ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, këshilltarë psikosocial, terapeutë të punës, logopedë, terapeutë zhvillimi apo profesionist të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor;

1.7. **Pranimi në Institucion shëndetësor** - procedura nga ardhja apo sjellja e personit për kontroll apo pranim deri te marrja e vendimit për trajtim të vullnetshëm apo ndalim të pavullnetshëm në atë Institucion;

1.8. **Kujdes për shëndetin mendor** - tërësia e veprimeve dhe masave që ndikojnë në vënien e diagnozës së çrregullimeve mendore dhe trajtimin e rehabilitimin e personave me çrregullime mendore, si dhe të gjitha masat e tjera që ndikojnë në parandalimin e këtyre çrregullimeve;

1.9. **Miratim i informuar** - miratimi i dhënë prej një personi, i cili ka zotësinë të kuptojë përmbajtjen e miratimit dhe pasojat e dhënies apo të refuzimit të miratimit;

1.10. **Rehabilitimi** - rikthimi dhe ruajtja e aftësive adaptuese sociale të një personi me çrregullim mendor;

1.11. **Stigmë** - sjellja e përbuzjes, nënçmimit ose e mosrespektimit ndaj një personi me çrregullime mendore;

1.12. **Trajtim** - tërësia e veprimeve të vlerësimit, diagnostikimit, trajtimit dhe rehabilitimit, që përfshin marrëdhëniet ndërmjet pacientit dhe ekipit multidisciplinar të institucioneve të kujdesit për shëndetin mendor dhe akterve të tjerë të përfshirë në kujdesin shëndetësor;

1.13. **Trajtim i vullnetshëm** - trajtimi me kërkesë ose miratim të personit që vuan nga çrregullimi mendor ose me kërkesë të përfaqësuesit ligjor;

1.14. **Trajtim i pavullnetshëm** - trajtimi i një personi që vuan nga një çrregullim serioz mendor, që kryhet pa miratimin e tij/saj dhe konfirmohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor;

1.15. **Terapia elektrokonvulsive** - trajtimi i çrregullimeve mendore, përmes shfrytëzimit të rrymës elektrike me qëllim kurimi të rasteve specifike rezistente në forma tjera të trajtimit;

1.16. **Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)** - organizatë e pavarur shëndetësore me rëndësi të veçantë publike në nivelin e kujdesit dytësor dhe tretësor të kujdesit

shëndetësor, me cilësi të personit juridik, që ka të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi;

1.17. **Komisioni psikiatrik–ligjor** - është komision profesional i cili jep vlerësimin për gjendjen mendore të klientit-pacientit.

Neni 4

Mbrojtja dhe promovimi i shëndetit mendor

Mbrojtja dhe promovimi i shëndetit mendor kryhet nëpërmjet masave që kontribuojnë në sigurimin ose rivendosjen e ekuilibrit mendor të individit, duke fuqizuar kapacitetet individuale, duke promovuar integritetin, duke përmirësuar pranimin dhe duke luftuar diskriminimin e stigmën në mjedisin social të tij.

Neni 5

Parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor

1. Parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor janë:

1.1. Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor;

1.2. Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social;

1.3. Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore;

1.4. Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekipe multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit;

1.5. Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime mendore në përputhje me aktet ndërkombëtare të aplikuara në Kosovë;

1.6. Në të gjitha instancat ku personat janë nën moshën tetëmbëdhjete (18) vjet, duhet të merret si faktor udhëzues gjatë marrjes së vendimit, parimi në interes me të mirë të fëmijës.

Neni 6

Të drejtat e personave me çrregullime mendore

1. Personat me çrregullime mendore gëzojnë:

1.1. të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë;

1.2. të drejtën të marrin shërbim shëndetësor të arritshëm dhe efikas në kushte të barabarta si të gjithë pacientët e tjerë;

1.3. të drejtën për trajtim dhe mbrojtje, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre;

1.4. të drejtën për të pranuar ose jo ndërhyrjen e propozuar diagnostike e terapeutike, përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë ligj;

- 1.5. të drejtën për t'u informuar për të drejtat e tyre, si dhe për të qenë pjesë e hartimit të planit individual të trajtimit;
- 1.6. të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga gabimi në trajtim ose keqtrajtimet e mundshme;
- 1.7. të drejtën për të kërkuar rishqyrtimin e shtrimit apo mjekimit të detyruar;
- 1.8. të drejtën për konfidencialitet mbi të dhënat për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore;
- 1.9. të drejtën për të mos u detyruar forcërisht të ekzaminohen nga pikëpamja mjekësore me qëllim përcaktimin e një çrregullimi mendor të mundshëm, me përjashtim të rasteve sipas procedurave të parapara në këtë ligj;
- 1.10. të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë;
- 1.11. të drejtën për t'u ankuar për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.

2. Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime mendore mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Këto kufizime varen nga gjendja shëndetësore e klientit dhe nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Konventat ndërkombëtare të pranuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Neni 7

Konfidencialiteti

Personat që zhvillojnë veprimtari të parashikuara në këtë ligj, janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e të gjithë informacionit të marrë nga pacienti në institucionet shëndetësore. Këta persona përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së fshehtësisë profesionale vetëm kur informacioni i jepet mjekut kurues të të sëmurit dhe/ose organizmave të përkrahjes sociale, si dhe organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 8

Mbrojtja nga diskriminimi dhe trajtimet çnjerëzore

1. Personave me çrregullime mendore u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe dispozitave ligjore në fuqi.
2. Ndalohet çfarëdo shkelje, nënçmimi, torture, dënimi apo trajtimi çnjerëzor ndaj personit me çrregullime mendore.

Neni 9

Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar

1. Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Në raste të veçanta kjo masë mund të propozohet me kërkesë të komisionit psikiatriko - ligjor. Vendimi përkatës merret nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja dhe mandati i Komisionit psikiatriko–ligjor, do të rregullohet me akt nënligjorë të cilin e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë.

3. Titullari i shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe/ose persona të tjerë që kanë interesa të ligjshme, duhet të njoftojnë gjykatën themelore nëse konstatojnë që kujdestari ligjor i personit me çrregullime mendore nuk i përmbush detyrimet e tij. Në këtë rast, gjykata vendos për zëvendësimin e kujdestarit.

4. Masat në rastin e mospërmbushjes së kërkesave, bashkëpunimit dhe përkujdesjes së familjarit /kujdestarit ligjor ndaj të sëmurit me çrregullim serioz mendor rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë.

KREU II SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR

Neni 10 Kategoritë e shërbimeve

1. Shërbimet shëndetësore, përmes të cilave ofrohet kujdesi për shëndetin mendor janë:

1.1. Kujdesi shëndetësor parësor;

1.2. Kujdesi shëndetësor dytësor;

1.3. Kujdesi shëndetësor tretësor.

Neni 11 Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor

1. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor për shëndetin mendor është shërbimi që ofrohet nga mjekët e familjes dhe shërbimi i infermierisë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor.

2. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor bazohet në paketën bazë të shërbimit të kujdesit parësor ku përfshihet identifikimi, referimi dhe përcjellja e klientit me çrregullime mendore.

Neni 12 Shërbimi i kujdesit shëndetësor dytësor

1. Shërbimet e shëndetit mendor të nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor janë pjesë e SHSKUK dhe përfaqësohen me:

1. Departamentet e Psikiatrisë në kuadër të Spitaleve të Përgjithshme;

2. Qendrat e shëndetit mendor në bashkësi dhe Shtëpitë integruese;

3. Qendra për Integrim, rehabilitim, risocializim të të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.

Neni 13 Shërbimi i kujdesit shëndetësor tretësor

1. Shërbimet e shëndetit mendor të nivelit tretësor ofrohen në SHSKUK dhe atë në:

- 1.1. Klinikën e psikiatrisë;
- 1.2. Institucionin përkatës të Psikiatrisë Forenzike;
- 1.3. Institucionin përkatës të Sëmundjeve të Varësisë.

Neni 14

Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë

1. Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët janë pjesë përbërëse e shërbimeve në të gjitha kategoritë e shërbimeve të shëndetit mendor siç janë parashikuar në nenin 10, nënparagrafi 1.1, nenin 12, paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, dhe neni 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të këtij ligji.
2. Në shërbimet spitalore të shëndetit mendor, fëmijët nuk mund të vendosen në hapësira të përbashkëta me personat e rritur.
3. Opinion i fëmijës duhet të merret parasysh në rastet e trajtimit të pavullnetshëm dhe vendosjes së pavullnetshme në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës”.

Neni 15

Menaxhimi i shërbimeve të shëndetit mendor

1. Shërbimet e shëndetit mendor në kujdesin parësor shëndetësor menaxhohen në bazë të Statutit të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, ndërsa shërbimet e shëndetit mendor të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor menaxhohen në bazë të Statutit të SHSKUK.
2. Në të gjitha nivelet e shërbimeve të shëndetit mendor zbatohen programe unike të trajtimit të bazuara në të dhëna shkencore dhe protokolle të propozuara nga Odat e profesionistëve shëndetësor dhe të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

KREU III

NDËRGJEGJËSIMI NË LIDHJE ME ÇRREGULLIMET MENDORE

Neni 16

Kujdesi në familje

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës garanton mbështetjen psikologjike, psiko-pedagogjike, shërbimet e ndihmës personale ose familjare, si dhe mbështetje financiare përmes skemave të parapara me dispozitat ligjore për personat me aftësi të kufizuara apo personat me çrregullime mendore.
2. Familjet, që kanë persona me çrregullime mendore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse që merren me kujdesin, trajtimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime mendore, kujdesen dhe mbështesin këta persona për integrimin e tyre në familje, komunitet dhe shoqëri.
3. Organet e pushtetit lokal dhe Qendrat për punë sociale, brenda kompetencave të tyre, në bashkëpunim me strukturat shëndetësore, marrin të gjitha masat për të mbështetur personat me çrregullime mendore dhe familjet e tyre.

Neni 17

Riaftësimi profesional

1. Personat me çrregullime mendore gëzojnë të drejtën të përfitojnë nga politikat e aftësisimit dhe riaftësisimit profesional kur gjendja shëndetësore dhe arsimore e lejojnë një gjë të tillë.
2. Mënyra e përfitimit dhe përfshirja e personave me çrregullime mendore në këto politika përcaktohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 18

Shëndeti mendor në institucionet rezidenciale të përkujdesit social

1. Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.

KREU IV

TRAJTIMI NË SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR TË SPECIALIZUAR ME SHTRETËR

Neni 19

Trajtimi i vullnetshëm

1. Personi me çrregullime mendore merr trajtim të vullnetshëm në shërbimin e shëndet mendor të specializuar me shtretër, pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kusht të informimit paraprak.
2. Miratimin për të miturit ose personat me zotësi të kufizuar për të vepruar e jep kujdestari ose përfaqësuesi i tyre ligjor. Në rastet kur i mituri ose personi me zotësi të kufizuar është në gjendje të shpreh mendimin e tij/saj, dhe megjithatë i është nënshtruar trajtimit me kërkesë të kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të tij/saj, ai ka të drejtë të ankohet ndaj një vendimi të tillë pranë gjykatës me përfaqësim të pavarur.
3. Miratimi i informuar sigurohet nëpërmjet diskutimit me pacientin për natyrën dhe qëllimin e ndërhyrjes terapeutike të propozuar. Përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar janë pjesë e kartelës klinike të pacientit. Pacienti nënshkruan për dhënien e miratimit si në kartelë ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar.
4. Personi me çrregullime mendore referohet për në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, pasi ka kryer ekzaminimin paraprak nga mjeku në shërbime shëndetësore parësore, shërbimet e shëndetit mendor në komunitet apo shërbimet tjera ambulatore shëndetësore publike apo private.
5. Personi me çrregullime mendore, kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen, refuzimin apo të ankohen për trajtimin në çdo moment të procesit, gjë e cila mund të kundërshtohet vetëm kur përmbushen kriteret për trajtim të pavullnetshëm.
6. Trajtimi i vullnetshëm i një personi me çrregullime mendore në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër nuk mund të shërbejë për asnjë rast për qëllim të shqyrtimit të aftësisë për punë, përveç në rastet specifike kur kërkohet nga Komisioni përkatës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 20

Trajtimi i pavullnetshëm

1. Subjekt i trajtimit të pavullnetshëm është personi, i cili shtrohet në mënyrë të pavullnetshme në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër ose pasi është shtruar në mënyrë të vullnetshme mbahet në mënyrë të pavullnetshme, sipas përcaktimit të Komisionit të mjekëve specialist:

1.1. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja dhe mandati i Komisionit të mjekëve specialist, do të rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë.

2. Rastet, për të cilat gjykohet se një person me çrregullime mendore duhet të trajtohet në mënyrë të pavullnetshme, janë kur:

2.1. ka një çrregullim të rëndë mendor që kufizon aftësinë e tij/ saj për të kuptuar ose kontrolluar sjelljen e tij/ saj;

2.2. pa trajtimin e pavullnetshëm personi rrezikon jetën, shëndetin ose sigurinë e vetes apo të tjerëve;

2.3. janë shterruar mundësitë ekzistuese për trajtimin shëndetësor në komunitet dhe mjekimi i nevojshëm jepet vetëm nëpërmjet shtrimit në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, në përputhje me parimet sa më pak shtrënguese të trajtimit;

2.4. opinionin e personit të prekur është marrë parasysh;

2.5. nuk ka në dispozicion masa me pak ndërhyrëse të ofrimit të kujdesit të duhur.

3. Vendimi për trajtim të pavullnetshëm të një personi merret nga Komisioni i mjekëve specialist vetëm pasi të ketë kryer ekzaminimin e tij. Personi me çrregullime mendore, familjarët e tij të afërt ose kujdestari ligjor gëzojnë të drejtën të informohen për shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe për të drejtat që pacienti gëzon në këtë gjendje.

4. Trajtimi i pavullnetshëm i një personi me çrregullime mendore në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër nuk mund të shërbejë për asnjë rast për qëllim të shqyrtimit të aftësisë për punë.

5. Procedurat e trajtimit dhe të informimit të pacientit dhe personave tjerë të interesuar bëhet konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 21

Të drejtat e personit që do t'i nënshtrohet trajtimit të pavullnetshëm

1. Pacienti, i cili i nënshtrohet trajtimit të pavullnetshëm, ka të drejtë:

1.1. t'i sigurohet në të gjitha rastet informacioni për të drejtat e tij;

1.2. të përfaqësojë personalisht interesat e ligjshme gjatë veprimeve procedurale gjatë shtrimit të pavullnetshëm. Në situata ku gjendja shëndetësore nuk e lejon, këto interesa përfaqësohen nga përfaqësuesi ligjor;

1.3. t'i garantohet mbrojtja ligjore në të gjitha veprimet procedurale në të cilat ai merr pjesë, si dhe në ato veprime procedurale, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të dhe ku ai nuk është i pranishëm;

1.4. t'i shpjegohen me shkrim brenda dyzet e tetë (48) orëve arsyet e trajtimit të pavullnetshëm;

1.5. të apelojë vendimin e trajtimit të pavullnetshëm pranë gjykatës kompetente;

1.6. e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare duke përfshirë edhe privatësinë e komunikimit dhe korrespondencës.

Neni 22

Procedura për shtrimin në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër për personat që kanë nevojë për trajtim të pavullnetshëm

1. Personi i gjendur në rrethanat e parashikuara në nenin 19, të këtij ligji, dërgohet në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër nga personeli mjekësor i shërbimeve të urgjencës, një person i afërt i tij/saj ose nga çdo nëpunës ose person tjetër që vihet në dijeni për gjendjen shëndetësore.

2. Policia e Kosovës, me kërkesë të personelit mjekësor, e ndihmon atë gjatë kryerjes së vizitave mjekësore dhe transferimit të personit në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe garanton mbrojtjen e përkohshme të pronës së tij. Në rastet kur mungon ndihma e menjëhershme e personelit mjekësor, Policia e Kosovës detyrohet të shoqërojë personin në prani të familjarëve ose të të afërmeve të tjerë në shërbimin e urgjencës mjekësore më të afërt.

3. Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm të personit, informon menjëherë personelin mjekësor ose policor që e ka shoqëruar, familjarët dhe personat e tjerë që e shoqërojnë si dhe përfaqësuesin ligjor, nëse është i pranishëm. Personi gëzon të drejtën të komunikojë me personat pranë tij apo përfaqësuesin e tij ligjor.

4. Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për shtrimin e pavullnetshëm, brenda njëzet e katër (24) orëve.

Neni 23

Rishikimi i trajtimit të pavullnetshëm

1. Shefi i shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër urdhëron me shkrim në kartelën mjekësore rivlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit të shtruar në mënyrë të pavullnetshme. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i mjekëve specialist që nuk ka marrë pjesë në procedurën fillestare të shtrimit dhe trajtimit të pavullnetshëm.

2. Pas rivlerësimit të gjendjes shëndetësore, personeli mjekësor plotëson kartelën mjekësore me të gjitha shënimet e nevojshme dhe referon pranë shefit të shërbimit nëse trajtimi i pavullnetshëm është i bazuar apo i pabazuar ose nuk ekzistojnë më shkaqet që personi të mbahet në kushte të tilla.

3. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se nuk ekzistojnë më shkaqet që personi të mbahet në kushte trajtimi të pavullnetshëm dhe urdhëron nxjerrjen e menjëhershme të personit nga trajtimi i pavullnetshëm. Vendimi i shefit të shërbimit dhe arsyet e tij shënohen në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore.

4. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se ekzistojnë shkaqet që personi të mbahet në kushte trajtimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të marrë trajtimin e pavullnetshëm në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda dyzet e tetë (48) orëve, udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit

mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës themelore për të vlerësuar procedurën e kryer. Një kopje e kërkesës i vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit ligjor të tij.

Neni 24

Trajtimi i pavullnetshëm me vendim gjykate

1. Gjyqtari e shqyrton kërkesën e paraqitur nga udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e trajtimit të pavullnetshëm, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga paraqitja e saj.
2. Vendimi i gjyqtarit zbatohet menjëherë nga shërbimi i specializuar i shëndetit mendor me shtretër.
3. Në çdo rast, kur nuk ekzistojnë më shkaqet për trajtim të pavullnetshëm, udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, familjarët ose përfaqësuesi ligjor parashtrajnë në gjykatën kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës.

Neni 25

Trajtime të veçanta mjekësore dhe kirurgjikale

1. Çdo trajtim mjekësor dhe kirurgjikal, përfshirë dhe terapinë elektrokonvulsive te personat me çrregullime të shëndetit mendor, zbatohet, në çdo rast, në interes të nevojave shëndetësore të pacientit, duke e informuar dhe marrë miratimin e pacientit ose të përfaqësuesit të tij ligjor në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Terapia elektrokonvulsive zbatohet pas miratimit të informuar të vetë pacientit ose përfaqësuesit të tij ligjor, sipas protokolleve të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë. Terapia elektrokonvulsive nuk zbatohet tek te fëmijët:
 - 2.1. Vendimin për aplikimin e Terapisë elektrokonvulsive e merr nga komisioni i mjekeve specialistë;
 - 2.2. Terapia elektrokonvulsive mund të aplikohet vetëm në institucionet e kujdesit shëndetësor tretësor.
3. Terapia elektrokonvulsive nuk zbatohet tek fëmijët.
4. Rregullat e etikës profesionale, në bazë të të cilave kryhen procedurat mjekësore dhe kirurgjikale, zbatohen edhe në rastet e personave me çrregullime mendore.

Neni 26

Kërkimet hulumtuese dhe shkencore

Kërkimet hulumtuese dhe shkencore ndaj personave me çrregullime mendore ndërmerren vetëm pasi të jetë marrë miratimi i informuar nga këta pacientë.

Neni 27

Kufizimi fizik

1. Kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe përfshin, sipas protokollit përkatës, elementet e mëposhtme:

- 1.1. Mbajtjen me forcë të personit;
 - 1.2. Përdorimin e detyruar të medikamenteve;
 - 1.3. Imobilizimin;
 - 1.4. Izolimin.
2. Kufizimi fizik zbatohet për periudha të shkurtra kohore me objektiva të qarta, sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Të gjitha procedurat e ndjekura për realizimin e kufizimit fizik dhe arsyet e ndërmarrjes së tyre përshkruhen në mënyrë të hollësishme në kartelën e pacientit.
3. Gjatë kufizimit fizik, kontakti i stafit të shërbimit të shëndetit mendor me klientin duhet të jetë aktiv dhe i vazhdueshëm, që shkon përtej monitorimit rutinë, sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Ndalohet përdorimi i kufizimit fizik si mjet ndëshkimi ose si mjet më lehtësues për stafin e shërbimit.
5. Kufizimi fizik zbatohet në kushtet kur:
- 5.1. Autorizohet nga mjeku psikiatër me shkrim;
 - 5.2. Kryhet në formën më pak kufizuese/shtrënguese që ofron siguri dhe kontroll të sjelljes agresive të pacientit;
 - 5.3. Forca e përdorur është në përpjesëtim të drejtë me rrezikun e perceptuar;
 - 5.4. Shërbimi i shëndetit mendor i specializuar me shtretër ka infrastrukturën e nevojshme për të zbatuar në mënyrë sa më të sigurt kufizimin fizik sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.
6. Klienti/familjari, përfaqësuesi ligjorë ose institucioni shtetëror përkatës, duhet të informohet brenda dyzetë e tetë (48) ore, kur klienti është apo bëhet subjekt i kufizimit fizik.

KREU V
SHËNDETI MENDOR NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT
TË VENDIMEVE PENALE

Neni 28

Shëndeti mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

1. Institucionet shëndetësore për ekzekutimin e vendimeve penale janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime mendore që kanë kryer vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion shëndetësor, apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime mendore gjatë vuajtjes së dënimit.
2. Çdo person, që gjendet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuan nga çrregullimi mendor, gëzon të drejtën e trajtimit të barabartë shëndetësor brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, sipas të njëjtave standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë për institucionet e tjera shëndetësore.
3. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor, sipas nevojave ofron asistencën e duhur për diagnostikimin, kurimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve me çrregullime mendore që mbahen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

4. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë i propozojnë Qeverisë për miratim aktin nënligjor ku i përcaktojnë rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve të shëndetit mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

KREU VI MONITORIMI I SHËNDETIT MENDOR

Neni 29

Këshilli Profesional për Shëndetin Mendor

1. Këshilli Profesional për Shëndetin Mendor është organ këshillimor i Ministrit të Shëndetësisë. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja si dhe mandati i Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor, përcaktohet me akt nënligjor të cilin e propozon Ministria e Shëndetësisë dhe e miraton Qeveria.

2. Këshilli profesional për Shëndetin Mendor këshillon Ministrin e Shëndetësisë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe për rishikime të rëndësishme ligjore, organizative e teknike në fushën e shëndetit mendor.

Neni 30

Monitorimi i jashtëm i shërbimit të shëndetit mendor

Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmave të tij, vëzhgon rregullisht me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor.

Neni 31

Pjesëmarrja e organizatave jofitimprurëse

1. Ministria e Shëndetësisë mbështet iniciativat e organizatave jofitimprurëse që synojnë asistencë në realizimin e objektivave strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë në zhvillimin dhe përmirësimin e institucioneve të kujdesit të shëndetit mendor, si dhe të atyre organizatave që synojnë monitorimin e jashtëm e të pavaruar të respektimit të të drejtave të njeriut në këtë sektor.

2. Veprimtaria e organizatave jofitimprurëse në ambientet e institucioneve të kujdesit të shëndetit mendor rregullohet në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë. Në çdo rast gjatë kësaj veprimtarie, këto organizata respektojnë legjislacionin në fuqi dhe ofrojnë siguri të nevojshme të përdorimit etik dhe ligjor të të dhënave personale dhe konfidenciale.

Neni 32

Shqyrtimi i kërkesave/ankesave nga grupe interesi

1. Institucionet, që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor, janë të detyruara që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë punë të shqyrtojnë të gjitha kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarëve ose personave të interesuar për mbrojtjen e interesave të të sëmurëve mendorë.

2. Pala e interesuar ka të drejtë të parashtrijë ankesë kundër vendimit të institucioneve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në Ministrinë e Shëndetësisë brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) dite punë. Ministria e Shëndetësisë duhet ti përgjigjet palës në ankesën e saj brenda afatit tridhjetë (30) ditë punë.

3. Kundër vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë, pala ka të drejtë të ankohet në Gjykatën kompetente brenda afatit ligjor.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 33
Dispozitat ndëshkuese

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, si më poshtë:

1.1. Shkelja e nenit 7, nxjerrja e sekretit profesional me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj, dënohet me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në tre (3) vjet;

1.2. Shkelja e paragrafit 1 të nenit 19, kryerja e trajtimit të vullnetshëm pa marrë miratimin e informuar, dënohet me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në tre (3) vjet;

1.3. Shkelja e paragrafit 3 të nenit 20, mosinformimi për të drejtat dhe arsyet e trajtimit, dënohet me gjobë pesëqind (500) euro;

1.4. Shkelja e paragrafit 4 të nenit 22, mosnjoftimi në afat i shefit të shërbimit, dënohet me gjobë pesëqind (500) euro;

1.5. Shkelja e paragrafit 4 të nenit 23, mosrespektimi i afateve të vendosura, dënohet me gjobë pesëqind (500) euro;

1.6. Shkelja e nenit 25, kryerja e trajtimeve të veçanta mjekësore dhe kirurgjikale, në kundërshtim me këtë nen, dënohet me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në tre (3) vjet dhe gjobë një mijë (1.000) euro;

1.7. Shkelja e nenit 26, kryerja hulumtimeve për qëllime shkencore pa miratimin e pacientëve, dënohet me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit, deri në tre (3) vjet dhe gjobë një mijë (1.000) euro.

2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobës për shkeljet nga paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 i këtij neni është Inspektoriati i Ministrisë së Shëndetësisë.

3. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobës për shkeljet nga paragrafi 1.1, 1.6 dhe 1.7 i këtij neni është Oda e Profesionistëve Shëndetësor.

Neni 34
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Për zbatimin e këtij ligji, në afat brenda një (1) viti, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përkatëse nxjerrin aktet përkatëse nënligjore të cilat parashihen me këtë ligj.

2. Aktet nënligjore që janë të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 35
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -025

24 tetor 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-030-2015, datë 13.11.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

LIGJI NR. 03/L-022

PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të kreut 5.1 (j) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë;

Duke u nisur nga fakti se Kosova garanton të drejtat e përcaktuara me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;

Duke u nisur nga fakti se në Kosovë ndalohet diskriminimi i fëmijëve në çfarëdo baze;

Duke pasur parasysh rëndësinë, rolin dhe vështirësitë e familjes në mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme,

Miratton këtë

LIGJ PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME

KREU I

Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përmendura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

“Fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme fizike, mendore dhe shqisore” konsiderohen fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.

“Parashtruesi i kërkesës për ndihmë materiale dhe kujdes” nënkupton personin që paraqet kërkesën për përkrahje materiale.

“Autoriteti përkatës” nënkupton Departamentin e Mirëqenies Sociale ose ndonjë organ tjetër të cilin MPMS-ja e autorizon për administrimin e përkujdesjes .

“Përkujdesje” nënkupton një beneficium që administrohet nga MPMS-ja, dhe shërben për të ofruar

mbështetje materiale personave që e ofrojnë këtë ndihmë dhe kujdes.

“Përkrahje materiale” është benificion në formë të shumës financiare mujore ose formë tjetër e shpërblimit në të holla që administrohet nga MPMS-ja, për familje me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

“Komisioni mjekësor” nënkupton një grup të përbërë prej ekspertëve mjekësor, të emëruar nga MPMS-ja për ta përcaktuar shkallën e gjendjes shëndetësore të fëmiut.

“Ekspert” nënkupton personin që ka kryer specializimin nga fusha e mjekësisë dhe është i licencuar si ekspert.

“Shuma mujore” nënkupton shumën e saktë të mjeteve materiale që duhet t'i paguhet familjes me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

“Bashkësia familjare” përkufizohet si një grup individësh që jetojnë bashkë nën një kulm dhe që bashkërisht ndajnë shpenzimet e jetesës. Sipas këtij Ligji, bashkësia familjare mund të përfshijë personat që nuk janë anëtarë të familjes në kuptimin e ngushtë.

“Familja” është bashkësi e cila përbëhet nga paraqitësi i kërkesës dhe të gjithë anëtarët e tjerë të familjes që ndodhen në bashkësinë familjare: bashkëshorti ose partneri i cili jeton bashkë me të, prindërit dhe fëmijët duke përfshirë edhe fëmijët e adoptuar, fëmijët e vendosur në familje, ose fëmijët e njërit nga partnerët.

“Vendim” është akti juridik të cilin e nxjerr autoriteti përkatës, Departamenti i Mirëqenies Sociale, për njohjen e të drejtës në ndihmë materiale familjes ose personit tjetër i cili kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuar.

“Ekspertiza” nënkupton procedurën e vërtetimit të llojit, shkallës së dëmtimit fizik, mendor, shqisore apo të kombinuar.

“Aftësia e kufizuar e përhershme” nënkupton gjendjen shëndetësore të fëmijës i cili plotësisht dhe përherë nuk mund të lëvizë ose të kryejë aktivitetet e përditshme jetësore pa ndihmën e personit tjetër.

“Fëmijë” nënkuptohet çdo person nën moshën 18 vjeçare me përjashtim kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

“MPMS” nënkupton Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 3

3.1. Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përpilon strategjinë e vet për këtë kategori të fëmijëve.

3.2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, siguron përkrahje materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, në pajtim me mundësitë buxhetore të Kosovës.

3.3. Ndhima materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, do të ofrohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Departamentit të saj të Mirëqenies Sociale.

3.4 Ndhima materiale mundëson fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme të bëjnë një jetë më normale në kushtet që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë jetën e tyre.

3.5. Ndhima materiale për fëmijën e me aftësi të kufizuar të përhershme paguhet në emër të prindit apo kujdestarit të fëmijës, përmes xhironlogarisë bankare.

KREU II

Realizimi i të drejtës në ndihmë materiale

Neni 4

4.1. E drejta në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme realizohet në formë të përkrahjes financiare në para.

4.2. Këto mjete materiale i jepen familjes ose kujdestarit i cili e ofron ndihmën dhe kujdesin për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershëm për të cilin i është njohur kjo e drejtë.

4.3. Lartësia dhe afatet për dhënien e ndihmës materiale përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore u takon fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë banor të Kosovës dhe janë me aftësi të kufizuar të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh.

Neni 6

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

a) fëmijët

b) fëmijët e verbër si dhe,

c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vetë, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale.

KREU III

Komisioni vlerësues për përcaktimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme

Neni 7

Komisioni vlerëson llojin, shkallën, dhe peshën e shëndetit fizik, mendor apo shqisor të dëmtuar të fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme.

Neni 8

8.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr vendim për themelimin e komisionit mjekësor për vlerësimin e shëndetit të fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët gëzojnë mbrojtjen e veçantë me këtë Ligj.

8.2. Me këtë vendim përcaktohet kompetenca territoriale e komisionit mjekësor.

8.3. MPMS-ja me aktvendim të veçantë themelon komisionin e shkallës së parë dhe komisionin mjekësor

të shkallës së dytë.

Neni 9

Përbërja e komisionit mjekësor dhe procedurat e njohjes së të drejtës në ndihmë e kujdes

9.1. Komisioni mjekësor përbëhet prej pesë (5) ekspertë.

9.2. Komisioni mjekësor përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari i komisionit, dhe tre (3) anëtarë, dhe numër të njëjtë të zëvendësve të tyre.

9.3. Për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të komisionit, si dhe zëvendësit e tyre caktohen personat me specializim të kryer pas fakultetit dhe me së paku pesë (5) vite përvojë pune në lëmit e tyre.

9.4. MPMS-ja në komision mund të caktojë edhe personin me kualifikim superior në lëmin e shkencave sociale, por jo më shumë se një (1) anëtar.

9.5. Anëtari i komisionit të shkallës së parë nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i komisionit të shkallës së dytë.

Neni 10

Komisioni i shkallës së parë

10.1 Për anëtar të Komisionit caktohen siç është e përshtatshme për rrethanat e rastit:

- a) nëpunës i shërbimeve sociale;
- b) mjek specialist i pediatriisë;
- c) mjek specialist i oftalmologjisë - ORL;
- d) mjek specialist fiziatër – ortoped;
- e) mjek specialist i neurologjisë ose neuropsikiatriisë;
- f) mjek specialist i psikiatriisë .

10.2. Çdo anëtar i Komisionit të shkallës së parë i caktohet zëvendës nga lëmi i njëjtë i specializimit.

10.3. Për kryetar të Komisionit të shkallës së parë emërohet mjeku specialist i pediatriisë.

Neni 11

Komisioni i shkallës së dytë

11.1 Për anëtar të Komisionit të shkallës së dytë caktohen siç është e përshtatshme për rrethanat e rastit:

- a) nëpunës i shërbimeve sociale,
- b) mjek specialist i pediatriisë,
- c) mjek specialist i oftalmologjisë -ORL
- d) mjek specialist fiziatër - ortoped,
- e) mjek specialist i neurologjisë ose psikiatriisë.

11.2. Çdo anëtar i Komisionit për ekspertizë në shkallë të dytë i caktohet zëvendësi nga lëmi i njëjtë i specializimit.

11.3. Për kryetarë të Komisionit të shkallës së dytë caktohet mjeku specialist i pediatriisë.

11.4. Kryetarit të Komisionit i caktohet zëvendësi, nga i njëjti specializim.

KREU IV

Procedura për ekspertizë

Neni 12

12.1. Qendra për Punë Sociale, në vijim QPS, e cila zhvillon procedurën për njohjen e ndihmës materiale, familjes me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, nëse konsideron se duhet të bëhet ekspertiza, nxjerr konkluzë dhe ia dorëzon të gjithë dokumentacionin komisionit të shkallës së parë për ekspertizë.

12.2. Në bazë të konkluzës së QPS-së dhe shënimeve të prezantuara, kryetari i Komisionit të shkallës së parë për çdo ekspertizë fton anëtarët e komisionit të cilët e japin mendimin me shkrim për rastin konkret, pasi të kenë shqyrtuar dokumentacionin dhe ta kenë ekzaminuar personin.

12.3. Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime të ndara për ekspertizën e bërë në rastin konkret, dhe pas analizës së të gjitha vlerësimeve të ekspertëve, përpilohet raporti i përbashkët me shkrim të cilin e nënshkruan kryetari i Komisionit si dhe të gjithë anëtarët e tjerë të cilët kanë marrë pjesë në ekspertizën e personit.

Neni 13

13.1. Komisioni i shkallës së parë është i obliguar që mendimin e vet lidhur me rastin ta dorëzojë më së voni në afatin prej njëzetënjë (21) ditëve nga dita e marrjes së përfundimit për kryerjen e ekspertizës.

13.2. Komisioni i dorëzon QPS-së raportin me shkrim në dy (2) kopje dhe të gjitha shënimet e tjera përcjellëse lidhur me rastin konkret.

13.3. Dokumentacioni lidhur me mendimin e dhënë në raport trajtohet si rreptësisht konfidencial në përputhje me nenin 4 të këtij Ligji.

13.4. Raporti i Komisionit duhet të përmbajë:

- a) shënimet personale të personit;
- b) diagnozën shëndetësore të personit;
- c) llojin, shkallën dhe peshën e dëmtimit fizik, mendor apo shqisor;
- d) ekzistimin e nevojës për ndihmë dhe kujdes të përhershëm;
- e) datën e raportit dhe nënshkrimin; dhe
- f) rekomandimin e mjekut për vlerësimin e serishëm të gjendjes shëndetësore.

Neni 14

Procedurat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Komisionit të shkallës së dytë

14.1. Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë të nxjerrë nga QPS-ja, vendim i cili është nxjerrë në bazë të raportit të Komisionit të shkallës së parë. QPS-ja të gjithë materialin ia dërgon Komisionit të shkallës së dytë për ekspertizë të re nëse kjo është e nevojshme për të vendosur në shkallën e dytë. Ankesa ushtrohet nëpërmjet organit i cili ka nxjerrë vendimin në shkallë të parë.

14.2. Komisioni i ekspertëve i shkallës së dytë ka të drejtë në bazë të dokumentacionit ekzistues dhe atij plotësues për rastin konkret sipas ankesës ta aprovoj, refuzoj ose ta kthejë lëndën në rishqyrtim tek Komisioni i shkallës së parë.

14.3. Raporti i Komisionit të shkallës së dytë jepet me shkrim në dy (2) kopje, i përmban të gjitha elementet si dhe raportin e Komisionit të shkallës së parë.

Neni 15

(1) Komisioni i cili kryen ekspertizën mban evidencën për punën e bërë administrative nga momenti i marrjes së konkluzës për kryerjen e ekspertizës, për dokumentet e marra, për seancat e mbajtura të Komisionit, për personat për të cilët është bërë ekspertiza.

Neni 16

16.1. Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për ekspertizë mund të kopenzohen në mënyrë të përshtatshme për kohën e tyre.

16.2. Lartësia e kompensimit, mënyra e pagesës caktohet në përputhje me programin për paga të rregulluar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti për mirëqenie sociale konform kohës dhe përpjekjeve të kushtuara.

16.3. Mandati i Komisioneve për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme zgjat dy (2) vjet.

KREU V

Procedurat Administrative të realizimit të të drejtave

Neni 17

Mjetet financiare për zbatimin e këtij Ligji sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Neni 18

18.1. Përkrahjen materiale mund ta realizojë personi gjegjësisht familja, pa marrë parasysh gjendjen materiale të ti/saj apo të familjes së tij/saj, nëse ka fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

18.2. Kërkesa për përkrahje materiale i dërgohet QPS-së, në çdo kohë deri sa fëmija me aftësi të kufizuar të përhershme t'i mbushë 18 vjeç.

18.3. Kërkesa paraqitet duke plotësuar formularin të cilin e përgatitë Departamenti për Mirëqenie Sociale dhe të njëjtës i bashkëngjiten dokumentet që kërkohen nga MPMS – Departamenti për Mirëqenie Sociale.

Neni 19

Kërkesës për realizimin e përkrahjes materiale duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- a) fotokopje e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës;
- b) lajmërimin e vendbanimit të fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme;
- c) certifikatën e lindjes, për fëmijën;
- d) aktvendimi për kujdestar, nëse kërkesën e parashtron kujdestari;
- e) dokumentacioni mjekësor me epikriz.

Neni 20

Realizimi i kësaj të drejte nënkupton shtesën e posaçme me të holla, të cilën Ministria ua jep familjes ose biresuesit apo kujdestarit tjetër të fëmijës me aftësi të kufizuar, e të cilët për shkak të sëmundjes së rëndë fizike, mendore apo shqisore të lindur ose të paraqitur më vonë, të cilët për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore janë të kushtëzuar në ndihmën e personave të tjerë, për çka familja ka shpenzime të shtuara dhe të jashtëzakonshme.

Neni 21

21.1 Drejtori i QPS-së nxjerr vendim në bazë të:

- a) kërkesës me shkrim, drejtuar QPS-së;
- b) fotokopje të letërnjoftimit;
- c) certifikatës së lindjes;
- d) raportit të Komisionit mjekësor për shëndetin e fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme;
- e) shënimet për familjen apo personin i cili kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme;
- f) informatat e vendbanimit të fëmijës me aftësi të kufizuara .

21.2 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë mund të kërkojë edhe dokumente të tjera, të cilat janë të domosdoshme për vlerësimin e rastit në përputhje me nenin 24 përveç atyre të parapara në nenin 19 dhe 21 të këtij Ligji.

Neni 22

Parashtrimi i kërkesës dhe vendosja

22.1 Prindi ose kujdestari tjetër, bën kërkesë me shkrim, në QPS për njohjen e të drejtës për përkrahjen materiale për kujdesin e fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme.

22.2. QPS-ja nxjerr aktvendimin me të cilin njihet e drejta për ndihmë materiale prindit ose kujdestarit me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

22.3. Aktvendimi përmban shënime për fëmijën i cili gëzon këtë të drejtë dhe shënimet për familjen, respektivisht personin i cili e realizon ndihmën materiale për kujdes, si dhe lartësinë dhe mënyrën e realizimit të përkrahjes (ndihmës) materiale.

22.4. Lartësia e shumës mujore për përkrahje materiale familjes së fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme përcaktohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr MPMS-ja.

Neni 23

E drejta e Ankimit

23.1 Pala e pakënaqur me vendimin e QPS-së ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

23.2. Ankesa i drejtohet autoritetit përkatës, Departamentit të Mirëqenies Sociale, përmes QPS.

23.3. MPMS-ja lidhur me ankesën e paraqitur nga pala, mund të vërtetojë: vendimin e Shkallës së parë, ta ndryshojë atë ose ta kthejë lëndën në rishqyrtim.

23.4. MPMS-ja në afat prej 30 ditësh do të nxjerrë vendim të ri lidhur me ankesën kundër vendimit të organit të shkallës së parë.

23.5. Vendimi i MPMS-së i shkallës së II është akt përfundimtar në procedurë administrative.

23.6. Pala e pakënaqur me vendimin e shkallës së II të MPMS-së ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente.

Neni 24

Konfidencialitetin e shënimeve personale të parashtruesve të kërkesave

24.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, garanton fshehtësinë për informatat personale, të cilat i kanë mbledhur prej parashtruesve të kërkesave, në përputhje me ligjin e zbatueshem në Kosovë duke përfshirë edhe ato që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale.

24.2. Familja e cila realizon përkrahjen materiale për kujdes dhe ndihmë fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme është i obliguar të lajmërojë të gjitha ndryshimet që ndikojnë në realizimin e kësaj të drejte.

24.3. Monitorimin e realizimit të kësaj të drejte e bën DMS-ja përmes QPS-së dhe i nënshtrohen raportimit të rregullt.

KREU VI

Dispozitat kalimtare

Neni 25

25.1. Për zbatimin e Ligjit, MPMS-ja mund të nxjerrë akte tjera nënligjore në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të këtij ligji, të cilat nuk mund të jenë në kundërshtim me këtë Ligj ose ligjet tjera në fuqi.

25.2. Njohja e të drejtës për përkrahje materiale njihet nga data e aplikimit për këtë të drejtë.

Neni 26

26.1. Me hyrjen e këtij Ligji në fuqi shfuqizohet çdo dispozitë e ligjit të aplikueshëm në Kosovë e cila është në kundërshtim me këtë Ligj.

26.2. Në mungesë të dispozitave të këtij Ligji, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Shëndetësinë, Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, dhe ligjeve të tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

UNMIK/REG /2008/ 33
14.06.2008

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 03/2009 PËR RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E
PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR REALIZIMIN E TË DREJTËS NË NDIHMË MATERIALE PËR
FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË PËRHERSHME**

I PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 07/2010 DHE ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MPMS)
NR.06/2014**

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave dhe afateve të aplikimit, riaplikimit për realizimin e të drejtës në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme të moshës një (1) deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Neni 2

Autoriteti përkatës

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes këtij Udhëzimi, autorizon Qendrat për Punë Sociale (QPS) në komunat e Kosovës, si autoritete përgjegjëse për zhvillimin e procedurës për njohjen e të drejtës në ndihmë materiale, familjeve të cilat ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme.

Neni 2.A

Vdekja e fëmijut

1. Ndihma materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme nuk iu paguhen familjeve të cilave iu ka vdekur fëmija.
2. Vdekja dëshmohet me ekspertizë medicinale ose certifikatë të vdekjes.
3. Kur fëmiju vdes, ndihma materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, i ndërpritet për muajin vijues.
4. Nëse Prindi apo Kujdestari i tërheq paratë pas vdekjes së fëmijut, konsiderohet se ka kryer mashtrim. Prindi apo Kujdestari është i detyruar ta kthejë shumën e marrë, në rastin e kundërt ndaj personit të tillë, do të ndërmerren masa ligjore, për kthimin e mjeteve të tërhequra pa bazë ligjore.

Neni 3

Dhënia e informatave për parashtruesit e kërkesave

1. Nëpunësi i shërbimeve sociale i QPS-së, do të ofrojë ndihmë dhe informata për parashtruesit e kërkesave, familjeve të cilat ruajnë dhe përkujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme;
2. Nëpunësi i shërbimeve sociale obligohet që të këshillojë parashtruesit e kërkesave, se cilat dokumente duhet t'i sjellin për të aplikuar për ndihmë materiale;
3. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk posedon dokumente relevante, nëpunësi i shërbimeve sociale ka për obligim që ti udhëzojë se ku duhet ti sigurojnë ato dokumente.

Neni 4

Plotësimi i Aplikacioneve

Aplikacioni për përkrahjen materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, plotësohet dhe nënshkruhet nga parashtruesi i kërkesës.

Neni 5 Pranimi i kërkesave

1. Nëpunësi i shërbimeve sociale me shumë kujdes duhet të kontrollojë çdo kërkesë që pranohet;
2. Parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kërkesë vetëm në Qendrën për Punë Sociale, selia e së cilës është në vendbanimin e përhershëm të aplikuesit;
3. Nëpunësi i shërbimeve sociale kontrollojnë validitetin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në aplikacion;
4. Nëpunësi i shërbimeve sociale siguron se aplikacioni është plotësuar tërësisht dhe se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar dokumentacionin relevant.

Neni 6 Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Krahas aplikacionit për realizimin e të drejtës për përkrahje financiare, aplikuesi duhet të bashkëngjisë edhe këto dokumente:

- 1.1. fotokopjen e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës;
- 1.2. informatën-vërtetimin nga Bashkësia Lokale për vendbanimin e fëmijës dhe familjes e cila përkujdeset për të;
- 1.3. certifikatën e lindjes për fëmijën (origjinale) jo më e vjetër se gjashtë muaj;
- 1.4. aktvendimin e kujdestarisë / nëse kërkesën e parashtron kujdestari (origjinale);
- 1.5. dokumentacionin mjekësor me epikrizë /certifikatën mjekësore zyrtare/ mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës (origjinale) jo më e vjetër se gjashtë muaj.

Neni 7 Validiteti i kërkesës

1. Nëse kërkesës nuk i bashkëngjiten dokumentet nga neni paraprak, nuk do të pranohet dhe do t'i kthehet parashtruesit të kërkesës. Nëpunësi i shërbimeve sociale duhet të tregojë palës arsyet e mos pranimit të kërkesës;
2. Nëse kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm është i rregullt, nëpunësi i shërbimeve sociale bën pranimin e kërkesës, njëkohësisht ia dorëzon parashtruesit të kërkesës dëftesën e pranimit duke e vulosur dhe nënshkruar;
3. Dokumentet identifikuese dhe dëshmitë përkatëse origjinale futen brenda në dosje së bashku me kërkesën dhe numrin e telefonit kontaktues (i domosdoshëm) për arsye të efikasitetit të procedurës.

Neni 8 Detyrimet e QPS-së pas pranimit të dokumentacionit

1. Qendra për Punë Sociale, pas pranimit të kërkesës dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm, nxjerrë **KONKLUZË**, ku më pas ia dorëzon për ekspertizë Komisionit Mjekësor të shkallës së parë;
2. Komisioni Mjekësor për vlerësimin e paaftësisë së përhershme të fëmijës është i obliguar që ekzaminimin mjekësor dhe mendimin e vet lidhur me rastin, ta dorëzojë më së voni në afat prej 21 ditësh, siç është përcaktuar në nenin 13.1 të Ligjit;
3. Zyrtari përgjegjës i QPS-së, do të njoftojë parashtruesin e kërkesës për datën dhe vendin e kontrollimit mjekësor më së paku 5 (pesë) ditë para datës së caktuar për mbajtjen e komisionit.

Udhëzimi për plotësim ndryshim (2010)

Neni 2

Plotësimi i dokumentacionit (lëndës)

1. Nëse Komisioni Mjekësor gjatë ekzaminimit mjekësor, vlerëson së duhet të plotësohet dokumentacioni me raporte të tjera shëndetësore, aplikuesi obligohet që t'a plotësojë dokumentacionin në afat prej 30 ditësh.
2. Nëse aplikuesi në afatin e paraparë nuk e parashtron plotësimin e dokumentacionit sipas rekomandimit të Komisionit Mjekësor, konsiderohet se ai ka hequr dorë nga kërkesa.
3. Plotësimi i dokumentacionit të lëndës pas afatit të paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni, konsiderohet aplikim i ri (riaplikim).

Neni 9

Përbërja e Komisioneve Mjekësore

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Zyrës së Komisioneve Mjekësore me qëllim të vlerësimit real të gjendjes shëndetësore të fëmijës me aftësi të kufizuara, themelon Komisione të Mjekëve:
 - 1.1. Komisionin Mjekësor të shkallës së parë dhe
 - 1.2. Komisionin Mjekësor të shkallës së dytë;
2. Për anëtarë të Komisionit të shkallës së parë caktohen:
 - 2.1. nëpunësi i shërbimeve sociale;
 - 2.2. mjeku specialist i pediatriisë;
 - 2.3. mjeku specialist i oftamologjisë – ORL;
 - 2.4. mjeku specialist fiziatër-ortoped;
 - 2.5. mjeku specialist i neurologjisë ose neuropsikiatriisë;
 - 2.6. specialist i psikiatriisë;
3. Për secilin anëtar të Komisionit të shkallës së parë caktohet zëvendësi nga lëmia e njëjtë e specializimit;
4. Për kryetar të Komisionit të shkallës së parë emërohet mjeku specialist i pediatriisë;
5. Për anëtarë të Komisionit të shkallës së dytë caktohen:
 - 5.1. nëpunësi i shërbimeve sociale,
 - 5.2. mjeku specialist i pediatriisë,
 - 5.3. mjeku specialist i oftamologjisë – ORL,
 - 5.4. mjeku specialist fiziatër-ortoped,
 - 5.5. mjeku specialist i neurologjisë ose psikiatriisë;

6. Për secilin anëtar të Komisionit për Ekspertizë të shkallës së dytë caktohet zëvendësi nga lëmia e njëjtë e përcaktimit;
7. Për kryetar të Komisionit të shkallës së dytë caktohet mjeku specialist i pediatriisë;
8. Kryetarit të komisionit i caktohet zëvendësi nga i njëjti specializim.

Neni 10 **Detyrimet e QPS-së pas ekspertizës mjekësore**

1. QPS-ja është e obliguar që në bazë të raportit (vlerësimit) të Komisionit Mjekësor të nxjerrë aktvendim mbi **njohjen/refuzimin** e kërkesës për njohjen e të drejtës në përkrahje materiale në të holla për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme nga 1-18 vjeç.
2. Aktvendimi për njohjen e të drejtës, varësisht nga gjendja shëndetësore dhe mosha e fëmijës, duhet të përmbajë kohëzgjatjen për njohjen e të drejtës materiale si dhe shumën mujore të kompensimit material.
3. QPS-ja obligohet që së paku dy herë në vit, të vizitojë familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, të cilës i është njohur e drejta në kompensim material dhe njëkohësisht të hartojë raport me shkrim mbi gjendjen e shëndetësore të fëmijës.

Neni 11 **Detyrimet e prindit / kujdestarit**

Prindi / kujdestari i fëmijës, të cilit i njihet e drejta në kompensim material për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme, detyrohet që për çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes shëndetësore të fëmijës, ta informojë menjëherë QPS-në.

Udhëzimi për plotësim dhe ndryshim (2014)

Neni 3.A **Udhëtimi i Familjes (fëmiut) jashtë vendit**

1. Me rastin e udhëtimit të fëmijës jashtë vendit me qëllim shërimi, ose vizita familjare, familjes nuk i ndërpritet përkrahja materiale për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme.
2. Me rastin e largimit të fëmijës, familja është e pbliguar të lajmëroj organin kompetent me shkrim për vendin e shkuarjes dhe kohën e qëndrimit.
3. Qëndrimi jashtë vendit i fëmijës më shumë se tre muaj do të rezultoj me ndërprerjen e përkrahjes materiale familjes së fëmijës me aftësi të kufizuara të përhershme, por me mundësi vazhdimi pas kthimit nga bota e jashtme, prej ditës kur konstatohet, nga komisioni përkatës kompetente (QPS) se klienti është kthyer, ose duke marr për bazë datën kur Aplikanti bënë kërkesë për vazhdimin e përkrahjes materiale për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme.

Neni 12 **Vendimi dhe Ankesa**

1. Pala e pakënaqur me vendimin e QPS-së ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Ankesa përmes QPS-së i drejtohet, Departamentit të Mirëqenies Sociale (DMS) të MPMS-së, si autoritet përkatës për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të shkallës së parë.
3. Lidhur me ankesën e paraqitur nga pala, DMS-ja në bazë të vlerësimit të Komisionit Mjekësor të shkallës së II-të, mund të vërtetojë vendimin e shkallës së parë, ta ndryshojë atë ose ta kthejë lëndën në rishqyrtim te Komisioni i shkallës së parë;

4. DMS-ja në afat prej 30 ditësh do të nxjerrë vendim të ri meritor, lidhur me ankesën kundër vendimit të organit të shkallës së parë.
5. Vendimi i DMS-së i shkallës së dytë (2) është akt përfundimtar në procedurë administrative.
6. Pala e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë (2), ka të drejtë të iniciojë kontestin administrativ pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga data e marrjes së vendimit.

Udhëzimi për plotësim dhe ndryshim (2010 dhe 2014)

Neni 3

E drejta për paraqitjen e kërkesës së re (Riaplikim)

1. Aplikuesit të cilit i'u ka refuzuar kërkesa për realizimin e të drejtës në përkrahje materiale për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme, ka të drejtë që të paraqesë kërkesë të re për realizimin e kësaj të drejte, nëse ndërkohë gjendja shëndetësore e fëmijës ka ndryshuar dhe është përkeqësuar.
2. Aplikuesi e fiton të drejtën në riaplikim pas periudhës dy (2) vjeçare, prej kohës kur është vlerësuar dhe refuzuar nga ana e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë, gjegjësisht nga vendimi përfundimtar i shkallës ankuese.
3. Në raste të veqanta aplikuesi për realizimin e të drejtës në përkrahje material për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme, mund të riaplikoj edhe pa kaluar dy vite nga aplikimi i fundit, kur sjell dëshmi/raporte të reja mjekësore në bazë të të cilave konstatohet se gjendja shëndetësore ka shenja të përkeqësimit të vazhdueshëm

Neni 13

Puna e Komisioneve Mjekësore

Puna e Komisionit Mjekësor është e rregulluar me Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme si dhe me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2009 për Themelimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrës së Komisioneve Mjekësore.

Neni 14

Afati për aplikim

1. Afati për aplikim për realizimin e të drejtës për ruajte dhe përkujdesje të fëmijëve me aftësi të kufizuara, fillon më 01.03.2009;
2. Të gjithë parashtuesit e kërkesave të cilët aplikojnë deri me datën 30.06.2009 do t'ju njihet e drejta në kompensim material për përkujdesje të fëmijës me aftësi të kufizuara të përhershme, në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2009;
3. Të gjithë parashtuesve të kërkesave të cilët aplikojnë pas datës 30.06.2009, e drejta në kompensim material, do t'ju njihet nga data e aplikimit/parashtrimit të kërkesës.

Neni 15

Sanksionet për aplikuesit

Dhënia e shënimeve jo të sakta si dhe moslajmërimi me kohë i ndryshimeve nga përfituesit e kompensimit material për përkujdesje të fëmijëve me aftësi të kufizuara, që ka për qëllim realizimin e kundërligjshëm të kësaj të drejte, do të ketë si pasojë iniciimin e procedurave administrative për kthimin e mjeteve financiare si dhe ndjekjen për përgjegjësi penale të aplikuesit.

Neni 16

Familjet të cilat janë shfrytëzuese të përkrahjes financiare, nuk mund të jenë njëkohësisht, shfrytëzues të të drejtave apo beneficioneve të tjera të cilat ndërlidhen me përkujdesjen e fëmijës me aftësi të kufizuara.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministri i MPMS-së Nenad Rašić
Prishtinë, Shkurt 2009

(EKSTRAKT)

LIGJI NR. 04/L-131

PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) dhe 51 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj rregullon dhe përcakton:

1.1. pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut paguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti;

1.2. konsolidimin, harmonizimin dhe unifikimin e skemave pensionale të aplikueshme, të cilat aktualisht financohen nga Buxheti Shtetëror i Kosovës;

1.3. krijimin e një kornize ligjore të unifikuar për sigurimin e vazhdueshëm të këtyre pensioneve për shtetasit e Republikës së Kosovës si dhe për shtetasit e huaj, në përputhje me marrëveshjet bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i nënshkruan Republika e Kosovës me shtetet përkatëse;

1.4. kriteret dhe procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension për pagesat e pensioneve.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Ky ligj përfshin Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontributpagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.

2. Krijon metodologji sipas së cilës vlera e pensioneve harmonizohet dhe përshtatet me rritjet e kostos së jetesës.

3. Përcakton procedurat administrative përmes të cilave personat mund të aplikojnë për përfitimin e pensioneve.

4. Adreson trajtimin e çështjeve të pagesave të tepërta dhe pensioneve të papaguara.

5. Krijon një proces, sipas së cilit personat mund të rishikojnë kushtet e pranimit për pension.

6. Krijon një rregull tranzicioni që iu takon personave që marrin pagesat e pensioneve në skemat dhe

programet pensionale ekzistuese që janë duke u zbatuar; si dhe,

7. Rregullon çështje të tjera nga skemat pensionale të përcaktuara më këtë akt ligjor, të cilat janë në interes dhe favor të shfrytëzuesve pensional.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Pension** - pagesë e rregullt mujore e paguar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për personin që i plotëson kushtet e pensionimit të parapara me këtë ligj;

1.2. **Pensionist** - qytetari i Republikës së Kosovës, i cili i plotëson kushtet për të qenë përfitues i njërës nga skemat pensionale në Kosovë;

1.3. **Mosha e pensionimit** – mosha e pensionimit, në përputhshmëri me këtë ligj, sipas kategorive të përfituesve nga skemat e pensioneve;

1.4. **Pensioni bazik i moshës** - pensioni minimal i rregullt mujor të paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, pa marrë parasysh, a kanë qenë të punësuar apo jo dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

1.5. **Pension kontributpagues i moshës** - pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83) e të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

1.6. **Pensioni i pa aftësisë të përhershme** - pensioni i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

1.7. **Pensioni i parakohshëm** - pensioni i rregullt mujor i paguar për minatorët e kompleksit “Trepça”, dhe minatorëve të tjerë të punësuar në minierat e tjera të Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

1.8. **Pensioni invalidor i punës** - pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj, si dhe invalidët e punës sipas Ligjit Pensional dhe Invalidor të aplikuar para datës 01.01.1999;

1.9. **Pensioni familjar** - pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

1.10. **Komisioni Mjekësor** - organi i ekspertizës mjekësore, i emëruar nga Ministria për të përcaktuar gjendjen shëndetësore, përkatësisht të aftësisë së kufizuar;

1.11. **Anëtarët e familjes** - janë bashkëshorti/ja, fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të birësuar;

1.12. **KRRJ – Kostoja e Rregullimit të Jetesës** - kostoja e rregullimit të jetesës si metodë e përlllogaritjes së kostos së shpenzimeve ditore;

1.13. **Ministria**” - ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS).

Neni 4
Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj

1. Për personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas këtij ligji, sigurohen këto të drejta:

- 1.1. E drejta në pension bazik të moshës;
- 1.2. E drejta në pension kontributpagues të moshës;
- 1.3. E drejta në pension të aftësisë së kufizuar;
- 1.4. E drejta në pension të parakohshëm;
- 1.5. E drejta në pension invalidor të punës;
- 1.6. E drejta në pension familjar.

Neni 5
Sigurimi i mjeteve financiare për pagesat e pensioneve

Mjetet financiare për pagesën e të gjitha pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 6
Garantimi i pagesave të pensioneve

Qeveria e Republikës së Kosovës garanton realizmin e të drejtave për të gjitha llojet e pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

* * * * *

Neni 9
Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë të përhershme

1. Pensioni i pa aftësisë të përhershme do t'iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Pensioni i pa aftësisë së përhershme do t'iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

3. Kërkesa për pension të pa aftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunat e Kosovës.

4. Kërkesat për pension të pa aftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale.

5. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse:

- 5.1. ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore;
- 5.2. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës;

5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh;

5.4. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.

6. Ministria apo Autoriteti përkatës mund t'i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar.

7. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë të përhershme duhet të përmbajnë rregulla të përcaktuara me qëllim të mbrojtjes së informatave mjekësore konfidenciale të aplikuesve të cilat do të përcaktohen me akte nënligjore.

* * * * *

Neni 11

Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës

1. Të drejtën në pension invalidor të punës e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare të cilët e dëshmojnë realizimin e kësaj të drejte me Vendim apo (fletëpagesë) të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit invalidor të punës, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensionsal dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83), para datës 01.01.1999.

2. E drejta në pension invalidor të punës iu njihet edhe të gjithë të punësuarve aktual, tek të cilët është shfaqur paaftësia e plotë për punë, si pasojë e lëndimit në punë apo e sëmundjes profesionale.

3. Lartësia e pensionit invalidor të punës është në shumë të njëjtë me pensionin bazik të moshës.

4. Verifikimin dhe vlerësimin e lëndimit në punë dhe sëmundjeve profesionale do ta bëjnë institucionet publike të specializuara të Mjekësisë së Punës në Republikën e Kosovës.

5. E drejta në pension invalidor të punës si dhe procedurat administrative për realizimin e kësaj të drejte, në mënyrë të detajzuar, do të përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria.

* * * * *

Neni 13

Lartësia e shumës së pensioneve

Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 14

Harmonizimi i pensioneve me koston e jetesës

1. Harmonizimi i pensioneve me koston e jetesës do të bëhet një herë në vit duke rritur shumën e pensionit që duhet paguar me të njëjtën përqindje bazuar në Indeksin e Kostos së jetesës të vitit paraprak.

2. Pasi të jetë aplikuar rritja me përqindjen rezultuese, shuma e pensionit që del do të rumbullakësohet me numrin më të afërt të plotë (të shprehur në Euro).

3. Indeksi i Kostos së jetesës do të përcaktohet nga Ministria e Financave dhe do të reflektojë ndryshimet në mesataren e shpenzimeve të jetesës të pensionistëve.

4. Ministria e Financave, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë, do të jetë përgjegjëse për llogaritjet që kërkohen nga ky ligj dhe për përcaktimin e nivelit të rritjes së pagesave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

5. Në rast se ndonjë pension i paguar në bazë të këtij ligji, rritet me akt tjetër ligjor apo nënligjor, apo me ndonjë masë tjetër të autorizuar administrative, atëherë nuk do të zbatohet KRRJ për dy (2) vite kalendarike, duke filluar nga muaji kur rritja ka hyrë në fuqi.

Neni 15 **Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale**

Në rast të jostabilitetit financiar dhe me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale publike, zbatohet neni 36 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe neni 4 i Ligjit nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 16 **Kufizimet në numrin e pensioneve të paguara**

Personat të cilët janë përfitues të të cilit do pension të Skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, nën asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga Ministria.

* * * * *

Neni 18 **Detyrat dhe Përgjegjësitë e Departamentit përkatës për pensione**

1. Departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj.

2. Departamenti veçmas është përgjegjës për:

2.1. propozimin dhe përgatitjen e politikave dhe strategjive lidhur me sistemin pensional në Republikën e Kosovës;

2.2. menaxhimin dhe administrimin e procedurave të aplikimit dhe ankimit përmes, të cilave iu mundësohet personave që të aplikojnë për pensionet të parapara me këtë ligj;

2.3. hartimin e akteve nënligjore që rregullojnë dhe përcaktojnë kriteret për njohjen e të drejtave në skemat pensionale të përcaktuara me këtë ligj;

2.4 administrimin e një procesi, sipas të cilit përcaktohen të drejtat sipas ankimit, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni;

2.5. menaxhimin me kohë të pagesave të pensioneve të pensionistëve të përcaktuara me dokumentet kontraktuale në mes të Ministrisë dhe ndonjërit nga bankat e vendit;

2.6. mbajtjen e evidencës së faturave dhe mjeteve financiare për pagesën e pensioneve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike;

2.7. përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit për të gjitha shpenzimet lidhur me shpërndarjen e pensioneve;

2.8. monitorimin e statusit të personave që marrin pensione;

2.9. çështje tjera, të cilat janë të përcaktuara me akte tjera nënligjore.

Neni 19 **Procedurat Administrative**

1. Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimit të kërkesës në Ministri.
2. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe vendoset në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.
3. Parashtruesi i kërkesës duhet të njoftohet me shkrim, lidhur me realizmin e të drejtës në pension.
4. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në organin e shkallës së dytë të Ministrisë.
5. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
6. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim dhe udhëzon palën për mundësinë e zhvillimit të procedurave të mëtutjeshme gjyqësore.
7. Pala e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë, me padi, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit me shkrim, mund të hap konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.
8. Procedurat e aplikimit dhe të ankimit në mënyrë të detajzuar rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 20 **Pagesa e pensioneve**

1. Të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës.
2. Pagesat bëhen vetëm në konton bankare të pensionistit, e cila është verifikuar nga Ministria gjatë shqyrtimit të kërkesës për pension.

Neni 21 **Ndërprerja e pagesës së pensioneve**

1. Pagesat e pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar të përcaktuara me këtë ligj, do të ndërpriten, si në rastet e mëposhtme:
 - 1.1. në rast të vdekjes së pensionistit, pagesa e pensionit ndërpritet në muajin pasues pas vdekjes së tij/saj;
 - 1.2. në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshtetësinë e shtetit, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale;
 - 1.3. nëse vlerësohet së parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim apo keqinterpretim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të Ministrisë, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

Neni 22

Korrigjimet e pagesave të pensioneve

1. Kur personi është paguar më pak se shuma e pensionit, Ministria paguan borxhin e mbetur në kohën brenda muajit vijues.
2. Nëse personi ka vdekur, shumat e mbetura borxh ndaj personit para se të vdesë do t'i paguhen bashkëshortit/bashkëshortes së tij/saj, apo nëse ai/ajo nuk ka bashkëshort/e, shuma do t'iu paguhet fëmijëve në pjesë të barabarta, dhe në rast se personi nuk ka as bashkëshort/e as fëmijë, atëherë shuma iu paguhet prindërve të personit apo kujdestarit ligjor.

Neni 23

Pagesat e gabuara dhe pagesat e tepërta të pensioneve

1. Secili person që është pranues i ndonjë pagese të pensionit të bërë gabim në konton bankare të tij/saj, apo që iu është paguar ndonjë shumë më tepër sesa që i takon, do të kërkohet që ta kthejë shumën e plotë, pavarësisht arsyes së bërjes së pagesës së gabuar apo të tepërt.
2. Nëse një person me vetëdije merr një pagesë të gabuar apo një pagesë të tepërt të pensionit, ai ose ajo duhet informojë pa vonesë rreth shumës së pranuar, Ministrinë.
3. Nëse Ministria, identifikon ndonjë pagesë të gabuar apo të tepërt ndaj një pensionisti apo personi tjetër, do të lajmërojë me shkrim personin rreth pagesës. Lajmërimi duhet të përshkruajë shumën e pagesës, datën kur është bërë pagesa e tepërt dhe masat që ndërmerr Ministria për të përmirësuar pagesat e gabuara apo të tepërta. Këto masa mund të jenë:
 - 3.1. zbritja e shumës nga pagesat e ardhshme për të siguruar përmirësimin e gabimit në kohën më të shkurtër të mundshme;
 - 3.2. kërkesën me shkrim për të kthyer shumën ndaj personit.
4. Gjatë shqyrtimit të mënyrës dhe shpejtësisë së mbledhjes së pagesave të gabuara, Ministria, mund të marrë parasysh nevojat ekonomike të pensionistit dhe mund të riprogramojë kthimin e pagesave për të reflektuar rrethanat ekonomike.
5. Nëse një person që merr lajmërimin për një pagesë të gabuar ose të tepërt, nuk pajtohet me shumën e paguar që pretendon Ministria, ose me metodën, me të cilën ajo kërkon të kthehet pagesa, ai ose ajo mund të kërkojë rishqyrtim të procedurës.
6. Nëse pala refuzon të kthejë pagesat e paguara pa bazë ligjore, atëherë Ministria, do iniciojë procedurën gjyqësore në Gjykatën përkatëse.

Neni 24

Vdekja e pensionistit

1. Ministria, do të ndërmarrë veprime me të cilat do të monitorojë burimet ekzistuese të informatave për të identifikuar pensionistët që kanë vdekur, me qëllim që të bëjë ndërprerjen e pagesës së Pensionit sa më parë që është e mundshme.
2. Shfrytëzuesit e pensionit bazik të moshës dhe shfrytëzuesit e pensioneve të parakohshme duhet të paraqiten në zyrat e caktuara nga Ministria një herë në gjashtë muaj me dokumentet përkatëse të identifikimit.
3. Ministria mund të suspendojë përkohësisht pagesën e pensionit nëse pensionisti nuk arrin të bëjë një gjë të tillë konform paragrafit 2 të këtij neni.

4. Suspendimi nga pagesa e pensionistëve në shfrytëzimin e pensioneve, do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

Neni 25

Verifikimi dhe monitorimi i dëshmime të parashtruesit të kërkesës për pension

1. Ministria do të krijojë një proces inspektimi për monitorimin e pagesave të pensioneve për të siguruar që personat të cilët marrin pension janë të kualifikuar dhe me rastin e inspektimit mund të verifikojë që:

1.1. personi që merr pagesa të tilla është në jetë;

1.2. kontoja bankare në të cilën paguhet pensioni është vërtetë konto e pensionistit të cilit i bëhet pagesa;

1.3. gjendja shëndetësore e personit që merr pension të aftësisë së kufizuar, të jetë në përputhje me diagnozat mjekësore;

1.4. ish-punëtorët e Kompleksit të Minierave të Trepçës dhe minierave të tjera të vendit që përfitojnë pensionin të parakohshëm, nuk mund të jenë të punësuar ose të vetëpunësuar dhe të duhen të jenë mbi pesëdhjetë për qind (50%) me aftësi të kufizuara; dhe,

1.5. çdo verifikim tjetër që Ministria e vlerëson si të arsyeshëm dhe të nevojshëm për të siguruar menaxhimin dhe administrimin e mirëfilltë të pensioneve.

2. Kur vlerësohet se një person, nuk i plotëson kushtet dhe kriteret për pensionet e përcaktuara me këtë ligj, nga ai do të kërkohej që të kthejë shumën e pagesave që i është bërë atij ose asaj.

Neni 26

Shfrytëzuesit aktual të pensioneve

1. Të gjithë shfrytëzuesit aktual të pensioneve bazike të moshës, pensionistëve kontributpagues, të pensioneve të aftësisë së kufizuar, të cilat janë të përcaktuar me aktet ligjore dhe nënligjore të mëhershme, që nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji do të konsiderohen të kualifikuar dhe nga ata nuk do të kërkohej që të aplikojnë për pensionet e përcaktuara me këtë ligj.

2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shfrytëzuesit aktual të pensioneve të parakohshme, duhet të aplikojnë, sipas dispozitave të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 27

Shfuqizimi i dispozitave ligjore të aplikueshme

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të shfuqizohen këto ligje dhe akte nënligjore:

1.1. Neni 3 dhe 4 i Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë;

1.2. Neni 2, 3 dhe 4 i Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2005/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores. nr. 2001/35 mbi Pensionet;

1.3. Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (Rregullorja Nr. 2003/40 e UNMIK-ut);

1.4. Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2007 për pensionim të parakohshëm për punëtorët e kompleksit "Trepça" nën administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë;

- 1.5. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2007 për Zbatimin e Vendimit të Qeverisë nr. 13/2007;
- 1.6. Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2004 për Përcaktimin e Lartësisë së Pensionit Bazë në Kosovë për vitin 2004;
- 1.7. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2009 për Rritjen e Pensioneve për Zbatimin e Vendimit të Qeverisë nr. 02/51;
- 1.8. të gjitha aktet e tjera nënligjore të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 28

Aktet nënligjore të aplikueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore

1. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, aktet nënligjore të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi si në vijim:

- 1.1. Udhëzimi Administrativ nr. 6/2003 për themelimin e Departamentit të Administratës Pensionale;
- 1.2. Udhëzimi Administrativ nr. 13/2004 për Administrimin e pagesave të skemës së pensioneve për personat më aftësi të kufizuar;
- 1.3. Udhëzimi Administrativ nr. 15/2004 për zbatimin e Ligjit të pensioneve për persona më aftësi të kufizuar;
- 1.4. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2005 për procedurat e Monitorimit dhe rishqyrtimit të së drejtës për pensionet e aftësisë së kufizuar;
- 1.5. Udhëzimi Administrativ nr. 07/2005 për procedurat Administrative të kthimit të pagesave nga shfrytëzuesit e pensionit të aftësisë së kufizuar;
- 1.6. Udhëzimi Administrativ nr. 09/2005 për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2004 për procedurat e paraqitjes së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar;
- 1.7. Udhëzimi Administrativ nr. 10/2009 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2004 për Procedurat e Paraqitjes së Kërkesës për Pension me Aftësi të Kufizuara;
- 1.8. Udhëzimi Administrativ nr. 11/2009 për Administrimin e Pagesave të Skemave Pensionale;
- 1.9. Udhëzimi Administrativ nr. 13/2009 për Procedurat e Administrimit të Kthimit të Pagesave nga Shfrytëzuesit e Skemave Pensionale;
- 1.10. Udhëzimi Administrativ nr. 06/2010 për Procedurat e Riaplikimit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar;
- 1.11. Udhëzimi Administrativ nr. 11/2010, për lajmërimin, suspendimin, riaktivizimin, riaplikimin dhe ndërprerjet e pagesave të pensionit themelor pas vdekjes së pensionistit.

Neni 29

Nxjerrja e akteve nënligjore

Për zbatim të drejtë dhe të plotë të këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi Ministria nxjerrë aktet përkatëse nënligjore.

Neni 30

Zbatimi i veçantë i ligjit

Dispozitat e nenit 11, 12, të këtij ligji do të fillojnë së zbatuari, nga 01.01.2015, në përputhje me fondet buxhetore në dispozicion.

Neni 31
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-131

06 maj 2014

Shpallur me dekretin Nr. DL-024-2014, datë 21.05.2014 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPMS) NR.06/2015 PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT PËR PENSIONIN E PAAFTËSISË SË PËRHERSHME

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat pensionale të Financuara nga Shteti (Gz.Nr.35/05 qershor 2014), Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (Gz.Nr.01.01.2007), nenit 8 paragrafit 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/18 Prill 2011), si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, dt.12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPMS) NR.06/2015 PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT PËR PENSIONIN E PAAFTËSISË SË PËRHERSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin dhe rregullimin e procedurave administrative, për rregullimin e njohjes së të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, zbatohen ndaj personave, të cilët paraqesin kërkesën për njohje për pension të paaftësisë së përhershme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-131 për Skemat pensionale të Financuara nga Shteti.

Neni 3 Përkufizimet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë këtë kuptim dhe domethënie në njëjtë sikurse në Ligjin nr.04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga Shteti.

Neni 4 E drejta në pension të paaftësisë së përhershme

Të drejtën për të aplikuar për pension të paaftësisë së përhershme e kanë shtetasit Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumente të identifikimit dhe të cilët janë të moshës prej tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetëpesë (65) vjeq.

Neni 5 Procedura e aplikimit për pensionin e paaftësisë së përhershme

1. E drejta për të aplikuar për pension të paaftësisë së përhershme, ushtrohet përmes kërkesës së palës, përkatësisht formularit për aplikim në pension, e cila duhet të përmbajë:

- 1.1. emërtimin e organit të cilit i drejtohet;
- 1.2. emrin e kërkuesit;
- 1.3. arsyen për njohjen e të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme;
- 1.4. datën e dorëzimit dhe

1.5. nënshkrimin.

2. Kërkesës, duhet të bashkëngjiten edhe këto dokumente, si në vijim:

2.1. Dëshminë mjekësore se është me paaftësi të përhershme;

2.2. Certifikatë apo raport mjekësor lëshuar nga institucionet shëndetësore të nivelit sekondar apo terciar. Në certifikatë duhet të jetë i specifikuar vlerësimi i aftësisë së kufizuar;

2.3. Kopja e dokumentit të identifikimit;

2.4. Ekstraktin nga Zyra Civile se është banorë i përhershëm në adresën e caktuar;

2.5. Ekstraktin e lindjes;

2.6. Një nga dëshmitë për faturat të cilat janë në emër të vetë, faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit, beturinave;

2.7. Dëshmi tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatës.

3. Zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale ka të drejtë të kërkoj dokumente shtesë siç specifikohen në këtë udhëzim edhe për përfituesit aktual të pensioneve.

Neni 6

Paraqitja e kërkesës në zyrën pensionale përkatëse

1. Kërkesa, së bashku me dokumentet tjera të përcaktuara në neni 5 të këtij udhëzimi, dorëzohet në zyrë e pensioneve përkatëse sipas vendbanimit më të afër të palës.

2. Në rast se pala për shkak të pamundësisë nuk mund të paraqes kërkesën, mund ta autorizon personin tjetër që në emër të tij/saj ta parashtron kërkesën ose ta dërgoj përmes postës së regjistruar. Autorizimi duhet të jetë i noterizuar.

3. Zyra e pensioneve, përkatësisht zyrtari përgjegjës i pranimit, sigurohet se kërkesa e paraqitur pala ose i/e autorizuari i tij/saj, ose përmes postës, është e kompletuar sipas nenit 5 të këtij udhëzimi.

4. Në qoftë se zyrtari përgjegjës konstaton se parashtruesi i kërkesës, nuk e ka plotësuar dokumentacionin siç parashihet në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ, zyrtari përmes konkluzionit mbi plotësimin e lëndës, përkatësisht sigurimin e provave apo dëshmimeve, kërkon nga parashtruesi që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të sjelli dëshmitë e kërkuara me qëllim që kërkesa e tij të përcjellët në procedurat e mëtutjeshme për vendim marrje.

5. Nëse parashtruesi i kërkesës, edhe pas pesëmbëdhjetë (15) ditëve nuk sjell dëshmi apo provë, atëherë, kërkesa e tij për njohjen e së drejtës në pension të paaftësisë së përhershme, përmes konkluzionit i refuzohet kërkesa.

6. Ndaj refuzimit të kërkesës për aplikim të drejtën në pension të paaftësisë së përhershme, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në ankesë në shkallën e dytë të Ministrisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së konkluzionit.

Neni 7

Pranimi i kërkesës

1. Zyrtari përgjegjës i pranimit në zyrën pensionale përkatëse, me rastin e pranimit të kërkesës të

kompletuar, është i detyruar të ia lëshoj parashtruesit, dëshminë për pranimin e kërkesës.

2. Kërkesa regjistrohet në librin zyrtar – në protokoll.

3. Zyrtari përgjegjës e njofton parashtruesin e kërkesës për zhvillimin e procedurës, përkatësisht të vlerësimit nga komisioni mjekësor.

Neni 8

Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës

1. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Mjekësorë i Departamentit të Pensioneve.

2. Komisioni Mjekësorë, shqyrtimin e lëndës dhe ekzaminimet mjekësore, i kryen në zyret pensionale përkatëse.

3. Komisioni Mjekësorë, në bazë të dëshmime mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës.

4. Komisioni Mjekësorë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës, lëndën së bashku me dokumentet përcjellëse, e kthen rek organi i shkallës së parë për marrjen e vendimit.

5. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe vendoset në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e Parashtrimit.

6. Parashtruesi i kërkesës njoftohet me shkrim për vendosjen e kërkesës.

Neni 9

Rivlerësimi Mjekësor

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të paaftësisë së përhershme, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit mjekësor pas skadimit të afatit të përcaktuar prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh.

2. Zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse, pesmëbëdhjetë (15) ditë para skadimit të Vendimit e njohton shfrytëzuesin e pensionit, për datën dhe vendin e procedurës së rivlerësimit mjekësor.

Neni 10

Riaplikimi

1. Ripalikimi për pensionin e paaftësisë së përhershme, mund të bëhet nga parashtruesi i kërkesës, vetëm pasi të kenë kaluar dy vite (2) nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar në procedurën administrative.

2. Kërkesa për riaplikim dorëzohet në Zyrën pensionale përkatëse.

3. Zyrtari i pensioneve, udhëzon parashtruesin e kërkesës, për procedurën e riaplikimit.

4. Krahas kërkesës me shkrim, parashtruesi i kërkesës, me rastin e riaplikimit, duhet ti dorëzoj edhe këto dëshmi:

4.1. Vendimin përfundimtar me të cilin i është refuzuar kërkesa, respektivisht vendimi i refuzuar sipas ankesës;

4.2. Dëshmi të reja mjekësore në bazë të të cilave konstatohet se gjendja shëndetësore krahasuar me gjendjen e mëparshme ka shenja të përkeqësimit të vazhdueshëm.

5. Në raste të veçanta aplikuesi për pensionin e paaftësisë së përhershme, mund të riaplikoj edhe pa u

mbushur dy (2) vite, por jo më parë se gjashtë (6) muaj nga data e nxjerrjes së vendimit të fundit kur i është trajtuar kërkesa përkatësisht ankesa për pension të paaftësisë së përhershme.

6. Riaplikimi pas gjashtë (6) muajsh për pensionin e paaftësisë së përhershme, mund të bëhet kur janë në pyetje sëmundjet me zhvillim të shpejtë të cilat dëmtojnë shumë shëndetin, në bazë të të cilit dëshmohet se janë plotësisht dhe përherë të paaftë për çfarëdo lloji të punës.

7. Sëmundjet të cilat kanë një zhvillim të përsheptuar dhe që dëmtojnë rëndë shëndetin si dhe zvogëlojnë në tërësi aftësitë e punës sipas vlerësimit të Komisionit Mjekësor të MPMS-së, janë:

- 7.1. Karcinomat e të gjitha organeve të vërtetuara me ekzaminim histopatologjik;
- 7.2. Insulti cerebrovaskular;
- 7.3. Status post infraktus myocar;
- 7.4. Insuficienca rentale terminale;
- 7.5. Hemopatitë;
- 7.6. Politraumat (gjatë aksidenteve, amputimet e extremiteteve);
- 7.7. Epilepsia me kriza të shpeshta;
- 7.8. Psikozat e renda;
- 7.9. Cirroza hepatike e dekompenzuar;
10. Arthriti rheumatoid gr.II-IV;
- 7.11. Morbus Perther dhe
- 7.12. Sëmundjet tjera që dëmtojnë rëndë shëndetin.

Neni 11 E drejta e ankesës

1. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në komisionin e shkallës së dytë të Ministrisë.
2. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
3. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerrë vendim për miratimin ose refuzimin e ankesës.
4. Pala e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë, mund të hap konflikt administrativ pranë Departamentit për çështje administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 12 Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet:
 - 1.1. Udhëzimi Administrativ nr.13/2004 për Administrimin e pagesave të skemës së pensioneve për personat me aftësi të kufizuara;
 - 1.2. Udhëzimi Administrativ nr.15/2004 për zbatimin e Ligjit të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara;
 - 1.3. Udhëzimi Administrativ nr.03/2005 për procedurat e Monitorimit dhe rishqyrtimit të së drejtës për

pensionet e aftësisë së kufizuar;

1.4. Udhëzimi Administrativ nr.07/2005 për procedurat Administrative të kthimit të pagesave nga shfrytëzuesit e pensionit të aftësisë së kufizuar;

1.5. Udhëzimi Administrativ nr.09/2005 për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ nr.09/2004 për procedurat e paraqitjes së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar;

1.6. Udhëzimi Administrativ nr.10/2009 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.09/2004 për Procedurat e Paraqitjes së Kërkesës për Pension me Aftësi të Kufizuara;

1.7. Udhëzimi Administrativ nr.06/2010 për Procedurat e Riaplikimit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit.

Arban Abrashi

Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Dhjetor, 2015

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPMS) NR.05/2015 PËR PROCEDURAT E LAJMËRIMIT,
SUSPENDIMIT NGA PAGESA DHE KTHIMIN E MJETEVE NË RASTET E KEQPËRDORIMIT TË
PENSIONEVE**

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Në mbështetje të neni 24 paragrafi 4, Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti (Gazeta Zyrtare Nr. 35/05 Qerdhor 2014) nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/18 prill 2011), si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë (Gazeta Zyrtare nr. 15, dt. 12.09.2011),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPMS) NR.05/2015 PËR PROCEDURAT E LAJMËRIMIT, SUSPENDIMIT
NGA PAGESA DHE KTHIMIN E MJETEVE NË RASTET E KEQPËRDORIMIT TË PENSIONEVE**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të lajmërimit të pensionistëve, suspendimin nga pagesa si dhe ndërprerjen e pagesave të pensioneve pas vdekjes së pensionistit.
2. Udhëzimi Administrativ ka për qëllim edhe rregullimin e procedurave të pagesave të kthimit të mjeteve në rastet e keqpërdorimit të pensioneve.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky udhëzim administrativ zbatohet ndaj shfrytëzuesve të skemave pensionale sipas Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

**Neni 3
Përkufizimet**

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë udhëzim, kanë kuptimit dhe domethënien e njëjtë sikurse shprehet e përdorura në Ligjin nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti.

**Neni 4
Lajmërimi i pensionistëve**

1. Departamenti i Pensioneve është i obliguar që të pajisë të gjithë shfrytëzuesit e pensionit me kartelën për lajmërim.
2. Shfrytëzuesit e pensionit janë të obliguar që të lajmërohen personalisht çdo 6 muaj përkatësisht 180 ditë, në zyrat me të afërta të Departamentit të Pensioneve.
3. Përgjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, pensionisti mund të autorizoj përfaqësuesin e tij/saj për tu lajmëruar vetëm një herë brenda vitit nëse është përkohësisht jashtë Kosovës.
4. Pensionisti me rastin e lajmërimit, duhet të sjellë me vete dokumente identifikuese:
 - 4.1. Letërnjoftimin e lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Kosovës;
 - 4.2. Kartelën e pensionistit për lajmërim-Evidencë.

5. Në rastet kur pensionisti e autorizon përfaqësuesin e tij, sipas paragrafit 3 të këtij neni, përfaqësuesi i autorizuar duhet të sjellë:

5.1. dëshmi se shfrytëzuesi i pensionit është në jetë, dëshmi kjo e lëshuar nga organi kompetent;

5.2. kopjen e pasaportës me datën se kur e ka lëshuar Kosovën;

5.3. adresën e qëndrimit të përkohshëm e dokumentuar me dokument valid të lëshuar nga institucioni përkatës i shtetit ku ai është duke qëndruar;

5.4. dokumentin mjekësor nga institucioni përkatës nëse është duke u shëruar jashtë vendit;

5.5. dëshmi nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës nëpër botë në rast nevojë.

6. Në rastet kur pensionisti, për arsye shëndetësore, nuk mund të paraqitet personalisht në sportelet e lajmërimit, ai apo ajo, duhet ta informoj zyrën pensionale se nuk mund të lajmërohet në datën e caktuar.

7. Në rastet e tilla, me kërkesën e pensionistit, Departamenti i Pensioneve, shqyrton kërkesën dhe njëherit vendos që përmes ekipeve mobile të vizitoj pensionistin.

8. Zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale, është i obliguar që të bëjë evidentimin e lajmërimit të pensionistit se është në jetë, duke nënshkruar kartelën e lajmërimit ku më pas i vazhdohet pagesa e pensionit.

9. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave bie mbi zyrtarin përgjegjës i cili vendos të dhënat, në bazë të procesverbalit të bërë nga vizita në terren, në Sistemin e Integruar Informativ.

10. Departamenti i Pensioneve, përkatësisht zyrat pensionale përkatëse, janë të obliguara që të mbajnë evidencën për pensionistët e lajmëruar në Sistemin Integruar Informativ.

Neni 5 Suspendimi nga pagesa

1. Nëse pensionisti nuk lajmërohet siç është përcaktuar në nenin 4 paragrafin 2 të këtij ushëzimi, suspendohet përkohësisht nga pagesa e mëtejme e pensionit.

2. Pensionisti që është suspenduar sipas paragrafit 1 të këtij neni, i vazhdohet pagesa e pensionit, nëse pensionisti lajmërohet në zyrën përkatëse pensionale, brenda tre (3) muajsh nga data e suspendimit.

3. Në rast se pensionisti, lajmërohet brenda tre (3) muajve nga data e suspendimit, duke llogaritur muajin e lajmërimit, Departamenti i Pensioneve, përkatësisht zyra e pensioneve, është e detyruar të ia paguaj pensionet e papaguara maksimalisht për tre (3) muaj.

4. Në raste se pensionisti, nuk lajmërohet në afat prej tre (3) muajsh apo nëntëdhjetë (90) ditë, nga data e suspendimit, kërkesa e tij konsiderohet si riaplikim ndërsa pagesa do të rrjedhë nga dita (muaji) e paraqitjes së kërkesës.

Neni 6 Ndërprerja e pagesës së pensionit

1. Pensioni nuk i paguhet shfrytëzueseve të pensionit që kanë vdekur.

2. Kur pensionisti vdes, pensioni do të paguhet deri në datën, përkatësisht muajin e vdekjes.

3. Pensioni ju ndërprehet edhe në raste kur vlerësohet se parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim gjatë procesit të aplikimit ose gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të ministrisë, kur konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

4. Nëse shfrytëzuesi i pensionit e ka bartë autorizimin për tërheqjen e pensionit tek personi tjetër, personi i autorizuar nuk ka të drejtë të bëjë tërheqjen e pensionit pas vdekjes së pensionistit, në të kundërtën do të iniciohet procedura për kthim të mjeteve, përmes marrëveshjes apo do të iniciohet padi në gjykatë për pasurim të pabazë.

5. Lajmërimi i rastit të vdekjes nga familjarët për pensionistin i cili është suspenduar dhe në nderkohe ka vdekur, duhet të bëhet brenda 90 ditëve nga dita e vdekjes së pensionistit. Në rastet e tilla, kompensimi bëhet në mënyrë retroaktive për periudhën kohore sa ka qenë në jetë pensionisti.

Neni 7

Procedura në rast të keqpërdorimit të autorizimit dhe kthimit të pagesave në rastet e vdekjes së pensionistit

1. Personi i autorizuar i cili pas vdekjes së pensionistit, e keqpërdor autorizimin për tërheqje të pensionit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, përgjigjet penalisht sipas Kodit Penal për veprë penale të mashtrimit.

2. Personi i autorizuar i cili bën tërheqjen e pensionit pas vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit, është i detyruar që t'i kthejë të gjitha pagesat nga momenti i vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit.

3. Procedura për veprën penale nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni "mashtrimit" iniciohet sipas detyrës zyrtare nga prokurori i shtetit.

4. Pala e dëmtuar me pëlqimin e personit të autorizuar që ka tërhequr pensionin pas vdekjes së pensionistit, mund të mos inicioj procedurë nëse i njëjti pajtohet dhe i kthen mjetet e tërhequra.

5. Shmangia nga ndjekja penale mund të bëhet vetëm derisa nuk është paraqitur propozimi për ndjekje penale në prokurorinë përkatëse themelore.

6. Nëse në procedurë penale nuk vendoset lidhur me kërkesën pasurore juridike, atëherë pala e dëmtuar ka të drejtë në procedurën kontestimore ta realizojë kërkesën e tillë përkitazi me pasurimin pa bazë.

7. Në qoftë se shfrytëzuesi i pensionit i cili është i suspenduar nga pagesa, nuk paraqet kërkesë për riaktivizim pas një afati prej 12 muajve, zyrtari i autorizuar i Departamentit të Pensioneve, në harmoni me marrëveshjen bankare, është i detyruar të kërkojë nga banka përkatëse, gjendjen e mjeteve në llogarinë e përfituesit, kthimin e tyre dhe mbylljen e llogarisë.

Neni 8

Bashkëpunimi ndërinstitucional në mbledhjen e informatave në rastet kur pensionistët vdesin

1. Departamenti i Pensioneve, ka për obligim që të bashkëpunoj me të gjitha nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal për mbledhjen e informatave për personat të cilët kanë qenë shfrytëzues të pensionit dhe që ndërkohë kanë vdekur.

2. Departamenti i Pensioneve, përmes zyrave të pensioneve, mbajnë kontakt me komunat dhe organizatat e tjera publike dhe private, në mënyrë që informatat të procedohen në bazën e të dhënave nga zyrtarët kompetent.

3. Të gjitha zyrat pensionale, duhet të mbledhin informata për vdekjet e konfirmuara dhe të pakonfirmuara të pensionistëve në bazë të të cilave do të ndërmerret procedura e ndërperjes nga pagesa e pensionit.

Neni 9

Dëshmitë për konfirmimin e vdekjes së pensionistit

1. Zyrat e pensioneve, mund të kërkojnë dëshmi dhe informata nga institucionet qendrore dhe lokale, si në vijim:

1.1. Certifikatën e vdekjes;

1.2. Njoftimi i vdekjes i publikuar në gazeta;

1.3. Njoftimi i vdekjes i publikuar në vende publike si në mure, drunj, etj;

1.4. Njoftimi i vdekjes në zyrat pensionale nga anëtarët e familjes së pensionistit përkatësisht i autorizuari i pensionistit;

1.5. Njoftimi i vdekjes nga ana e organeve të sigurisë, mjekëve, spitalit, autoriteteve komunale apo ndonjë organi tjetër publik.

2. Nëse dëshmitë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përmbajnë datën e vdekjes së pensionistit, zyrat e pensioneve ju raportojnë Departamentit të Pensioneve për rastet e konfirmuara të vdekjes.

3. Njoftimet bëhen përmes Formularit D1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.

4. Zyrat pensionale, kontrollojnë dhe krahasojnë me bazën e të dhënave të Sistemit të Integruar Informativ dhe sipas nevojës edhe me dosjen e kërkesës.

5. Pas verifikimit të gjendjes faktike, zyrat pensionale fillojnë procedurën e ndërprerjes së pagesave.

6. Në rast se konfirmohet se pensionisti ka vdekur, zyrat e pensioneve, nxjerr vendim për ndërprerjen e pagesës së pensionit.

7. Vendimi i nxjerrë sipas paragrafit 6 të këtij neni, përmes Formularit D2 e cila është pjesë e këtij Udhëzimi Administrativ, sistemohet në arkiv, në pjesën e pasives ku përmbillet procedura e rastit të vdekjes së konfirmuar.

Neni 10

Informatat për vdekjet e pakonfirmuara të pensionistëve

1. Zyra pensionale bën verifikimin e pensionistëve të vdekur dhe nëse informata e marrë nga burimet e shënuara në nenin 9 paragrafin 1 të këtij Udhëzimit Administrativ, nuk përfshin datën e vdekjes, njoftimi konsiderohet si vdekje e pa konfirmuar. Rastet e tilla janë:

1.1. Nëse njoftimi i vdekjes nga shtypi ditor nuk përmban detaje të mjaftueshme për verifikim se pensionisti ka vdekur (nëse nuk përmban të dhënat e përgjithshme, si p.sh. viti i lindjes, etj);

1.2. Njoftimi i vdekjes i publikuar në vendet publike nuk përmban detaje të mjaftueshme në bazë të të cilave do të mund të identifikohet pensionisti i vdekur;

1.3. Njoftimi jo zyrtar i vdekjes në zyrën Rajonale (përveç kur zyra lokale e pensioneve ka njohuri se pensionisti ka vdekur);

1.4. Hulumtimet ose verifikimet e rasteve të vdekjes nga ekipet mobile të autorizuara nga udhëheqësit rajonal si dhe informatat e tjera që bëjnë të dyshohet se pensionisti ka vdekur.

2. Sistemi i Integruar Informativ e mundëson suspendimin e pagesës së pensionit në mënyrë automatike bazuar në të dhënat që regjistrohen nga zyrtarët e pensioneve.

3. Departamenti i Pensioneve do të:

3.1. kontrollojë të dhënat me bazën e shënimeve SII-së;

3.2. suspendojë nga pagesa e mëtejme pensionistin i cili nuk është lajmëruar në afatin e paraparë;

3.3. njofton paraprakisht pensionistin për datën e lajmërimit të ardhshëm duke e shënuar në kartelën për lajmërim;

3.4. konfirmon mosbartjen e transferit të pensionit në llogarinë bankare të pensionistit.

4. Në rastet e pakonfirmuara të vdekjes, zyrtari përkatës i zyrës pensionale, e suspendon përkohësisht nga pagesa pensionistin, deri sa të konfirmohet rasti.

5. Nga momenti i ndalesës së transferit të pagesës së pensionit në llogarinë bankare, fillon të rrjedhë afati kohor në përputhje me të dhënat për suspendim, të cilat përlllogariten nga Sistemi i Integruar Informativ.

Neni 11

Shënimet për personat e vdekur

1. Departamenti i Pensioneve mban shënimet për vdekjen e çdo pensionisti për të cilin është njoftuar.

2. Të gjitha të dhënat trajtohen në përputhje me Ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Secila zyrë pensionale, mban shënime për vdekjen e çdo pensionisti.

4. Departamenti i Pensioneve mbanë shënime për personat kontaktues dhe institucionet, nga të cilat kanë marrë informata të sakta rreth vdekjes së pensionistit.

Neni 12

Përgjegjësia për raportim

1. Çdo zyrtarë i zyrave pensionale, i cili ka informatë se një pensionist ka vdekur, ka përgjegjësi që të raportoj menjëherë tek zyrtari përgjegjës.

2. Nëse zyrtari i zyrës pensionale dështon në raportimin e informatës të cilën ai/ajo e di për vdekjen e pensionistit, konsiderohet si shkelje serioze e detyrave të punës që rezulton me inicimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtarit i cili nuk ka informuar për vdekjen e pensionistit.

Neni 13

Procedura e verifikimit dhe inspektimit të dëshmime në rastet kur pensionistët janë në jetë

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit, mund të monitorohen dhe inspektohen në rast se Departamenti i Pensioneve, përkatësisht zyret pensionale dyshojnë në ndonjë ndryshim eventual të rrethanave të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përzgjedhjen e shfrytëzuesit të skemave pensionale të përcaktuara në ligjin në fuqi për skemat pensionale të financuara nga shteti.

2. Departamenti i Pensioneve, përkatësisht zyret përkatëse pensionale, mund të caktojnë komisione inspektuese apo të autorizojnë zyrtarë përkatës për monitorimin dhe inspektimin e rasteve që dyshohen për keqpërdorje.

3. Verifikimi dhe inspektimi nga komisionet inspektuese apo zyrtarët e autorizuar, mund të bëhet në çdo kohë dhe në çdo menyrë.

4. Në rastet e verifikimit dhe inspektimit, komisionet inspektuese apo zyrtarët e autorizuar, përgatitin raportin me shkrim për cesilin rast, i cili më pas i dorëzohet zyrtarit përgjegjës.

5. Në bazë të raportit të aprovuar, Departamenti i Pensioneve, fillon procedurën për kthim të mjeteve.
6. Çdo person i cili pengon Komisionin Inspektues apo zyrtarin e autorizuar për të bërë verifikimin e fakteve të prezantuara në kërkesë, ju suspendohet nga pagesa deri në verifikimin e plotë të gjendjes faktike.
7. Dispozitat e këtij neni dhe nenit 14 të këtij Udhëzimi Administrativ, vlejnë edhe për shtetasit e huaj, të cilët janë të njëjës prej skemave pensionale të financuara nga shteti për të cilët Kosova ka lidhur Marrëveshje Bilaterale nga Sigurimi Social.

Neni 14

Kthimi i pagesave pas procedurës së verifikimit dhe inspektimit

1. Gjatë procedurës së verifikimit dhe inspektimit, nëse Komisioni Inspektues apo zyrtari i autorizuar, vlerëson se dëshmitë e prezantuara në fletaplikacion nuk janë të vërteta apo shfrytëzuesi i skemës pensionale nuk e ka informuar Departamentin e Pensioneve, përkatësisht zyrën përkatëse pensionale për ndonjë ndryshim të rrethanave të cilat ndikojnë në të qenurit shfrytëzues i pensionit, ai/ajo është i detyruar që t'i kthejë të gjitha pagesat e pensionit, apo ato pagesa të cilat i ka marrë nga ndryshimi i statusit të tij.
2. Çdo person i cili me qëllim prezanton dëshmi të rreme apo ndonjë dokument të falsifikuar për marrjen e pensionit, apo nuk e informon menjëherë Departamentin e Pensioneve përkatësisht zyrën përkatëse pensionale për ndonjë ndryshim eventual të rrethanave, është i detyruar që t'i kthejë të gjitha pagesat e pensionit të cilat i ka marrë më parë.
3. Kur Komisioni Inspektues apo zyrtari i autorizuar, konstaton se ekziston njëra nga arsyet për kyhimin e pagesave, shfrytëzuesi apo personi i cili ka bërë tërheqjen e pensionit duhet të kthejë të gjitha pagesat e marra pa bazë ligjore.
4. Komisioni Inspektues apo zyrtari i autorizuar, i rekomandojnë shfrytëzuesit të pensionit që brenda afatit prej tetë (8) ditë pune, t'i kthejë të gjitha pagesat pensionale të marra pa bazë ligjore.
5. Në qoftë se shfrytëzuesi i pensionit, nuk i përmbahet konstatimit të zyrtarit përgjegjës përkatësisht zyrës përkatëse pensionale për kthimin e pagesave në afatin prej tetë (8) ditësh, atëherë iniciohet procedura e paraparë për kthim të mjeteve.
6. Pas skadimit të afatit tetë (8) ditësh, Departamentit të Pensioneve përmes aktit të veçantë duke potencuar faktet të cilat janë esenciale në largimin e përfituesit nga pensioni, kërkon kthimin e pagesave në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga personi i cili ka bërë tërheqjen e pensionit.
7. Në pamundësi të kthimit të menjëhershëm të shumës së mjeteve të tërhequra, Departamenti i Pensioneve në marrëveshje me personin i cili ka bërë tërheqjen e mjeteve, mund të bien dakord për kthimin e mjeteve në këste, brenda një periudhe gjashtë (6) deri dymbëdhjetë (12) muaj.
8. Në qoftë se ish-përfituesi i pensionit, e përfill rekomandimin për kthimin e pagesave menjëherë apo sipas marrëveshjes në afatin e paraparë, është i obliguar të sjellë fletëpagesën apo fletëpagesat të cilat i dorëzon te zyrtari i autorizuar, me qëllim të barazimit të kthimit të pagesave.
9. Zyrtari i autorizuar, në rast nevojë do të bëjë kërkesën në bankë për t'u njoftuar me gjendjen financiare të llogarisë së përfituesve të pensionit për mjetet eventuale ekzistuese në llogari, llogari kjo që nuk ka pasur qarkullim për një kohë të gjatë dhe normalisht iniicohetocedura për kthimin e mjeteve në Departamentit të Pensioneve dhe mbylljen e llogarisë.
10. Për rastet kur nuk arrihet marrëveshje për kthimin e mjeteve konform paragrafit 4, 6 dhe 7 të këtij neni, kundër shfrytëzuesit të pensionit, respektivisht personit i cili e ka shfrytëzuar pensionin pa bazë

ligjore, ministria do të inicoj procedurën gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

Neni 15 **Llogaritë bankare**

1. Pensioni paguhet përmes llogarisë bankare varësisht nga përcaktimi i pensionistit.
2. Në rast kur pensionisti vdes, Departamenti i Pensioneve, kërkon nga banka përkatëse, t'i kthej mjetet e alokuara pas vdekjes së pensionistit.
3. Në rastet kur zyrtarët e bankës deklarojnë se ia kanë paguar pensionin personit të autorizuar edhe pas vdekjes së pensionistit, Departamenti i Pensioneve, kërkon nga banka që të identifikojë personin që e ka bërë tërheqjen e pensionit.
4. Departamenti i Pensioneve kontaktojnë çdo muaj me bankat në mënyrë që kërkojnë informata për pensionistët që kanë vdekur ose për të cilët kanë kërkuar që të hiqen nga llogaria bankare.

Neni 16 **Raportet**

Udhëheqësi i zyrës pensionale, përgatitë raport javor, të cilin ja dërgon Departamentit të Pensioneve për numrin e pagesave të ndërprerjeve të konfirmuara dhe suspenduara për shkak të vdekjes së pensionistit.

Neni 17 **Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet:

- 1.1. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2014 ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 15/2004 për zbatimin e ligjit të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ nr.12/2009.
- 1.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2013 për lajmërimin, suspendimin, riaktivizimin, riaplikimin dhe ndërprerjen e pagesave të pensionit themelor pas vdekjes së pensionistit;
- 1.3. Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2009 për procedurat administrative të kthimit të pagesave nga shfrytëzuesit e skemave pensionale.
- 1.4. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2009 ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 15/2004 për zbatimin e ligjit të pensioneve për persona me aftësi të kufizuara;
- 1.5. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2009 për administrimin e pagesave të skemës së pensioneve për personat me aftësi të kufizuara;
- 1.6. Udhëzimi Administrativ nr 15/2004 për zbatimin e ligjit të pensioneve për persona me aftësi të kufizuara.

Neni 18 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

Arban Abrashi

Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale
11 dhjetor 2015

Në mbështetje të nenit 92 paragrafit 4. dhe 93 paragrafit (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Rriten pagat për të gjitha kategoritë e të punësuarëve që marrin pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës në nivelin 25% në pagën bazë nga data 1 prill 2014.
2. Rriten pensionet dhe kompenzimet për këto kategori:
 - 2.1. Personat me aftësi të kufizuara, në nivelin 25%
 - 2.2. Invalidët e Luftës, në nivelin 25%
 - 2.3. Pensionistët e hershëm të Trepçës, në nivelin 50%
 - 2.4. Pensionistët e parakohshëm të TMK-së, në nivelin 25%
 - 2.5. Pensionet bazë të kontributdhënësve, në nivelin 25%
 - 2.6. Pensionet bazike, në nivelin 25%
 - 2.7. Pensionistët e pjesëtarëve të FSK-së, në nivelin 25%
 - 2.8. Kompenzimet për të verbrit, në nivelin 25%
3. Mjetet nga pika 1. dhe 2 e këtij vendimi ndahen nga programi Kontigjenca për paga (kodi 201-281) dhe transferohen te organizatat buxhetore në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje sipas specifikimit të ndarjeve në nën-programe, të përgatitur nga Ministria e Administratës Publike.
4. Obligohet Ministria e Administratës Publike, Ministria e Financave, dhe të gjitha Organizatat buxhetore për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

LIGJI Nr. 03/L-019

**PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA
I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR.05/L-078 (VITI 2016)**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke pohuar se unversialiteti, pandashmëria, ndërvarësia dhe ndërlidhja e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe nevojës së personave me aftësi të kufizuar për t'i garantuar ato pa diskriminim;

Me qëllim të avancimit të pozitës socio-materiale dhe integritit në jetën e përditshme të Personave me aftësi të kufizuara;

Me qëllim të zbatimit të drejtë të parimeve themelore dhe të drejtave universale nga marrëdhënia e punës,

Miratton

**LIGJ PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA**

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Fushëveprimi**

Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësim, riaftësim profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura, të cilat ndërlidhen me objektin e shqyrtimit dhe rregullimit në këtë ligj kanë këtë kuptim dhe domethënie:

1.1. **Aftësia e kufizuar** - kufizim në qasje dhe aktivitete të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore;

1.2. **Personat me aftësi të kufizuara** - personat që kanë dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;

1.3. **Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara**, si pasojë e dëmtimit - Invalidin e luftës, invalidin civil të luftës, invalidin e punës, personi i lindur me dëmtime fizike, shqisore , intelektuale ose mendore, dhe personi i cili si shkas i fatkeqësisë apo sëmundjes ka aftësi të kufizuar fizike, shqisore , intelektuale ose mendore;

1.4. **Komisioni Mediko-Social** - ekip i përbërë prej ekspertësh mjekësor dhe ekspert të lëmive të tjera, i themeluar nga institucioni përkatës, me qëllim të konstatimit dhe vlerësimit të shkallës së aftësisë së kufizuar të një personi;

1.5. **Aftësimi dhe riaftësimi profesional** - të gjitha aktivitetet që synojnë të sigurojnë njohuri, shkathtësi të reja për punë efikase brenda profesionit që e ka kryer edhe më parë, apo për një profesion tjetër që personi me aftësi të kufizuar mund t'a kryejë me sukses;

1.6. **Përshtatshmëria e mjedisit** - masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi pa barriera të natyrave të ndryshme për sigurim të qasjes së përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar;

1.7. **Mjetet ndihmëse** - mjete të cilat i përdorin personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e zakonshme;

1.8. **Punë e përshtatshme** - punën të cilën e kryen personi me aftësi të kufizuara në përputhje me mundësitë e tij fizike, shqisore, intelektuale ose mendore si dhe me kualifikimin përkatës të fituar gjatë shkollimit të rregullt apo specifik, apo aftësimit dhe riaftësimit profesional;

1.9. **Trajneri** – profesionist i certifikuar, i cili ka mandat nga Qendra për Aftësim Profesional – QAP, që të organizoj procesin teorik dhe praktik të aftësimit dhe riaftësimit profesional të kandidatëve të përfshirë në trajnim, t'i vlerësoj kandidatët për njohurit dhe shkathtësitë e arritura gjatë trajnimit;

1.10. **Edukimi specifik** - proces arsimor i aprovuar nga organet kompetente arsimore për plotësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara;

1.11. **Asistenti** - person i domosdoshëm pa të cilin personi me aftësi të kufizuar nuk mund të aftësohet apo të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune;

1.12. **Punëtorja mbrojtëse** - ndërmarrje që themelohet me qëllim të ofrimit të punës dhe të punësimit të përshtatshëm, në vendin dhe hapësirën me pajisje përkatëse për personat me aftësi të kufizuara;

1.13. **Qendra punuese** - vend punishte e specializuar që punëson persona me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të punësohen apo ta mbajnë punën, sipas kushteve të përgjithshme, dhe të veçanta në punëtorinë mbrojtëse;

1.14. **MPMS** - Ministrinë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

1.15. **APRK** - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës;

1.16. **QAP** - Qendrat e Aftësimit Profesional të themeluara nga MPMS-ja që ofrojnë shërbime për aftësim, riaftësim dhe kualifikim të punëkërkuësve, me qëllim të rritjes së mundësive për punësim produktiv dhe vetëpunësim në harmoni me kërkesat e tregut të punës;

1.17. **ZP** - Zyrat e Punësimit.

KREU II

STATUSI I PersonaVE me Aftësi të KUFIZUARa për Punë

Neni 4

1.Varësisht nga statusi dhe realizimi i të drejtave, person me aftësi të kufizuara për punë është:

1.1. Personi me aftësi të kufizuar, shfrytëzues i të drejtave dhe përfitimeve financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi;

1.2.personi me aftësi të kufizuara pa përgatitje profesionale për punë, i cili realizon të drejta dhe përfitime sipas dispozitave për sigurim pensional dhe invalidor;

1.3.personi me aftësi të kufizuara, i cili realizon të drejta dhe përfitime sipas dispozitave ligjore mbi mbrojtjen e invalidëve të luftës dhe atyre civil;

1.4.nxënësi prej moshës pesëmbëdhjetë (15) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me aftësi të kufizuar mendore, fizike, psikike ose të kombinuara sipas dispozitave ligjore të aplikueshme për shkollimin e mesëm, duke i siguruar atij që ka nevojë edhe gjuhën e shenjave për personin e shurdhët dhe Alfabetin e Brajlit për të verbër;

1.5.i riu prej moshës pesëmbëdhjetë (15) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me pengesa në zhvillim, i cili realizon të drejta dhe përfitime sipas dispozitave ligjore të ndihmës sociale dhe dispozitave tjera; dhe

1.6.personi me aftësi të kufizuara më i vjetër se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, i cili të drejtën në aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësim, nuk ka mund ta realizoi sipas dispozitave ligjore nga pika 1 deri në pikën 3 të këtij neni.

Neni 5 Diskriminimi

1. Diskriminimi përfshin çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, i cili konsiston në mosdhënien e mundësive të barabarta ose trajtimit jo të barabartë në punësim apo në profesion.

2. Çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune në bazë të aftësive të caktuara që kërkohen për atë vend pune, nuk konsiderohet si diskriminim.

3. Ndalohet çdo lloj diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar ju garantohet mbrojtje ligjore e barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.

KREU iii

Procedurat për VLERËSIMIN E AFTËSISË për Punë për Personat me aftësi të kufizuara

Neni 6

1. Zvogëlimin e aftësive për punë për personat me aftësi të kufizuara sipas paragrafëve 1., 2., 3., dhe 6 të nenit 4 të këtij ligji në shkallën e parë, e përcakton komisioni profesional në zyrën rajonale kompetente të DAPK-së.

2. Zvogëlimin e aftësive për punë për personat me aftësi të kufizuara sipas paragrafëve 1., 2., 3., dhe 6 të nenit 4 të këtij ligji e përcakton Komisioni Mediko-Social, i cili punon dhe vepron në kuadër të Departamentit kompetent të MPMS.

3. Iniciativa për fillimin e procedurës për njohjen e të drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni, paraqitet me kërkesën e personit me aftësi të kufizuar. Në pamundësi të iniciativës për fillimin e procedurës nga ana e personit me aftësi të kufizuar, iniciativën për procedurë e bën familja e tij e ngushtë, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi i tij ose personi i tretë.

4. Kërkesa për procedurë për vlerësimin e zvogëlimit të aftësisë së kufizuar për punë mund të ngritët në bazë të kërkesës së vetë personit me aftësi të kufizuar, anëtarit të familjes së ngushtë, përfaqësuesit të tij ligjor ose kujdestarit të tij.

5. Kërkesës i bashkëngjiten edhe dokumentet e nevojshme mbi përcaktimin e aftësisë së zvogëluar për punë.

6. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e Komisioni Mediko-Social të shkallës së parë, ka të drejt ankesë pranë organit të shkallës së dytë në MPMS.

Neni 6A

Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë

1. Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë dhe mundësitë për punësim apo mbajtjen (ruajtjen) e punës përfshinë kriteret mjekësore, sociale dhe kritere të tjera të cilët përcaktojnë mundësitë dhe aftësinë e personave me aftësi të kufizuara për inkuadrimin e domosdoshëm në tregun e punës dhe kryerjen e punëve në mënyrë të pavarur apo me mjetet ndihmuese teknike, përkatësisht punësimin në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

2. Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara vlerësohet nga Komisioni Mediko-social. Për mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara MPMS-ja nxjerrë akt nënligjor.

3. Gjatë procesit të vlerësimit të aftësisë së mbetur për punë, caktohet gjendja sociale, psikologjike dhe faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në aftësinë për punë dhe mundësitë e punësimin.

4. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja dhe mandati i Komisionit Mediko-social, rregullohen me akte nënligjore të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6B

Konfidencialiteti

Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë dhe mundësitë për punë apo ruajtjen e punës, duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të sigurojnë respektimin e personalitetit, dinjitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

1. Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, me akt nënligjor të veçantë e përcakton shkallën e aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara.

2. Procedurat e aplikimit për caktimin e aftësisë së kufizuar dhe njohjen e të drejtave në aftësim, riaftësim dhe punësim, rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

3. Në procedurën e vendosjes për përcaktimin e aftësisë së zvogëluar të punës për personat me aftësi të kufizuara si dhe njohjen e të drejtës për punë sipas këtij ligji, aplikohen dispozitat e ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative.

KREU IV

AFTËSIMI, RIAFTËSIMI PROFESIONAL DHE AFTËSIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 8

1. Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në aftësim, riaftësim profesional sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me këtë ligj. Në rastet e caktuara, kur është e nevojshme për shkak të shkallës, llojit dhe rëndësisë, aftësimi, riaftësimi mund të behët në shkollat e veçanta dhe institucione tjera sipas plan-programeve për aftësimin, riaftësimin profesional.

2. Aftësimi, riaftësimi profesional i personave me aftësi të kufizuar përfshin këto masa dhe aktivitete:

- 2.1.përcaktimin e aftësisë mendore për punë;
 - 2.2.informimin, këshillimin profesional dhe vlerësimin e mundësisë profesionale;
 - 2.3.analizimin e tregut për punë, mundësitë për punësim dhe inkuadrimin në punë;
 - 2.4.vlerësimin i mundësisë për aftësimin, riaftësimin dhe hartimin e programeve për aftësim, riaftësim;
 - 2.5.aftësimin profesional, kualifikimin plotësues, rikualifikimin me programet e përsosjes dhe mirëmbajtjes së shkathtësive të punës dhe atyre sociale në periudhën derisa të punësohet;
 - 2.6.informimin dhe këshillimin me procese teknologjike gjatë aftësimit profesional për punësim;
 - 2.7.programet vetanake dhe të përbashkëta për avancimin e punës sociale dhe integrimi në shoqëri;
 - 2.8.mësimin profesional, planifikimin dhe aplikimin e teknologjisë së zgjedhur;
 - 2.9.propozimet këshillëdhënëse mbi aplikimin e teknikave dhe teknologjive të ndryshme në mësim dhe në punë, krahas vlerësimit të mundësive për zbatimin e tyre;
 - 2.10.ndihmën Teknike, përkrahjen përcjelljen dhe vlerësimin e rezultateve; si dhe
 - 2.11.njoftimin, dhe përkrahjen për burimet financiare.
3. Kohëzgjatja e aftësimit, riaftësimit profesional varet nga aftësitë e mbetura për punë, ndërlikueshmëria e organizimit dhe e zbatimit të masave dhe aktiviteteve.
 4. Aftësimin, riaftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara e organizon dhe e menaxhon Qendrat për aftësim profesional në Kosovës.
 5. Aktivitetet e aftësimit, riaftësimit profesional realizohen në institucionet arsimore, zyrat e punësimit, Qendrat e aftësimit profesional, dhe personat tjerë juridik, të cilët i plotësojnë kushtet për arsim dhe aftësim profesional, të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e tjera të aplikueshme.

Neni 9

Angazhimet personale për aftësimin, riaftësimin profesional

1. Personi me aftësi të kufizuara, në mënyre të mëvetësishme mund të kontribuoj në aftësimin, riaftësimin e tij profesional dhe në punësim në këto raste:
 - 1.1. me përkujdesje për shkollimin dhe aftësimin profesional të tij/saj varësisht nga mundësitë e ofruara, aftësitë dhe shkathtësitë e tij/saj;
 - 1.2. me aplikim në konkursin publik për punësim për vendet e lira dhe të përshtatshme të punës, për të cilat i plotëson kushtet e parapara;
 - 1.3. me pranimin e punës së ofruar dhe gatishmërinë për kryerjen e punës së tillë;
 - 1.4. me respektimin e disiplinës teknologjike gjatë aftësimit dhe punës profesionale;
 - 1.5. me bashkëpunimin në çështjet e aftësimit dhe punës profesionale me mjekun, defektologun, psikologun, me punëtorin social, juristin, teknologun dhe drejtpërdrejt me punëtorin e varur;
 - 1.6. me miratimin e ofertës së arsyeshme të ofruar nga punëdhënësi për ndërrimin e punës, respektivisht caktimit në punët e tjera adekuate për shkak të ndërprerjes së nevojave ose pamundësisë së kryerjes së punëve të deri atëhershme; dhe
 - 1.7. me aftësimin profesional gjatë punës, sipas nevojës edhe me kualifikim plotësues ose me rikualifikim me qëllim të mbajtjes së vendit të punës;

Neni 10
Politikat qeveritare për aftësimin profesional

1. Politikat qeveritare përkitazi me aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara do të përfshijnë:

- 1.1. aftësimin, riaftësimin profesional dhe format tjera të mbështetjes për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- 1.2. parimet, mënyra e veprimit dhe metodat e përgatitjes profesionale të zbatuara përgjithësisht në kualifikimet e personave të tjerë, zbatohen në rastet e personit me aftësi të kufizuar, deri në atë mase sa lejojnë aftësitë e tij;
- 1.3. masat e mundshme dhe të nevojshme për të krijuar dhe zhvilluar shërbimet e specializuara të aftësimin profesional për personat me aftësi të kufizuara, që kërkojnë ndihmë për gjetjen e punës dhe avancim në vendin e punës;
- 1.4. plan programet mësimore sipas sistemit modular që mundësojnë aftësim individual për personat me aftësi të kufizuara;
- 1.5. aftësimin e përbashkët të personave me aftësi të kufizuara me të tjerët, në hapësirë të njëjtë dhe trajner të njëjtë me qëllim të integritit të tyre në shoqëri;
- 1.6. angazhimin e institucioneve që ofrojnë aftësim profesional, për të krijuar mjedis fizik të përshtatshëm për qasje pa vështirësi për personat me aftësi të kufizuara;
- 1.7. aftësimin e personelit administrativ dhe teknik të institucioneve për aftësim, riaftësim dhe punësim, të cilët drejtpërsëdrejti punojnë me personat me aftësi të kufizuara.

KREU V

KUSHTET E PUNËSIMIT

Neni 11

Kushtet e përgjithshme dhe veçanta të punësimin

1. Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në punësim, integrim në tregun e punës në kushtet përgjithshme dhe te veçanta të përcaktuara me këtë ligj.
2. Në kushte të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, mund të punësohen në Punëtoritë Mbrojtëse, Qendrat Punuese dhe në punë të tjera, në bazë të aftësive të punës dhe sipas kushteve të përgjithshme mund të punësohen në tregun e hapur të punës ose ta mbajnë punën e vet.
3. Punësimi në kushte të veçanta konsiderohet edhe vetëpunësimi, si dhe punësimi në ekonominë familjare i personave me aftësi të kufizuara.
4. Me kushtet e përgjithshme të punësimin, nënkuptohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës.

Neni 12

Punësimi në tregun e hapur të punës

1. Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara.
2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

3. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 12 të ligjit bazik, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në një xhirrollogari të veçantë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës, pagesat mujore në lartësi të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që duhet të kishte punësuar.

3a. Mënyrat, procedurat dhe afatet e pagesës mujore sipas paragrafit 1 të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

4. Varësisht nga shkalla dhe kategoria e aftësisë së kufizuar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë nënligjor, do të rregulloj dhe përcaktoj vendet e punës dhe punët e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 13

Themelimi i marrëdhënies së punës

1. Personi me aftësi të kufizuara themelon marrëdhënie të punës me nënshkrimin e kontratës së punës, në përputhje me Ligjin e punës, Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ligjeve të veçanta me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit.

2. Personi me aftësi të kufizuara i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas Ligjit të punës, Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ligjeve të veçanta me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës, kontratës kolektive, këtij ligji dhe kontratës së punës.

3. Personi me aftësi të kufizuara vetëm me pëlqimin dhe me nënshkrimin e tij mund të punojë natën, jashtë orarit të punës ose me orar të ndryshuar, në harmoni me vlerësimin e Komisionit Medico-Social, i cili ia ka përcaktuar nivelin e aftësisë për punë.

4. Bartësi i sigurimit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, merren vesh me punëtorin rreth kushteve të punës dhe marrëdhënien e punës, kohën e punës, kohëzgjatjen e punës, mbikëqyrjen profesionale, mbulimin e shpenzimeve të përshtatjes dhe lartësinë e atyre shpenzimeve si dhe marrëdhëniet tjera nga puna.

5. Bartësi i sigurimit të punësimit nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 18 të këtij ligji ose personi tjetër fizik ose juridik, mund të merret vesh me personin me aftësi të kufizuara, lidhur me përshtatjen e kushteve dhe marrëdhënieve të punës, kohën e punës, kohëzgjatjen, mbikëqyrjen profesionale, mbulimin e shpenzimeve të përshtatjes së punës dhe lartësinë e atyre shpenzimeve, si dhe marrëdhëniet tjera nga puna.

Neni 14

Qendrat për aftësim profesional në Kosovë

1. Qendra për aftësim profesional në Kosovë është në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

2. Qendra për aftësim profesional në Kosovës është institucion i themeluar me qëllim të aftësimit, riaftësimit profesional dhe nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

3. Mjetet financiare për punën e Qendrës sigurohen nga themeluesi, nga aktivitetet shërbyese të Qendrës dhe donacionet vendore apo të jashtme.

4. Krijimi i punëtorive mbrojtëse dhe qendrave punuese rregullohet me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga MPMS.

Neni 15

1. Qendra për aftësim profesional angazhohet:

1.1.për aftësimin, riaftësimin profesional, sipas kërkesës së tregut të punës për të gjithë personat me aftësi të kufizuara;

1.2.për nxitjen e punësimit të përshtatshëm të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me aftësitë e mbetura për punë;

1.3.për zhvillimin e programeve, praktikave dhe strategjive për aftësimin, riaftësimin profesional dhe nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara;

1.4.për zbatimin e drejtë dhe efikas të plan-programeve edukative të aftësimin, riaftësimin profesional, të përcaktuara nga MASHT-i;

1.5.për krijimin e projekteve mbështetëse përkritazi me aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;

1.5a. Gjatë aftësimin, riaftësimin profesional për personat me aftësi të kufizuara të sigurohet interpretuesi i gjuhës së shenjave dhe asistenti në raste të nevojshme .

1.6.për hulumtimin e mundësive të subvencionimit nga donacionet e ndryshme, me qëllim të përkrahjes së vetëpunësimit të personave me aftësi të kufizuara;

1.7.për zhvillimin e teknologjisë përkatese, lidhur me aftësimin, edukimin dhe trajnimin e personave me aftësi të kufizuara;

1.8.për krijimin e punëtorisë mbrojtëse, qendrës punuese dhe ndërmarrjeve tjera, të cilat mundësojnë aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara; si dhe

1.9.koordinimin, menaxhimin dhe administrimin e shumë çështjeve tjera të cilat ndërlidhen me aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;

Neni 16

Evidentimi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

1. Evidentimin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara sipas legjisllacionit të aplikueshëm dhe dispozitave të këtij ligji e bëjnë dhe e udhëheqin zyrtarët e punësimit, sipas vendbanimit të këtyre personave.

2. Mënyrën dhe rregullat për mbajtjen e evidencës e përcakton Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt nënligjor.

3. Punëdhënësi është i obliguar që t'u dërgojë zyrtarëve të punësimit të dhënat vijuese për personat me aftësi të kufizuara që janë të punësuar tek ai/ajo:

3.1.emrin, mbiemrin dhe adresën e vendbanimit;

3.2.datën e themelimit të marrëdhënies së punës;

3.3.datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Afati i dorëzimit të këtyre shënimeve nga punëdhënësi sipas paragrafit 3 të këtij neni, për të punësuarit që gjenden në marrëdhënie pune, është gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndërsa, për të punësuarit e ri si dhe për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për personat me aftësi të kufizuara, afati është tridhjetë (30) ditë nga dita e fillimit të punës, gjegjësisht dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Neni 17

Obligimet e punëdhënësit të ri (të sapo themeluar)

1. Punëdhënësit e rinj, që nga momenti i marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë, në afat prej njëzetekatër (24) muajsh janë të liruar nga obligimet lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

2. Punëdhënësi nga paragrafi 1 i këtij neni, i cili kërkon shtyrje të afatit pas njëzetekatër (24) muajve lidhur me detyrimin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është i obliguar që kërkesën ta arsyetojë në mënyrë të hollësishme.

3. Kopja e vendimit të cilën e nxjerr organi përgjegjës i MPMS-së, për shtyrjen e obligimit për pranimin nga paragrafi 2 i këtij neni i dërgohet zyrës së punësimit.

4. Punëdhënësit të cilët janë themeluar dhe regjistruar sipas ligjit, por nuk janë të detyruar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara sipas paragrafit 2 të nenit 12 të këtij ligji, mund ta punësojnë këtë kategori në punët e përshtatshme sipas këtij ligji, dhe të realizojnë stimulimet dhe beneficionet e parapara me këtë ligj.

KREU VI

BENEFICIONET E PUNËDHËNËSVE PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 18

Beneficionet financiare me rastin e punësimit

1. Punëdhënësi i cili punëson persona me aftësi të kufizuara si dhe personi me aftësi të kufizuara që ushtron veprimtari të pavarur, të drejtën për lehtësime doganore dhe tatimore e realizojnë sipas një akti nënligjor të nxjerr nga Qeveria e Kosovës.

2. Për personin me aftësi të kufizuara njëqind për qind (100%) shfrytëzues i pensionit të aftësisë së kufizuara, pensioni të shndërrohet në asistencë personale për ndihmësin në punë (asistentin e tij) dhe kjo të rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 19

Stimulimi material në të holla

1. Punëdhënësi, i cili e punëson personin me aftësi të kufizuara që është i papunësuar, sipas dispozitave ligjore, përveç punëdhënësit nga neni 11 i këtij ligji, ka të drejtë në stimulim material në të holla.

2. Stimulimi material në të holla, përcaktohet në lartësinë e kontributit të obliguar në paga, i përcaktuar me dispozitat e obligueshme të sigurimit pensional, në bazë të kontributit të obligueshëm të paguar për paga (rroga), i përcaktuar me dispozitat mbi sigurimin shëndetësor si dhe kontributit të obligueshëm të paguar për paga, i përcaktuar sipas ligjit, i cili rregullon ndërmjetësimin me rastin e punësimit dhe të drejtave gjatë kohës së papunësisë.

3. Kërkesën për pagesën e stimulimit material në të holla, punëdhënësi ia paraqet buxhetit të Kosovës. Kërkesës i bashkëngjitet pro fatura e stimulimit material në të holla, me të dhënat e personave me aftësi të kufizuara, dhe mbi kontributet e paguara në paga për ata persona. Po kështu, kërkesës i bashkëngjiten edhe dëshmitë se kontributet janë paguar për të gjithë punëtorët dhe kopjet e llogarisë së pagave për personat me aftësi të kufizuara ndërsa, herën e parë edhe dëshminë për punësimin dhe aftësinë e mbetur për punë.

4. Punëdhënësi mundet që kërkesën për pagesë të stimulimit material në të holla ta paraqes me përfundimin e muajit. Stimulimi në të holla paguhet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës me të dhënat e nevojshme.

5. Autorizohen organet kompetente që ta publikojë mënyrën e realizimit të të drejtave për stimulim material, si dhe përmes organeve drejtuese kompetente të punëdhënësit, ta mbikëqyrë rregullsinë e llogaritjes së stimulimit në të holla dhe besueshmërinë e dëshmive.

Neni 20

Qendra për aftësim profesional e Kosovës, për shërbimet që u ofron personave me aftësi të kufizuara, i paguan shërbimet publike në lartësi të njëjtë sikurse amvisëritë.

Neni 21

1. Për lehtësimet tatimore, doganore dhe lehtësime tjera, Qendra për aftësimin profesional, punëtorja mbrojtëse, qendra punuese dhe punëdhënësit e tjerë mbajnë kontabilitet të veçantë.

2.Mjetet e siguruara nga përfitimet shfrytëzohen vetëm për:

2.1.zgjerimin e kapacitetit të Qendrës për aftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara;

2.2.hapjen e vendeve të reja të punës;

2.3.pajisjen me teknologji të re të Qendrës; dhe

2.4.përmirësimin e standardit të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 22

Donacionet për destinime të veçanta

1. Qendra për aftësimin profesional e Kosovës, punëtorja mbrojtëse dhe qendra punuese, mund të pranojnë donacione në mjete financiare dhe në pajisje.

2. Nëse donacioni është Grant i përcaktuar atëherë ne kuadër të marrëveshje donator i përcakton kriteret, e nëse është grant i përgjithësohen kriteret i përcakton Qeveria.

3. Donacionet në mjete financiare nuk shfrytëzohen për pagat e punëtorëve, të cilat sipas dispozitave tatimore konsiderohen të ardhura.

4. Donacionet në mjete financiare ose pajisje, qendra për aftësimin, riaftësimin profesional, punëtorja mbrojtëse dhe qendra punuese, i udhëheqin dhe shfrytëzojnë si mjete me destinim të veçantë.

5. Mjetet e destinimeve të veçanta udhëhiqen në llogari të posaçme.

6. Shfrytëzuesit e destinimeve të veçanta nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar që për çdo vit, t'ia dorëzojnë raportin financiar organit mbikëqyrës për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim si dhe donatorit.

7. Mjetet materiale nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat nuk janë shpenzuar për destinimet si në paragrafin 2 të këtij neni, barten në buxhetin e Kosovës dhe përdoren për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara.

KREU VII

MJETET FINANCIARE PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 23

1. Mjetet financiare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara i sigurojnë:

1.1.Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, ku ka punuar më parë personi me aftësi të kufizuara dhe ku atij i është përcaktuar aftësia e kufizuar për punë gjatë kohës së punës dhe Shoqatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve, OJQ-të e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, përmes dhënies së donacioneve të ndryshme, Sigurimi i këtyre mjeteve dhe raportet ndërmjet këtyre subjekteve për subvencionimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuar rregullohen me marrëveshje të veçantë.

Neni 24

1. Financimi për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara bëhet nga buxheti i Kosovës.

2. Buxhetin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, e menaxhon dhe mbikëqyrë Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Kosovës.

3. Mjetet e nevojshme për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara sigurohen nga buxheti i Kosovës si mjete të themeluesit , mjetet e kontributeve të veçanta, mjetet e

pashpenzuara nga destinime të veçanta, të ardhurat e tjera në bazë të ligjit dhe dispozitave tjera, si dhe donacionet e personave juridik vendor dhe të jashtëm.

4. Mjetet e grumbulluara do të dedikohen për:

- 4.1. programet zhvillimore dhe avancimin e aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- 4.2. financimin e institucioneve për aftësimin, riaftësimin profesional;
- 4.3. pagesën e stimulimit material në para;
- 4.4. bashkëfinancimin e programeve për mbajtjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara;
- 4.5. për vendet e reja të punës për personat me aftësi të kufizuara.

KREU VIII

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 25

1. Me gjobë në të holla prej pesëqind (500) deri dymijë (2000) euro do të dënohet punëdhënësi dhe personi përgjegjës i tij:

- 1.1. i cili bën diskriminim në punësim sipas nenit 5 të këtij ligji;
- 1.2. i cili nuk paguan kontributin e posaçëm, ndërsa ka qenë i obliguar që ta paguaj sipas nenit 12 të këtij ligji;
- 1.3. i cili ndaj personit me aftësi të kufizuara sillet në kundërshtim me dispozitat e nenit 13 të këtij ligji;
- 1.4. i cili nuk i dorëzon të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara sipas nenit 16 të këtij ligji;
- 1.5. i cili mjetet për destinim të veçantë i shfrytëzon për qëllime tjera dhe nuk i udhëheqë në llogari të posaçme sipas nenit 22 të këtij ligji;
- 1.6. i cili nuk e dorëzon raportin financiar vjetor për mjetet me destinim të veçantë sipas paragrafit 6 të nenit 22 të këtij ligji; si dhe
- 1.7. i cili në nën kodin buxhetor nuk i paguan mjetet e pashpenzuara të destinimeve të veçanta sipas paragrafit 7 të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 26 Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit në fuqi për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

KREU IX

Neni 27

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Punëdhënësit kanë për detyrë që aktet e brendshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës, t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji më së largu brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes së tij në fuqi.

2. Deri në nxjerrjen e akteve të brendshme nga paragrafi 1 i këtij neni, drejtpërsëdrejti aplikohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 28

Deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, personat me aftësi të kufizuara realizojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës në bazë të dispozitave që kanë qenë në fuqi.

Neni 29

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, brenda afatit prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të nxjerrë aktet nënligjore që parashihen me këtë ligj.

Neni 30

Më hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat e ligjeve në fuqi që janë në kundërshtim me të.

Neni 31

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-01918 dhjetor 2008

Shpallur me dekretin Nr. DL-084-2008, datë 07.01.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Dr. Fatmir Sejdiu

RREGULLORE (MPMS) NR.02/2015 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRKRAHJES FINANCIARE PËR SUBVENCIONE DHE GRANDE

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Në mbështetje të nenit 8 paragrafit 8.5 të Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.12/2007, 01.05.2007), nenit 8 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/l-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare (Gazeta Zyrtare Nr.5, 5 Prill 2012), nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (Gazeta Zyrtare nr. 47, 25 janar 2009), nenit 53 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin Financave Publike (Gazeta Zyrtare nr.27/2008, 03.06.2008), nenit 8, paragrafit 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.1, 18 Prill 2011); si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011);

Nxjerr:

RREGULLOREN (MPMS) NR.02.2015 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRKRAHJES FINANCIARE PËR SUBVENCIONE DHE GRANDE

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përkrahjes së personave fizik që kanë nevojë për ndihmë financiare dhe mbështetjen e personave juridik (OJQ-të dhe ndërmarrjet) që ofrojnë shërbime dhe zbatojnë projekte në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet vetëm për personat fizik dhe juridik (OJQ-të dhe ndërmarrjet), të cilat aplikojnë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për sigurimin e përkrahjes financiare me subvencione dhe grante, që mund të financohen nga mjetet e aprovuara dhe alokuara për këtë destinim, në kuadër të programeve buxhetore të MPMS-së.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë domethënie:

1.1. **Person fizik** – nënkupton individin që ka nevojë për përkrahje financiare, për zgjidhjen e një problemi në fushën sociale apo fushën e punësimit;

1.2. **OJQ-të** – nënkupton organizatat joqeveritare dhe shoqatat të cilat përfaqësojnë të drejtat e kategorive sociale dhe ofrojnë shërbime apo zbatojnë projekte në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale;

1.3. **Ndërmarrjet** – nënkupton ofruesit privat dhe ndërmarrjet sociale të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe të punësimit, si dhe zbatojnë projekte për hulumtime, trajnime dhe këshillime në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale;

1.4. **Subvencion** – nënkupton të gjitha transferet e njëanshme të pakthyeshme për personat fizik dhe juridik të cilat bazohen në një marrëveshje apo vendim të nënshkruar në mes të përfituesit dhe MPMS-së;

1.5. **Grante** – nënkupton shumën e caktuar të parave të cilat i transferohen një personi fizik dhe juridike për realizimin një qëllimi të caktuar, ku specifikohet paraprakisht në detaje mënyra e shpenzimit të parave.

Neni 4 **Programi vjetor i financimit**

1. MPMS-ja në fillim të çdo viti, përgatit një program për përkrahje me subvencione dhe grante në fushën e punësimit, aftësisimit dhe mirëqenies sociale, program i cili mund të publikohet në mediat publike dhe elektronike.

Neni 5 **Fusha e përkrahjes**

1. Ministria përkrah personat fizik që kanë nevojë për përkrahje financiare, OJQ-të dhe ndërmarrjet, të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve dhe realizimin e projekteve në fushën e punësimit, aftësisimit profesional dhe mirëqenies sociale, duke përfshirë këto fusha specifike:

1.1. Zgjidhjen e një problemi social dhe nevojë sociale emergjente, për individin dhe familjen në gjendje të rëndë sociale;

1.2. Ofrimin e shërbimeve të punësimit, për personat e regjistruar si punëkërkuar dhe të papunë;

1.3. Ofrimin e trajnimeve profesionale për punëkërkuar dhe të papunët e regjistruar në shërbimet publike të punësimit;

1.4. Ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës dhe të moshuarit;

1.5. Ofrimin e shërbimeve për invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, viktimat civile dhe veteranët e luftës.

Neni 6 **Subvencionet dhe grantet**

1. Subvencionet dhe grantet për personin fizik dhe juridik të përcaktuar me këtë rregullore, realizohen sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit të arritur në mes të MPMS-së dhe përfituesit, si dhe vendimit të përfaqësuesit të autorizuar nga MPMS-ja (Ministri).

2. Subvencionet dhe grantet ndahen nga linja buxhetore, kategoria për subvencione dhe transfere.

3. Varësisht prej nevojave të paraqitura subvencionet dhe grantet për personat fizik dhe juridik, mund të realizohen me Marrëveshje Mirëkuptimi dhe thirrje publike apo konkurs për projektpropozime.

4. Subvencionet dhe grantet, ndahen në mënyrë periodike dhe ad-hoc sipas nevojës.

Neni 7 **Përkrahja me Subvencione**

1. Subvencione mund të përfitojnë personat fizik që kanë nevojë për përkrahje, OJQ-të dhe shoqatat, si në vijim:

1.1. Individu i cili ka nevojë për një pagesë në para të gatshme, për zgjidhjen e një problemi emergjent ose problemeve të strehimit dhe kushteve elementare për jetesë;

1.2.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime të punësimit dhe trajnimit profesional për personat me aftësi të kufizuara;

1.3.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime të mirëqenies sociale për mbrojtjen e fëmijëve;

1.4.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime të mirëqenies sociale për personat me aftësi të kufizuara;

1.5.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime të mirëqenies sociale për personat e moshuar;

1.6.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës dhe trafikimit;

1.7.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime për invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, viktimave civile dhe veteranët e luftës;

1.8.OJQ-të dhe shoqatat që ofrojnë shërbime për pensionistët dhe invalidët e punës.

Neni 8 Përkrahja me Grante

1. Grante mund të përfitojnë personat fizik që kanë nevojë për përkrahje, OJQ-të dhe ndërmarrjet, si në vijim:

1.1. Të papunët me projektide për vetëpunësim, trajnim në punë dhe aftësim profesional;

1.2. Individit që ofron shërbime të kujdesit social në familje dhe komunitet për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara;

1.3. OJQ-të dhe ndërmarrjet që ofrojnë punësim për të papunët e regjistruar në shërbimet publike të punësimit;

1.4. OJQ-të dhe ndërmarrjet që ofrojnë trajnime dhe aftësim profesional për të papunët e regjistruar në shërbimet publike të punësimit;

1.5. Ndërmarrjet dhe kompanitë private që punësojnë personat e regjistruar si të papunë në shërbimet publike të punësimit;

1.6. OJQ-të dhe ndërmarrjet që realizojnë hulumtime dhe këshillime në fushën e punësimit dhe aftësimin profesional;

1.7. OJQ-të dhe ndërmarrjet që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për mbrojtje të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar;

1.8. OJQ-të dhe ndërmarrjet që ofrojnë shërbime për mbrojtjet dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje dhe trafikim;

1.9. OJQ-të dhe ndërmarrjet që ofrojnë shërbime për invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, viktimat civile dhe veteranët e luftës;

1.10. OJQ-të dhe ndërmarrjet që realizojnë hulumtime, trajnime dhe këshillime në fushën e politikave sociale dhe sigurimeve sociale.

1.11. OJQ-të dhe ndërmarrjet që ofrojnë shërbime për pensionistët dhe invalidët e punës.

Neni 9

Shumat e përfitimeve me subvencione dhe grante

1. Shuma maksimale e mbështetjes me subvencione dhe grante për personat fizik, mund të përcaktohet me rastin e thirrjes publike apo konkursit për aplikim.
2. Shuma e përfitimit me subvencione dhe grante për personat fizik, caktohet pas vlerësimit të kërkesës apo projekti idesë nga komisioni përkatës.
3. Shuma maksimale e mbështetjes me subvencione dhe grante për personat juridik, mund të përcaktohet me rastin e thirrjes publike apo konkursit për aplikim.
4. Shuma e përfitimit me subvencione dhe grante për personat juridik, caktohet pas vlerësimit të projektpropozimit nga komisioni përkatës.
5. Me rastin e zbatimit të programeve dhe projekteve të bashkëfinancimit me komunat, ndërmarrjet publike, donatorët dhe organizata ndërkombëtare, shuma e subvencioneve dhe granteve përcaktohet me marrëveshje mirëkuptimi.

Neni 10

Kushtet dhe kriteret e përgjithshme

1. Personat fizik të cilët aplikojnë për përkrahje financiare, duhet të jenë shtetas dhe banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës, përjashtimisht përfitues mund të jenë edhe shtetasit e huaj në rastet e caktuara sipas legjislacionit në fuqi.
2. OJQ-të të cilat aplikojnë për subvencione apo grante, duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare.
3. Ndërmarrjet të cilat aplikojnë për subvencione apo grante, duhet të jenë të regjistruara, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Kriteret për përkrahje me subvencione për personat fizik

1. Personat fizik të cilët aplikojnë për subvencione në fushën e punësimit dhe aftësimin profesional, duhet t'i plotësojnë këto kriteret:
 - 1.1. Të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit si të papunësuar ose punëkërkuar;
 - 1.2. Të jenë të kualifikuar në lëmin përkatës;
 - 1.3. Dëshmi nga punëdhënësi se janë të angazhuar si praktikantë;
 - 1.4. Kontratën e punës të lidhur nga punëdhënësi dhe i punësuar;
 - 1.5. Të kenë vijuar një trajnim profesional lidhur me fushën e caktuar.
2. Personat fizik të cilët aplikojnë për subvencione në fushën e mirëqenies sociale, duhet t'i plotësojnë këto kriteret:
 - 2.1. Kërkesën me arsyetim për nevojën e përfitimit;
 - 2.2. Specifikacionin për shpenzimet e subvencionit dhe
 - 2.3. Dokumentacionin shtesë i cili dëshmon nevojat e tjera për përfitim.

Neni 12
Dokumentet për aplikim për subvencione nga OJQ-të

1. OJQ-të me rastin e aplikimit për subvencione, duhet t'i kenë dokumentet, si në vijim:

- 1.1. Projektpropozimin që përfshin qëllimin dhe aktivitetet e projektit;
- 1.2. Buxhetin e detajizuar si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
- 1.3. Afatin e precizuar kohor për implementimin dhe vendin;
- 1.4. Përshkrimin e detajizuar të përfituesve dhe pjesëmarrësve;
- 1.5. Përshkrimin e detajizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës, përfshirë: personelin, pajisjet dhe aftësinë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete;
- 1.6. CV-të e ekspertëve të angazhuar në projekte;
- 1.7. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
- 1.8. Xhirologarinë në një të një prej bankave komerciale të Kosovës;
- 1.9. Certifikatën e regjistrimit dhe statutin e saj;
- 1.10. Certifikatën e numrit fiskal; dhe
- 1.11. Raportin mbi gjendjen financiare për dy vitet e kaluara.

2. OJQ-të cilat ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare, përveç dokumenteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë edhe të licencuara për llojin e shërbimeve/it të cilat i ofrojnë.

Neni 13
Kriteret për grante për personat fizik

1. Personat fizik të cilët aplikojnë për grante në fushën e punësimit dhe aftësimit profesional, duhet t'i plotësojnë edhe këto kriteret:

- 1.1. Të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit si të papunësuar ose punëkërkues;
- 1.2. Të jenë të kualifikuar në lëmine përkatëse;
- 1.3. Të kenë vijuar një trajnim profesional lidhur me fushën e caktuar;
- 1.4. Certifikatën për trajnime relevante/specifike ose të dëshmojnë në formë të shkruar se do të vijojnë trajnimet përkatëse brenda afatit të përcaktuar nga MPMS-ja;
- 1.5. Të kenë projektidenë për zhvillimin e biznesit;
- 1.6. Të kenë Planin e Biznesit; dhe
- 1.7. Të kenë të regjistruar biznesin në veprimtarinë përkatëse.

2. Personat fizik të cilët aplikojnë grante në fushën e mirëqenies sociale, duhet t'i plotësojnë këto kriteret:

2.1.Të jenë në regjistrin e punëtorëve social;

2.2.Të jenë të licencuar në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare; dhe

2.3.Të prezantojnë projektidenë për ofrimin e shërbimeve.

3. Përparësi në përfitim të grantit, në rastet kur projekti ndërlidhet me objektivat përkatëse në ndonjë nga skemat, të drejtën e aplikimit e kanë:

3.1. Përfituesit e ndihmave sociale, kategoria e dytë;

3.2. Invalidët dhe kategoritë e tjera të dala nga lufta;

3.3. Prindërit vetushqyes;

3.4. Grupet e cenuara; dhe

3.5. Komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë.

Neni 14

Dokumentet për grante për OJQ-të

1. OJQ-të me rastin e aplikimit për grante, duhet t'i kenë dokumentet, si në vijim:

1.1.Projektpropozimin që përfshinë qëllimin dhe aktivitetet e projektit;

1.2.Buxhetin e detajzuar si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;

1.3.Afatin e precizuar kohor për implementim dhe vendin;

1.4.Përshkrimin e detajzuar të përfituesve dhe pjesëmarrësve;

1.5.Përshkrimin e detajzuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës, përfshire: personelin, pajisjet dhe aftësinë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete;

1.6.CV-të e eksperteve të angazhuar në projekte;

1.7.Referencat;

1.8.Kopje të kontratave dhe marrëveshjeve të mirëkuptimit;

1.9.Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;

1.10.Xhirollogarinë në një të një prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore të Kosoves;

1.11.Certifikatën e regjistrimit dhe statutin e saj;

1.12.Certifikatën e numrit fiskal;

1.13.Vërtetimin nga gjykata ekonomike se OJQ-ja nuk është nën hetime; dhe

1.14.Vërtetimin nga Administrata Tatimore.

2.OJQ-të cila ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare, përveç të përcaktuara në paragrafin 1 të

këtij neni, duhet të jenë edhe të licencuara për llojin e shërbimeve/it të cilat i ofrojnë.

Neni 15

Dokumentet për aplikim për grante nga ndërmarrjet

1. Ndërmarrjet, me rastin e aplikimit për grante, duhet t'i kenë dokumentet, si në vijim:

- 1.1. Projektpropozimin që përfshin qëllimin dhe aktivitetet e projektit;
- 1.2. Buxhetin e detajizuar si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
- 1.3. Afatin e precizuar kohor për implementim dhe vendin;
- 1.4. Përshkrimin e detajizuar të përfitueseve dhe pjesëmarrësve;
- 1.5. Përshkrimin e detajizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës, përfshirë: personelin, pajisjet dhe aftësinë për menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete;
- 1.6. CV-të e ekspertëve të angazhuar në projekte;
- 1.7. Referencat;
- 1.8. Kopje të kontratave dhe marrëveshjeve të mirëkuptimit;
- 1.9. Certifikatën e regjistrimit;
- 1.10. Xhirologarinë në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- 1.11. Certifikatën e numrit fiskal;
- 1.12. Vërtetimin nga gjykata ekonomike se ndërmarrja nuk është nën hetime;
- 1.13. Vërtetimin nga Administrata Tatimore;
- 1.14. Pasqyrat e Auditimit për dy vitet e fundit.

2. Ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare, përveç dokumenteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë edhe të licencuara për llojin e shërbimeve/it të cilat i ofrojnë.

Neni 16

Procedurat e aplikimit

1. Procedurat e aplikimit për përfitim në subvencione apo grante, fillon nga momenti i shpalljes publike përmes thirrjes për propozime apo konkursit për projekte në të cilat përcaktohet afati kohor i aplikimit.
2. Publikimi i thirrjes me subvencion apo grante, mund të bëhet përmes Ueb faqes së MPMS-së dhe eventualisht përmes mediave të shkruara dhe atyre elektronike.
3. MPMS-ja, përgatit formën e kërkesave dhe aplikacioneve për plotësim të cilat publikohen në ueb faqen e saj.
4. Dorëzimi i kërkesave dhe aplikacioneve me dokumentacionin e kërkuar për aplikim, dorëzohen në arkivin qendror të MPMS-së.

5. Personat e interesuar, fletë aplikacionin dhe dokumentet e nevojshme për aplikim, i dorëzojnë në Arkivin qendror të MPMS-së.

6. Pranimi i aplikacioneve nga personat fizik dhe juridik, përcaktohet në bazë të thirrjes së publikuar.

7. Me rastin e përmbylljes së afatit për aplikim, arkivi i MPMS-së harton listën aplikuesve dhe së bashku me dokumentacionin e pranuar ia dorëzon Komisionit Vlerësues.

Neni 17

Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve dhe kërkesave

1. Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së, themelohen, Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve për subvencione dhe grante dhe Komisioni për vlerësimin e kërkesave për subvencione.

2. Komisioni Vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve sipas nenit 16 të kësaj rregullore, perbehet prej tre anëtarëve, ku njeri prej tyre është edhe kryetar ndërsa dy të tjerët anëtar të komisionit.

3. Komisioni Vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve, në afat prej 30 ditësh, është i detyruar që të shqyrtojë të gjitha fletë aplikacionet dhe me pas të përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit me listën e propozuar për miratim.

4. Raporti përfundimtar i vlerësimit, i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm i MPMS-së për vendimarrje.

5. Mandati i komisionit përfundon deri në përfundimin e procesit.

6. Komisioni Vlerësues për shqyrtimin e kërkesave për subvencione, përbëhet prej tre anëtarëve, ku njeri është kryetar ndërsa dy të tjerët anëtar të komisionit me mandat një (1) vjeçar.

7. Komisioni Vlerësues për shqyrtimin e kërkesave për subvencione, në afat prej 10 ditësh, është i detyruar që të shqyrtojë kërkesat dhe me pas të përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit të propozuar për miratim tek Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së.

8. Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së, nxjerr vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore për subvencione dhe nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit.

Neni 18

Shpallja e fituesve

1. Pas marrjes së vendimit nga Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së, bëhet publikimi i listës së fituesve për subvencione apo grante.

2. Publikimi i listës nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhet përmes njoftimit përkatës.

3. MPMS i njofton aplikuesit të cilit nuk kanë përfituar subvencione apo grante.

4. Pas përzgjedhjes së përfituesve, lidhet Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të MPMS-së dhe përfituesit/ve.

5. Në marrëveshje, duke mos u kufizuar vete në këto përcaktohen, qëllimi, fushëveprimi, mënyra dhe afati i përmbartimit të projektit, mundësit eventuale të modifikimit të projektit në periudha të caktuara kohore, të drejtat dhe përgjegjësit e palëve, monitorimi i projektit, mënyra dhe afatet e pagesave, gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe raportimi.

Neni 19

Monitorimi i subvencioneve dhe granteve

1.Monitorimi i subvencioneve dhe granteve, mund të realizohet në disa nivele:

1.1.Monitorimi nga zyrtari i autorizuar;

1.2.Monitorimi nga niveli lokal dhe

1.3.Monitorimi nga niveli qendror.

2.Për monitorimin e subvencioneve dhe granteve për personin fizik, caktohet zyrtar monitorues nga niveli lokal ose qendror.

3.Për monitorimin e subvencioneve dhe granteve për personat juridik, themelohet Komisioni i Monitorimit në përbërje të përfaqësuesve të nivelit lokal dhe qendror.

4.Për monitorimin e programeve dhe projekteve me bashkëfinancim, themelohet Komiteti Drejtues, me aktorët e përfshirë në zbatimin e programit të projektit.

5.Zyrtari monitorues, Komisioni i Monitorimit dhe Komiteti Drejtues, themelohen me vendim të institucioneve përkatëse.

6.Zyrtari monitorues, Komisioni i Monitorimit dhe Komiteti Drejtues, përgatitin raportin për realizimin e përfitimeve nga personat fizik dhe juridik.

Neni 20 Bashkëfinancimi

1.MPMS-ja, në rastet e caktuara mund të jetë bashkëfinancuese e programeve dhe projekteve në fushën e punësimit, aftësisht profesional dhe mirëqenies sociale.

2.Bashkëfinancimi për realizimin e programeve dhe projekteve mund të bëhet me organizatat ndërkombëtare, fondacionet dhe donatorët.

3.Bashkëfinancimi për realizimin e programeve dhe projekteve mund të bëhet me institucionet vendore si ministrinë, komunat dhe ndërmarrjet publike.

4.Bashkëfinancimi për realizimin e programeve dhe projekteve mund të bëhet me kompanitë vendore dhe investitorët e jashtëm.

5.Shuma e mjeteve të bashkëfinancimit me subvencione dhe grante, duhet të jetë në përputhje me shumën e mjeteve buxhetore të alokuara në kuadër të Programit Buxhetor të MPMS-së.

6.Zbatimi i bashkëfinancimit të programeve dhe projekteve me të gjithë bashkëfinancuesit nga paragrafi 2, 3 dhe 4 i këtij neni, rregullohet me marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi.

Neni 21 Pagesat

1.Pagesat e subvencionit dhe grantit për personin fizik dhe juridik, realizohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit, përkatësisht vendimit në të cilin përcaktohen kushtet e pagesës.

2.Ekzekutimi i pagesave, bëhet më së largu 20 ditë nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit, përkatësisht vendimit.

3.Pagesa nuk realizohet para se të bëhet mbyllja e projekteve paraprake për subvencione dhe grante të realizuara nga MPMS-ja.

4.Mjetet financiare, për realizimin e pagesës së subvencionit dhe grantit, realizohet nga mjetet e destinuar në kuadër të programeve buxhetore përkatëse të MPMS-së.

Neni 22

Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme

- 1.Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme për subvencione dhe grante për personat fizik, mund të përcaktohen me vendim apo thirrjen për projektide.
2. Shpenzimet e pranueshme dhe të pa pranueshme për subvencione dhe grante për personat juridik, mund të përcaktohen në thirrjen për aplikim apo konkursin për projektpropozime.
- 3.Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme për subvencione dhe grante në raste të caktuara, mund të përcaktohen edhe me marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi.

Neni 23

Raportimi

1.Përfituesit e subvencioneve dhe granteve, pas përfundimit të projekteve dhe programeve, dorëzojnë raportet narrative dhe financiare tek zyrtaret e autorizuar për monitorim të projekteve, përkatësisht komisioneve përkatëse apo komitetet drejtuese, të përcaktuara në nenin 19 të kësaj Rregulloreje.

2.Raportet narrative vlerësohen dhe kontrollohen nga zyrtari autorizuar për monitorim të projekteve, komisioni i monitorimit apo komitetit drejtues.

2.1.Raporti narrativ duhet të përfshijë: numrin e përfituesve, ndikimin në vazhdimësinë e projektit, të dhënat dhe statistikën për rezultatet e arritura.

2.2.Raporti narrativ së bashku me dokumentacionin shtesë për zbatimin e aktiviteteve i dorëzohet MPMS-së në kopje elektronike dhe të shkruar.

3.Raporti financiar vlerësohet dhe aprovohet nga një komision i themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm.

3.1.Raporti financiar, duhet të përfshijë, shpenzimet e pagesave të realizuara gjatë zbatimit të projektit, të cilat duhet të specifikohen në bazë të kategorive ekonomike të shpenzimeve.

3.2.Raporti i shpenzimeve financiare, duhet të jetë në harmoni me shpenzimet e paraqitura në projektpropozim, i cili mund të variojë deri në 10% të vlerës së përgjithshme të projektit.

3.3.Shpenzimet e prezantuara në raportet financiare, duhen të jenë të dokumentuara me të gjitha dëshmitë mbi realizimin e pagesave gjatë zbatimit të projekteve dhe programeve.

3.4.Çdo shpenzim i realizuar mbi vlerën prej 500 euro, duhet të dëshmohet përmes transferit bankar.

3.5.Pas analizimit dhe vlerësimit të shpenzimeve, bëhet kërkesa për procedimin e pagesës së radhës apo mbyllja e projektit në rastet kur dorëzohet raporti financiar përfundimtar.

Neni 24

Auditimi

1. Auditimi i subvencioneve dhe granteve, të realizuara nga përfituesit, bëhet nga auditimi i brendshëm i MPMS-së.

2. Njësia e auditimit, përgatit raportin me rekomandimet, lidhur me të gjeturat e auditimit.
3. Raportet e auditimit, i dorëzohen përfituesit, kabinetit të MPMS-së dhe institucioneve përkatëse.
4. Auditimi i subvencioneve dhe granteve, mund të bëhet edhe nga auditorët e jashtëm.

Neni 25
Konflikti i interesave

1. Në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, është në lidhje familjare me ndonjërin nga përfituesit e subvencioneve apo granteve, automatikisht përjashtohen nga procedura e vlerësimit dhe shqyrtimit.
2. Të gjitha rastet e tjera të shmangies nga konflikti i interesit, bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 26
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 04/2014 për procedurat e përkrahjes institucionale për aftësim, riaftësim profesional dhe përgatitje për treg të punës.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore, hyn në fuqi shtatë (7) ditë nga data e nënshkrimit të Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Arban Abrashi

Ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Prishtinë, 2015

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 03/2010 PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJOHJEN E TË DREJTAVE NË AFTËSIM, RIAFTËSIM DHE PUNËSIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-19 për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;

Me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të pozitës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës,

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2010 PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJOHJEN E TË DREJTAVE NË AFTËSIM, RIAFTËSIM DHE PUNËSIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes së këtij Udhëzimi Administrativ është vendosja dhe përcaktimi i rregullave dhe procedurave të aplikimit për njohjen e të drejtave në aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në aftësim, riaftësim profesional dhe punësim sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar me Ligjin dhe Legjislacionin tjetër të aplikueshëm;
2. Dispozitat e këtij akti nënligjor, sipas kompetencës, detyrave dhe përgjegjësi, janë të detyruara t'i zbatojnë të gjitha institucionet të cilat sipas fushëveprimit të tyre, përkujdesen për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 3 Përkufizimi

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura, të cilat ndërlidhen me objektin e shqyrtimit dhe rregullimit të Udhëzimit Administrativ, kanë këtë kuptim:

1.1. **“Aftësia e kufizuar”** - është kufizimi i qasjes dhe aktiviteteve të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore;

1.2. **“Personat me aftësi të kufizuara”** - janë ata persona që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërvëprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët;

1.3. **“Aftësimi dhe riaftësimi”** - është ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve në mënyrë të organizuar, nga institucionet përgjegjëse dhe institucionet e tjera, për riedukimin e personit me aftësi të kufizuara, me qëllim të mundësimin për gjetjen e një pune të përshtatshme dhe aftësimin për aktivitete të përditshme të tij;

1.4. **“Aftësimi profesional”** - është proces themelor për ndërtimin dhe përmirësimin e kapaciteteve për të siguruar dhe mbajtur punën kualitative, për t'u avancuar nga një vend pune në

një vend tjetër dhe për ballafaqim me ndryshimet në teknologji dhe kushtet e tregut të punës;

1.5. **“Përshtatshmëria e mjedisit”** - nënkupton masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi të lirë, pa barriera të natyrave të ndryshme;

1.6. **“Mjetet ndihmëse”** - janë ato mjete të cilat i përdorin personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e zakonshme;

1.7. **“Punë e përshtatshme”** - nënkuptohet puna të cilën e kryen personi me aftësi të kufizuara në përputhje me mundësitë e tij fizike, shqisore dhe mendore, si dhe me kualifikimin përkatës të fituar gjatë shkollimit special apo aftësimin dhe riaftësimin profesional;

1.8. **“Qendra për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësim”** - është institucion me cilësi të personit juridik, e cila merret me koordinimin, menaxhimin dhe administrimin e aftësimin, riaftësimin profesional dhe nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara;

1.9. **“Asistenti”** - është personi i domosdoshëm pa të cilin personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aftësohet apo të riaftësohet për punë ose të krijojë marrëdhënie pune;

1.10. **“Punëtorja mbrojtëse”** - është ndërmarrje që themelohet me qëllim të ofrimit të punës dhe të punësimit të përshtatshëm, në vendin dhe hapësirën me pajisje përkatëse për personat me aftësi të kufizuara;

1.11. **“Qendra punuese”** - është vend punishte e specializuar që punëson persona me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të punësohen apo ta mbajnë punën, sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta në punëtorinë mbrojtëse;

1.12. **“Trajneri”** - është personi i certifikuar, i përgatitur dhe i ngarkuar për ofrimin e ndihmës në aftësim dhe riaftësimin profesional për personat me aftësi të kufizuara, në pajtim me kërkesat e vendeve të punës në tregun e hapur të punës;

1.13. **“Kandidati”** - është personi i cili përfshihet në programin e aftësimin profesional;

1.14. **“Certifikata”** - është dokumenti zyrtar, që lëshohet pas përfundimit të programit të aftësimin dhe riaftësimin profesional;

1.15. **“Sistemi Modular”** - nënkupton aftësimin dhe riaftësimin individual;

1.16. **“Kurrikula”** - nënkupton, planin dhe programin mësimor për aftësim dhe riaftësimin profesional;

1.17. **“MPMS-ja”** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.18. **“DPP-ja”** - Departamenti i Punës dhe Punësimit të MPMS-së;

1.19. **“DAP-i”** - Divizioni për Aftësim Profesional;

1.20. **“QAP-et”** - Qendrat e Aftësimin Profesional;

1.21. **“QMAP-të”** - Qendrat Mobile të Aftësimin Profesional;

1.22. **“DP-ja”** - Divizioni i Punësimit;

1.23. **“ZP-të”** - Zyrat e Punësimit.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe kompetencat

1. Departamenti i Punës dhe Punësimit përmes DAP-it dhe DP-së harton politikat e punësimit dhe aftësimeve profesionale dhe mbikëqyr realizimin e tyre.;
2. DAP-i zhvillon politikat për aftësim profesional përmes QAP-ve në harmoni me kërkesat e tregut të punë.
3. Në mbështetje të donatorëve, organizohen aftësimet profesionale për kandidatët e certifikuar në QAP-e, në kompani dhe punëkërkesit e tjerë.
4. Zyrat e Punësimit këshillojnë dhe orientojnë punëkërkesit me aftësi të kufizuara lidhur me profesionet e përshtatshme të cilat zhvillohen në QAP-e.

Neni 5

Procedurat e aplikimit për regjistrimin si të papunë të personave më aftësi të kufizuara

1. Personat me aftësi të kufizuara duhet të lajmërohet për regjistrim dhe evidencë në Zyrat e Punësimit sipas vendbanimit të tyre.
2. Personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aplikojë për evidencë, njëkohësisht në dy apo më tepër Zyra të Punësimit;
3. Për ndërrimin e vendbanimit, në afatin prej tetë (8) ditësh, punëkërkuksi me aftësi të kufizuara duhet të informojë ZP-në.
4. Pas aplikimit në Zyrën e Punësimit personi me aftësi të kufizuara pajiset me kartelë të papunësisë.
5. Personi me aftësi të kufizuara lajmërohet në Zyrat e Punësimit për t'u informuar për mundësitë e punësimit, vendet e lira të punës, këshillimet profesionale, këshillimet për aftësim dhe ndërmjetësim në punësim.

Neni 6

Kushtet dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim dhe evidentim në Zyrat e Punësimit

1. Personi me aftësi të kufizuara për t'u regjistruar si i papunë, duhet të lajmërohet personalisht në Zyrat e Punësimit;
2. Personi me aftësi të kufizuara për t'u regjistruar si i papunë në Zyrën e Punësimit, duhet të ketë këto dokumente:
 - 2.1. letërnjoftimin,
 - 2.2. dëshmi për përgatitjen shkollore, dhe
 - 2.3. dëshmi për aftësimet eventuale të kryera.

Neni 7

Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara në aftësim dhe riaftësim profesional

1. Personi me aftësi të kufizuara i regjistruar në Zyrat e Punësimit, informohet për ofrimin e shërbimeve këshilluese për orientim, aftësim, riaftësim profesional dhe punësim;
2. Personi me aftësi të kufizuara duhet të posedojë dokument (rekomandim) të lëshuar nga QRP-ja me të

cilin aplikon në QAP;

3. QAP-i bën aftësimin dhe riaftësimin e kandidatëve dhe në përfundim të programit të aftësimit ata i nënshtrohen procesit të vlerësimit dhe certifikohen;

4. Kandidatëve u mundësohet vlerësimi i kompetencave paraprake përmes testimit në module veç e veç dhe testit përfundimtar që i paraprinë certifikimit.

Neni 8

Prioritetet për personat me aftësi të kufizuara

1. Personi me aftësi të kufizuara hyn në grupin e personave me prioritet për aftësim, riaftësim dhe punësim;

2. Personit me aftësi të kufizuara i jepet prioritet në listat e pritjes për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim;

2.1. Personit me aftësi të kufizuara i jepet **prioritet në këshillim**, nga këshilltari pranë Zyrave të Punësimit për orientimin në karrierë dhe trajnim.

Neni 9

Aktivitetet për aftësimin dhe riaftësimin për punë

1. Aftësimi dhe riaftësimi profesional i personave me aftësi të kufizuara përfshin këto aktivitete:

1.1. Vlerësimin e mundësisë për aftësimin, riaftësimin dhe hartimin e programeve për aftësim dhe riaftësim;

1.2. Aftësimin profesional, kualifikimin plotësues, rikualifikimin me programet e përsosjes dhe mirëmbajtjes së shkathtësive të punës dhe atyre sociale, në periudhën derisa të punësohet;

1.3. Informimin dhe këshillimin me procese teknologjike gjatë aftësimit profesional për punësim;

1.4. Programet vetanake dhe të përbashkëta për avancimin e punës sociale dhe integrimin në shoqëri;

1.5. Mësimin profesional, planifikimin dhe aplikimin e teknologjisë së zgjedhur;

1.6. Propozimet këshillëdhënëse mbi aplikimin e teknikave dhe teknologjive të ndryshme në mësim dhe në punë, krahas vlerësimit të mundësive për zbatimin e tyre.

Neni 10

Kohëzgjatja e aftësimit profesional dhe riaftësimit

1. Kohëzgjatja e aftësimit dhe riaftësimit profesional varësisht nga aftësimi mund të jetë prej 3 muaj deri në 6 muaj;

2. Aftësimi dhe riaftësimi profesional mund të zhvillohen edhe në kohëzgjatje deri në 2 javë, varësisht nga aftësitë punuese të personit me aftësi të kufizuara.

Neni 11

Angazhimi individual në procesin e aftësimit profesional

1. Personi me aftësi të kufizuara, në mënyrë të mëvetëshme mund të kontribuojë në aftësimin dhe riaftësimin e tij profesional, në rastet kur:

1.1. Përkujdeset për shkollimin dhe aftësimin profesional, varësisht nga mundësitë e ofruara, aftësitë dhe shkathtësitë;

1.2. Respekton disiplinën teknologjike gjatë aftësimit dhe punës profesionale;

1.3. Bashkëpunon në çështjen e aftësimit dhe punës profesionale me punëtorin social, mjekun, defektologun, psikologun, teknologun, juristin dhe drejtëpërsëdrejti me punëtorin e varur.

Neni 12

Angazhimi në procesin e punësimit

1. Personi me aftësi të kufizuara, mund të kontribuojë në punësimin e tij, në rastet kur;

1.1. Aplikon në konkursin publik për punësim për vendet e lira dhe të përshtatshme të punës, për të cilat i plotëson kushtet e parapara;

1.2. Pranon punën e ofruar dhe ka gatishmëri për kryerjen e punës së tillë;

1.3. Miraton ofertën e arsyeshme, të ofruar nga punëdhënësi për ndërrimin e punës, respektivisht caktimit në punët e tjera adekuate për shkak të ndërprerjes së nevojave ose pamundësisë së kryerjes së punëve që ka kryer deri atëherë;

1.4. Aftësohet profesionalisht gjatë punës, sipas nevojës edhe me kualifikim plotësues ose me rikualifikim, me qëllim të mbajtjes së vendit të punës.

Neni 13

Punësimi në tregun e hapur të punës

1. Organet shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat joqeveritare, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, obligohen që me kushtet e përshtatshme të punës t'i punësojnë personat me aftësi të kufizuara;

2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë.

Neni 14

Masat lehtësuese për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara

Punëdhënësi i cili punëson persona me aftësi të kufizuara ka edhe benificione të tjera të përcaktuara me legjislacionin e aplikueshëm. Të drejtën për lehtësime doganore dhe tatimore e realizojnë sipas ligjeve tatimore dhe doganore në fuqi.

Neni 15

Politikat rreth aftësimit profesional

1. Politikat lidhur me aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, përfshijnë:

1.1. Aftësimin dhe riaftësimin profesional për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;

1.2. Zbatimin e parimit, mënyrës së veprimit dhe metodave të aftësimit profesional ndaj personit me aftësi të kufizuara, varësisht sa lejojnë aftësitë e tij;

1.3. Planprogramet mësimore sipas sistemit modular që mundësojnë aftësimin individual për personat me aftësi të kufizuara;

1.4. Aftësimet e përbashkëta të personave me aftësi të kufizuara me të tjerët, në hapësira të njëjta dhe trajner të njëjtë, me qëllim të integritit të tyre në shoqëri.

Neni 16
Inicimi për ndryshim dhe plotësim

Ky Udhëzim Administrativ mund të ndryshohet dhe plotësohet me kërkesën e DPP-së dhe strukturave tjera kompetente të MPMS-së.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nenad Rašič

Ministri i MPMS-së

Prishtinë, Shkurt 2010

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 09/2010
PËR
PËRCAKTIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË PËRPTHJE ME AFTËSITË E TYRE TË PUNËS

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.3.pika (d) të Rregullorës 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Me qëllim të zbatimit të drejtë dhe të plotë të Ligjit Nr. 03/L-19 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/2010
PËR
PËRCAKTIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË PËRPTHJE ME AFTËSITË E TYRE TË PUNËS

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes së këtij Udhëzimi Administrativ, është përcaktimi i vendit të punës, hapësirës dhe kushteve të përshtatshme për punë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me aftësitë e tyre të punës.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Më këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet rregullimi i punësimit të personave me aftësi të kufizuara në kushte dhe hapësira të përshtatshme të punës në organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit publik dhe privat, organizatat joqeveritare, si dhe në subjektet e tjera ekonomike.

Neni 3
Përkufizimet

1. **“Aftësi e kufizuar”**- është kufizimi i qasjes dhe aktivitetit të zakonshëm në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor ose mendor, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore.
2. **“Personat me aftësi të kufizuara”** - janë ata persona që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta me të tjerët.
3. **“Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara si pasojë e dëmtimit** - janë invalidët e luftës, invalidët civil të luftës, invalidët e punës, personat e lindur me të meta fizike, shqisore apo mendore dhe personat të cilët për shkak të fatkeqësisë apo sëmundjes kanë të meta fizike, mendore apo shqisore.
4. **”Komisioni profesional”** - është ekipi i përbërë prej ekspertëve mjekësor dhe lëmvive të tjera i themeluar nga autoriteti përkatës, me qëllim të konstatimit dhe vlerësimit të shkallës së aftësisë së kufizuar të një personi.
5. **“Përshtatshmëria e mjedisit”** - nënkupton masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi të përshtatshëm, pa barriera të natyrave të ndryshme.

6. **“Mjetet ndihmëse”** - janë ato mjete të cilat i përdorin personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të zakonshme.
7. **“Punë e përshtatshme”** - nënkupton punën të cilën e kryen personi me aftësi të kufizuara, në përputhje me mundësitë e tij fizike, shqisore dhe mendore, si dhe me kualifikimin përkatës të fituar gjatë shkollimit special, apo aftësimit dhe riaftësimit profesional.
8. **“Vendi i punës”** - është hapësira apo mjedisi për punë në të cilën personi me aftësi të kufizuara kryen punë të përcaktuara në procesin e punës të punëdhënësi, vetëm apo bashkërisht me të punësuarit e tjerë.
9. **“Punëtorja mbrojtëse”** - është ndërmarrje që themelohet me qëllim të ofrimit të punës dhe punësimit të përshtatshëm, në vendin dhe hapësirën me pajisje përkatëse për personat me aftësi të kufizuara.
10. **“MPMS-ja”** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
11. **“DPP-ja”** - Departamenti i Punës dhe Punësimit të MPMS-së.
12. **“DP”** - Divizioni i Punësimit.
13. **“ZP”** - Zyrat e Punësimit.

Neni 4

Kushtet dhe kriteret për klasifikimin e vendeve të punës

1. Personi me aftësi të kufizuara i cili është i regjistruar në ZP-ë ka të drejtë në punësim, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe akteve tjera nënligjore.
2. Varësisht nga shkalla dhe kategoria e aftësisë së kufizuar, rregullohet dhe përcaktohet vendi i punës dhe punët e përshtatshme për personin me aftësi të kufizuara.
3. Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në punësim, integrim në tregun e punës në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me ligj.
4. Punësimi në kushte të veçanta konsiderohet edhe vetëpunësimi, si dhe punësimi në ekonominë familjare të personit me aftësi të kufizuara.
5. Me kushtet e përgjithshme të punësimit, nënkuptohet punësimi i personit me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës.

Neni 5

Përshtatshmëria e vendit të punës

1. Përshtatshmëria e vendit të punës për personin me aftësi të kufizuara duhet të bëhet duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të përcaktuara nga punëdhënësi në procesin e punës.
2. Përshtatshmëria e vendit të punës bëhet duke i pajisur hapësirat e vendit të punës me pajisje teknike dhe teknologjike, për të krijuar ambient të sigurt dhe të shëndetshëm për personin me aftësi të kufizuara.

Neni 6

Caktimi i vendit dhe hapësirës për punë

1. Vendi në të cilin punësohet personi me aftësi të kufizuara duhet të jetë i përshtatshëm, në mënyrë që ai të kryejë punën i pavarur.

2. Vendi i punës i personit me aftësi të kufizuara duhet të jetë i sigurtë dhe i mbrojtur në mënyrë që të mos jetë i rrezikuar shëndeti i personit me aftësi të kufizuara.
3. Personi me aftësi të kufizuara mund të punësohet edhe në punë të tjera të cilat i përshtaten atij, varësisht nga vendi i punës dhe qasja.
4. Punëdhënësi me akt të brendshëm përcakton vendin dhe përshtatshmërinë e punës për personin me aftësi të kufizuara.

Neni 7

Lehtësirat në kryerjen e detyrave të punës

1. Personit me aftësi të kufizuara mund t'i lejohet kryerja e detyrave të punës edhe nga shtëpia, sipas marrëveshjes me punëdhënësin.
2. Në vendin e punës për personin me aftësi të kufizuara varësisht nga nevojat e personit, mund të sigurohet mbështetje përmes ndihmës profesionale apo asistencës gjatë realizimit të detyrave të punës.

Neni 8

Përparësitë në vendin e punës

1. Gjatë identifikimit të vendeve të lira të punës, punëdhënësi duhet t'i japë prioritet përshtatjes së vendit të punës dhe krijimin e mundësive për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
2. Në vendet e punës të klasifikuara për persona me aftësi të kufizuara duhet të kenë përparësi personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë përqindje më të lartë të aftësive të kufizuara apo dëmtime më të mëdha fizike në raport me personat e tjerë.
3. Personi me aftësi të kufizuara mund të punësohet për një vend pune përmes ZP-së, nëse i plotëson kushtet e parapara për vendin e caktuar të punës sipas kërkesës së punëdhënësit.
4. Vendi i punës i cili i përshtatet personit me aftësi të kufizuara, publikohet përmes konkursit publik.

Neni 9

Punësimi i personit me aftësi të kufizuara

1. Punësimi i personit me aftësi të kufizuara bëhet varësisht nga aftësitë e tij për punë, të vërtetuara nga ana e komisionit profesional.
2. Personi me aftësi të kufizuara duhet t'i plotësojë kushtet dhe shkathtësitë e parapara për vendin e caktuar të punës.
3. Personi me aftësi të kufizuara nuk duhet të vihet para një situatë të vështirë dhe diskriminuese duke i favorizuar personat e tjerë në raport me personin i cili ka aftësi të kufizuara.
4. Personi me aftësi të kufizuara mund të punojë natën, jashtë orarit të punës ose me orar të ndryshuar, në përputhje me vlerësimin e komisionit profesional, i cili ia ka përcaktuar aftësinë e zvogëluar të punës.

Neni 10

Të drejtat e personit me aftësi të kufizuara nga marrëdhënia e punës

1. Personi me aftësi të kufizuara i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit në fuqi dhe akteve tjera nënligjore.

2. Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në pagë për punën e kryer, ashtu siç e kanë pagën personat të cilët e bëjnë të njëjtën punë, si dhe gëzon të gjitha të drejtat dhe beneficionet nga marrdhënia e punës.

3. Bartësi i sigurimit të personit me aftësi të kufizuara arrin marrëveshje me punëtorin rreth kushteve të punës, sigurisë në punë, orarit të punës, kohëzgjatjes së punës, mbikëqyrjes profesionale, mbulimit të shpenzimeve të përshtatjes dhe lartësisë së atyre shpenzimeve, si dhe për çështje të tjera nga marrëdhënia e punës.

Neni 11

Inicimi për ndryshim dhe plotësim

Ky Udhëzim Administrativ mund të ndryshohet dhe plotësohet me kërkesën e DPP-së dhe strukturave të tjera kompetente të MPMS-së.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministri i MPMS-së

Nenad Rashiq

Prishtinë, Gusht 2010

UDHËZIMI ADMINISTRATIV
NR. 09/2012
PËR MËNYRAT DHE RREGULLAT E MBAJTJES SË EVIDENCËS PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të nenit 93 (4), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 10, të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (22.03.2011) dhe të Nenit 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë;

Duke pasur parasysh nenin 16 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-019, për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV
NR. 09/2012
PËR MËNYRAT DHE RREGULLAT E MBAJTJES SË EVIDENCËS PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i nxjerrjes së këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi dhe përcaktimi i mënyrës, procedurave dhe kushteve për mbajtjen e evidencës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara të përcaktuara në Ligjin për Aftësimin Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Neni 2
Fushat e zbatimit

1. Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për:

1.1. Regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuarve të personave me aftësi të kufizuara në Zyrat e Punësimit

1.2. Regjistrimin dhe evidencën e të punësuarve me aftësi të kufizuara me ndërmjetësimin e Zyrës së Punësimit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet të cilat përdoren në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

1.1. **“Aftësi e kufizuar”**- është kufizimi i qasjes dhe aktivitetit të zakonshëm në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor ose mendor, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore;

1.2. **“Personat me aftësi të kufizuara”** – janë ata persona që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta me të tjerët;

1.3. **“Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara si pasojë e dëmtimit** – janë invalidët e luftës, invalidët civil të luftës, invalidët e punës, personat e lindur me të meta fizike, shqisore apo mendore dhe personat të cilët për shkak të fatkeqësisë apo sëmundjes kanë të meta fizike, mendore apo shqisore;

1.4. **“Komisioni profesional”** – është ekipi i përbërë prej ekspertëve mjekësor dhe lëmive të tjera, i themeluar nga autoriteti përkatës me qëllim të konstatimit dhe vlerësimit të shkallës së aftësisë së kufizuar të një personi;

1.5. **“Përshtatshmëria e mjedisit”** – nënkupton masat e ndërmarra me qëllim të sigurimit të një mjedisi të përshtatshëm, pa barriera të natyrave të ndryshme;

1.6. **Kartela e të papunësuarit** – është një dokument zyrtar i Zyrës së Punësimit përmes së cilës vërtetohet regjistrimi i një personi si i papunësuar përkatësisht punëkërkues në Zyrën përkatëse të punësimit;

1.7. **Aftësimi dhe riaftësimi profesional** – është një aktivitet që synon të sigurojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime të nevojshme për performancë efikase brenda një profesioni apo një grupi profesionesh;

1.8. **“MPMS-ja”** – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

1.9. **“DPP-ja”** – Departamenti i Punës dhe Punësimit të MPMS-së.

1.10. **“DP”** – Divizioni i Punësimit.

1.11. **“ZP”** – Zyrat e Punësimit.

Neni 4

Mbajtja e Evidencës për Persona me Aftësi të Kufizuara

1. Zyrat e Punësimit e udhëheqin evidencën për të papunësuarit dhe punëkërkuesit me aftësi të kufizuara, sipas vendbanimit të këtyre personave dhe sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Zyrat e Punësimit mbajnë, udhëheqin evidencën për të papunësuarit dhe punëkërkuesit me aftësi të kufizuara të cilët janë ndërmjetësuar ne punësim përmes Zyrave të Punësimit.

3. Zyrat e Punësimit udhëheqin edhe evidencën ne bazë të dhënave të grumbulluara nga punëdhënësit të cilët kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Obligimet e Zyrave të Punësimit

1. Zyrat e Punësimit janë të obliguara të mbajnë regjistrimin dhe evidencën për numrin e të punësuarve dhe punëkërkuesve të personave me aftësi të kufizuara, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Zyrat e Punësimit janë të obliguara të mbajnë të dhënat në evidencë për numrin e:

2.1. punëdhënësve që kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara;

2.2. të punësuarve me aftësi të kufizuara;

2.3. punëkërkuesve që janë persona me aftësi të kufizuara.

3. Zyrat e Punësimit janë të obliguara që gjatë regjistrimit të mbajnë evidencën, varësisht nga shkalla dhe kategoria e aftësisë së kufizuar dhe gjinisë për personat me aftësi të kufizuara.

4. Zyrat e Punësimit janë të obliguara që në bazë të të dhënave të grumbulluara nga punëdhënësit për nevojat e punësimit, të njoftojnë të papunësuarin dhe punëkërkuuesin në cilësinë e personit me aftësi të kufizuara mbi mundësitë dhe kushtet për punësim.

Neni 6

Dorëzimi i të dhënave në Zyrat e Punësimit

1. Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare të cilët kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, janë të obliguar që në Zyrat e Punësimit të dorëzojnë këto të dhëna:

1.1. Emrin dhe mbiemrin e personit me aftësi të kufizuara, si dhe adresën e vendbanimit;

1.2. Datën e themelimit të marrëdhënies së punës të personit me aftësi të kufizuara;

1.3. Përgatitjen shkollore për personin e punësuar me aftësi të kufizuara;

1.4. Vendin e punës në të cilin është i angazhuar personi me aftësi të kufizuara;

1.5. Datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për personin me aftësi të kufizuara dhe arsyeja për ndërprerjen e punës.

2. Afati i dorëzimit të këtyre shënimeve nga punëdhënësi sipas paragrafit 1, të këtij neni për të punësuarit me aftësi të kufizuara që janë në marrëdhënie pune, është gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e fillimit të punës te punëdhënësi.

3. Për të punësuarit që iu ndërpritet marrëdhënia e punës për personat me aftësi të kufizuara, afati për lajmërim në zyrën e punësimit është tridhjetë (30) ditë nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Neni 7

Evidenca për punëdhënësit

1. Evidencat për punëdhënësit të cilët shfrytëzojnë shërbimet e Zyrave të Punësimit, udhëhiqen në bazë të paraqitjes së kërkesave të tyre lidhur me nevojat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Evidenca mbahet në kartelë të veçantë të punëdhënësit. Kartela përmban të dhëna për:

2.1. emrin dhe selinë e punëdhënësit;

2.2. shifrën dhe llojin e veprimtarisë;

2.3. numrin e të punësuarve sipas llojit të aftësisë së kufizuar, shkallës së paaftësisë të personit me aftësi të kufizuara, sipas gjinisë;

2.4. lartësinë e pagës mujore bruto për personin me aftësi të kufizuara;

2.5. nevojat për punësim dhe llojin e shërbimeve, të cilat punëdhënësi dëshiron ti shfrytëzojë në Zyrat e Punësimit.

Neni 8

Evidentimi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

1. Evidenca e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Zyrat e Punësimit udhëhiqet duke evidentuar:

- 1.1. Emrin, mbiemrin dhe emrin e njërit prind të personit me aftësi të kufizuara;
- 1.2. data dhe vendi i lindjes së personit me aftësi të kufizuara;
- 1.3. vendbanimi i personit me aftësi të kufizuara;
- 1.4. përgatitja shkollore dhe profesioni i personit me aftësi të kufizuara;
- 1.5. punët të cilat i kryen i punësuari me aftësi të kufizuara;
- 1.6. data e punësimit dhe data e përfundimit të punësimit për personin me aftësi të kufizuara;
- 1.7. orarin e punës për personin me aftësi të kufizuara;
- 1.8. shkalla dhe kategorizimi i aftësisë së kufizuar për personin me aftësi të kufizuara.

Neni 9

Informimi i personave me aftësi të kufizuara

1. I papunësuar dhe punëkërkuesi lajmërohen në Zyrat e Punësimit për t'u informuar për mundësitë e këshillimit profesional, vendet e lira të punës dhe ndërmjetësimin në punësim,
2. Personi me aftësi të kufizuara i cili është i regjistruar në Zyrat e Punësimit ka të drejtë në punësim, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 10

Inicimi për ndryshim dhe plotësim të Udhëzimit Administrativ

Ky Udhëzim Administrativ mund të ndryshohet dhe plotësohet me kërkesën e Departamentit Ligjor dhe strukturave tjera kompetente të MPMS-së, apo me rekomandimin e kabinetit të Ministrit të MPMS-së.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministri i MPMS-së

Nenad Rashiq

Prishtinë, 2012

LIGJI Nr. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR PERSONAT E VERBËR

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë ligj rregullohet statusi ligjor i personave të verbër në Republikën e Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbërve.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **I/E verbër** - personi me humbje të plotë të pamurit të lindur ose të fituar të përcaktuar sipas kriterëve mjekësore të vlerësuara nga Komisioni Mediko-social;

1.2. **Komisioni Mediko-social** - komision i përbërë prej ekspertëve mjekësor dhe social, i formuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili bën përcaktimin e shkallës së verbërisë, duke përfshirë kohëzgjatjen e saj, për secilin person që paraqet kërkesë për të gëzuar kompensim për shkak të verbërisë, përfitimet dhe të drejtat sipas këtij ligji;

1.3. **Ministria përkatëse** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.4. **ZQM** - Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

**Neni 4
Mbrojtja**

1. Personat e verbër mbrohen nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. Kur veprimet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni përbejnë vepër penale, nismën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e kanë dhe organet e rendit organi i prokurorisë apo shoqata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose kujdesen për ta.

**Neni 5
Punësimi**

1. Me këtë ligj përfitojnë të gjithë personat e verbër, të cilët me vendim të Komisionit Mediko – social plotësojnë kriteret e caktuara - kjo nënkupton sigurimin e pjesëmarrjes së tyre aktive, duke ju plotësuar kushtet e mëposhtme:

1.1. punësimi në kushte të favorshme dhe me përparësi, sipas ligjeve në fuqi dhe kriterëve të veçanta të përcaktuara në ligje të posaçme.

1.2. personat juridik dhe fizikë që punësojnë persona të verbër përfitojnë të gjitha beneficionet të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.

Neni 6 Lirimi nga taksat dhe tatimi

Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë. Në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi.

Neni 7 Të ardhurat dhe beneficionet

1. Personat e verbër gëzojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet sipas ligjeve në fuqi.
2. Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) Euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria.
3. Përfituesit material për shkak të verbërisë, sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë kompensim nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është përcaktuar me ligj.
4. Përfitim material për shkak të verbërisë e marrin personat, pavarësisht nga mosha dhe në të njëjtën masë përfitojnë edhe shoqëruesit e të verbërve të grupit të parë, nevoja për të cilët përcaktohet nga Komisioni Mediko-social.
5. E drejta në përfitim material të verbërisë për personat e verbër, si dhe shoqëruesit e tyre, sipas këtij ligji, realizohet nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet dhe kriteret për realizimin e tyre.
6. Personat e verbër nënshkruajnë kontratë me shoqëruesit e tyre, para organit kompetent të qendrës për punë sociale dhe ia paraqesin nëpunësit të organit kompetent.
7. Këto pagesa bëhen çdo muaj nga Departamenti i Administratës Pensionale në kuadër të Ministrisë përkatëse.
8. Fondet për pagesa, nga paragrafi 1. i këtij neni, sigurohen nga buxheti i përgjithshëm i Ministrisë përkatëse.

KREU II KUJDESI, SIGURIMI I VENDSTREHIMIT, SIGURIMI SHËNDETËSOR, ARSIMIMI, PUSHIMI DHE MIRËSITË E TJERA

Neni 8 Strehimi

Të verbrit që plotësojnë kushtet ligjore për t'u konsideruar si qytetarë me nevojë për strehim, në përfundim të vlerësimit të nevojës së tyre, përfitojnë një shtesë prej njëzet (20) pikash, mbi masën e vlerësuar.

Neni 9 Kujdesi shëndetësor

1. Shërbimet shëndetësore themelore ofrohen në cilësi dhe sasi të njëjtë si për të gjithë qytetarët.

2. Përrjashtimi nga pagesat dhe bashkë-pagesat rregullohet sipas Ligjit për shëndetësi dhe me akte tjera nënligjore.

3. Shërbimet mjekësore të cilat ju ofrohen personave të verbër, të cilët nuk paguajnë premiumet do të rimbursohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi për Sigurime Shëndetësore.

Neni 10 Edukimi dhe Arsimimi

1. Edukimi dhe arsimimi i personave të verbërve, në institucionet publike bëhet sipas ligjeve në fuqi.

2. Personave të verbër ju sigurohet përdorimi i shkrimit brail, shkrimit relievor, shkrimit me shkronja të zmadhuara dhe tekstet në teknikën akustike dhe digjitale nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

3. Pajisjet tiflo-teknike dhe tiflo-didaktike të cilat lehtësojnë integrimin e personave të verbër në shoqëri janë mjete ndihmëse për të cilat obligohet MPMS, MASHT dhe Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës për sigurimin dhe shpërndarjen e tyre.

Neni 11 Qasja në informacion

1. Personave të verbër u mundësohet informimi në brail, në reliev, shkrim të zmadhuar, si dhe në audio për të gjithë sinjalistikën në ambientet publike informacionet publike zyrtare, literaturën tekstet, dhe librat në të gjitha nivelet shkollore në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.

2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës dhe Ministria e infrastrukturës janë përgjegjëse për zbatimin e paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 12 Rehabilitimi

1. Qeveria përcakton fonde për ndërtimin e qendrave të rehabilitimit, me kapacitet të mjaftueshëm për personat e verbër.

2. Administrimi i qendrave të rehabilitimit, bëhet me autorizimin e Ministrisë përkatëse në bashkëpunim me Shoqatën për Personat e Verbër të Kosovës.

3. Qeveria, në funksion të rehabilitimit dhe argëtimit të të verbërve, përkrah veprimtarinë kulturore të tyre dhe u siguron falas, pjesëmarrjen në këto manifestime kulturore dhe sportive.

Neni 13 Udhëtimi

1. Personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre gjatë shoqërimit të personit të verbër, gëzojnë beneficione në pagesa, në trafikun urban falas, ndërsa në ndërrurban bëhet me pagesën pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së biletës.

2. Operatorët privat dhe publik duhet të përcaktojnë vendet për të verbrit dhe të vendosin sinjale përkatëse. Këto vende janë të liruara nga detyrimi fiskal të përcaktuar me udhëzim nga MT dhe Ministria e Infrastrukturës.

Neni 14 Shpenzimet e energjisë elektrike dhe telefonit

1. Të gjithë personat e verbër, gëzojnë lehtësira në konsumin e energjisë elektrike sipas Ligjit të Skemës Sociale.

2. Qeveria siguron që të gjithë të verbrit të grupit të parë, të pajisen me softuer folës asistues për të verbëritë.

Neni 15 Përfitimet dhe të drejtat tjera

1. Institucionet përgjegjëse për miratimin e projekteve të infrastrukturës dhe rregullimin e territorit, nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët dhe mjediset publike, në qoftë se në to nuk janë marrë parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme për persona të verbër.

2. Personat e verbër në shërbime publike kanë përparësi në zgjidhjen e kërkesave. Sipas nevojës ata duhet të tregojnë librezën që dëshmon statusin e tyre.

Neni 16 Besueshmëria e informatave personale

Institucionet dhe personat përgjegjës nuk kanë të drejtë të japin të dhëna për gjendjen verbërisë të një personi, pa pëlqimin e tij, përveç kur kjo lejohet me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III GRUPIMET, PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT, EVIDENCA DHE KOMISIONI MEDIKO-SOCIAL

Neni 17 Komisioni Mediko-social, kompetencat e tij dhe kategorizimi

1. Komisioni Mediko-social përbëhet nga tre (3) ekspertë okulistë, një ekspert tiflolog, një (1) ekspert në fushën e punës sociale, një (1) përfaqësues i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, si dhe një (1) përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili është kryetar i komisionit.

2. Mandati i ekspertëve është një (1) vit pa të drejtë rizgjedhjeje. Funksionimi i komisionit Mediko-social bëhet sipas rregullores së miratuar nga ministria përkatëse.

3. Personat e verbër, përfitues nga ky ligj i nënshtrohen vlerësimit të komisionit Mediko-social në ministrinë dhe rajonet përkatëse.

4. Komisioni Mediko-social për personin e verbër lëshon vendim, duke përcaktuar grupin e verbërisë, si dhe nevojat sociale.

5. Komisioni shqyrton kërkesën e personit të verbër, për të përcaktuar shkallën e verbërisë dhe nevojave sociale.

6. Përfituesit nga ky ligj kategorizohen në dy grupe:

6.1. grupi i parë janë personat që nuk e dallojnë dritën nga errësira, deri në qartësinë e të parit 0.02.

6.2. grupi i dytë janë personat që kanë humbje pjesërisht të shikimit, mbi 0.02 deri 0.05.

7. Personi i verbër, i grupit të parë, duhet të deklarojë emrin e shoqëruesit të tij/saj, para organit kompetent që e regjistron atë në një regjistr të posaçëm. Po ashtu, ai duhet të deklarojë edhe ndërrimin eventual të shoqëruesit, nëse e vlerëson të arsyeshme se një ndërrim i tillë duhet të bëhet. Me këtë ndërrim, menjëherë njoftohet edhe administrata e ministrisë përkatëse.

8. Shoqatat bazuar në vendimin e Komisionit Mediko-social lëshon librezën e posaçme të verbërisë, si dokument, provë për përfitim nga ky ligj.

Neni 18 Evidentimi

1. Institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe komunal, duhet të mbajnë evidencën e saktë dhe të formatizuar të numrit të përfituesve të të dy kategorive.

2. Në fund të vitit kalendarik, por edhe sipas kërkesës së ministrisë përkatëse, Shoqata e të Verbërve të Kosovës obligohet të dorëzojë regjistrin e evidencave të librezave të lëshuara për përfituesit nga ky ligj.

Neni 19 E drejta për ankim

Paditë e ngritura në gjykatën kompetente për moszbatimin e këtij ligji shqyrtohen me procedurë të përsheptuar.

Neni 20

Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës dhe beneficionet e përcaktuara me këtë ligj.

KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21 Bashkëpunimi

1. Për zbatimin e këtij ligji, dhe pa mohuar të drejtat e individëve ose grupeve të tjera, Shoqatës së të Verbërve të Kosovës i njihet e drejta e përfaqësimit të të verbërve dhe fitimit të shërbimeve të posaçme, në varësi të plotësimit të kushteve të mëposhtme:

1.1. ushtrimit të veprimtarisë në të gjithë territorin e Kosovës mbi bazën e një statusi demokratik, të njohur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.2. nënshkrimit të kontratave me ministritë dhe institucionet që financojnë ofrimin e këtyre shërbimeve;

1.3. nënshtrimin ndaj kontrolleve të institucioneve publike për cilësinë e shërbimeve, përdorimin e fondeve, dhe respektimin e statutit të organizatës.

Neni 22 Aktet nënligjore

Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muajsh Qeveria e Kosovës dhe ministritë përkatëse nxjerrin aktet nënligjore.

Neni 23 Dispozitat ndëshkimore

1. Çdo institucion i cili nuk i respekton dispozitat e këtij ligji ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi.

2. Çdo person i cili me vetëdije paraqet deklaratë të rreme ose prezanton dokumentet e falsifikuara me qëllim të përfitimit të drejtave dhe beneficioneve të përcaktuara sipas këtij ligji, ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 24 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet çdo dispozitë tjetër e aktit ligjor ose nënligjor, e cila është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 25 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa do të zbatohet nga 01 janari 2013.

**Ligji Nr. 04/L - 092
14 qershor 2012**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-032-2012, datë 02.07.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**

RREGULLORE (MPMS) NR. 02/2013
PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT MEDIKO-SOCIAL DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR
REALIZIMIN E TË DREJTAVE PËR PERSONAT E VERBËR

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër (Gazeta Zyrtare Nr.20. 18.07.2012), nenit 8 paragrafit 1.4. të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/18 Prill 2011), si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, dt. 12.09.2011),

Nxjerr:

RREGULLORE (MPMS) NR. 02/2013
PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT MEDIKO-SOCIAL DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR
REALIZIMIN E TË DREJTAVE PËR PERSONAT E VERBËR

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore, ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisë të Komisionit Mediko-Social, për vlerësimin e shkallës së verbërisë dhe vlerësimin e nevojave sociale për personat e verbër, si dhe përcaktimin e procedurave të aplikimit për realizimin e të drejtave të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-092 për personat e verbër.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore, i dedikohet të gjithë personave të verbër, pa limit moshe, të cilët sipas Komisionit Mediko-Sociale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj Rregulloreje, vlerësohen si persona të verbër.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë këtë kuptim:

1.1. DP – Departamenti i Pensioneve i MPMS-së

1.2. Shoqata e të Verbërve të Kosovës, - është organizatë përfaqësuese e të verbërve, e cila ofron shërbime për të verbrit, sipas nenit 21 të Ligjit për të Verbrit;

1.3. Nevojat sociale – nënkupton krijimin e kushteve dhe mundësive të personave të verbër, me qëllim të integritetit sa më të mirë të tyre në shoqëri dhe jetë të pavarur;

1.4. Komisioni konziliar – është komisioni në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – Klinika e Syve në Prishtinë, i cili përbëhet nga tre specialistë të oftalmologjisë, të cilët japin mendimin për shkallën e verbërisë, kurse vlerësimin për shkallën e verbërisë përkatësisht grupin, vendos Komisioni Mediko-Social i emëruar nga MPMS-ja.

1.5. Mjetet tiftoteknike, - janë mjetet ndihmëse të cilat e lehtësojnë personin e verbër, për t'u pavarësuar në jetë.

Neni 4
Funksionet e Komisionit Mediko-Social

1. Komisioni Mediko-Social, ka këto funksione:

1.1. Ekzaminimin e aplikuesit;

1.2. Vlerësimin e shkallës së të pamurit, e cila behet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga QKUK-ja, Klinika e Oftalmologjisë të aplikuesit dhe ekzaminimin objektiv nga ana e Komisionit Mediko-Social.

1.3. Përcaktimin e grupit të verbërisë;

1.4. Vendosjen për caktimin e shoqëruesit për personin e verbër të kategorisë së parë;

1.5. Përcaktimin e mjeteve ndihmese tifloteknike për orientim dhe lëvizje;

1.6. Përcaktimin e nevojës për edukim dhe arsimin;

1.7. Përcaktimin e nevojës për rehabilitim;

1.8. Përcaktimin e nevojës për aftësim dhe riaftësim profesional;

1.9. Përcaktimin e nevojës për punësim.

Neni 5

Përbërja e Komisionit Mediko-Social

1. Komisioni Mediko-Social, përbëhet nga:

1.1. Një specialist i mjekësisë së punës, përkatësisht përfaqësues i MPMS-së; njëkohësisht edhe kryetar i komisionit sipas ligjit.

1.2. Një oftalmolog

1.3. Një tiflolog;

1.4. Një ekspert i fushës së punëve sociale;

1.5. Një përfaqësues i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit Mediko-Social, bëhet sipas propozimit të udhëheqësit të Zyrës së Komisioneve Mjekësore me aprovim të Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së.

3. Puna e Komisionit Mediko-Social, organizohet dhe menaxhohet nga Zyra e Komisionit Mjekësor, sipas Udhëzimit Administrativ nr.01/2009 për Themelimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrës së Komisioneve Mjekësore.

Neni 6

Kushtet dhe kriteret për njohjen e statusit të personit të verbër

1. Personi që konsiderohet se ka probleme serioze me të pamurit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për përcaktimin e shkallës së verbërisë dhe nevojës sociale, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara, si në vijim:

1.1. Të jetë qytetar i Republikës së Kosovës.

1.2. Përveç dokumentacionit mjekësor, aplikacionit duhet të bashkëngjisë edhe mendimin konziliar

të QKUK-së, përkatësisht të Klinikës së Syve në Prishtinë.

2. Përveç, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, aplikuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

- 1.1. Formularin e plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi;
- 1.2. Kopjen e letërnjoftimit;
- 1.3. Certifikatën e lindjes;
- 1.4. Certifikatën e vendbanimit;
- 1.5. Aktvendimin për kujdestari për fëmijët aplikues pa përfaqësues ligjor; dhe
- 1.6. Dokumente tjera shtesë të cilat mund të përdorën si argumente.

3. Pas vlerësimit të Komisionit Mediko-Social, kur personi i verbër i plotëson kushtet dhe kriteret për përfitim material për shkak të verbërisë do i hapet xhirologaria nga MPMS-ja, po ashtu xhirologaria do i hapet edhe shoqëruesit të të verbërit.

Neni 7 Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për njohjen e statusit të personit të verbër, bëhet në formë të shkruar, duke plotësuar formularët e përcaktuar nga organi i MPMS-së.
2. Formulari në formë të kërkesës dhe dokumentet e tjera të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, pranohen nga zyrat e pensioneve të MPMS-së, sipas vendbanimit të aplikuesit.
3. Formulari në formë të kërkesës dhe dokumentet e tjera të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, pranohet nga zyrat e pensioneve, varësisht nga vendbanimi i aplikuesit.
4. Zyrtari përgjegjës i pensioneve, pas procedurës së verifikimit dhe kompletimit, i lëshon aplikuesit fletë-dëshmi, që ka dorëzuar aplikacionin.
5. Formularit të plotësuar, i bashkëngjiten dokumentet përkatëse, të cilat dorëzohen për shqyrtim të mëtutjeshëm në Departamentin e Pensioneve të MPMS-së.
6. Departamenti i Pensioneve, ia procedon lëndën Komisionit Mediko-Social për shqyrtim dhe vlerësim.
7. Komisioni Mediko-Social, pas shqyrtimit dhe vlerësimit, ia kthen lëndën Departamentit të Pensioneve.
8. Departamenti i Pensioneve nxjerr vendim për njohjen apo mos njohjen e statusit të personit të verbër bazuar në vlerësimin e Komisionit Mediko-Social dhe sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Ligjin për Personat e Verbër.

Neni 8 Procedura Ankimore

1. Pala e pakënaqur me vendimin e Departamentit të Pensioneve, mund të paraqesë ankesë me shkrim, në afat prej 30 ditësh, në Komisionin e Ankesave të MPMS-së.
2. Përbërjen dhe zgjedhjen e komisionit të ankesave e emëron Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së.
3. Komisioni i Ankesave, në afat prej tridhjetë (30) ditësh shqyrton dhe vendos ankesën e aplikuesit.

4. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, mund të ushtroj padi në gjykatën themelore, konkretisht Departamentin për Çështje Administrative, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 9 Rivlerësimi

1. Në bazë të vlerësimit të Komisionit Mediko-Social, përfituesit e grupit të parë, do t'i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për grupin e dytë, rivlerësimi bëhet në çdo tri vite.

2. Në rastet e caktuara kur natyra e sëmundjes është në zhvillim të shpejtë, e cila dëmton rëndë të pamurit, përfituesit e grupit të dytë, mund të aplikojnë edhe para tri viteve, për procedurë të përshpejtuar në organet kompetente të MPMS-së.

Neni 10 Pjesët përbërëse të Rregullores

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, janë: Formulari për Aplikim nr.1 dhe Formulari për Vlerësim i Komisionit Mediko-Social me nr.2.

Neni 11 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Shfrytëzuesit aktual të skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuara, me rastin e njohjes së të drejtës në kompensim sipas Ligjit 04/L-092, ndryshimi i pagesës do t'i llogaritet në mënyrë retroaktive nga 01.01.2013 në masë të shumës së pensionit të paguar dhe shumës së përcaktuar të kompensimit financiar për të verbrit.

2. Të gjithë përfituesit të cilët aplikojnë deri me 31.12.2013, pagesa iu bëhet në mënyrë retroaktive, ndërsa nga 01.01.2014, nga dita e paraqitjes së kërkesës përkatësisht muajit;

3. Përfituesit nga skema për personat me aftësi të kufizuara prej moshës prej 0-18 vjet sipas Ligjit Nr. 03/L-022, për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, ndërpriten nga pagesa me rastin e njohjes së të drejtës sipas Ligjit 04/L-092 për Personat e Verbër.

Neni 12 Dispozitat e Shfuqizimit

Me miratimin e kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr.01/2013 për Funkcionimin e Komisionit Mediko-Social.

Neni 13 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit.

3. Kjo Rregullore me hyrjen në fuqi do të shtypet në alfabetin e Brajlit.

Nenad Rashiq

Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Prishtinë, Dhjetor, 2013

**RREGULLORE QRK Nr. 15/2014 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Duke marrë parasysh Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 07/157, të datës 22.11.2013, për aprovimin e Programit Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës, Në pajtim me Nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, nr.15, 12.09.2011),

Miraton:

**RREGULLORE QRK-Nr. 15/2014 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës si dhe qasje në shërbimet e interpretimit, nëpërmjet Interpretëve të Gjuhës së Shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal.
2. Të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal, janë të obliguara që personave nga komuniteti i të shurdhërve t'i ofrojnë shërbim sipas nevojës dhe kërkesave në gjuhën e shenjave.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **“Personi i Shurdhër”** është personi që nuk dëgjon dhe që i takon një grupi të veçantë gjuhësor të cilët përdorin Gjuhën e Shenjave si gjuhë të parë;
 - 1.2. **“Interpret i Gjuhës së Shenjave”** është personi i kualifikuar, i/e cili/a ka kaluar trajnimet dhe janë të akredituara nga institucionet përkatëse;
 - 1.3. **“Klienti”** është personi nga komuniteti i të shurdhërve të cilit i ofrohet shërbimi sipas nevojës në gjuhën e shenjave;
 - 1.4. **“Zyra për Qeverisje të Mirë- ZQM”**- është Zyra në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;

1.5. **“Shoqata Kosovare e të Shurdhërve-SHKSH”**- Nënkupton Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve në nivel të Republikës së Kosovës;

1.6. **“Interpretimi i gjuhës së shenjave”** nënkupton komunikimin në mes të personave të shurdhër dhe gjysëm të shurdhër dhe personave të cilët dëgjojnë. Interpretimi mund të inkorporoj informacionet kulturore të asociuara me gjuhën e përdorur.

1.7. **“Gjuha e shenjave”** – nënkupton Gjuhën e shenjave e cila ka rregullat e saja gramatikore, strukturën e fjalisë dhe nuancat kulturore.

KAPITULLI II - KOORDINIMI NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE

Neni 4

Koordinimi në ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave

1. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve, koordinojnë ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave.
2. ZQM në bashkëpunim me SHKSH krjojnë një trup koordinues për koordinimin, promovimin e ofrimit të shërbimeve në gjuhën e shenjave.
3. Trupa koordinuese për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave përfshinë edhe përfaqësues të institucioneve tjera publike dhe jopublike.
4. Trupa koordinuese për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave mund të pranojë fonde edhe nga donatorët për promovimin dhe ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave.
5. Trupa koordinuese ka për mandat që në përputhje me kërkesat që vijnë nga institucionet përkatëse të ofrojë planin dhe standardet lidhur me rregullat për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Promovimi

1. ZQM në bashkëpunim me SHKSH:
 - 1.1. organizojnë dhe promovojnë ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. mbajnë trajnime bazike për institucionet publike lidhur me ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës;
 - 1.3. përkujdesen për ofrimin e trajnimeve për personat e shurdhër në Kosovë me theks të posaçëm fëmijët dhe gratë;
 - 1.4. përkujdesen që për udheheqësit e institucioneve të larta publike, në rastet e festave shtetërore, ngjarje të jashtëzakonshme dhe ngjarje tjera të rëndësishme të dërgojnë mesazhet edhe në gjuhën e shenjave.

KAPITULLI III - PROCEDURA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE PËR PERSONAT E SHURDHËR

Neni 6

Procedura për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër

1. Çdo Person i Shurdhër që ka nevojë për marrjen e shërbimit në gjuhën e shenjave i drejtohet SHKSH.
2. SHKSH pas shqyrtimit të kërkeses i siguron Interpretin e Gjuhës së Shenjave personit në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.
3. Personi i Shurdhër i shoqëruar nga Interpretin e Gjuhës së Shenjave të ngarkuar nga ana e SHKSH paraqiten në Institucionin Publik marrjen e shërbimeve të nevojshme në Institucionin publik.
4. SHKSH plotëson formularin e ofrimit të shërbimeve dhe këtë formular ia jep Interpretit i cili së bashku me zyrtarin e institucionit publik e nënshkruajnë;
5. Interpreti i gjuhës së shenjave pas ofrimit të shërbimeve i dorëzon formularin e plotësuar dhe të nënshkruar në SHKSH, klineti dhe nga zyrtari i institucionit publik.
6. SHKSH në baza mujore i dërgon formularet në ZQM.

Neni 7

Procedura për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për institucionet publike

1. Institucionet publike që janë të obliguara për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave i drejtohen SHKSH.
2. SHKSH pas shqyrtimit të kërkeses i siguron interpretin e gjuhës së shenjave personit në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.
3. Interpreti i Gjuhës së Shenjave paraqitet në Institucionin publik sipas kohës dhe vendit të përcaktuar nga Institucioni Publik dhe SHKSH.
4. SHKSH plotëson formularin e ofrimit të shërbimeve dhe këtë formular ia jep Interpretit i cili së bashku me zyrtarin e institucionit publik e nënshkruajnë;
5. Interpreti i gjuhës së shenjave pas ofrimit të shërbimeve i dorëzon formularin e plotësuar dhe të nënshkruar në SHKSH.
6. SHKSH në baza mujore i dërgon formularet në ZQM.
7. ZQM përkujdeset që nga Buxheti i ndarë të bëhet pagesa e intepretëve.

Neni 8

Financimi

1. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim në baza vjetore do të ndajë mjete financiare për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave për të gjithë vendin.
2. Numri i shërbimeve nuk guxon të tejkaloj buxhetin e ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI IV - TRAJNIMET DHE CERTIFIKIMI I INTERPRETËVE TË GJUHËS SË SHENJAVE

Neni 9

Trajnimet dhe certifikimi

1. Çdo interpret i gjuhës së shenjave që dëshiron të pajiset me certifikatë/diplomë, ai/ajo duhet të regjistrohet si anëtarë i Shoqatës Kosovare të Shurdhërve dhe të ndjek trajnimet e ofruara nga ana e Shoqatës Kosovare të Shurdhërve të cilat janë të akredituara nga institucioni përkatës.

2. Interpretët e Gjuhës së Shenjave të cilët ndjekin trajnimet të ofruara nga ana e Shoqatës Kosovare të Shurdhërve ata duhet të kalojnë edhe provimin e akreditimit.

3. Vetëm interpretët e gjuhës së shenjave të akredituar kanë të drejtë që në mënyrë institucionale dhe zyrtare të ofrojnë interpretim në gjuhën e shenjave.

Neni 10

Kriteret për pranim në trajnime

1. Kriteret për pranim në trajnime për Interpret të Gjuhës së Shenjave janë si më poshtë:

1.1. Esenciale:

1.1.1. Duhet të jetë i/e moshës madhore mbi 18 vjeqare;

1.1.2. Të jetë i/e rrjedhshëm në Gjuhën e Shenjave;

1.1.3. Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën e folur.

1.2. Të dëshirueshme:

1.2.1. Ta ketë të përfunduar shkollimin universitar apo shkollën e mesme;

1.2.2. Përvojë në situatat interpretuese.

Neni 11

Llojet e Certifikimit të interpreteve të gjuhës së shenjave

1. Certifikimet e Interpreteve të Gjuhës së Shenjave, janë si në vijim:

1.1. **Certifikatë e pjesëmarrjes** – nënkupton pjesëmarrjen në trajnime por ai/ajo interpret nuk ka kaluar provimin e akreditimit;

1.2. **Diplomë** – Interpret i Gjuhës së Shenjave–nënkupton se ai/ajo ka kaluar trajnimet e interpreteve dhe provimin e akreditimit.

Neni 12

Ngritja e kapaciteteve

1. Çdo Interpret i Gjuhës së Shenjave duhet që gjatë vitit të ndjek trajnimet e ofruara nga ana e Shoqatës Kosovare të Shurdhërve në këto fusha:

1.1. Kultura dhe Historia e të Shurdhërve;

1.2. Zhvillimin gjuhësor;

1.3. Bazat e Interpretimit, Teori dhe Praktikë;

1.4. Kodi i Etikës për Interpretët e Gjuhës së Shenjave.

2. Interpretët Gjuhës së Shenjave duhet të njohin plotësisht lëndën me të cilën ata punojnë në mënyrë që të jenë në gjendje të përcjellin informacionin nga njëra gjuhë, e cila njihet si burimi i gjuhës, në gjuhën tjetër, që njihet si gjuhë e targetuar.

Neni 13

Lista e interpretëve të gjuhës së shenjave

1. ZQM në bashkëpunim me SHKSH në baza vjetore do të përgatis listën e interpretëve të gjuhës së shenjave me të cilët do të lidhet kontratë për ofrimin e shërbime në gjuhën e shenjave në bazë të kërkesë dhe në të gjithë vendin.
2. Lista e interpretëve të gjuhës së shenjave bëhet publike dhe të gjithë personat, institucionet publike dhe private mund të kërkojnë shërbime nga interpretët e gjuhës së shenjave.
3. Tarifa për shërbimet e interpretimit në gjuhën e shenjave caktohet nga Qeveria sipas propozimit të ZQM në koordinim me SHKSH, sipas standardeve në fuqi.

KAPITULLI V - PARIMET E PUNËS SË INTERPRETËVE TË GJUHËS SË SHENJAVE

Neni 14

Parimet e punës së Interpretëve të Gjuhës së Shenjave

1. Parimet e punës së Interpretëve të Gjuhës së Shenjave janë si në vijim:
 - 1.1. **Ndjekja profesionale** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave interpretojnë saktësisht, vishen dhe sillen në mënyrë të përshtatshme për çdo rrethanë në përputhshmëri me Kodin e Etikës;
 - 1.2. **Konfidencialiteti** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave respektojnë intimitetin e konsumatorëve dhe ruajnë në konfidencë të gjitha informacionet e fituara si rrjedhojë e shërbimeve profesionale. Interpretët mund të jenë të liruar nga ky obligim vetëm me autorizimin e konsumatorit ose kur kërkohet me ligj;
 - 1.3. **Objektiviteti** – Interpretët e Gjuhës së Shenjave nuk duhet të konsultojnë, këshillojnë ose të imponojnë opinionet e tyre personale;
 - 1.4. **Paanësia** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave duhet të qëndrojnë neutral, të paanshëm dhe objektiv. Ata duhet të shmangen shëndrrimit të mesazheve për arsye politike, religjioze, morale apo filozofike ose të çdo lloj mesazhi të anshëm ose konsideratë subjektive;
 - 1.5. **Zotërimi** – Interpretët e Gjuhës së Shenjave duhet të pranojnë detyrën duke patur parasysh aftësitë e tyre, situatat ku interpretojnë dhe klientët të cilët janë të kyçur;
 - 1.6. **Saktësia** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave pranojnë përgjegjësinë që besnikërisht do të përcjellin mesazhin në të dy gjuhët, pa shtuar apo larguar informacionet, duke i dhënë konsideratë ndryshimeve gjuhësore, duke ndjekur tonin, stilin, regjistrin dhe theksin e burimit të mesazhit;
 - 1.7. **Konflikti i interesit** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave nuk duhet të paraqesin klientëve asnjë biznes, agjencion, proces, substancë apo material në të cilën ata kanë interes personal apo financiar pa zbuluar këto interesa te klientët. Interpretët e Gjuhës së Shenjave nuk duhet të pranojnë ose duhet të largohen nga marrëveshja në të cilën paanësia mund të jetë e vështirë të ruhet për shkak të besimeve personale ose gjendjes së tyre
 - 1.8. **Kompensimi** – Interpretët e Gjuhës së Shenjave kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për shërbimet në mënyrë profesionale;
 - 1.9. **Zhvillimi i vazhdueshëm profesional** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave duhet të ndjekin trajnimet e ofruara profesionale;
 - 1.10. **Solidarizimi profesional** - Interpretët do të sillen me kolegët në frymën e kooperimit të

ndërsjellë, duke i trajtuar dhe paraqitur tek te tjerët me respekt, mirësjellje, drejtësi dhe mirëbesim etj.

1.11. **Distanca profesionale** - Distanca profesionale është kualitet i kujdesit lidhur me klientët, shërbimin duke mos lejuar të ndikojë në interpretimin e njërit, duke mos i prezentuar informacionet tek klienti e cila ka ndikim në jetën e tyre.

1.12. **Kundërdiskriminimi** - Interpretët e Gjuhës së Shenjave tajton të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të barabartë.

2. Interpretët zbatojnë Kodin e Etikës i cili nxirret nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve.

KAPITULLI VI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave

ZQM në bashkëpunim me SHKSH përgatisin Udhëzuesin për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.

Neni 16

Formulari për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave

ZQM në bashkëpunim me SHKSH përgatisin Formularin për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.

Neni 17

Publikimi dhe informimi

1. ZQM dhe SHKSH krijojnë link të veçantë në ueb faqet e tyre institucionale publikojnë edhe në gjuhën e shenjave:

1.1. këtë rregullore;

1.2. Formularin për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës;

1.3. Udhëzuesin për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës dhe;

1.4. të gjitha materialet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të gjuhës së shenjave për personat e shurdhër dhe për institucionet.

Neni 18

Periudha Kalimtare

1. Deri në akreditimin e Interpretëve të Gjuhës së Shenjave, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore, interpretet e akredituar vazhdojnë punën dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Interpretët e Gjuhës së Shenjave të akredituar nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje nuk kanë nevojë që ti nënshtrohen riakreditimit.

Neni 19

Përgjegjësia për zbatim

1. ZQM është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal, të cilat kanë obligime me ligje të veçanta për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave nuk i nënshtrohen rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë: 15 Tetor 2014

LIGJI Nr. 05/L -067

PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione të përfituesve të këtij ligji si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Paraplegjikët** – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

1.2. **Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët)** – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

1.3. **Përfituesit e këtij Ligji** - Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

1.4. **Kompenzimi** - nënkupton shumën e pagesës mujore për mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme ditore.

1.5. **Komisioni Vlerësues** - komision i përbërë prej ekspertëve mjekësor dhe social, i emëruar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale sipas Legjislacionit në fuqi.

1.6. **MPMS** - Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

1.7. **MASHT** – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;

1.8. **MSH** – Ministria për Shëndetësi;

1.9. **MI** – Ministria për Infrastrukturë;

1.10. **Komunat** – Komunat në Republikën e Kosovës;

1.11. **MMPH** – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

1.12. **SHOQATA**- Shoqatat e licencuara që ofrojnë shërbime për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

KAPITULLI II MBROJTJA E DINJITETIT

Neni 4 Mbrojtja

Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 5 Mbrojtja e integritetit të personit

Përfituesit e këtij ligji kanë të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit dhe për respekt ndaj integritetit të tyre fizik dhe mendor në bazë të barabartë me personat e tjerë.

Neni 6 Liria e të shprehurit dhe mendimit, si dhe qasja në informacion

Përfituesit e këtij ligji gëzojnë të drejtën e tyre për të shprehur mendimet e tyre përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre.

KAPITULLI III PËRFITIMET

Neni 7 Kompensimi

1. Përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS.
2. Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Punësimi, vetëpunësimi apo ndonjë formë tjetër e punësimit, nuk do të jenë arsye për përjashtim nga kompensimi, siç përcaktohet në këtë ligj.
4. Përfituesit e këtij ligji pavarësisht nga mosha marrin kompensim të paraparë me këtë ligj.

Neni 8 Kujdestari personal

1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji.
2. Përfituesit e këtij ligji kanë të drejtën e zgjedhjes së kujdestarit të tyre.
3. Nëse përfituesi i këtij ligji nuk është në gjendje të bëjë zgjedhjen e kujdestarit, organi i kujdestarisë i cakton kujdestarin.
4. Përfituesit e këtij ligji nënshkruajnë kontratë me kujdestarin e tyre, para organit kompetent të Noterisë.
5. Përfituesit e këtij ligji, duhet të deklarojë emrin e kujdestarit personal, para organit kompetent që e regjistron atë në një regjistër të posaçëm së bashku me kontratën e vërtetuar tek Noteri.
6. Po ashtu, ai duhet të deklarojë edhe ndërrimin eventual të kujdestarit personal, nëse e vlerëson të arsyeshme se një ndërrim i tillë duhet të bëhet. Me këtë ndërrim, menjëherë njoftohet edhe Administrata e MPMS.
7. Për lehtësimin e procedurës së përfituesve të këtij ligji MPMS cakton formën e kontratës së përcaktuar në këtë nen.

Neni 9 Fondet për pagesa të kompensimit dhe kujdestarit

1. E drejta në kompensim të përfituesve të këtij ligji, si dhe të kujdestarit personal të tyre, realizohet nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.
2. Fondet për pagesa të kompensimit dhe kujdestarit, sigurohen nga buxheti i përgjithshëm i MPMS.
3. Pagesa bëhet çdo muaj nga Departamenti për Pensione në kuadër të MPMS.
4. Përfituesit e këtij ligji të cilët gjinden në institucione nën përkujdesjen shtetërore nuk mund jenë përfitues të kompensimit sipas këtij ligji.

KAPITULLI IV KUJDESI, SIGURIMI I VENDSTREHIMIT, SIGURIMI SHËNDETËSOR, ARSIMIMI DHE IDENTIFIKIMI

Neni 10
Lirimi nga taksat dhe tatimi

1. Për Lirim nga tatimi, taksat, doganimit për importim dhe nga taksat për regjistrim të automjetit për nevojat e përfituesve të këtij ligji vlejné dispozitat sipas legjislacionit në fuqi.
2. Përfituesit e këtij ligji lirohen nga taksat për regjistrim të automjetit personal apo të kujdestarit.
3. Përfituesit e këtij ligji lirohen nga taksat për dokumente personale dhe certifikata të gjendjes civile.

Neni 11
Identifikimi

1. Përfituesit e këtij ligji pajisen me librezë zyrtare identifikuese.
2. MPMS mbanë dhe përditëson Regjistrin e përfituesve të këtij ligji.
3. Forma dhe përmbajtja e librezës zyrtare identifikuese si dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga MPMS.

Neni 12
Arsimimi

1. Arsimimi i përfituesve të këtij ligji, në institucionet publike dhe private bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për shkollim pa pagesë në të gjitha nivelet e shkollimit në institucionet publike dhe strehimit në konviktet publike.
3. MASHT në bashkëpunim me MMPH dhe komunat ndërmarrin të gjitha masat me qëllim që të gjitha institucionet shkollore dhe Universitetet qoftë ato private apo publike të sigurojnë kushte dhe standarde teknike të objekteve për qasje dhe qëndrim të përdoruesve të karrocave në pajtim me legjislacionin përkatës për ndërtimet.

Neni 13
Kujdesi shëndetësor

1. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik lirohen nga pagesa e premiumit dhe çfarëdo pagese tjetër shtesë në sistemin shëndetësor publik.
2. Përfituesit e këtij ligji në pamundësi për t'u paraqitur në institucionet shëndetësore publike, përfitojné shërbim shëndetësor shtëpjak nga profesionisti shëndetësor i licencuar, mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato shërbime mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatore dhe në kushte shtëpie.
3. Lista dhe llojet e pajisjeve ndihmëse falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim, përcaktohen me akt nënligjor.
4. Institucionet kompetente ofrojnë rehabilitim shëndetësor, fizik dhe social për përfituesit e këtij ligji sipas vlerësimit të komisionit vlerësues.
5. Për zbatimin e këtij neni Qeveria nxjerr akt nënligjor sipas propozimit të MSH.

Neni 14
Shpenzimet e energjisë elektrike

Përfituesit e këtij ligji gëzojnë reduktim në tarifa të konsumimit të energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara nga organet kompetente.

Neni 15

Udhëtimi

1. Përfituesit e këtij ligji si dhe kujdestari i tyre, gëzojnë beneficione në pagesa, në trafikun urban falas, ndërsa në trafikun ndërrurban bëhet me pagesën pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së biletës.
2. Operatorët privat dhe publik duhet të përcaktojnë vendet për përfituesit e këtij ligji, këto vende janë të lira nga detyrimi fiskal të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Përkujdesja për strehim

1. Përfituesit e këtij ligji, që plotësojnë kushtet ligjore për t'u konsideruar si qytetarë për strehim, në përfundim të vlerësimit të nevojës së tyre, përfitojnë strehimim familjar në ndërtimet të objekteve kolektive të banimit social.
2. Organet kompetente të pushtetit lokal duhet t'u japin përparësi zgjidhjes së kërkesave të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik për strehim, duke pasur parasysh kushtet, veçoritë dhe gjendjen shëndetësore të tyre.

KAPITULLI V

PËRBËRJA DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 17

Komisioni Vlerësues

1. Përfituesit e këtij ligji i nënshtrohen vlerësimit të Komisionit Vlerësues të MPMS në zyrat rajonale.
2. Komisioni Vlerësues lëshon vlerësim, duke përcaktuar personin si përfitues të këtij ligji si dhe grupimin dhe nevojat e tij sociale.
3. Komisioni shqyrton kërkesat e përfituesve të këtij ligji, për njohje të statusit dhe beneficioneve.
4. Përbërja dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues caktohet nga Qeveria me akt nënligjor sipas propozimit të MSH-së dhe MPMS-së ndërsa një (1) anëtar caktohet nga shoqatat e licencuara që ofrojnë shërbime për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në cilësinë e vëzhguesit.

Neni 18

E drejta për ankim

1. Personit që kërkesa për njohjen e statusit dhe kompenzimeve i është refuzuar, ka të drejtë në ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh .
2. Ankesat i shqyrton komisioni i shkallës së dytë i MPMS.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Bashkëpunimi dhe promovimi

1. Këshilli Nacional për personat me aftësi të kufizuara si njëra ndër strukturat me të larta reprezentative për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara do të monitoron dhe raporton mbi procesin e zbatimit të këtij ligji.

2. Përbërja dhe përgjegjësitë e Këshillit Nacional për personat me aftësi të kufizuara caktohet nga Qeveria sipas propozimit të Zyrës për Qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 20

Zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe, drejtpërsëdrejti zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 21

Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale

1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, pagesa e cilitdo dhe të gjitha beneficioneve financiare të siguruar nga ky ligj duhet të kërkohet vetëm deri në atë masë që:

1.1. fondet janë përvetësuar veçmas për një qëllim të tillë, sipas ligjit të aplikueshëm për buxhetin vjetor;

1.2. ka fonde të mjaftueshme, në dispozicion për pagesa të tilla;

1.3. Qeveria nuk ka lëshuar vendim sipas paragrafit 2 të këtij neni që redukton apo eliminon pagesa të tilla.

2. Në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.

Neni 22

Dispozitat ndëshkuese

1. Çdo institucion, i cili nuk i respekton dispozitat e këtij ligji, ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi.

2. Çdo person që me vetëdije paraqet deklaratë të rreme ose prezanton dokumente të falsifikuara, me qëllim të përfitimit të të drejtave dhe beneficioneve të parapara me këtë ligj, ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. Personit, nga paragrafi 2 i këtij neni, i merret librezja zyrtare identifikuese për një periudhë kohore deri në tre (3) vite.

Neni 23

Zgjidhja e kontesteve

Përfituesit e këtij ligji mund të kërkojnë që çdo mosmarrëveshje që del nga ky ligj të zgjidhet në organin kompetent administrativ apo gjyqësor në bazë të ligjit në fuqi.

Neni 24

Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit

1. Për zbatimin e këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muaj, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministrinë nxjerrin aktet nënligjore.

2. Qeveria e Kosovës, sipas nevojës, përveç akteve nënligjore të përcaktuara në këtë ligj, mund të nxjerrë edhe akte të tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa kompensimet dhe benefitet nga dispozitat e nenit 7, 8, 9 dhe 13 (paragrafi 3 dhe 4) të këtij ligji, do të fillojnë së zbatuari, nga 1 janar 2017.

Ligji Nr. 05/L -067
25 maj 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-013-2016, datë 13.06.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.

Ligji Nr. 02/L-17

**PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE
(I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-0810)**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren nr. 2001/9, të datës 15 maj 2001, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, posaçërisht Kreu 5.1(g), 5.7, dhe 9.3.2;

Me qëllim që të vendoset baza ligjore për rregullimin dhe përparimin shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe për familjet,

Miratton:

LIGJIN PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Dispozitat themelore
Neni 1

1.1. Ky Ligj përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë.

1.2. Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjisllacionin e Republikës së Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t'u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale.

1.3. Përkufizimet

Shërbimet sociale dhe familjare - përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale.

Përkujdesja e drejtpërdrejtë sociale - nënkupton ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen. Përkujdesja mund të ofrohet në shtëpinë e vetë personit, në një familje tjetër, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor ose në një institucion rezidencial.

Këshillimi është një proces sistematik dhe i programuar i ofrimit të informacionit, këshillave dhe udhëzimeve me qëllim që të ndihmohet një individ ose një familje për të përmirësuar rrethanat sociale dhe ndër njerëzore.

Ndihma materiale nënkupton sigurimin e parave, strehimit të përkohshëm, ushqimit, pagesës së shpenzimeve mjekësore, veshmbathjes ose çfarëdo nevojë tjetër të domosdoshme materiale urgjente për individin ose familjen, të cilët nuk kanë burim tjetër në dispozicion.

Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak:

1. se është fëmijë pa përkujdesje prindore
2. se është fëmijë me sjellje asociale
3. se është delikuent i mitur
4. të marrëdhënieve të çrregulluara në familje
5. të moshës së shtyer
6. të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike
7. të aftësive të kufizuara mendore
8. të sëmundjes mendore
9. të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi
10. të dhunës në familje
11. të trafikut të qenieve njerëzore
12. të varësisë nga alkooli ose drogat
13. të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu
14. ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë.

Familje në nevojë konsiderohet ajo familje kur njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës, në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore, abuzimit nga ana e prindit ose prindërve të tij, për shkak të paaftësisë së prindit ose prindërve apo kujdestarit që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë.

Fëmijë nënkupton personin i cili është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

I mitur nënkupton personin mes moshës katërmëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç.

Zyrtar i shërbimeve sociale nënkupton një profesionist të shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushë të punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose në ndonjë lëmë tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe regjistruar në regjistrin të Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.

Qendra për Punë Sociale (QPS) - është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale.

Organi i kujdestarisë është organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.

Roli i Ministrisë Neni 2

2.1. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëposhtëm: Ministria) është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe siguron që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa asnjë dallim, siç është raca, përkatësia etnike, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik, origjina kombëtare.

2.2. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe përgatitjen e planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për popullatën e Republikës së Kosovës, të sigurojë zbatimin sipas standardeve të duhura të këtyre politikave dhe planeve strategjike nga ana e komunave dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, si edhe për kornizën rregullatore të shërbimeve sociale

dhe familjare dhe koordinon aktivitetet e agjencive ndërkombëtare e qeveritare dhe të organizatave joqeveritare në mënyrë që të promovojë zhvillimin dhe zbatimin koherent të politikave të mirëqenies sociale, të inkurajojë pjesëmarrjen e komunitetit dhe zhvillimin e iniciativave dhe aktiviteteve të komunitetit në lidhje me mirëqenien sociale.

2.3. Komunat ose organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë edhe ndërmarrjet private mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Megjithatë, Ministria rezervon të drejtën që të përcaktojë ku, si dhe kush i kryen këto shërbime.

2.4. Në të gjitha çështjet në lidhje me çdo parashtim të kërkesës pranë gjykatës për heqjen ose zvogëlimin e të drejtave prindore ose heqjen apo kufizimin e lirisë të një personi në nevojë, Qendra për Punë Sociale mban përgjegjësinë e drejtpërdrejtë dhe çfarëdo veprimi i tillë inicohet nga kjo qendër.

2.5. Ministria është përgjegjëse për specifikimin e standardeve profesionale të resurseve për shërbimet sociale dhe familjare që duhet të përmbushen nga komunat dhe organizatat e tjera që ofrojnë këto shërbime dhe për krijimin e mekanizmave që sigurojnë arritjen e tyre. Kjo përfshin specifikimin e llojit dhe numrit të personelit profesional që duhet punësuar.

2.6. Komunat dhe organizatat e tjera që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare duhet t'u përmbahen rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara nga Ministria. Në raste të veçanta, kur Ministria e konsideron të nevojshme, ato duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna për menaxhimin.

2.7. Në rrethana të veçanta, kur komuna ose ndonjë organizatë tjetër që ofron shërbime sociale dhe familjare nuk i plotëson në mënyrë të vazhdueshme standardet minimale të specifikuar nga Ministria për ofrimin e këtyre shërbimeve, Ministria do të marrë përsipër përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për kryerjen e shërbimeve të tilla, për aq kohë sa të jetë e nevojshme që situata të përmirësohet.

2.8. Kur ka raste, incidente ose rrethana që ngjallin shqetësim serioz të opinionit ose kur paraqiten çështje të rëndësishme me interes publik në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, ministri, mund të krijojë një komision hetues, i cili zhvillon punimet publikisht dhe publikon konkluzionet dhe rekomandimet e tij.

2.9. Ministria është e autorizuar që të ndërmarrë hulumtime, ose të angazhojë të tjerët që ndërmarrin kërkime në fusha të ndryshme përkitazi me kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

2.10. Me qëllim që, komunave ose organizatave që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në emër të saj, të ju mundësohet kryerja e këtyre funksioneve, Ministria do tu ndaj fonde vjetore për këtë destinim me një shpallje publike për blerjen e shërbimeve.

Roli i departamentit përkatës

Neni 3

3.1. Ministria përmes departamentit përkatës:

- a. bashkëpunon me komunat, rrethet akademike, ministritë tjera dhe me palët e interesuara për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
- b. ofron propozime, sugjerime dhe këshilla për Ministrinë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës në lidhje me zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me shërbimet sociale dhe familjare.

3.3. Në emër të Ministrisë, Departamenti përkatës është përgjegjës për drejtimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha funksioneve operative të përcaktuara me këtë ligj:

- a. përgatitjen e rregulloreve, urdhëresave dhe udhëzimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjar;
- b. nxjerrjen e udhëzimeve në lidhje me standardet e nivelit të shërbimeve që duhet të plotësohen nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare;
 - b.a. licencimin e OJQ-ve të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare;
- c. zhvillimin e inspektimeve të shërbimeve sociale dhe familjare;
- d. shqyrtimin e raporteve vjetore të drejtorive përkatëse komunale dhe miratimin e planeve vjetore të punës së tyre;
- e. miratimin e themelimit të objekteve rezidenciale për përkujdesje nga ana e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare;
- f. marrjen e përgjegjësisë së menaxhimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në vazhdimësi dhe në mënyrë serioze që të plotësojë standardet e pranueshme për kryerjen e shërbimeve;
- g. dhënien e udhëzimeve në lidhje me parashtrimin e kërkesave për urdhër kujdestarie para gjykatave, të cilat kanë të bëjnë me fëmijët dhe të rriturit e rrezikuar;
- h. në raste të veçanta, mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të rasteve të shërbimeve sociale dhe familjare;
- i. themelimin dhe koordinimin e panelit për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar ose për adoptim;
- j. zhvillimin e procedurës së ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare;
- k. çdo formë të re të mbrojtjes që nuk është përfshirë në këtë ligj;
- l. për promovimin, zhvillimin dhe begatimin e njohurive, shkathtësive dhe standardeve profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
- m. hulumtime në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, nxit ngritjen profesionale të kuadrit nëpërmjet trajnimit dhe ofrimit të këshillimit për profesionistët.
- n. publikimit të doracakëve përkatës, raporteve për rezultatet e kërkimeve dhe materialeve promovuese
- o. inspektimin, komisionimin e shërbimeve sociale dhe familjare në institucionet e përcaktuara me ligj, si dhe në organizatat joqeveritare dhe në sektorin privat. Në lidhje me këto aktivitete përpilon një raport vjetor me shkrim.

3.3.a. për funksionimin dhe specifikimin e aktiviteteve në nën-paragrafët l., m., dhe n. të këtij ligji, Ministria, nxjerr akt nënligjor.

3.3.b. për funksionimin dhe specifikimin e aktiviteteve në nën-paragrafin o. të paragrafit 3.3. të këtij ligji, Ministria, nxjerr akt nënligjor.

3.5. Për çdo inspektim Departamenti përpilon një raport i cili vë në pah arritjet dhe mangësitë në shërbimet sociale dhe familjare, të cilat i nënshtrohen inspektimit duke ofruar këshilla dhe udhëzime sipas nevojës. Raporti i dërgohet ofruesit të shërbimeve dhe komunës përkatëse.

3.6. Të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare duhet të bashkëpunojnë në vazhdimësi me zyrtarët e departamentit përkatës që bëjnë monitorimin dhe inspektimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe të bëjnë të mundshme që menjëherë të shikohen në mënyrë të papenguar të gjitha shënimet, dokumentet dhe personat të cilat i kërkon. Në të kundërtën, mosbashkëpunimi me Ministrinë në mënyrë të vazhdueshme, mund të rezultojë me ndalimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

3.7. Departamenti përkatës është i autorizuar që ofruesve të shërbimeve të cilët dështojnë në plotësimin e standardeve të pranueshme për të kryer shërbimet t'u japë udhëzime për masat që duhet të ndërmerren për harmonizimin e cilësisë së shërbimeve me këto standarde. Dështimi në ndjekjen e këtyre udhëzimeve mund të rezultojë me ndalesën e ushtrimit të mëtejshëm të shërbimeve sociale dhe familjare nga ana e ofruesit të tyre.

Këshilli i përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare Neni 5

5.1. Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare (në tekstin e mëposhtëm: Këshilli) krijohet me këtë ligj.

5.2. Këshilli është përgjegjës për mirëmbajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe në këtë vazhdë shërben si një organ regjistruar dhe licencues për profesionistët që punojnë në këtë lëmë.

5.3. Këshilli është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët janë të licencuar për ta ushtruar veprimtarinë në *Republikën e Kosovës*. Ai ka kompetencë që të vendosi se kush mund të jetë i licencuar si profesionist specialist i shërbimeve sociale dhe familjare, cakton se çfarë zhvillimi i vazhdueshëm profesional kërkohet nga profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare, shqyrton ankesat kundër profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe vendosë për sanksionet disiplinore që duhen zbatuar, duke përfshirë heqjen e profesionistit të shërbimeve sociale dhe familjare nga regjistri.

5.3.a. Këshilli licencon trajner në fushën e shërbimeve sociale dhe mund të autorizoj ekspert vendor nga rradhët e veta dhe jashtë tij, në ofrimin e trajnimit për profesionistë të shërbimeve sociale dhe familjare;

5.3.b. Këshilli për licencimin apo certifikimin e trajnimeve mund të ketë rolin edukativo arsimor për të gjithë profesionistët, OJQ dhe organizatave qeveritare të cilët merren me shërbime sociale dhe familjare.

5.4. Këshilli duhet të adoptojë një kod të etikës dhe mirësjelljes për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare.

5.5. Këshilli nxjerrë rregullore adekuate për zhvillimin e punimeve në lidhje me kompetencat që ka.

5.6. Këshilli duhet të jetë i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij.

5.6.a. Kundër vendimeve të Këshillit mund të bëhet ankesë te Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Këshillit.

5.6.b. Anëtarët e Këshillit për licencim, nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa.

5.7. Kundër vendimeve të këtij Komisioni, pala e pakënaqur, përmes padisë, mund të hapë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente të Republikës së Kosovës.

5.8. Këshilli ka njëzetënjë (21) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

5.9. Përbërja e Këshillit do të jetë si vijon:

- njëmbëdhjetë anëtarë zgjedhen nga radhët e profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare që gjenden në regjistrin e Këshillit;
- dy anëtarë emërohen nga Asociacioni i Komunave,
- dy anëtarë i emëron Universiteti i Prishtinës,
- një anëtarë i emëruar nga Këshilli i Përgjithshëm Shëndetësor,
- një nga komuniteti dhe organizatat joqeveritare dhe
- katër anëtarë të emëruar nga Ministria.

5.10. Këshilli zgjedhë kryetarin dhe zëvendëskryetarin nga radhët e veta.

5.11. Anëtarët e Këshillit nuk duhet të mbajnë asnjë pozitë që nuk është në pajtim me funksionet e tyre si anëtarë të Këshillit. Ata duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

5.13. Ministria ose vetë Këshilli mund t'ia referojë Gjykatës Supreme pretendimet se një anëtar i Këshillit ka dështuar t'i përmbushë obligimet e tij të dala nga rregulloret e Këshillit dhe pas shqyrtimit të dëshmimeve dhe përgjigjeve të anëtarit të Këshillit mund të urdhërojë që anëtari i Këshillit të largohet nga detyra. Gjykatësi i Gjykatës Supreme mund ta drejtoj rastin tek autoritetet e ndjekjes penale nëse konsideron se mund të ekzistojë aspekti kriminal lidhur me çështjen në shqyrtim. Anëtarit të Këshillit çdoherë duhet t'i sigurohen prova dhe dokumente lidhur me shkeljen e obligimeve.

5.14. Në rast të largimit nga detyra, vdekjes apo dorëheqjes së ndonjë anëtari të Këshillit, Ministri emëron anëtar të ri që shërben për kohën e mbetur të mandatit të anëtarit të cilin e zëvendëson.

5.15. Këshilli mund të formojë komitete dhe të caktojë raportuesit për kryerjen efikase të detyrave të tyre.

5.16. Kuorumi për takimin e Këshillit duhet të jetë 11 anëtarë.

5.17. Vendimet e Këshillit duhet të merren nga 2/3 e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Këshillit dhe në rast të një votimi me rezultat të barabartë kryetari do ta ketë të drejtën për hedhjen e një vote shtesë.

5.18. Këshilli duhet t'i regjistrojë të gjithë profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare të cilët aplikojnë për regjistrim, me kusht që ata t'i kenë përmbushur kërkesat të cilat Këshilli i vlerëson të nevojshme lidhur me arsimimin, përvojën dhe trajnimin e tyre.

5.19. Këshilli duhet t'i regjistrojë si specialistë të gjithë profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare të cilët aplikojnë për regjistrim si specialistë me kusht që ata t'i kenë përmbushur kërkesat të cilat Këshilli i vlerëson të nevojshme lidhur me arsimimin, përvojën dhe trajnimin e tyre.

5.20. Këshilli duhet t'i caktoj kërkesat për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare lidhur me zhvillimin e vazhdueshëm profesional, në mënyrë që ata të mbeten në regjistër si profesionistë dhe specialistë të shërbimeve sociale dhe familjare.

5.21. Këshilli nxjerrë rregulloret që i konsideron të nevojshme për sigurimin e licensimit, regjistrimin e specialistëve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional adekuat.

5.22. Këshilli është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha pretendimeve për shkelje të obligimeve nga profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare.

5.23. Ankesa kundër profesionistit të shërbimeve sociale dhe familjare mund t'i bëhet drejtpërdrejt Këshillit nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, profesionistët e tjerë apo anëtarët e publikut.

5.24. Këshilli duhet të caktojë se si shqyrtohen ankesat e tilla, dhe ta njoftojë personin që është nën hetime lidhur me akuzat, arsyet të cilat e kanë nxitur hetimin dhe të drejtat e tij për qasje në dosjen e ankesës gjatë gjithë procesit sapo të jetë e mundur pas pranimit të ankesës dhe para se të jetë mbledhur ndonjë komision për vërtetimin e fakteve të ankesës.

5.25. Komisioni që shqyrton ankesën ka kompetenca të përgjithshme për inspektim, verifikim dhe vlerësim, duke përfshirë qasjen në cilindo dokument që mund të ofrojë informacione relevante për ankesën. Pasi komisioni ta ketë përfunduar punën e tij, ai duhet të paraqesë një raport për Këshillin dhe një kopje për ankuesin dhe subjektin e ankesës i cili duhet të ftohet të paraqitet para Këshillit në një seancë shqyrtimi.

5.26. Personi nën hetime mund të ndihmohet dhe, në rast të sëmundjes ose për shkaqe tjera të arsyeshme të përcaktuara nga Këshilli, mund të përfaqësohet nga personi i autorizuar apo avokati mbrojtës, të cilit duhet mundësuar qasja në të gjitha dokumentet e mbledhura gjatë hetimit.

5.27. Nëse në seancën e shqyrtimit nuk paraqitet personi ndaj të cilit është bërë ankesa ose person i autorizuar apo avokati mbrojtës, kjo nuk do ta pengojë Këshillin që rastin ta shqyrtojë dhe ta vendosë.

5.28. Seanca e Këshillit është publike.

5.29. Këshilli vendos nëse ekzistojnë fakte të mjaftueshme për të vërtetuar se profesionisti i shërbimeve sociale dhe familjare ka bërë shkelje të detyrës dhe ta vendosë sanksionin. Këshilli përcakton një nga sanksionet e numëruara nga (a) deri në (d):

- a). qortimi
- b). qortimi dhe vërejtja
- c). suspendimi nga regjistri për një kohë deri një vit
- d). heqja nga regjistri i profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare.

5.30. Me rastin e përcaktimit të sanksioneve, Këshilli siguron që ato të jenë në përpjesëtim me shkeljen e obligimit për të cilin janë dhënë.

5.32. Anëtarët e Këshillit, për pjesëmarrje dhe shërbime që ofrojnë në kuadër të Këshillit, do të kompenzohet nga Ministria dhe donatorët e ndryshëm.

5.33. Ministria i siguron kushtet e kërkuara për funksionimin e Këshillit.

5.34. Këshilli financohet edhe nga pagesat e taksave të regjistrimit për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare dhe nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

5.34a. Të hyrat të cilat realizohen nga pagesat e taksave të regjistrimit për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare do t'i takojnë Buxhetit të Republikës së Kosovës.

5.35. Këshilli mund ta emërojë një sekretar dhe një numër të personelit të nevojshëm në kuadër të buxhetit të tij, në mënyrë që t'i kryejë përgjegjësitë e tij sipas këtij ligji.

5.36. Të gjithë profesionistët që punojnë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë duhet t'i plotësojnë kërkesat për regjistrim dhe të regjistrohen në Këshill.

5.37. Për përbërjen, institucionet këshilluese dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ministria nxjerr akt nënligjor.

Roli i Komunës

Neni 6

6.1. Secila komunë, përmes drejtoratit të saj përkatës, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria.

6.2. Ndonëse kanë përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në territorin e tyre, asnjë anëtar i zgjedhur i asamblesë komunale ose zyrtar i komunës nuk mund të japë urdhëresa në lidhje me menaxhimin profesional të cilitdo rast të veçantë të shërbimeve sociale dhe familjare, as të ketë qasje në të dhënat konfidenciale të rastit.

6.3. Drejtoratet e komunave kryejnë shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari.

6.4. Drejtoratet marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Ato përgatisin plane vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajnë bazën e të dhënave dhe nxjerrin statistika sipas rekomandimeve të Ministrisë. Komuna, përmes drejtorive përkatëse, paraqet raport vjetor për aktivitete që lidhen me shërbime sociale dhe familjare si dhe raporte të veçanta në raste konkrete me rrezikshmëri apo interes të lartë, me kërkesën e Ministrisë.

6.5. Gjatë përgatitjes së planeve të tyre vjetore drejtoratet janë të obliguara që të konsultohen gjerësisht me shfrytëzuesit e shërbimeve sociale dhe familjare, përfaqësuesit e tyre, organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera relevante të komunitetit dhe grupet profesionale në territorin e tyre në lidhje me zhvillimin, planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare.

6.6. Çdo drejtorat siguron që qendra për punë sociale në territorin e vet të ketë resurse sipas standardeve të specifikuara nga Ministria. Kjo përfshin llojin dhe numrin e personelit profesional që duhet punësuar.

6.7. Përveç sigurimit të resurseve për përmbushjen e përgjegjësisë të caktuara për qendrat e punës sociale nga ky ligj dhe ligjet e tjera relevante, drejtoratet lejohen që nëpërmes QPS-ve dhe organizatave joqeveritare të sigurojnë ose mundësojnë ushtrimin e shërbimeve shtesë që vijojnë:

- a. ndihmë në punët e shtëpisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, pastrimin, gatimin e ushqimit dhe larjen e rrobave për individët, të cilët për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar ose sëmundjes, nuk mund të kryejnë këto punë për veten ose të cilët nuk kanë familje apo ndonjë ndihmë tjetër;
- b. përkujdesje të drejtpërdrejtë personale të individëve në shtëpinë e tyre, duke përfshirë por pa u kufizuar me veshjen e rrobave, larjen, higjienën personale, ndihmën për të lëvizur dhe për t'u ngritur, cilët, për shkak të moshës, aftësive të kufizuara ose sëmundjes, nuk mund të kryejnë vetë këto punë ose nuk kanë familje apo ndonjë ndihmë tjetër në dispozicion;
- c. hapja e një qendre, ku individët në nevojë mund të mblidhen çdo ditë për t'u shoqëruar e ushqyer, për të mbajtur higjienën personale, për të zhvilluar terapinë e punës dhe çfarëdo aspekti tjetër të këshillimit dhe përkujdesjes sociale;
- d. shërbime specialistike të këshillimit për njerëzit me varësi ose probleme të tjera psiko-sociale;
- e. asistencë me anë të përkrahjes financiare, sigurimit të lokalit ose këshillës profesionale për grupet e njerëzve në nevojë ose ata që kujdesen për ta në mënyrë që të krijojnë dhe mbajnë grupe për ndihmë reciproke dhe grupe për vetë ndihmë;

- f. përkujdesje rezidenciale për të moshuarit dhe njerëzit me nevoja të posaçme;
- g. çdo shërbim tjetër i përshtatshëm lidhur me shërbimet sociale dhe familjare.

6.8. Drejtorati bën përgatitje adekuata për t'u përgjigjur në rastet e shërbimeve urgjente sociale dhe familjare të cilat kërkohen jashtë orarit të rregullt të punës.

6.9. Me lejen e Ministrisë, komunat mund të sigurojnë bashkërisht shërbime specialistike ose shërbime të tjera sociale dhe familjare në territoret e tyre.

Roli i Qendrës për Punë Sociale Neni 7

7.1. Secila komunë themelon një Qendër për Punë Sociale si institucion publik që do të ketë një ose më shumë degë (në tekstin e mëposhtëm: QPS) dhe personel të përbërë nga profesionistët me trajnime dhe kualifikime përkatëse - *Zyrtar i shërbimeve sociale* sipas pikës 1.3 i të këtij ligji. QPS është përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave që ia jep ky ligj.

7.2. Qendra për punë sociale formon organin e kujdestarisë dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Kosovës.

7.2.a. Organi i kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar që të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve dhe të rriturve në nevojë sociale, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmarrë veprime të tjera ligjore.

7.2.b. Gjykata, fton Organin e Kujdestarisë që të marrë pjesë në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet.

7.3. Drejtori i QPS-së zgjedhet nga komuna me anë të konkursit publik sipas Ligjit të shërbimit civil. Kandidatët për këtë post duhet kenë së paku tri vjet përvojë pune si Zyrtar i shërbimeve sociale siç është përcaktuar në pikën 1.3. i të këtij ligji.

7.4. Drejtori i QPS-së i jep llogari komunës për përdorimin në mënyre të efektshme dhe të dobishme të resurseve të akorduara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

7.5. Drejtori i QPS-së i jep llogari Ministrisë për mbajtjen në nivel të standardeve të praktikës profesionale dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisve të përcaktuara me këtë ligj.

7.6. QPS-ja është e obliguar të bëjë vlerësime profesionale për secilin individ ose familje që jeton ose gjendet në territorin e saj e që kërkon ndihmë prej saj ose në ndonjë mënyrë tjetër mësohet apo shihet se ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare.

7.7. Nëse vlerësimi profesional tregon se një individ ose një familje ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare, QPS-ja, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante, përfshirë edhe përkrahjen nga familja nëse ka familje dhe resurse të përshtatshme në dispozicion, të ofrojë shërbimet që i konsideron të përshtatshme.

7.8. Çdo QPS duhet të ketë këshillin e ekspertëve, i cili përbëhet nga të gjithë Zyrtar i shërbimeve sociale të punësuar në të.

7.9. Këshilli i ekspertëve shqyrton dhe drejtorit i jep mendime e propozime për çështjet që kanë të bëjnë me:

- a. punën profesionale dhe aktivitetet specifike brenda QPS-së të përcaktuara me ligj dhe rregullore,
- b. organizimin e QPS-së dhe degëve të saj,
- c. vështirësitë në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara profesionale dhe ushtrimin e të drejtave dhe aktiviteteve tjera të QPS-së në rastet më të rënda individuale,
- d. nevojën për arsimim shtesë profesional,
- e. gjëra të tjera të mbuluara me këtë ligj.

Roli i sektorit joqeveritar Neni 8

8.1. Personat juridikë, që nuk janë në sektorin qeveritar, duke përfshirë ndërmarrjet, organizatat dhe shoqatat vullnetare, organizatat fetare, grupet për vetë ndihmë dhe organizatat e tjera lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare janë të inkurajuar të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, qoftë me nismën e tyre ose me kontratë, në emër të drejtoratit komunal në rastin e shërbimeve lokale, ose në emër të Ministrisë në rastin e shërbimeve në nivel të Republikës së Kosovës.

8.2. Për të mundësuar këtë, komunat dhe Ministria përmes departamentit përkatës u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave joqeveritare që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla.

8.3. Çdo organizatë joqeveritare që ofron shërbime sociale dhe familjare duhet të regjistrohet pranë organit përkatës dhe të licencohet nga Ministria përmes departamentit përkatës, si edhe t'u përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave lidhur me aktivitetet e tyre siç përcaktohen nga Ministria.

8.4. Komunat mund të hyjnë në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e saj.

8.5. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale mund të japë fonde dhe të ofrojë çfarëdo ndihme tjetër materiale, duke përfshirë lokalet, ose këshillat për organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare në nivel të Republikës së Kosovës përmes procedurave të komisionimit dhe kontraktimit.

Shërbimet për Fëmijë dhe Familje Neni 9

9.1. Në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.

9.2. Në bashkëpunim me familjet, komunitetin, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të caktuara me ligj, komunat ofrojnë përkujdesje sociale, këshillim social dhe, në rrethana të jashtëzakonshme, asistencë materiale për fëmijët dhe familjet e tyre të cilët janë në nevojë dhe jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për këto shërbime dhe aftësinë e komunës që t'i plotësojë ato në mënyrë të arsyeshme.

9.3. Qendra për punë sociale ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare sepse:

- a. ai ose ajo është pa përkujdesje prindore;
- b. prindi ose prindërit e tij, ose ndonjë përkujdesës tjetër, për shkak të mënyrës së jetesës, paaftësisë ose sëmundjes fizike ose mendore, problemeve psiko-sociale, varësisë ose arsyeve të tjera, kanë vështirësi në ofrimin e nivelit adekuat të përkujdesjes dhe mbikëqyrjes për të;

- c. ai ose ajo ka aftësi të kufizuar ose sëmundje mendore;
- d. ai ose ajo ka aftësi të kufizuar ose sëmundje fizike;
- e. ai ose ajo kanë vështirësi në sjellje;
- f. ai ose ajo janë delikuent;
- g. ai ose ajo janë duke vuajtur si pasojë e konfliktit familjar;
- h. ai ose ajo kanë ndonjë formë tjetër të problemit psiko-social që i bën ata persona në nevojë.

9.4. Qendra për punë sociale mban një regjistër të familjeve dhe të fëmijëve në nevojë të cilët jetojnë në territorin e saj, nuk gëzojnë përkrahje nga familja ose komuniteti ose kanë vështirësi që të përkujdesen për fëmijët e tyre, ose kur fëmija është në rrezik ngase lihet pas dore, shfrytëzohet, abuzohet ose në çfarëdo forme tjetër dëmtohet. Qendra për punë sociale cakton vizita të rregullta për ato familje në nevojë që gjenden në regjistrin për shërbime sociale dhe familjare nga një person përgjegjës, në mënyrë që të krijohet siguria dhe mirëqenia e fëmijës dhe t'i sigurohet familjes çfarëdo shërbimi që konsiderohet i arsyeshëm.

9.5. Në përmbushjen e detyrave të veta sipas Kodit për të miturit, qendra e punës sociale në rolin e organit të kujdestarisë siguron që shërbimet e ofruara në bazë të mandatit që ka janë në përputhje me obligimet që përmban Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

9.6. Në rastin kur gjykata njofton QPS-në për procedurat ndaj fëmijës dhe ai fëmijë apo familja e tij i janë të njohura, QPS-ja ka për detyrë t'i ofrojë gjykatës çfarëdo informate apo këshille me rëndësi për menaxhimin e duhur të rastit.

Mbrojtja e Fëmijëve Neni 10

10.1. Interesat më të mira të fëmijës përmbushen kur nevojat e zhvillimit të tyre fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes natyrore të tij. Të gjithë subjektet duhet të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë, mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale.

10.2. Vetëm në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se një fëmijë është duke pësuar dëm serioz në shëndetin e tij fizik ose mendor, ose është në rrezik për diçka të tillë brenda familjes së tij, mund të merret në konsideratë heqja e tij nga përkujdesja e prindit ose prindërve ose përkujdesësit tjetër të tij.

10.3. Përveç në rast të masave afatshkurtra emergjente, fëmija nuk hiqet nga përkujdesja e prindit ose prindërve ose përkujdesësve të tij pa pëlqimin e tyre apo pa urdhër të gjykatës.

10.4. Nëse një zyrtar i shërbimeve sociale ka arsye të besojë se në një rast të caktuar ekziston rrezik serioz, imediat për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e një fëmije, ai/ajo mundet sipas kompetencave që ka, të hyjë në çdo objekt banimi dhe të vendosë fëmijën në një vend të sigurt, ku do t'i ofrohet përkujdesja për një periudhë të caktuar, jo më të gjatë se shtatëdhjetë e dy orë (72).

10.5. Para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orësh, nëse Organi i Kujdestarisë nuk siguron pëlqimin e prindit/prindërve ose kujdestarit, rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Kur rrethanat e kërkojnë, gjykata mund t'i japë urdhër Organit të Kujdestarisë për vlerësim brenda një periudhe prej njëzetënjë (21) ditësh, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme.

10.6. Çdo pjesëtar i profesionit të mësuesisë, infermierisë, mjekësisë, stomatologjisë, psikologjisë ose i policisë apo profesionist tjetër që ka për detyrë përkujdesjen për fëmijët, i cili dyshon ose ka dëshmi se

një fëmijë vuan nga abuzimi fizik, seksual ose psikologjik nga ana e prindit ose përkujdesësit të tij është i obliguar me këtë ligj që t'ia raportojë çështjen drejtorit të qendrës përkatëse të punës sociale. Dështimi që të veprohet kësaj nga ana e secilit nga grupet e lartpërmendura i nënshtrohet ndjekjes penale.

10.7. Kur një qendër për punë sociale bëhet me dije se ka arsye për të dyshuar se një fëmijë që jeton ose gjendet në territorin e saj, është i braktisur ose bonjak ose duke vuajtur ose i kërcënuar nga çfarëdo forme e dhunës fizike apo mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore ose trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, duke përfshirë abuzimin seksual, përderisa është nën përkujdesjen e prindit(ërve) ose çfarëdo personi tjetër që kujdeset për fëmijën, qendra për punë sociale duhet të marrë çdo hap të nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së fëmijës, të raportojë brenda 24 orësh çështjen tek departamenti përkatës dhe të zhvillojë vlerësim gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për mbrojtje.

10.8. Në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se fëmija është jashtë kontrollit të prindërve të tij ose personave që kanë përgjegjësinë për t'u kujdesur për të, në përmasat sa sjellja e tyre dhe mënyra e tyre e jetesës paraqet rrezik serioz për mirëqenien, shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të të tjerëve, atëherë Organi i Kujdestarisë i qendrës për punë sociale duhet të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës profesional për nevojat e fëmijës për shërbime sociale dhe familjare.

10.9. Është detyrë e çdo profesionisti që ka pasur kontakt me fëmijën, i cili i nënshtrohet vlerësimit gjithëpërfshirës profesional nga ana e një QPS-je që të bashkëpunojë dhe të asistojë gjatë vlerësimit kur është e mundur.

10.10. Kur dyshohet në abuzimin e ndonjë fëmije, organet për zbatimin e ligjit kanë për detyrë që t'i ndihmojnë qendrës për punë sociale në vlerësimin e saj gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për shërbime sociale dhe familjare dhe të zhvillojë hetimet e veta kriminale nëse rrethanat e arsyetojnë këtë.

10.11. Pas përfundimit të vlerësimit gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për shërbime sociale dhe familjare, QPS-ja dërgon pa vonesë brenda njëzetekatër (24) orëve, njoftimin në drejtorinë përkatëse komunale. Nëse Organi i Kujdestarisë i QPS-së konsideron se ka arsye për të kërkuar masa mbrojtëse, ka për detyrë që çështjen ta dërgojë para gjykatës, me qëllim që gjykata të nxjerrë vendim për formën e mbrojtjes.

10.12. Organi i kujdestarisë, mund të parashtrojë kërkesën për një urdhër për vlerësim, deri në njëzetën (21) ditë.

10.13. Me rastin e parashtimit të kërkesës për urdhër vlerësimi Organi i Kujdestarisë duhet të paraqesë dëshmi para gjykatës se vlerësimi i përligjur i nevojave të fëmijës nuk ka qenë e mundur të bëhet pa një autorizim të tillë.

10.14. Me rastin e parashtimit të kërkesës për formën e mbrojtjes, Organi i Kujdestarisë duhet t'i vërtetojë gjykatës vlerësimin e tij se fëmija ka nevojë për mbrojtje nga gjykata dhe se të gjitha alternativat e arsyeshme janë marrë në konsideratë para se të shtrohet çështja në gjykatë.

10.15. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për formën e mbrojtjes gjykata do t'u kushtojë rëndësi të veçantë:

- a. dëshirave dhe ndjenjave të verifikuara të fëmijës në fjalë,
- b. nevojave fizike, emocionale dhe arsimore të tij,
- c. efektit të pritshëm në të për shkak të ndryshimit të cilësdo rrethanë të tij,
- d. moshës, gjinisë, prejardhjes së tij dhe çfarëdo karakteristike që ai/ajo mund ta ketë e që gjykata e konsideron relevante,

- e. çfarëdo dëmtimi që ka pësuar ose është në rrezik ta pësojë fëmija,
- f. sa është i aftë secili nga prindërit e fëmijës, dhe çdo person tjetër lidhur me të cilin gjykata e konsideron këtë çështje relevante për plotësimin e nevojave të tij,
- g. përmasat e kompetencave në dispozicion të gjykatës për t'u marrë në mënyrë adekuate me rastin.

10.16. Nëse gjykata konsideron se fëmija ka nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje, është e autorizuar të nxjerrë një urdhër kujdestarie në lidhje me fëmijën. Gjukata duhet të cekë kushtet e urdhrit që vlejnjë për secilin rast individual.

10.17. Opsionet që i ka gjykata në dispozicion në suaza të formës së mbrojtjes janë:

- a. mbikëqyrja e fëmijës dhe kushteve të tij të jetesës nga zyrtari i shërbimeve sociale, përderisa është nën përkujdesje të prindit/ve ose kujdestarit.
- b. të drejtat e kujdestarisë të ndara në mes prindit(ërve) ose kujdestari dhe QPS-ja,
- c. të drejtat e kujdestarisë të bartura tek QPS-ja, gjersa fëmija vazhdon të qëndrojë në shtëpi,
- d. të drejtat e kujdestarisë të bartura te QPS-ja me kërkesë që përkujdesja për fëmijën të bëhet larg prindit(ve) ose kujdestari të tij,
- e. nëse fëmija nuk jeton me prindërit e tij, duhet të bëhen përgatitjet dhe marrëveshjet që fëmija të ketë qasje tek prindi(rit) ose kujdestari e tij,
- f. kohëzgjatjen sa do të jetë fuqi urdhri para se të merret në rishqyrtim.

1.18. Organi i Kujdestarisë siguron përmbushjen e kërkesave dhe kushteve të vendimit për formën e mbrojtjes.

10.19. Prindërit ose kujdestari, fëmija i të cilëve është subjekt i vendim për formën e mbrojtjes ndihmohen nga qendra për punë sociale, ku është e mundshme, që t'i ndryshojnë rrethanat e tyre në mënyrë që t'u mundësohet rimarrja e të drejtave dhe përgjegjësive prindore.

10.20. Në rastet kur fëmijëve iu është shqiptuar vendimi për formën e mbrojtjes, Qendra për Punë Sociale do ta shqyrtoj, deri në atë masë sa forma e mbrojtjes nuk është më e nevojshme ose e përshtatshme. Organi i Kujdestarisë, për tërheqjen e saj, duhet të parashtroj kërkesë para gjykatës.

Format alternative të përkujdesjes për Fëmijët Neni 11

11.1. Organi i Kujdestarisë ka për detyrë të përkujdeset dhe është i obliguar të veprojë çdoherë si prind i mirë ndaj një fëmije:

- a. bonjak pa të dy prindërit,
- b. që është dhënë për adoptim nga prindi ose prindërit e tij,
- c. që është braktisur,
- d. të cilit nuk i dihen prindërit,
- e. që i është dhënë qendrës për punë sociale në përkujdesje të përkohshme nga prindi ose prindërit e tij,
- f. që i është dhënë për përkujdesje Qendrës për Punë Sociale nga ana e gjykatës.

11.2. Nëse një fëmijë është jetim, pa të dy prindërit dhe i jepet përkujdesje adekuate nga një individ ose familje e cila nuk ka lidhje farefisnore me të, atëherë Organi i Kujdestarisë në territorin ku jeton fëmija, merr masa që kjo situatë të rregullohet nëpërmjet formës së mbrojtjes. Në këto rrethana, departamenti përkatës, duhet të paguajë ndihma financiare që janë adekuate për përkujdesjen dhe mbajtjen e fëmijës.

11.3. Në rastet kur prindërit e fëmijës janë të panjohur, kur prindërit e kanë dhënë pëlqimin për braktisje, ose kur prindi është vazhdimisht i paaftë për të siguruar kujdes të nevojshëm për mirëritjen e fëmijës, për shkak të sëmundjes së rëndë psikike të diagnostifikuar apo paaftësisë së rëndë psikike të diagnostifikuar, Organi i Kujdestarisë merr masa për sigurimin e përkujdesjes adekuate afatgjate për fëmijën.

11.4.a. Në raste të veçanta, me kërkesën e prindit, prindërve apo kujdestarit, nga QPS, fëmija mund të vendoset në një vend tjetër jashtë shtëpisë me qëllim që atij ti ofrohet përkujdesje sociale më e mirë sipas vlerësimit profesional dhe nevojës së fëmijut të bërë nga Organi i Kujdestarisë.

11.4.b. Për vendosjen e fëmijës në një vend tjetër jashtë shtëpisë, duhet të bëhet vlerësimi profesional sipas nevojës së fëmijut, është konsultuar fëmija dhe dëshirat e tij janë marrë në konsideratë.

11.4.c. Në rrethanat kur prindi/prindërit mbajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre prindore, me kërkesën e tyre mund ta kthejnë fëmijën në shtëpi, pas vlerësimit nga Organi i Kujdestarisë.

11.5. Në asnjë rrethanë fëmija që merret në përkujdesje nga Organi i Kujdestarisë sipas pikës së mësipërme 10.4, nuk vendoset në një institucion ndëshkimor.

11.6. Sa i përket fëmijës që i është besuar nga gjykata Organit të Kujdestarisë për përkujdesje, gjykatësi specifikon formën e mbrojtjes dhe kushtet sipas të cilave Organi i Kujdestarisë ushtron këtë përgjegjësi.

11.7. Në mënyrë që të ushtrojë përgjegjësitë e tij për fëmijët që merren në përkujdesje të tij Organi i Kujdestarisë siguron, sipas nevojave të secilit fëmijë individual, përkujdesje rezidenciale, strehim familjar ose vendosje në adoptim.

11.8. Me qëllim që ta ndihmojë Organi i Kujdestarisë në organizimin dhe mbikëqyrjen e përkujdesjes së fëmijëve për të cilët ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë, Ministria përmes departamentit përkatës emëron një panel për vendosje të fëmijëve.

11.9. Ky panel ka funksionet vijuese:

- a. jep mendim për përshtatshmërinë e prindërve strehues familjar;
- b. jep mendim për vendosjen e fëmijëve me prindërit strehues familja;
- c. jep mendim për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe përshtatshmërinë e familjeve potenciale adoptuese.

11.10. Paneli për vendosjen e fëmijëve drejtohet nga drejtori i Departamentit përkatës ose nga një person tjetër i caktuar nga ai dhe ka shtatë anëtarë të emëruar nga Departamenti përkatës në bazë të ekspertizës dhe përvojës së tyre relevante profesionale.

11.11. Departamenti përkatës mban një regjistër unik të prindërve strehues familjar në Kosovë.

11.12. Prindërit potencial të strehimit familjar vlerësohen nga Zyrtari i Shërbimeve Sociale i QPS-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë dhe raportet e tyre merren në shqyrtim nga Paneli për Vendosjen e Fëmijëve, i cili vendos për përfshirjen e tyre në regjistër.

- 11.13. Mendimi në lidhje me vendosjen e fëmijëve individualë me prindërit strehues familjarë merren nga paneli i lartpërmendur pas shqyrtimit të nevojave dhe rrethanave të fëmijës dhe përshtatshmërisë së prindërve strehues familjarë që t'i plotësojnë ato.
- 11.14. Fëmija me përparësi vendoset vetëm në një familje, e cila me familjen e tij ka të përbashkët prejardhjen etnike, gjuhësore, kulturore dhe religjioze.
- 11.15. Qendra për Punë Sociale kompetente obligohet që ta vizitojë fëmijën së paku një herë në muaj, në mënyrë që të sigurohet se atij/asaj i ofrohet përkujdesje adekuate dhe t'u japë prindërve strehues familjarë çfarëdo këshille ose udhëzimi të dobishëm për përkujdesjen e fëmijës.
- 11.16. Të gjitha vendimet ose pëlqimet e rëndësishme lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës në strehim familjar merren nga Qendra për Punë Sociale kompetente për mbrojtjen e fëmijës, pas konsultimit me prindërit biologjik të fëmijës nëse kjo është e mundur, ose kujdestarin e fëmijës.
- 11.17. Në rast të vendosjes së pasuksesshme ose të papërshtatshme, paneli mund të urdhërojë heqjen e fëmijës nga përkujdesja e prindërve që e kanë marrë në strehim familjar.
- 11.18. Kur prindërit strehues familjarë konsiderohen në përgjithësi të papërshtatshëm për këtë detyrë, ata mund të hiqen nga regjistri nga ana e panelit.
- 11.19. Nëse, gjatë strehimit familjar, një fëmijë lëndohet rëndë ose vdes, është detyrë e Ministrisë që të inicioi zhvillimin e hetimeve mbi rrethanat dhe të ndërmarrë çdo masë të nevojshme pasuese.
- 11.20. Departamenti drejtoria përkatëse e Komunës obligohet të sigurojë që fëmijët nën përkujdesje të tij të jenë në mënyrë adekuate të përkujdesur materialisht. Për këtë do t'u japë prindërve strehues familjarë ndihma adekuate financiare për mbajtjen e fëmijës i cili është vendosur tek ata dhe, kur është e nevojshme, të mbulojë çdo shpenzim shtesë, duke përfshirë edhe shpenzimet mjekësore.
- 11.21. Departamenti përkatës, përmes panelit për vendosje të fëmijëve, është organi i vetëm në Kosovë përgjegjës për hartimin e regjistrave të prindërve potencialë adoptues dhe vendosjen e fëmijëve në familjet e propozuara nga QPS-të.
- 11.21.a. Familja e interesuar për adoptim të fëmijës pa kujdes prindëror, kërkesën duhet ta paraqesë në gjykatë, ndërsa gjykata kërkesën i'a dërgon Qendrës për Punë Sociale për të dhënë vlerësimin profesional për familjen.
- 11.21.b. Pas vlerësimit profesional pozitiv QPS-ja e njofton me shkrim gjykatën dhe familja evidentohet në Regjistrin për Panel të familjeve potenciale për adoptim, ndërsa për familjen e vlerësuar negativisht lëndën do ta dërgojë për vendim në gjykatë.
- 11.21.c. Përparësi për adoptimin e fëmijës, ka çifti bashkëshortor.
- 11.21.d. Interesi më i mirë i fëmijës ruhet nëse dallimi në moshë në mes të të adoptuarit dhe adoptuesit nuk është më e madhe se mosha pesëdhjetë (50) vjeç.
- 11.22. Çdo person i cili organizon adoptim në kundërshtim të dispozitave nga ky ligj ose tenton që ta bëjë këtë, ndëshkohet për vepër penale.
- 11.23. Çdo profesionist që ushtron presion të papërbalueshëm ndaj një prindi ose prindërve për ta dhënë fëmijën e tyre për adoptim, konsiderohet fajtor për shkelje flagrante profesionale dhe i nënshtrohet ndjekjes penale.
- 11.24. Paneli për vendosjen e fëmijëve mban një regjistër të personave të cilët Organi i Kujdestarisë i miraton si prindër adoptues, pas shqyrtimit të vlerësimeve dhe kërkimeve të bëra.

11.24.a. Organi i Kujdestarisë para se të dërgojë lëndën në gjykatë me propozimin për adoptimin e fëmijës, obligohet që paraprakisht të marrë mendimin e Panelit.

11.24.b. Adoptues mund të jetë vetëm qytetari i Republikës së Kosovës. Përjashtimisht, shtetasi/ banori i huaj mund të jetë palë adoptuese, nëse fëmija nuk mund të adoptohet ose të birësohet në Republikën e Kosovës dhe/ose ekzistojnë arsye të bazuara për veprimin e tillë, nëse fëmija ka nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar që nuk mund të i ofrohet në Republikën e Kosovës. Për adoptimin e fëmijës nga shtetasi i huaj nevojitet pëlqimi paraprak i Panelit.

11.25. Në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve të cilët mund të jenë subjekt i kërkesave për adoptim nga njerëzit që jetojnë jashtë Kosovës, paneli për vendosjen e fëmijëve ka detyrat vijuese:

- a. të sigurojë se ka përputhshmëri me kërkesat e Konventës së Hagës mbi të Drejtën Private, Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Lidhje me Adoptimin Ndërshtetëror,
- b. të vendosë dhe të zhvillojë marrëdhënie bashkëpunimi me organet përkatëse për adoptim në vendet pranuese potenciale,
- c. të vendosë kriteret që duhen zbatuar për adoptim ndërshtetëror,
- d. të mundësojë procedurat e nevojshme ligjore për kryerjen e adoptimit ndërshtetëror siç përcaktohet nga Konventa e Hagës.

11.26. Ministria, nxjerr akt nënligjor për përbërjen dhe funksionimin e Panelit për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar dhe adoptim.

11.27. Ministria, nxjerr akt nënligjor për rregullimin e strehimit familjar në Republikën e Kosovës.

Neni 11.A

Mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale

11.A.1. Mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale bëhet nga ana e Organit të Kujdestarisë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare që kanë ekspertizë profesionale për trajtimin e kësaj kategorie.

11.A.2. Në procedurën e trajtimit dhe të mbrojtjes, interesi më i mirë i fëmijës është konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.

11.A.3. Mbrojtja e fëmijëve të kësaj kategorie përfshinë të gjithë fëmijët nën moshën katërmëdhjetë (14) vjeçare të cilët bien ndesh me legjislacionin në fuqi, kundër të cilëve nuk mund të zhvillohet procedura penale dhe ku si përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve, është Organi i Kujdestarisë apo organizatat joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime të veçanta për mbrojtjen e interesave të fëmijëve.

11.A.4. Për të gjithë fëmijët kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale, pas njoftimit nga prokurori, Organi i Kujdestarisë përgjegjës sipas kompetencës territoriale, ofron mbrojtjen dhe trajtimin adekuat.

11.A.5. Pas njoftimit nga prokurori, për kryerjen e veprës penale të fëmijës, Organi i Kujdestarisë cakton menaxherin e rastit për secilin rast të referuar.

11.A.6. Pas vlerësimit të rastit menaxheri mund të krijojë partneritet me organizatat qeveritare dhe joqeveritare, institucionet shkollore, shëndetësore, policore, me familjen dhe komunitetin, në mënyrë që të krijohen mundësi sa më të mira për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës.

Neni 11.B

Mbrojtja dhe trajtimi i fëmijëve me sjellje asociale

11.B.1. Mbrojtja e fëmijëve me sjellje asociale bëhet nga ana e organit të kujdestarisë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare që kanë ekspertizë profesionale për trajtimin e kësaj kategorie.

11.B.2. Për fëmijët me sjellje asociale, pas referimit në QPS-ë nga familja, shkolla, komuniteti, institucioni shëndetësor, shërbimi sprovues, policia, OJQ-të, etj. Organi i Kujdestarisë përgjegjës sipas kompetencës territoriale, ofron mbrojtje dhe trajtim adekuat në përputhje me legjislacioni në fuqi.

11.B.3. Pas referimit nga subjektet e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, Organi i Kujdestarisë cakton menaxherin e rastit për secilin rast të referuar.

11.B.4. Pas vlerësimit të rastit, menaxheri mund të krijojë partneritet me organizatat qeveritare, institucionet shkollore, shëndetësore, policore, me familjen dhe komunitetin, në mënyrë që të krijohen mundësi sa më të mira për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës.

Shërbimet për të rriturit Neni 12

12.1. Në bashkëpunim me familjet, komunitetet, organizatat joqeveritare dhe organet tjera të parashikuara me ligj, komuna ofron përkujdesje sociale, këshillim dhe, në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit që kanë nevojë për shërbime sociale e që jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për shërbime të tilla dhe në mundësinë e komunës që t'i kryejë ato në mënyrë të arsyeshme.

12.2. Ministria ka përgjegjësinë për themelimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve rezidenciale, strehimoreve të mbrojtura dhe strehimoreve emergjente për njerëzit në nevojë në Kosovë.

12.3. Asnjë komunë ose organizatë joqeveritare nuk mund të themelojë një objekt rezidencial për njerëzit në nevojë pa lejen e Ministrisë.

12.3.a. Ministria ofron përkujdesje për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara mendore, ngecje në zhvillim mendor, në rastet kur ata nuk kanë persona të tjerë në gjini të cilët sipas ligjit janë të detyruar të kujdesen për ta.

12.3.b. Fëmijët mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare kanë për detyrim të japin përkrahje financiare dhe ofrim të përkujdesjes për prindërit e tyre, nëse ata nuk janë të aftë për punë dhe nuk kanë të ardhura minimale për të jetuar dhe kanë nevojë për përkujdesje.

12.3.c. Ofrimi i shërbimeve dhe përkujdesjes për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara mendore, ngecje në zhvillim mendor, nga ana e institucioneve përkatëse, mund të ofrohen edhe me participim nga të afërmit apo personat e tjerë në gjini, të cilët janë të obliguar të kujdesen për ta.

12.3.d. Për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara mendore, ngecje në zhvillim mendor, ofrohen shërbime edhe në komunitet-shtëpi të personit në gjendje të nevojës sociale, për të dy kategoritë, për ata që nuk kanë persona tjerë në gjini dhe për personat që kanë persona në gjini, por që dëshirojnë t'i blejnë shërbimet.

12.4. Komunat mund të sigurojnë ndihma financiare ose ndihmë tjetër për njerëzit në nevojë, ose për ata që kujdesen për nevojtarët që dëshirojnë të bashkohen për të formuar grupe për ndihmë reciproke, vetë ndihmë dhe vetë përkrahje.

12.5. Qendrat për punë sociale, me kërkesën e nevojtarëve, mban një regjistër të njerëzve në nevojë që jetojnë në territorin e tyre, të cilëve iu mungon përkrahja nga familja ose komuniteti dhe kanë vështirësi për të mbajtur veten e tyre, ose janë në rrezik ngase lihen pas dore, shfrytëzohen apo abuzohen nga të tjerët ose janë të kërcënuar nga çfarëdo forme tjetër e dëmtimit. Qendra për punë sociale për njerëzit në

nevojë që janë në regjistër cakton vizita të rregullta nga një person përgjegjës, në mënyrë që të monitorohet siguria dhe mirëqenia e tyre.

12.6. Ministria, nxjerr akt nënligjor për rregullimin e procedurave për kategoritë e lartpërmendura të këtij neni.

Mbrojtja e të rriturve në rrezik Neni 13

13.1. Në rastet kur një QPS vihet në dijeni se ka dëshmi se një i rritur nuk është në gjendje të përkujdeset për veten për arsye të aftësive të kufizuara mendore ose është i lënë pas dore, i shfrytëzuar ose abuzuar nga të tjerët për shkak të moshës, dobësisë ose aftësisë së kufizuar fizike ose mendore, frikës se ata do ta dëmtojnë, ose për shkak të faktorëve të tjerë është i rrezikuar deri në atë masë sa që i mungon zotësia që të veprojë në emër të vet, drejtori i qendrës për punë sociale në territorin ku ai/ajo jeton ose gjendet, duhet të ndërmarrë pa vonesë të gjitha hapat e nevojshëm për sigurinë e tij.

13.2. Nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, Qendra për Punë Sociale duhet të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për një urdhër kujdestarie.

13.3. Para dhënies së urdhrimit të kujdestarisë, gjykatësi duhet të bindet se ka arsye të mjaftueshme për të arsyetuar një masë të tillë, sepse për shkak të paaftësisë mendore ose fizike nga subjekti i kërkesës nuk mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të veprojë në emër të vet.

13.4. Një urdhër i tillë specifikon hapat që Qendra për Punë Sociale është kompetent t'i ndërmarrë në mënyrë që të mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e personit për të cilin jepet urdhri. Kompetencat që i ka gjykata në dispozicion janë:

- a. Mbikëqyrja e rrethanave të jetesës të të rriturit të rrezikuar nga ana e një profesionisti të caktuar nga Qendra për Punë Sociale për këtë qëllim, gjersa ai/ajo qëndron në shtëpinë e tij;
- b. Urdhëresa për Qendrën për Punë Sociale për të vendosur të rriturin, i cili mendërisht nuk është i aftë për t'u kujdesur për veten në një objekt të përshtatshëm rezidencial;
- c. Urdhëresa për palët e treta që të ndërprejnë kontaktet me të rriturin e rrezikuar i cili është subjekt i urdhrimit të kujdestarisë;
- d. Specifikimi i kohëzgjatjes sa do të jetë urdhri në fuqi para se të skadojë ose të rishikohet.

13.5. Personi i cili është subjekt i një urdhri kujdestarie nuk mund të mbahet asesi në një institucion ndëshkimor.

13.6. Nëse është e nevojshme, gjykatat mund të urdhërojnë Shërbimin Policor të Kosovës që ta ndihmojë qendrën për punë sociale në zbatimin e urdhrimit të kujdestarisë.

13.7. Qendra për Punë Sociale siguron që të përmbushen kushtet e urdhrimit të kujdestarisë.

13.8. Qendra për Punë Sociale, paraqet kërkesën për tërheqjen e urdhrimit të kujdestarisë sapo të pushojë së ekzistuari nevoja për të.

13.9. Kur ka shqetësim të arsyeshëm për rrezikun imediat të dëmtimit serioz të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së një të rrituri të rrezikuar dhe ekzistojnë dëshmi se atij i mungon aftësia fizike ose mendore që të veprojë në emër të tij, punëtori social i Qendrës për Punë Sociale në bazë të vlerësimit të tij mundet t'i parashtrijë gjykatës një kërkesë për një urdhër për mbrojtje emergjente.

13.10. Para se të japë urdhrin për mbrojtje emergjente, gjykatësi duhet të bindet se ka dëshmi të mjaftueshme prima facia për të arsyetuar një masë të tillë dhe ka baza të arsyeshme që të besohet se, për shkak të paaftësisë fizike dhe mendore, frikës, kërcënimit ose ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, nuk mund të pritët që subjekti i kërkesës që të veprojë në emër të vet në mënyrë të arsyeshme.

13.11. Efekti i urdhrin për mbrojtje emergjente është që të lejojë Zyrtarin e shërbimeve sociale të Qendrës për Punë Sociale i cili ka parashtuar kërkesën, të hyjë në çdo hapësirë banimi dhe ta sjellë subjektin e urdhrin në një vend të sigurt ku mund të mbrohet nga rreziku dhe ku mund të vlerësohen nevojat mjekësore, sociale dhe psikologjike të tij. Gjykatësi i cili jep urdhrin emergjent mund të urdhërojë policinë, personelin mjekësor, ose që të dy bashkë, që ta shoqërojnë Zyrtarin e shërbimeve sociale të Qendrës për Punë Sociale, të ndihmojnë në zbatimin e urdhrin për mbrojtje emergjente. Kushdo që pengon Zyrtarin e shërbimeve sociale në ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, bën vepër penale sipas legjislacionit në fuqi.

13.12. Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje emergjente caktohet nga gjykata.

13.13. Një i rritur i rrezikuar, i cili është subjekt i urdhrin për mbrojtje emergjente dhe i cili ka aftësi mendore për të shprehur gjykimin e tij, është i lirë të refuzojë që të shkojë në vend të sigurt ose të largohet në çdo kohë nga vendi i sigurt në të cilin është sjellë dhe me këtë urdhri automatikisht skadon.

Këshilla Ekspertësh për Gjykatat Neni 14

14.1. Në rastet kur një gjykatë merret me fëmijë gjatë seancave penale ose civile, duke përfshirë, por pa u kufizuar me seancat e drejtësisë për të mitur, dhe rastet e besimit të fëmijëve, ose në rastet kur është involvuar mirëqenia e një të rrituri të rrezikuar, gjykata duhet të kërkojë nga qendra për punë sociale zhvillimin e hetimeve dhe ofrimin e vlerësimit profesional të rrethanave sociale të personit në fjalë dhe të bëjë rekomandime për mirëqenien e tij të ardhshme.

14.2. Me marrjen e kërkesës së tillë nga gjykata, Qendra përkatëse për punë sociale urdhëron fillimin e një hetimi të tillë nga ana e një zyrtari të shërbimeve sociale të miratuar për këtë destinim dhe i siguron gjykatës raportin e kërkuar. Raportet e tilla duhet t'i dorëzohen gjykatës jo më vonë se 21 ditë pas bërjes së kërkesës, përveç nëse në kërkesë nuk është përcaktuar ndryshe.

14.3. Gjykata nuk merr vendim përfundimtar në një rast ku nevojitet raporti i tillë derisa nuk i ka vlerësuar se duhet përmbajtjen dhe rekomandimet e tij.

Procedurat ankimore Neni 14.A

14.A.1. Çdo palë e pakënaqur ose përfaqësuesi i tij, i cili mendon se i është bërë e padrejtë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare, ka të drejtë në rishikimin e kërkesës nga ana e drejtorit të QPS-së si dhe në ankesë në shkallë të dytë, pranë komisionit përkatës.

14.A.2. Drejtori i QPS-së, pas pranimit të kërkesës për rishikim të rastit, obligohet t'i kthejë përgjigje me shkrim në afat ligjor palës së interesuar, duke mos ia humbur afatin e ankesës në shkallë të dytë.

14.A.3. Pala e pakënaqur me vendimin e drejtorit të QPS-së mund të ushtrojë ankesë në komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave dhe parashtrësve në shkallë të dytë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së pranimit të aktvendimit.

14.A.4. Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave funksionon pranë departamentit përkatës në MPMS-ë.

14.A.5. Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave dhe parashtresave në shkallë të dytë përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Kryetari i komisionit caktohet sipas pozitës zyrtare, një (1) anëtar nga komuna, një (1) anëtar nga QPS-ja, ndërsa dy (2) anëtarë të tjerë caktohen nga departamenti përkatës. Vendimi është i plotfuqishëm me aprovimin/refuzimin e tre (3) anëtarëve të komisionit përkatës.

14.A.6. Vendimi i komisionit për shqyrtimin, vendosjen e ankesave dhe parashtresave në shkallë të dytë për shërbime sociale dhe familjare, nënshkruhen nga kryetari i komisionit.

14.A.7. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, komisioni shqyrton ankesën dhe dokumentacionin relevant dhe sipas nevojës interviston dëshmitarët. Vendimet e veta ua përcjell me shkrim palëve të ankesës përmes QPS-së.

14.A.8. Pala e pakënaqur mund të ngritë kontest administrativ, përmes padisë në gjykatën kompetente, në afat prej tridhjetë (30) ditësh kundër vendimit të komisionit të shkallës së dytë.

14.A.9. Ministria nxjerr akt nënligjor për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave dhe parashtresave në shkallë të dytë.

Dispozitat të tjera Neni 15

15.1. I gjithë komunikimi verbal, i shkruar ose elektronik lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në mes të një individi ose një familjeje që shfrytëzon shërbime të tilla dhe profesionistit të shërbimeve sociale dhe familjare, trajtohen me mirëbesim.

15.2. Çdo profesionist i shërbimeve sociale dhe familjare duhet që të gjitha informacionet për rastet e trajtuara të jenë konfidenciale, në të kundërtën është përgjegjës për shkelje flagrante profesionale dhe i nënshtrohet ndjekjes penale.

15.2.a. Çdo profesionist i shërbimeve sociale dhe familjare është i obliguar që ta respektojë Kodin etik të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të Republikës së Kosovës.

15.3. Çdo person ose përfaqësues i çdo personi, i cili beson se është diskriminuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme ose për arsye tjera i janë mohuar shërbimet adekuate sociale dhe familjare, ka të drejtën që të ankohe.

15.4. Në rastet kur një individ ose një familje janë të pakënaqur me vendimin e nëpunësit të shërbimeve sociale në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ose refuzimin e ofrimit të shërbimeve të tilla ose me cilësinë e shërbimit të ofruar, mund të kërkojnë që drejtori i QPS-së përkatëse të rishqyrtojë rastin e tyre.

15.5. Drejtori i QPS-së rishqyrton rastin brenda shtatë ditëve prej pranimit të kërkesës së tillë dhe ankuesit do t'ia japë përfundimet e tij me shkrim.

15.6. Nëse ankuesi është i pakënaqur me përgjigjen e drejtorit, mund të ankohe zyrtarisht tek Departamenti.

15.7. Departamenti i Mirëqenies Sociale krijon një komision për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare.

15.8. Komisioni për ankesa kryesohet nga drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale, ose i emëruari i tij, dhe ka katër anëtarë të tjerë, një drejtor të një QPS-je e cila nuk është e lidhur me ankesën, një përfaqësues i komunës përkatëse dhe dy persona të pavarur të emëruar nga Departamenti.

15.9. Brenda tridhjetë ditësh nga dita e marrjes së ankesës, Komisioni shqyrton ankesën dhe dokumentacionin relevant dhe sipas nevojës interviston dëshmitarët. Vendimet e veta ua përcjellë me shkrim palëve të ankesës.

15.10. Nëse ankuesi është i pakënaqur me vendimin e Komisionit për ankesa, ai mund të ankohet tek Gjykata Supreme.

15.11. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale nxjerrë rregullore, procedura, udhëzime dhe akte të tjera nënligjore lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare të cilat janë subjekt i këtij ligji.

Shfuqizimi i akteve nënligjore
Neni 15.A

15.A.1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen:

- a. Udhëzimi Administrativ nr. Nr. 1/2006 për themelimin dhe punën e këshillit të përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare;
- b. Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2006 për themelimin e komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave në shkallën e dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare;
- c. Udhëzimi Administrativ Nr. 5/2006 për themelimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim;
- d. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2004 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë; dhe
- e. Propozimië Nr.04/2005 për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2004 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë.

Nxjerrja e akteve nënligjore
Neni 15.B

15.B.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e drejtë dhe efikas të tij.

15.B.2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas paragrafit 1. të këtij neni, vazhdojnë të zbatohen aktet nënligjore të aplikueshme, të përcaktuara në nenin 15 dhe aktet e tjera të aplikueshme deri në masën që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Mundësitë buxhetore
Neni 15.C

Institucionet e ndikuara në këtë ligj, të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, i përmbushin obligimet e tyre në zbatimin e tij, sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin vjetor të Buxhetit.

Dispozitat përfundimtare
Neni 16

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr. 02/L-17
21 prill 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci

LIGJI Nr. 2003 / 15

PËR SKEMËN E NDIHMËS SOCIALE NË KOSOVË
I
NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-096
(VITI 2012)

Kuvendi i Kosovës,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 dhe me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme.

Duke marrë parasysh Shtojcën VII pjesën (xi) të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë- Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Institucioneve.

Me qëllim që të sigurohet rrjeti i sigurisë sociale në kuadrin e gjerë të mbrojtjes sociale në Kosovë dhe të lehtësohet varfëria me anë të ndihmave sociale për të varfrit dhe familjet nevojtare,

Miratton:

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet skema e ndihmës sociale në Kosovë, me qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet që janë në varfëri.

Neni 2
Përkufizimet

Sipas këtij ligji:

2.1. "Familja" përbëhet prej atyre personave nevojat e të cilëve merren parasysh me rastin e vendosjes së përzgjedhshmërisë dhe shumës së ndihmës sociale, dhe përkufizohet si një bashkësi që përbëhet prej paraqitësit të kërkesës ose marrësi të ndihmës dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët janë në bashkësi familjare: bashkëshorti/ja e tij /saj ose partnerët që jetojnë bashkë, prindërit dhe fëmijët, përfshirë fëmijët e birësuar (bijëzuar) fëmijët në strehim familjar apo fëmijët e njërit partner. Prandaj, familja mund të përbëhet nga paraqitësi i kërkesës ose marrësit të ndihmës dhe një, dy, tre a më shumë anëtarëve që jetojnë në një bashkësi familjare. Individit pa asnjë anëtar tjetër të familjes në bashkësinë familjare, sipas këtij ligji, konsiderohet një familje.

2.2. Anëtarët e familjes të cilët janë :

- i. në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç ose më të vjetër;
- ii. personat me aftësi të kufizuar, kur marrin pensionin për aftësi të kufizuar të punës, të financuar nga Buxheti i Kosovës;
- iii. fëmijët nga mosha nga një (1) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç që marrin pagesa, sipas Ligjit Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme; dhe

iv. personat të cilët janë përfitues të pensioneve, si rezultat i kontributit, sakrificës apo pasojave së luftës së UÇK-së.

v. anëtarët e familjes, sipas këtij paragrafi, të cilët janë të përfshirë në përkufizimin e familjes, nuk do të merren parasysh kur llogaritet madhësia e familjes e cila përcakton shumën e ndihmës sociale, që i duhet dhënë familjes. Përkrahim të vetëm do të bëjnë anëtarët e familjes të cilët marrin pagesë financiare sipas Ligjit për vlerat e luftës. Në rastet e tilla, anëtarët e familjes të cilët marrin pagesa sipas këtij ligji, do të llogariten si anëtarë të familjes kur të përcaktohet madhësia e familjes për pagesat e ndihmës sociale.

2.3. "Pension i aftësisë së kufizuar" nënkupton çdo pagesë të sigurisë sociale që u bëhet personave të cilët konsiderohen me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i cili drejton skemën e tillë të pagesave.

2.4. "Bashkësia familjare" përkufizohet si një grup individësh që jetojnë bashkë nën një kulm dhe që bashkarisht ndajnë shpenzimet e jetesës. Sipas këtij ligji, bashkësia familjare mund të përfshijë personat që nuk janë anëtarë të familjes .

2.5. "Jetimi" përkufizohet si fëmijë, të dy prindërit e të cilit kanë vdekur, ose që është lindur nga një prindër (vetushqyes) që ka vdekur.

2.6. "Prindi vetushqyes" përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës.

2.7. "Person i/e varur" përkufizohet si individ i cili i takon njërit prej grupeve që vijojnë:

i. Personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë(18) vjeç dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara që e bëjnë atë të paaftë për të punuar për punë shpërblyese.

ii. Personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar;

iii. Kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi përherë të kufizuara apo të personave në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeçe.

iv. Personat deri në, moshën katërmëdhjetë (14) vjeç;

v. Personat ndërmjet moshave pesëmbëdhjetë (15)dhe tetëmbëdhjetë (18) dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm;

vi. Prindërit vetushqyes me, së paku, një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

Sipas këtij ligji, personat që i takojnë çfarëdo grupi të shënuar në nën-paragrafët (i) deri në (vi) më lartë, konsiderohen të varur dhe të paaftë për punë të shpërblyeshme.

2.8. **Komisioni mjekësor** - nënkupton një grup ekspertësh mjekësor i formuar dhe i miratuar nga ministria përkatëse e punës dhe mirëqenies sociale, me qëllim të ekzaminimit dhe përcaktimit të gjendjes shëndetësore, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë të çdo personi apo anëtari të familjes, i cili është i përfshirë në realizimin e të drejtave të përcaktuara sipas këtij ligji. të çdo personi apo anëtari të familjes i cili është i përfshirë me këtë ligj.

2.9. Një person do të konsiderohet se është me të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara nëse është mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe nën moshën 65 vjeç dhe është me aftësi të kufizuara fizike

apo mendore dhe është i paaftë për punë shpërblyese. Aftësia përherë e kufizuar dhe e meta e rëndë fizike dhe mendore përkufizohet aftësia përherë e kufizuar fizike dhe mendore në shkallë jo më pak se 80%, siç është aftësia e kufizuar që e bën personin të paaftë për punë në kohën kur ai paraqet kërkesën dhe për një periudhë vijuese prej jo më pak se një vit (1).

2.10. "Verifikimi i gjendjes materiale" siç referohet në Udhëzimin Administrativ që e shoqëron këtë Ligj i referohet verifikimit të të hyrave të llogaritshme dhe të jo llogaritshme dhe të mirave materiale të llogaritshme dhe jo të llogaritshme. Verifikimi i gjendjes shërben për vlerësimin e kritereve financiare, siç parashihet në nenin 5, për llogaritjen e shumës neto të ndihmës sociale që duhet të paguhet.

2.11. "Ministria " do të thotë Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale"

2.12. I papunësuar sipas këtij ligji është anëtari i familjes i cili kërkon punë aktivisht, është i regjistruar si i papunë në Zyrën e punësimit dhe i cili ka nënshkruar deklaratën e papunësisë me Zyrën e punësimit.

2.13. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale.

2.14. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin dhe domethënien e njëjtë sikur shprehjet e përkufizuara në nenin 2 të ligjit bazik.

Neni 3

Skema e ndihmës sociale

3.1. Skema e ndihmës sociale ofron ndihmë financiare familjeve të përzgjedhshme në përputhje me kriteret e parapara në këtë ligj dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Kosovës.

3.2. Shërbimet e ndihmës sociale brenda qendrave për punë sociale, të caktuara për të administruar skemën e ndihmës sociale, menaxhohen nga udhëheqësi i shërbimit të ndihmës sociale, i cili zgjidhet nga komuna, në bashkëpunim me Ministrinë.

3.3. Udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, i përgjigjet drejtorit /drejtorisë përkatëse në komunë dhe i raporton Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

3.4. Ministria në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda të administrimit të skemës së ndihmës sociale, mund ta marrë në administrim të drejtpërdrejtë skemën e ndihmës sociale në atë komunë, për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit.

3.5. Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e proceduarve, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në skemën e ndihmës sociale është nëpunësi i skemës së ndihmës sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i shërbimit të skemës së ndihmës sociale.

Neni 4

Kriteret jo-financiare për ndihmë sociale

4.1. Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive të përcaktuara me këtë ligj.

4.2. Përfshirë, shfrytëzues të ndihmës sociale, mund të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët:

a). kanë leje qëndrimi në Kosovë;

b). personat në cilësinë e azilkërkuesit;

c). personat në cilësinë e refugjatit; dhe

d). personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese.

4.3. Për njohjen e të drejtës në ndihmë sociale si dhe përcaktimin e kushteve dhe kritereve për shtetasit e huaj, sipas paragrafit 4.2. të këtij neni, Qeveria nxjerr akt nënligjor.

4.4. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 pikën 2.7 të ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

4.5. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe :

a). me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç; apo

b). që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

4.6. Dispozita e paragrafit 4.5. do të modifikohet me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës së fëmijës gradualisht të ngritët më qëllim që ky kriter të ndryshohet, i cili do të varet nga fondet e nevojshme buxhetore të vëna në dispozicion dhe do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale.

4.7. Të gjithë anëtarët e familjes brenda kategorisë së dytë, ose duhen të jenë të varur, ashtu siç është definuar në paragrafin 2.7 të ligjit në fuqi, ose anëtari i vetëm i aftë për punë në familje, duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në Zyrën e punësimit.”

4.8. Zyra e punësimit lëshon deklaratën e papunësisë për anëtarin e vetëm të aftë për punë të familjes, në mënyrë që të bëjë certifikimin e anëtarit të familjes që aktivisht kërkon për t'u punësuar. Deklarata e papunësisë përfshin të dhënat personale, procedurat e zhvilluara për punësimin dhe trajnimin e të papunësuarit si dhe thekson përgjegjësitë dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga Zyra e punësimit dhe i papunësuarit që dëshiron të përfitojë ndihmë sociale.

4.9. Deklarata e papunësisë do të jetë e vlefshme për periudhën prej gjashtë (6) muajve, për të korresponduar me periudhën e dhënies së ndihmës sociale. Zyra e punësimit është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes për të papunësuarin për trajnim, punësim, këshillim, punë publike dhe programe tjera të punësimit. Zyra e punësimit, po ashtu është përgjegjëse për të verifikuar se kohëzgjatja për të gjetur punë nga i papunësuarit, është gjashtë (6) muaj dhe do të përfshijë masat aktive të punësimit, për të verifikuar se ato janë adekuate dhe janë ndërmarrë nga i papunësuarit.

4.10. Çfarëdo shkelje e deklaratës së papunësisë nga i papunësuarit, do të rezultojë me anulimin e certifikimit si i papunësuar. Procedurat e regjistrimit, certifikimit dhe kërkimit aktiv të punësimit për të papunësuarin do të rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

4.11. Personat që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe që kanë mbaruar shkollimin e mesëm do të konsiderohen si të aftë për punë dhe në gjendje për të punuar edhe nëse vazhdojnë shkollimin e rregullt në universitet ose në ndonjë program trajnues.

4.12. Personat që:

a). banojnë; ose

b). janë në institucione të tipit të mbyllur, si: institucionet psikiatrike, shtëpitë e pleqve, institucionet religjioze, shkollat rezidenciale dhe burgjet, nuk mund të përfitojnë ndihma sociale sipas këtij ligji.

Neni 5

Kriteret financiare për ndihmë sociale

5.1. Përveç kërkesave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, organet përkatëse shqyrtojnë edhe kushtet shtesë, të parashikuara në nenin 5, për të fituar të drejtën e ndihmës sociale.

5.2. Për të fituar të drejtën në ndihmë sociale, kërkuesi ose marrësi duhet t'i përmbushë kërkesat financiare të përzgjedhshmërisë. Kërkuesi ose marrësi i përmbushin kërkesat financiare të përzgjedhshmërisë vetëm kur ata i përmbushin këto kushte:

a). Ai apo ajo ka mjete që llogariten nën kufizimin e lejuar. Këto kufizime të mjeteve do të saktësohen në një Udhëzim Administrativ (në tekstin e mëtejshëm “ Udhëzim”) që do ta lëshojë Ministria.

dhe

b). Nëse ai apo ajo ka të hyra të përgjithshme që llogariten të jenë (pas zbritjeve të duhura) nën shkallën standarde të përgjithshme mujore për atë familje, të saktësuara në nenin 9 pikën 1.

5.3. Të mirat materiale të llogaritshme janë sendet me vlerë që përfshijnë: pagesat e përgjithshme nga pensionet individuale të kursimit, që u jepen personave ose përfituesve – siç përcaktohet në ligjet në fuqi, pagesa të tjera të përgjithshme, bizneset private apo familjare, prona, disa lloje të caktuara të pasurisë së patundshme, toka dhe mjetet motorike në përdorim.

5.4. Zotërimi apo qasja përfituese e disa llojeve të caktuara të të mirave materiale mund ta diskualifikojnë familjen nga ndihma sociale. Këto të mira materiale do të përkufizohen në Udhëzim .

5.5. Të mirat jo të llogaritshme materiale përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to: kursimet e pensioneve të anëtarëve të familjes në llogaritë individuale të detyrueshme në përputhje me ligjet e aplikueshme, prona e shfrytëzuar si vendbanim kryesor i familjes, automjeti që përdoret nga anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara, të cilët janë nën përkujdesje nga personi tjetër njëzetekatër (24) orë, ashtu sikur është vendosur nga Organi i kujdestarisë, toka në sipërfaqe jo më shumë se zero pikë pesë (0.5) hektarë.

5.6. Të hyrat mund të jenë të llogaritshme dhe të pallogaritshme në përcaktimin e përzgjedhshmërisë financiare apo në llogaritjen e shumës së ndihmës sociale. Të hyrat e llogaritshme janë të gjitha të hyrat që merren parasysh në përcaktimin e përzgjedhshmërisë financiare. Të hyrat jo e llogaritshme janë të gjitha të hyrat që bëjnë përjashtim nga vlerësimi i përzgjedhshmërisë financiare. Të gjitha të hyrat do të konsiderohen si të hyra të llogaritshme nëse nuk përkufizohen si të hyra të pallogaritshme.

5.7. Të hyrat e llogaritshme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto: të hyrat e fituara, të trashëguara, dhurata, të hyrat e pranuar në mall, qiraja, dërgesat e parave, beneficionet që u janë dhënë anëtarëve të familjes sipas Ligjit për vlerat e luftës, pensionet e kursimeve individuale dhe pensioneve plotësuese individuale ose të punëdhënësve, pensionet që merren nga jashtë, disa pagesa të përgjithshme dhe lloje të ndryshme të të hyrave.

5.7. a. Të hyrat jo të llogaritshme përfshijnë: Pensionin bazik të moshës, pensionin e aftësisë së kufizuar, disa pagesa të përgjithshme, pagesat sipas Ligjit Nr.03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, të moshës një (1) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pagesat e njëhershme që u jepen familjeve që fitojnë të drejtën në ndihmë sociale, siç përcaktohet në këtë ligj, prodhimi shtëpiak për konsum familjar, disa lloje të caktuara të kredivë dhe ndihmave financiare si dhe lloje të tjera të të hyrave.

5.8. Ministria nxjerr akt nënligjor për përlogaritjen e të mirave materiale dhe jo- materiale si dhe të hyrave të llogaritshme dhe jo të llogaritshme.

5.9. Subjekt i nenit 5.5, nëse vlera e të mirave materiale të llogaritshme familjare është nën kufizimin (limitin) e testit të të mirave materiale mujore (siç përcaktohet në Udhëzim) dhe nëse të hyrat e llogaritshme mujore të familjes (pas zbritjeve përkatëse) janë nën normën standarde mujore (siç përcaktohet në nenin 9.1.) atëherë familja është e përzgjedhshme nga aspekti financiar për ndihmë sociale.

Neni 6

Kërkesat për ndihmë sociale

6.1. Familjet që konsiderojnë se janë rast social sipas kategorisë së parë dhe të dytë të këtij ligji, i parashtrajnë kërkesë me shkrim për ndihmë sociale organit përkatës. Në të njëjtën kohë, familja nuk mund të parashtrorë kërkesë, përkatësisht, të shfrytëzojë ndihmë nga më shumë se një organ. Familja mund të marrë ndihmë sociale në të njëjtën kohë vetëm nga një organ përkatës.

6.2. Familjet me një apo më shumë anëtarë të paaftë për punë, që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale për kategorinë e parë, gjendjen shëndetësore të këtyre anëtarëve e ekzaminon dhe vlerëson Komisioni mjekësor i ministrisë. Procedurat e punës, kriteret dhe metodologjia për vlerësim dhe rishikim të nivelit dhe llojit të paaftësisë nga ana e Komisionit mjekësor do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

6.3. Procedura për paraqitjen e kërkesave për ndihmën sociale rregullohet me një akt nënligjor të cilin e lëshon ministria.

Neni 7

Periudha e shfrytëzimit të ndihmës sociale

7.1. Familja që ka fituar të drejtën e ndihmës sociale për kategorinë e parë do të marrë ndihma sociale deri në dymbëdhjetë (12) muaj, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parashikuara gjatë kësaj periudhe. Pas kalimit të periudhës së lartpërmendur, familja duhet të bëjë kërkesë të re për vazhdimin e të drejtës për ndihmë sociale.

7.2. Familja që ka fituar të drejtën në ndihmë sociale për kategorinë e dytë do të marrë ndihmë sociale deri në gjashtë (6) muaj, me kusht që t'i përmbushë kriteret e parashikuara gjatë kësaj periudhe dhe të ndërmarë veprime të nevojshme për punësim, sipas kërkesës së organeve përkatëse. Organet përkatëse kërkojnë nga anëtari i familjes i cili është i certifikuar si punëkërkues, dëshmi mbi orvatjet e tij për të gjetur punë. Ministria, nxjerr akt nënligjor për mënyrën e paraqitjes së punëkërkuesve, në Zyrën e punësimit, dëshmitë mbi orvatje për të gjetur punë dhe afatet kohore.

Neni 8

Detyra për të informuar

8.1. Organi përkatës ka për detyrë që ta informojë me shkrim secilin kërkues të ndihmës sociale për rezultatin e kërkesës në afatin prej katërdhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës së tij të kompletuar tek organi përkatës.

8.2. Familja që merr ndihmë sociale duhet ta informojë menjëherë organin përkatës për çdo ndryshim të rrethanave, të cilat mund të ndikojnë në të drejtën e tyre për ndihmë sociale.

8.3. Ministria dhe organi përkatës mund të autorizojë nëpunës për të bërë verifikime të rastit ose verifikime sistematike të familjeve që marrin ndihmë sociale, në mënyrë që të vërtetohen faktet e paraqitura në kërkesat e tyre. Për verifikime të tilla kërkuesi i ndihmës nuk duhet të paralajmërohet, në qoftë se ato bëhen gjatë ditës.

8.4. Nëpunësve të autorizuar sipas nenit 8.3 u jepet autorizimi për verifikim të kërkesave, dhe nëse kërkohet, duhet ta dëshmojnë identitetin e tyre dhe të veprojnë vetëm brenda autorizimeve të përcaktuara.

Neni 9

Llogaritja e pagesave mujore të ndihmave sociale

9.1. Shuma mujore e ndihmës sociale përcaktohet sipas numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria. Lartësia e vlerës së përfitimeve për familje rregullohet me akt nënligjor, me ç'rast Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr vendim për lartësinë e pagesës së shumës mujore për familje. Shuma mujore e ndihmës sociale harmonizohet me indeksin e çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

9.2. Ministria nxjerr akt nënligjor për përlllogaritjen e shumës së ndihmës sociale.

9.4. Familjet që fitojnë të drejtën sipas ligjit ekzistues, do t'i marrin pagesat në mënyrë retroaktive prej muajit kur i është dorëzuar kërkesa e kompletuar autoritetit përkatës.

Neni 9.A

Familja e përzgjedhur për skemën e ndihmës sociale, për çdo fëmijë të moshës zero (0) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, realizon një përfitim financiar në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit. Ministria nxjerr akt nënligjor për procedurat dhe mënyrat e realizimit të kësaj të drejte.

Neni 10

Gjobat për dëshmi të rreme dhe obstrukcione

10.1. Çdo person që me vetëdije deklaron të dhëna të pavërteta ose paraqet dokumente të pasakta për të përfituar ndihmën sociale sipas ligjit të tashëm, apo që nuk e informon organin përkatës për çdo ndryshim të rrethanave, të cilat mund të ndikojnë në të drejtën e tyre për ndihmë sociale, është i obliguar ta kthejë shumën e parave të marrë padrejtësisht. Personi i tillë do të paguajë shumën tjetër e cila është e barabartë me shumën mujore të ndihmës sociale për një familje. Procedurat për kthimin e parave do të përcaktohen në një Udhëzim të cilin e lëshon Ministria .

10.2. Çdo person që pengon qëllimisht përpjekjet e ligjshme të organit përkatës për t'i verifikuar faktet e paraqitura në kërkesë, i refuzohet kërkesa për ndihmë sociale.

Neni 11

Shqyrtimi i ankesave

11.1. Kërkuesi i ndihmës sociale që është i pakënaqur me aktvendimin zyrtar të organit përkatës, mund të paraqet kërkesë me shkrim tek udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale për rishqyrtim të aktvendimit. Kërkesa për rishqyrtim bëhet jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e marrjes së aktvendimit. Ajo nuk e humb të drejtën për ankesë në shkallën e dytë në Komisionin për ankesa në departamentin përkatës të ministrisë, ndërsa udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale në afatin prej dhjetë (10) ditësh e shqyrton kërkesën për rishqyrtim apo atë e bart tek organi më i lartë, i cili vendos në lidhje me ankimimin.

11.2. Kërkuesi i ndihmës, që është i pakënaqur me aktvendimin e organit përkatës, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim Komisionit të ankesave, si organ i shkallës së dytë, në departamentin përkatës, i cili vepron nën autorizimin e Ministrisë. Ankesat dorëzohen jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e marrjes së aktvendimit nga organi përkatës i QPS-së. Komisioni i ankesave duhet ta shqyrtojë ankesën dhe ta njoftojë me shkrim parashtruesin e ankesës për aktvendimin e pranuar jo më vonë se njëzetënjë (21) ditë pas marrjes së ankesës.

11.3. Pala e pakënaqur me aktvendimin e Komisionit për ankesa të shkallës së dytë, ka të drejtë të parashtojë padi në afatin prej tridhjetë (30) ditësh për iniciimin e kontestit administrativ në gjykatën kompetente, nga dita e marrjes së aktvendimit.

Neni 12 **Ndihmat e veçanta**

12.1. Ministria, në rastet e caktuara, mund të marrë vendim për të përmbushur ad – hoc, kërkesat momentale të veçanta për familjet në nevojë sociale, që nuk janë parashikuar me këtë ligj. Sipas këtij ligji konsiderohet e veçantë një nevojë momentale dhe e njëhershme por jo e vazhdueshme. Nëse nevoja momentale dhe e njëhershme përsëritet brenda dymbëdhjetë (12) muajve, nuk mund të mbështetet sipas këtij neni. Organi përgjegjës i ministrisë, vlerëson dhe administron dhënien e një mbështetjeje të tillë. Familja ose individi mund të kërkojë këtë ndihmë pavarësisht nëse është apo jo shfrytëzues i skemës së ndihmës sociale.

12.2. Familja, individi, mund të kërkojë përmbushjen e nevojave të veçanta vetëm prej një organi në përputhje me këtë nen. Familja ose individi nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë ndihmë materiale për një nevojë të njëjtë prej më shumë se një organi. Vetëm një anëtar i familjes mund të kërkojë ndihmë në çdo kohë.

12.3. Buxheti për skemën e ndihmës sociale, për ndihma të veçanta, përfshin pagesa të veçanta për nevoja të jashtëzakonshme.

12.4. Ministria, çdo vit kalendarik, në kuadër të buxhetit të përgjithshëm, planifikon mjete buxhetore për pagesa të ndihmave të veçanta, në shumën vjetore prej së paku njëqindmijë (100.000) Eurosh. Procedurat për këto pagesa të ndihmave të njëhershme do të përkufizohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 13 **Administrimi dhe financimi i Skemës**

13.1. Sipas këtij ligji, Skema e ndihmës sociale administrohet nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Qeveria brenda 60 ditëve, pas sugjerimeve të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, lëshon një apo më shumë Udhëzime administrative që përmbajnë rregulla të cilat duhet të përmbushen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në administrimin e skemës së ndihmës sociale që është themeluar sipas këtij ligji. Këto Udhëzime administrative duhet të jenë në përputhje me këtë Ligj dhe me Ligjin për Financat Publike.

13.2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave, në përputhje me Ligjin për Financat Publike, përcaktojnë buxhetin vjetor për skemën e ndihmës sociale.

13.3. Ministria e Financave i vërteton Qeverisë së Kosovës, për çdo vit, jo më vonë se më 1 dhjetor, se shuma e mjaftueshme e buxhetit i është ndarë, për vitin vijues për pagesat e ndihmës sociale në Shkallën standarde mujore bruto. Nëse Ministria e Financave nuk mund të vërtetojë se ka fond të mjaftueshëm për pagesat e ndihmës sociale në Shkallën standarde mujore bruto, ajo (Ministria) duhet t'i paraqesë Qeverisë për miratim, një propozim të arsyetuar të një shume të tjetër buxhetore, e cila, megjithatë, nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vitit aktual.

13.4. Ministria e Financave, bashkërisht me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, vërtetojnë për çdo vit shkallët standarde bruto për ndihmë sociale, në bazë të të dhënave në dispozicion të përfituesve të mundshëm dhe mundësive të Buxhetit të Kosovës.

Neni 14 **Fshehtësia e informatës personale**

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale dhe organet përkatëse nuk duhet t'ia tregojnë informatat e mbledhura të përfituesve të skemës asnjë organizate ose organi, përveç rasteve kur kjo bëhet me qëllim zbulimi të mashtrimit ose korrupsionit. Në rastet e jashtëzakonshme, informata mund t'u tregohet organeve publike për të mundësuar ndihma financiare, ndihma të tjera, pagesat e beneficioneve në mallra që u jepen anëtarëve të një familjeje. Këto kërkesa mund të merren parasysh kur ekziston bazë specifike statutare për një ndihmë financiare të posaçme, ndihmë tjetër, pagesë ose përfitim në mallra , kur këto nuk janë në kundërshtim me synimin e skemës së ndihmës sociale dhe kur efekti i këtyre nuk ndikon në diskualifikimin e familjes nga e drejta për ndihmë sociale .

Neni 15

Zbatimi

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale mund të nxjerr Udhëzime administrative për zbatimin e këtij ligji. Këto udhëzime administrative duhet të jenë në përputhje me këtë Ligj dhe me Ligjin për Financa Publike dhe në përputhje me çdo urdhëresë administrative të Qeverisë.

Neni 15.A

Beneficionet - subjekt i vështirësive fiskale

Në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas Ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.

Neni 15.B

Zbatimi i veçantë i ligjit

Përfitimet financiare të përcaktuara me këtë ligj, për familjet e përzgjedhura në skemën e ndihmës sociale, të cilat kanë fëmijë deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç sipas nenit 9 të këtij ligji, do të realizohen varësisht dhe në masën që mund të mbulohen nga kursimet e mundshme financiare në skemat aktuale të përcaktuara dhe kursimet që do të bëhen brenda fondeve buxhetore në dispozicion. Përfitimet e reja jepen vetëm mbi bazën e kursimeve të qëndrueshme, por nuk kufizohen vetëm në to.

Neni 15.C

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në afat prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij akti ligjor, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e drejtë dhe efikas të këtij ligji.
2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas paragrafit 1. të këtij neni, vazhdojnë të zbatohen aktet nënligjore të aplikueshme, të përcaktuara në nenin 15 të ligjit bazik për shfuqizim dhe aktet tjera të aplikueshme deri në masën që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 16

Ligji në fuqi

16.1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen:

- a). Rregullorja Nr.2003/XX të datës 18.12.2003, për zbatimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë;
- b). Udhëzimi Administrativ Nr. 8/2004 për verifikimin e gjendjes materiale në familjet që aplikojnë për ndihmë sociale;

c). Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2005 për rregullimin e procedurave të përkrahjes financiare, familjeve dhe individëve në raste të jashtëzakonshme.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 4 muaj pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe pas shpalljes nga PSSP-ja.

18.08.2003

UNMIK/REG/2003/28

**LIGJI Nr. 04/L-032
PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.

2. Qëllimet e arsimimit dhe aftësimimit parauniversitar janë:

2.1. zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë;

2.2. avancimi i krijimit të njohurive themelore shkencore, shkathtësive të komunikimit, vrojtimit dhe shkathtësive analitike, kreativitetit, mëvetësisë dhe aftësive të ndërlidhura të mësimnxënies;

2.3. zhvillimi i respektit të nxënësi për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me konventat përkatëse dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

2.4. zhvillimi i respektit të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e komunitetit të tij, për vlerat e Republikës së Kosovës, për shtetin nga i cili mund të ketë prejardhjen dhe për respektimin e diversitetit;

2.5. përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë;

2.6. të zhvillojë të nxënësi respektin për mjedisin.

3. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet si zvogëlim apo kufizim i çfarëdo të drejte të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të paraparë me ligjin në fuqi.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Akreditim** - procesi përmes të cilit Autoriteti Shtetëror i Kualifikimeve (ASHK), në bazë të ligjit në fuqi, përcakton, monitoron dhe auditon institucionet (organet vlerësuese), të cilat i vlerësojnë kandidatët dhe lëshojnë certifikata e diploma, si dhe çdo organ tjetër që krye funksione në emër të ASHK-së.

1.2. **Rritur** - personi që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, por qëllimi i këtij ligji përfshin çdo fëmijë që ka arritur moshën në të cilën zakonisht përfundohet arsimi i detyruar dhe mund të hyjë në tregun e punës, si dhe të marrë pjesë në programe arsimore të përcaktuara për të rritur.

1.3. **Arsimimi dhe aftësimi i të rriturve** - mësimin dhe aftësimin publik dhe privat që ofrohet për të rriturit dhe për fëmijët e moshës mbi pesëmbëdhjetë (15) vjeç që i plotësojnë kushtet për të vijuar programet mësimore të përcaktuara për të rritur.

1.4. **Miratim** - procesi, përmes të cilit ASHK i njeh kualifikimet.

1.5. **Vlerësim** - i referohet proceseve (përfshirë provimet dhe testet) që përdoren për të grumbulluar, analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e arritjes individuale në mësim.

1.6. **Zona e mbulimit** - zona e vendbanimit e përcaktuar nga komuna për një institucion të caktuar arsimor.

1.7. **Fëmijë** - çdo person nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

1.8. **Komunitet** - një grup kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar që tradicionalisht është i pranishëm në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

1.9. **Mosha e shkollimit të obligueshëm** - mosha e përcaktuar sipas këtij ligji.

1.10. **Kurrikulum i bazë** - pjesa e përgjithshme të kurrikulumit të paraparë nga Ministria për të gjitha shkollat.

1.11. **Ndëshkim fizik** - çdo formë e goditjes apo e kontaktit tjetër fizik të qëllimshëm nga ana e mësimdhënësit ose ndonjë anëtar tjetër të personelit me një nxënës, me përjashtim të rasteve të ndërhyrjes së detyrueshme, kur një nxënësi rrezikon sigurinë e nxënësve të tjerë ose të personelit.

1.12. **Drejtor** - drejtuesi më i lartë i një institucioni arsimor ose aftësues.

1.13. **Braktisje e shkollës** - ndërprerja e parakohshme e shkollimit të detyruar.

1.14. **Institucion arsimor dhe aftësues** - çdo institucion shkollor ose aftësues që realizon shërbime arsimore të niveleve 0, 1, 2, 3, 4 sipas ISCED.

1.15. **Shërbim arsimor** - çdo veprimtari që është drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë e lidhur me mësimdhënien, si dhe çdo mbështetje materiale apo ndonjë formë tjetër.

1.16. **Cikli i parë dhe i dytë, lidhur me kualifikimin e kërkuar për mësimdhënës** - një program të miratuar në nivelin 5 të ISCED-it që shpie në shkallën Bachelor (180 gjer 240 kredi

në kuadër të Sistemit Evropian për Bartjen dhe Grumbullimin e Kredive - ECTS) apo Master (300 ECTS).

1.17. **Këshilli drejtues** - organi përgjegjës për qeverisjen e institucionit arsimor apo aftësues, me funksione të parapara me këtë ligj.

1.18. **Komisioni i granteve** - Komisioni me këtë emërtim, i themeluar sipas ligjit në fuqi.

1.19. **Arsimimi gjithëpërfshirës** - përcaktuar në bazë të dispozitave të Konventës së OKB-së për të Drejta të Fëmijës (1989), të Deklaratës së Salamankës të UNESCO-s (1994) dhe Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007).

1.20. **Inspektor i arsimit** - personi zyrtar i Ministrisë që merret me inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet e arsimit, të mbuluara përmes këtij ligji.

1.21. **ISCED** - Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit, të miratuara nga UNESCO, në Konferencën e përgjithshme, në seancën e 29-të, të mbajtur në nëntor të vitit 1997, dhe të ndryshuara më vonë.

1.22. **Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)** - agjencia me këtë emërtim, e themeluar në bazë të legjislacionit në fuqi .

1.23. **Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV)** - agjencia me këtë emërtim, e themeluar sipas dispozitave të këtij ligji.

1.24. **Korniza e Kurrikulumit e Kosovës (KKK)** - korniza e kurrikulumit për arsimin parauniversitar, e miratuar nga Ministria.

1.25. **Ministria** - Ministria e Arsimit, e Shkencës, dhe e Teknologjisë si autoritet qeveritar, përgjegjës të e së cilës përfshijnë arsimin, shkencën dhe teknologjinë.

1.26. **Drejtor Komunal i Arsimit (DKA)** - zyrtari në komunë me këtë titull, ose personi që aktualisht kryen këtë funksion.

1.27. **Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)** - autoriteti me këtë emërtim, i themeluar sipas ligjit në fuqi, përgjegjës për hartimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe rregullimin e sistemit kombëtar të kualifikimeve.

1.28. **Korniza Kombëtare e Kualifikimeve** - mekanizmi shtetëror për klasifikimin e kualifikimeve në kuadër të sistemit shtetëror të kualifikimeve në bazë të një numri kriteresh që përcaktojnë nivelet e Kornizës Kombëtare të Kualifikimit dhe llojet e rezultateve të mësimnxënies që janë në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, të hartuar nga AKK-ja në përputhje me ligjin në fuqi.

1.29. **Gjuhë e komuniteteve** - gjuhët që fliten në Republikën e Kosovës, përveç dy gjuhëve zyrtare.

1.30. **Prind** - kujdestari ligjor i fëmijës, në bazë të ligjit në fuqi.

1.31. **Shërbim pedagogjik në shkollë** - shërbimi arsimor dhe aftësues që ofrohet nga këshilltari, pedagogu, psikologu me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të punës në shkollë.

1.32. **Institucion arsimor apo aftësues i financiar me fonde publike** - institucioni arsimor apo aftësues - financiar prej fondeve publike.

1.33. **Nxënës** - çdo person të regjistruar në çfarëdo programi të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore dhe aftësuese.

1.34. **Kualifikim** - njohje zyrtare e të arriturave të shkollimit apo të aftësimit ose suksesi i kënaqshëm në test apo në provim.

1.35. **Shkollë** - çdo institucion arsimor që ofron shërbime arsimore në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të ISCED-it, përfshirë çdo institucion aftësimi që ofron shërbime arsimore në nivelin 3 të ISCED-së.

1.36. **Kurrikulum me bazë shkolle** - ajo pjesë e kurrikulumit që përcaktohet nga vetë shkollat apo institucionet arsimore dhe të aftësimit.

1.37. **Vit shkollor** - periudha kohore që fillon me 1 shtator të një viti dhe që përfundon më 31 gusht të vitit pasues, e caktuar nga Ministria, siç është përcaktuar në Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës, ndaras për shkollat dhe institucionet e aftësimit.

1.38. **Standardet** - tregues të matshëm të suksesit të përkufizuar, në formë të kriterëve cilësore apo sasore, të cilat pritet të arrihen nga kandidatët në mënyrë që ata t'i fitojnë kualifikimet.

1.39. **Mësimdhënës** - personi i kualifikuar sipas dispozitave të këtij ligji me përgatitje akademike dhe profesionale, i punësuar për ofrimin e shërbimeve arsimore për nxënësit.

1.40. **Institucion i aftësimit ose Qendër e aftësimit** - çfarëdo institucioni arsimor publik ose privat përmes të cilit ofrohen shërbimet arsimore për nivelet 3 apo 4 të ISCED-it.

Neni 3

Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.
2. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.
3. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.
4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.
5. Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të:

5.1. respektojnë dhe avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi;

5.2. kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë, dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve.

6. Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinioneve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.

7. Institucionet publike arsimore duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagandojnë një fe të caktuar.

8. Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësive të tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit si dhe adresimit të çështjeve disiplinore dhe sjelljeve.

Neni 4

Mbrojtja e grupeve të cenueshme

1. Të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese.

2. Ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private.

3. Ndalohen aktivitetet promovuese jashtë Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës në përfitim ose në dëm të çfarëdo partie politike, gjinie, përkatësie racore a etnike, feje ose pozite sociale nëpër institucionet arsimore dhe aftësuese. Kur çështjet relevante paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësve duhet t'u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta.

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 5

Detyrat e Ministrisë

1. Ministria mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe ka detyrat e përgjithshme që:

1.1. të zhvillojë politika, hartojë dhe zbatojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin parauniversitar;

1.2. të përcaktojë rezultatet e niveleve të ndryshme të arsimit dhe aftësimin parauniversitar si dhe të japë kualifikime, ose të autorizojë dhënien e tyre, për të gjithë ata që me sukses i përfundojnë programet parauniversitare sipas niveleve përkatëse të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;

1.3. të promovojë sistem jo diskriminues, të arsimit në të cilin respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor;

1.4. të promovojë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimit; të sigurojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit dhe të punësuarve në institucionin arsimor dhe aftësues, si dhe të avancojë masat për parandalimin e braktisjes;

1.5. të vendosë kritere dhe të menaxhojë një sistem të licencimit të mësimitdhënësve, përmes Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimitdhënësve, të themeluar sipas këtij ligji;

1.6. të vendosë dhe mirëmbajë një sistem të informatave për menaxhimin e arsimit dhe aftësimit.

1.7. t'i ofrojë komisionit për grante në baza vjetore të dhëna të mjaftueshme dhe standarde të formulës me qëllim të përcaktimit të grantit specifik për arsim në përputhje me ligjin në fuqi dhe dispozitat e nenit 28 të këtij ligji;

1.8. të dizajnojë dhe mbikëqyrë format efektive të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese për t'u zbatuar nga komunat dhe përcaktojë kritere dhe procedura të monitorimit të punës së Këshillit Drejtues;

1.9. të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësimit përmes mekanizmave të cekura në nenin 8 të këtij ligji për inspektim, monitorim, dhe vlerësim me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi;

1.10. të përcaktojë kriteret për vlerësimin dhe notimin e nxënësve në institucionet arsimore dhe aftësuese;

1.11. të organizojë dhe të menaxhojë vlerësimin e jashtëm për nivelet 1, 2 dhe 3 të ISCED-it në përputhje me kërkesat për dhënien e kualifikimeve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe, sipas nevojës, duke u konsultuar me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve;

1.12. të sigurojë politika gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me nevoja të veçanta;

1.13. të promovojë pjesëmarrjen dhe partneritetin e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe aftësuese përmes Këshillit të Prindërve të Kosovës, organeve udhëheqëse të institucioneve arsimore dhe aftësuese dhe përmes mënyrave tjera;

2. Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore lidhur me:

2.1. kalendarin shkollor dhe periudhën kohore të vitit shkollor në kuadër të Kornizës së Kurrikulimit të Kosovës,

2.2. kohëzgjatjen e orës së mësimi dhe pushimeve shkollore, festat,

2.3. numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe proporcionin e numrit nxënës-mësimdhënës (klasat apo shkollat që japin mësim në gjuhët jozyrtare mund të themelohen edhe me numër më të ulët, sesa ai i paraparë në kushte të zakonshme),

2.4. provimet dhe vlerësimet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ministria nxjerr akte nënligjore në lidhje me regjistrimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e arsimit, duke marrë parasysh kriteret në vijim:

3.1. dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet e arsimit, si dhe nga ato të aftësisë duhet të përmbajnë të dhënat personale, si vijon: emri, emri i prindit-kujdestarit ligjor, mbiemri dhe data e lindjes;

3.2. dokumentet zyrtare duhet të lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare; nxënësi i arsimuar në gjuhën jozyrtare ka të drejtën që përveç në gjuhët zyrtare, dokumentet e veta zyrtare t'i ruhen dhe lëshohen edhe në gjuhën e tij të mësimi;

3.3. të dhënat personale që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike e fetare mund të evidencohen vetëm për shkaqe të monitorimit statistikor që ndihmon në promovimin mundësive të barabarta, dhe nuk mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër. Të dhënat e tilla nuk mund të regjistrohen në ndonjë mënyrë përmes së cilës individët mund të identifikohen si të tillë.

4. Në kuadër të raportit vjetor të qeverisë, Ministria raporton për arsimin parauniversitar, si dhe për zbatimin e këtij ligji para Kuvendit në fund të vitit kalendarik.

5. Ministria emërton dhe riemërton institucionet publike arsimore dhe aftësuese në bazë të rekomandimit nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) përkatëse në bazë të propozimeve të bëra nga këshilli drejtues i institucionit arsimor apo aftësues, e që mund të jenë deri në tri propozime.

6. Ministria përcakton kodin unik të çdo institucioni arsimor apo aftësues, i cili përdoret në sistemin e menaxhimit të informatave arsimore.

7. Kompetencat e Ministrisë, si plotësim i kompetencave të specifikuara në ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, 21 Maj 2008, në fushën e infrastrukturës së objekteve arsimore dhe aftësuese janë:

7.1. hartimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave, standardeve dhe normave për hapësirën shkollore;

7.2. ofrimin e ndihmës teknike për komunat në planifikimin dhe dizajnimin e objekteve arsimore dhe aftësuese;

7.3. hartimin e politikave për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirës shkollore;

7.4. ofrimin e ndihmës teknike komunave për të siguruar përshtatshmërinë e ndërtesave shkollore dhe të pajisjeve sipas standardeve ndërkombëtare për shëndet dhe siguri, si dhe për mbrojtje të mjedisit, për të siguruar qasje të nxënësve dhe punonjësve me aftësi të kufizuara dhe pajisjet ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës.

7.5. miratimin e investimeve kapitale për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të financuara nga buxheti i Kosovës dhe donatorët.

7.6. zhvillon dhe mirëmban programin për hapësira shkollore, i cili ndërlidhet me sistemin e informatave për menaxhimin në arsim dhe harton planin kombëtar për investimet kapitale në arsim.

8. Përmes një akti nënligjor, Ministria miraton standardet e licencimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese, përfshirë edhe standardet e cekura në paragrafin 7. të këtij neni.

9. Ministria licencon dhe akrediton institucione që ofrojnë kualifikime të përgjithshme sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në bazë të kriterëve dhe standardeve të përcaktuara për këtë qëllim; institucionet që ofrojnë lloje të tjera të kualifikimeve akreditohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, në bazë të kriterëve dhe standardeve të përcaktuara për këtë qëllim dhe licencohen nga Ministria.

10. Ministria vepron si organ i shkallës së dytë për vendimet e organeve të tjera arsimore dhe aftësuese, ku e drejta e ankesës përcaktohet në këtë ligj.

11. Ministria përmes një akti nënligjor, për një periudhë kohore të përcaktuar përmes tij, me kërkesë të komunës apo të komunave, mund të akordojë lirimin ose zbutjen e çfarëdo kërkesë të paraparë me këtë ligj për cilëndo komunë ose institucion arsimor e aftësues, në mënyrë që të lehtësojë zbatimin e projekteve inovative që i kontribuojnë ngritjes së standardeve të arritjes të nxënësit. Gjatë ushtrimit të këtij autoriteti, Ministria merr parasysh ndikimin e projektit në kurrikulum dhe në vlerësim, si dhe merr parasysh ndikimin e mundshëm të projektit tek nxënësit, përfshirë nxënësit me vështirësi në nxënie apo me aftësi të kufizuara, si dhe pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme.

12. Ministria, me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi, dhe në marrëveshje me komunën përkatëse, promovon partneritetin publiko – privat për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve arsimore dhe aftësuese.

13. Ministria nxjerr akt nënligjor për shpërndarjen e teksteve shkollore falas dhe ruajtjen e tyre, sipas dispozitave të nenit 26 dhe 27 të këtij ligji.

14. Ministria, përmes aktit nënligjor, përcakton pjesëmarrjen financiare të nxënësve për nivelin 4 të ISCED-it.

15. Ministria në bashkëpunim me ministritë relevante, ndërmerr masa të veçanta për arsimin e individëve në burgje ose në institucionet për shkelësit e mitur të ligjit, si dhe për ata të mbyllur në institucione psikiatrike, ose për ata që i nënshtrohen hospitalizimit afatgjatë, janë në përkujdesje sociale në strehimore dhe për ata që janë liruar nga institucionet ose nga spitalet dhe vazhdojnë procesin arsimor.

16. Ministria nxjerrë akte nënligjore në çdo fushë të përgjegjësive të saj në bazë të këtij ligji ose cilitdo ligj tjetër në fuqi.

Neni 6

Këshilli shtetëror për arsimim parauniversitar

1. Këshilli Shtetëror për Arsimim parauniversitar (KSHAP) përbëhet nga nëntë ekspertë të cilët nominohen nga institucionet në vijim:

1.1. Universitetet publike (2);

1.2. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (1);

1.3. Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde, dhe Vlerësim (1);

1.4. Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (1);

1.5. Këshilli i Prindërve të Kosovës (1);

1.6. Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (1);

- 1.7. Ministria (1);
- 1.8. Një ekspert ndërkombëtar i nominuar nga Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë.
2. Kryesuesi dhe zëvendësi i KSHAP zgjedhen nga anëtarët vendor për një mandat të vetëm katër (4) vjeçar.
3. KSHAP luan rol këshilldhënës për Ministrinë.
4. Çështjet administrative që kanë të bëjnë me KSHAP rregullohen me akt nënligjor.
5. KSHAP monitoron progresin në procesin e reformave në arsimin parauniversitar nga këndvështrimi kombëtar dhe ndërkombëtar, bënë propozime për ndryshime, harton raporte këshilldhënëse ose rekomandime për fusha të caktuara dhe diskuton çështje të tjera që i referohen nga ministri.

Neni 7

Kompetencat e komunës

1. Kompetencat e komunave janë të rregulluara përmes:
 - 1.1. Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L040, të datës 20 Shkurt 2008, dhe Ligjit për arsim në komuna, nr. 03/L-068, të datës 21 maj 2008, dhe
 - 1.2. kompetencave shtesë të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji .
2. Ushtrimi i përgjegjësive dhe detyrave të komunës në këtë fushë monitorohet nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi.
3. Komunitat kanë përgjegjësitë shtesë në vijim:
 - 3.1. ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese;
 - 3.2. mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore;
 - 3.3. sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjieniko sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe sigurisë efektive.
 - 3.4. përmes bashkëpunimit me prindër, polici dhe autoritetet e tjera publike, marrin hapa për të adresuar sjelljet e dhunshme dhe keqpërdorimin në ose në lidhje me institucionin përkatës.

Neni 8

Inspektimi i arsimit

1. Inspektimi i institucioneve arsimore dhe aftësuese për qëllimin e specifikuar në nën-paragrafin 1.9. paragrafi 1. të nenit 5 të këtij ligji është përgjegjësi e Departamentit të Inspektionit pranë Ministrisë.
2. Autoriteti për inspektim buron nga Ministria; drejtorët e institucioneve arsimore dhe aftësuese dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit duhet të bashkëpunojnë me inspektorët e autorizuar duke ofruar të gjithë

dokumentacionin e nevojshme, qasje në institucion, si dhe të marrin pjesë në inspektim personalisht apo përmes zëvendësit të autorizuar.

3. Inspektimi duhet të organizohet në cikle vjetore të planifikimit, me mundësi të inspektimit të veçantë në kushtet e përcaktuara nga Departamenti i Inspektimit.

4. Qëllimet e inspektimit të funksionimit të institucionit arsimor dhe aftësues në nivelin 0,1,2,3 dhe 4 të ISCED-it janë që së bashku me inspektorë të fushave të tjera (punësimi, shëndetësia, ndërtimi, financat etj) të kontrollojnë dhe evidentojnë:

4.1. respektimin e detyrave dhe funksioneve përkatëse të institucionit në përputhje me këtë ligj si dhe ligjet tjera dhe aktet nënligjore;

4.2. funksionimin e këshillit drejtues të institucionit, funksionimin e këshillit të prindërve dhe këshillit të nxënësve, korrektësinë në të dhënat e nxënësve sipas niveleve dhe klasave, saktësinë në dokumentet pedagogjike dhe shkollore, organizimin e mësimi;

4.3. numrin, kualifikimet dhe mundësitë për zhvillim profesional të mësimitdhënësve;

4.4. ambientin e punës duke përfshirë respektimin e standardeve të shëndetësisë dhe sigurisë, të dhënat e evidentuara të veprimeve disiplinore dhe rezultatet e tyre;

4.5. zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kurrikulumit duke përfshirë kurrikulumin bërthamë, kurrikulumin me bazë shkolle, procedurat e testimit dhe vlerësimit, përdorimin e teksteve të miratuara dhe materialet mësimore;

4.6. dhe, në rastet kur evidentohet moszbatim i aspekteve të mësipërme, drejtorit të institucionit në fjalë i jepen rekomandime dhe këshilla specifike për ndryshimet e nevojshme në një afat të caktuar.

5. Nëse drejtori nuk merr masa të nevojshme për të adresuar mangësitë në fushat e cekura më lartë në paragrafin 4. të këtij neni, inspektori mund të përcaktojë procedurat disiplinore që duhet të merren ndaj drejtorit apo personelit tjetër në institucion.

6. Pas raportit të inspektorit, i cili nënshkruhet nga inspektori dhe drejtori i institucionit përkatës:

6.1. Ministria mund të ndërpresë punën e institucioneve arsimore dhe aftësuese të cilat nuk janë të licencuara apo veprojnë në ambiente të pasigurta dhe të pashëndetshme.

6.2. Ministria mund të udhëzojë komunën që të ndërpresë marrëdhënien e punës së një mësimitdhënësi që është punësuar në kundërshtim me kriteret e specifikuar në këtë ligj, ose është përjashtuar nga puna për shkak të kushteve mjekësore ose urdhrat të gjykatës apo dispozitat e këtij ose ligjeve të tjera në fuqi kërkojnë një gjë të tillë;

6.3. në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit, Ministria mund të kërkojë zbatimin e mësimi shtesë ose alternativ.

6.4. Ministria mund të anulojë notat në rastet kur nuk janë respektuar procedurat e vlerësimit si dhe diplomat dhe dokumentet tjera që janë marrë në kundërshtim me këtë ose ligjet tjera në fuqi.

7. Departamenti i Inspektimit gjithashtu ka përgjegjësinë të monitorojë dhe vlerësojë punën akademike të institucionit si pjesë e ciklit vjetor të inspektimit. Ministria, në konsultim me Agjencionin e Kosovës për

Kurrikul Standarde dhe Vlerësim përcakton kritere dhe procedura për inspektim kombëtar që mund të përfshijë ekspertë në disa fusha specifike akademike ose profesionale në përputhje me paragrafin 4. të nenit 25 të këtij ligji.

8. Ankesat ndaj vendimeve ose veprimeve të Inspektorit mund të bëhen pranë Komisionit për ankesa në Ministri.

SISTEMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 9

Organizimi i arsimit parauniversitar

1. Arsimimi parauniversitar dhe parashkollor organizohet përmes një kornize të mësimit tërë jetësor sipas niveleve të ISCED-it si vijon dhe në pajtim me fazat kryesore të Kornizës Kombëtare të Kurrikulimit:

1.1. niveli 0: Arsimi parashkollor (normalisht mosha zero (0) deri në gjashtë (6) vjeç, faza kyçe 0 dhe një pjesë e fazës 1 e KKK), i rregulluar me këtë ligj vetëm për moshën pesë (5) deri gjashtë (6) vjeçare (shkollë parafillore); përndryshe në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;

1.2. niveli 1: Arsimi fillor që zgjat 5 vite (normalisht prej moshës gjashtë (6) vjeçare, pjesa e mbetur e fazës 1 dhe 2 e KKK);

1.3. niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët që zgjat katër (4) vite (normalisht prej moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare, faza 3 dhe 4 e KKK);

1.4. niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë që zgjat tri (3) vite, varësisht nga kurrikulumi i përcaktuar nga Ministria (normalisht prej moshës pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, faza 5 dhe 6 e KKK), përfshirë gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit, dhe

1.5. niveli 4: Arsimimi postsekondar në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional në periudhën një (1) deri dy (2) vite (zakonisht nga mosha tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, specializimi passekondar në KKK).

1.6. programe të mësimit gjatë gjithë jetës për të rritur që mund të ofrohen në nivelet 3, dhe 4 të ISCED-it.

2. Shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë (6) vjeçare që është mosha minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED-it.

3. Edukimi parafillor bëhet i detyrueshëm siç është paraparë në dispozitat kalimtare.

4. Shkollimi i detyruar ofrohet falas.

5. Ministria mund të nxjerrë akte nënligjore për shmangien e situatave të jashtëzakonshme në lidhje me kërkesat për arsim të detyruar.

6. Fëmija, i cili në kohën e fillimit të vitit shkollor është nën minimumin e moshës së duhur për shkollimin e detyruar mund të regjistrohet në këtë shkollim në bazë të rekomandimit të shërbimit profesional pedagogjiko-psikologjik në shkollë. Vendimi për regjistrim merret nga drejtori i shkollës.

7. Ministria, përmes aktit nënligjor, mund të përcaktojë test përzgjedhës për shkolla të caktuara profesionale të nivelit 3 të ISCED-it.

8. Ministria, përmes një akti nënligjor, mund të modifikojë definicionet e niveleve të ISCED-it në përputhje me rezultatet e Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s në seancën e 36 (2011) duke u bazuar në rishikimin e ISCED-it siç ishte raportuar në konferencën e përgjithshme të UNESCO-s, seancën e 35-të (2009).

Neni 10

Dispozitat specifike për edukimin parashkollor

1. Edukimi parashkollor i fëmijëve nën moshën pesë (5) vjeçare është faza kyçe 0 e KKK, niveli 0 i ISCED-it, kujdesi i hershëm dhe edukimi i fëmijëve.
2. Klasa para fillore për fëmijët mbi moshën pesë (5) vjeçare është pjesë e fazës së 1-rë kyçe të KKK, nivelit 0 të ISCED-it, e inkorporuar në shkollimin e detyruar sipas nenit 9 të këtij ligji, zbatohet siç është paraparë në dispozitat kalimtare.
3. Sipas paragrafit 6. të këtij neni, kurrikulumi i kujdesit dhe edukimit të hershëm rregullohet me KKK.
4. Kujdesi dhe edukimi i hershëm mund të organizohet në institucionet publike parashkollore, institucionet private parashkollore, qendrat socio-kulturore, të licencuara sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore.
5. Komunat mund të ndërmarrin veprime të nevojshme, përfshirë ofrimin e asistencës financiare, për të përkrahur iniciativat private për kujdes dhe edukim të hershëm.
6. Kurrikulimi, procedurat e miratimit të planit të punës, natyra dhe kohëzgjatja e programeve për kujdes dhe edukim të hershëm, çështjet e inspektimit, financimit, personelit dhe të tjera rregullohen përmes aktit nënligjor.

Neni 11

Dispozitat specifike për arsimin dhe aftësimin profesional

Arsimi dhe aftësimi profesional rregullohet përmes ligjit për arsimin dhe aftësimin profesional nr. 02/L-42, 23 shkurt 2006, përderisa nuk është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 12

Dispozitat specifike për arsimin dhe aftësimin e të rriturve

1. Qëllimi i arsimit dhe i aftësimin të rriturve është zhvillimi i shkathtësive, njohurive dhe parimeve të duhura të të rriturit si pjesë e kornizës së të mësuarit gjatë gjithë jetës.
2. Të rriturit mund të arsimohen ose aftësohen në institucionet e licencuara private, publike dhe të partneritetit të niveleve 3 dhe 4 të ISCED-it, sipas dispozitave të këtij ligji, me ndryshimet në vijim të cilat specifikohen në një akt nënligjor:
 - 2.1. përshtatja e kurrikulimit, vlerësimi i të mësuarit paraprak, kohëzgjatja e programeve, vijimi, vlerësimi dhe procedurat e tjera për të mësuarit e të rriturve;
 - 2.2. caktimi i pagesave për vijim dhe kriteret e pranimit;

2.3. përcaktimi, në bazë të këshillave të Këshillit Shtetëror për Licecimin të Mësimdhënësve (KSHLM), i kualifikimeve për mësimdhënës, trajnerë, instruktorë, apo personel tjetër i përfshirë në arsimin dhe aftësimin profesional.

2.4. përcaktimi i kriterëve shtesë për licencimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimin, të cilat ofrojnë programe për arsimin dhe aftësimin e të rriturve;

2.5. financimi i institucioneve të arsimit dhe aftësimin për ofrimin e programeve efektive për arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

Neni 13

Themelimi i institucioneve arsimore

1. Shkollat fillore (niveli 1 i ISCED-it) dhe të mesme të ulëta (niveli 2 i ISCED-it) themelohen në çdo komunë. Shkollat e këtyre niveleve mund të kombinohen.

2. Komuna mund të themelojë dhe mbajë paralele të ndara të nivelit 1 dhe 2 të ISCED-it në zonat në të cilat nuk ka shkolle amë, sipas kriterëve të vendosura nga Ministria me aktin nënligjor.

3. Komunat, brenda territorit të tyre, sigurojnë ofrimin e shkollimit në nivelin 1, 2 dhe 3 të ISCED-it në të gjitha gjuhët e mësimdhënies edhe nën numrin minimal për regjistrim të nxënësve të përcaktuar me akt nënligjor, ose ofrojnë alternativa, duke përfshirë në mes të tjerash, transportin e subvencionuar deri në vendin ku ofrohet shkollimi.

4. Arsimi dhe aftësimi profesional në nivelin 3 të ISCED-it mund të bëhet në shkolla apo në institucione të aftësimin, qofshin ato publike apo private, ose në ndërmarrje publike apo private.

5. Arsimi profesional passekondar në nivelin 4 të ISCED-it mund të bëhet në kolegje, institucione të aftësimin, qofshin ato publike apo private, në ndërmarrje publike apo private, ose sipas marrëveshjeve për partneritet që rregullohet sipas ligjit në fuqi. Ministria rregullon kushtet për pranim në programet e ofruara në institucionet e financuara nga fondet publike ose në institucionet passekondare jouniversitare të partneritetit.

Neni 14

Caktimi i nxënësve nëpër institucionet arsimore

1. Secila shkollë e nivelit 1 dhe 2 të ISCED-it ka zonën e saj të mbulimit, të përcaktuar nga komuna.

2. Të gjithë nxënësit e moshës së shkollimit të detyruar që jetojnë në atë zonë kanë të drejtën e regjistrimit dhe vijimit të shkollës së nivelit përkatës.

3. Për nxënësit me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara, sipas nenit 39 të këtij ligji, komuna ka për obligim që t'i regjistrojë ata nxënës dhe më pas të veprojë sipas procedurave të parapara në nenin 41 të këtij ligji.

4. Për nxënësit që flasin gjuhë jo-zyrtare dhe që jetojnë në një zonë të mbulimit ku nuk arrihet minimumi për hapjen e klasave apo të shkollave të niveleve 1 dhe 2 të ISCED-së për mësim në ndonjë gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare, komuna ofron alternativë, si parashihet në nenin 13, paragrafin 3. të këtij ligji.

5. Institucionet arsimore dhe aftësuese të nivelit 3 të ISCED-it kanë zonën e mbulimit të përcaktuar nga marrëveshja mes komunave (apo nga Ministria aty ku nuk mund të arrihet ndonjë marrëveshje) në bazë të llojit të arsimit apo aftësimin përkatës; dhe duhet të mundësohet transferi vullnetar mes llojeve të ndryshme të shkollave në këtë nivel në bazë të interesave dhe aftësive të nxënësit.

6. Vijimi në shkollat e caktuara të nivelit përkatës, ose çdo marrëveshje alternative e bërë sipas paragrafëve 3. deri 6. të këtij neni, është i detyruar për nxënësit e moshës së shkollimit të detyruar, përveç nëse transferohen në ndonjë shkollë tjetër ose lirohen nga vijimi.

7. Në raste të veçanta, komuna mund të lirojë nxënësit nga obligimi për të vijuar shkollën e caktuar sipas paragrafit 2. të këtij neni nëse konstatohet se kjo është në interes të nxënësit pas kërkesës së bërë nga prindërit e nxënësit dhe është siguruar arsimimi adekuat alternativ në nivelin përkatës.

8. Prindërit e nxënësit që jeton jashtë zonës së mbulimit të ndonjë shkolle të caktuar mund të aplikojnë në komunën përkatëse për të regjistruar fëmijën në atë shkollë. Vendet e tilla caktohen në mënyrë të drejtë nga Komuna, në bazë të kriterëve transparente dhe të publikuara.

9. Kalimi i obligueshëm prej një shkolle në tjetrën në rastet kur kjo duhet të bëhet për të mirën e nxënësve të tjerë rregullohet përmes dispozitave të këtij ligji.

10. Përfshirja e nxënësve në institucionet e aftësimit në nivelin 4 të ISCED-it rregullohet me akt nënligjor.

Neni 15 **Vijueshmëria në shkollë**

1. Vijimi i shkollimit të detyruar nga ana e nxënësit është një përgjegjësi kryesore e prindit.

2. Prindi i fëmijës së moshës së shkollimit të detyruar bën shkelje të ligjit, nëse:

2.1. nuk e regjistron fëmijën në shkollë publike, institucion aftësimi, shkollë speciale ose shkollë private të licencuar dhe të përshtatshme për moshën e fëmijës dhe për nivelin e mësimi, ose nuk bën aranzhime alternative për arsimimin e fëmijës me miratim nga Ministria sipas nenit 47 të këtij ligji, ose

2.2. pa shkak të arsyeshëm, si është sëmundja apo ndonjë shkak tjetër i pashmangshëm, nuk i siguron fëmijës vijim të rregullt në institucionin arsimor në kohën e përcaktuar nga këshilli drejtues për fillimin e mësimi.

3. Kur drejtori i institucionit arsimor dhe aftësues e sheh të arsyeshme dhe në interesin më të mirë të nxënësit, pas marrjes së kërkesës me shkrim nga prindërit e nxënësit, mund ta lirojë nxënësin nga vijimi i mësimi deri në (2) dy javë gjatë vitit shkollor.

4. Nëse nxënësi pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk vijon shkollimin ose e ndërprente shkollimin e detyruar, prindërit e tij dënohen për kundërvajtje nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose i neglizhencës së prindërve. Në raste të tilla, komuna e njofton Ministrinë me shkrim.

5. Për të promovuar vijimin ose zvogëluar braktisjen e shkollës, komuna organizon transport të sigurt dhe efikas për nxënësit në shkollimin e detyruar. Komuna mund të kërkojë pagese por edhe mund të bëjë falas transportin shkollor, për:

5.1. nxënësit që jetojnë në zonën e mbulimit, por që janë brenda distancës prej katër (4) kilometra nga shkolla, përveç nxënësve me aftësi të kufizuara; dhe

5.2. nxënësve që jetojnë jashtë zonës së mbulimit.

6. Ministria përgatit udhëzime për të ndihmuar komunat dhe institucionet arsimore dhe aftësuese për të adresuar në mënyrë afektive braktisjen.

Neni 16 **Këshilli i Prindërve të Kosovës**

1. Ministria themelon Këshillin e Prindërve të Kosovës (KPK). Ky Këshill ka nëntë (9) anëtarë. Kohëzgjatja e mandatit të tyre është katër (4) vite dhe anëtarët zgjedhin kryesuesin dhe nënkryesuesin e Këshillit.

2. Funkzioni i KPK-së është përfaqësimi i interesave të prindërve, inkurajim dhe avancim i rolit të prindërve si palë e rëndësishme e interesit në promovimin e cilësisë në arsim, përcjellja e mendimeve të prindërve te Ministria lidhur me çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar dhe të jetë kanali kryesor i komunikimit dhe këshillimit mes Ministrisë, institucioneve arsimore e aftësuese dhe prindërve.

3. Ministria nxjerr akt nënligjor për punën e KPK-së, procedurat për emërimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të tij, duke përfshirë gjithmonë anëtarë të komuniteteve jo shumicë.

4. Ministria siguron buxhetin vjetor dhe infrastrukturën logjistike që të mundësojë punën efektive të KPK-së.

PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Neni 17 **Këshilli drejtues**

1. Çdo institucion publik arsimor dhe aftësues duhet të ketë këshillin drejtues. Në rast se këshilli drejtues nuk mund të formohet ose nuk mund të mblidhet në periudhën prej tre (3) muajsh, funksionet e tij merren nga drejtori i institucionit, me kusht që komuna (Ministria në rastet e institucioneve të nivelit 4 të ISCED-it) vazhdon me përpjekjet e mëtutjeshme për ta themeluar këtë këshill dhe për të mbajtur takimet e tij çdo tre (3) muaj.

2. Këshilli drejtues përbëhet nga:

2.1. tre (3) përfaqësues të prindërve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në komunë nëse ka ndonjë nxënës nga ato komunitete në atë institucion;

2.2. dy (2) përfaqësues nga shoqëria (palë me interes të emëruara nga komuna);

2.3. tre (3) përfaqësues të mësimdhënësve

2.4. për shkollat e nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it, një përfaqësues të nxënësve, i zgjedhur nga nxënësit që vijnë në shkollimin.

3. Në rastet kur shkollat e nivelit 1-2 të I ISCED-it ose institucionet arsimore të nivelit 3 të ISCED-it kanë më shumë se 1000 nxënës, numri i anëtarëve duhet të ngritet në katër, në tre, në katër dhe në dy në kategoritë përkatëse sipas paragrafit 2. të këtij neni. Nëse numri i nxënësve bie nën 1000, numri i anëtarëve duhet të reduktohet në nivelin minimal, ashtu që anëtari që është zgjedhur i fundit në secilin grup të kryej mandatin e tij në fund të vitit shkollor.

4. Përfaqësuesit e prindërve në këshillin drejtues zgjidhen me votim të fshehtë nga anëtarët e Këshillit të Prindërve të Shkollës.

5. Këshilli drejtues ka të drejtë të caktojë përfaqësues shtesë pa të drejtë vote, për të siguruar përfaqësim të gjerë të punëdhënësve dhe shoqërisë në përgjithësi.

6. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat tri (3) vite, me kusht që ata të vazhdojnë të jenë mësimdhënës, nxënës, prindër të nxënësve në shkollën përkatëse. Përfaqësuesit e prindërve dhe mësimdhënësve mund të zgjidhen në mandatin e dytë.

7. Kryetari i këshillit drejtues zgjidhet çdo vit nga këshilli drejtues nga radhët e përfaqësuesve të prindërve. Kryetari mund të rizgjidhet.

8. Drejtori i institucionit arsimor ushtron funksionin e Sekretarit të Këshillit drejtues. Drejtori i raporton Këshillit drejtues për çdo vit lidhur me aktivitetet dhe financat e institucionit, dhe ka të drejtën që të sugjerojë zgjidhje dhe të marrë pjesë në debate, por jo edhe të drejtën e votës. Drejtori i shkollës është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Këshillit.

9. Këshilli drejtues i shkollës mund të ftojë Drejtorin komunal të arsimit dhe/ose zëvendësin e tij që të marrë pjesë në takimet e Këshillit, në mënyrë që të ofrojë informata ose sqarime apo të dëgjojë pikëpamjet e Këshillit drejtues, por pa të drejtë vote.

10. Këshilli drejtues gjatë zbatimit të kompetencave dhe detyrave të tij, i respekton parimet e arsimit parauniversitar të parapara në këtë ligj, duke përfshirë edhe respektimin e të drejtave të komuniteteve.

11. Këshilli drejtues i shkollës në nivelet 1,2 dhe 3 të ISCED-së, ka detyrat dhe kompetencat si vijon:

11.1. të hartojë rregullat e shkollës të specifikuar në nenin 22 të këtij ligji, për t'u miratuar nga komun;

11.2. të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve nga anëtarët e Këshillit Drejtues, që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve në emërimin e drejtorit, zëvendës drejtorit dhe mësimdhënësve të shkollës;

11.3. të ushtrojë funksionet e ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës, siç është përcaktuar në këtë ligj.

11.4. të vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë;

11.5. të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës;

11.6. të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve;

11.7. të shpreh pikëpamjet e veta për çështjet që kanë të bëjnë me shkollën apo çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar;

11.8. të miratojë listën e teksteve shkollërore dhe materialeve të tjera shkollërore për t'u përdorë në shkollë në bazë të propozimeve të mësimdhënësve të shkollës, brenda kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

11.9. të kontribuojë në hartimin e planit zhvillimor të arsimit nga komuna në rastet, kur ka të bëjë me shkollën përkatëse;

11.10. të ushtrijë funksionet e tjera që i janë deleguar nga komuna në pajtim me ligjin;

12. Këshilli drejtues mban dokumentacionin e duhur për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet. dhe sipas kërkesës i vë në dispozicion për procedura të auditimit dhe inspektimit.

13. Këshilli drejtues i shkollës, me propozimin e drejtorit të shkollës, mund të themelojë organe të tjera këshilluese brenda shkollës.

14. Përfaqësuesit e nxënësve, në organet drejtuese të shkollës, nuk marrin pjesë në pjesët e takimit dhe diskutimet për çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit apo çështjet personale të drejtorit, zëvendësdrejtorit, mësimdhënësve, punëtorëve tjerë të shkollës apo me çështje personale që kanë të bëjnë me nxënësit e tjerë.

15. Anëtari i Këshillit drejtues të shkollës nuk merr pjesë në pjesët e takimit dhe diskutimet për çështjet ku ai ka interes personal ose financiar dhe deklaron interesin e tillë në fillim të takimit.

16. Këshilli drejtues duhet të mbajë regjistrin e interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe të personelit drejtues të shkollës.

Neni 18

Këshilli i nxënësve

1. Këshilli drejtues i çdo shkolle të nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it themelon një këshill të nxënësve, i cili duhet të ketë së paku një nxënës të zgjedhur nga secila klasë dhe që zgjidhet çdo vit përmes votës së fshehtë.

2. Roli i Këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe të përfaqësohen në këshillin drejtues.

Neni 19

Këshilli i prindërve

1. Çdo institucion arsimor apo aftësues duhet të ketë këshill të prindërve.

2. Kompetencat dhe fushë veprimtaria e Këshillit të prindërve përcaktohen përmes aktit të veçantë nënligjor.

3. Këshilli i prindërve zgjidhet me vota të fshehta të gjithë prindërve të nxënësve që vijnë në mësimin në atë institucion.

4. Prindërit, përveç përfaqësimit në Këshillin e Prindërve, kanë të drejtë t'i paraqesin ankesat e tyre, drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues, komunës dhe Ministrisë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mjedisin shkollor.

Neni 20

Personeli udhëheqës

1. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i institucionit arsimor dhe aftësues zgjidhen në bazë të Ligjit mbi arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr 03/L-068, 21 Maj 2008, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASHT me akt nënligjor, duke i shtuar edhe dy përfaqësues të Këshillit drejtues në cilësinë e vëzhguesve në komisionin e përbashkët të emërimit.

2. Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- 2.1. caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- 2.2. detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit;
- 2.3. përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës;
- 2.4. ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria;
- 2.5. detyrat lidhur me kurrikulumin;
- 2.6. çështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji.

Neni 21

Sekretari ose administratori

1. Institucionet arsimore dhe aftësuese që kanë më shumë se pesëqind (500) nxënës kanë të drejtën të kenë sekretar ose administrator, i cili zgjidhet nga komuna përmes konkursit publik; Komuna mund të vendos të emërojë një sekretar apo administrator për institucione më të vogla përmes konkursit publik.
2. Kompetencat dhe përgjegjësit e sekretarit ose administratorit përcaktohen nga komuna në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 22

Rregullat e shkollës

1. Komuna, pas pranimit të propozimit të këshillit drejtues të shkollës, miraton rregullat e parapara për të promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve, dhe për të promovuar konceptin e shkollave të shëndetshme dhe eliminimin e dhunës.
2. Rregullat e shkollës i caktojnë të drejtat dhe detyrimet e nxënësve që nuk janë parashikuar në këtë ligj apo aktet nënligjore të nxjerra sipas tij, por ato janë të bazuara gjithmonë në legjisllacionin në fuqi.
3. Prindi, i cili është i pakënaqur me vendimet e komunës sipas këtij neni, mund të ankohet te kryetari i komunës dhe nëse prindi është i pakënaqur me vendimin e kryetarit të komunës, ai mund të dorëzojë një ankesë në Ministri në lidhje me mosrespektimin e Kushtetutës apo ligjit në fuqi. Vendimi i Ministrisë do të jetë përfundimtar në procedurën administrative.
4. Komuna siguron mësimin alternativ, për nxënësit që janë larguar nga shkolla, në shkollën në të cilën nxënësit janë transferuar, në bazë të dispozitave të këtij ligji.
5. Komuna sipas kompetencave mund të udhëzojë drejtorin e shkollës apo Këshillin drejtues të shkollës, në rastet kur sipas mendimit të komunës, edukimi, arsimit apo siguria në shkollë është ose mund të dëmtohet në një të ardhme të afërt nga veprimet e nxënësve apo prindërve.
6. Obligohen nxënësit për bartjen e uniformes shkollore.

Neni 23

Aktivitetet jashtëshkollore

1. Drejtori i shkollës ose Këshilli i prindërve, me pëlqimin e Këshillit drejtues, mund të organizojë aktivitete jashtëshkollore.
2. Aktivitetet jashtëshkollore rregullohen me akt të veçantë nënligjor.

KURRIKULUMI, TEKSTET SHKOLLORE, MJETET MËSIMORE DHE STANDARDET

Neni 24

Korniza e Kurrikulumit e Kosovës

1. Ministria përmes Agjencisë së Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV), harton Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës (KKK).
2. Përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve duhet të përfshihen në zhvillimin apo rishikimin e KKK-së.
3. KKK përbëhet nga kurrikulumit bërthamë dhe kurrikulumit me bazë shkolle për secilin nivel të arsimit parauniversitar dhe përcakton fushat mësimore.
4. KKK shërben si bazë për hartimin e kurrikulumeve lëndore.
5. Ministria, AKKSV, komuna, Këshilli drejtues dhe drejtori i një institucioni arsimor dhe aftësues ushtrojnë funksionet e tyre përkatëse sipas këtij ligji me qëllim që të sigurojnë se Korniza e Kurrikulumit të Kosovës, i përmbahet parimeve në vijim: edukimi dhe arsimimi cilësor për të gjithë, gjithë përfshirja, qasja e bazuar në kompetenca, fleksibiliteti dhe lëvizshmëria, transparenca dhe llogaridhënia dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe:
 - 5.1. promovon zhvillimin intelektual, moral, kulturor dhe fizik të nxënësve dhe të shoqërisë;
 - 5.2. përgatit nxënësit për mundësitë dhe përgjegjësitë për jetë dhe punë të suksesshme;
 - 5.3. përcakton njohuritë, shkathtësitë dhe vlerat sipas nivelit të arsimit të shprehura në kompetenca kryesore;
 - 5.4. promovon frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës mes të gjitha komuniteteve.
6. Përmes aktit nënligjor për secilin nivel të arsimit parauniversitar, Ministria specifikon:
 - 6.1. përmbajtjen e kurrikulumit bërthamë, duke përfshirë kurrikulumet lëndore, ndarjen e kohës mësimore për kurrikulumin bërthamë dhe atë shkollor, duke pasur parasysh që kurrikulumit me bazë shkolle të mos kalojë 20 % të totalit;
 - 6.2. mësimin e një apo më shumë gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës nga të gjithë nxënësit, duke përfshirë nxënësit nga komunitetet pakicë që nuk mësojnë në njërin nga gjuhët zyrtare;
7. Sipas dispozitave të Ligjit për arsim në komuna, nr. 03/L-068, 21 Maj 2008, institucionet arsimore, qofshin ato publike apo private, nuk mund të devijojnë nga kurrikulumit bërthamë, përveç në:
 - 7.1. rrethana të veçanta me lejen e Ministrisë, të lëshuar pas konsultimeve me AKKSV-në;

7.2. me miratimin e Ministrisë, për qëllime të projekteve inovative sipas paragrafit 11. të nenit 5 të këtij ligji; ose

7.3. kur plani individual arsimor për ndonjë nxënës të caktuar miratohet sipas paragrafit 6. të nenit 41 të këtij ligji.

8. KKK u mundëson të gjithë nxënësve të zgjerojnë njohuritë rreth identitetit, Kulturës dhe gjuhës së tyre, si dhe inkurajon dialogun ndërkulturor.

9. Brenda kurrikulumit me bazë shkolle, institucionet arsimore janë të lira që të mbajnë çdo lëndë që nuk është e ndaluar me këtë ligj ose ligje të tjera në fuqi.

Neni 25

Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim

1. Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV) themelohet si agjenci për të udhëhequr çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e kurrikulumit, standardeve dhe vlerësimit.

2. AKKSV është agjenci ekzekutive që vepron nën Ministrinë.

3. Statusi dhe puna e AKKSV-së rregullohet me akt nënligjor.

4. AKKSV zhvillon Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës dhe kurrikulumin e lëndëve përmes një procesi të rregullt të diskutimit me përfaqësuesit e mësimdhënësve dhe komunave, me organizatat përfaqësuese të komunitetit, si dhe me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe rekomandimet për:

4.1. përmbajtjen e kurrikulumit bërthamë, përfshirë metodologjinë qendrore dhe programet mësimore të lëndëve; objektivat, rezultatet e të mësuarit për secilën lëndë që lidhet me fazat kryesore të kurrikulumit dhe kompetencat kryesore që duhet të arrihen në fund të nivelit 3 të ISCED-së;

4.2. matjen dhe vlerësimin e standardizuar të suksesit të nxënësve në intervale të përcaktuara dhe kriteret për përparimin e nxënësve që janë në përputhje me kushtet e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve për vlerësim që çojnë në dhënien e kualifikimeve;

4.3. listën e teksteve të rekomanduara si dhe burime të tjera mësimore, përfshirë këtu materiale të përshtatshme për përdorim nga nxënësit që kanë vështirësi në mësim apo ata me aftësi të kufizuara.

Neni 26

Tekstet shkollore dhe mjetet e tjera mësimore

1. Me qëllim të sigurimit të cilësisë së materialeve që përdoren në institucionet publike arsimore dhe aftësuese, Ministria miraton tekstet shkollore dhe mjetet e materialet e tjera mësimore sipas këshillave të AKKSV-së, dhe sipas rregullave të prokurimit, hartimit, rishikimit dhe publikimit të cilat përcaktohen në një akt nënligjor.

2. Vetëm materialet miratuara nga Ministria, sipas këtij neni, mund të përdoren në institucionet publike.

3. Këshillat drejtuese të institucioneve arsimore ose aftësuese miratojnë nga lista e miratuar nga Ministria, tekstet shkollore dhe mjetet e materialet tjera mësimore, sipas propozimeve të mësimdhënësve, për përdorim në institucione përkatëse.

4. Tekstet shkollore të miratuara nga Këshilli drejtues në nivelet 1 dhe 2 në bazë të paragrafit 2. të këtij neni ofrohen falas.

Neni 27

Tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve

1. Tekstet shkollore në gjuhën serbe për nivelin 1 dhe 2 do të përdoren siç është përcaktuar me ligjin në fuqi dhe jepen falas.

2. Tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve në të cilat është duke u zhvilluar mësimi për nivelet 1 dhe 2 ofrohen falas.

SISTEMI I FINANCIMIT

Neni 28

Financimi

1. Burimet e financimit të arsimit dhe aftësisht parauniversitar janë:

1.1. granti specifik i arsimit si i bazuar në ligjin për financat e pushtetit lokal, nr. 03/L-049, 13 Mars 2008, dhe ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr.03/L-048, 13 Mars 2008 për të financuar nivelin minimal të standardeve të arsimit parauniversitar dhe duhet të alokohet për komuna në bazë të parametrave dhe standardeve të siguruara nga Ministria.

1.2. të hyrat vetanake që gjenerohen nga institucionet arsimore dhe aftësuese, dhe

1.3. financim shtesë nga granti i përgjithshëm komunal, varësisht nga mundësitë financiare të komunës.

2. Granti specifik për arsim definohet në bazë të qasjes së financimit të hapur sipas ligjit për financat e pushtetit lokal u ndahet komunave sipas formulës shtetërore për financimin e arsimit parauniversitar, të miratuar nga Komisioni i granteve.

3. Formula shtetërore e financimit të arsimit parauniversitar në paragrafin 2. të këtij neni bazohet në

3.1. numrin e nxënësve të regjistruar,

3.2. përpjesëtimet nxënës – mësimdhënës për ndarjen e personelit dhe kalkulimin e pagave sipas pagave mesatare,

3.3. financimin për zëvendësimin e mësimdhënësve në pushim mjekësor dhe të lindjes,

3.4. financimin për shkollë sipas llojit dhe madhësisë së objekteve shkollore,

3.5. financimin e shkollave në zona të thella malore, si dhe

3.6. financim për kokë të nxënësit për shpenzime operative dhe investime kapitale.

4. Ministria në konsultim me Drejtoratet e Arsimit Komunal mund të konsolidojë kriteret e formulës.

5. Ajo që i referohet komunës është e njëjtë për Ministrinë në rastet e institucioneve që ofrojnë programe të nivelit 4 të ISCED-it. Kriteret për financimin e institucioneve të nivelit 4 të ISCED-it përcaktohen nga Ministria.

Neni 29 **Delegimi i autoritetit financiar**

1. Komuna delegon përgjegjësinë për buxhet dhe financa tek institucionet arsimore dhe aftësuese sipas formulës komunale të specifikuar në një akt nënligjor; formula duhet të lejojë ndryshime nëse ndryshon numri i nxënësve gjatë vitit fiskal.

2. Komuna mban të drejtën të rishikojë formulën komunale në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe aftësuese.

3. Kur përgjegjësia delegohet sipas paragrafit 1. të këtij neni:

3.1. çdo Këshill drejtues duhet të ketë çdo vit fiskal një buxhet të alokuar dhe në bazë të asaj ndarje, miraton planin buxhetor;

3.2. Këshilli drejtues i institucionit mund të delegojë përgjegjësinë për shpenzime në fusha të specifikuar dhe me limite të specifikuar financiare te drejtori i institucionit. Aranzhimet e tilla i nënshtrohen orarit të delegimit, të miratuar dhe mund të anulohen nga komuna përkatëse;

3.3. komuna apo Këshilli drejtues i institucionit ('autoriteti delegues') sigurojnë dispozita të përshtatshme financiare për personel dhe pajisje lidhur me zbatimin efikas të funksioneve administrative të deleguara në lidhje me buxhetin;

3.4. çdo shumë e siguruar nga komuna për Këshillin drejtues të institucionit mbetet pronë e komunës derisa këshilli drejtues apo drejtori ta shpenzojnë atë sipas nevojës;

3.5. çdo pasuri e blerë me fonde nga buxheti i shkollës do të mbetet pronë e shkollës, respektivisht komunës dhe do të menaxhohet nga Këshilli drejtues i institucionit ose drejtori, sipas planit të delegimit;

3.6. nuk mund të tejkalohet pjesa e miratuar e buxhetit për një institucion arsimor apo aftësues;

4. Çdo kontest mes Këshillit drejtues të institucionit dhe drejtorit, sa i përket buxhetit të institucionit, i nënshtrohet një arbitrimi obligues të bërë nga komuna.

5. Çdo kontest mes komunës dhe këshillit drejtues, sa i përket buxhetit të institucionit, i nënshtrohet një arbitrimi obligues të bërë nga Ministria.

Neni 30 **Monitorimi**

1. Autoritetet deleguese monitorojnë ushtrimin e autoritetit të deleguar.

2. Autonomia financiare që u jepet këshillave drejtuese të institucionit dhe drejtorëve i nënshtrohet përgjegjësisë ndaj autoritetit delegues në formë të raporteve të audituara vjetore, të përpiluara për autoritetin delegues.

3. Delegimi i autoritetit mund të pezullohet ose anulohet nëse autoriteti delegues përcakton se fondet janë menaxhuar keq ose janë përdorur për qëllime tjera e jo për ato për të cilat janë deleguar.

4. Anulimi i autoritetit të deleguar sipas paragrafit 3. të këtij neni ndodh vetëm pas konsultimeve me palëve dhe përveç rasteve urgjente kur pandehet se fondet janë keq menaxhuar, do të kërkohet nga autoriteti delegues që të japë së paku tridhjetë (30) ditë lajmërim për anulimin e planifikuar.

5. Çdo kontest mes komunës dhe Këshillit drejtues të institucionit lidhur me këtë pjesë i dërgohet Ministrisë për vendim.

PERSONELI MËSIMDHËNËS DHE UDHËHEQËS

Neni 31

Krijimi i bazës profesionale për mësime dhënë

1. Mësime dhënësit janë shërbyes profesional publik që kryejnë detyra në institucionet arsimore dhe aftësuese sipas legjislacionit në fuqi dhe të cilët përmbushin kushtet e nevojshme të parapara me këtë ligj për kualifikim dhe licencim.

2. Një person i cili nuk i përmbush kushtet e nevojshme për të qenë mësime dhënë, siç përcaktohet në këtë ligj, mund të punësohet në një institucion arsimor dhe aftësues si asistent apo instruktor për të ndihmuar punën e një mësime dhënësi të kualifikuar dhe të licencuar, nëse drejtori i institucionit është i bindur se ky person posedon aftësitë, ekspertizën dhe përvojën e nevojshme për një punë të tillë dhe nuk diskualifikohet nga mbajtja e një pozite të tillë sipas këtij ligji, apo ndonjë ligji tjetër në fuqi.

3. Kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktorëve përcaktohen me një akt të veçantë nënligjor.

4. Ministria siguron që brenda resurseve në dispozicion, të aftësohen punonjës të mjaftueshëm për të plotësuar obligimet lidhur me edukimin dhe arsimin në gjuhët jozyrtare dhe lidhur me kurrikulin specifik për komunitete.

Neni 32

Këshilli shtetëror për licencimin e mësime dhënëve

1. Ministri emëron anëtarët e Këshillit Shtetëror për Licencim e Mësime dhënëve (në vijim KSHLM), përbërja e të cilit dhe rregullon procedurat e tij, pagesat dhe çështjet e tjera, si kërkohen me këtë ligj apo me ligje të tjera në fuqi.

2. KSHLM ka detyra dhe përgjegjësi, si përcaktohen me akte nënligjore.

3. Procedurat zyrtare të KSHLM-së mbi lëshimin dhe revokimin e licencave të mësime dhënëve janë të hapura për inspektim publik.

4. Ministria, me akte nënligjore, mund të delegojë një ose më shumë funksione të KSHLM-së, si dhe mund të anulojë delegime të tilla.

5. Nëse delegimi i funksioneve bëhet sipas paragrafit 4. të këtij neni, Komisioni për ankesa dhe parashtrësia në MASHT do të veprojnë si një trup për ankesa ndaj vendimeve relevante të KSHLM-së për arsye të mos pajtueshmërisë me këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër në fuqi.

Neni 33

Licencimi i mësime dhënëve

1. Licencimi i mësimdhënësve, zhvillimi i kornizës dhe standardet për zhvillim profesional dhe vlerësim të performancës është përgjegjësi e Ministrisë, e cila vepron sipas këshillave dhe rekomandimeve të KSHLM-së.
2. Licencimi i mësimdhënësve përcakton kërkesat që duhet plotësuar nga mësimdhënësit për të hyrë dhe qëndruar në profesion, si dhe kriteret dhe kërkesat për avancim në sistemin e licencimit.
3. Ministria, përmes aktit nënligjor, sipas këshillave të KSHLM-së, përcakton:
 - 3.1. sipas paragrafit 4. të këtij neni, kërkesat për kualifikim të mësimdhënësve, duke përfshirë nivelin e kërkuar të kualifikimit për një nivel të caktuar të arsimit parauniversitar.
 - 3.2. procedurat për avancimin e kualifikimit të mësimdhënësve ekzistues duke organizuar kualifikimin e tyre në nivelin e njëjtë të kërkuar për mësimdhënës të rinj, deri në Gusht 2020.
 - 3.3. kërkesat për zhvillim profesional dhe performancë të mësimdhënësve në kuadër të procesit të licencimit.
 - 3.4. standardet dhe procedurat e akreditimit të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
 - 3.5. standardet e praktikës profesionale të mësimdhënësve;
4. Të gjitha programet universitare që qojnë drejt kualifikimit për mësimdhënës duhet që më së voni deri në fillim të vitit akademik 2012/2013 të jenë ekuivalent me programet e ciklit të dytë prej 300 ECTS që përmbajnë komponentën akademike, profesionale dhe pjesë praktike, detajet e të cilave rregullohen përmes aktit nënligjor.
5. Në rastin e mësimdhënësve të nivelit 4 të ISCED-it, duke përfshirë ata të punësuar në institucionet për arsimimin dhe aftësimin profesional, Ministria, në bazë të rekomandimeve të KSHLM-së, mund të specifikojë kërkesa shtesë apo alternative për aftësim që pasqyrojnë karakterin profesional të këtij niveli. Kualifikimet e tilla përcaktohen në një akt nënligjor.
6. Pas rekomandimit të KSHLM-së, Ministria mund të saktësojë kualifikime shtesë për mësimdhënësit e nxënësve me vështirësi në të mësuar, të nxënësve me pengesa në dëgjim, të nxënësve me pengesa në të parë dhe të nxënësve që kanë pengesa në dëgjim dhe në të parë. Ato kualifikime përcaktohen përmes aktit nënligjor.
7. Rivlerësimi i një mësimdhënësi të licencuar me qëllim të përtëritjes së licencës, do të ndodhë në një interval kohor që nuk kalon pesë vite nga data e lëshimit të licencës ekzistuese.
8. Rivlerësimi i një mësimdhënësi të licencuar mund të iniciohet në çdo kohë, nëse puna e mësimdhënësit është një çështje për t'u bregosur; në raste të tilla, komuna ndërmerr hapat e duhur për t'i dhënë udhëzime dhe përkrahje mësimdhënësit në fjalë.
9. Një licencë mund të revokohet apo pezullohet nga Ministria nëse sipas mendimit të saj, bazuar në një raport të përpiluar nga një mjek i pavarur, mësimdhënësi nuk është në gjendje të vazhdojë punën për shkak të mungesës së kapaciteteve shëndetësore, fizike apo mentale. Në raste të tilla, mësimdhënësi në fjalë do të ketë të drejtën për të paraqitur dëshmi mjekësore dhe të ankohet me shkrim në Ministri. Vendimi i Ministrisë do të jetë përfundimtar.

10. Një licencë mund të merret apo pezullohet nga Ministria me kërkesë të drejtorit komunal të arsimit, atëherë kur procedurat disiplinore janë ndërmarrë kundër një mësimitdhënësi. Pezullimi do të shqyrtohet pas përfundimit të procedurave të tilla dhe ndonjë ankese që mund të paraqitet.

11. Licenca tërhiqet menjëherë nga Ministria pas shqiptimit të dënimit për shkelje të ligjit ose për vepra të padenja që përfshijnë fëmijët. Organet e caktuara shtetërore do të lajmërohen për këtë tërheqje sipas ligjit në fuqi.

12. Nëse një person, i cili e ka marr licencën sipas këtij neni, lë përkohësisht profesionin e mësimitdhënies me vullnetin e tij, mund të kthehet në statusin e mësimitdhënësit me licencë të rregullt pa ndonjë periudhë provuese, nëse mungesa e tij është më e shkurtër se pesë (5) vite. Kjo dispozitë nuk është e aplikueshme për mësimitdhënësit e shkarkuar nga pozitat e tyre.

Neni 34

Kualifikimet shtesë për emërim në pozita udhëheqëse dhe inspektorë

1. Kandidatët që aplikojnë për pozitën e drejtorit apo zëvendësdrejtorit të një institucioni arsimor apo inspektorit të arsimit duhet të posedojnë licencën si mësimitdhënësi të kualifikuar.

2. Me kërkesë të komunës dhe sipas këshillave të KSHLM, Ministria mund të ndryshojë kushtet e kërkuara në paragrafin 1. të këtij neni në raste të veçanta.

3. Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore dhe aftësuese që tërësisht apo kryesisht punojnë në gjuhët e komuniteteve do të jenë përfaqësues të atyre komuniteteve dhe do të jenë plotësisht të familjarizuar me identitetin e komunitetit përkatës.

4. Të gjithë drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore dhe cilido person tjetër me përgjegjësi për të administruar institucionet arsimore që mbajnë pozitat e tyre deri në datën kur do të hyjë ky ligj në fuqi, duhet të kenë përfunduar me sukses deri më 31 korrik 2013 një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose fusha të ngjashme, i cili duhet të jetë i autorizuar nga Ministria sipas rekomandimeve nga KSHLM-ja.

5. Nga data 1 gusht 2013, të gjithë kandidatët për postet e cekura në paragrafin 4. të këtij neni para emërimit të tyre duhet të kenë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose fushë të ngjashme, i cili është i autorizuar nga Ministria sipas rekomandimeve të KSHLM-së.

6. Ministria, përmes një akti nënligjor, sipas këshillave të KSHLM, përcakton kërkesat për zhvillim profesional për personat që mbajnë pozitat e cekura në paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 35

Zgjedhja ose emërimi i drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve dhe instruktorëve

1. Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore, mësimitdhënësit, asistentët dhe instruktorët zgjidhen përmes një konkursi publik në bazë të meritës personale, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për arsye reale apo të supozuara që ka lidhje me gjininë, racën, gjendjen martesore, orientimin seksual, përkatësinë etnike, nevojat e veçanta, pasurinë, vendin e lindjes, pikëpamjet politike ose filozofike apo rrethanat e tjera.

2. Përzgjedhja apo emërimi i drejtorëve dhe i zëvendësdrejtorëve, i mësimitdhënësve apo i asistentëve dhe i instruktorëve për institucionet arsimore dhe aftësuese që punojnë tërësisht apo kryesisht në gjuhët e komuniteteve jo shumicë marrin parasysh nevojën për përfaqësim dhe familjarizim të plotë me

identitetin e komunitetit përkatës; sigurimi i plotësimin të këtyre nevojave nuk konsiderohet si diskriminues sipas ligjit në fuqi.

3. Autoritetet që bëjnë emërimet, siç përcaktohet në këtë ligj, krijojnë procedura të drejta, të hapura dhe transparente për angazhim bazuar në kualifikimet dhe nevojat e postit.

4. Mësimdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi.

5. Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxhues ose për mësimdhënësit, merren për bazë kushtet, si janë: arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim të përcaktuar në këtë ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm. Emërimet e tilla përfundojnë në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit është bërë emërimi.

6. Kontrata e mësimdhënësit, i cili është zgjedhur në fillim të semestrit të dytë, me kërkesë të mësimdhënësit vazhdon deri më 31 gusht apo deri në përfundimin e periudhës përkatëse të testimit, e cila do që të ndodh më vonë. Kontrata e mësimdhënësit që është zgjedhur në mars e më vonë vazhdohet deri në fund të vitit shkollor.

7. Asnjë person nuk do të emërohet në një post në një institucion shkollor, publik apo privat, nëse ai ka qenë ndonjëherë i dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët. Një personi që është dënuar për krime të tilla nuk i jepet një pozitë e tillë apo ai shkarkohet nga posti i tij menjëherë sipas ligjit relevant në fuqi.

8. Me akt nënligjor, Ministria duhet të përpilojë dispozita të tjera në përputhje me këtë ligj lidhur me emërimin e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, asistentëve dhe instruktorëve sipas këtë ligji, si dhe përgjegjësive të komunave dhe këshillave drejtuese.

9. Mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit, për të cilët vlen ky nen janë të punësuar të komunës përkatëse apo të Ministrisë lidhur me nivelin 4 të ISCED-it.

10. Nivelet e pagesës, kushtet dhe afatet e punësimit, shtesat e përgjegjësive dhe gradimi i drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, asistentëve dhe instruktorëve rregullohet përmes aktit nënligjor në përputhje me ligjin në fuqi, si dhe zbatohen nga komunat dhe nga Ministria përkitazi me nivelin 4 të ISCED-it.

Neni 36

Mbrojtja nga sanksionet arbitrare dhe të tjera

1. Ministria, komunat, këshillat drejtuese dhe drejtorët e institucioneve arsimore do të sigurojnë që mësimdhënësit të kenë liri brenda ligjit si dhe në përputhje me nivelin e arsimit ku janë punësuar, për të diskutuar njohuritë e fituara si dhe për të dhënë ide të reja dhe mendime të debatueshme brenda kurrikulit të miratuar, pa rrezikuar humbjen e vendit të punës apo të ndonjë privileggi që mund ta kenë.

2. E drejta e mësimdhënësve për liri të shprehjes mund të kufizohet vetëm me ligj.

3. Ministria dhe komunat marrin masa të sigurojnë se:

3.1. mësimdhënësit kanë të drejtë për organizim dhe mbledhje brenda ligjit;

3.2. mësimdhënësit janë të mbrojtur nga diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë për arsye reale apo të supozuara siç janë gjinia, raca, gjendja martesore, orientimi seksual, ngjyra, feja, pikëpamjet politike apo të tjera; prejdardhja kombëtare, etnike apo sociale, përkatësia ndaj një komuniteti etnik, nevojat e veçanta, pronësia, lindja apo rrethana të tjera.

3.3. mësimdhënësit janë të mbrojtur nga ngacmimi apo sulmi nga cilido person në mjediset e institucionit arsimor dhe aftësues apo në vendet e ndërlidhura me to.

Neni 37

Personeli profesional jomësimdhënës

1. Personat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një akt nënligjor mund të zgjidhen nga komuna në institucionet arsimore për të ofruar shërbime profesionale, përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punë këshilluese dhe sociale.
2. Komuna mund të zgjedhë në institucione arsimore nëpunës, teknikë dhe mbështetës që të marrin funksione administrative, teknike dhe të përkrahjes sipas kriterëve të përcaktuara në një akt nënligjor.
3. Personat e zgjedhur sipas paragrafit 1. ose 2. të këtij neni mund të inkuadrohen në detyra të mësimdhënies vetëm nëse posedojnë licencë.
4. Personi i cili është dënuar për vepër penale ndaj fëmijëve nuk do të zgjidhet në poste të cilat janë të mbuluara me këtë nen, në ndonjë institucion arsimor, publik apo privat. Një person që është dënuar për vepra të tilla nuk i jepet një pozitë e tillë ose shkarkohet menjëherë nga posti i tij në përputhje me ligjin relevant në fuqi.

Neni 38

Emërimet e përkohshme

Komuna do të sigurojë pagesat për personat, të cilët përkohësisht zgjidhen si ushtrues detyre i drejtorit të institucioneve arsimore ose aftësuese apo për të zëvendësuar personelin që mungon për arsye shëndetësore ose të lehonisë.

Neni 39

Nevojat e veçanta arsimore

1. Fëmija ka vështirësi në mësim nëse:
 - 1.1. ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe;
 - 1.2. ka një paaftësi e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore apo aftësuese.
2. Fëmija nuk duhet të konsiderohet se ka vështirësi në mësim vetëm për shkak se gjuha, ose forma e gjuhës, në të cilën zhvillohet mësimi nuk është e njëjtë me gjuhën, ose me formën e gjuhës, të cilën e përdor në shtëpi të tij ose sepse i takon një komuniteti të caktuar dhe në rastet e tilla komuna duhet të sigurojë që fëmijës t'i ofrohet mbështetje efikase në gjuhën e mësimdhënies.
3. Ofrimi i arsimit të posaçëm për fëmijët do të thotë ofrimi i arsimit që i shtohet ose dallon nga arsimit që në përgjithësi bëhet për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore dhe aftësuese të themeluara në komunë.

4. Ofrimi i arsimit të posaçëm nuk kufizohet vetëm për fëmijët me vështirësi në mësim, por kjo gjithashtu zbatohet edhe për fëmijët me dhunti të veçanta, të cilët mund të kërkojnë modifikim të modeleve të zakonshme të progresit në sistemin e arsimit të detyruar, përfshirë edhe kurrikulumin.

Neni 40

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës

1. Qëllimi i qartë i këtij Ligji është që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, si parashihen në Konventën e UNESCO-s për të Drejtat e Fëmijëve (1989), në Deklaratën e Salamankës (1994), Konventën e OKB-së për të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuara (2007) dhe në konventat apo rekomandimet e tjera përkatëse ndërkombëtare.

2. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkupton se:

2.1. institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve;

2.2. mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve; dhe

2.3. ambientet e posaçme arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësimit.

3. Komunitat marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkolla të rregullta të komunës, përfshirë edhe themelimin e dhomave burimore dhe klasave të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike, përfshirë ato ndijore.

4. Sipas vlerësimeve individuale profesionale, komunitat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.

Neni 41

Vlerësimi profesional

1. Çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunitat e tjera të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.

2. Procedura e vlerësimit nga ekipi profesional mund të fillohet me kërkesën e ndonjë prindi apo institucioni arsimor a aftësues me pëlqimin e prindit.

3. Në përputhje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe duke pasur parasysh dëshirat dhe opinionet e prindërve, vlerësimi profesional shqyrton dhe përcakton nëse nxënësi ka nevojë për vijimin e shkollimit special dhe çfarë lloji i mësimdhënies duhet të ofrohet, ku qëllimet e vlerësimit janë si në vijim:

3.1. për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës;

3.2. për të dhënë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxënie dhe mirëqenien e fëmijës;

3.3. për të përkufizuar nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhënie;

3.4. për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.

4. Ministria, me akt nënligjor, përcakton procedurat dhe afatet kohore për vlerësimin profesional.

5. Nëse vendimi i komunës ndryshon nga vlerësimi profesional i ekspertëve, arsyet për vendimin e komunës duhet të shpjegohen me shkrim. Prindërve u jepet mundësia të bëjnë ankesë me shkrim. Në raste të tilla, Ministria do të sjellë vendimin përfundimtar dhe ajo mund të konsultohet me këta ekspertë siç përcakton vet.

6. Përmbajtja e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta për arsim përcaktohet në planet e arsimit individual. Procedura dhe modeli i këtyre planeve rregullohet me akt nënligjor.

Neni 42

Qendrat burimore, shkollat speciale dhe njësitë që ofrojnë arsimim të veçantë

1. Ministria mund të themelojë dhe mirëmbajë qendra të burimeve, shkolla speciale si dhe njësi të tjera që ofrojnë arsim special për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda apo të shumëfishta apo me vështirësi në mësimnxënie, të cilët vlerësohet se nuk janë në gjendje të arsimohen në shkolla komunale apo në institucione publike për aftësim.

2. Qendrat e burimeve dhe njësitë e tjera, të themeluara sipas këtij neni, gjithashtu ofrojnë ndihmesë, në kuadër të resurseve që i kanë në dispozicion, në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore dhe aftësuese që arsimojnë nxënësit me vështirësi në mësim.

3. Mësimdhënësit dhe personeli tjetër profesional i punësuar në shkolla, qendra të burimeve dhe njësi të tjera të themeluara sipas këtij neni licencohen sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Ministria siguron transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm apo aranzhon kujdes rezidencial të përshtatshëm, sipas vlerësimit profesional individual, për fëmijët që vijojnë shkollat speciale, qendrat e burimeve dhe për njësitë e tjera të themeluara sipas kësaj pjese.

Neni 43

Gjuha e shenjave dhe sistemi Brejll (Braille)

1. Nxënësve dhe fëmijëve të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, duhet t'u ofrohet mësimdhënie për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe përmes mënyrës së gjuhës së shenjave.

2. Ministria mund të vendosë që mësimdhënia nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe për përdorimin e gjuhës së shenjave të ofrohet në një lokacion jashtë institucionit të zakonshëm të nxënësve.

3. Nxënësit me të parë të pjesshëm dhe ata të verbër kanë të drejtën që të mësohen për përdorimin e alfabetit Brejll, si dhe për ndihmat teknike të nevojshme. Nxënësit e tillë kanë gjithashtu edhe të drejtën për orientimin e nevojshëm dhe për udhëzime gjatë lëvizjes në shkollë, vajtjen dhe kthimin nga shkolla dhe në shtëpi.

4. Para dhënies së mësimin përmes gjuhës së shenjave, në alfabetin Brejll dhe udhëzimeve për orientim dhe lëvizje ose ndonjë trajnimi sipas këtij neni, ekipi komunal vlerësues i përbërë prej ekspertëve, i themeluar sipas këtij ligji, bën një vlerësim të aftësive të kufizuara të nxënësit, si dhe nevojat e tij për qasje.

ARSIMI PRIVAT DHE I PARTNERITETIT

Neni 44

E drejta për arsimim privat dhe për themelimin e institucioneve private arsimore ose aftësuese

1. Çdo fëmijë ka të drejtë të vijojë mësimin në një institucion privat arsimor apo aftësues të licencuar sipas këtij ligji.
2. Institucionet private arsimore dhe aftësuese mund të themelohen nga subjektet juridike, të regjistruara në Kosovë, apo nga ndonjë qytetar a grup qytetarësh të Republikës së Kosovës.
3. Personi që ka qenë i dënuar për ndonjë vepër të dhunës apo për ndonjë vepër të pahijshme që ka përfshirë fëmijët, në Republikën e Kosovës apo gjëkund, nuk mund të themelojë, nuk mund të jetë i lidhur me financimin apo me ndonjë aspekt tjetër ose nuk mund të vazhdojë që gjatë dënimit pasues të jetë i ndërlidhur me ndonjë institucion arsimor dhe aftësues.

Neni 45

Institucionet arsimore dhe aftësuese të partneritetit

1. Ministria ose komuna janë kompetente të lidhin kontratë me ndonjë institucion ose individ për të promovuar dhe themeluar projekte të përbashkëta arsimore sipas legjislacionit në fuqi.
2. Nëse një institucion themelohet sipas paragrafit 1. të këtij neni, ai institucion trajtohet si institucion arsimor dhe aftësues me kapital të përzier.

Neni 46

Licencimi dhe inspektimi i shkollave private dhe atyre në partneritet

1. Çdo institucion arsimor privat ose në partneritet që ofron arsimim në nivelet 0, 1, 2, 3 dhe 4 të ISCED-it duhet kërkojë të licencohet nga Ministria.
2. Kriteret për dhënien e licencës për arsim dhe aftësim formulohen nga Ministria sipas udhëzimeve të Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar dhe përbëjnë një standard qeveritar për licencim, i cili shpallet përmes aktit nënligjor.
3. Standardi qeveritar për licencim merr parasysh metodat e ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies që përdoren nga institucionet private dhe mënjanimin e rrezikut ndaj nxënësve dhe punonjësve, përfshirë edhe dispozitat lidhur me:
 - 3.1. përshtatshmërinë e ndërtesave dhe pajisjeve, të cilat duhet patjetër të jenë sipas standardeve për shëndetin dhe sigurinë dhe dizajnin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe klasat, kabinetet, punëtoritë dhe laboratorët, fushat ose sallën sportive;
 - 3.2. bibliotekën dhe sallat për kompjuterë;
 - 3.3. numrin dhe kualifikimet e mësimdhënësve;
 - 3.4. kornizën e Kurrikulumit të Kosovës ose një kurrikulum të jashtëm të njohur nga Ministria, sipas këshillës së AKKSV-së

4. Licenca për institucionin privat arsimor përfshin dispozita për garancinë bankare për të mbrojtur interesat financiare të personave që duhet të përfundojë arsimimin e tyre në një institucion tjetër në rast se ai mbyllet.
5. Institucioni privat arsimor mund të fillojë të funksionojë vetëm pasi të ketë marrë licencën nga Ministria si dhe lejen e biznesit nga komuna, sipas legjislacioni në fuqi.
6. Procedurat administrative për lëshimin, ripërtëritjen dhe ndryshimin e licencës për arsim dhe aftësim përcaktohen me akt nënligjor.
7. Institucioni privat arsimor mundet që në bazë të kontratës me prindër të përcaktojë rregullat e sjelljes në institucion.
8. Themeluesi i institucionit arsimor dhe aftësues mund të mbyllë atë institucion pa ndonjë ndëshkim në përfundim të vitit shkollor.
9. Institucioni privat arsimor dhe aftësues i nënshtrohet inspektimit nga ana e Ministrisë sipas ligjit në fuqi.
10. Pas konsultimeve me Autoritetin Shtetëror të Kualifikimeve, Ministria mund të nxjerrë akt nënligjor lidhur me ofrimin e shërbimeve private arsimore dhe aftësuese apo lidhur me mbështetjen e shërbimeve të tilla nga ana e organizatave apo operatorëve joqeveritarë.

Neni 47 **Shkollimi në shtëpi**

1. Nëse komuna vlerëson se ndonjë fëmijë i moshës së shkollimit të detyruar nga territori i saj nuk është duke u arsimuar në mënyrë të duhur, përmes vijueshmërisë së rregullt në shkollë ose ndryshe dhe nuk i nënshtrohet përjashtimit të përherëshëm sipas këtij ligji, ajo i dërgon një vërejtje me shkrim prindërve dhe kërkon nga ata që të bindin komunën brenda afatit kohor të përcaktuar në vërejtje se fëmija është duke u arsimuar në shtëpi ose diku tjetër.
2. Arsimimi i duhur sipas paragrafit 1. të këtij neni do të thotë arsimim efikas me orar të plotë që është i përshtatshëm për moshën, aftësitë dhe prirjen e fëmijës si dhe ndonjë nevojë të veçantë për arsim që fëmija mund të ketë.
3. Nëse prindërit nuk i përgjigjen komunës brenda afatit kohor të specifikuar në vërejtjen e cekur në paragrafin 1. të këtij neni, komuna e procedon rastin në procedurë për kundërvajtje.
4. Nëse prindërit përgjigjen se fëmija është duke u arsimuar jashtë sistemit formal të arsimit dhe aftësimin publik ose privat, aranzhimet e bëra nga prindërit si dhe ato të inspeksionit duhet t'i nënshtrohen autorizimit të Ministrisë pas konsultimeve me komunën përkatëse.

Neni 48 **Arsimimi në diasporë**

1. Arsimimi në diasporë rregullohet sipas Ligjit për Mërgatën e Kosovës 03/L-171.
2. Institucionet arsimore dhe aftësuese të cilave u atribuohet ky nen janë të vendosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ku nxënësit që janë qytetar të Republikës së Kosovës të moshës për shkollim të detyruar vijnë arsim dhe aftësim.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 49
Dispozitat kalimtare

1. Ministria nxjerr akte nënligjore brenda një (1) viti për zbatimin e këtij ligji dhe për çështjet që nuk mbulohen me këtë ligj.
2. Dispozitat e nenit 9 paragrafi 3; nenit 10 paragrafi 3 ; nenit 24 paragrafi 6; nenit 25 paragrafi 1 ; neni 28; neni 29; nenit 33 paragrafi 4; neni 35; neni 37 paragrafi 1; neni 39 paragrafi 3; neni 42 paragrafi 1., 2., 4. neni 43 paragrafi 3; neni 48 paragrafi 1., 2. mund të hynë në fuqi nga viti shkollor 2015/16 po që se krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi ekzakt të kostos financiare të periudhës vijuese
3. Përfshirja e arsimit pas sekondar jouniversitar (niveli 4 i ISCED-it) në sistemin e arsimit dhe aftësimin parauniversitar hyn në fuqi nga data, e cila do të caktohet nga Kuvendi.
4. Komunitat i harmonizojnë rregulloret në fuqi me dispozitat e këtij ligji brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e Ligjit.

Neni 50
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat e Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm (Ligji 2002/2) si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 51
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-032
29 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-035-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV nr. 24/2014 SHNDËRRIMI I KLASAVE TË BASHKANGJITURA NË DHOMA TË BURIMEVE

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

Në mbështetje të nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-032, të nenit 8 nenparagrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr.09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve

Numër: 24/2014

Datë: 21.07.2014

Neni 1

Qëllimi

Ky UA ka për qëllim të përcaktoj mënyrën e shndërrimit të Klasave të bashkangjitura (KB) në Dhoma të burimeve (DHB), fushëveprimin, rolin dhe detyrat e dhomave burimore si njësi mbështetëse të shkollave të rregullta si dhe mbështetjen e nxënësve që rregullta si dhe mbështetjen e nxënësve që integrohen në klasat e rregullta nga klasat e bashkangjitura.

Neni 2

Funksioni i Dhomës së burimeve

Dhoma e burimeve është klasë që ofron shërbime mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në klasa të rregullta brenda shkollës.

Neni 3

Mësimdhënësi i klasës së bashkangjitur

1. Pas përfundimit të procesit të shndërrimit të Klasës së bashkangjitur (KB) në Dhomën e burimeve (DHB), mësimdhënësi i klasës së bashkangjitur kalon si mësimdhënësi mbështetës në nivele shkolle.
2. Në shkolla ku ekzistojnë më shumë se një mësues i KB, drejtori i shkollës në bashkëpunim me DKA, vlerëson nevojat e shkollës, në raport me numrin e nxënësve me nevoja të veçanta mbrenda shkollës. Në rastet kur nuk ka nevojë për më shumë se një mësues mbështetës, DKA vendos të transferoj mësuesin mbështetës në shkollë tjetër të komunës.
3. Në klasat e bashkangjitura ku janë nxënësit me dëmtime të rënda dhe të cilët e kanë kaluar moshën e obliguar të shkollimit, sipas Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032 duhet të përcillen deri në përfundimin e klasës së IX-të.

Neni 4

Shërbimet që ofron Dhoma e burimeve

1. Mbështetja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të cilët janë në klasat e rregullta dhe sipas nevojës.
2. Punë individuale me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

3. Prodhimi i materialeve mësimore dhe didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.
4. Mbështetje personelit arsimor për punë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.
5. Organizimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.
6. Planifikimin, këshillimin dhe vlerësimin e PIA-së.
7. Takime me prindër, OJQ-të të ndryshme.

Neni 5

Roli i mësimdhënësit mbështetës

1. Vrojton në klasa të rregullta në bashkëpunim me mësimdhënësit klasor/kujdestarët klasor nxënësit e nivelit të ulët (posaçërisht faza kalimtare nga klasa e parë filllore në klasën e parë dhe nga klasa e pestë në klasën e gjashtë) për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.
2. Mbështet nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë në klasa të rregullta.
3. Planifikon dhe organizon bashkë mësimdhënie me mësimdhënësin e rregullt në klasa ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore.
4. Ku ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë klasës.
5. Përpilon planin individual të arsimit bashkë me mësimdhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerë të ekipit të PIA dhe kur është e mundur edhe vetë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.
6. Përkujdeset që plani individual i arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë.
7. Këshillon dhe ndihmon mësimdhënësit e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhoj me klasën gjithëpërfshirëse.
8. Harton materiale mësimore alternative bashkë me mësimdhënësit e klasës së rregullt, të cilat do të përdoren në mësimdhënien me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
9. Ndhmon në vetëdijesimin e stafit të shkollës për procesin gjithëpërfshirës.
10. Ndhmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.
11. Bashkëpunon me Qendrat burimore për integrimin e fëmijëve me NVA nga Qendra burimore në shkollë të rregullt, përgatit dhe mbështet procesin e integritit të fëmijës në klasë të rregullt.
12. Bashkëpunon me Qendrat burimore rreth metodave të mësimdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga nevojat specifike që paraqiten në shkollë.
13. Planifikon në baza javore dhe mujore dhe i raporton drejtorit të shkollës ku punon për punën e bërë.
14. Mësuesi mbështetës ka 40 orë punë më javë (8 orë në ditë).

Neni 6

Struktura organizative e Dhomave burimore

1. Dhoma burimore ka të njëjtin status brenda shkollës sikurse të gjitha klasat e rregullta.
2. Kjo dhomë përdoret nga mësuesi mbështetës për punë individuale me nxënësit, por edhe nga stafi tjetër i shkollës për aktivitete të ndryshme.

Neni 7

Procedurat e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta

1. Drejtori i shkollës duhet krijoj një ekip mbështetës brenda shkollës i cili përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtori i shkollës;
 - 1.2. Mësimdhënësi i klasës së bashkëngjitur;
 - 1.3. Mësimdhënësi mbështetës;
 - 1.4. Psikologu ose pedagogu i shkollës aty ku ekzistojnë, por, nëse shkolla nuk ka pedagog ose psikolog mund të angazhohet ndonjë mësimdhënës i cili zhvillim profesional për arsim gjithëpërfshirës.
2. Mësimdhënësi i klasës së bashkëngjitur vlerëson vlerëson fëmijët të cilët janë të gatshëm të fillojnë me integrim të pjesshëm apo të plotë në klasa të rregullta. Këtë e diskuton me ekipin mbështetës brenda shkollës dhe pasi ekipi vendos për këtë, drejtori i shkollës merr vendim me shkrim lidhur me integrimin e nxënësve në klasë të rregullt.
3. Ekipi mbështetës vendos për nivelin dhe klasën ku do të integrohet fëmija dhe komunikon me mësuesin (1-5) apo në qofte se kemi të bëjmë me klasat (6-9) atëherë me mësimdhënësit lendorë ku nxënësi do të fillojë të ndjek procesin mësimor.
4. Rekomandohet që nxënësit të fillojnë të integrohen fillimisht në lëndët e shkathtësive siç janë: lënda kulturore muzikore, art figurativ dhe edukatë fizike, por ekipi mbështetës mund të vendos që fëmija të ndjek edhe lëndë tjera apo të integrohet plotësisht.
5. Gjatë kësaj faze duhet të përcillet fëmija nga mësuesi mbështetës dhe mësimdhënësi i klasës së bashkëngjitur, gjithmonë në komunikim edhe me mësimdhënësin e klasës apo mësimdhënësin e lëndës për të vlerësuar nëse fëmija ka probleme në adaptim dhe çështje tjera që lidhen me mësimnxënien.

Neni 8

Dispozitat kalimtare

Ky UA vlen për klasat e bashkëngjitura ekzistuese.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Ministri.

Prof.dr. Ramë Buja, ministër

UDHËZIM ADMINISTRATIV 23/2013 QENDRAT BURIMORE

Në bazë të nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 8 paragrafi 1.13 të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nenit 8 të Ligjit për inspektionin e arsimit në Kosovë, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4. shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, Ministria E Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV QENDRAT BURIMORE

Numër: 23/2013

Datë: 18.06.2013

Neni 1 Qëllimi

Ky UA ka për qëllim të përcaktoj fushëveprimtarinë, rolin, strukturën, detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës Burimore për mësim dhe këshillim, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor.

Neni 2 Akti i themelimit

Qendrat Burimore e kanë aktin e themelimit, logon, vulën dhe xhirollogarinë e vet.

Neni 3 Fushëveprimi i Qendrave Burimore për mësim dhe këshillim

1. Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim janë institucione edukativo-arsimore dhe të shërbimeve mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

2. Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim organizojnë mësim për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta dhe ofrojnë ofrojnë shërbime të këshillimit për të gjitha shkollat e rregullta në tërë territorin e Kosovës.

- 2.1. Për fëmijët me dëmtime në të parë;
- 2.2. Për fëmijët me dëmtime në dëgjim;
- 2.3. Për fëmijët me çrregullime në të folur;
- 2.4. Për fëmijët me dëmtime fizike;
- 2.5. Për fëmijët me dëmtime intelektuale dhe në zhvillim;
- 2.6. Për fëmijët me çrregullime neurologjike;
- 2.7. Për fëmijët me çrregullime në spektrin e autizmit;
- 2.8. Për fëmijët me çrregullime specifike në të nxënë;
- 2.9. Për fëmijët me çrregullime emocionale dhe të sjelljes;
- 2.10. Për fëmijët me aftësi të kufizuara të shumëfishta.

Neni 4
Struktura organizative e Qendrave Burimore për mësim dhe këshillim

1. Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim përbëhet prej:
 - 1.1. Shkollës speciale për fëmijë me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta;
 - 1.2. Sektori i shërbimeve mbështetëse;
 - 1.3. Konvikti për akomodimin e nxënësve, sipas nevojës.

Neni 5
Bashkëpunimi brenda Qendrës Burimore

Shkolla speciale dhe Sektori i Shërbimeve mbështetëse bashkëpunojnë ngusht në shkëmbimin e informatave, njohurive, ekspertizës, hulumtimit dhe burimeve.

Neni 6
Shërbimet që ofron Qendra Burimore për mësim dhe këshillim

1. Mësimdhënie dhe akomodim të fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta.
2. Identifikon fëmijët me NVA që janë jashtë dhe brenda sistemit arsimor e që kanë nevojë për mbështetje dhe i referon për vlerësim, në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe QB tjera, me MSH, MPMS dhe OJQ-të, institucionet tjera.
3. Mbështetë fëmijët dhe arsimtaret në institucionet e rregullta shkollore si dhe prindërit e fëmijëve.
4. Zhvillon, harton dhe shpërndan materiale mesimore dhe didaktike për nxënës me NVA në institucionet e arsimit parauniversitar.
5. Organizon kurse trajnimi të akredituara lidhur me temat që janë specifike për QB gjegjëse.
6. Ben vlerësimin pedagogjik të nxënësve përbrenda QB-së dhe rekomandon avancimin apo kalimin e tyre në shkollë të rregullt.
7. Përkujdeset që nxënësit me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë të pajisen me mjete teknologjike dhe ndihmëse, në bashkëpunim me ministritë relevante dhe donatorët tjerë.

Neni 7
Këshilli drejtues i QB

Çdo QB do të ketë Këshillin drejtues në përputhje me nenin 17 të LAP nr. 04/L-032.

Neni 8
Personeli i Qendrës Burimore

1. Drejtori i QB zgjedhet nga MASHT sipas LAP nr. 04/L-032. Kandidatët për drejtor, përveç kualifikimit përkatës, duhet të kenë edhe përvojë në fushën e arsimit special/gjithëpërfshirës
2. Sekretari ose administratori zgjedhet nga MASHT.
3. Personeli edukativo-arsimor zgjedhet nga Qendra Burimore në bashkëpunim me MASHT-in.

4. Gjithë personeli edukativo-arsimor i punësuar në QB duhet të ketë kualifikim dhe pervojë pune në fushën e arsimit special/gjithëpërfshirës posaçërisht për specifiken e QB përkatëse.
5. Licencimi i mësimdhënësve në QB bazohet në legjislacionin në fuqi.
6. Është obligim i stafit menaxhues të QB-së që ta organizojë fazën e familjarizimit për stafin e ri, në mënyrë që ata të njoftohen me natyrën dhe specifikat e punës në QB.
7. Stafi i QB është:
 - 7.1. Stafi i shkollës speciale;
 - 7.2. Stafi i shërbimeve mbështetëse;
 - 7.3. Edukatorët dhe stafi i konviktit;
 - 7.4. Stafi rehabilitues sipas nevojave të QB;
 - 7.5. Koordinator i caktohet nga stafi pedagogjik ekzistues dhe atë:
 - 7.5.1. Koordinator i shërbimeve mbështetëse;
 - 7.5.2. Koordinator i shkollës speciale;
 - 7.5.3. Koordinator i konviktit;
 - 7.5.4. Koordinator për marrëdhënie me publikun dhe partnerët;
 - 7.5.5. Bazuar në detyrat shtesë të Koordinatorit do të ngritet edhe koeficienti i pagesës së tij/saj.
8. Orari i punës për stafin edukativo-arsimor është 6 orë në ditë.
9. Përveç orëve mësimore, stafi pedagogjik do të punoj në zhvillimin dhe planifikimin e shërbimeve mbështetëse, si dhe organizimin e arsimit në shkollën speciale.
10. Personeli teknik rekrutohet sipas rregullave të MASHT në mënyrë efikase dhe ekonomike, duke u bazuar në madhësinë e QB-së dhe numrin e nxënësve.
11. Riorganizimi dhe punësimi i stafit të ri mund të behet në përputhje me nevojat e Qendrës Burimore.
12. Procedura fillohet me iniciativën e Qendrës Burimore, bazuar në planin e hartuar.
13. Riorganizimi dhe punësimi i stafit të ri aprovohet nga MASHTI-i.

Neni 9

Zona e mbulimit

1. Qendrat Burimore mbulojnë zona të caktuara:
 - 1.1. QB "Xheladin Deda" për fëmijët me dëmtime në të parë, në Pejë tërë territorin e Kosovës;
 - 1.2. QB "Nëna Terezë" për fëmijët me dëmtime në dëgjim, në Prizren tërë territorin e Kosoves;
 - 1.3. QB "Përparimi" për fëmijët me dëmtime intelektuale dhe zhvillim, Prishtinë: Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Gjiilan, Kamenicë, Novobërdë, Shtime, Ferizaj, Viti, Podujevë, Obiliq, Kaçanik;

1.4.QB “Lef Nosi” për fëmijët me dëmtime intelektuale dhe në zhvillim, Prizren: Prizren, Deçan, Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Shtërpçë, Dragash, Junik, Mamushë;

1.5.QB “Nëna Terezë” për fëmijët me dëmtime intelektuale dhe në zhvillim, Mitrovicë: Mitrovicë, Istog, Pejë, Klinë, Drenas, Skënderaj, Vushtrri, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq.

2. Me rritjen e kapaciteteve të Qendrave Burimore, zonat e përcaktuara do të mbulohen në mënyrë graduale dhe efektive me qëllim që në një të ardhme të mbulohet tërë territori i Kosovës nga Qendrat Burimore.

Neni 10

Struktura e shkollës speciale

1. Sipas niveleve arsimore, shkolla speciale ka

1.1.Klasën parafillore (nivel 0);

1.2.Arsimi fillor, klasat 1-5 (nivel 1);

1.3.Arsimi i mesëm i ulët, klasat 6-9 (nivel 2);

1.4.Arsimi i mesëm i lartë, klasat 10-12 (nivel 3);

1.5.Arsimi joformal bazuar në specifikat e shkollës.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e shkollës speciale

1. Ofron mësimdhënie për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta.

2. Bën akomodimin e nxënësve në konvikt dhe organizon aktivitetet jashtëshkollore të planifikuara dhe të strukturuar.

3. Krijon programe për përgatitjen e fëmijëve që do të regjistrohen në shkollë.

4. Përpilon plane lehtësuese edukativo-arsimore sipas specifikave të shkollës.

5. Përpilon plane individuale të arsimit për të gjithë fëmijët që ndjekin mësimin në shkollë speciale.

6. Përcakton detyrat e stafit përgjegjës për kujdes ditor dhe konvikt me qëllim të mbulimit të gjitha nevojave personale të fëmijëve (p.sh. kujdesi higjienik, nevojat fiziologjike, zhvillimi i shkathtësive jetesore etj.)

7. Ofron programe të arsimit joformal për personat me aftësi të kufizuara që e kanë tejkaluar moshën shkollore në bashkëpunim me institucionet tjera shkollore sipas LAARR.

8. Ofron shërbime rehabilitimi sipas specifikave të shkollës.

9. Bën vlerësimin e nevojave të nxënësve.

10. Planifikon fazën e tranzicionit të nxënësve.

11. Bashkëpunon me prindërit dhe institucionet tjera relevante.
12. Organizon transport efikas dhe të sigurve të rregulluar sipas LAP.
13. Ofron shujta ushqimore në baza ditore për nxënësit në QB.

Neni 12

Procedurat e regjistrimit të nxënësve në Qendrat Burimore

1. Qendra Burimore regjistron të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, bazuar në vendimin e ekipit për vlerësim profesional i cili funksionon në nivel të komunës.

1.1. Prindi i fëmijës i drejtohet komunës për regjistrimin e fëmijës në shkollë;

1.2. Fëmija me aftësi të kufizuara të shumëfishta, shkollohet në QB-në e cila ofron arsimim dhe mbështetje për aftësinë e kufizuar dominuese të fëmijës.

2. Nëse fëmija që është në moshën shkollore, nuk është i përfshirë në sistemin shkollore, e ka ndërprerë shkollimin, apo e ka tejkaluar moshën e përcaktuar për regjistrim në shkollë, atëherë fëmijës do t'i ofrohet një program arsimor kompensues që bazohet në nevojat dhe shkathtësitë e fëmijës për ta kompensuar kohën e humbur.

2.1. Fëmija duhet të regjistrohen në nivelin përkatës arsimor që përafërsisht korrespondon me moshën e fëmijës, me një dalim prej 1-2 vjet, të shumtën;

2.2. Ekipi vlerësues përbrenda QB-së i vlerëson aftësitë arsimore të fëmijës dhe e rekomandon nivelin arsimor për fëmijën;

2.3. Në arsimin e mesëm të lartë mund të regjistrohen nxënësit që kanë përfunduar shkollën fillore speciale, mirëpo që nuk janë të vjetër se 20 vjeç;

2.4. E drejta e fëmijës për t'u regjistruar në QB-në e cila më së miri i adreson nevojat e tij/saj duhet të respektohet.

2.4.1. Në rast se QB-ja refuzon regjistrimin e fëmijës, atëherë ajo obligohet ta lëshoj një arsyetim me shkrim për prindin e fëmijës dhe për NJAS/MASHT;

2.4.2. Pala ka të drejtë ankese në Zyrën për Ankesa dhe Parashtresa në MASHT.

3. QB-të, në bashkëpunim me OJQ-të, zhvillojnë aktivitete vetëdijesimi për prindër që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara lidhur me rëndësinë e arsimit, me qëllim të regjistrimit të fëmijëve prej fillimit të moshës së detyruar të shkollimit.

Neni 13

Organizimi i mësimin në shkollën speciale për fëmijët me dëmtime të rënda

1. Arsimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara është i organizuar sipas niveleve të arsimit parauniversitar dhe rregulloreve përkatëse.

2. Procesi mësimor në shkolla speciale mund të organizohet sipas kurrikulit bërthamë, ndërsa për nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta, procesi mësimor organizohet sipas fushave të aktiviteteve, varësisht nga shkalla e aftësisë së kufizuar të fëmijës.

3. Mësimdhënia bazohet në nevojat individuale të nxënësit dhe përmbajtja individualizohet me hartimin e PIA.

4. Për nxënësit me aftësi të kufizuara të renda intelektuale, të cilët nuk mund të ndjekin planprogramin e rregullt, procesi mësimor pas klasës së pestë organizohet nga një grup prej 3-4 mësime dhënësis të cilët janë përgjegjës për një klasë-një arsimtar për shkencat shoqërore, një për shkencat natyrore, një për lëndën e shkathtësive dhe një arsimtar për gjuhë angleze, sipas nevojave.

5. Për arsimin e mesëm të lartë, varësisht nga drejtimi, një arsimtar caktohet për lëndët e përgjithshme, një për lëndët profesionale dhe një arsimtar për punë praktike.

6. Arsimi i mesëm special organizohet në bazë të llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar dhe realizohet në drejtime trevjeçare profesionale.

7. Proporcioni arsimtar-nxënës

7.1. 6-10 nxënës me aftësi të kufizuara të renda shqisore;

7.2. 5-8 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale;

7.3. 3-5 nxënës me aftësi të kufizuara të renda intelektuale dhe të shumëfishta;

7.3.1. Angazhimi i një asistenti klasor është i domosdoshëm;

7.4. Sistemimi i nxënësve në grupe bëhet nga ekipi vlerësues i shkollës;

7.5. Asistentët tjerë klasor mund të angazhohen sipas nevojave dhe kapaciteteve të QB-së.

8. Nxënësit me aftësi të kufizuara, të cilët, bazuar në vlerësimin e ekipit vlerësues, nuk mund të përfshihen në mësimin e rregullt, gjegjësisht nuk mund të ndjekin shkollën speciale, atëherë shkolla e organizon procesin edukativo-arsimor në shtëpi ose në institucionin shëndetësor.

9. Puna edukativo-arsimore në shkolla speciale, realizohet nga mësime dhënësis të bashku me edukatorët, bashkëpunëtorët profesional dhe bashkëpunëtorët tjerë të rehabilitimit.

10. Gjatë orarit mësimor, shkolla është përgjegjëse për mirëqenien dhe kujdesin e nxënësit.

11. Prindërit e fëmijëve do të ftohen në shkollë sipas nevojës apo kur shkolla e sheh të arsyeshme.

Neni 14

Programet e veçanta për nxënësit që e kanë tejkaluar moshën shkollore

1. Fëmijët që e kanë tejkaluar moshën shkollore e që aktualisht janë të regjistruar në Qendrat Burimore, duhet të kenë qasje në programe të veçanta për ta përfunduar arsimin e obligueshëm.

2. Fëmijët që e kanë tejkaluar moshën shkollore dhe regjistrohen për herë të parë në shkollë, apo fëmijët që janë identifikuar jashtë sistemit shkollor, duhet të kenë qasje në arsimin për të rritur me qellim që ta përfundojnë arsimin e obligueshëm duke i orientuar këta nxënës në programe adekuate.

3. Fëmijët që veç janë të regjistruar, mirëpo për shkaqe shëndetësore e kanë ndërprerë shkollimin, duhet të kenë qasje në programe të veçanta për ta përfunduar arsimin e obligueshëm.

Neni 15

Certifikimi në shkollat speciale

1. Pas kryerjes së niveleve të arsimit, nxënësve në shkollat speciale u lëshohen librezat, dëftesa, certifikata ose diploma sipas UA nr. 14/2009.

2. Nxënësit që kanë ndjekur planprograme të individualizuara në një ose disa lëndë dhe nxënësit që kanë ndjekur mësimin sipas fushave të aktiviteteve, do të vlerësohen sipas kritereve individuale.
3. Përdorimi i Planit Individual të Arsimit është rregulluar/do të rregullohet me UA të veçanta.
4. Nxënësit që kanë kryer shkollimin në shkolla speciale sipas planprogramit të rregullt, mund të marrin pjesë në testin e maturës.

Neni 16

Procesi i integritit nga Qendra Burimore në shkolla të rregullta

1. Në rast se ekipi vlerësues në QB vlerëson se fëmija mund të përfshihet në shkollë të rregullt, atëherë QB-ja e ka për obligim që ta iniciojë dhe zhvillojë procedurën për përfshirjen e fëmijës në mënyrë të planifikuar sa më parë që është e mundur.
2. Format e integritit dhe regjistrimit në shkolla të rregullta:

2.1. Integrimi i pjesshëm

2.1.1. Nxënësi regjistrohet në shkollën ku ndjekë shumicën e orëve mësimore.

2.2. Integrimi i plotë

2.2.1. Integrimi i plotë bëhet në bashkëpunim të ngushtë me prindin dhe shkollën e rregullt.

Neni 17

Respektimi i identitetit dhe integritetit të nxënësve në QB

1. Identiteti dhe integriteti personal i nxënësve duhet të respektohet nga QB në të gjitha rrethanat.
2. Të dhënat personale dhe fotografitë e nxënësve nuk mund të publikohen pa lejen paraprake me shkrim të prindit.
3. Leja paraprake me shkrim e prindit kërkohet për intervista, hulumtimet dhe pjesëmarrjen e nxënësve në ngjarje publike.

Neni 18

Masat disiplinore në Qendrat Burimore

1. Masat disiplinore që aplikohen për nxënësit e Qendrave Burimore parashihen me UA për kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore nr. 6/2010.
2. Para shqiptimit të masës disiplinore duhet të merret parasysh gjendja e nxënësit dhe aftësia e kufizuar e tij/saj.

Neni 19

Organizimi i transportit të nxënësve në shkollat speciale të Qendrave Burimore

1. Transporti i nxënësve i të gjitha niveleve organizohet nga QB-ja në mënyrë të përshtatshme, efikase, të sigurt dhe ekonomike.
2. Transporti për nxënësit konviktore paguhet nga komunat sipas nenit 42, paragrafi 4 i Ligjit nr. 04/032.
3. Transporti sigurohet përmes kompanive të transportit duke përzgjedhur kompaninë me tender.

4. Kompanitë organizojnë transport sipas standardeve të parapara nga MASHT.

Neni 20

Struktura e shërbimeve të mbështetjes

1. Koordinatori.
2. Arsimitarët udhëtues në bazë të nevojave dhe zonave që mbulojnë.
3. Ekipe për mbështetje teknike në shkollën speciale dhe shërbimet e mbështetjes, do të formohen dhe funksionojnë sipas nevojave dhe specifikave të Qendrës Burimore me sa vijon:
 - 3.1. Ekipi i vlerësimit pedagogjik;
 - 3.2. Ekipi i rehabilitimit;
 - 3.3. Ekipi për hartimin e materialeve mësimore;
 - 3.4. Ekipi i trajnimeve;
 - 3.5. Shërbimet e veçanta sipas nevojave të Qendrës Burimore.

Neni 21

Detyrat e shërbimeve të mbështetjes

1. Bën identifikimin dhe referimin për vlerësim të fëmijëve që janë jashtë procesit mësimor dhe të atyre që janë në shkollë dhe në institucione parashkollore, e që kanë nevojë për mbështetje.
2. Mbështetë institucionet parashkollore dhe shkollat e rregullta, si dhe prindërit e fëmijëve.
3. Mbështet nxënësit dhe arsimtarët në shkolla të rregullta me anë të arsimtareve udhëtues duke aplikuar forma të punës praktike në klasë.
4. Zhvillon, harton dhe shpërndan materiale ndihmëse mësimore për nxënës.
5. Ofron këshilla për arsimtarë të rregullt se si të punohet me nxënës.
6. Organizon kurse trajnuese të akredituara për temat lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë në shkolla të rregullta.
7. Ofron kurse të shkurtra në Qendrën Burimore për nxënësit e shkollave të rregullta të cilët kanë nevojë të mësojnë ndonjë teknikë të mësimit apo kanë nevojë të vlerësohen apo të rehabilitohen dhe të mbështeten më periudhat e tranzicionit.
8. Bën vlerësimin pedagogjik të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë në shkolla.
9. Ofron pajisje ndihmëse dhe mësimore për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.
10. Bashkëpunon me OJQ-të që merren me personat me aftësi të kufizuara për t'i identifikuar fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.
11. Krijon rrjetin e QB me qëllim që të mbulojnë mirë gjithë territorin e Kosovës.

12. Bashkëpunon me ekipet vlerësuese dhe mbështetëse komunale lidhur me vendosjen e fëmijës me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë dhe mbështetjen që i nevojitet fëmijës.
13. Organizon fushata vetëdijesimi për prindër dhe komunitetin lidhur me arsimin gjithëpërfshirës.
14. Bashkëpunon me arsimtarët gjithëpërfshirës dhe me arsimtarët e klasave të bashkangjitura në koordinimin e mbështetjes për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë.
15. Bën hulumtime lidhur me metodat dhe teknikat e ndryshme mësimore bashkëkohore dhe publikon rezultatet e atyre hulumtimeve.
16. Mban dhe azhurnon bazën e të dhënave për mbështetjen që u ofron shkollave të rregullta dhe për punën e bërë i raportojnë rregullisht stafit drejtues të QB.

Neni 22

Përshkrimi i punës së mësuesit udhëtues

1. Mësuesi udhëtues duhet të ketë kualifikim dhe përvojë pune në fushën e arsimit special/gjithëpërfshirës posaçërisht për specifikën e QB përkatëse prej 3-5 vjet në arsim me fëmijët me NVA bazuar në specifikat e aftësisë së kufizuar:
 - 1.1. Të ketë përvojë pune 3-5 vjet në arsimin me fëmijët me NVA bazuar në specifikat e aftësisë së kufizuar;
 - 1.2. Të ketë trajnime në fushën e arsimit me NVA dhe gjithëpërfshirës;
 - 1.3. Mësuesi udhëtues duhet të pësojë patentë shofer.
2. Mbështetja e nxënësve në shkollat e rregullta:
 - 2.1. Identifikimi i nevojave për mbështetje në shkollat e rregullta;
 - 2.1.1. Mbajtja e bazës së të dhënave për fëmijët e mbështetur në procesin gjithëpërfshirës bëhet me formularin për evidencën e fëmijëve;
 - 2.2. Mënyrat e mbështetjes:
 - 2.2.1. Planifikimi i orëve dhe forma e mbështetjes për një fëmijë bëhet nga grupi mbështetës në QB.
 - 2.2.2. Mësuesit udhëtues profilizohen sipas niveleve arsimore;
 - 2.3. Hartimi i planeve të punës dhe raportimi;
 - 2.3.1. Mësuesi udhëtues harton plane vjetore, mujore dhe javore të punës;
 - 2.3.2. Mësuesit udhëtues përdorin formularë të unifikuar për planifikim dhe raportim të hartuar nga MASHT dhe QB;
 - 2.3.3. Mësuesit udhëtues takohen në Qendrën Burimore çdo dy javë;
 - 2.3.4. Mësuesit udhëtues të Kosovës takohen çdo tre muaj.
3. Mësuesi udhëtues punon 40 orë në javë.

- 3.1. 10 orë për udhëtim;
 - 3.2. 10 orë përgatitje të materialeve, trajnime, raportim, planifikim;
 - 3.3. 20 orë mbështetje për nxënësit e përfshirë.
4. Numri i fëmijëve të mbështetur bazohet në formën e mbështetjes dhe numrin e orëve të punës së arsimtarit udhëtues.
- 4.1. Rritja e numrit të fëmijëve të identifikuar për mbështetje imponon edhe rritjen e numrit të arsimtarëve udhëtues.
5. Kushtet e punës:
- 5.1. Çdo mësues udhëtues do të ketë telefon zyrtar me mbushje prej 10 eurosh në muaj;
 - 5.2. Çdo mësues udhëtues pajiset me lloptop dhe rrjet interneti nga QB;
 - 5.3. Pajisjet e punës të siguruara nga QB regjistrohen si pronë e QB;
 - 5.4. Transporti për mësuesit udhëtues organizohet në mënyrë efikase dhe ekonomike nga Qendrat Burimore me automjete të shkollës me anë të kompenzimit të shpenzimeve të transportit publik dhe me anë të kompensimit të shpenzimeve për shfrytëzimin e automjetit personal;
 - 5.5. Mësuesit udhëtues pajisen me kartelë identifikimi, vizitkarta dhe materiale informuese nga QB.

Neni 23

Hartimi i planeve vjetore dhe raportimi i Qendrave Burimore

1. Qendrat Burimore planifikojnë punën e tyre përmes hartimit të:
 - 1.1. Planit zhvillimor të QB për vitin vijues, i cili duhet të dorëzohet në MASHT deri më 30 qershor;
 - 1.1.1. Planit të shkollës speciale sipas niveleve arsimore;
 - 1.1.2. Planit të shërbimeve mbështetjes;
 - 1.1.3. Planit të trajnimeve;
 - 1.1.4. Planit të aktiviteteve të konviktit.
2. Raportimi vjetor i punës së QB bazuar në planet e punës dorëzohen në MASHT deri më 31 gusht.

Neni 24

Financimi i Qendrave Burimore

1. Qendrat Burimore financohen dhe administrohen nga MASHT.
2. Mbështetja financiare për QB mund të sigurohet edhe nga donatorët dhe me vetëfinancim.
3. QB planifikon shpenzimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.
4. Ndarja e buxhetit bëhet sipas planifikimit vjetor të QB dhe ndahet sipas kriterëve të përcaktuara nga MASHT.

Neni 25
Zhvillimi dhe monitorimi i punës së QB

1. MASHT përmes NJAS, harton politika dhe rregullore për zhvillimin e Qendrave Burimore.
2. MASHT inspekton dhe monitoron QB, bazuar në LAP nr. 04/L-032.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit të tij nga ministri.

Prof.dr. Ramë Buja, ministër

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.18/2013 PERDORIMI I PLANIT INDIVIDUAL TË ARSIMIT

Në bazë të nenit 41 paragrafi 6 të Ligjit të Arsimit parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr.17, dt.16 shtator 2011), si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Perdorimi i planit individual të arsimit

Numër: 18/2013

Datë 20.05.2013

Neni 1

Qëllimi

Ky UA përcakton procedurat për realizimin e së drejtës së fëmijëve dhe nxënësve në Planin individual të arsimit (PIA), zbatimin dhe vlerësimin e tij në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, me qëllim të përfshirjes optimale dhe të sigurimit të qasjes së plotë të fëmijëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin edukativo-arsimor.

Neni 2

Definicioni i PIA-s

1. Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.
2. Vendimi për edukim dhe arsimim të fëmijëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta merret nga ekipi vlerësues dhe mbështetës në nivel komunal.
3. PIA shërben për planifikimin sistematik të edukimit të edukimit dhe arsimit, mësimdhënies dhe mesimnxënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës.
4. Qëllimi kryesor i PIA-s është, të ndihmohen fëmijët dhe nxënësit në mënyrë që të arrijë të ndjekë plan-programin e rregullt.
5. PIA përcakton individualizmin e një lënde mësimore apo mësimdhënien përmes fushave të aktiviteteve ku vlerësohet se është e nevojshme për fëmijën dhe nxënësin.
6. PIA është një dokument i besueshëm dhe informatat për të, mund t'u jepen të tjerëve vetëm me lejen e prindërve.

Neni 3

E drejta për Planin individual të Arsimit

1. Të drejtën për PIA e kanë të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore me vendim për arsim me nevoja të veçanta nga ekipi vlerësues dhe mbështetës i komunës.
2. Të drejtën në PIA e ka fëmija i cili ka nevojë për mbështetje shtesë në edukim dhe arsim për shkak të vështirësisë në qasje dhe pjesëmarrje, nëse këto vështirësi ndikojnë në arritjen e rezultateve të arsimit të përgjithshëm, dhe veçanërisht nëse fëmija:
 - 2.1. Ka vështirësi në mesimnxënie për shkak të aftësisë së kufizuar specifike në të mësuar apo sjellje dhe zhvillim emocional;

2.2. Ka një aftësi të kufizuar fizike, motorike, shqisore, intelektuale apo të shumëfishtë, si dhe çrregullime të ndryshme zhvillimore dhe neurologjike, etj.

2.3. Ka arsye të tjera.

3. Vendimi për arsimin me nevoja të veçanta merret për një periudhë kohore të kufizuar, së paku 2 vite.

4. Pas periudhës së caktuar kohore, ekipi vlerësues dhe mbështetës rivlerëson nevojat e fëmijës për mbështetje dhe merr vendim nëse duhet vazhduar apo të ndërprehet vendimi për arsim me nevoja të veçanta.

5. Në rastet kur shihet se fëmija ka ndryshime të dukshme mund të behet rivlerësimi edhe më herët.

Neni 4

Hartimi i Planit Individual të Arsimit

1. Plani Individual i Arsimit bazohet në formën zyrtare të PIA-s dhe në udhëzuesin për PIA-n të Miratuar nga MASHT.

2. PIA duhet të hartohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, fëmijën kur është e përshtatshme dhe personelin përkatës.

Neni 5

Përmbajtja e Planit Individual të Arsimit

1. PIA është ndarë në tri pjesë:

1.1. Pjesa administrative

1.1.1. Të mbledhë të dhënat kryesore të fëmijës për të cilat paraprakisht është pajtuar prindi ose kujdestari i tij.

1.2. Pjesa pedagogjike

1.2.1. Të jep informata për gjendjen momentale të fëmijës;

1.2.2. Të përshkruhen qëllimet edukativo-arsimore;

1.2.3. Të përshkruhen lëndët e individualizuara;

1.2.4. Të përshkruhen fushat e aktiviteteve;

1.2.5. Të përshkruhet vlerësimi i arritjes së rezultateve të pritshme dhe vlerësimi i sistemit përkatës.

1.3. Pjesa rehabilituese

1.3.1. Të mbledhë të dhëna për trajtimet e ofruara për fëmijën ose nxënësin;

1.3.2. Të ndajë përgjegjësitë dhe detyrat në mes të shkollës dhe të ofruesve të shërbimeve.

2. Forma për planifikimin e tranzicionit përdoret, dhe mbështetjen e vazhdueshme në rastet kur fëmija ose nxënësi kalon:

2.1. Prej një institucioni në tjetrin, kur ndërrohet vendbanimin;

- 2.2. Prej një niveli të shkollimit në nivelin më të lartë;
- 2.3. Prej shkollës speciale në shkollën e rregullt dhe anasjelltas;
- 2.4. Prej klasës së bashkangjitur në klasën e rregullt dhe anasjelltas

3. PIA përcakton:

- 3.1. Qëllimet edukativo-arsimore të fëmijës ose nxënësit për periudhën sa zgjat plani individual;
- 3.2. Objektivat mësimore të fëmijës ose nxënësit përmes të cilave realizohet qëllimi i përcaktuar;
- 3.3. Metodatat dhe teknikat e punës të nevojshme për të realizuar objektivat e përcaktuara;
- 3.4. Burimet e kërkuara për shërbimet që duhet ofruar bazuar në burimet ekzistuese;
- 3.5. Përmbajtjen e lëndëve mësimore të individualizuara ose të fushave të aktiviteteve;
- 3.6. Format e vlerësimit të fëmijës ose nxënësit;
- 3.7. Personat përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e PIA-s;
- 3.8. Procesin e monitorimit dhe rishikimit të tij.

Neni 6

Rishikimi dhe vlerësimi i PIA-s

- 1. Rishikimi dhe vlerësimi i PIA-s bëhet dy herë gjatë vitit shkollor dhe në çdo moment tranzicioni.
- 2. Në procesin e rishikimit dhe vlerësimit përfshihen të gjithë personat që punojnë me fëmijën ose nxënësin.
- 3. Vlerësimi i zbatimit të PIA-s përfshin dy aspekte:
 - 3.1. Vlerësimin e përgjithshëm të
 - 3.2. Vlerësimin e sistemit përkrahës.

Neni 7

Vlerësimi i suksesit të fëmijëve me PIA

- 1. Pas përfundimit të gjysëmvetorit të parë dhe të dytë, si dhe pas përfundimit të nivelit të caktuar, fëmijët ose nxënësit me PIA marrin librezë, dëftesa, certifikata dhe diploma.
- 2. Suksesi i fëmijës ose nxënësit evidentohet edhe në librin amëz.
- 3. Përgjegjësinë për vlerësimin e suksesit të fëmijës ose nxënësit e ka edukatori/mësimdhënësi i klasës ose arsimtari i lëndës së caktuar me mbështetjen e ekipit hartues të PIA-s.
- 4. Fëmijët ose nxënësit me PIA, që mund të ndjekin planprogramin e rregullt, vlerësohen sipas rregullave të përgjithshme të vlerësimit, me nota numerike dhe me vlerësim përshkrues.
- 5. Fëmijët ose nxënësit që nuk mund të ndjekin planprogramin e rregullt në lëndë të caktuara dhe kanë lëndë të individualizuara, vlerësohen duke u bazuar në rezultatet e pritshme individuale.

6. Vlerësimi i individualizuar evidentohet në dokumentacionin me yll.
7. Fëmijët ose nxënësit që ndjekin mësimin sipas fushave të aktiviteteve, vlerësohen sipas objektivave dhe qëllimeve individuale të përcaktuara.
8. Edukimi përmes fushave të aktiviteteve organizohet për fëmijët e moshës parashkollore dhe për fëmijët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta në nivel parashkollor dhe në nivele tjera.

Neni 8
Evidentimi dhe ruajtja e dokumentacionit

Evidentimi, besueshmëria dhe ruajtja e dokumentacionit të PIA-s është përgjegjësi e shkollës apo institucionit parashkollor përkatës.

Neni 9
Monitorimi i përdorimit të PIA-s

MASHT ka përgjegjësinë për monitorimin e përdorimit të PIA-s dhe për t'i angazhuar inspektorët e arsimit në procesin e monitorimit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi datën e nënshkrimit nga Ministri.

Prof.dr. Ramë Buja, ministër

UDHEZIMI ADMINISTRATIV NR. 07/2012 VLERESIMI PROFESIONAL I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA EDUKATIVO-ARSIMORE

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet; 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr:

UDHEZIM ADMINISTRATIV

Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore

Numër: 07/2012

Datë: 23.05.2012

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që të përcaktoj procedurën me të cilën bëhet vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore, në mënyrë që atyre t'ju ofrohet një arsimim i përshtatshëm për t'i përmbushur nevojat e tyre individuale të përcaktuara nga MASHT-i.

Neni 2 Vlerësimi profesional

1. Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta mund të përfshijë:

- 1.1. Institucionet parashkollore,
- 1.2. Të gjitha klasat në shkollat e rregullta,
- 1.3. Klasat e bashkangjitura në shkolla të rregullta,
- 1.4. Shkollat speciale-Qendrat burimore,
- 1.5. Shkollat speciale të tipit spitalor,
- 1.6. Qendrat edukative e rehabilituese-OJQ.

Neni 3 Inicimi i procedurës së vlerësimit profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore

1. Inicimin e kërkesës për vlerësimin profesional të fëmijëve që do të përfshihen në kornizën arsimore sipas qëllimit të përcaktuar nga nevojat e veçanta edukativo-arsimore të tij, mund të parashtrij:

- 1.1. Prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës;
- 1.2. Drejtori i shkollës ku është i regjistruar fëmija, me kërkesën e mësimdhënësit klasor dhe gjithëpërfshirës;
- 1.3. DKA, zyrtari i arsimit gjithëpërfshirës;
- 1.4. Mjeku i kujdesit familjar apo ndonjë specialist tjetër mjekësor;

1.5. Drejtori i Qendrës Komunale për Punë Sociale- punëtori social.

2. Kur në vend të njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit ligjor, një shërbim tjetër kërkon që të bëhet vlerësimi, kryesuesi i ekipit vlerësues duhet t'i informojë prindërit/kujdestarin ligjor dhe të kërkojë leje me shkrim prej tyre për të vazhduar procedurën e vlerësimit. Në rastet kur prindërit nuk jetojnë së bashku apo janë shkurorëzuar, nënshkrimi i njërit prind është i mjaftueshëm për të pranuar kërkesën, përderisa edhe prindi tjetër është i informuar për këtë kërkesë.

3. Kërkesa për vlerësim profesional të fëmijëve dorëzohet në DKA.

Neni 4

Ekipi profesional vlerësues dhe përkrahës

1. Vlerësimin profesional të fëmijëve do ta bëjnë anëtarët e ekipit profesional për vlerësim që emërohen nga komuna.

2. Ekipi vlerësues përbëhet anëtarët si në vijim:

2.1. Zyrtari komunal i arsimit special-gjithëpërfshirës;

2.2. Psikologu;

2.3. Punëtori social;

2.4. Mësimdhënësi gjithëpërfshirës;

2.5. Mësimdhënësi i klasës së bashkangjitur;

2.6. Mësimdhënësi profesional i Qendrës Burimore;

2.7. Eksperti varësisht nga karakteristikat e dëmtimit të fëmijës.

3. Prindi, kujdestari ligjor i fëmijës duhet të jetë prezent dhe konsultativ gjatë gjithë kohës së vlerësimit.

Neni 5

Kompetencat e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës EPVP

1. Vendimet e ekipit vlerësues të cilat janë të plotfuqishme duhet të zbatohen si nga personat që ju drejtohen ashtu edhe nga institucionet.

2. Ekipi vlerësues duhet të kërkojë dokumente të nevojshme për tu kompletuar, me qëllim të vlerësimit sa më objektiv dhe të plotë për fëmijën.

3. Ekipi i vlerësimit ka kompetenca që të:

3.1. Bëjë vlerësimin pedagogjik për aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës në procesin edukativo-arsimor.

3.2. Vendos sipas nevojës për mbështetje për nevoja të veçanta edukativo-arsimore, ofrimin e shërbimeve speciale brenda arsimit të rregullt siç janë: mbështetja nga mësimdhënësi gjithëpërfshirës ose arsimtari udhëtues, korrigjimi i të folurit ose shtesë për mësimdhënësin, terapi e gjuhës, edhëzime të specializuara ndihmë mjekësore për fëmijët sipas dëmtimeve dhe tjera.

3.3. Ekipi ka kompetencë që të marrë vendim për arsim me nevoja të veçanta, sipas nevojës së fëmijës.

4. Personat e pakënaqur me vendimet e ekipit për vlerësim mund të parashtrajnë ankesë në Komisionin për Parashtrësia në Komunë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Neni 6

Procedura për ofrimin e shërbimeve rreth vlerësimit të nevojave për arsimim me nevoja të veçanta

1. Gjatë periudhës së ardhshme dyvjeçare, procedura e vlerësimit profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore do të jetë fleksibile, në mënyrë që t'iu mundësohet këtyre fëmijëve qasja sa më e shpejtë që është e mundur në shfrytëzimin e shërbimeve të nevojshme. Procedura për përcaktimin e shërbimeve, në të ardhmen do të planifikohet në atë mënyrë që shërbimet e identifikuar si të domosdoshme, do të planifikohen në fillim të vitit shkollor.

2. Kërkesat për vlerësim do t'i dërgohen kryesuesit të ekipit vlerësues.

3. Në afat prej 15 ditësh nga koha e marrjes së kërkesës për vlerësim, kryesuesi do të caktoj një takim parapërgatitor me anëtarët e përhershëm të Ekipit vlerësues për të vendosur se çfarë vlerësimesh nevojiten, ndërsa në rastet urgjente ky takim parapërgatitor mund të bëhet edhe me mënyrë elektronike, telefon e mënyra të tjera të komunikimit të shpejt.

4. Kërkesa për vlerësimin e adresuar me shkrim do të dërgohet brenda 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

5. Prindërit e fëmijës janë të obliguar që pa marrjes së vendimit, të sjellin fëmijën si dhe dokumentacionin e kërkuar për vlerësim. Nëse prindi apo kujdestari ligjore kundërshton procedurën e vlerësimit, ata duhet gjithsesi ta informojnë ekipin për mosgatishmërinë e tyre në zbatimin e kërkesës së dërguar nga ana e ekipit për vlerësim, duke parashtruar ankesën e tyre dhe arsyeshmërinë e saj. Ankesa nga ana e prindërve nëse nuk ushtrohet në kohë, atëherë vendimi i ekipit do të zbatohet brenda 15 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për vlerësim.

6. Ekipi për vlerësim të fëmijës është i obliguar që brenda dy muajsh pas marrjes së kërkesës për vlerësim, të sigurojë dokumentacionin e duhur me të dhënat e nevojshme.

7. Kryesuesi cakton mbajtjen e një takimi të ekipit për t'i informuar të gjithë anëtarët e nëse paraqitet nevoja edhe shkollën, përfaqësuesit komunal si dhe prindërit apo kujdestarin ligjor të fëmijës për kohën e mbajtjes së këtij takimi.

8. Lajmërimi për takim do të bëhet së paku 10 ditë më parë.

9. Nëse prindërit dëshirojnë të marrin pjesë në takimin e ekipit, por për shkaqe objektive dhe subjektive nuk mund të vijnë, atëherë takimi mund të shtyhet deri në datën kur prindërit do të kenë mundësi të marrin pjesë.

10. Prindërit kanë të drejtë t'i shqyrtojnë të gjitha dokumentet që i sjell ekipi si dhe t'i fotokopjojnë sipas nevojës. Njëkohësisht, ata kanë të drejtën të shfrytëzojnë çdo protokoll që ka të bëjë me fëmijën e tyre.

11. Ekipi do të mbajë proces të rregullt për çdo takim të mbajtur në të cilin do të evidentohen të gjitha arsyeshmëritë rreth vendimeve të marra.

12. Drejtori komunal i arsimit ku fëmija me nevoja të veçanta caktohet se do të mbajë mësimin, është përgjegjës për zbatimin e vendimit të ekipit rreth sigurimit të transportit apo kompensimin e shpenzimeve

të nevojshme për bartjen e sigurt brenda komunës së tyre ose në një komunë tjetër në të cilën është caktuar fëmija që të shkollohet.

13. Ekipi ligjërish do të mbikëqyrë procesin e zbatimit të vendimeve të cilat i bie ekipi.

Neni 7 Plani Individual i Arsimit (PIA)

1. Plani individual i arsimit hartohet pas vendimit të ekipit vlerësues dhe përkrahës për arsimin me nevoja të veçanta. Secili fëmijë që ka vendim për arsim me nevoja të veçanta duhet të ketë PIA. Ekipi vlerësues dhe përkrahës mund të jap rekomandime për iniciimin e planit individual të arsimit PIA.

2. Drejtori i shkollës në të cilën mëson fëmija me nevoja të veçanta edukativo-arsimore është përgjegjës për kontrollimin e hartimit si dhe zbatimit të PIA-së.

Neni 8 Rishqyrtimi

1. Ekipi vlerësues duhet ti shqyrtoj të gjitha vendimet e veta së paku një herë në dy vite. Të gjithë ata që kanë kërkuar të bëhet vlerësimi i FNV nga ana e ekipit, mund të kërkojnë që rishqyrtimi i vendimeve të behet edhe më herët.

2. Procesi i rishqyrtimit do të jetë i ngjashëm me procesin që është përshkruar më lartë, por afati prej dy vitesh mund të shkurtohet nëse kështu vendos ekipi.

Neni 9 Financimi

Në bazë të dispozitave të përgjithshme të Ligjit për Menaxhimin e financave publike në Kosovë, komuna cakton nivelin e pagesës së anëtarëve të ekipit vlerësues në bazë të punës së kryer.

Neni 10 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ shfuqizohet UA nr. 9/2007, Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta

Neni 11 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Prof. dr. Ramë Buja, ministër

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.26/2012 KUALIFIKIMET PËR PERSONELIN QË PUNON ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE

Në bazë të nenit 33 paragrafi 6 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-032, (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, 22 mars 2011, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Kualifikimet për personelin që punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Numri: 26/2012

Data: 31.10.2012

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ (më tutje UA) është që të rregullojë kualifikimet e kërkuara për caktimin e personelit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore si me vështirësi në të mësuar, dëmtime në të dëgjuar, dëmtime në të parë, dëmtime të kombinuara në të parë dhe në të ndëgjuar, dëmtime intelektuale, fizike dhe dëmtime të shumëfishta etj.

Neni 2 Përkufizimet

Për t'iu shmangur dykuptimësive, e tërë terminologjia arsimore e përdorur në këtë UA do të përkufizohet në pajtim me nenin 2 të Ligjit për arsimin parauniversitar “Vështirësi në mësim” dhe “Ofrimi i arsimit me nevoja të veçanta”, nënkuptojnë ashtu siç janë përkufizuar në nenin 39 të ligjit në fjalë.

Neni 3 Kualifikimet për mësime dhënësit

1. Kualifikimet e kërkuara për caktimin e mësime dhënësit për nxënësit vlerësuar sipas nenit 41 dhe 42 të Ligjit për arsimin parauniversitar që kanë vështirësi në mësim dhe se kanë nevojë për arsim me nevoja të veçanta janë:

1.1. Edukimi parafillor: Fakulteti i Edukimit, programi parafillor.

1.2. Arsimi fillor:

1.2.1. Fakulteti i Edukimit, programi i arsimit fillor;

1.2.2. Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit – drejtimi përkatës;

1.2.3. Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë speciale;

1.2.4. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë se përgjithshme.

1.3. Arsimi i mesëm i ulët:

1.3.1. Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit-drejtimi përkatës;

1.3.2. Fakulteti i Edukimit programi i arsimit fillor;

1.3.3. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë speciale;

1.3.4. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë së përgjithshme.

1.4. Arsimi profesional:

Fakulteti përkatës për arsimin dhe aftësimin profesional dhe niveli Master.

1.5. Mësimdhënës udhëtues:

1.5.1. Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit- drejtimi përkatës;

1.5.2. Fakulteti i Edukimit, Programi i arsimit fillor;

1.5.3. Fakulteti Filozofik, dega e pedagogjisë speciale;

1.5.4. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë, niveli Master.

2. Mësimdhënës mbështetës :

2.1. Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit-drejtimi perkates.

2.2. Fakulteti i Edukimit, programi i arsimit fillor.

2.3. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë speciale.

2.4. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë, niveli Master.

3. Mësimdhënës në klasën e bashkangjitur :

3.1. Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit- drejtimi përkatës;

3.2. Fakulteti i Edukimit, programi i arsimit fillor;

3.3. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë speciale;

3.4. Fakulteti Filozofik dega e Pedagogjisë.

4. Ekipi profesional në Qendrat Burimore:

4.1. Punëtori social;

4.2. Psikologu;

4.3. Pedagogu;

4.4. Logopedi;

4.5. Audiologu;

4.6. Fizioterapeuti;

4.7. Pediatri;

4.8. Tifologu;

4.9. Surdopedagogu;

4.10. Oligopedagogu;

4.11. Somatopedagogu;

4.12. Ergoterapist dhe therapist okupues.

5. Bashkëpunëtorët e jashtëm: Psikiatri, oftalmologu, otorinolaringologu, mjeku u mjekësisë familjare.

6. Menaxheri i njësisë së shtypjes në Braj : Teknik, drejtimi informatikë.

7. Lektor i shkrimit në braj: Fakulteti i Filologjisë, gjuhë dhe letërsi shqipe ose gjuha e bashkësive të caktuar sipas gjuhës së shkollimit të nxënësit, me drejtimin 'njohës i shkrimit në braj'

8. Interpretues i gjuhës së shenjave: Fakulteti i Edukimit ose Pedagogjisë speciale. Certifikata mbi programin aftësues të akredituar për interpretues të gjuhës së shenjave.

Neni 4 Hyrja në fuqi

1. Hyrja në fuqi e këtij UA do të bëhet pa paragjykim të pozitës së personelit të punësuar deri në atë datë sipas dispozitave të legjislacionit ekzistues.

2. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Prof. dr. Ramë Buja, ministër

LIGJI Nr. 05/L -018

PËR PROVIMIN E MATURËS SHTETËRORE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PROVIMIN E MATURËS SHTETËRORE

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Ligj rregullohet funksioni, përmbajtja, kushtet, kriteret dhe mënyra e organizimit të provimit të maturës shtetërore.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Matura shtetërore** - vlerësim i arritjeve, të njohurive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve të cilët i kanë fituar gjatë arsimimit parauniversitar në përputhje me Kurrikulën e Republikës së Kosovës, apo përcaktimi i nivelit të kompetencave të arritura të nxënësve dhe lejimi i tyre që të vazhdojnë arsimimin në nivelin universitar.

1.2. **Kandidat** - nxënësi, personi i cili e përfundon me sukses klasën përfundimtare të arsimit të mesëm të lartë dhe i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore.

1.3. **Administruesi dhe Mbikëqyrësi** - persona të cilët caktohen nga organet kompetente për administrimin dhe mbikëqyrjen e testimit.

1.4. **Vëzhguesi** - person i angazhuar nga DKA në bashkëpunim me DVSM i cili vëzhgon dhe ndihmon procesin e administrimit të testimit për klasën e caktuar. Ai bashkërenditë detyrat dhe punët në bashkëpunim me administruesin për klasën përkatëse të akredituar nga Komisioni.

1.5. **Monitoruesi** - person i angazhuar nga KSHM në bashkëpunim me DVSM i cili monitoron vendin e mbajtjes së testimit me qëllim të ofrimit të dëshmimeve për mbarëvajtjen e procesit. Ai regjistron të gjitha aktivitetet e zhvilluara dhe raporton për realizimin e procesit të testimit prej momentit të fillimit deri në përfundim të këtij procesi në raport me standardet e vendosura. Detyrat dhe obligimet e tij përcaktohen paraprakisht nga DVSM dhe KSHM, ndërsa është person i pavarur në raportim për rrjedhën e tërë procesit.

1.6. **Test I standardizuar**- testi i përpiluar dhe harmonizuar në pajtim me karakteristikat metrike të testeve që janë sajuar nga një institucion i profesionalizuar për hartimin e testeve të tilla.

1.7. **DKA** - Drejtoria Komunale e Arsimit.

1.8. **DVSM** - Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim.

1.9. **IAL** - Institucionet e Arsimit të Lartë.

1.10. **KSHM** - Komisioni Shtetëror i Maturës.

1.11. **KKK**- Korniza e Kurrikulës së Kosovës.

Neni 3

Mbajtja e provimit

Provimi i Maturës Shtetërore mbahet me test të standardizuar, në kushte të barabarta për të gjithë kandidatët sipas rregullave dhe kriterëve të vlerësimit.

Neni 4

Provimi i maturës shtetërore

Provimi i maturës shtetërore është proces i mbledhjes, përpunimit, analizimit, vlerësimit dhe i interpretimit të të dhënave me qëllim të përcaktimit të shkallës së njohurive dhe zotërimit të kompetencave të përcaktuara në kurrikulë.

Neni 5

Të drejtat e kandidatit

1. Kandidati i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

2. Kandidati me nevoja të veçanta i nënshtrohet provimit të maturës shtetërore sipas kushteve dhe kriterëve që u përshtaten nevojave të tyre.

3. Provimit të maturës shtetërore i nënshtrohen edhe kandidatët nga arsimit për të rritur.

4. Kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve me nevoja të veçanta dhe kandidatëve të arsimit për të rritur përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 6

Kandidati i ardhur nga jashtë

1. Kandidati i cili jashtë Kosovës ka marrë dëftesën e klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë e cila është e nostrifikuar në Kosovë, ka të drejtë të hyjë në provimin e maturës shtetërore.

2. Kandidati i nënshtrohet provimit aty ku e cakton MAShT, bazuar në dokumentin e nostrifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

3. Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet e hyrjes në provim si të gjithë kandidatët e tjerë.

Neni 7

Organet kompetente

1. MASHT është autoriteti shtetëror përgjegjës për organizimin e provimit të maturës shtetërore në bashkëpunim me:

1.1. Komisionin Shtetëror të Maturës (KSHM).

1.2. Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA).

1.3. Shkollat e Mesme të Larta.

1.4. Komisionet e qendrave të testimit.

Neni 8

Komisioni Shtetëror i Maturës

1. Komisioni Shtetëror i Maturës (KSHM), është organ vendimmarrës, mbikëqyrës, organizativ, vlerësues, analizues dhe këshillues për maturën.

2. Komisioni Shtetëror i Maturës ka dymbëdhjetë (12) anëtarë me mandat tre vjeçar (3) në këtë përbërje:

2.1. MASHT tre (3) anëtarë, njëri nga ta kryetar.

2.2. DVSM një (1) anëtarë pa të drejtë vote.

2.3. Institucionet e Arsimit të Lartë tre (3) anëtarë,

2.4. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës një (1) anëtar,

2.5. DKA një (1) anëtar,

2.6. Përfaqësues nga drejtorët e shkollave të mesme të larta nga gjimnazet dhe shkollat profesionale dy (2) anëtar,

2.7. Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve të Kosovës një (1) anëtarë.

3. Ministri emëron Komisionin Shtetëror të Maturës, duke pasur parasysh barazinë gjinore dhe etnike.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror të Maturës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror të Maturës janë :

- 1.1. miraton listën e anëtarëve të komisioneve të lëndëve për përpilimin e kërkesave për provimin shtetëror të maturës me propozimin e DVSM.
- 1.2. miraton planin e punës për organizimin e provimit të maturës për vitin vijues të hartuar nga DVSM, më së largu deri më 31 gusht.
- 1.3. merr opinionet nga komuniteti për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit dhe mbi këto opinione nxjerr udhëzime për subjektet në procesin e provimit të maturës.
- 1.4. miraton katalogun dhe bën harmonizimin e lëndëve për provimin e maturës, në përputhje me planprogramet mësimore sipas drejtimeve respektivisht profileve, me propozimin e DVSM.
- 1.5. publikon rezultatet e testit me MASHT.
- 1.6. përcakton standardet për administrim të provimit të maturës shtetërore.
- 1.7. miraton testet e hartuara nga DVSM.

Neni 10

Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e DVSM janë :

- 1.1. harton teste të standardizuara bazuar në Kurrikulën e Kosovës të miratuar nga MASHT.
- 1.2. propozon dhe trajnon mbikëqyrësit, administruesit, anëtarët e komisioneve si dhe individë të tjerë të përfshirë në procesin e provimit të maturës shtetërore.
- 1.3. përgatit bazën e të dhënave për kandidatët e provimit të maturës shtetërore.
- 1.4. përgatit dhe publikon material bazë dhe informuese jo më vonë se në muajin tetor.
- 1.5. gjatë tërë vitit përgatit dhe publikon materiale ndihmëse për provimin e maturës shtetërore.
- 1.6. përgatit dhe shpërndan udhëzues për shkollat e mesme të larta dhe DKA për organizimin e programeve përgatitore për kandidatët që do t'i nënshtrohen provimit të maturës.
- 1.7. organizon dhe mbikëqyrë procesin e shtypjes, paketimit, shpërndarjes dhe kthimit të materialeve për provimin e maturës shtetërore.
- 1.8. bën kontrollimin dhe përpunimin e të dhënave të kandidatëve dhe përgatit rezultatet për shpallje.
- 1.9. përgatit raportin për ecurinë e testit të maturës dhe raportin teknik për provimin e maturës.
- 1.10. publikon materialet bazë, udhëzuesit informativ dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore në web faqen e MASHT.

1.11. krijon dhe procedon mënyrën e informimit rreth shpalljes dhe dokumenteve tjera për provimin e maturës në faqen elektronike dhe në media.

Neni 11

Drejtoria Komunale e Arsimit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e DKA-së janë:

- 1.1. shpallja e njoftimit për vendimin e ministrit në lidhje me organizimin e provimit të maturës.
- 1.2. caktimi i detyrave dhe obligimeve për drejtorët e shkollave në lidhje me mbajtjen e provimit të maturës sipas udhëzimeve të KSHM dhe DVSM.
- 1.3. siguron të dhënat e sakta dhe me kohë për kandidatët që do të vlerësohen përfshirë edhe kandidatët me nevoja të veçanta.
- 1.4. propozon mbikëqyrësit dhe administruesit sipas udhëzimeve të DVSM.
- 1.5. cakton objektet për qendra të testimit.
- 1.6. koordinon punët shkollë - DVSM dhe KSHM.
- 1.7. brenda tre (3) dite raporton me shkrim për mbarëvajtjen e procesit të provimit të maturës shtetërore.
- 1.8. analizon rrjedhat dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore në nivel të shkollave.
- 1.9. propozon dhe ndërmerr masa për ngritjen e cilësisë bazuar në rezultatet dhe analizat.
- 1.10. gjatë kohës së administrimit të testit angazhon ekipet e shërbimit shëndetësor

2. Kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga organet mbikëqyrëse.

Neni 12

Shkolla e Mesme e Lartë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Shkollës së Mesme të Lartë janë :

- 1.1. përgatit listën e kandidateve që i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore dhe i dërgon në DKA.
- 1.2. përgatit hapësirën për mbajtjen e provimit të maturës shtetërore sipas udhëzimeve nga KSHM.
- 1.3. përgatit dhe ofron program mbështetës për provimin e maturës shtetërore.

Neni 13

Komisioni në qendrat e testimit

1. Komisioni në qendrat e testimit përbëhet nga tre (3) anëtarë. Dy (2) anëtarë nga DKA dhe një (1) anëtar nga MASHT që i propozon DVSM.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të qendrës së testimit rregullohen me akt nënligjor dhe për shkeljet e tyre ndëshkohen në bazë të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 14

Administruesi dhe mbikëqyrësi

1. Administruesin dhe mbikëqyrësin i cakton DVSM në bazë të propozimeve të DKA dhe institucioneve të arsimit të lartë.
2. Puna e administruesit dhe mbikëqyrësit të provimit të maturës shtetërore monitorohet nga KSHM, DVSM dhe Komisioni i qendrës së testimit.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e administruesit dhe mbikëqyrësit rregullohen me akt nënligjor dhe për shkeljet e tyre ndëshkohen në bazë të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 15

Afati i organizimit të provimit të maturës shtetërore

Afatin dhe datën e organizimit të provimit të maturës shtetërore i cakton Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 16

Paraqitja e provimit të maturës

1. Kandidati paraqet provimin e maturës shtetërore më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së provimit.
2. Fletëparaqitja për provimin e maturës shtetërore plotësohet në formularin që merret në shkollë, i cili përmban të dhënat për kandidatin.
3. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidati paraqet edhe:
 - 3.1. dëftesat për kryerjen e klasave të shkollës së mesme të lartë,
 - 3.2. certifikatën nga libri amë i të lindurve,
 - 3.3. diplomën e shkollës së mesme të lartë profesionale.

Neni 17

Përmbajtja e provimit të maturës

1. Provimi i maturës shtetërore përbëhet nga:

- 1.1. lëndët obligative : gjuhë amtare, matematikë dhe gjuhë e huaj.
 - 1.2. lëndët zgjedhore të propozuara nga DVSM dhe të miratuara nga KSHM.
 - 1.3. kandidati përcaktohet për lëndët zgjedhore sipas afateve të parapara nga KSHM.
2. Digjitalizimi i provimit të maturës shtetërore rregullohet me akt nënligjor.

Neni 18

Kriteret e provimit të maturës

1. Të gjithë nxënësit/kandidatët e gjimnazeve të cilët me sukses e kanë përfunduar vitin e fundit pajisen me diplomë dhe i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore,
2. Të gjithë nxënësit/kandidatët që kanë kryer me sukses provimin përfundimtar të arsimit profesional pajisen me diplomë. Ata që dëshirojnë regjistrimin në IAL i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore.
3. Pragu i kalueshmërisë në provimin e maturës shtetërore është katërdhjetë përqind (40%).
4. Të gjithë kandidatët që kanë kaluar provimin e maturës shtetërore pajisen me certifikatë nga KSHM.
5. Forma dhe përmbajtja e certifikatës së provimit të maturës shtetërore, rregullohet me akt nënligjor të MASHT-it.
6. Kandidatët e pakënaqur me rezultatet e arritura në provimin e maturës shtetërore, kanë të drejtë ta refuzojnë rezultatin me shkrim para marrjes së diplomës dhe t'i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore në afatet vijuese.

Neni 19

Obligimet e Institucioneve të Arsimit të Lartë

1. Institucionet e Arsimit të Lartë, janë të obliguara që t'i pranojnë rezultatet e arritura të kandidatëve gjatë viteve të shkollimit të mesëm të lartë dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore.
2. Institucionet e Arsimit të Lartë publik dhe privat nuk kanë të drejtë të regjistrojnë studentë pa provim të maturës shtetërore.
3. Pranimi i studentëve do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura:
 - 3.1. tridhjetë përqind (30%) gjatë shkollimit të mesëm të lartë.
 - 3.2 .tridhjetë përqind (30%) në provimin e maturës shtetërore.
 - 3.3. katërdhjetë përqind (40%) në vlerësimin e brendshëm të njësive akademike.

Neni 20

Vendi i mbajtjes së provimit

1. Vendet e mbajtjes së provimit të maturës caktohet nga KSHM.

2. Lokalet ku mbahet provimi i maturës duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- 2.1. të kenë hapësirë të mjaftueshme për mbajtjen e provimit pa pengesë,
- 2.2. të kenë ndriçim dhe ajrosje të mjaftueshme,
- 2.3. të ketë materiale informuese dhe udhëzuese për mbarëvajtjen e provimit.
- 2.4. të jenë të mbikëqyrura dhe të siguruara në mënyrë që kandidatët t'i nënshtrohen provimit të pa penguar nga të tjerët.

Neni 21

Vërtetimi i identitetit të kandidatit

1. Vërtetimi i identitetit të kandidatit gjatë hyrjes në provimin e maturës shtetërore, bëhet përmes dokumentit zyrtar të identifikimit apo dokumentit të lëshuar nga institucioni shkollor.
2. Kandidatit nuk i lejohet hyrja në provimin e maturës shtetërore pa dokument identifikues.

Neni 22

Kohëzgjatja e provimit

Kohëzgjatja e provimit caktohet në bazë të numrit të pyetjeve dhe formatit të testit me vendim të KSHM.

Neni 23

Publikimi i rezultateve të provimit

DVSM është e obliguar që pas nxjerrjes së rezultateve të provimit të maturës t'ia paraqes KSHM-së për miratim dhe publikim.

Neni 24

E drejta në ankesë

Të drejtë ankesë kanë të gjithë kandidatët të cilët nuk janë të kënaqur me procesin e vlerësimit të tyre.

Neni 25

Subjekti tek i cili dorëzohet ankesa

1. Kandidati ka të drejtë të parashtojë ankesë:
 - 1.1. në shkallë të parë në DVSM.
 - 1.2. në shkallë të dytë në Komisionin për Parashtrësia dhe Ankesa në MAShT.

Neni 26

Afati për parashtrimin e ankesës

Afati për parashtrimin e ankesës në organin e shkallës së parë është tre (3) ditë pas publikimit të rezultateve, ndërsa në organin e shkallës së dytë është pesë (5) ditë nga dita kur kandidati ka marrë përgjigjen në ankesë.

Neni 27

Afati për marrjen e vendimit pas ankimit

1. Afati për marrjen e vendimit në përgjigje në ankesë:

1.1. nga DVSM është tre (3) ditë nga dita kur kandidati ka parashtruar ankesë.

1.2. nga Komisioni për Parashtresa dhe Ankesa në MASHT, është pesë (5) ditë nga dita kur kandidati ka parashtruar ankesë.

Neni 28

Ruajtja dhe arkivimi

Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit të maturës shtetërore bëhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar.

Neni 29

Dispozitat ndëshkimore

1. Anëtarët e Komisionit në qendrat e testimit, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i provimit të maturës shtetërore që shkel rregullat e administrimit të testit, ndëshkohet për kundërvajtje në shumë prej treqind euro (300) € deri në pesëqind euro (500) €.

2. Anëtarët e Komisionit në qendrat e testimit, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i provimit të maturës shtetërore i cili zbulon sekretet e testit ndëshkohet me gjobë në të holla prej një mijë (1000) deri në tremijë (3000) € si dhe me masa disiplinore dhe penale të parapara në Kodin Penal të Kosovës.

3. Kandidatët të cilët gjatë provimit të maturës shtetërore shkelin rregullat e mirësjelljes, të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim, ju anulohet testi i maturës dhe të njëjtët i nënshtrohen provimit në afatet vijuese.

Neni 30

Themelimi i Agjencisë

Me themelimin e Agjencisë së Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim sipas Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, përgjegjësia për organizimin e provimit të maturës shtetërore bartet nga DVSM tek Agjencia.

Neni 31

Aktet nënligjore

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë brenda tre (3) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 32

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 03/ L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore.

Neni 33 **Hyrja në fuqi**

Ky kigj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -018

14 dhjetor 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-044-2015, datë 29.12.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR.06/2016 KUSHTET DHE KRITERET E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

në mbështetje të nenit 5 paragrafit 2 dhe paragrafit 4 të Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore, Ligji nr. 05/L-018, (Gazeta zyrtare nr. 2/ 08 janar 2016), nenit 8 nenparagrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së punës së qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR.06/2016 KUSHTET DHE KRITERET E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 1 Qëllimi

Me anë të këtij Udhëzimi administrativ caktohet mënyra e organizimit, përmbajtja, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit të maturës shtetërore për kandidatët me nevoja të veçanta.

Neni 2 Nacionet

1. Kandidat me nevoja të veçanta konsiderohet kandidati që ka zhvillim të vonuar psikofizik që kufizon një apo më shumë aktivitete.
2. Kandidat me zhvillim të vonuar konsiderohet kandidati që ka një apo më shumë prej këtyre dëmtimeve:
 - 2.1. Dëmtime në të dëgjuar nga më të lehtat deri te më të rëndat;
 - 2.2. Dëmtime në të parë nga më të lehtat deri te më të rëndat;
 - 2.3. Dëmtime intelektuale, zhvillim mendor nën shkallën e pritur për moshën e individit;
 - 2.4. Dëmtime fizike, që shkaktojnë vështirësi dhe pamundësi të lëvizjes së lirë dhe të kryerjes së aktiviteteve të jetës së përditshme.

Neni 3 Përmbajtja e provimit të maturës shtetërore

1. Provimi i maturës shtetërore përbëhet nga:
 - 1.1. Lëndët obligative: gjuhë amtare, matematikë dhe gjuhë e huaj;
 - 1.2. Lëndët zgjedhore të propozuara nga DVSM dhe të miratuara nga KSHM;
 - 1.3. Kandidati përcaktohet për lëndët zgjedhore sipas afateve të parapara nga KSHM.

Neni 4 Procedura e organizimit të provimit të maturës shtetërore

1. Provimit të maturës shtetërore kandidati me nevoja të veçanta i nënshtrohet në të njëjtën kohë si edhe kandidatët e tjerë, por me kushte dhe kriteret të veçanta që u përshtaten nevojave të tyre.

2. Provimit të maturës shtetërore i nënshtrohet kandidati me nevoja të veçanta i cili jashtë Republikës së Kosovës ka marrë një dëftesë të barasvlershme me dëftesën e mbarimit të shkollës së mesme të lartë e cila është e verifikuar nga MASHT.

3. Kandidatit sipas pikës dy (2) të këtij neni i caktohet qendra e testimit në të cilën do t'i nënshtrohet provimit shtetëror të maturës me vendim të veçantë të lëshuar nga MASHT, bazuar në dokumentin e verifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me DKA.

Neni 5

Kushtet e mbajtjes së provimit të maturës shtetërore për kandidatin me dëmtime në të dëgjuar

1. Kandidatit që ka dëmtime në të dëgjuar duhet t'i sigurohen kushtet:

- 1.1. Vendi i përshtatshëm për mbarëvajtjen e provimit të maturës shtetërore;
- 1.2. Testi me lëndë dhe përmbajtje sipas drejtimit të caktuar;
- 1.3. Administruesi i cili duhet të jetë interpretues i gjuhës së shenjave;
- 1.4. Përparësi vendosjeje në qendrën e testimit.

Neni 6

Kushtet e mbajtjes së provimit të maturës shtetërore për kandidatin me dëmtime në të parë

1. Kandidatit që ka dëmtime në të parë duhet t'i sigurohen kushtet:

- 1.1. Vendi i përshtatshëm për mbarëvajtjen e provimit të maturës shtetërore;
- 1.2. Teksti me font më të madh të shkronjave;
- 1.3. Administruesi i cili duhet t'i lexojë tekstin dhe t'i ndihmojë në bartjen e përgjigjeve në fletëpërgjigje;
- 1.4. Përparësi vendosjeje në qendrën e testimit.

Neni 7

Kushtet e mbajtjes së provimit të maturës shtetërore për kandidatin me dëmtime intelektuale

1. Kandidatit që ka dëmtime intelektuale duhet t'i sigurohen kushtet:

- 1.1. Vendi i përshtatshëm për mbarëvajtjen e provimit të maturës shtetërore;
- 1.2. Administruesi i cili duhet t'i ofrojë asistencë përkatëse;
- 1.3. Përparësi vendosjeje në qendrën e testimit.

Neni 8

Kushtet e mbajtjes së provimit të maturës shtetërore për kandidatin me dëmtime fizike

1. Kandidatit që ka dëmtime fizike duhet t'i sigurohen kushtet:

- 1.1. Vendi i përshtatshëm për mbarëvajtjen e provimit të maturës shtetërore;
- 1.2. Administruesi i cili duhet t'i ofrojë asistencë teknike;

1.3. Përparësi vendosje në qendrën e testimit.

Neni 9
Kohëzgjatja e provimit të maturës shtetërore

Kohëzgjatja e provimit të maturës shtetërore për kandidatin me nevoja të veçanta përcaktohet sipas nevojës.

Neni 10
E drejta në ankesë

Kandidati me nevoja të veçanta ka të drejtë në ankesë sipas Ligjit nr. 05/L-018.

Neni 11
Dispozitat ndeshkimore

Kandidati me nevoja të veçanta i cili gjatë provimit të maturës shtetërore shkel rregullat e mirësjelljes të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim, i anulohet testi i maturës dhe i njëjti i nënshtrohet provimit në afatet vijuese.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri.

Prof. dr. Arsim Bajrami

Ministër

Dt. 05.05.2016

LIGJI NR. 03/L-068

PËR ARSIMIN NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton këtë

LIGJ PËR ARSIMIN NË KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

1.1 Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunat e Republikës së Kosovës.

1.2 Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të interpretohet si pakësim apo kufizim i të drejtave të cilat komunitetet dhe anëtarët e tyre i gëzojnë sipas ligjit në fuqi.

KREU I

Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Institucioneve të Republikës së Kosovës në Arsim

Neni 2
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Dhënia e kompetencave për komunat apo shkollat në fushën e arsimit sipas këtij ligji nuk mund të interpretohet si cenim i kompetencave të Kuvendit të Republikës së Kosovës ndër të tjera në lidhje me:

- a) çdo çështje që hyn në fushën e arsimit, e cila nuk është në interesin lokal;
- b) formulimin e standardeve që i përkasin çështjeve që hyn në fushën e arsimit, pa marrë parasysh nëse çështja në fjalë influencon një çështje që është apo nuk është në interesin lokal.

Neni 3
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT) ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) të zhvillojë politika dhe të hartoi e implementojë legjisllacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencën në Kosovë;
- b) të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim dhe mundësitë e shkollimit cilësor të vihen në dispozicion për të gjithë;
- c) të krijojë dhe menaxhojë një sistem të përgjithshëm të certifikimit për të gjithë mësimdhënësit në Kosovë;

- d) të përhapë arsimin jo-formal dhe arsimin për të rritur në të gjitha nivelet, duke përfshirë zonat e thella dhe të promovojë mundësitë e shkollimit gjatë gjithë jetës për të gjithë;
- e) të dizajnojë, implementojë dhe mbikëqyr forma të barasvlershme dhe efikase të administrimit arsimor dhe menaxhimit shkollor;
- f) të përmirësojë cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin arsimor në të gjitha nivelet;
- g) të lehtësojë zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe ofrimin efikas të shërbimeve arsimore;
- h) të promovojë hulumtimet në lidhje me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës;
- i) të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës të bibliotekave Universitare dhe shkollore;
- j) të promovojë një politikë përfshirëse për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor; dhe
- k) të promovojë pjesëmarrjen e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe format e duhura të partneriteteve shkollë-komunitet në nivelin lokal;
- l) inspektimin e Arsimit.

KREU II

Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Komunave në Arsim

Neni 4

Kompetencat dhe Kompetencat e Zgjeruara të Komunave

4.1 Komunitetët kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për atë që ata i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimitdhënësve dhe administratorëve.

4.2 Përveç kompetencave të referuara në Paragrafin 1 të këtij Neni, Komunave mund t'i u jepen kompetenca të zgjeruara në fushën e arsimit, ashtu si përshkruhet nga ky ligj dhe ligjet e tjera në fuqi.

4.3 Në pajtim me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, komunitetët kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komuna të tjera dhe autoritete të tjera, brenda sferës të kompetencave të veta në fushën e arsimit. Kjo e drejtë përfshin bashkëpunimin me komunitetët dhe institucionet në Republikën e Serbisë, duke përfshirë agjensionet qeveritare.

Neni 5

Kompetencat e Komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë)

Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë kompetencat e mëposhtme të veçanta komunale në arsimin publik për nivelet 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë) në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i:

- a) ndërtimin e objekteve shkollore në pajtueshmëri me Kapitullin 3 të këtij ligji dhe me ligjet e tjera në fuqi;

- b) regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mos-diskriminimit sipas ligjit;
- c) punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë;
- d) zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin e te dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin dy anëtar do të jenë nga Komuna dhe një nga MASHTI-i;
- e) regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë dhe licencimin e institucioneve arsimore parashkollore, në pajtim me Kapitullin 4 të këtij ligji;
- f) pagesën e stafit menaxherial si dhe të personelit tjetër të punësuar në pajtim me legjislacionin e Kosovës;
- g) trajnimin e edukatorëve dhe stafit tjetër profesional në pajtim me udhëzimet, parimet dhe standardet e shpallura nga MASHT-i;
- h) mbikëqyrjen e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i;
- i) përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin menaxherial, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, si dhe masat disiplinore;
- j) raportimin të qeveritë lokale dhe MASHT-i rreth arsimit, veprimtarive buxhetore dhe menaxhuese për nivelin parashkollor në pajtim me legjislacionin komunal dhe qendror;
- k) aplikimin e këtyre funksioneve apo kompetencave të deleguara, ashtu si përcaktohet nga marrëveshja formale mes komunës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- l) monitorimin dhe raportimin tek prindërit apo autoritetet e tjera përgjegjëse të vijueshmërisë arsimore dhe sociale të nxënësve, ashtu si përcaktohet nga legjislacioni; dhe
- m) caktimin e shumave të participimit të prindërve për pranimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte në pajtim me ligjet e Kosovës.

Neni 6

Përgjegjësitë Administrative të Komunave

Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë përgjegjësitë e mëposhtme komunale administrative në arsimin publik në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i:

- a) komunat ofrojnë shërbime arsimore administrative të mjaftueshme për funksionet e arsimit parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë në pajtim me ligjin;
- b) shërbimet arsimore administrative minimale përfshijnë emërimin e Drejtorit Komunal për departamentin/drejtoratin, i cili përbëhet nga sektori funksional për arsimin si dhe personel mbështetës të mjaftueshëm profesional për të kryer detyra e kërkuara sipas legjislacionit të Kosovës; dhe
- c) monitorimi dhe raportimi i menaxhimit dhe veprimtarive arsimore në komuna kryhen nëpërmjet organit administrativ komunal të identifikuar si kompetent për atë funksion nga Kryetari i Komunës.

KREU III

Kompetencat në Ndërtimin e Objekteve Arsimore Publike

Neni 7

Kompetencat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Kompetencat e MASHT-it në ndërtimin e objekteve shkollore përfshijnë ofrimin e asistencës teknike për komunat në planifikimin dhe projektimin e objekteve arsimore nëse kërkohet; shqyrtimin e të gjitha planeve dhe projekteve për pajtueshmëri me standardet e projektimit dhe ndërtimit të shkollave në Kosovë para fillimit të prokurimeve për shërbimet e ndërtimit; financimin dhe miratimet e ndërtimeve që financohen nga grantet e drejtpërdrejta të MASHT-it; dhe inspektimet para vënies në përdorim të objekteve të ndërtuara për pajtueshmëri me planet e miratuara dhe krijimin e kushteve normale për procesin arsimor dhe trajnues.

Neni 8

Kompetencat e Komunave

8.1 Objektet arsimore publike mund të ndërtohen nga komuna dhe të financohen nga buxhetit të komunës dhe donacionet tjera.

8.2 Kompetencat komunale në ndërtimin e objekteve arsimore përfshijnë identifikimin e nevojave për ndërtimin e objekteve arsimore, përcaktimin e vendndodhjes së objekteve dhe ofrimin e tokës komunale, përgatitjen e planit të implementimit, projektimin e objektit, dhënien e lejes së ndërtimit, prokurimin e shërbimeve dhe materialeve të ndërtimit, inspektimet e nevojshme, dhënien e lejeve përfundimtare për vënie në përdorim të objektit dhe krijimin e kushteve normale për procesin e arsimimit dhe trajnimit.

8.3 Komuna duhet të paraqesë konfirmimin për disponueshmërinë e tokës komunale për ndërtim, planin e implementimit të projektit dhe projektin përfundimtar të shkollës jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së planifikuar për fillimin e prokurimit për shërbimet e ndërtimit.

8.4 Shkollat do të kenë buxhetin e tyre të ndare nga Komuna.

Neni 9

Kompetencat që përcaktohen nga Burimet e Financimit

9.1. Nëse i gjithë financimi apo një pjesë e financimit të një objekti është grant i drejtpërdrejtë nga MASHT-i dhe granti është i pranuar formalisht nga komuna për atë ndërtim:

a) projekti i ndërtimit duhet të shqyrtohet dhe miratohet apo refuzohet nga MASHT-i brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga momenti i dorëzimit nga komuna dhe para fillimit të prokurimit për punimet e ndërtimit;

b) shqyrtimi dhe miratimi i këtyre projekteve nga MASHT-i është transparent dhe i bazuar në pajtueshmërinë me Master Planin e Ndërtimit Arsimor apo ndonjë ligj pasues dhe përmbushjes së kriterëve të MASHT-it për dizajnin dhe ndërtimin e shkollave; dhe

c) procesi i shqyrtimit dhe miratimit nga ana e MASHT-it rishikohet në pajtim me legjislacionin e Kosovës.

9.2. Nëse asnjë grant i drejtpërdrejtë nga MASHT-i nuk përdoret për të financuar të gjitha kostot apo një pjesë të kostove të ndërtimit për objektin arsimor, MASHT-i mund vetëm të miratojë projektin dhe ndërtimin, në pajtim me kriteret zyrtare të MASHT-it për dizajnin dhe ndërtimin e shkollave.

KREU IV

Licencimi dhe Regjistrimi i Mësimdhënësve dhe Licencimi i institucioneve

Neni 10

Licencimi , Regjistrimi dhe Punësimi i Mësimdhënësve

10.1 Mësimdhënësit mund të regjistrohen dhe punësohen vetëm nëse ata plotësojnë kriteret dhe standardet arsimore të caktuara me ligj.

10.2 MASHT-i organizon proces të para regjistrimit në shkallë vendi, duke u bazuar në kritere të drejta dhe transparente për të krijuar listën e mësimdhënësve të licencuar të mësimdhënësve të ardhshëm, kjo listë azhurnohet për çdo vit.

10.3 Të gjithë mësimdhënësit e ardhshëm të cilët janë të para regjistruar licencohen nga MASHT-i.

10.4 Pas krijimit të procesit të para regjistrimit dhe licencimit në shkallë vendi, dhe pas publikimit të listë së pare të hapur, komunat mund të regjistrojnë dhe punësojnë vetëm kandidatët, të cilët janë të përfshirë në listën e caktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

10.5 Procesi i licencimit i përcaktuar në këtë nen, i kushton vëmendje të veçantë nevojave të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, përfshirë edhe mundësinë efektive për dërgimin e mësimdhënësve nga shtetet e huaja.

Neni 11

Licencimi i Arsimit

11.1 Të gjitha institucionet arsimore në Kosovë licencohen në pajtim me kriteret dhe standardet e caktuara me ligj. Institucionet publike arsimore licencohen nga komuna para fillimit të funksionimit të tyre.

11.2 Komunat lëshojnë licenca të biznesit vetëm për institucionet arsimore private në mënyrë te njëjtë sikur licencat tjera të biznesit sipas dispozitave të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal të Kosovës. Komunat para lëshimit të licencës për biznes për objektet edukativo-arsimore private në territorin e tyre kërkojnë dokumente që dëshmojnë regjistrimin dhe licencimin nga MASHT-i si institucion edukativo-arsimor.

11.3 Komunat pas marrjes së një vendimi me shkrim nga ana e MASHT-it lëshojnë vendime administrative të cilat japin, mohojnë apo anulojnë licencimin e çdo institucioni edukativo-arsimor publik.

a) MASHT-i e dorëzon njoftimin për mendimin e tij tek komuna dhe institucioni që e ka bërë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas dorëzimit të kërkesës për mendim nga komuna.

b) Komuna informon institucionin që e ka bërë kërkesën për vendimin e saj jo më vonë se 60 ditë pasi ta pranojë pranon mendimin nga ana e MASHT-it.

11.4 Në të gjitha rastet kur vendimi i komunës dallon nga mendimi i MASHT-it, komuna duhet t'i ofroj MASHT-it dhe institucionit që e ka bërë kërkesën sqarim të hollësishëm me shkrim për arsyet e vendimit të saj; dhe

11.5 Nëse komuna nuk e informon institucionin që e ka bërë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, siç kërkohet në paragrafin 3 b të këtij neni, mendimi i MASHT-it vlerësohet të jetë vendim përfundimtar për licencimin e Institucionit edukativo-arsimor.

KREU V

Arsimimi në Gjuhën Serbe

Neni 12

Arsimimi në Gjuhën Serbe

12.1 Komunitetët kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe.

12.2 Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

12.3 Plan programet apo tekstet shkollore përkatëse të Republikës së Serbisë nuk do të përdoren për mësimdhënie para njoftimit të MASHT-it; nëse pas këtij njoftimi, MASHT-i brenda tre muajve nuk paraqet ndonjë kundërshtim (në mënyrë që t'i ofrohet kohë e mjaftueshme Ministrisë të shqyrtoj plane programet apo tekstet shkollore në fjalë), ai material mund të përdoret.

12.4 Në rast të paraqitjes së kundërshtimit nga ana e MASHT-it për përdorimin e ndonjë plan programi apo teksti shkollor të caktuar në gjuhën serbe, çështja i dërgohet komisionit të pavarur, i cili themelohet në bazë të nenit 13 të këtij ligji, për të shqyrtuar plan programin apo librin shkollor në fjalë, për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Plan programi mësimor i caktuar ose teksti shkollor nuk mund të përdoren për mësimdhënie pa vendosur komisioni i pavarur.

Neni 13

Komisioni i Pavarur

13.1 Komisioni i pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

- a) tre (3) përfaqësues nga MASHT-i;
- b) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilët që mbajnë ulëset e rezervuara apo garantuara për komunitetin serb të Kosovës; dhe
- c) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

13.2 Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash.

13.3 Kryesimi i Komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëset e rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe përfaqësuesit të zgjedhur nga MASHT-i çdo vit.

Neni 14

Kompetencat e Zgjeruara të Komunës së Mitrovicës Veriore

Kompetencat e poshtëshënuara janë kompetencat komunale për arsimin e lartë në Mitrovicën Veriore:

- a) Universiteti i Mitrovicës Veriore është institucion publik autonom i arsimit të lartë;
- b) Universiteti miraton statutin që saktëson organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror të Republikës së Kosovës, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur:

(i) komisioni i pavarur përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve:

(ii) tre (3) përfaqësues të përzgjedhur nga MASHT-i;

(iii) tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga universiteti; dhe

(iv) Një (1) anëtar, i përzgjedhur nga Kryeministri.

(v) komisioni i merr vendimet me shumicë votash;

(vi) kryesimi i komisionit bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga Universiteti dhe një përfaqësues i përzgjedhur nga MASHT-i.

c) Vendimet për pajtueshmërinë e statutit me legjislacionin kornizë qendror, standardet dhe praktikat më të mira evropiane si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e universitetit brenda sistemit universitar të Kosovës merren nga komisioni i pavarur i themeluar sipas nenit 14b të këtij ligji;

d) Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetencat për këtë universitetin publik në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin në fuqi të Republikës së Kosovës;

e) Universiteti do të ketë Bordin e përbërë nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy do të caktohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjidhen nga fakulteti apo nga organi i studentëve të Universitetit dhe dy (2) anëtarët tjerë do të zgjidhen në mënyrën e përcaktuar në statutin e Universitetit;

f) Komuna gjithashtu do të sigurojë që Universiteti të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe burimet e tjera institucionale. Fondet për universitetin nga Republika e Serbisë duhet të jenë transparente dhe të bëhen publike, në pajtim me ligjet e Kosovës;

g) Veprimet dhe burimet buxhetore që i ofrohen Universitetit të Mitrovicës Veriore duhet të jenë në pajtim me ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në legjislacionin që hyn në fuqi deri më 1 janar 2009; dhe

h) Komuna e Mitrovicës Veriore mund të bashkëpunojë me çdo komunë tjetër për drejtimin e universitetit.

KREU VI

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare dhe Hyrja në Fuqi

Neni 15

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

15.1 Institucionet e qeverisjes lokale harmonizojnë Statutet dhe Rregulloret e aplikueshme me dispozitat e këtij ligji Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga hyrja e tij në fuqi.

15.2 Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, zhvlehtësohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë Ligj.

Neni 16

Mjetet Juridike

Kundër çdo veprimi apo mosveprimi të ndërmarr nga ndonjë autoritet sipas këtij ligji pala e interesuar ka te drejte ankese ne procedurën administrative apo gjyqësore.

Neni 17

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-068

21 Maj 2008

Ligji Nr. 02/L-52

MBI EDUKIMIN PARASHKOLLOR

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (d) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15. maj 2001),

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e edukimit parashkollor;

Miraton:

LIGJIN MBI EDUKIMIN PARASHKOLLOR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përkufizimet:

Neni 1

Edukimi parashkollor i referohet edukimit të hershëm nga edukatorët e njohur për fëmijët e moshës parashkollore.

Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet edukimit të posaçëm të tyre që kanë ngecje ose dëmtime shqisore, dëmtime fizike, vështirësi në të nxënë, çrregullime sociale, emocionale dhe në komunikim.

Gjithëpërfshirja (shih Konventa e të Drejtave të Fëmijës, neni 2) - Shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

Institucione parashkollore mund të definohen objektet apo shtëpitë e konventuara të cilat janë të ndërtuara në mënyrë speciale për të ofruar programe parashkollore dhe të cilat plotësojnë nevojat edukative dhe zhvillojnë nevojat e fëmijëve deri në regjistrimin e tyre në shkollë fillore. Këto institucione ofrojnë shërbime të cilat janë me orar të plotë, gjysmë orari dhe mund të zgjatet orari edhe gjatë shërbimit të mbrëmjes.

Institucione tjera parashkollore, këtu hyjnë të gjitha institucionet tjera parashkollore, pos atyre publike d.m.th institucionet parashkollore private, Qendrat me Bazë në Komunitet etj.

Mbrojtja e fëmijëve (shih Konventa e të Drejtave të Fëmijës, neni 19)

-Shtetet palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja apo shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e

prindërve të tij, ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

Pjesëmarrja e prindërve i referohet involvimit të prindërve në aranzhimet e bëra nga institucionet parashkollore për të ndihmuar dhe kontribuar prindërit në efektivitetin e vendimeve në edukimin e fëmijëve të tyre, aktivitetet të cilat mbështesin planprogramin e atyre të cilët asistojnë në veprimin e institucioneve parashkollore.

Programet e edukimit parashkollor i referohen shërbimeve për edukim dhe zhvillim të hershëm të ofruara në institucione parashkollore publike, paralele parafillore, institucione tjera parashkollore e familje.

Standardet e edukimit parashkollor i referohen udhëzimeve të vendosura nga MASHT-i të cilat paraqesin kërkesat esenciale për ofrimin e edukimit parashkollor në Kosovë.

Neni 2

- 2.1. Edukimi parashkollor është hallkë përbërëse e sistemit unik të edukimit dhe arsimit në Kosovë.
- 2.2. Edukimi parashkollor përfshin fëmijët deri me regjistrimin e tyre në shkollën fillore.
- 2.3. Përfshirja e fëmijëve në edukim parashkollor rregullohet me udhëzim administrativ.
- 2.4. Vijimi i edukimit parashkollor është vullnetar.

Qëllimet e edukimit parashkollor

Neni 3

Qëllimet e ligjit për edukim parashkollor janë rregullimi normativ institucional i edukimit parashkollor në institucionet parashkollore, përmes të cilave do të arrihet :

- (a) Të inkurajohet aftësia që të kuptohet dhe të pranohet vetvetja dhe të tjerët;
- (b) Të inkurajohet aftësia për bashkëbisedime, të pranohen ndryshimet dhe të marrin pjesë në grupe;
- (c) Të inkurajohet aftësia për të identifikuar emocionet dhe të nxiten në shprehjen dhe manifestimin e përjetimeve emocionale;
- (d) Të inkurajohet kërshtëria, shpirti hulumtues, intuita dhe imagjinata dhe të zhvillohet mendimi i pavarur;
- (e) Të inkurajohet zhvillimi gjuhësor dhe i komunikimeve tjera për përdorimin efikas dhe kreativ të gjuhës, që më vonë të ndihmojë në lexim dhe shkrim;
- (f) Të inkurajohet aftësia dhe shprehja artistike;
- (g) Të transferohet dituria në fusha të ndryshme të shkencës dhe jetës së përditshme;.
- (h) Të inkurajohet zhvillimi trupor dhe psikik;
- (i) Të inkurajohet pavarësia e fëmijëve në higjienën personale dhe në kujdesin e shëndetit të tyre;
- (j) Të inkurajohet raporti pozitiv ndaj mjedisit jetësor dhe vetëdijesimi për mjedisin ekologjik.

Parimet e edukimit në institucionet parashkollore

Neni 4

Edukimi në institucionet parashkollore do të bazohet në këto parime:

- (a) Barazia;
- (b) Gjithë përfshirja;
- (c) Demokracia;
- (d) Autonomia e personelit;
- (e) Profesionalizmi dhe përgjegjësia;
- (f) Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve;
- (g) E drejta për të qenë ndryshe;
- (h) Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve.

Gjuha

Neni 5

5.1. Në institucionet parashkollore, edukimi parashkollor do të bëhet në gjuhën shqipe.

5.2. Në vendbanimet me popullsi të përzier institucionet parashkollore do të ofrojnë edukim edhe në gjuhën e minoriteteve konform dispozitave kushtetuese dhe ligjeve të veçanta.

Fëmijët me nevoja të veçanta

Neni 6

6.1. Edukimi parashkollor është e drejtë e të gjithë fëmijëve përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta, i cili do të realizohet në përputhje me këtë ligj dhe me akte nënligjore.

6.2. Në pajtim me këtë ligj, fëmijët me nevoja të veçanta përfshijnë edhe fëmijë me dëmtime mentale, të verbër dhe fëmijë me dëmtime të shikimit, të shurdhër dhe ata me dëmtime të dëgjimit, fëmijët me dëmtime në të folur, fëmijët me dëmtime motorike dhe me çrregullime të sjelljes dhe emocioneve, fëmijët me dëmtime të kombinuara dhe fëmijët tjerë në rrezik për të qenë në pozitë të pafavorshme arsimore, të cilëve u duhen instruksione të ndara me ndihmë profesionale shtesë ose programe speciale.

Krijimi i kushteve për vendosje të fëmijëve në institucionet parashkollore

Neni 7

7.1. Kur në rrethin e vendbanimit të fëmijëve, nuk ka institucione parashkollore, komuniteti ka të drejtë të vetorganizohet në përputhje me këtë ligj, për të ofruar shërbime të edukimit parashkollor. Në mbështetje të këtyre organizimeve të komunitetit, institucionet përgjegjëse të edukimit parashkollor të komunës përkatëse, duhet të synojnë të gjejnë mundësi për të përkrahur këto iniciativa. Përkrahja duhet të jetë në përputhje me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore.

7.2. Kur në rrethin e vendbanimit të fëmijëve, në institucionet parashkollore nuk ka vende të lira edhe pse numri i aplikantëve i përmbush kushtet për formimin e grupeve të tjera, komuniteti ka të drejtë të kërkojë nga institucionet përgjegjëse të edukimit parashkollor komunal, të zgjerojë kapacitetin e institucioneve parashkollore përkatëse. Këto të fundit brenda një afati optimal duhet të synojnë t'i përmbushin kërkesat e komunitetit, ose të ndihmojnë në gjetjen e alternativave të tjera.

7.3. Kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së përmendur në të dy paragrafët e mësipërme do të përcaktohen qartë me aktet nënligjore.

II. ORGANIZIMI DHE PËRMBAJTJA E EDUKIMIT PARASHKOLLOR NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE DHE INSTITUCIONET TJERA PARASHKOLLORE

Detyrat themelore

Neni 8

Detyrat themelore të institucioneve parashkollore janë:

- a) Ndihma prindërve në përkujdesin dhe edukimin e fëmijëve;
- b) Përparimi i cilësisë së jetesës së fëmijëve dhe familjes;
- c) Krijimi i kushteve për zhvillimin e potencialeve individuale të fëmijëve dhe manifestimin e tyre; dhe
- d) Krijimi i kushteve për t'i aftësuar fëmijët në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që i shtron shkolla.

Neni 9

Programet edukativo-arsimore për fëmijët parashkollor duhet të bazohen në plan programin e përgjithshëm të edukimit parashkollor të miratuar nga Këshilli i Ekspertëve të Programeve dhe Teksteve Shkollore të MASHT-it.

Plani dhe Programi

Neni 10

10.1. Institucioni parashkollor e ushtron veprimtarinë e vet në bazë të planit dhe programit të punës, i cili bëhet për një vit shkollor dhe zgjat, nga 1 shtatori i vitit vijues deri më 31 gusht të vitit të ardhshëm.

10.2. Planin dhe programin vjetor të punës për një vit shkollor e bie këshilli drejtues i institucionit parashkollor më së largu deri më 31 gusht.

10.3. MASHT nxjerr udhëzime administrativ lidhur me këshillin drejtues, përbërjen dhe kompetencat e tij.

10.4. Plani vjetor i punës përfshin programet edukative, programet e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve, të higjienës dhe ushqimit, të kujdesit shoqëror si dhe programet tjera të cilat institucioni parashkollor i realizon në marrëveshje me prindërit e fëmijëve.

10.5. Organizimi dhe komponentet e detajizuara të jetës në institucionet parashkollore do të përcaktohen nga plani vjetor i punës, i miratuar nga këshilli drejtues i institucionit parashkollor në bashkëpunim me këshillin e prindërve.

10.6. Plani vjetor i punës do të përcaktojë organizimin e institucionit dhe orët e punës, programet, edukimin dhe kujdesin për fëmijët (në kujdesin familjar të fëmijëve), vendosjen e fëmijëve në grup moshë, punën e profesionalistëve dhe personelin tjetër në institucion, bashkëpunimin me prindërit për edukimin dhe kujdesin, shëndetin dhe ndihma të tjera, mbikëqyrje të edukatorëve fillestar, relacionet e komunitetit, bashkëpunimin me personelin trajnues të institucionit parashkollor në fushën e edukimit parashkollor, programet e avancimit të personelit, programet e punës të institucionit për trupin profesional dhe personelin tjetër, si dhe dinamikën e veprimtarisë edukative, nevojat materiale dhe të tjera për realizimin e procesit edukativ.

10.7. Zbërthimi i detyrave të dhëna në paragrafin dy dhe detyrave tjera rregullohet me udhëzim administrativ.

Prezantimi i plan programeve parashkollore

Neni 11

11.1 Institucionet parashkollore do të shkoqisin plan programet duke i ofruar, objektivat, përmbajtjet dhe metodat e punës. Plan programet publikohen posaçërisht për prindërit.

11.2. Institucionet parashkollore publike dhe të tjera do të publikojnë opinionin e Këshillit të Ekspertëve të Programeve dhe Teksteve Shkollore të MASHT-it.

11.3. Çështjet e obligueshme për (shpallje) publikim do të përcaktohen nga MASHT-i me udhëzim administrativ.

Programet për fëmijët parashkollor dhe miratimi

Neni 12

12.1. Programet edukativo-arsimore për fëmijët parashkollor të përpiluara nga institucionet parashkollore publike dhe të tjera dhe ekspertëve të tjerë duhet të jenë në harmoni me standardet e përgjithshme të edukimit parashkollor.

12.2. Programet edukativo-arsimore për fëmijët parashkollor të përpiluara në institucionet parashkollore publike e tjera do të miratohen nga Këshilli i Ekspertëve të Programeve dhe Teksteve Shkollore i MASHT-it.

12.3. Programet edukativo-arsimore për fëmijët parashkollor do të përfshijnë:

- (a) Emërtimin e programit;
- (b) Premisat filozofike;
- (c) Fushat dhe objektivat e veprimtarive edukative;

- (d) Përmbajtjen;
- (e) Metodologjinë;
- (f) Kohëzgjatjen;
- (g) Mënyrat dhe format e bashkëpunimit me prindër.

12.4. Ofruesit e programeve edukative për fëmijët parashkollorë në institucione publike duhet të zgjidhen nga Kuvendi Komunal ose nga dy e më shumë komuna nëse në mes tyre ka një marrëveshje.

12.5. Programet për fëmijët parashkollor në institucionet tjera parashkollore, do të hartohen nga themeluesit ose personeli i përshtatshëm i institucioneve parashkollore në pajtim me këtë ligj dhe statutin e themeluesit.

E drejta për të zgjedhur një program

Neni 13

13.1. Prindërit kanë të drejtën e zgjedhjes së programeve parashkollore për fëmijët e tyre në institucionet publike apo private.

13.2. Mënyra e zgjedhjes së programeve rregullohet me udhëzim administrativ.

Kohëzgjatja e programeve në institucionet parashkollore

Neni 14

14.1. Institucionet parashkollore ofrojnë programe me kohëzgjatje si në vijim:

- a) Programet me orar të plotë që zgjasin gjashtë deri në dhjetë orë në ditë;
- b) Programet me gjysmë orari që zgjasin tri deri në gjashtë orë në ditë, të cilat mund të ofrohen në mëngjes, pasdite ose me ndërime;
- c) Programe afatshkurta që zgjasin 240 deri në 600 orë në vit për fëmijët parashkollor.

14.2. Programet afatshkurtra dhe afatgjata u ofrohen fëmijëve deri në përfshirjen e tyre në shkollë fillore.

14.3. Kohëzgjatja e programeve tjera parashkollore do të rregullohet me udhëzim administrativ.

Regjistrat e edukimit parashkollor

Neni 15

15.1. Institucionet parashkollore duhet të mbajnë regjistra të edukimit parashkollor të përcaktuara nga MASHT-i.

15.2. Më kërkesën e MASHT-it dhe organeve tjera kompetente regjistrat e mbajtur për edukimin parashkollor duhet të dorëzohen në afatin e paraparë.

III. EDUKIMI PARASHKOLLOR FORMAL NË FAMILJE

Neni 16

16.1. Edukimi parashkollor formal organizohet edhe në familje.

16.2. Edukimi parashkollor formal në familje organizohet për fëmijët të cilët nuk mund të shkojnë në institucione parashkollore për shkak të sëmundjes.

16.3. Kushtet dhe mënyrat e organizimit të edukimit parashkollor formal rregullohen në përputhje me këtë ligj dhe me anë të udhëzimit administrativ.

16.4. Mënyra e caktimit, financimit dhe mbikëqyrjes së edukatorit që punon në edukimin parashkollor në familje do të rregullohet me udhëzim administrativ.

IV. THEMELIMI I ASOCIACIONEVE DHE GRUPEVE KËSHILLUESE

Themelimi i asociacioneve dhe grupeve këshilluese

Neni 17

Institucionet përgjegjëse të edukimit parashkollor në Kosovë që sigurojnë dhe mbështesin edukimin parashkollor mund të themelojnë asociacione dhe grupe këshilluese në mënyrë që së bashku t'i zgjidhin problemet e tyre, të bashkëpunojnë me trupa profesional dhe administrativ, si dhe të kryejnë detyra të tjera të përbashkëta.

V. FINANCIMI

Burimet e financimit

Neni 18

Programet e edukimit parashkollor mund të financohen nga :

- (a) Buxheti i Kosovës;
- (b) Themeluesit;
- (c) Pagesat nga prindërit;
- (d) Donacionet dhe burimet tjera.

Themeluesit dhe mjetet financiare

Neni 19

19.1. Themeluesi i institucionit parashkollor, është i obliguar që të sigurojë mjete për themelimin dhe punën e institucionit parashkollor.

19.2. Themelues i institucioneve parashkollore publike është komuna, ndërsa themelues i institucioneve tjera parashkollore janë personat juridik privat.

19.3. Institucioni parashkollor i siguron mjetet edhe përmes shitjes së shërbimeve në treg dhe nga burime tjera në pajtim me ligjin.

19.4. Nëse dy apo më tepër themelues e themelojnë së bashku një institucion parashkollor, mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, i sigurojnë themeluesit sipas aktit të themelimit.

19.5. Mjetet nga paragrafët paraprake të këtij neni, të realizuara në institucionin parashkollor publik duhet të depozitohen në llogarinë adekuate zyrtare bankare në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, ndërsa shpenzimi i tyre do të bëhet në bazë të planit dhe programit vjetor të institucionit parashkollor publik, të cilin e miraton DKA.

19.6. Mjetet e dedikuara për financimin e edukimit parashkollor publik dhe mënyra e shpenzimit të tyre do të rregullohet me udhëzim administrativ.

Kontrolli financiar

Neni 20

Përdorimi i mjeteve financiare në institucionet parashkollore do të kontrollohet dhe inspektohet nga mekanizmat e kontrollit dhe inspektimit nga MASHT-it dhe institucionet tjera përkatëse.

Institucionet parashkollore publike Financimi nga komuna

Neni 21

21.1. Dallimi në mes të çmimit të programeve edukative dhe pagesës së bërë nga prindërit do të sigurohet nga buxheti i komunës për financimin e të ardhurave personale, të mirave, taksat e të punësuarve në institucion e po ashtu edhe shpenzimet për material në pajtim me standardet.

21.2. Financimi nga paragrafi paraprak do të sigurohet nga komuna në të cilën prindërit kanë banim të përhershëm. Komuna gjithashtu do të sigurojë financimin për fëmijët, prindërit e të cilëve janë banorë të përkohshëm të këtij komuniteti lokal nëse të paktën njëri prej tyre është pagues i taksave në Kosovë.

21.3. Buxheti i komunës gjithashtu do të sigurojë fonde për mirëmbajtjen dhe investimin në prona dhe pajisjet e institucioneve parashkollore publike dhe mundësisht institucionet parashkollore që veprojnë në bazat e një koncesioni.

Pagesat e bëra nga prindërit

Neni 22

Bazë e pagesës së bërë nga prindi do të jetë ushqimi i fëmijëve dhe materiali didaktik.

Përcaktimi i çmimeve të programeve

Neni 23

Kushtet për përcaktimin e çmimeve të programeve edukative rregullohen me udhëzim administrativ.

Përcaktimi i tarifave të paguara nga prindërit

Neni 24

24.1. Tarifatat që duhet të paguhen nga prindërit do të përcaktohen nga komuna në bazë të një shkalle që i grupon prindërit në të ardhurat për pjesëtarë të familjes në krahasim me pagën mesatare në Kosovë dhe pasurisë familjare.

24.2. Prindërit që marrin ndihmë sociale do të jenë të liruar nga këto tarifa.

24.3. Në raste përjashtimesh, komuna mundet në bazë të opinionit të autoriteteve kompetente mbi taksat dhe ndihmën sociale, që gjatë përcaktimit të tarifës për pagesë të pranojnë fakte të tjera që tregojnë gjendjen e vërtetë sociale të familjes si dhe shtesën e të ardhurave dhe pasurisë të specifikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

24.4. Nëse më shumë se një fëmijë vijon institucionin parashkollor, tarifatat për fëmijën tjetër do të zbriten për një klasë.

24.5. Zbritja e tarifave për fëmijë do të rregullohen me udhëzim administrativ.

24.6. Duke mos marrë parasysh kushtëzimet e këtij paragrafi, prindërit që nuk i përmbahen detyrimit të taksës mbi të ardhurat në Kosovë, do të duhet të paguajnë çmimin e plotë të programit të ndjekur nga fëmija i tyre.

Zhvillimi i edukimit parashkollor Mjetet nga Buxheti i Kosovës

Neni 25

25.1. Nga Buxheti i Kosovës mund të financohen si më poshtë:

- a) Për zhvillimin e mëtejshëm të përhershëm shkencor të edukimit parashkollor, MASHT-i bart përgjegjësinë për institucionet përkatëse;
- b) Personelit profesional dhe ndihmës të institucioneve parashkollore u mundësohet qasja në të ardhurat më të reja shkencore;
- c) Mbledhje profesionale;
- d) Punësimi dhe trajnimi profesional gjatë punës provuese;
- e) Revista për fëmijë, revista profesionale dhe subvencionime për publikime profesionale;
- f) Pajisjen dhe funksionimin e mediatekës në institucione parashkollore publike;
- g) Bashkëpunim ndërkombëtar.

25.2. Kategoritë e fëmijëve që janë përfitues të veçantë nga Buxheti i Kosovës janë:

- a) Grupet parashkollore të hospitalizuar në spitalet që veprojnë në nivele të Kosovës;
- b) Grupet parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta , dhe
- c) Fëmijët e invalidëve të luftës.

Institucionet tjera parashkollore Licencimi i institucioneve tjera parashkollore

Neni 26

Licencimin e institucioneve parashkollore private e bën MASHT-i.

Mundësitë dhe kërkesat për mbështetje, financim

Neni 27

27.1 MASHT-i dhe institucionet përgjegjëse komunale të edukimit parashkollor do të synojnë të përkrahin financiarisht iniciativat jopublike që ofrojnë shërbime të edukimit parashkollor. Me synim që të rritet përqindja e fëmijëve që kanë qasje në këtë lloj edukimi dhe cilësia e përgjithshme e edukimit parashkollor në Kosovë, MASHT-i dhe institucionet përgjegjëse komunale të edukimit parashkollor gjatë marrjes në konsiderate, përkrahjes financiare të këtyre iniciativave, duhet të ketë parasysh këto kritere:

- a) Pozita gjeografike e komunitetit ku ofrohet ky shërbim, duke marrë parasysh sidomos zonat rurale dhe ato të lëna pas dore;
- b) Shërbimet për fëmijë me nevoja të veçanta;
- c) Personeli i institucioneve parashkollore duhet të jenë të punësuar në baza të rregullta ligjore;
- d) Qasja të jetë e hapur për të gjithë fëmijët.

27.2. Mënyrat, kushtet dhe mundësitë e financimit të institucioneve tjera parashkollore do të rregullohen me udhëzim administrativ.

VI. TË PUNËSUARIT E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Kërkesat lidhur me kualifikim

Neni 28

28.1. Veprimtaritë edukative në institucione parashkollore duhet të realizohen nga edukatorë parashkollorë, asistentë parashkollor, këshilltarë, specialistë të fushave të ndryshme edukativo-arsimore.

28.2. Edukatorët parashkollor të grup-moshave parashkollore që ofrojnë programe speciale për fëmijë të moshës parashkollore me nevoja të veçanta, duhet të kenë të njëjtin nivel të arsimit që nevojitet për edukatorë të tjerë parashkollor dhe duhet të kenë kualifikim adekuat.

28.3. Grupet parashkollore që përfshijnë edhe fëmijë me nevoja të veçanta, në mungesë të kuadrit të paraparë në nenin 28.2 mund t'u jepet edukim nga një edukator parashkollor me një diplomë në arsimim parashkollor të përgjithshëm dhe arsimim ose aftësim shtesë për fëmijë me nevoja të veçanta.

28.4. Edukatorët duhet të kenë:

- a) Diplomën e Fakultetit të Edukimit programi parashkollor;
- b) Shkollës së Lartë Pedagogjike-drejtimi për edukatorë;
- c) Fakulteti Filozofik-dega e Pedagogjisë, dhe
- d) Diploma të fakulteteve arsimore, të plotësuara me trajnime adekuate për edukatorë parashkollorë e të certifikuara nga MASHT-i.

28.5. Personeli që udhëheq institucionin parashkollor duhet të ketë:

- (a) Diplomë fakulteti me programe të edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve parashkollor;
- (b) Përvojë dhe aftësi menaxhuese;
- (c) Në mungesë të tyre mund të zgjidhen edhe kandidatët e profileve arsimore me përgatitje pedagogjike

28.6. Zgjedhjen e udhëheqësve të institucioneve parashkollore publike e bën MASHT, kurse të institucioneve tjera parashkollore themeluesi.

28.7. Përbërja e komisionit dhe mënyra e zgjedhjes së udhëheqësve të institucioneve parashkollore, përcaktohet me udhëzim administrativ.

28.8. Asistenti parashkollor duhet të ketë:

- a) Një diplomë të shkollës së mesme të marrë nga mbarimi i një programi për arsimin parashkollor, ose
- b) Një diplomë të shkollës së mesme të plotësuar me trajnime adekuate profesionale, e të certifikuar nga MASHT-i.

28.9. Këshilltarët duhet të kenë diplomë universitare në fushën përkatëse si dhe kualifikime pedagogjike.

28.10. Specialistët duhet të kenë diplomë universitare, në mungesë të tyre mund të punojnë edhe me Shkollë të Lartë.

28.11. Punësimi në institucionet parashkollore bëhet në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil.

Orët e punës së edukatorëve

Neni 29

29.1. Fondi i orëve të punës për edukatorë parashkollor duhet të përfshijë përgatitjet, planifikimin, realizimin e aktiviteteve edukative, bashkëpunim me prindërit, pjesëmarrje në organizimin e jetës dhe punës në institucionet parashkollore.

29.2. Fondi i orëve të punës së edukatores për javë do të caktohet me udhëzim administrativ.

VII. MBLEDHJA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 30

Institucionet parashkollore do të mbledhin, procesojnë, ruajnë, mbajnë dhe të përdorin të dhënat personale të mbajtura në regjistra në përputhje me rregullat për mbrojtjen e informacioneve personale të identifikimit në qoftë se ndryshe nuk përcaktohet me ligj.

Lloji i të dhënave në institucione parashkollore

Neni 31

Në mënyrë që të sigurojnë edukimin parashkollor, të monitorojnë aktivitetet dhe t'i përdorin për statistika, institucionet parashkollore duhet të ruajnë shënimet e më poshtme:

- a) Të dhënat e fëmijëve që kanë aplikuar dhe atyre që janë pranuar;
- b) Të dhënat e shumave të paguara nga prindërit;
- c) Të dhënat e fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje dhe këshillim të veçantë;
- d) Të dhënat eventuale të ndonjë kujdestari shtëpiak të fëmijës/fëmijëve.

Të dhënat e fëmijëve aplikues dhe të pranuar

Neni 32

Të dhënat e fëmijëve aplikues dhe të pranuar do të rregullohen me udhëzim administrativ.

Të dhënat e shumave të paguara nga prindërit dhe gjendja sociale e familjeve

Neni 33

33.1. Institucionet parashkollore duhet të ruajnë të dhëna mbi shumat e paguara nga prindërit.

33.2. Të dhënat mbi shumat e paguara nga prindërit duhet të përmbajnë:

- a) Shumat individuale të faturave që duhet të paguhen nga prindërit;
- b) Pagesat e faturave mujore nga prindërit.

33.3. Të dhënat nga paragrafi 2, i këtij neni duhet të ruhen për të monitoruar pagesat mujore.

33.4. Institucionet parashkollore publike duhet të sigurojnë të dhënat nga paragrafi 2, i këtij neni nga komuna që është kompetente për përcaktimin e shumave të faturave për t'u paguar nga prindërit, ndërsa për institucionet tjera parashkollore përcaktohen nga themeluesi.

33.5. Të dhënat e gjendjes sociale të familjeve të fëmijëve që ndjekin një institucion parashkollor duhet të përfshijnë informacion mbi:

- a) Të ardhurat, buxhetin dhe pronën e pjesëtarëve të familjes;
- b) Numrin e pjesëtarëve të familjes;
- c) Fakte dhe rrethana të tjera që mund të ndikojnë në shumën e faturave;
- d) Faturat e paguara nga prindërit.

33.6. Komunat duhet të mbledhin të dhënat nga pika (a) dhe (b) e paragrafit paraprak të këtij neni, vetëm për prindërit që kërkojnë një zbritje në fatura (çmime).

33.7. Themeluesit mund t'ia delegojnë të drejtën për të mbledhur dhe ruajtur të dhënat e gjendjes sociale të familjeve, institucioneve parashkollore.

Të dhënat e fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje dhe këshillim të veçantë

Neni 34

34.1. Të dhënat e fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje dhe këshillim të veçantë duhet të përfshijnë:

- a) Anamnezën familjare dhe sociale;
- b) Anamnezën e zhvillimit;
- c) Procedurën diagnostike;
- d) Procedurën për mbështetje profesionale;
- e) Opinione profesionale të institucioneve të tjera: qendra të mirëqenies, institucione shëndetësore, qendra mbështetëse për këshillim dhe arsimim.

34.2. Të dhënat personale të fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje dhe këshillim të veçantë do të mblidhen në bazë të gjykimit të shërbimit këshillues.

34.3. Të dhënat personale të specifikuara në paragrafin e parë do të mblidhen në marrëveshje me prindërit e fëmijëve ose me kujdestarët ligjorë, përveç rasteve kur fëmijët janë të rrezikuar nga familjet dhe ju nevojitet mbrojtje.

34.4. Këshilltarët do të jenë të detyruar të trajtojnë informacionin e specifikuar nga paragrafi i parë i këtij neni me besueshmëri profesionale. Specialistë të tjerë që marrin të dhëna të tilla si shkas i natyrës të punës së tyre gjithashtu duhet t'i trajtojnë të dhënat me besueshmëri profesionale.

Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Neni 35

Mënyra e mbledhjes së të dhënave do të rregullohet me udhëzim administrativ.

Ruajtja e të dhënave Afati i ruajtjes së të dhënave

Neni 36

Shënimet për të dhënat e aplikantëve do të fshihen brenda një viti pasi që një fëmijë nuk është pranuar, ndërsa të dhënat e vijuesve të edukimit parashkollor mund të fshihen duke u bazuar në ligjin për ruajtjen e dokumenteve zyrtare.

Mbrojtja e të dhënave

Neni 37

37.1. Institucionet parashkollore janë të obliguara që të dhënat e tyre sipas kërkesës t'ia dërgojnë MASHT-it.

37.2. Institucionet parashkollore dhe komuna duhet t'i bëjnë të ditura të dhënat nga dosjet e tyre organeve të tjera administrative ose organizatave të tjera në bazë të Ligjit për qasje në dokumente zyrtare.

37.3. Kur të procesohen, të dhënat personalisht të identifikueshme mund të përdoren dhe publikohen vetëm në atë formë që mos të bëjnë të ditur identitetin e një individi.

37.4. Të dhënat personalisht të identifikueshme lidhur me zhvillimin personal të fëmijës nga dosjet personale të fëmijëve në institucionet parashkollore mund të dërgohen jashtë institucionit parashkollor për dhe me kërkesën e institucionit tjetër vetëm me lejen e prindit të fëmijës, nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 38

38.1. Mbikëqyrjen mbi zbatueshmërinë e këtij ligji dhe dispozitave që dalin nga ky ligj e bën MASHT-i.

38.2. Mbikëqyrjen inspektuese e bën inspekcioni i arsimit, në përputhje me ligjin mbi inspektionin e arsimit.

38.3. Mbikëqyrja profesionale pedagogjike e punës së edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional realizohet në suaza të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nga mbikëqyrës profesional pedagogjik ose persona tjerë profesional, të cilët i autorizon MASHT-i.

38.4. Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale pedagogjike, të drejtat, detyrat, dhe autorizimet e mbikëqyrësve profesional pedagogjik dhe personave tjerë të autorizuar për mbikëqyrje profesionale pedagogjike rregullohen me udhëzim administrativ.

38.5. Mbikëqyrjen inspektuese shëndetësore mbi zbatimin e këtij ligji, që ka të bëjë me mbrojtjen shëndetësore dhe ushqimin e fëmijëve, e ushtron inspeksioni sanitar komunal.

38.6. Mbikëqyrjen inspektuese sanitare mbi zbatueshmërinë e këtij ligji, që ka të bëjë me ushqimin e fëmijëve, e ushtron Ministria e Shëndetësisë.

38.7. Mbikëqyrjen inspektuese të rrezikut nga zjarri e bën shërbimi i zjarrfikësve .

38.8. Mbikëqyrjen për punën profesionale në zbatimin e këtij ligji, për pjesën që ka të bëjë me kujdesin social dhe abuzimit të fëmijëve e organizon dhe zbaton Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe institucionet tjera përkatëse.

38.9. Institucionet parashkollore janë të obliguara të raportojnë çdo shqetësim apo rast që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijës institucioneve përkatëse, në bazë të nenit 19 të Konventës së të Drejtave të Fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

Ndalimi i punës

Neni 39

39.1. Nëse organi kompetent shtetëror vërteton se institucioni parashkollor nuk plotëson kushtet e parapara me ligj do të përcaktojë një afat optimal, që nuk e cenon mirëqenien e fëmijës, brenda të cilit institucioni parashkollor duhet t'i eliminojë parregullsitë.

39.2. Nëse institucioni parashkollor nuk i mënjanon parregullsitë në afatin e përcaktuar, organi kompetent shtetëror do të bie aktin me të cilin do t'i ndalohet puna institucionit parashkollor.

Shpenzimet e sistemit të fëmijëve në institucionet parashkollore do t'i bartë institucioni parashkollor, të cilit i është ndaluar puna.

Gjobat

Neni 40

40.1. Themeluesi i institucioneve dhe organizatat edukativo-arsimore do të dënohen me dënime administrative, gjobë prej 500-1.000 €, nëse do të kalojnë numrin e fëmijëve të grup moshave, ndërsa drejtorët parashkollor të përgjegjshëm për veprimtarinë e institucioneve parashkollore do të jenë përgjegjës për një gjobë prej 200-1.000 €, nëse numri i fëmijëve në grup-moshë është më i madh se sa në udhëzim administrativ.

40.2. Në rast të përsëritjes së shkeljeve të parapara në paragrafin 1, dënimet administrative dyfishohen.

40.3. Në rast të ripërrirjes së shkeljeve do të ngritët procedura për shkarkimin e drejtorit dhe marrjen e licencës së punës institucionit.

IX. NDËRPRERJA E PUNËS SË INSTITUCIONIT PARASHKOLLOR

Neni 41

41.1. Ndërprerja e punës së institucioneve dhe organizatave të edukimit parashkollor mund të bëhet me vendimin e themeluesit.

41.2. Me vendimin e MASHT-it, nëse veprimtaria edukativo-arsimore bëhet pa licencim nga MASHT-i.

41.3. Institucionit parashkollor i ndërpritet puna sipas kushteve dhe mënyrës së paraparë me këtë ligj.

41.4. Me vendimin për ndërprerjen e punës së institucionit parashkollor përcaktohet edhe afati dhe mënyra e ndërprerjes së punës dhe rregullohet mënyra e sistemit të fëmijëve, të cilët kanë qenë vijues të institucionit parashkollor në institucion tjetër përkatës, sipas mundësive.

41.5. Rastet e ndërprerjes së punës së institucionit parashkollor do të caktohen me udhëzim administrativ.

X. DISPOZITAT E PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Financimi

Neni 42

42.1. Para adaptimit të programeve të edukimit parashkollor në përputhshmëri me këtë ligj, në vijim këto pika konsiderohen si shërbime publike në fushën e edukimit parashkollor dhe përgatitjes për shkollë:

- a) Edukimi parashkollor i fëmijëve para se të hyjnë në shkollë, duke përfshirë përgatitjen e fëmijëve për shkollë fillore;
- b) Edukimi dhe kujdesin për parashkollorë me nevoja të veçanta sipas ligjit;
- c) Programe për fëmijë parashkollor të qytetarëve jashtë shtetit.

42.2. Aktivitetet e specifikuar në pikën (a) të paragrafit paraparak do të jenë të financuara nga buxhetet e komunave, aktivitet e specifikuar në pikën (b) do të jenë të financuara nga buxhetet e komunës dhe

shtetit, ndërsa aktivitetet e specifikuara në pikën (c) të paragrafit paraprak do të financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe qytetarët tanë jashtë Kosovës.

Edukatorët parashkollorë

Neni 43

Edukatorët parashkollor që i kanë përmbushur kërkesat për mësimdhënie para hyrjes në fuqi të këtij ligji mund të vazhdojnë punën edukative edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Punësimi

Neni 44

Punësimi i personelit në institucione parashkollore publike bëhet në bazë të Ligjit për shërbime civile.

Miratimi i plan programit

Neni 45

45.1. Këshilli i Ekspertëve i programeve dhe teksteve shkollore i MASHT- bën miratimin e plan programit të edukimit parashkollor.

45.2. Deri në miratimin e plan programit të ri të edukimit parashkollor vazhdohet të punohet me atë ekzistues.

Përshtatja e programit

Neni 46

46.1. Institucionet parashkollore publike dhe të tjera duhet të përshtatin programet e tyre në harmoni me standardet e edukimit dhe arsimit parashkollor me këtë ligj brenda 2 vitesh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

46.2. Përshtatja e planeve dhe programeve me plan programin e ri të edukimit parashkollor, duhet të realizohet deri në vitin 2007.

46.3. Nëse institucionet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni nuk i përmbushin obligimet e specifikuara në paragrafin e parë dhe dytë të këtij neni, do t'i merret licenca e punës.

Zbritja graduale e numrit të fëmijëve sipas grup-moshave

Neni 47

Numri i fëmijëve sipas nenit 2.3 të këtij ligji, do të realizohet deri më 1 shtator 2007.

Neni 48

MASHT duhet të synojë që deri në vitin 2010 të sigurojë gjithë përfshirjen e fëmijëve pesë deri në gjashtë vjeç në edukimin parafillor.

Neni 49

MASHT nxjerr udhëzime administrative në afat prej një viti për plotësimin e këtij ligji.

**Hyrja në fuqi e ligjit
Neni 50**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vlejtori aktet ligjore dhe nënligjore të mëparshme, të cilat e kanë rregulluar këtë fushë.

Neni 51

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Më 6 mars 2006

UNMIK/REG/2006/11

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 19/2016 PËR
PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONE PARASHKOLLORE NË KOSOVË**

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 2.3. të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor (UNMIK/REG 2006/11 6 mars 2006), nenit 8 nën paragrafi 1.4. të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë të zyrës së kryeministrit dhe ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores së punës së qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 19/2016
PËRFSHIRJA E FËMIJËVE NË INSTITUCIONE PARASHKOLLORE NË KOSOVË**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim t'ua mundësojë të gjithë fëmijëve përfshirjen në edukimin parashkollor.

**Neni 2
Moshat fillestare**

1. Në institucionet parashkollore përfshihen fëmijët prej moshës 9 muaj deri në 6 vjeç.
2. Edukimi parashkollor organizohet në dy ndarje të grup-moshave:
 - 2.1. Në çerdhe përfshihen fëmijët nga moshat 9 muaj deri në 3 vjeç, ndërsa
 - 2.2. Në kopshte përfshihen fëmijët 3-6 vjeç.

**Neni 3
Procedurat e regjistrimit të fëmijëve në I.P**

1. Procedurat për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore për fëmijët nga 9 muaj deri në 6 vjeç.
2. Përmbajtja e kërkesës për fëmijën aplikues në institucion parashkollor:
 - 2.1. Emri i fëmijës/ emri dhe mbiemri i prindit, kujdestarit ligjor;
 - 2.2. Certifikata e lindjes së fëmijës;
 - 2.3. Vendbanimi, adresa;
 - 2.4. Data e dorëzimit të kërkesës;
 - 2.5. Nënshkrimi i prindit;
 - 2.6. Dëshmia nga mjeku për gjendjen shëndetësore të fëmijës;
 - 2.7. Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës).
 - 2.8. Të dhënat për prindërit/kujdestarin ligjor.
3. Kërkesa duhet të përmbajë këto të dhëna për të dy prindërit, emri dhe mbiemri i kujdestarit ligjor.

- 3.1. Vendi i punës (nëse punon, studion), kualifikimi dhe nr. i telefonit, email adresa;
- 3.2. Numri i anëtarëve të familjes së ngushtë;
- 3.3. Numri i fëmijëve tjerë të vendosur në IP.

Neni 4

Parakushtet/kriteret për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore

1. Në institucionet parashkollore publike, kanë të drejtë të aplikojnë për pranim fëmijët që i takojnë komunës, bashkësisë lokale/lagjeve të së njëjtit lokacion me kopshtin ose aplikojnë në kopshtin më të afërt.
2. Në institucion parashkollor, të drejtë aplikimi kanë fëmijët nga mosha 9 muajsh, kur fillon vijueshmëria në kopsht dhe përfundon në moshën 6 vjeçare kur fillon arsimi i obliguar – klasa e parë.
3. Udhëheqësit e institucionet parashkollor i përcaktojnë grupet edukative për konkurs për aplikim sipas grup-moshave të përcaktuara në nenin 5.
4. Përfshirja në institucionet parashkollore publike është me pagesë, tarifa që duhet paguhet nga prindi do të përcaktohet nga komuna, sipas një shkalle në bazë të të ardhurave të familjes në krahasim me pagën mesatare dhe të ardhurave të familjes.
5. Fëmijët që vijnë nga grupet e rrezikuara lirohen nga pagesa (fëmijët e familjeve me asistencë sociale, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, fëmijët e nënave vetë mbajtëse, fëmijët që jetojnë me një prind, fëmijët e veteranëve të luftës). Komuna është e obliguar që fëmijëve që aplikojnë nga grupet e marginalizuara t'u sigurojë vend në IP.
6. Çdo fëmijë me nevoja të veçanta arsimore ka të drejtë të përfshihet në njërën nga grupet edukative në institucion parashkollor.
 - 6.1. Fëmijët me dëmtime të rënda mund të përfshihen në IP, nëse institucioni e ka të siguruar kuadrin adekuat profesional dhe kushtet tjera të nevojshme, varësisht nga lloji i dëmtimit.
 - 6.2. Koha e qëndrimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në IP përcaktohet në bazë të vlerësimit nga ekipi vlerësues nëse IP e posedon, por nëse IP nuk e posedon këtë ekip, atëherë kërkohet ndihma nga ekipi vlerësues pedagogjik komunal, çdo herë në bashkëpunim me prindin nëse fëmijët janë në gjendje të përballojnë regjimin ditor të institucionit parashkollor, duke pasur parasysh shkallën dhe nevojat e veçanta të tyre që i posedojnë.
7. Për të gjitha rastet e liruara nga pagesa prindërit/kujdestarët ligjor, duhet të dëshmojnë me dokumenta zyrtar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale kërkesën për lirim.
8. Përparësi për regjistrim në institucionet parashkollore kanë fëmijët e stafit edukativ (që janë me gjidhënie) por jo në grupin që ajo punon në institucion.
9. DKA në bashkëpunim me institucionet parashkollore harton kriteret për publikim të konkursit duke u mbështetur në këtë udhëzim administrativ.
10. Komuna obligohet të subvencionoj fëmijët e liruar nga pagesa.
11. IP krijojnë portfolio për secilin fëmijë me të gjitha shënimet e kërkuara të cilën duhet ta përditësojë, përcjellë e plotësojë për çdo vit deri në mbarim të vijueshmërisë në edukimin parashkollor.

12. Pas mbarimit të edukimit parafillor, një kopje e portfolios së fëmijës, i jepet fëmijës, ndërsa një kopje ruhet në arkivin e IP-së.

Neni 5

Raporti edukator/fëmijë sipas grup-moshave

1. Për moshën e fëmijëve nga 9 muaj – vjeç, raporti edukator/fëmijë është 2:10, ose më së shumti 2:12.
2. Për moshën e fëmijëve 2 – 3 vjeç, raporti edukator/fëmijë është 2:14, ose më së shumti 2:16.
3. Për moshën e fëmijëve 3 – 4 vjeç – raporti edukator/fëmijë është 2:20, ose më së shumti 2:22.
4. Për moshën e fëmijëve 4 – 5 vjeç, raporti edukator/fëmijë është 2:22, e më së shumti 2:24.
5. Për moshën e fëmijëve 5- 6 vjeç, në kopshte raporti edukator/fëmijë është 2:24, ose më së shumti 2:26.
6. Nëse institucioni parashkollor ka hapësirë fizike prej moshës 3 – 6 vjeç, për grup-mosha të organizimit, numri i fëmijëve mund të rritet për dy fëmijë më shumë, me vendim të drejtorit të kopshtit dhe këshillit të prindërve.
7. Nëse një fëmijë me nevoja të veçanta arsimore është pjesë në njërin nga grup-moshat, atëherë numri minimal i fëmijëve duhet të zbres për dy fëmijë më pak në grup.
8. Nëse në IP ka edukatore mbështetëse ose ka asistente për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, numri i fëmijëve nuk ka nevojë të zbresë për dy më pak.
9. Numri maksimal i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore/dëmtime të lehta në një grup mund të jetë 3 fëmijë.
10. Numri i fëmijëve në grup duhet të jetë i përcaktuar për arsye të lehtësimit dhe bashkëveprimit fëmijë/i rritur si dhe bashkëveprimit mes fëmijëve.
11. Çdo fëmijë duhet të frekuentojë në një grup (klasë të qëndrueshme).
12. Çdo grup edukativ (dhimë) duhet të ketë dy edukatore në institucionet parashkollore me kohë qëndrimi të plotë për çdo grup edukativ. Edukatorët të cilat punojnë nga 6 orë të drejtëpërdrejtë me fëmijë dhe 2 orë përgatitore, norma e plotë e edukatores/it që punon në institucionet parashkollore është 30+10.
13. Edukatorët janë përgjegjës të drejtëpërdrejtë për vazhdimësinë e veprimeve edukative.
14. Për moshën 5 – 6 vjeç, edukatorët që punojnë në paralelet parafillore, në kuadër të shkollave fillore duhet të punojnë nga 5 orë pune të drejtëpërdrejt me fëmijët dhe 1 orë përgatitje për punë edukative, duke përcjellë 2 grupe fëmijësh. Raporti edukator/fëmijë për këtë grup-moshë është 1:18 maksimumi i lejuar është 20 fëmijë në një grup edukativ.

14.1. Grupi 1 – 2:30 minuta

14.2. Grupi 2 – 2:30 minuta

14.3. Në total norma 5+1)

Neni 6

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 6/2008 i dt. 03.03.2008 si dhe Udhëzimi nr. 48/2007.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij.

Prof. dr. Arsim Bajrami

Ministër

Datë: 26.08.2016

LIGJI Nr. 04/L-037

PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton:

LIGJ PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

KREU I

LIGJIN PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i Ligjit të arsimit të lartë është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Parimet

1. Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në parimet si në vijim:

1.1. lirinë akademike, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe interpretimi i saj i mëtutjeshëm nga ana e gjyqësorit;

1.2. barazia para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë.

1.3. mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim.

1.4. shumëllojshmëria dhe cilësia në programe të studimit dhe në mbështetje të mësimnxënies;

1.5. kreativiteti, inovacioni dhe ndërmarrësia si objektiva kyçe për bartësit e arsimit të lartë dhe të programeve të studimit;

1.6. fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit të lartë që i sigurojnë studentit dhe personelit lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në dhënien e diplomave dhe kualifikimeve.

1.7. përkushtim në punë kërkimore dhe akademike për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien si dhe për të zgjeruar kufijtë e njohurive brenda Kosovës dhe jashtë saj.

1.8. angazhim aktiv të studentëve si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv, në jetën e institucionit dhe në mësimnxënien e tyre.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Akreditim** - njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuar të cilësisë dhe se kualifikimet e tij u japin bartësve të tyre, në pajtim me ligjin në fuqi, një numër të drejtash, siç janë mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, profesione specifike dhe për të përdorur një titull.

1.2. **Mbrojtje e të dhënave** - dhe emërtimet në lidhje me to kanë kuptimin e bashkëngjitur atyre në Ligjin nr. 2009-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.

1.3. **Rrjeti Evropian i Qendrave për Informim-ENIC** - rrjeti evropian i qendrave për informim, të cilat ofrojnë informacione për njohjen e diplomave, titujve dhe kualifikimeve të tjera ndërkombëtare, për sistemin arsimor, si për vendet e huaja, ashtu edhe për vetë vendin anëtar të këtij rrjeti si dhe për mundësitë e studimit jashtë vendit, duke përfshirë edhe pagesat dhe bursat dhe këshilla për çështje praktike në lidhje me lëvizshmërinë dhe barasvlerën.

1.4. **Sistemi Evropian i Transferimit dhe i Akumulimit të Kredive (ECTS)** - cakton kreditë për komponentët e kursit, të bazuara në ngarkesën në punën e studentëve që kërkohet për të arritur objektivat e një drejtimi të veçantë të studimit.

1.5. **Zonë evropiane e arsimit të lartë** - ka kuptimin e përcaktuar në deklaratën e ministrave evropianë të arsimit të lartë në Bolonjë (1999).

1.6. **Sigurim i brendshëm i cilësisë** - vlerësimi formal i proceseve, përmes të cilëve bartësi siguron vetveten se oferta e tij (qoftë ajo e programeve apo e shërbimeve) i plotëson standardet që korrespondojnë me praktikën më të mirë evropiane dhe që tregojnë përmirësim të vazhdueshëm.

1.7. **Rezultatet e të nxëniet** - arritjet në nxënie dhe shprehen në terma të asaj se çka pritet që nxënësi të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të shkallës së studimeve apo të modulit. Aty mund të përfshihen edhe qëndrimet, sjelljet, vlerat dhe etika.

1.8. **Të mësuarit gjatë gjithë jetës** - arsimimi i përgjithshëm, arsimimi dhe aftësimi profesional, arsimimi joformal dhe nxënia informale, të ndërmarra gjatë gjithë jetës, duke rezultuar në ngritjen e njohurive, shkathtësive dhe të kompetencave brenda perspektivës personale, shoqërore, sociale apo asaj të punësimit.

1.9. **NARIC - Qendra shtetërore për njohje dhe informim akademik (për Kosovë ose për ndonjë vend tjetër)**. - NARIC Kosova, ndihmon në promovimin e lëvizshmërisë së studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve, duke ofruar këshilla dhe informacione kompetente në lidhje me njohjen akademike të diplomave dhe të periudhës së studimeve, të ndërmarra në shtete të tjera. Vendimet mbi njohjen dhe barasvlerën merren nga Këshilli shtetëror për njohje në pajtim me standardet evropiane.

1.10. **Arsimi parauniversitar** - u referohet programeve formale shkollore të MASHT-it, të rregulluara përmes legjislacionit në fuqi.

1.11. **Bartës privat** - çdo institucion i themeluar qoftë për fitim ose jofitimprurës nga cilido person, grup personash apo organizatë tjetër përveç Qeverisë së Republikës së Kosovës apo të ndonjë shteti tjetër sovran. Kur një bartës privat është krijuar dhe vepron sipas parimit të joprofitabilitetit, ai mund të marrë formën e një organizate joqeveritare dhe të gëzojë të mirat dhe detyrimet përkatëse, të një OJQ-je, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1.12. **Program** - program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë.

1.13. **Bartës** - çdo institucion ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë.

1.14. **Bartës publik** - bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

1.15. **Partneriteti publiko-privat**- mund të themelohet për të ofruar shërbime të arsimit të lartë. Formimi i tij do të jetë në përputhje me parimet e barazisë së trajtimit, mosdiskriminimit, transparencës, përpjesëtimin, efektshmërisë së kostos, efijencës, mbrojtjes së interesit publik, lirisë së konkurrencës dhe të vlerës së fituar për para si dhe do të jetë në përputhje me Ligjin për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet në infrastrukturë si dhe me procedurat për dhënien e tyre (Ligji -03/L-090, qershor 2009).

1.16. **Organ akreditues i njohur** - Agjencia Kosovare e Akreditimit apo ndonjë organ i ngjashëm i tillë, i cili në Zonën evropiane të arsimit të lartë, është aktualisht i anëtarësuar në rrjetin evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë /ENQA/, ose (në Shtetet e Bashkuara), është një organ akreditues i cili është i njohur nga Këshilli i akreditimit për arsimin e lartë /CHEA/ apo nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara /USDE/ apo nga të dyja, ose (në cilindo juridiksion tjetër) është pranuar nga Ministria në baza të ndërsjella si një organ i themeluar në mënyrë të duhur shtetëror a rajonal i akreditimit, që njihet dhe është i autorizuar nga ministria relevante në kuadër të atij juridiksioni.

Neni 4

Objektivat dhe organizimi i arsimit të lartë

1. Objektivat e arsimit të lartë janë:

1.1. krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore e shkencore;

1.2. përgatitja e studentëve për studime të mëtejshme, praktikë profesionale dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, me anë të përvetësimit dhe zhvillimit të njohurive të thelluara dhe kompetencave të nivelit të lartë;

1.3. ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës që janë të aftë për të përfituar nga ky arsimim dhe për t'i kontribuar shoqërisë dhe vendit të tyre gjatë gjithë jetës së tyre.

2. Arsimi i lartë organizohet, si vijon:

2.1. niveli i parë - tre (3) deri katër (4) vite studime me të cilat studenti arrin 180, përkatësisht 240 kredi/ ECTS dhe merr diplomën Bachelor.

2.2. niveli i dytë – një (1) deri dy (2) vite studime pas mbarimit të nivelit të parë me të cilat studenti arrin 60, përkatësisht 120 kredi /ECTS dhe studenti merr diplomën Master.

2.3. niveli i tretë - programe të studimeve të doktoratës me karakter akademik dhe hulumtuesshkencor të pavarura.

2.4. çdo arsimim tjetër pas shkollës së mesme në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi (ECTS).

Neni 5

Qasja në arsimin e lartë

1. Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi.
2. Nuk do të ketë kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë.
3. Bartësi i arsimit të lartë që është i akredituar në Kosovë, sipas këshillës së NARIC Kosova, mund të pranojë një kualifikim shtetëror apo ndërkombëtar ose një diplomë shtetërore a ndërkombëtare si të barasvlershme me certifikatën e maturës, e cila përcaktohet në këtë ligj. Në rastin e paraqitjes për vlerësim të një certifikate për mbarimin e shkollimit në një shtet tjetër, njohja, përveç në raste të jashtëzakonshme, do të bëhet vetëm për certifikatën që tregon përfundimin e së paku 12 viteve të shkollimit dhe që i jep të drejtën pronarit të saj për të aplikuar në universitet apo për të hyrë në testin pranues në universitet në shtetin e huaj përkatës.
4. Një kualifikim, diplomë ose përvojë shtetërore a ndërkombëtare mund të pranohet si e barasvlershme me shkallën Baçellor, të cekur në nën-paragrafin 2.1. paragrafi 2. i nenit 4 të këtij ligji nga bartësi i arsimit të lartë, i akredituar në Kosovë sipas këshillës së NARIC Kosova. Në rastin e paraqitjes për vlerësim të një certifikate të marrë nga një institucion i arsimit të lartë, duhet të jetë i akredituar nga një organ akreditues i njohur, siç është përkufizuar në nenin 3 të këtij ligji.
5. Arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt, me korrespondencë, përmes të mësuarit në distancë dhe me kombinim të cilësdo prej këtyre mënyrave të studimit, ashtu sikurse parashihet në statutin e bartësit që jep kualifikim të arsimit të lartë.
6. Asgjë në këtë ligj ose në instrumentet plotësuese të nxjerra sipas tij, apo në dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, nuk do të kufizojnë lirinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë:
 - 6.1. për të sjellë risi në arsimin e lartë në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencat e tyre;
 - 6.2. për të ofruar kurse të çdo niveli arsimor për përvetësimin e aftësive që janë të nevojshme apo të përshtatshme për realizimin e qëllimeve të arsimit të lartë dhe për dhënien e kontributit në të mësuarit gjatë gjithë jetës.
7. Arsimi i lartë mund të ofrohet nga çdo bartës i licencuar i arsimit të lartë, pa kufizim për sa i përket kohëzgjatjes apo strukturës së vitit shkollor, me kusht që të mund t'ia dëshmojë në mënyrë të kënaqshme një organi akreditues të njohur se diplomat e tij plotësojnë standardet e pritshme për diploma të tilla brenda Zonës evropiane të arsimit të lartë.

Neni 6

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e Arsimit të Lartë

1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij dhe të atyre të nxjerra në bazë të nenit 14 të Ligjit për arsim në komunat e Republikës së Kosovës (03-L- 068, të majit 2008), Ministria është përgjegjëse për:
 - 1.1. planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë, në konsultim me Bartësit e akredituar të arsimit të lartë;
 - 1.2. rregullimin e statusit të bartësve publik dhe privatë të arsimit të lartë dhe miratimin e statuteve të tyre. Statutet e të gjitha universiteteve dhe të cilit do aplikues për titull 'universitet' duhet të ratifikohen nga Kuvendi;
 - 1.3. ndarjen e fondeve bartësve të arsimit të lartë për qëllime të mësimdhënies dhe të hulumtimit në interesin publik në kuadër të dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm për financimin

e shërbimeve publike në Kosovë dhe duke siguruar që fondet e tilla janë shpenzuar në përputhje me prioritetet e dakorduara ndërmjet Ministrisë dhe çdo bartësi nëpërmjet instrumenteve të financimit, të specifikuara në formën e aktit nënligjor;

1.4. autorizimin e formatit dhe përmbajtjes së Diplomës dhe të Shtojcës së diplomës, në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare për Akreditim, të cilat lëshohen nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë, të përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria;

1.5. dhënien e propozimeve lidhur me krijimin e një skeme ose skemave për mbështetjen financiare të studentëve dhe rregullimin e administrimit të një skeme apo skemave të tilla;

1.6. promovimin e lëvizjes së studentëve dhe të personelit brenda Zonës evropiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë si dhe inkurajimin për përdorimin e gjuhës angleze për mësim krahas gjuhëve zyrtare. Vendosjen e rregullave lidhur me njohjen akademike dhe profesionale, në përputhje me standardet evropiane, qoftë përmes NARIC Kosova brenda Ministrisë, ose përmes Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe informimi i publikut për statusin e kualifikimeve të huaja përmes ENIC Rrjetit evropian të qendrave për informim;

1.7. promovimin e mundësive të barabarta në qasjen dhe pranimin në arsimin e lartë, në zhvillimin dhe trajnimin e personelit, në mundësitë për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit të lartë.

1.8. krijimin e Këshillit shtetëror për arsimin e lartë, i cili këshillon Ministrin për çështje të arsimit të lartë,

1.9. duke caktuar termat dhe referencat e tij si dhe për emërimin e anëtarëve;

1.10. promovimin e lidhjeve midis bartësve publik të arsimit të lartë në Kosovë, bartësve privatë të arsimit dhe aftësisë, industrisë dhe tregtisë si dhe për inkurajimin e zhvillimit të ndërmarrësisë;

1.11. promovimin e lidhjeve midis të gjithë bartësve të arsimit të lartë në Kosovë dhe institucioneve të arsimit të lartë në regjion dhe më gjerë.

1.11. licencimin e bartësve të arsimit të lartë;

1.12. sigurimin e ndihmesës, në përputhje dhe këtë ligj, për bartësit e akredituar të arsimit të lartë dhe studentëve të regjistruar aty;

1.13. rregullimin e të gjitha çështjeve të tjera lidhur me arsimin e lartë, të cilat nuk janë të rregulluara veçmas në bazë të këtij ligji.

2. Në ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të saj në bazë të këtij ligji, Ministria respekton dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (Ligji nr. 03/L-047, mars 2008).

Neni 7

Agjencia e Kosovës për Akreditim

1. Agjencia e Kosovës për Akreditim AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Përmes proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ajo, të cilat i plotësojnë praktikën më të mira ndërkombëtare, AKA-ja siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë të plotësojnë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. (ENQA).

2. Në përputhje me këtë ligj dhe me instrumentet e tjera ndihmëse të nxjerra në bazë të tij, AKA-ja është përgjegjëse për:

2.1. këshillimin me Ministrinë lidhur me kërkesat e institucioneve për licencimin e kurseve apo programeve të tyre, të cilat janë pjesë e një kualifikimi apo që shpjen në fitimin e kualifikimeve të arsimit të lartë;

2.2. inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave;

2.3. kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo riakreditimin e tyre, duke përfshirë të drejtën për dhënien e titujve dhe diplomave;

2.4. kryerjen e vlerësimeve periodike të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë;

2.5. këshillimin e Ministrisë, lidhur me rezultatet e vlerësimit të cilësisë dhe implikimet e tij për financimin e bartësve publik të arsimit të lartë, lidhur me caktimin e fondeve për bartësit privatë të arsimit të lartë dhe me mbështetjen sipas gjykimit të lirë për studentët që ndjekin programe studimi tek bartësit privatë të arsimit të lartë dhe;

2.6. kryerjen, në emër të Ministrisë, të atyre funksioneve që mund të delegohen lidhur me njohjen e kualifikimeve akademike dhe profesionale e, në veçanti, për të vepruar si organ kompetent për rregullimin e kualifikimeve në arsimin e lartë në përputhje me ligjin për kualifikimet shtetërore;

2.7. ndërmarrjen e aktiviteteve të tjera që janë konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare koherente për arsim të lartë e që kanë për qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe të standardeve në arsimin e lartë në Kosovë.

3. AKA-ja shpall politikat, kriteret dhe standardet e saj për akreditim si dhe vendimet, rekomandimet dhe këshillimet për sa u përket institucioneve dhe programeve të veçanta dhe publikon një raport vjetor.

4. AKA duhet të qeveriset nga një bord i përbërë nga jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë persona, të emëruar nga Ministria për një mandat të caktuar, i cili duhet të përbëhet nga radhët e personave të të dy gjinive, që janë aktivë në punën akademike të arsimit të lartë dhe /ose në profesione brenda dhe jashtë Kosovës dhe i cili duhet të ketë të paktën tre persona ('ekspertë ndërkombëtarë'), që nuk janë të punësuar nga asnjë bartës i arsimit të lartë në Kosovë. Ky bord do të quhet Këshilli shtetëror i cilësisë i AKA-së. Anëtarët e tij ratifikohen nga Kuvendi. Vendimet apo rekomandimet lidhur me akreditimet Këshilli i merr me shumicën e votave të anëtarëve të vet. Këshilli i raporton çdo vit Ministrisë dhe Kuvendit lidhur me aktivitetet e veta të akreditimit dhe me përshtatshmërinë e infrastrukturës mbështetëse që ka në dispozicion.

5. Nëse më shumë se një e treta e anëtarëve të bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye brenda një viti, Ministria duhet ti raportojë këtë Kuvendit.

Neni 8

Bartësit publik të arsimit të lartë

1. Bartësit publik të arsimit të lartë janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë.

2. Emërtimi i çdo bartësi publik përcaktohet nga Ministria në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të kriterëve të publikuara.

3. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të tij, çdo bartës publik i arsimit të lartë ka individualitet të plotë ligjor lidhur me çështjet që trajtohen në këtë ligj, duke përfshirë të drejtën për të:

- 3.1. zotëruar dhe menaxhuar troje, godina dhe pasuri të tjera kapitale;
- 3.2. marrë dhe administruar fonde nga cilido lloj burimi i ligjshëm;
- 3.3. huazuar para brenda kufijve, në atë masë dhe në kuadër të kushteve që parashihen brenda rregulloreve financiare, të miratuara në kuadër të statutit të bartësit;
- 3.4. propozuar Ministrisë taksat, tarifat dhe gjobat për miratim;
- 3.5. emëruar dhe për të ndërprerë marrëdhënien e punës së personelit akademik dhe kuadrit tjetër si dhe për të ushtruar të gjitha detyrat një punëdhënësi, siç është paraparë me legjislacionin në fuqi;
- 3.6. bërë kontrata për mallra dhe shërbime;
- 3.7. krijuar marrëdhënie ligjore me studentët;
- 3.8. themeluar ndërmarrje komerciale për qëllime arsimore dhe hulumtuese;
- 3.9. nënshkruar marrëveshje me institucionet e tjera në Kosovë dhe me institucione ndërkombëtare.

4. Me kusht të plotësimit të kërkesave sipas ligjit në fuqi, Ministria mund t'i jep një bartësi publik të arsimit të lartë, të drejtën e shfrytëzimit të truallit, godinave apo pajisjeve që janë pronë publike dhe shoqërore.

5. Një bartës publik i arsimit të lartë, i cili shfrytëzon një truall, godinë apo pajisje që është pronë shoqërore nuk mund ta shesë atë ose t'ia tjetërsojë dikujt të drejtat pronësore të kësaj prone. Megjithatë, një bartës publik i arsimit të lartë, i cili ka marrë në shfrytëzim një truall, godinë apo pajisje që është pronë publike ose shoqërore mund ta japë me qira këtë pronë, me kusht që më parë të ketë marrë miratimin formal nga Ministria. Nëse jepet ky miratim, Ministria përcakton kushtet për shfrytëzimin e të ardhurave nga kjo pronë.

Neni 9

Krijimi, shkrirja dhe shuarja e bartësve publik

1. Bartësit publik të arsimit të lartë mund të krijohen vetëm me vendimin e Ministrisë, i cili duhet të ratifikohet nga Kuvendi.

2. Nëse Ministria konstaton se është në interesin e përgjithshëm, atëherë Ministria mund të shuaj ose mbyllë bartësit publik të arsimit të lartë dhe do t'i bëjë të njohura publikisht arsyet e vendimit të saj. Para marrjes së vendimit për shuarjen apo mbylljen e këtyre bartësve, Ministria publikon një dokument diskutimi dhe konsultohet me organin drejtues të të gjithë bartësve, tek të cilët ndikon ky vendim si dhe me AKA-në. Vendimi i Ministrisë për të mbyllur apo shuar një institucion të tillë duhet të ratifikohet nga Kuvendi.

3. Organi qeverisës i një bartësi publik të arsimit të lartë mund që vet të propozojë shkrirjen ose mbylljen e bartësit, e që duhet të miratohet nga Ministria pas konsultimit me AKA-në.

4. Themelimi i një bartësi publik të arsimit të lartë shoqërohet me dhënien e një licence në bazë të dispozitave dhe varësisht nga kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

5. Në rast se një bartës publik i arsimit të lartë mbyllet ose shkrihet, Ministria do të përcaktojë të gjitha çështjet që lidhen me pronësinë, detyrimet dhe obligimet e vazhdueshme ndaj studentëve të regjistruar në institucionet e mbyllura ose të shkriura.

Neni 10 Universitetet

1. Universiteti është institucion arsimor dhe i kërkimit shkencor, që jep diploma e grada duke përfshirë nivelin e doktoratës, me synim:

1.1. përparimin në fushën e njohurive akademike, në Kosovë, në rajon dhe më gjerë;

1.2. zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës; zhvillimin e shkathësive profesionale dhe të kompetencave të larta; dhe

1.3. nxitjen e qytetarisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

2. Në bazë të dispozitave të këtij ligji, emërtimi "Universitet", mund t'i jepet vetëm atij bartësi të akredituar të arsimit të lartë, që ka ofruar kurse apo programe të akredituara për së paku pesë vjet, në të paktën pesë fusha studimi, sikurse përcaktohet në akt nënligjor të Ministrisë dhe i cili ka nxjerrë të paktën nga një të diplomuar me doktoratë të akredituar në secilin nga këto programe studimi.

3. Në bazë të dispozitave të këtij ligji emërtimi "Kolegj universitar", mund t'i jepet bartësit të akredituar të arsimit të lartë, i cili ofron studime të doktoratës në së paku tri fusha të studimeve dhe që janë të akredituara nga AKA. AKA do të publikojë kriteret e detajuara për caktimin e një bartësi të akredituar si "Kolegj universitar", të përcaktuar me akt nënligjor nga MASHT.

4. Fjala "Universitet", si fjalë e ndarë ose në kombinim me përshkrime të tjera, nuk mund të miratohet ose të përdoret në çfarëdo forme në emërtimin e ndonjë bartësi pa lejen e Ministrisë, pas miratimit në parim nga ana e AKA-së.

Neni 11 Bartësit tjerë të arsimit të lartë

1. Ministria, në pajtim me paragrafin 1. të nenit 8 të këtij ligji, përveç universitetit mund të themelojë edhe bartës të tjerë të arsimit të lartë, të cilët mund të japin diploma, grada dhe tituj që i nënshtrohen akreditimit nga AKA-ja. Ajo mund ta bëjë këtë në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet një partneriteti publik-privat, siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji.

2. Kompanitë private, fondacionet dhe trustet mund të themelojnë institucione të arsimit të lartë. Statutet e tyre do të përcaktojnë strukturën e qeverisjes dhe të menaxhimit të institucionit, së bashku me misionin dhe qëllimet e tyre strategjike. Bartësit e tillë privatë deklarohen në dokumentet dhe statutet e tyre të themelimit nëse kanë funksion fitimprurës apo jofitimprurës por që janë në interes të përgjithshëm.

3. Të gjithë bartësit privatë duhet të jenë të licencuar nga Ministria.

4. Në marrjen e vendimit të saj për të licencuar një bartës privat, Ministria do të ndërmarrë inspektime që konsiderohen të nevojshme për të formuar një pasqyrë të qartë të bazuar në dëshmi. Ministria mund të autorizojë për inspektime të tilla agjenci të tjera me ekspertizë të veçantë, përveç AKA-në,

5. Bartësit e arsimit të lartë, përveç universiteteve, me kusht të akreditimit sipas nenit 4 të këtij ligji, fitojnë emërtime, të cilat pasqyrojnë natyrën, fushëveprimin dhe nivelin e ofertës të tyre. Sipas këshillës së AKA-së, Ministria do të nxjerrë rregullore për emërtime të tilla, të cilat mund të përfshijnë në mes të tjerash emërtime, siç janë: "kolegj universitar", "kolegj", "institut", "shkollë" ose "akademi".

6. Emërtimet “kolegj universitar”, “kolegj”, “institut”, “shkollë” ose “akademi”, veçmas apo në kombinim me përshkrime të tjera, nuk mund të përdoren në çfarëdo forme në emërtimin e ndonjë bartësi pa lejen e qartë të Ministrisë, me rekomandimin e AKA-së.

7. Nëse Ministria nuk i jep licencë një bartësi privat, bartësi nuk mund të pranojë student. Nëse bartësit, i cili paraprakisht ka qenë i licencuar i merret licenca, një bartës i tillë nuk mund të pranojë studentë të rinj, dhe i njëjti duhet të bëjë marrëveshje për të siguruar që studentët e tij aktual, nëse ka të tillë, të mund të përfundojnë me sukses programin e tyre të studimeve në ndonjë institucion tjetër të akredituar.

Neni 12

Themelimi, akreditimi dhe licencimi i bartësve privat

1. Një bartës privat i arsimit të lartë mund të themelohet nga një kompani private, fondacion apo trust, me vendqëndrim në Kosovë dhe që ka një zyrë të regjistruar në Kosovë.

2. Një bartës privat i arsimit të lartë aplikon për akreditim dhe marrje licence në bazë të dispozitave të këtij ligji.

3. Një bartës privat i arsimit të lartë mund të fillojë aktivitetin e tij vetëm pas marrjes së licencës.

4. Kusht për marrjen e licencës nga një institucion privat i arsimit të lartë është edhe paraqitja pranë Ministrisë e një plani strategjik dhe një plani biznesi, duke përfshirë një garanci nga ana e këshillit drejtues të tij apo ndonjë organi ekuivalent lidhur me qëndrueshmërinë financiare për të paktën tri (3) vjet. Rishikimi i rregullt i planit strategjik dhe planit të biznesit, duke përfshirë edhe garancinë, i paraqitet çdo vit Ministrisë.

5. Një bartës privat i arsimit të lartë mund të mbyllet nga ana e këshillit drejtues të tij apo ndonjë organi ekuivalent vetëm në fund të vitit akademik. Licenca e një institucioni privat duhet të përfshijë një dispozitë për një garanci financiare për të mbrojtur interesat financiare të studentëve në mënyrë që ata të vazhdojnë studimet në një institucion tjetër të akredituar në rast të mbylljes së institucionit për t'u mundësuar studentëve përfundimin e provimeve.

6. Një bartës privat i arsimit të lartë nuk mund ta shpallë veten si “i akredituar”, nëse nuk është akredituar në Kosovë sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe me instrumente të tjera, të nxjerra në bazë të tij. Nëse është akredituar për programe nga një shtet a organizatë tjetër, bartësi privat duhet të dëshmojë dhe deklarojë hapur origjinën e një akreditimi të tillë dhe se i njëjti duhet të miratohet edhe nga AKA si akreditim në Kosovë.

7. Një bartës privat i arsimit të lartë gëzon lirinë që në statutin e tij apo në dokumente të tjera themeluese të aprovojë çfarëdo modeli të qeverisjes dhe të menaxhimit, me kusht që ky model të ndajë në mënyrë të qartë rolin dhe kompetencat e pronarëve nga vendimet për çështjet akademike si dhe të lejojë pjesëmarrjen e personelit mësimdhënës dhe të studentëve në vendimmarrje lidhur me çështjet akademike.

Neni 13

Autonomia e bartësve të arsimit të lartë

1. Bartësit e licencuar të arsimit të lartë kanë autonominë dhe lirinë akademike.

2. Bartësit e licencuar të arsimit të lartë gëzojnë të drejtat nga dispozitat e këtij ligji për të:

2.1. zgjedhur autoritetet drejtuese menaxhuese dhe për të përcaktuar mandatet e tyre;

- 2.2. organizuar strukturat dhe aktivitetet përmes rregullave të tyre, të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë ligj dhe me dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të tij, me ligjet e tjera të zbatueshme dhe me statutet e tyre;
 - 2.3. zgjedhur mësimdhënësit dhe personelin tjetër, për të përcaktuar kushte lidhur me pranimin e studentëve, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve, të miratuara nga AKA-ja;
 - 2.4. hartuar dhe zbatuar në mënyrë të pavarur kurrikulet dhe projektet për kërkime shkencore, në këshillim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë; dhe,
 - 2.5. dhënë tituj profesorëve dhe personelit tjetër, në pajtueshmëri me këtë ligj, me ligjin në fuqi për punësim si dhe skemën e aprovuar nga AKA-ja. Këto kritere përcaktohen në statutin e bartësit.
3. Statutet e bartësve të arsimit të lartë përfshijnë dispozita që garantojnë lirinë akademike të personelit mësimdhënës dhe të studentëve, siç përshkruhet tutje në këtë ligj.
 4. Mjediset e bartësve të licencuar të arsimit të lartë gëzojnë paprekshmërinë nga organet e rendit publik, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligje të veçanta.
 5. Bartësi publik i arsimit të lartë lirohet nga të gjitha format e tatimeve për veprimtaritë e tij mësimore dhe kërkimore shkencore, të cilat financohen nga burime publike apo të dhuruara, përveç rasteve që lidhen me veprimtari fitimprurëse.

Neni 14

Licencimi i bartësve të arsimit të lartë

1. Çdo bartës i arsimit të lartë në Kosovë duhet të ketë një licencë për të kryer punën e tij. Licenca lëshohet nga Ministria sipas dispozitave të këtij ligji dhe dokumenteve plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij. Licencat do të kenë kohëzgjatje të kufizuar, jo më gjatë se pesë (5) vite, varësisht nga kohëzgjatja e akreditimit të tyre nga AKA. Licencat janë të ripërtërishe.
2. Kriteret për dhënien e licencës një bartësi të arsimit të lartë përcaktohen me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.
3. Licenca i jepet çdo bartësi që i plotëson kriteret.
4. Kriteret e licencimit përveç akreditimit nga AKA, si parakusht kryesor, përfshijnë dispozita lidhur me:
 - 4.1. përshtatshmërinë e mjediseve dhe Pajisjeve;
 - 4.2. realizueshmërinë financiare, duke përfshirë përkushtimin e bartësit për krijimin e një fondi për përkrahje të studentëve;
 - 4.3. një plan biznesi trevjeçar.
5. Kërkesa të tjera shtesë për licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë përshkruhen më poshtë në këtë ligj dhe në dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij. Si minimum, këto kërkesa shtesë do të përfshijnë si në vijim:
 - 5.1. statutin i cili siguron ndarjen e pronësisë nga udhëheqja akademike e institucionit.
 - 5.2. objektet dhe burimet e tjera fizike të cilat janë të përshtatshme për punën arsimore të bartësit, të sigurta dhe të përshtatshme për qëllimin dhe për të cilat bartësi e ka titullin e plotë ligjor;

- 5.3. mësimdhënësit, hulumtuesit shkencorë dhe personelin ndihmës, të kualifikuar në një nivel të përshtatshëm për punën arsimore të bartësit dhe të cilët në mënyrë ligjore janë të kontraktuar prej bartësit;
- 5.4. sisteme financiare të audituara;
- 5.5. akreditimin në nivel institucional si dhe në atë të programeve nga ana e AKA ose ndonjë organi tjetër i njohur për akreditim, dhe i miratuar nga AKA;
- 5.6. pagesën e garancisë financiare, bazuar në numrin e përgjithshëm të studentëve;
- 5.7. shuma e garantuar për studentë dhe çfarëdo ndryshimi në aplikimin e saj do të saktësohet me udhëzim administrativ, të nxjerrë nga Ministria;
- 5.8. marrëveshje me të paktën dy bartës të tjerë të akredituar që sigurojnë se studentët mund të transferohen në programe të ngjashme tek njëri nga këta bartës të akredituar, në rast të falimentimit apo tërheqjes së akreditimit. AKA-ja duhet të jep pëlqimin për marrëveshjet e arritura.
6. Bartësi publik konsiderohet i licencuar, përveç nëse ai dështon në plotësimin e standardeve të AKA-së për akreditimin institucional. Licenca e tij do të mundësojë që ai të ofrojë vetëm ato programe, për të cilat është i akredituar nga AKA-ja, apo nga ndonjë agjenci e njohur për akreditim, me miratim të AKA.
7. Bartësi i arsimit të lartë, mund të aplikojë në çdo kohë pranë Ministrisë për ndryshimin e kushteve në licencën e tij.
8. Ministria në çdo kohë mund t'ia revokojë licencën bartësit nëse ka prova se nuk i ka plotësuar kërkesat për standardet e licencimit. Në rast se vjen deri te një revokim i tillë, bartësi gëzon të drejtën që të parashtrijë ankesë pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe atë vetëm për shkak të mangësive procedurale.

Neni 15

Akreditimi dhe vlerësimi i cilësisë

1. Të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga AKA-ja në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore:
2. Një bartës i arsimit të lartë që kërkon akreditim për herë të parë, bën një kërkesë pranë AKA-së të paktën një vit përpara datës së parashikuar për marrjen e akreditimit. Kur një bartës i ri i arsimit të lartë publik është themeluar dhe licencuar në bazë të dispozitave të këtij ligji, kjo kërkesë për akreditim nuk do të zbatohet. Megjithatë, një bartës i tillë duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe duhet të bëjë kërkesë për akreditim pranë AKA-së brenda dymbëdhjetë muajve nga data e licencës së tij të parë.
3. Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Ky rishikim nga ana e ekspertëve do të përfshijë një inspektim të drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve. Riakreditimin e një institucioni apo të një ose më shumë programeve të tij mund ta kërkojnë bordi i AKA-së ose Ministria brenda një periudhe më të shkurtër se pesë vjet.
4. Çdo bartës, varësisht nga përputhja me kërkesat e licencimit, duhet të kërkojë akreditim institucional çdo pesë vjet. Njësitë akademike dhe programet e tij do t'i nënshtrohen vlerësimit të rregullt të cilësisë.
5. Certifikatat e akreditimit lëshohen nga AKA-ja.

6. Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë nuk arrin të fitojë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me një organizim tjetër të akreditimit jo më vonë se pas një viti.

7. Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës, bartësi mund të ankohet në organin kompetent konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ.

8. Vlerësimi i cilësisë së programeve të bartësve të akredituar të arsimit të lartë kryhet nga AKA-ja për çdo program brenda ciklit kohor që nuk zgjat më shumë se 5 vjet. AKA-ja cakton grupe ekspertësh ndërkombëtar të fushave përkatëse. AKA publikon në faqen elektronike të saj procedurat, kriteret dhe rezultatet e vlerësimeve të cilësisë.

Neni 16

Gradat dhe diplomat

1. Një bartës i akredituar i arsimit të lartë do të ketë të drejtën për të dhënë grada e diploma të specifikuara në certifikatën e akreditimit. Këto mund të përfshijnë grada dhe diploma të ofruara së bashku ose si kualifikime të dyfishta me një ose më shumë institucione të tjera të miratuara nga AKA-ja. Dokumentet e gradave dhe të diplomave do të jenë në pajtim me formatin e aprovuar nga Ministria, të specifikuara përmes udhëzimeve administrative.

2. Statuti i një bartësi të arsimit të lartë në përputhje me këtë ligj, specifikon gradat dhe diplomat që jepen nga bartësi dhe përfshin të drejtën për të hartuar rregulla akademike apo rregulla të tjera lidhur me dhënien e gradave e të diplomave të tilla e që i nënshtrohen akreditimit nga AKA-ja apo nga ndonjë organ i njohur akreditues me miratimin e AKA.

3. Programet e nivelit Baçelor dhe të atyre për diplomë, të ofruara nga të gjithë bartësit e arsimit të lartë, hartohen në mënyrë fleksibile me mundësi regjistrimi dhe transferimi në momente të përshtatshme dhe me dhënien e kredive ose kualifikimeve në varësi të përparimit të studentit. Në formulimin e rregullave, bartësi publik i arsimit të lartë merr parasysh konventat aktuale të Sistemit evropian të transferimit të kredive.

4. Ministria, duke u nisur nga interesi i përgjithshëm, gëzon të drejtën të miratojë ose të refuzojë miratimin e kurrikulave të kurseve që çojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t'u punësuar në një shkollë.

5. Vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t'u punësuar në një shkollë.

6. Në të gjitha rastet e tjera, një bartës i arsimit të lartë gëzon liri në organizimin e kurrikulave të tij dhe të skemave të vlerësimit e të provimit mbi bazën e rregullave, që janë transparente, të ndershme dhe lehtë të kuptueshme për studentët. Bartësi do të kërkojë sigurimin e standardeve dhe të cilësisë për realizimin e kurrikulit përmes shqyrtimit të jashtëm të skemave të vlerësimit dhe të provimeve të tij si dhe do të kërkojë në mënyrë aktive mendimin e studentëve mbi përvojën e tyre të të mësuarit.

7. Vetëm ato grada dhe diploma që lëshohen nga bartësit e akredituar dhe të licencuar të arsimit të lartë njihen nga Qeveria për arsye punësimi, për marrjen e funksioneve publike ose për kryerjen e funksionit të njohjes ndërkombëtare, siç saktësohet në nën-paragrafin 1.7. të paragrafit 1. Dhe paragrafin 2. të nenit 6 të këtij ligji.

8. Është detyrë e çdo bartësi të akredituar të arsimit të lartë që të pajisë çdo person, i cili ka marrë një gradë apo diplomë, me një diplomë dhe me një shtojcë të diplomës të vulosur; të dyja këto duhet të kenë formatin e përcaktuar në akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria.

9. Pas dhënies së një grade apo diplome, të njëjtat mund të anulohen vetëm në rrethana specifike të përcaktuara në rregullat e hartuara mbi bazën e statutit të bartësit të arsimit të lartë dhe me kusht të së drejtës në padi në Gjykatën kompetente.

10. Në konsultim me organet e tjera relevante qeveritare, Ministria mund të përcaktojë në një udhëzim administrativ kërkesa shtesë arsimore, përveç gradës apo diplomës, si kusht për t'u punësuar në ndonjë profesion, i cili trajtohet nga ligje të tjera apo në bazë të kushteve të përcaktuara në konventa a marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 17

Statuti i bartësve të arsimit të lartë

1. Funksionimi dhe menaxhimi i bartësit publik të arsimit të lartë përcaktohet në statut të propozuar nga ana e Ministrisë dhe të miratuar nga Kuvendi. Ky statut mund të ndryshohet në përputhje me dispozitat e tij dhe me pëlqimin e Ministrisë dhe miratimin nga ana e Kuvendit.

2. Statutet e të gjithë bartësve të tjerë dhe çdo ndryshim në to miratohen vetëm nga Ministria.

3. Statuti i çdo universiteti përmban dispozita që i japin Senatit apo një strukture të barasvlershme përgjegjësi kryesore për këshillim dhe vendimmarrje lidhur me çështje akademike, ku ndër anëtarët e këtij organi janë edhe përfaqësues të zgjedhur të stafit akademik dhe studentë.

4. Statuti i çdo bartësi publik të arsimit të lartë, garanton zhvillimin e konsultimeve për çështje akademike me personelin mësimor dhe me studentët.

5. Statuti i çdo bartësi të arsimit të lartë që merr fonde publike siguron zbatimin e parimeve të mëposhtme nga bartësi:

5.1. mundësi të barabarta për punësim dhe qasje të barabartë në studim e kërkim shkencor pa diskriminim.

5.2. të gjithë personat dhe organet veprojnë në përputhje me standardet më të larta të modestisë, integritetit, të sinqeritetit, të objektivitetit, të llogaridhënies, të transparencës, të ndershmërisë dhe të udhëheqjes. Në kryerjen e detyrave zyrtare, askush nuk mund të veprojë si përfaqësues i asnjë lloj grupi të çfarëdo përshkrimi dhe nuk kërkon apo pranon asnjë lloj mandati. Gjatë tërë kohës të gjithë duhet të veprojnë vetëm në interes të bartësit si i tërë.

6. Statuti që i paraqitet Ministrisë në bazë të dispozitave të këtij ligji, miratohet nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Refuzimi i Ministrisë për të dhënë pëlqimin në statut apo për të konfirmuar modifikime në të mund të kundërshtohet pranë Gjykatës kompetente.

Neni 18

Struktura qeverisëse e bartësve të arsimit të lartë

1. Këshilli Drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i bartësit të arsimit të lartë që merr fonde publike. Këshilli drejtues ka përgjegjësi të përgjithshme në ushtrimin e veprimtarisë së bartësit dhe funksionet e tij përshkruhen hollësisht në statut.

2. Këshilli drejtues do të ketë jo më shumë se nëntë dhe jo më pak se pesë anëtarë. Numri i anëtarëve të këshillit drejtues që emërohen nga Ministria në interes të përgjithshëm, duhet të jetë i specifikuar në statut dhe nuk duhet të kalojë gjysmën e numrit të përgjithshëm të anëtarësisë. Ata duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste si dhe me aftësi të tjera praktike. Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet.

3. Të gjithë anëtarët e këshillit drejtues, me përjashtim të atyre të emëruar sipas paragrafit 2. të këtij neni zgjidhen sipas procedurës së përcaktuar në statutin e bartësit. Një numër i anëtarëve të zgjedhur nga Universiteti mund të jenë nga komuniteti akademik ndërkombëtar. Statuti do të specifikojë sa anëtarë do të zgjidhen prej atyre që janë brenda institucionit dhe sa prej komunitetit akademik ndërkombëtar.

4. Të gjithë anëtarët e këshillit drejtues shërbejnë në cilësi individuale në këshill, e jo si delegatë ose përfaqësues të një interesi të veçantë grupor.

5. Këshilli drejtues për çdo vit zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin prej anëtarëve të vet, të cilët nuk janë punonjës apo studentë të institucionit.

6. Anëtarët e këshillit drejtues, të emëruar në bazë të paragrafit 2. të këtij neni i mbajnë postet e tyre për një periudhë kohe të caktuar, sikurse parashihet në dispozitat e statudit. Ata mund të shkarkohen nga Ministria me rekomandim të këshillit drejtues apo edhe pa të, për arsye bindëse si:

7. Dënim për një vepër të rëndë penale që ndëshkohet me burgim prej më shumë se gjashtë muajsh;

7.1. paaftësi në kryerjen e funksioneve të postit të tij për shkak të paaftësisë fizike apo mendore, të dokumentuar me një raport nga një konsilium i mjekëve të pavarur, i caktuar sipas legjislacionit në fuqi.

7.2. sjellje, e cila sipas vlerësimit të Ministrisë, paraqet dështim, refuzim, shpërfillje, paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit që ushtron, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara në statutin e bartësit apo në këtë ligj, duke përfshirë ato të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji.

8. Ankesa kundër shkarkimit të bërë me iniciativë të Këshillit drejtues mund t'i drejtohet Ministrisë.

9. Mandati i KD përcaktohet në Statutin e bartësit dhe siguron që kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve nuk mund të jetë e njëjtë me autoritetet menaxhuese dhe senatit.

10. Këshilli drejtues është përgjegjës për të zhvilluar një plan strategjik trevjeçar, i cili do të aktualizohet çdo vit. Në përgatitjen e planit strategjik dhe të aktualizimeve vjetore të tij, Këshilli drejtues do të konsultohet me Ministrinë përkitazi me përputhjen e objektivave dhe planeve të veta me Strategjinë shtetërore për arsimin e lartë dhe të burimeve që do të kishte të ngjarë të jenë në dispozicion nga Ministria. Fushëveprimi i konsultimeve të tilla përcaktohet me akt nënligjor që e nxjerr Ministria.

11. Këshilli drejtues merr masa për publikimin e raportit vjetor mbi punën e bartësit dhe jep informacione të cilat kërkohen nga Ministria dhe AKA-ja.

Neni 19

Autoritetet menaxhuese

1. Autoriteti kryesor menaxherial i një universiteti publik është rektori. Rektori i universitetit publik zgjidhet nga Këshilli drejtues me shumicën absolute të numrit të përgjithshëm të votave, pas një procesi formal të konkursit publik, pas vlerësimit nga një komision profesional dhe pas intervistimit nga i tërë Këshilli drejtues të Universitetit.

2. Autoriteti kryesor menaxhues i një bartësi të arsimit të lartë, me përjashtim të universitetit, përcaktohet në statutin e bartësit.

3. Procedurat për zgjedhjen dhe emërimin e autoritetit kryesor menaxhues, përgjegjësitë, detyrat, mandati i tij si dhe çështje të tjera përcaktohen në statutin e bartësit.

4. Statuti i bartësit gjithashtu duhet të saktësojë përgjegjësitë për secilin nga zyrtarët menaxhues.

Neni 20

Parimet kryesore të financimit të bartësve të arsimit të lartë

1. Bartësit publik të licencuar dhe të akredituar të arsimit të lartë mund të financohen nga burimet e mëposhtme, sipas dispozitave të përcaktuara në statutet dhe planet strategjike të tyre si:

- 1.1. fonde nga Ministria për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm;
- 1.2. pagesa për shkollim dhe pagesa tjera që bëjnë studentët;
- 1.3. pagesa për shërbime komerciale dhe shërbime të tjera;
- 1.4. donacione, dhurata, ndihmesa tjera dhe
- 1.5. kontrata me organizma shtetërorë, ndërkombëtarë, publik ose privatë në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të këshillimit.

2. Bartësit e arsimit të lartë gëzojnë të drejtën të lidhin kontrata për çfarëdo qëllimi që lidhet me arsimin e lartë dhe, në rastet kur kjo është pjesë e planit strategjik të tyre, edhe në lidhje me kërkime shkencore. Bartësit mund t'i investojnë fondet, duke përfshirë ato publike, në cilëndo ndërmarrje me qëllime të arsimit apo të kërkimit shkencor me kusht që:

- 2.1. ato kontrata të ndërlidhen me projekte që përkrahin planin strategjik të bartësit;
- 2.2. asnjë kontratë të mos imponojë ndonjë detyrim financiar ndaj pasurisë dhe pronës publike pa miratimin e Ministrisë dhe
- 2.3. fondet publike të mos futen në rreziqe të mundshme.

3. Nëse një bartës i arsimit të lartë nuk e fiton riakreditimin në përputhje me këtë ligj, atëherë Ministria, me akt nënligjor, mund të marrë masa të përkohshme për financimin e tij dhe marrjen e pagesave të shkollimit dhe të të ardhurave të tjera gjatë periudhës deri në rimarrjen e akreditimit, mbyllet apo shkrirjen, sikurse parashihet me ligj.

4. Ministria mund të sigurojë fonde publike për bartësit privatë të arsimit të lartë të licencuar dhe të akredituar në mbështetje të objektivave të Ministrisë. Çdo bartës privat i cili pranon fondet publike, i nënshtrohet përgjegjësisë dhe kërkesave të auditimit njëjtë si edhe bartësit publik, siç është përcaktuar në nenet 21,22,23,24 të këtij ligji.

Neni 21

Metodologjia e financimit

1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministria me akt nënligjor përcakton metodologjinë që do të përdoret për caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes publik, së bashku me shtesa të tjera ose koncesione, të cilat mund të miratohen nga Qeveria. Fondet mund të caktohen për qëllime të mësimdhënies, të punës kërkimore në lidhje me mësimdhënien, për infrastrukturë ose për qëllime të tjera.

2. Caktimi i fondeve për mësimdhënie e specifikon numrin e studentëve që do të arsimohen me shpenzimet publike në disiplina e fusha të caktuara studimi. Ky numër duhet të jetë në përputhje me numrin maksimal të saktësuar në licencën aktuale të bartësit. Përshkrimi i bashkangjitur për secilën disiplinë apo fushë përcaktohet nëpërmjet një akti nënligjor.

3. Ministria cakton fondet e bartësve të arsimit të lartë duke marrë parasysh objektivat e specifikuar në planin strategjik të bartësit dhe çfarëdo vërejtjesh apo rekomandimesh nga AKA-ja lidhur me cilësinë e mësimdhënies të këtyre bartësve ose të programeve të veçanta.

4. Ministria, bazuar në performancën e fundit të bartësit dhe do të caktojë një vijë buxhetore për një cikël të financimit pesë (5) vjeçar. Caktimi i fondeve për një bartës duhet të marrë formën e një marrëveshjeje të performancës, që do të zgjasë tri vjet dhe që do të publikohet nga Ministria pasi të jetë dakorduar me bartësin përkatës.

5. Fondet caktohen çdo vit si një shumë që i jepet bartësit gjatë vitit financiar në intervale kohe të përcaktuara nga Ministria e Financave. Brenda planit strategjik dhe kufijve të caktuar në licencë dhe sipas çfarëdo kushtesh të Ministrisë që kanë të bëjnë me fondet.

6. Këshilli drejtues miraton skemën financiare të delegimit dhe llogaridhënies me nënnjësitë buxhetore brenda institucionit përmes të cilës pasqyrohet planifikimi strategjik dhe detyrat mbi raportimin e performancës që ajo i detyrohet Ministrisë. Skema e tillë do të inkurajojë dhe lehtësojë zhvillimin e kapaciteteve, ngritjen e cilësisë dhe arritjen e rezultateve të dakorduara brenda çdo nënnjësie buxhetore. Këshilli drejtues nxjerr rregullore financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto marrëveshje do të përfshihen në statutin e bartësit.

Neni 22 **Kushtet e financimit**

1. Në caktimin e fondeve për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm, Ministria mund t'u caktojë kushte bartësve.

2. Kushtet që caktohen sipas këtij neni janë në përputhje me statutin e bartësit në fjalë dhe kanë të bëjnë me:

2.1. kontrollin financiar dhe auditimin;

2.2. blerjen, shfrytëzimin dhe disponimin me truall, godina dhe pajisje;

2.3. nivelin dhe aplikimin e pagesave për shkollim dhe të pagesave të tjera të studentëve;

2.4. ndryshimin e destinimit ose transferimin e fondeve të caktuara për mësimdhënie nga një fushë mësimore në tjetrën.

3. Ministria nuk cakton asnjë kusht që do të mund të ndikonte në kufizimin e mundësisë së bartësit për të vepruar, në përputhje me statutin e tij, për të tërhequr fonde nga burime të tjera, përfshirë këtu caktimin e vendeve shtesë të studimit brenda kufijve të licencës, me kusht që, sipas mendimit të Ministrisë, kjo nuk ka:

3.1. efekt negativ në cilësinë e arsimit me fonde publike.

3.2. nuk paragjykon detyrën e bartësit për të ushtruar veprimtarinë e tij pa asnjë lloj diskriminimi për arsye që kanë lidhje me gjininë, racën, prirjen seksuale, aftësinë e kufizuar, gjendjen martesore, ngjyrën, gjuhën, fenë, opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti etnik, pronësinë, lindjen apo që lidhen me gjendje të tjera.

4. Ministria nuk mund të caktojë kushte që kufizojnë lirinë mësimdhënies në kuadër të këtij ligji, licencës dhe akreditimit të bartësit.

5. Fondet që mbeten pa u shpenzuar në fund të vitit financiar caktohen për të kaluar në fondin rezervë për veprimtari të miratuara që janë specifikuar në planin strategjik të bartësit apo në përditësimet vjetore të tij.

6. Në varësi të dispozitave të këtij neni, Ministria mund të anulojë fonde, për të cilat ajo mendon se janë keqpërdorur dhe në këtë rast fondet i kthehen Ministrisë së Financave me kërkesën e kësaj të fundit.

Neni 23

Përgjegjësitë e Këshillit drejtues dhe autoritetit kryesor menaxhues të një bartësi të arsimit të lartë

1. Këshilli drejtues i një bartësi publik të arsimit të lartë apo organi i barasvlershëm në rastin e bartësit privat është përgjegjës kolektivisht para Ministrisë për përdorimin e duhur dhe të efektshëm të fondeve që i janë caktuar bartësit nga Ministria ose nga burime të tjera publike.

2. Çdo bartës i arsimit të lartë që merr fonde publike i raporton drejtpërdrejt Ministrisë për performancën e tij, jo më vonë se më 31 mars të vitit të ardhshëm. Raporti i performancës do të krahasojë rezultatet e arritura me planin strategjik dhe marrëveshjet për performancë për vitin në shqyrtim. Raporti do të përfshijë masat për performancën të cilat janë specifikuar nga Ministria me akt nënligjor dhe do të shoqërohet nga llogaritë e audituara të bartësit për vitin në shqyrtim. Ministria do t'i ofrojë Kuvendit një përmbledhje të raporteve për performancën shoqëruar nga një koment më së voni deri më 31 gusht të të njëjtit vit.

3. Autoriteti kryesor menaxhues i një bartësi të arsimit të lartë që merr fonde publike do t'ia tërheqë vërejtjen Këshillit drejtues për çdo veprim apo lëshim të tij, i cili, sipas mendimit të autoritetit kryesor menaxhues, përbën një shpërdorim të fondeve publike që i janë dhënë bartësit. Në rast se Këshilli drejtues nuk vepron për të korrigjuar një veprim të tillë jo të duhur apo lëshim, atëherë autoriteti kryesor menaxhues do t'ia raportojë drejtpërdrejt këtë veprim ose lëshim Ministrisë. Në raste të tilla, pavarësisht nga ndonjë dispozitë e statutit të bartësit që është e kundërt me këtë, Këshilli drejtues apo ndonjë organ tjetër i barasvlershëm nuk mund të të ndërmarrë asnjë veprim ndaj autoritetit kryesor menaxhues, me përjashtim të rasteve kur vetë Ministria e lejon një gjë të tillë.

4. Nëse, sipas vlerësimit të Ministrisë që bazohet në raportet përfundimtare dhe rekomandimet nga zyra e Auditorit të përgjithshëm, çështjet financiare apo çështjet e tjera të një bartësi kanë qenë ose janë duke u keqadministruar apo dispozitat e statutit nuk janë zbatuar në pajtim me këtë ligj dhe me statutin, Ministria mund që përveç kompetencave të akorduara nga paragrafi 6. i nenit 22 të këtij ligji, pas konsultimit me AKA-në dhe me bartësin, të jep udhëzime në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e bartësit që Ministria i sheh të arsyeshme, duke përfshirë, largimin dhe zëvendësimin e përkohshëm të një ose më shumë anëtarëve të Këshillit drejtues ose rektorit. Të gjitha veprimet e tilla ratifikohen nga Kuvendi brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh.

5. Vendimi kundër shkarkimit të anëtarë të KD apo rektorit apo ekuivalentit të tij mund të atakohet në Gjykatën Kompetente.

Neni 24

Kontrolli financiar

1. Statuti i çdo bartësi publik të arsimit të lartë përfshin dispozita për kryerjen e një kontrolli financiar të efektshëm dhe të pavarur, të brendshëm e të jashtëm.

2. Një kopje e çdo raporti të hartuar nga auditori i jashtëm apo i brendshëm ose çdo bartësi që merr fonde publike i dërgohet Ministrisë, e cila mund të kërkojë shpjegime nga këshilli drejtues i bartësit publik të arsimit të lartë, nëse e gjykon të nevojshme një gjë të tillë.

3. Ministria mund të caktojë një auditor të pavarur për të hetuar çështjet financiare të çdo institucioni publik të arsimit të lartë që merr fonde publike dhe këshilli drejtues i këtij institucioni duhet të sigurojë bashkëpunimin me auditorin.

4. Në rastet kur Ministria është e mendimit se ka shpërdorime serioze të fondeve publike, atëherë zbatohet paragrafi 6. i nenit 22 të këtij ligji.

Neni 25 **Veprimtaria komerciale**

1. Bartësi publik i arsimit të lartë gëzon të drejtën që, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të ligjit tjetër të zbatueshëm, me licencën, me statutin dhe me planin strategjik të tij, të marrë masa për të nxitur e shfrytëzuar veprimtarinë e tij arsimore dhe veprimtarinë kërkimore për qëllime komerciale në favor të bartësit.

2. Kur veprimtari të tilla komerciale përfshijnë ose potencialisht mund të përfshijnë shfrytëzimin e ndonjë të drejte të rëndësishme të pronës intelektuale lidhur me vepra letrare, artistike dhe shkencore, zbulime shkencore, projekte, shpikje, materiale, mallra ose shërbime të siguruara plotësisht apo pjesërisht duke përdorur fonde publike, bartësi duhet të kërkojë miratim paraprak nga Ministria. Për qëllimet e këtij neni, Ministria përcakton se cila është e drejta e rëndësishme e një prone intelektuale me anë të një udhëzimi administrativ, ku merret parasysh këshilla e dhënë nga Zyra për te drejtat e pronës intelektuale ose nga ministria kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

3. Tatimimi i aktivitetit komercial të një bartësi të arsimit të lartë publik është në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 26 **Titujt dhe gradat e personelit**

1. Titujt dhe gradat e personelit, kriteret e emërimeve dhe riemërimeve dhe çështje të tjera të lidhura me këto, specifikohen në statutin e çdo bartësi të arsimit të lartë. Ato duhet të jenë të hapura ndaj shqyrtimit nga AKA-ja dhe të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi për marrëdhënien e punës në Republikën e Kosovës.

2. Universitetet dhe kolegjet universitare për stafin akademik mund të caktojnë titujt si në vijim:

- 2.1. profesor i rregullt;
- 2.2. profesor i asociuar;
- 2.3. profesor asistent;
- 2.4. asistent universiteti.

3. Kriteret për secilin titull do të përfshijnë të paktën një diplomë Master në fushën e lëndës së të emëruarit. Përveç kësaj, profesorët e rregullt, profesorët e asociuar dhe profesorët asistentë duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike, që do të vlerësohet nga së paku tre recensues që kanë së paku një titull më të lartë se thirrja aktuale e kandidatit për avancim.

4. Profesorët e rregullt, profesorët e asociuar dhe profesorët asistentë duhet të kenë të përfunduara doktoratë dhe të kenë një sfond të suksesshëm të publikimit në revista me recension ndërkombëtar. Profesorët e rregulltë gjithashtu duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë udhëheqje të suksesshme akademike përmes hartimit të kurrikulit, risive pedagogjike, hulumtimit dhe publikimit së paku për tetë (8) vjet.

5. Bartësit e tjerë për stafin e tyre mund të caktojnë gradat si në vijim:

5.1. profesor;

5.2. profesor asistent;

5.3. ligjërues;

5.4. asistent.

6. Kriteret për të gjithë titujt, përveç atyre asistent dhe ligjërues, përfshijnë të paktën një diplomë Master ose ekuivalente në fushën e lëndës së të emëruarit. Përveç kësaj, profesor asistentët dhe profesorët e asociuar, duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të suksesshme të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike tjetër që do të vlerësohet nga së paku tre recensues që kanë së paku një titull më të lartë se thirrja aktuale e kandidatit për avancim.

7. Profesorët asistentë dhe profesorët e asociuar duhet të kenë të përfunduar doktoratë dhe të kenë një sfond të suksesshëm të publikimit në revista me recension ndërkombëtar.

8. Në qoftë se një person që mban një titull nga një universitet i akredituar ose nga një kolegji universitar i bashkëngjitet stafit të një bartësi që nuk është universitet apo, kolegji universitar ai mund të vazhdojë të mbajë titullin e dhënë më parë. Në qoftë se një person që mban një titull nga një kolegji universitar ose kolegji i akredituar i bashkohet stafit të universitetit, prej tij do kërkohet për të aplikuar për marrjen e një titulli nga universiteti.

9. Profesori i rregullt i pensionuar nga një post me orar të plotë, mund të caktohet si Profesor Emeritus dhe mund të thirret për të mbështetur institucionin, në të cilin ai mban këtë titull, në cilëndo mënyrë që konsiderohet e përshtatshme nga rektori.

10. Kriteret për secilin nga titujt nuk duhet të dekurajojnë aplikimet nga jashtë institucionit.

11. Përjashtim nga kriteret e caktuara në paragrafët 3. dhe 4. bëjnë titujt që jepen në fushën specifike që përcaktohen në Statutin e bartësit.

12. Çdo bartës i arsimit të lartë mund të emërojë stafin e posaçëm për mësimdhënie, poste administrative ose teknike, kërkime. Bartësi në statutin e tij do të specifikojë titujt e personelit të posaçëm kërkimor, mësimor, të personelit të lartë administrativ dhe të atij teknik, së bashku me kriteret për zhvillimin profesional, promovimin dhe avancimin brenda këtyre fushave të punës.

Neni 27 **Liria akademike**

1. Në statutin e vet apo në dokumentin e barasvlershëm themelues, çdo bartës i arsimit të lartë garanton se stafi akademik gëzon të drejtën brenda ligjit e për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të punës apo privilegjet që mund të gëzojnë nga bartësi.

2. E drejta e shprehjes së lirë për stafin akademik të bartësve të arsimit të lartë mund të kufizohet vetëm me ligj, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3. Personeli akademik i bartësve të licencuar dhe të akredituar gëzon lirinë për të publikuar rezultatet e kërkimeve të tij, por duke iu nënshtruar rregullave të bartësit lidhur me shfrytëzimin e të drejtave të pronës intelektuale në dobi të bartësit dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Statuti i çdo bartësi të arsimit të lartë dhe struktura e çdo bartësi privat të arsimit të lartë, si kusht për akreditim, duhet të përmbajnë dispozita që:

4.1. i garantojnë personelit lirinë e organizimit e të grumbullimit.

4.2. mbrojnë personelin nga çdo lloj diskriminimi.

5. Personeli akademik dhe personeli tjetër i bartësit të arsimit të lartë gëzon të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo veprim të institucionit të arsimit të lartë dhe për t'ia drejtuar atë ankesë fillimisht Ministrisë dhe pastaj një gjykatë kompetente.

Neni 28

Kushtet e shërbimit të personelit

1. Statuti i një institucioni publik të arsimit të lartë përmban dispozita lidhur me emërimet, mandatet, ngritjen në pozitë, disiplinën, suspendimin, shkarkimin, pushimin nga puna apo pensionimin.

2. Kushtet themelore të shërbimit të personelit në bartësit e arsimit të lartë duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Kushte të tjera të shërbimit të personelit te bartësit publik të arsimit të lartë, përcaktohen nga këshilli drejtues i bartësit, i cili krijon kuadrin e përshtatshëm për konsultime me sindikatat e njohura zyrtarisht me përfaqësuesit e personelit dhe me Ministrinë.

4. Çdo anëtar i personelit punësohet mbi bazën e kontratës individuale me bartësin e arsimit të lartë. Kontratat e tilla do të përfshijnë aranzhimet për vlerësim të rregullt të performancës së stafit duke përfshirë vëzhgimin e drejtpërdrejtë të mësimin dhe një proces të strukturuar për mbështetjen e zhvillimit profesional të tij.

5. Statuti i një bartësi publik të arsimit të lartë rregullon pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtar në komisione recenzuese në procesin e përzgjedhjes së personelit akademik me status të profesorit.

6. Statuti i bartësit të arsimit të lartë përfshin dispozita, të cilat përcaktojnë rrethanat, mbi bazën e të cilave një anëtar i personelit mund të punësohet në një punë të dytë me ose pa pagesë dhe që kufizojnë përgjegjësinë ligjore të punëdhënësit në raste të tilla.

Neni 29

Pranimi i studentëve

1. Secili kandidat që e kalon testin e maturës, gëzon të drejtën për të vazhduar studimet në institucionet e arsimit të lartë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nëpërmjet një udhëzimi administrativ, Ministria harton dispozita, kur është e nevojshme dhe e dobishme, lidhur me kohën dhe organizimin e provimeve të pranimit të caktuara nga institucionet e arsimit të lartë për të lehtësuar regjistrimin në arsimin e lartë të studentëve që nuk kanë hyrë në testin e maturës ose nuk e kanë kaluar atë.

3. Për fusha të veçanta studimi, bartësit publikë të arsimit të lartë mund të parashohin për disa lëndë provime shtesë për pranim të studentëve, të cilat duhet të aprovohen nga Ministria. Kërkesat për pranim përshkruhen në mënyrë të hollësishme në rregulloret e hartuara mbi bazën e statutit të institucionit.

4. Studentët pranohen në studime Master mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në këtë ligj.

5. Kur numri i kandidatëve të suksesshëm e kalon numrin e vendeve të financuara nga fonde publike në dispozicion të një programi, bartësi mund të pranojë, gjithnjë mbi bazën e meritave, studentë që paguajnë

tarifa në ato vende, të cilat nuk financohen me fonde publike, por deri në numrin e përcaktuar në licencën e bartësit.

6. Rregullat e përcaktuara nga një bartës publik i arsimit të lartë mund të përcaktojnë rrethanat, në bazë të të cilave studentëve që paguajnë shkollimin dhe që arrijnë rezultate të shkëlqyeshme në mësim, mund t'u ndahet një vend studimi i financuar me fonde publike në vitin e dytë apo në vitin vijues të studimit.

7. Bartësit privat të arsimit të lartë mund të pranojnë çdo kandidat në programet e tyre, me kusht që të mund t'i arsyetojnë vendimet e tyre para AKA-së.

Neni 30

Pagesa e shkollimit dhe tarifat tjera që paguhen nga studentët vendas apo të huaj

1. Ministria përcakton në një udhëzim administrativ, i cili rishqyrtohet çdo vit, pagesën maksimale të shkollimit që duhet paguar nga studentët që pranohen në bartësit publik të arsimit të lartë, të financuar nga Ministria.

2. Pagesat për shkollim të cekura në paragrafin 1. të këtij neni mund të përcaktohen në nivele të ndryshme:

2.1. varësisht nga fakti nëse studenti banon në Kosovë apo diku tjetër;

2.2. për programet e ndryshme sipas kostove që kanë.

3. Bartësit e arsimit të lartë që marrin fonde publike mund të vendosin tarifa, siç është tarifa për shqyrtimin e aplikacioneve, për regjistrim, për përsëritjen e provimeve dhe për diplomim, dhe këto tarifa do të miratohen nga organi drejtues i bartësit përkatës dhe konfirmohen nga Ministria.

4. Bartësit publik të arsimit të lartë mund të kërkojnë mbulimin e plotë të kostos ekonomike për dhënie dhe shërbimeve duke përfshirë fotokopjimin, materiale speciale dhe shërbime të tjera ndihmëse.

5. Bartësit privatë të arsimit të lartë, të cilët nuk janë pranues të fondeve publike, mund të vendosin vetë për tarifat.

Neni 31

Të drejtat dhe obligimet e studentit

1. Studentët që janë pranuar dhe regjistruar tek bartësi i arsimit të lartë hyjnë në marrëdhënie ligjore me atë bartës.

2. Studentët kanë të drejtat e mëposhtme, që mund të specifikohen më tej në statutin e bartësit:

2.1. të ndjekin të gjitha ligjëratat, seminarët dhe gjitha aktivitetet e tjera mësimore të organizuara në lëndët e tyre, sipas nivelit të tyre si dhe të vijojnë, nëse ka vend, proceset e tjera të organizuara të mësimdhënies;

2.2. të shfrytëzojnë ambientet në biblioteka dhe shërbime të tjera për studentët në godinën e bartësit; dhe

2.3. të marrin pjesë në zgjedhjet për postet e studentëve në organizmat e ngritura mbi bazën e statutit të bartësit.

3. Studentët kanë obligimet vijuese:

- 3.1. të respektojnë rregullat e hartuara nga bartësi;
 - 3.2. të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe studentëve të tjerë;
 - 3.3. t'i kushtojnë vëmendjen e duhur e të plotë studimeve dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike; dhe
 - 3.4. të paguajnë pagesa dhe tarifa që janë të caktuara.
4. Statuti ose dokumenti themelues i barasvlershëm me të i çdo bartësi të arsimit të lartë përmban dispozita, të cilat:
- 4.1. garantojnë lirinë e studentëve, brenda ligjit për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga bartësi;
 - 4.2. u garantojnë studentëve lirinë e fjalës, të organizimit e të tubimit sipas dispozitave ligjore.
 - 4.3. mbrojnë studentët nga çdo lloj diskriminimi.
 - 4.4. sigurojnë mekanizma të paanshëm dhe objektivë për trajtimin e çështjeve disiplinore që kanë të bëjnë me studentët.
5. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e bartësit. Statuti përmban dispozita mbi trajtimin e drejtë të ankesave të tilla.
6. Rrethanat në bazë të të cilave studentët mund të çregjistrohen për arsye akademike apo disiplinore si dhe procedurat për ankesë përcaktohen më detajisht në statutin e bartësit.
7. Studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim të bartësit të arsimit të lartë ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente.
8. Personat që kanë mbaruar provimin përfundimtar në nivelin për të cilin janë regjistruar nuk kanë më statusin e studentit.

Neni 32

Mbështetja financiare për studentin

1. Ministria mund të nxjerrë akt nënligjor për krijimin e skemës apo skemave për mbështetje financiare të studentëve, bazuar në nevojat ekonomike.
2. Skema të tilla të mbështetjes financiare për studentët mund të përfshijnë dispozitën për të ndihmuar studentët në pagesat për shkollim dhe në pagesa të tjera tek bartësit publik dhe, sipas vlerësimit të ministrisë, tek bartësit privat të arsimit të lartë.
3. Bartësit publik të arsimit të lartë mund të krijojnë skema për mbështetje financiare studentët, me fonde që nuk ndahen nga burime publike.
4. Ministria ndërmerr veprime që mendon se janë të dobishme dhe të nevojshme për të garantuar që studentët e regjistruar në cilindo institucion të kenë mundësi dhe qasje të barabartë për të aplikuar në skemën apo skemat ekzistuese të mbështetjes financiare për studentët, që janë në pajtim me këtë nen.
5. Të gjitha organizatat e financuara me fonde publike, që u sigurojnë studentëve strehim, ushqim, ndihmë mjekësore dhe sociale, janë pjesë përbërëse e bartësit dhe u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji. Ministria mund t'i udhëzojë këto organizata lidhur me detyrimet, vetëqeverisjen dhe tarifat.

Neni 33
Organizatave studentore

1. Statuti ose çdo dokument tjetër themelues i bartësit të arsimit të lartë parasheh krijimin e një ose më shumë organizatave, që të përfaqësojnë studentët dhe që të kontribuojnë në plotësimin e kërkesave sociale, kulturore, akademike e argëtuese të studentëve.
2. Bartësit publik të arsimit të lartë kontribuojnë financiarisht në themelimin e organizatave studentore, përfshirë në rastet e duhura, fonde për shpenzime kapitale dhe rrjedhëse për godinat dhe ambientet.

Neni 34
Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të këtij ligji bëhet në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 35
Zbatimi

1. Ministria nxjerr akte nën ligjore për zbatimin e këtij ligji në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Të gjithë bartësit duhet që statutet e tyre t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji brenda një periudhe kohore jo më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 36
Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e nëneve si neni 2 paragrafi 1. dhe 3., neni 4 paragrafi 1.3; neni 6 nën-paragrafi 1.6., 1.9., 1.10., 1.11., 1.12, neni 14 paragrafi 1.; neni 20 nën-paragrafi 1.2. dhe neni 35 paragrafi 1. mund të hynë në fuqi nga viti akademik 2015/16 po qe se krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi egzak të koston financiare të periudhës vijuese.

Neni 37
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji 2002/03 mbi arsimin e lartë dhe çdo dispozitë ligjore e cila është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 38
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-037
29 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-036-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 24/2012 KATEGORITË E STUDENTËVE PËR ASISTENCË SI DHE KUSHTET PËR FITIMIN E ASISTENCËS

Në mbështetje të nenit 32 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 9 paragrafi 1.11 dhe neni 20 i Ligjit për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, nenit 8 paragrafi 1.4, (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011). Në pajtim me shtojcën 6 të Rregullores nr 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt. 22.03.2011) dhe nenin 38 (6) të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Kategoritë e studentëve për asistencë si dhe kushtet për fitimin e asistencës

NUMËR: 24/2012

DATË: 22.10.2012

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të nevojshme për studentët që përfitojnë asistencë në rastet e regjistrimit dhe shkollimit në Universitetet Publike.

Neni 2

Kategoria e studentëve që do të përfitojnë për regjistrim dhe shkollim

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave;
2. Studentët – invalid të luftës;
3. Studentët që kanë mbetur pa njerin prind si pasojë e luftës;
4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;
5. Studentët e të njëjtit prind i cili i ka tre (3) e më shumë studentë të rregullt në studime, studenti i tretë (3) e më tutje lirohen nga pagesa.

Neni 3

Dokumentet për fitimin e të drejtës

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët, familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave
 - 1.1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale, konsiderohen ata studentë, familjet e të cilëve janë në evidencën e përfituesve të asistencës sociale;
 - 1.2. Studentët, familjet e të cilëve nuk janë në asistencë sociale, por nuk kanë asnjë burim të të ardhurave;
 - 1.3. Studentët për të përfituar statusin nga neni 3 paragrafi 1.1. duhet të paraqesin këto dokumente:
 - 1.3.1. Vërtetimin nga Qendra për Punë Sociale, në të cilin vërtetohet se familja e studentit është shfrytëzuese e ndihmave sociale.

1.4. Studentët për të përfituar statusin nga neni 3 paragrafi 1.2. duhet të paraqesin këto dokumente:

1.4.1. Vërtetimin nga Enti për Punësim me të cilin vërtetohet se asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk janë në marrëdhënie pune.

1.4.2. Vërtetimin nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa të Kuvendit Komunal me të cilin dëshmohet se asnjëri nga anëtarët e familjes së ngushtë nuk ngarkohet me tatim nga të ardhurat kadastrale, përkatësisht se nuk ushtrojnë veprimtari biznesi.

Neni 4 Studentët invalid të luftës

1. Studentët invalid të luftës konsiderohen ata studentë të cilët nga lufta e fundit kanë mbetur me aftësi të kufizuara fizike.

2. Studentët për të përfituar statusin nga neni 4 paragrafi 1 duhet të paraqesin këto dokumente:

2.1. Certifikatën e mjekut specialist;

2.2. Vërtetimin nga shoqata e invalidëve të luftës.

Neni 5 Studentët të cilët kanë mbetur së paku pa njërin prind si pasojë e luftës

1. Studentët të cilët kanë mbetur së paku pa njërin nga prindërit si pasojë e luftës, konsiderohen të gjithë ata që gjatë luftës së fundit kanë humbur së paku njërin nga prindërit.

2. Studenti për të përfituar statusin nga neni 5.1. duhet të paraqesin këto dokumente:

2.1. Certifikatën nga zyra e regjistrimit civil të Kuvendit Komunal si dëshmi për humbjen e prindërit në luftë;

2.2. Vërtetimin se nuk ushtron veprimtari biznesi pjesa tjetër e familjes dhe

2.3. Certifikatën e lindjes së aplikuesit (studentit).

Neni 6 Studentët me nevoja të veçanta

Studentët me nevoja të veçanta për të përfituar asistencën sociale duhet të paraqesin certifikatën e mjekut specialist me të cilën dëshmohet aftësia e tij e kufizuar fizike.

Neni 7 Paraqitja e dokumenteve

1. Të gjithë studentët të cilët paraqesin kërkesën për asistencë konform kushteve të parapara në këtë Udhëzim administrativ – dokumentet e nevojshme duhet t'i dorëzojnë në njësinë akademike përkatëse.

2. Lista e të liruareve nga pagesa duhet të shpallet para fillimit të regjistrimit të semestrit, e cila i dërgohet për zbatim shërbimeve administrative të njësisë akademike.

3. Vendimin për përfundimin e asistencës e nxjerr komisioni i përbërë nga MASHT dhe Universitetet Publike.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

Prof. dr. Ramë Buja, ministër

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SHËNDETËSI

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Me këtë ligj përcaktohen:
 - 1.1. të drejtat dhe detyrimet në fushën e shëndetësisë;
 - 1.2. parimet e kujdesit shëndetësor;
 - 1.3. sistemi i kujdesit shëndetësor;
 - 1.4. veprimtaria e institucioneve shëndetësore;
 - 1.5. mbikëqyrja e shërbimeve shëndetësore.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
 - 1.1. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Ministria** - Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.3. **Komuna** - njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës;
 - 1.4. **Qytetari** - personi me shtetësi të Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Shtetësinë e Kosovës, ose personi i kualifikuar si refugjat në pajtim me ligjin;

- 1.5. **Banori** - bartësi i lejes së qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës të lëshuar nga autoriteti kompetent, si edhe personi me status zyrtar të refugjatit;
- 1.6. **Shfrytëzuesi i shërbimeve shëndetësore** - personi i cili i shfrytëzon shërbimet shëndetësore;
- 1.7. **Anëtari i familjes së ngushtë** - bashkëshorti/ja, fëmiu, fëmiu i adoptuar, prindi (thjeshtri, njerka), vëllau dhe motra, deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;
- 1.8. **Personi me aftësi të kufizuar** - personi me aftësi përkohësisht ose përherë dhe plotësisht të kufizuar i cili ka më shumë se tetëmbëdhjetë (18) vite dhe më pak se gjashtëdhjetë e pesë (65) vite; që ka diagnozën mjekësore të gjendjes së tillë: fizike, ndijore, dhe mendore; të sëmundjes ose të aftësisë së kufizuar, që e bënë atë të paaftë për çfarëdo pune shpërblyese, dhe për të cilin, pas vlerësimit profesional, Ministria përkatëse ka marr vendim se i përmbush kriteret e përcaktuara me ligj;
- 1.9. **Invalidi i punës** - personi të cilit në pajtim me ligjin i është njohur e drejta e invaliditetit të punës;
- 1.10. **Invalidi i luftës** - pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilit në pajtim me ligjin i është njohur e drejta e invaliditetit si pasojë e luftës;
- 1.11. **Invalidi civil i luftës** - personi të cilit nga organi kompetent i është njohur e drejta e invaliditetit si pasojë e luftës dhe burgosjes politike;
- 1.12. **Agjensioni i Financimit Shëndetësor (AFSH)** - agjencion ekzekutiv i Ministrisë, paraardhës i Fondit të sigurimit publik shëndetësor, që në emër të shtetit realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me kontraktimin, blerjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si dhe grumbullimin e të gjitha mjeteve financiare për këtë qëllim.
- 1.13. **Fondi i Sigurimit Shëndetësor** - institucion i sigurimit publik shëndetësor me cilësi të personit juridik që ka të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të përcaktuara me ligj të veçantë.
- 1.14. **Akreditim** - procedura e njohjes zyrtare, nga një organ i autorizuar nga Ministria, të kompetencës së një institucioni shëndetësor për vlerësimin e konformitetit me standardet dhe rregullat teknike për të kryer veprimtarinë shëndetësore për të cilën është licencuar.
- 1.15. **Licencim** - procedura për dhënien e lejes profesionistit shëndetësor ose institucionit shëndetësor që të merret me veprimtari shëndetësore në Kosovë dhe që është i autorizuar ta ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
- 1.16. **Lista e barërave dhe materialit shpenzues** - Lista e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese që mbulohen nga Qeveria dhe bashkë-pagesat e qytetarëve;
- 1.17. **Bashkë-pagesa**, mjetet financiare që me qëllim të financimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor paguhet nga qytetarët dhe banorët të cilët në pajtim me këtë ligj nuk janë të liruar nga bashkë-pagesat me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në institucionin publik ose privat, ose në institucionin që është pjesë e partneritetit publiko-privat shëndetësor, të kontraktuar nga AFSH;
- 1.18. **Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës** - organizatë e pavarur shëndetësore me rëndësi të veçantë publike në nivelin e kujdesit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor,

me cilësi të personit juridik, që ka të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të përcaktuara me këtë ligj.

1.19. **Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor** - Lista e formave dhe llojeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që mbulohen nga Qeveria dhe nga bashkë-pagesat (përfshirë Listën e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese) e cila përpilohet nga komiteti teknik i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Lista mund të modifikohet sipas nevojës në bazë të vlerësimit të Ministrisë.

1.20. **Profesionisti shëndetësor** - punëtori që ofron shërbime shëndetësore;

1.21. **I diplomuar** - personi që ka përfunduar studimet themelore universitare;

1.22. **Specialist** - kualifikimi profesional i fituar gjatë shkollimit specialistik pas-diplomik, të kryer në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, që është i njohur dhe i nostrifikuar në pajtim me këtë ligj;

1.23. **Sub-specialist** - kualifikimi i ngushtë profesional i fituar gjatë shkollimit pas-specialistik në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, që është i njohur dhe i nostrifikuar nga organi i autorizuar ose i njohur në pajtim me këtë ligj;

1.24. **Bashkëpunëtori shëndetësor** - personi i cili nuk e ka kryer shkollimin formal medicinal, që me qëllim të realizimit të veprimtarisë shëndetësore është i punësuar në institucion shëndetësor;

1.25. **Shërbimi shëndetësor i burgjeve të Republikës së Kosovës** - shërbim autonom profesional, që në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse kujdeset për shëndetin e qytetarëve dhe banorëve të vendosur në institucionet korrektuese;

1.26. **Kujdesi shëndetësor** - masat dhe veprimet që ndërmerren nga organizatat, institucionet, dhe profesionistët shëndetësor, që për qëllim parësor kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve dhe të banorëve;

1.27. **Mjekësia familjare** - kujdesi personal, gjithëpërfshirës, dhe të vazhdueshëm për individin në kontekstin e familjes dhe bashkësisë

1.28. **Shërbimi profesional** - organizimi administrativ dhe profesional i institucioneve shëndetësore brenda një lëmie specialitike, që ka për qëllim sigurimin e vazhdimësisë së kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e organizimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

1.29. **Institucioni shëndetësor** - institucioni i themeluar nga personi juridik ose fizik që ofron shërbime të kujdesit shëndetësor, në bazë të licencës së lëshuar në pajtim me këtë ligj;

1.30. **Institucioni shëndetësor humanitar**, institucioni shëndetësor i themeluar nga organizata joqeveritare dhe jopërfituese me seli në Republikën e Kosovës që është e licencuar për veprimtari shëndetësore;

1.31. **Themelues** - Ministria, Kuvendi i Komunës si dhe personat fizik dhe juridik, të cilët kanë të drejtë të themelojnë institucionin shëndetësor në pajtim me këtë ligj;

1.32. **Dokumentacioni mjekësor** - dorëshkrimet, shënimet ose të dhënat e tjera përkitazi me identitetin personal të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore dhe gjendjes së tij shëndetësore në të cilat ka qasje profesionisti shëndetësor gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore;

1.33. **Fshehtësia profesionale** - ruajtja e të dhënave për gjendjen shëndetësore të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore nga qasja në to prej personave të paautorizuar;

1.34. **Emergjenca** - ndryshimi i përnjëhershëm i gjendjes shëndetësore, që në rast të mungesës së ofrimit të shërbimit të shpejtë shëndetësor rrezikon jetën ose dëmton seriozisht shëndetin e qytetarit ose banorit;

1.35. **Urgjenca** - ndryshimi i përnjëhershëm i gjendjes shëndetësore që kërkon kujdes të shpejtë shëndetësor, por që nuk rrezikon drejtpërdrejt jetën ose nuk dëmton seriozisht shëndetin e qytetarit ose banorit.

1.36. **Gjendja e urgjencës** - çdo lloj ngjarje e paparashikueshme që rrezikon jetën, integritetin fizik dhe shëndetin e qytetarëve dhe banorëve ose funksionimin e institucioneve shëndetësore, që cilësohet me shpërputhje të madhe ndërmjet nevojave për kujdesin shëndetësor dhe mundësive në dispozicion;

1.37. **Sterilizimi artificial** - procedura mjekësore që ka për qëllim humbjen e aftësisë së mbarësimi;

1.38. **Transplante** - janë organet, qelizat dhe indet me origjinë njerëzore ose shtazore të destinuar për tu transferuar te njeriu;

1.39. **Transplantimi** - çvendosje e transplantit brenda të njëjtit individ, midis individëve të të njëjtës specie, midis individëve të specieve të ndryshme, dhe midis individëve identik nga pikëpamja gjenetik, që zbatohet vetëm për nevoja mjekësore dhe kur vlerësohet se kjo është e domosdoshme për të siguruar jetën dhe shëndetin e marrësit të transplantit;

1.40. **Frytnimi i asistuar** - proces nëpërmjet të cilit qelizat vezë fekondohen me spermatozoid jashtë trupit, *in vitro*;

1.41. **Trajtimi para-mjekësor dhe alternativ** - metodat e trajtimit që janë të regjistruara nga shoqatat profesionale; dhe që duke qenë se nuk janë në pajtim me doktrinën aktuale mjekësore nuk përfshihen në shërbimet zyrtare shëndetësore.

2. Në këtë ligj, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe: njëjësi përfshin shumësin dhe shumësi njëjësin; dhe “ai” përfshin “ajo” dhe “tij” përfshin “saj”.

Neni 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë në kujdesin shëndetësor

1. Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

2. Të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor.

3. Secili shtetas dhe banor është i obliguar të përkujdeset për shëndetin e tij.

4. Qytetarët dhe banorët, në mënyrë të organizuar, nëpërmjet shoqatave ose individëve të emëruar, marrin pjesë aktive në krijimin e kushteve më të favorshme për zbatimin e veprimtarisë shëndetësore dhe realizimin e të drejtave të tyre në kuadër të kësaj veprimtarie.

5. Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetar, banorëve, dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore në kujdesin shëndetësor rregullohen me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.

KUJDESI SHËNDETËSOR

Neni 5

Parimet e kujdesit shëndetësor

1. Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u udhëhequr nga parimet themelore, si vijon:

1.1. Barazia

1.1.1. sigurimi i qasjes së plotë ndaj shërbimeve në Listën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pas përcaktimit të saj; për të gjithë qytetarët dhe banorët, përfshirë qasjen e lehtë deri te institucionet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara;

1.1.2. shpërndarja e drejtë e burimeve publike për kujdesin shëndetësor duke pasur dallimet socio-ekonomike;

1.1.3. barazia e plotë e sektorit publik, privat, dhe partneritetit publik-privat gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor, në pajtim me këtë ligj.

1.2. gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës.

1.3. cilësia: aplikimi i standardeve ndërkombëtare në organizimin, zhvillimin, dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor përkritazi me të gjitha aspektet, përfshirë: trajtimin e fokusuar në pacientë, përdorimin e resurseve, organizimin e punës, trajnimin, edukimin, licencimin, akreditimin, udhëzimet etike, dhe mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.

1.4. ndershmëria dhe llogaridhënia;

1.5. dhënia e prioritetit intervenimeve kost-efektive të kujdesit shëndetësor, të bazuara në të dhëna;

1.6. qëndrueshmëria dhe vazhdueshmëria;

1.7. parandalimi dhe zbulimi i hershëm i sëmundjeve nëpërmjet promovimit shëndetësor, detektimit, dhe politikave publike shumë-sektoriale për përmirësimin e shëndetit;

1.8. bashkë-përgjegjësia dhe solidariteti.

Neni 6

Veprimtaria shëndetësore

Institucionet e Republikës së Kosovës; institucionet shëndetësore; personat juridik dhe fizik, në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e tyre, obligohen që të marrin masat e nevojshme për zbatimin e parimeve dhe masave të kujdesit shëndetësor, në pajtim me politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministria.

* * * *

KREU III

POLITIKAT ZHVILLIMORE NË SHËNDETËSI

Neni 8

Politikat për kujdesin shëndetësor

1. Ministria, përpilon politika dhe zbaton ligjet e një sistemi jo-diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore.
2. Ministria, vendos normative dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë, duke i respektuar standardet e përkatëse ndërkombëtare.
3. Ministria, ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara me ligj për realizimin e veprimeve të duhura me qëllim të zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, banorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor.

Neni 9

Udhëheqja dhe Roli Rregullator

1. Funksionet udhëheqëse dhe rregullatore të Ministrisë përfshijnë:
 - 1.1. zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe ligjeve që sigurojnë sistem jo diskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor;
 - 1.2. koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin dhe zbatimin koherent të politikave shëndetësore;
 - 1.3. vendosjen e normave dhe standardeve si dhe nxjerrjen e akteve nën-ligjore për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet përkatëse ndërkombëtare;
 - 1.4. mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve nga nën-paragrafi 1.3, paragrafi 1. i këtij neni, përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet e tjera, sipas nevojës;
 - 1.5. përcjelljen e situatës dhe zbatimin e masave adekuate për parandalimin, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në sektorin e shëndetësisë;
 - 1.6. menaxhimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor;
 - 1.7. zhvillimi i burimeve institucionale dhe njerëzore në shëndetësi të domosdoshme për zvogëlimin e nevojës për trajtim jashtë vendit;
 - 1.8. përkrahjen e pjesëmarrjes, iniciativave dhe zhvillimit të aktiviteteve të qytetarëve dhe të banorëve që ndërlidhen me shëndetin;
 - 1.9. zhvillimin dhe pjesëmarrjen në fushatat për informim publik dhe projektet e tjera të promovimit shëndetësor me qëllim të rritjes së shkallës së vetëdijes publike dhe pajtueshmërisë me standardet shëndetësore;
 - 1.10. përkrahjen e zhvillimit të arsimimit dhe edukimit shëndetësor me qëllim të ngritjes së njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë;
 - 1.11. mbikëqyrjen e kontrollit të cilësisë së ujit dhe ushqimit me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, në pajtim me ligjin;
 - 1.12. planifikimin e resurseve njerëzore në shëndetësi

1.13. Ministria mund të formojë komisione, komitete, borde, këshilla profesionale dhe trupa të tjerë profesional për çështje dhe lëmi të caktuara, në pajtim me këtë ligj dhe aktet përcjellëse nën-ligjore.

* * * *

KREU IV ZBATIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Neni 11 Shërbimet

1. Shërbimet e kujdesit shëndetësor organizohen dhe ofrohen nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore si shërbime: spitalore, jashtëspitalore, shtëpiake, dhe emergjente.
2. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet përcjellëse nën-ligjore.
3. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për personat që nuk janë qytetarë ose banorë të Republikës së Kosovës bëhen me pagesë dhe rregullohen me akt nën-ligjor, të nxjerrë nga Ministria.

Neni 12 Masat dhe veprimet

1. Kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmjet masave dhe veprimeve, si në vijim:
 - 1.1. ruajtja dhe përparimi i mënyrave të shëndosha të jetesës nëpërmjet promovimit shëndetësor dhe aktiviteteve edukative të organizuara me qëllim të ngritjes së kulturës shëndetësore të qytetarëve dhe të banorëve;
 - 1.2. zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse dhe eliminimi i shkaktarëve të tyre duke evituar rrethanat që kanë mundësuar shfaqjen e epidemive;
 - 1.3. zbulimi i hershëm dhe trajtimi i sëmundjeve akute, si dhe mjekimi i sëmundjeve kronike masive jo-ngjitëse nga regjistri zyrtar, përfshirë rehabilitimin pas tyre;
 - 1.4. parandalimi, zbulimi i hershëm dhe trajtimi i sëmundjeve malinje, veçanërisht i kancerit të gjirit, kancerit të qafës së mitrës, dhe kancerit kolorektal .
 - 1.5. parandalimi i lëndimeve në punë dhe i sëmundjeve profesionale;
 - 1.6. parandalimi, zbulimi hershëm, dhe trajtimi i sëmundjeve të vartësisë, sëmundjeve me bartje seksuale, dhe HIV infeksionit“.
 - 1.7. sigurimi i furnizimit me barna, materiale shpenzuese, si dhe pajisje medicinale;
 - 1.8. trajtimi, rehabilitimi dhe resocializimi i të sëmurëve kronik mendor në bashkësi;
 - 1.9. trajtimi, rehabilitimi psikosocial dhe resocializimi i personave me aftësi të kufizuara në bashkësi;
 - 1.10. sigurimi i kushteve për ruajtjen e shëndetit të shtatzënave dhe të lehonave; fillimin e shëndoshë të jetës; si dhe zhvillimin e shëndoshë të fëmijëve dhe të rinjve;

- 1.11. ndërmarrja e masave për parandalimin dhe eliminimin e pasojave shëndetësore të shkaktuara nga gjendjet emergjente;
- 1.12. organizimi i shërbimit emergjent në bazë të ligjit të veçantë;
- 1.13. zbatimi i sistemit unik të mbledhjes së të dhënave dhe informimit në shëndetësi;
- 1.14. organizimi dhe zbatimi i mbikëqyrjes profesionale dhe juridike;
- 1.15. zbatimi i aktiviteteve në grumbullimin vullnetar të gjakut;
- 1.16. ndërmarrja e masave përkitazi me mbrojtjen nga shkaktarët e dëmshëm mjedisor; fizik, kimik, dhe biologjik;
- 1.17. parandalimi i anomalive kongjenitale dhe zbulimi i tyre i hershëm;
- 1.18. parandalimi dhe zbulimi i hershëm i kariesit, sëmundjeve të gojës dhe anomalive orofaciale;
- 1.19. shërbimi i kujdesit shëndetësor në shtëpi për qytetarët dhe banorët në nevojë, veçanërisht për personat e palëvizshëm.

* * * *

Neni 14

Kushtet dhe procedurat e zbatimit të kujdesit shëndetësor

1. Kujdesi shëndetësor zbatohet në institucionin shëndetësor, ose në banesë të qytetarit ose të banorit, si dhe në vende të tjera atëherë kur qytetari ose banori ka nevojë për kujdes shëndetësor emergjent.
2. Kujdesi shëndetësor në institucionin shëndetësor ushtrohet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me këtë ligj, aktet nën-ligjore, si dhe aktet e tjera të përgjithshme të institucionit shëndetësor.
3. Kujdesi shëndetësor në format e tjera të veprimtarisë shëndetësore ushtrohet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me këtë ligj, dhe aktet e tjera nën-ligjore.
4. Veprimtaria shëndetësore e shtetasve të huaj rregullohet me akt nën-ligjor, të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.

KREU V

ORGANIZIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Neni 15

Nivelet e kujdesit shëndetësor

1. Kujdesi shëndetësor organizohet dhe zbatohet në tri (3) nivele: parësor, dytësor dhe tretësor.
2. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen nga institucionet shëndetësore publike, private dhe publiko-private.
3. Kujdesi shëndetësor sigurohet në nivel: shteti, komune, punëdhënësi, në mënyrë individuale dhe në nivel të shërbimit profesional.
4. Ndarja e aktiviteteve ndërmjet niveleve të kujdesit shëndetësor realizohet në pajtim me strategjinë kombëtare të shëndetësisë, si dhe bazuar në parimin e kujdesit parësor shëndetësor si pikë hyrëse dhe themel të sistemit shëndetësor.

5. Qasja në kujdes shëndetësor sigurohet gjatë njëzet e katër (24) orëve pa ndërprerje, nëpërmjet: punës në orar të rregullt, punës në ndërrime, kujdestarisë, si dhe punës në kuadër të shërbimit të urgjencës, në pajtim me orarin e përcaktuar nga institucioni shëndetësor.

* * * *

Neni 17

Llojet e institucioneve shëndetësore

1. Llojet e institucioneve në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës janë të njëjta në sektorin: publik, privat, dhe publiko-privat.

2. Institucionet e nivelit parësor të kujdesit shëndetësor janë:

2.1. Qendra kryesore e mjekësisë familjare me njësitë përbërëse të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria;

3. Institucionet e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor janë:

3.1. Spitali i përgjithshëm dhe special me njësitë përbërëse të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria;

3.2. Poliklinika specialistike;

3.3. Ambulanca specialistike

3.4. Ambulanca stomatologjike

3.5. Qendra e shëndetit mendor me Shtëpinë për integrim në bashkësi;

3.6. Qendra e transfuzionit të gjakut;

3.7. Qendra e rehabilitimit fizikal dhe klimatik;

3.8. Qendra e mjekësisë sportive;

3.9. Qendra e mjekësisë së punës;

3.10. Qendrat rajonale të shëndetësisë publike.

3.11. Qendra për rehabilitimin e të dëgjuarit dhe të folurit.

4. Institucionet e nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor janë:

4.1. Qendra klinike universitare;

4.2. Qendra klinike universitare stomatologjike;

4.3. Instituti kombëtar i shëndetësisë publike;

4.4. Qendra kombëtare e mjekësisë së punës;

4.5. Qendra kombëtare e mjekësisë Sportive;

- 4.6. Qendra kombëtare e transfuzionit të gjakut;
- 4.7. Qendra kombëtare e telemjekësisë.
5. Barnatoret janë institucione shëndetësore që funksionojnë në të tri (3) nivelet e kujdesit shëndetësor.
6. Institucionet në shërbimin shëndetësor të burgjeve janë:
 - 6.1. Ambulanca e burgut;
 - 6.2. Stacionari i burgut;
 - 6.3. Institucioni shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta;
 - 6.4. Institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijut.

Neni 18

Kujdesi parësor shëndetësor

1. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet në pajtim me politikat, planet, dhe standardet e përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria;
2. Kujdesi parësor shëndetësor përfshin:
 - 2.1. Promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin, dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
 - 2.2. Mbrojtjen parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore, të mesme, dhe të larta në territorin e Komunës.
 - 2.3. ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, përfshirë sero-profilaksinë, vaksinoprofilaksinë, dhe kimio-profilaksinë në pajtim me ligjin, si dhe arsimimin dhe edukimin sistematik shëndetësor të popullatës;
 - 2.4. promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve;
 - 2.5. diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i tuberkulozës;
 - 2.6. organizimin e shërbimeve të urgjencës dhe emergjencës mjekësore si pjesë e sistemit unik të shërbimeve në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor;
 - 2.7. shërbimet e kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbimet e planifikimit familjar;
 - 2.8. shërbimet e shëndetit mendor.
3. Komunitat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.
4. Komunitat obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor.
5. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës shërbimeve të mjekësisë familjare, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.

6. Përbërja e ekipit të mjekësisë familjare përcaktohet me aktin nën-ligjor nga paragrafi 1. i këtij neni.
7. Çdo qytetar dhe banor me vështirësi shëndetësore është i obliguar të lajmërohet fillimisht tek mjeku familjar, me përjashtim të rasteve emergjente.
8. Prej çdo qytetari dhe banori do të kërkohej të përcaktohet për një mjek familjar.
9. Çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar në komunën ku jeton, brenda zonës së përfshirjes të përcaktuar nga komuna, dhe ka të drejtë ta ndërroj atë;
10. Profesionistët në kujdesin parësor shëndetësor do të bashkëpunojnë me profesionistët shëndetësor në nivelin dytësor dhe tretësor, në pajtim me këtë ligj.
11. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare.
12. Standardet e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare, përcaktohen me aktin nën-ligjor nga paragrafi 1. i këtij neni.
13. Me qëllim të mbështetjes së shërbimeve të mjekësisë familjare, Ministria mbikëqyrë dhe rregullon shërbimet e integruara të kujdesit parësor shëndetësor, në pajtim me këtë ligj.

Neni 19

Kujdesi dytësor shëndetësor

1. Kujdesi dytësor shëndetësor përfshinë: shërbimet spitalore, shërbimet jashtë-spitalore: diagnostike; terapeutike, rehabilituese, transportin emergjent, si dhe shërbimet e shëndetësisë publike.
2. Organizimi dhe veprimtaria e institucioneve shëndetësore nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohet me akte nën-ligjore të nxjerra nga Ministria.

Neni 20

Kujdesi dytësor shëndetësor në komuna

1. Kujdesi dytësor shëndetësor mund të organizohet edhe në nivelin komunal me kërkesën e Kuvendit përkatës komunal, dhe në pajtim me vendimin e Ministrit të Shëndetësisë.
2. Institucionet e kujdesit shëndetësor që nuk janë pjesë e organizatës shëndetësore nga neni 68 i këtij ligji, në komunat ku kujdesi dytësor shëndetësor zbatohet në bazë të legjislacionit përkatës për vetëqeverisjen lokale, do të kenë kompetenca të zgjeruara për ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondar, përfshirë këtu: regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me Ministrinë; punësimin dhe pagesën e pagave dhe mëditjeve në pajtim me legjislacionin në fuqi; si dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të kujdesit shëndetësor, në bashkëpunim me Odat e profesionistëve shëndetësorë nga neni 78 i këtij ligji.
3. Procedurat për zbatimin e kompetencave të kujdesit dytësor shëndetësor, rregullohen me këtë ligj dhe aktet e tjera nën-ligjore, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me legjislacionin përkatës për vetëqeverisje lokale.

Neni 21

Kujdesi tretësor shëndetësor

1. Kujdesi tretësor shëndetësor organizohet dhe ofrohet në institucione të licencuara nga Ministria ku krahas veprimtarisë shëndetësore ofrohet edhe shkollim universitar, shkollim specialistik dhe subspecialistik, si dhe puna kërkimore – shkencore.
2. Kujdesi tretësor shëndetësor përfshinë: kujdesin e avancuar shëndetësor: spitalor, jashtë spitalor, dhe të shëndetësisë publike; shërbimet konziliare; dhe transportin emergjent.
3. Institucionet nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të kenë Drejtor për arsim dhe shkencë, që propozohet nga fakulteti përkatës i shkencave mjekësore.
4. Në institucionet nga paragrafi 1. i këtij neni udhëheqësit e njësive profesionale shëndetësore, krahas kualifikimit specialistik, duhet të kenë thirrje akademike të profesorit, ose në mungesë të profesorit, thirrje të doktorit të shkencave ose përgatitje të lartë profesionale, si dhe duhet të jenë të punësuar në orar të plotë të punës në këto institucione.
5. Organizimi dhe zbatimi i procesit edukativ dhe arsimor në institucionet nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohet me akt nën-ligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria përkatëse e arsimit, dhe Universiteti i Prishtinës, të miratuar nga Qeveria.

* * * *

Neni 24

Referimi në institucionin tjetër shëndetësor

Në rastin kur institucioni i kujdesit shëndetësor nuk është në gjendje që të ofrojë kujdesin e duhur shëndetësor brenda fushëveprimit të tij, ai është i obliguar që të udhëzojë qytetarin në institucionin tjetër shëndetësor që është në gjendje të trajtojë rastin e veçantë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës medicinal duke e respektuar sistemin e referimit nga paragrafi 3. neni 16 i këtij ligji.

KREU VI

FORMAT E VEÇANTA TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

* * * *

Neni 34

Mjekësia fizikale dhe rehabilituese

Mjekësia fizikale dhe rehabilituese ofrohet në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor dhe rregullohet me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.

* * * *

Neni 37

Kujdesi shëndetësor në institucionet e për kujdesit social

Masat e kujdesit shëndetësor në institucionet e për kujdesit social përcaktohen me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria përkatëse për çështje sociale.

Neni 38

Institucionet shëndetësore në kuadër të shoqërisë civile

Shërbimet e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore humanitare dhe në format e tjera të organizimit të shoqërisë civile në lëmin e shëndetësisë, rregullohen me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 39
Trajtimi shëndetësor para-mjekësor dhe alternativ

1. Metodatat para-mjekësore dhe alternative të trajtimit të sëmundjeve, të çrregullimeve, dhe të lëndimeve, do të regjistrohen, rregullohen dhe mbikëqyren, në bazë të aktit nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.
2. Ndalohen metodatat dhe procedurat nga paragrafi 1. i këtij neni që nuk janë të regjistruara.

KREU VII
THEMELIMI, LICENCIMI DHE AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

* * * *

Neni 42
Licencimi dhe Akreditimi

1. Të gjitha institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën vetëm pas licencimit nga Ministria ose nga organi i autorizuar prej saj, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria, që përcakton kushtet specifike për punë sa i përket: hapësirës, kuadrit profesional, dhe pajisjeve medicinale.
2. Licencimi i institucioneve shëndetësore do të zbatohet në pajtim me planet, normativat, dhe standardet e përcaktuara nga Ministria.
3. Me rastin e aplikimit për licencë, institucioni shëndetësor duhet të deponoj aktin e themelimit, për të cilin paraprakisht ka dhënë pëlqim Ministria.
4. Akreditimin e institucioneve të licencuara shëndetësore e bënë organi i autorizuar nga Ministria në pajtim me aktin përkatës nën-ligjor.
5. Institucionet e akredituara shëndetësore kanë përparësi me rastin e kontraktimit të shërbimeve të tyre me AFSH.
6. Në Komunitatet me kompetencat e zgjeruara në ofrimin e kujdesit dytësor shëndetësor licencimi i këtyre institucioneve shëndetësore do të bëhet në përputhje me legjislacionin gjegjës për vetëqeverisjen lokale dhe nenin 20 të këtij ligji.

* * * *

KREU VIII
MBIKËQYRJA INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Neni 46
Llojet e mbikëqyrjes

1. Pavarësisht nga mjetet e financimit ose llojet e pronësisë të gjitha institucionet shëndetësore, përfshirë institucionet shëndetësore nga neni 20 i këtij ligji, do të jenë subjekt i mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme.
2. Mbikëqyrja nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të sigurojë zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore, normave etike dhe profesionale, si dhe standardeve bashkëkohore në shëndetësi.
3. Mbikëqyrja e brendshme nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin auditimin e brendshëm dhe organet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

4. Mbikëqyrja e jashtme nga paragrafi 1. i këtij neni zbatohet nga Inspektorati shëndetësor, Inspektorati farmaceutik, Inspektorati sanitar, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, dhe organet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 47 Inspektoratet

1. Inspektorati shëndetësor është organ administrativ i Ministrisë.
2. Punët, organizimi, autorizimet, detyrat, dhe kompetencat e Inspektoratit Shëndetësor përcaktohen me ligj të veçantë.
3. Inspektorati farmaceutik është organ administrativ i Ministrisë.
4. Punët, organizimi, autorizimet, detyrat, dhe kompetencat e Inspektoratit Farmaceutik përcaktohen me ligj të veçantë.
5. Punët, organizimi, autorizimet, detyrat, dhe kompetencat e Inspektoratit Sanitar përcaktohen me ligj të veçantë.

* * * *

KREU IX SISTEMI I INFORMIMIT SHËNDETËSOR

* * * *

Neni 51 Mbledhja e të dhënave dhe raportimi

1. Llojet, përmbajtja dhe menaxhimi i të dhënave; grumbullimi, përpunimi dhe shfrytëzimi i tyre; si dhe sistemi i raportimit brenda sistemit unik të SISH, përcaktohen me aktin nën-ligjor të Ministrisë nga paragrafi 2., neni 49 i këtij ligji.
2. Profesionisti shëndetësor dhe institucioni shëndetësor duhet të raportojnë për shërbimet e tyre duke mos cenuar të drejtat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe duke siguruar fshehtësinë profesionale, në pajtim me ligjin.
3. Çdo profesionistë shëndetësor me nënshkrimin e tij, mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacionin dhe regjistrat shëndetësorë.

Neni 52 Pronësia mbi të dhënat dhe përgjegjësitë

1. Pronar i të dhënave është institucioni shëndetësor që bën regjistrimin e tyre, në pajtim me aktin nën-ligjor nga neni nga paragrafi 2., neni 49 i këtij ligji.
2. Institucioni shëndetësor nga paragrafi 1. i këtij neni është përgjegjës për:
 - 2.1. grumbullimin, ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave në mënyrë të rregullt dhe të sigurt;
 - 2.2. sigurimin e qasjes së lehtë në të dhëna;
 - 2.3. mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale; dhe

2.4. mbrojtjen e të dhënave nga keqpërdorimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

* * * *

KREU X FINANCIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Neni 55 Sistemi i Financimit të Kujdesit Shëndetësor

1. Financimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës bëhet sipas modelit të kombinuar të financimit, nëpërmjet buxhetit dhe sistemit të sigurimeve shëndetësore, publike dhe private.
2. Fondi i sigurimit shëndetësor si pjesë e sistemit të sigurimit publik shëndetësor nga paragrafi 1. I këtij neni mund të themelohet dhe rregullohet vetëm me ligj të veçantë.

Neni 56 Agjensioni i Financimit Shëndetësor

1. Agjensioni i Financimit Shëndetësor (AFSH) është agjencion ekzekutiv i Ministrisë, që realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me negocimin dhe kontraktimin e shërbimeve nga Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe Lista e barërave dhe materialit harxhues medicinal, nga institucionet e licencuara shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si dhe grumbullimin e të gjitha mjeteve financiare për këtë qëllim.
2. Përparësi me rastin e kontraktimit të shërbimeve kanë institucionet e akredituara shëndetësore.
3. AFSH përcakton skemën stimulative për performancën e profesionistëve shëndetësorë dhe shërbimet përkatëse profesionale në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, të bazuar në kritere objektive dhe transparente të përmbushjes së indikatorëve të vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor të përcaktuara me akt nën-ligjor të nxjerr nga Ministria.
4. Themelimi, organizimi, modalitetet e kontraktimit, dhe funksionimi i përgjithshëm i AFSH rregullohet me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 57 Mjetet për Financimin e Kujdesit Shëndetësor

1. Mjetet e nevojshme për financimin e Listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga nënparagrafi 1.26 i nenit 3 i këtij ligji do të sigurohen nga burimet, si në vijim:
 - 1.1. buxheti i Kosovës;
 - 1.2. buxheti i komunave;
 - 1.3. bashkë-pagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore të cilët nuk janë të liruar, në pajtim me këtë ligj;
 - 1.4. dhuratat dhe trashëgimitë e dhuruara nga qytetarët individual;
 - 1.5. donacionet në formë të parave të gatshme ose të ngjashme;
 - 1.6. të ardhurat nga aktivitetet e autorizuara;

1.7. institucionet e sigurimeve shëndetësore, vendore dhe të jashtme, private dhe publike (pas themelimit, në pajtim me këtë ligj);

1.8. pagesat e drejtpërdrejta nga shfrytëzuesit dhe nga institucionet e sigurimeve shëndetësore, vendore dhe të huaja, privat dhe publik (pas themelimit të tij), në pajtim me këtë ligj.

Neni 58

Bashkë-pagesat

Bashkë-pagesat do të rregullohen me akt të veçantë nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria dhe mund të ndryshohen në çdo kohë.

Neni 59

Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor

1. Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor që mbulohen nga AFSH, përcaktohen në Listën e shërbimeve të përpiluar nga komiteti teknik i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë në fillim të çdo viti fiskal; të miratuar nga Qeveria, në pajtim me resurset financiare në dispozicion dhe nevojat shëndetësore të popullatës.

2. Lista nga paragrafi 1. i këtij neni dorëzohet në AFSH së bashku me deklaratën financiare mbi mundësit për mbulesën financiare të pakos së propozuar të shërbimeve.

3. Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor, sigurohen në institucionet e licencuara shëndetësore, publike dhe private, si dhe ato në kuadër të partneritetit publiko-privat, në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, me të cilat AFSH ka nënshkrua kontratë.

4. Rimbursimi i barërave dhe materialit shpenzues medicinal bëhet vetëm atëherë kur bari ka qenë i përshkruar nga ana e shërbimit të mjekësisë familjare, në recetë zyrtare, dhe me emër gjenerik.

5. Shërbimet plotësuese të kujdesit shëndetësor që nuk janë pjesë e Listës nga paragrafi 1. i këtij neni do të mund të sigurohen me pagesën e premiumit të sigurimit shëndetësor në kompanitë private të sigurimeve shëndetësore në vend ose publike dhe private jashtë vendit ose me pagesë të drejtpërdrejtë të çmimit të shërbimit në institucionin shëndetësor.

Neni 60

Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor

1. Institucionet shëndetësore dhe personat e tjerë juridik dhe fizik, të cilët ushtrojnë veprimtari shëndetësore, janë të obliguara, që për çdo pacientë të dokumentojnë shpenzimet si edhe llojin, vëllimin, cilësinë dhe çmimin e shërbimeve.

2. Institucionet shëndetësore dhe organizatat që marrin fonde publike për zbatimin e kujdesit shëndetësor, janë të detyruara të mbajnë llogaritë dhe evidencat në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe të sigurojnë informata të nevojshme për organet e autorizuara.

Neni 61

Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruar nga bashkë-pagesat

1. Qytetarët dhe banorët e liruar nga bashkë-pagesat janë personat që kanë të ardhura më të ulëta se niveli zyrtar i ndjeshmërisë sociale i përcaktuar nga Qeveria, në kategoritë e individëve të regjistruar si të ndjeshëm në aspektin social ose si të varfër, në bazë të aktit nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Qytetarët dhe banorët e liruar nga bashkë-pagesat janë po ashtu edhe personat të cilët janë:

- 2.1. viktima të trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin;
 - 2.2. banorët e përhershëm të vendbanimeve joformale në Republikën e Kosovës që nuk janë të regjistruar ose të cilët janë në proces të regjistrimit deri në përfundim të procesit të regjistrimit, ose deri një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çfarëdo realizohet më parë;
 - 2.3. personat e ri-atdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas ri-atdhesimit;
 - 2.4. të burgosurit të cilët janë në mbajtje të dënimit;
 - 2.5. personat të ç'vendosur me dhunë jashtë shtëpive të tyre si viktima të dhunës familjare, gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me ligjin.
 - 2.6. dhuruesit e gjakut që posedojnë dëshminë e lëshuar nga Enti i Kosovës për Transfuzionin e Gjakut se kanë dhënë gjak së paku pesë (5) herë në dy (2) vitet e fundit.
3. Shpenzimet e shërbimeve nga Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për shtetasit dhe banorët nga paragrafi 1. dhe paragrafi 2. i këtij neni do të barten nga Qeveria nëpërmjet transfereve përkatëse buxhetore në AFSH, në bazë të kërkesës nga Ministria, kornizës afat-mesme të shpenzimeve dhe legjislacionit në fuqi.

KREU XI SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS

Neni 62 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

1. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm SHSKUK) themelohet si institucion shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë.
2. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë, të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerr nga Ministria, në pajtim me këtë ligj.
3. SHSKUK ka autonomi ligjore të personit juridik, me të drejta, detyrime, dhe përgjegjësi të veçanta për zbatim të këtij ligji dhe akteve nën-ligjore të nxjerra nga Ministria.
4. Në funksionimin juridik SHSKUK fiton të drejta dhe merr obligime, është pronarë i aseteve të luajshme dhe të paluajshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij shëndetësore, dhe është palë në procedurat para gjykatave apo para organeve të tjera shtetërore.
5. SHSKUK ushtron veprimtarinë dhe përmbush obligimet dhe detyrat e tij në pajtim me normat, standardet, strategjitë dhe politikat e nxjerra nga Ministria.
6. Të punësuarit në SHSKUK nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës.

Neni 63 Themelimi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

1. SHSKUK themelohet me këtë ligj.
2. Akti themelor i SHSKUK është Statuti, të cilin e miraton Qeveria në propozim të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Me Statut të SHSKUK përcaktohen: numri i njësive përbërëse, autorizimet e tyre, fushëveprimi, organizimi, funksionimi, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë, sipas këtij ligji.

Neni 64

Drejtimi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

1. SHSKUK drejtohet nga Bordi Drejtues.

2. Bordi Drejtues është organi më i lartë vendim-marrës i SHSKUK.

3. Bordi Drejtues përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

3.1. një (1) përfaqësues nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës;

3.2 një (1) përfaqësues nga Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;

3.3 një (1) përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike;

3.4 një (1) përfaqësues nga Spitalet rajonale, në bazë të rotacionit dhe përbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore;

3.5 një (1) përfaqësues nga Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, në bazë të propozimit të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës;

3.6. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;

3.7. një (1) ekspertë i menaxhmentit shëndetësor me kualifikime të larta profesionale dhe shkencore i zgjedhur në bazë të konkursit publik.

4. Bordi Drejtues emërohet nga Qeveria në bazë të propozimit të Ministrit të Shëndetësisë.

5. Bordi Drejtues i përgjigjet Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë.

6. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjatë tri (3) vite.

7. Bordi Drejtues udhëhiqet nga Kryesuesi me mandat një (1) vjeçar i cili zgjidhet në bazë të parimit të rotacionit nga anëtarët e tij.

8. Bordi Drejtues mund të emërojë në cilësinë e vëzhguesit ekspertë vendor ose ndërkombëtar për mbështetjen e punës së tij përkitazi me çështje specifike.

9. Fushëveprimi, autorizimet, vendim-marrja dhe përgjegjësia e Bordit Drejtues përcaktohet me aktin mbi themelimin dhe Statutin e SHSKUK.

10. Me punët operative të SHSKUK udhëheq Drejtori i Përgjithshëm të cilin e emëron Bordi Drejtues në bazë të konkursit publik.

11. Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK emërohet në kohëzgjatje prej tri (3) vitesh.

12. Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK është përgjegjës për performancën profesionale dhe afarizmin financiar të SHSKUK.

13. Fushëveprimi, autorizimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm përcaktohen me Statutin e SHSKUK.

Neni 65

Financimi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

1. SHSKUK financohet nga Buxheti i Kosovës dhe nga burimet e tjera të përcaktuara me: këtë ligj, legjislacionin në fuqi, dhe aktet nën-ligjore të nxjerra nga Ministria.
2. Financimi i SHSKUK nga Buxheti i Kosovës zbatohet në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Nëse gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij SHSKUK realizon fitim, ai mund të përdoret vetëm për përmirësimin e performancës së veprimtarisë së tij shëndetësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.
4. Në rast të afarizmit negativ financiar, SHSKUK nuk mund t'ia atribuojë humbjet eventuale Ministrisë ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.
5. Lista e shërbimeve dhe çmimorja e shërbimeve që ofrohen nga SHSKUK miratohet nga Bordi Drejtues i SHSKUK.
6. Shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni në SHSKUK mund të shfrytëzohen, si në vijim:

6.1. Shtetasit dhe banorët e përcaktuar me nenin 59 të këtij ligji do të shfrytëzojnë këto shërbime pa pagesë;

6.2. Të gjithë shtetasit dhe banorët e tjerë do t'i shfrytëzojnë këto shërbime duke marrë pjesë në koston e trajtimit nëpërmjet bashkë-pagesës vlera e të cilës do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria, në pajtim me nenin 58 të këtij ligji;

6.3. Qytetarët dhe banorët të cilët janë klientë të kompanive të huaja (private ose publike), ose vendore (private) të sigurimeve shëndetësore do t'i shfrytëzojnë këto shërbime bazuar në statusin e tyre të dokumentuar të sigurimit shëndetësor;

* * * *

Neni 75

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Profesionistët shëndetësorë obligohen që të marrin pjesë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes së kualifikimeve të tyre profesionale.
2. Institucionet shëndetësore janë të obliguara që të mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë, në pajtim me këtë ligj dhe aktet e përgjithshme të institucionit.
3. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dokumentohet me Kredit e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) të evidentuara në portfolion personale.
4. Numri i krediteve të ZHVP, llojet e trajnimeve, legjitimiteti i institucioneve për të ofruar kredite të ZHVP, dhe çështjet e tjera relevante për zhvillimin e vazhdueshëm profesional do të jenë në autoritetin e Odës përkatëse të profesionistëve shëndetësorë nga neni 78 i këtij ligji.

* * * *

KREU XXI
DISPOZITAT DISIPLINORE DHE GJYQËSORE

Neni 93
Vërejtja me shkrim

1. Institucionit shëndetësor do t'i shqiptohet vërejtja me shkrim nga ana e Inspektoratit Shëndetësor, në rastet kur konstatohet:

- 1.1. shkelja e kodit të etikës mjekësore;
- 1.2. shkelja e normave të sigurisë teknike dhe mjekësore;
- 1.3. shkelja e detyrimeve të përcaktuara gjatë grevës;
- 1.4. lëshimet gjatë mjekimit;
- 1.5. mos-sigurimi i kushteve dhe mos-zbatimi i masave të kujdesit shëndetësor;
- 1.6. marrëdhënie jo-korrekte me qytetarin.

2. Institucioni shëndetësor dhe Drejtori i tij që nuk i binden vërejtjes me shkrim i nënshtrohen masave ndëshkimore, të përcaktuara me nenin 94 të këtij ligji.

Neni 94
Sanksionet për shkelje administrative dhe kundërvajtje

1. Institucioni shëndetësor dënohet me gjobë prej dymijë (2.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro për shkelje administrative dhe për kundërvajtje, në rastet në vijim:

- 1.1. ushtron veprimtarinë pa përmbushur kushtet nga neni 40 të këtij ligji;
- 1.2. shkelë dispozitën e paragrafit 3. neni 41 të këtij ligji duke bërë referim jo të ligjshëm të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;
- 1.3. ushtron veprimtarinë pa licencë valide të punës duke shkelë paragrafin 1. të nenit 42 të këtij ligji;
- 1.4. nuk kujdeset për të dhënat shëndetësore të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore në pajtim me nenin 52 të këtij ligji;
- 1.5. nuk siguron qasje në të dhënat sipas paragrafit 1. të nenit 53 të këtij ligji;
- 1.6. nuk siguron konstatimin e vdekjes dhe përcaktimin e shkakut të vdekjes në pajtim me paragrafin 4. të nenit 82 të këtij ligji;
- 1.7. nuk i siguron kushtet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësor të punësuar nga institucioni, nga neni 75 i këtij ligji;
- 1.8. nuk siguron kujdesin shëndetësor gjatë grevës, nga neni 80 dhe neni 81 të këtij ligji;
- 1.9. nuk harmonizon organizimin dhe aktet normative me këtë ligj, sipas nenit 96 të këtij ligji;
- 1.10. nuk i siguron kushtet për mbikëqyrje ose e pengon organin e autorizuar nga neni 47 i këtij ligji në kryerjen e detyrës së tij, në pajtim me ligjin;

1.11. nuk i bindet vërejtjes më shkrim.

2. Personi përgjegjës në institucionin shëndetësor dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro për shkelje të dispozitave nga:

2.1. neni 40 dhe neni 42 për ushtrimin e veprimtarisë pa i përmbushur kushtet ligjore të përcaktuara me këtë ligj;

2.2. neni 41 i këtij ligji për parandalimin e konfliktit të interesit;

2.3. neni 52 i këtij ligji për ruajtjen e të dhënave të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;

2.4. paragrafi 1. neni 53 i këtij ligji për mos sigurimin e qasjes ligjore në të dhënat shëndetësore;

2.5. neni 68 i këtij ligji për zhvillimin e vazhdueshëm profesional;

2.6. neni 80 dhe neni 81 të këtij ligji për sigurimin e kujdesit shëndetësor gjatë grevës;

2.7. paragrafi 4. neni 82 i këtij ligji për konstatimin e vdekjes;

2.8. paragrafi 2. neni 83 i këtij ligji për përcaktimin e shkakut të vdekjes me obduksion;

2.9. neni 96 të këtij ligji për harmonizimin e organizimit dhe akteve normative me këtë ligj.

3. Profesionisti shëndetësor dënohet me marrje të licencës së punës në kohëzgjatje prej:

3.1. gjashtë (6) muaj kur shkel dispozitat e paragrafit 1. të nenit 41 të këtij ligji për referim jo të ligjshëm;

3.2. një (1) viti kur shkel dispozitat e paragrafit 2. të nenit 41 të këtij ligji duke pranuar shpërblim jo të ligjshëm financiar ose tjetër;

3.3. gjashtë (6) muaj kur shkel dispozitat e paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji duke mos zbatuar raportimin e të dhënave në pajtim me këtë ligj;

4. Profesionisti shëndetësor dënohet me gjobë prej njëmijë (1000) deri në dymijë (2.000) Euro në rastet e kundërvajtjeve, kur:

4.1. ndërmerr trajtim pa leje të qytetarit ose të banorit apo të personit të autorizuar nga ai, duke shkelur dispozitat e aktit ligjor nga neni 4 i këtij ligji përveç në rastet emergjente kur vihet në rrezik jeta e tij;

4.2. ofron barëra për qytetarët ose banorët pa recetë në kundërshtim me paragrafin 2. Të nenit 26 të këtij ligji;

4.3. ushtron veprimtarinë shëndetësore pa licencë valide të punës në kundërshtim me paragrafin 3. të nenit 71 të këtij ligji;

4.4. ushtron kujdesin shëndetësor duke mos iu përmbajtur parimeve etike dhe profesionale;

4.5. ofron barin për shfrytëzuesin e shërbimeve shëndetësore pa recetë, në kundërshtim me paragrafin 2. të nenit 62 të këtij ligji.

4.6. përcakton çmimin e shërbimit shëndetësor jashtë çmimoreve të përcaktuara.

5. Mjetet e mbledhura nga gjobat paraqesin të hyra në Buxhetin e Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

* * * *

KREU XXII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

* * * *

Neni 99

1. Kontraktimi i shërbimeve me ofruesit e shërbimeve do të fillojë vetëm pasi që:

- 1.1. të jetë definuar lista e shërbimeve që do të kontraktohen;
- 1.2. të jetë përcaktuar çmimi i çdo shërbimi;
- 1.3. të definohet vëllimi i shërbimeve që do të kontraktohen;
- 1.4. të përcaktohet kostoja totale e shërbimeve që do të kontraktohen; dhe
- 1.5. të alokohen mjetet financiare brenda alokimit buxhetor (pas kalkulimit të të hyrave nga bashkë-pagesat).

2. Lista e barërave dhe materialeve harxhuese do të definohet dhe hynë në fuqi vetëm pasi që të vlerësohet ndikimi i saj fiscal dhe pasi që të jenë alokuar mjetet financiare brenda alokimit buxhetor (pas kalkulimit të të hyrave nga bashkë-pagesat).

Neni 100

Qeveria dhe Ministria, brenda një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, do t'i nxjerrin aktet nënligjore, të parapara me këtë ligj.

Neni 101

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen: Ligji i shëndetësisë Nr. 2004/4; Ligji Nr.03/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shëndetësi; Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi Nr. 2004/50; dhe dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 102 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-125
13 dhjetor 2012**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-018-2013, datë 26.04.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MSh) NR.06/2015 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA SPITALORE

(EKSTRAKT)

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë:

Në mbështetje të nenit 25 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi, nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare NR. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.06/2015 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA SPITALORE

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ rregullon: organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë shëndetësore në spital.

Neni 2 Fusha e veprimit

Ky Udhëzim Administrativ rregullon kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për kryerjen e veprimtarisë shëndetësore në spital nga profesionistët shëndetësor të licencuar.

Neni 3 Spitali

1. Spitali është institucion shëndetësor që ofron shërbim të kujdesit shëndetësor ambulator, diagnostifikim, stacionar, trajtim dhe rehabilitim 24 orësh.
2. Spitali sipas pronësisë është publik, privat dhe publiko-privat.

Neni 4 Llojet e spitaleve

1. Spitalet në Kosovë varësisht nga lloji i shërbimeve që ofrojnë janë:
 - 1.1. Spital i përgjithshëm;
 - 1.2. Spital special.

Neni 5 Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ, zbatohen përkufizimet e përcaktuara me Ligjin Nr. 04L-125 Për Shëndetësi dhe përkufizimet e mëposhtme:
 - 1.1. **Spital i Përgjithshëm:** është institucion shëndetësor i cili ofron shërbime të kujdesit shëndetësor multidisiplinar.

1.2. **Spital Special:** është institucion shëndetësor që ofron shërbime shëndetësore të specializuara në një deri tri fusha mjekësore të ndërlidhura në linjën specialistike dhe subspecialistike profesionale.

Neni 6 Lokacioni i spitalit

1. Objekti spitalor duhet t'i plotësoj këto kushte:

- 1.1. Vend me qasje të lehtë;
- 1.2. Kriteria hapësinore dhe urbanistike;
- 1.3. Mirëmbajtje ambient të sigurtë për pacient, personel dhe publikun.

Neni 7 Kushtet e përgjithshme spitalore

1. Objekti spitalor ku zhvillohet veprimtaria shëndetësore duhet të ndërtohet në përputhje me standardet ndërtimore të rregulluara me Ligjin për Ndërtimin dhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë çështjet e ambientit.

1.1. Mirëmbajtja e hapësirës spitalore:

- 1.1.1. Meremetimi dhe mirëmbajtja në mënyrë të rregullt;
- 1.1.2. Dyshemetë, muret dhe tavanet të jenë në harmoni me standardet ndërtimore për Institutet Shëndetësore;
- 1.1.3. Që pastrohen lehtë, që kanë qëndrueshmëri ndaj temperaturave të larta dhe zjarrit;
- 1.1.4. Dritaret të jenë të vendosura për sigurimin e dritës së mjaftueshme;
- 1.1.5. Hapësirat dhe korridoret qarkulluese duhet të jenë të gjëra, të lira dhe çdo herë në dispozicion për lëvizje të lirë të pacientëve qoftë me shtretër, barelë, apo karroca.

1.2. Qasja në hapësirën spitalore:

- 1.2.1. Dyert e hyrje-daljeve për qasje të lehtë dhe në përputhshmëri me standardet ndërtimore;
- 1.2.2. Dalje emergjente nga spitali;
- 1.2.3. Ashensor dhe qasje të lehtë për pacient me shtrat dhe për personat me aftësi të kufizuara.

* * * *

Neni 8 Standardet dhe Radhitja e hapësirave spitalore

1. Hapësirat e spitalit duhet të jenë të lidhura me njëra tjetrën, funksionale dhe të radhitura sipas zonave:

* * * *

3. Veprimtaritë specialistike të degëve operative mund të kenë hapësira të përbashkëta të bllokut operativ, nëse këtë e mundësojnë kushtet teknike-ndërtimore dhe ato të hapësirës së komunikimit në objektin ku janë të vendosura:

* * * *

3.6. Hapësira për personat me aftësi të kufizuara 8 m²;

* * * *

Neni 24
Shërbimi i ambulancave specialistike spitalore

* * * *

3. Pajisjet bazë dhe inventari për ambulancat specialistike për pacientët jashtë-spitalor janë:

3.1. Karrocë për transport të pacientëve në pozitë ulur;

* * * *

Neni 51
Detyrat dhe obligimet e spitaleve

1. Spitali obligohet të:

1.1. Zbatojë dispozitat juridike lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

1.2. Zbatoj standardet e miratuara në sektorin e shëndetësisë.

1.3. Nxjerrjen e statutit.

1.4. Vendos në vend të dukshëm listën e çmimeve për shërbimet që ofron.

* * * *

1.8. Sigurojë qasje për personat me aftësi të kufizuara.

* * * *

1.23. Vendosjen e kartës së të drejtave dhe përgjegjësive të pacientit sipas kushteve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 15/2013 Karta e të drejtave dhe përgjegjësive të pacientit,

* * * *

1.24. Të bëjë hetime lidhur me pohimin në ankesë të pacientit dhe të informoj në afat prej dhjetë (10) ditëve në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 19/2013 Linja telefonike për ankesat e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve telefonike.

* * * *

Neni 59
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë 10./07/2015

Ministri Shëndetësisë

Dr. Imet Rrahmani

UDHËZIMI ADMINISTRATIV 15/2013
Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Pacientit

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,

Ministria e Shëndetësisë, në mbështetje të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, në funksion të zbatimit të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor Nr.2004/38, në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 (1,4) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Shtojca 9 si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV 15/2013
Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Pacientit

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet obligimi i Institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësor në respektimin e të drejtave të pacientëve.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga Institucionet shëndetësore të kujdesit parësor, dytësor, tretësor dhe profesionistët shëndetësor.

Neni 3
Obligimet e Institucioneve shëndetësore

Obligohen Institucionet shëndetësore të kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor që të vendosin Shtojcën një (1) Karta e të drejtave të pacientit dhe Shtojcën dy (2) Karta e përgjegjësi të pacientit, në vend të dukshëm, në pritore dhe dhomat e pacientëve.

Neni 4

1. Institucionet shëndetësore të kujdesit parësor Shtojcën një (1) dhe Shtojcën dy (2) do ta vendosin në pritore të pacientëve.
2. Institucionet shëndetësore të kujdesit dytësor Shtojcën një (1) dhe Shtojcën dy (2) do ta vendosin në pritore dhe dhomat e pacientëve.
3. Institucionet shëndetësore të kujdesit tretësor Shtojcën një (1) dhe Shtojcën dy (2) do ta vendosin në pritore dhe dhomat e pacientëve.

Neni 5
Sanksionet administrative

1. Shkelja e dispozitave të Shtojcës një (1) Karta e të drejtave të pacientit, përbën sanksion administrativ dhe dënohet me gjobë si në vijim:
 - 1.1. Institucioni shëndetësor dënohet me gjobë prej **500 €** (pesëqind euro);
 - 1.2. Personi përgjegjës i Institucionit shëndetësor dënohet me gjobë prej **200€** (dyqind euro);

- 1.3. Profesionisti shëndetësor dënohet me gjobë prej **100 €** (njëqind euro).
2. Për shkelje të nenit 4 institucioni shëndetësor dënohet me gjobë prej **200 €** (dyqind euro).
3. Për shkelje të nenit 4 personi përgjegjës i institucionit shëndetësor dënohet me gjobë prej **100 €** (njëqind euro).

Neni 6

Shtojca një (1) Karta e të drejtave të pacientit dhe Shtojca dy (2) Karta e përgjegjësive të pacientit, janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 7

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.01/2003 Karta e të drejtave të pacientit.

Neni 8

Dispozitat e hyrjes në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prof. Dr. Ferid Agani

Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës

Datë: 13.08.'13

Shtojca 1

Karta e të Drejtave të pacientit

1. E drejta për masa parandaluese

Çdo qytetar ka të drejtë për shërbim të duhur shëndetësor me qëllim të parandalimit të sëmundjeve.

2. E drejta e qasjes

Çdo qytetari duhet t'i sigurohet e drejta e qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore pa asnjë diskriminim.

3. E drejta për informim

Çdo qytetar ka të drejtë për qasje në të gjitha informatat në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore, me shërbimet shëndetësore dhe si mund t'i shfrytëzoj ato.

4. E drejta për zgjedhjen e lirë

Çdo qytetar ka të drejtën e dhënies së pëlqimit në vendimet që kanë të bëjnë me shëndetin e tij (familjari ose kujdestari i tij në qoftë se gjendja e tij nuk lejon); ky informacion është parakusht për çdo procedurë dhe trajtim, duke përfshirë pjesëmarrjen në kërkim shkencor.

5. E drejta për zgjedhjen e lirë

Qytetari ka të drejtë që të konsultohet dhe të trajtohet nga mjeku të cilin e zgjedh vetë me pëlqimin e institucionit shëndetësor, brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe rregullat operative të institucionit.

6. E drejta për privatësi dhe konfidencialitet

Çdo qytetar ka të drejtën e konfidencialitetit të informatave personale, duke përfshirë informatat lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe procedurat e mundshme diagnostike ose terapeutike.

7. E drejta për respektimin e kohës së pacientit

Çdo qytetar ka të drejtë të marr trajtimin e domosdoshëm brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Kjo e drejtë aplikohet në çdo fazë të trajtimit.

8. E drejta për qasje në shërbimet cilësore

Çdo qytetar ka të drejtë të ketë qasje në shërbime shëndetësore duke u bazuar në standardet e cilësisë së lartë.

9. E drejta për sigurinë

Çdo qytetar ka të drejtën për të mos u dëmtuar nga keqfunksionimi i shërbimeve shëndetësore, praktikat jo të përshtatshme dhe gabimet mjekësore. Poashtu ka të drejtën e qasjes në shërbimet shëndetësore dhe trajtimet të jenë të sigurta.

10. E drejta për risi

Çdo qytetar ka të drejtë të ketë qasje në procedurat e reja diagnostike sipas standardeve ndërkombëtare.

11. E drejta për shmangie të vuajtjeve dhe dhimbjeve

Çdo qytetar ka të drejtë për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur dhimbjen dhe vuajtjen në çdo fazë të sëmundjes së tij.

12. E drejta për trajtim personal

Çdo qytetar ka të drejtë për trajtim diagnostik ose terapeutik të përshtatur për nevojat e tij personale.

13. E drejta e ankesës

Çdo qytetar ka të drejtën për t'u ankuar sa herë që pëson dëm fizik, moral dhe psikologjik. Poashtu ka të drejtë për të marrë përgjigje në ankesën e tij.

14. E drejta e ankesës përmes telefonit

Çdo qytetar ka të drejtën të paraqesë ankesë përmes lidhjes telefonike **Nr.080017777**, falas gjatë **24** orëve në Ministrinë e Shëndetësisë.

15. E drejta për kompensim

Çdo qytetar ka të drejtë të marrë kompensim brenda një afati të caktuar kohor sa herë që ka pësuar dëm fizik, moral ose psikologjik të shkaktuar gjatë trajtimit shëndetësor, në pajtim me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor.

Shtojca 2

Karta e përgjegjësisë të pacientit

1. Nëse e lejon gjendja shëndetësore e qytetarit, varësisht nga aftësitë dhe njohuritë e tij duhet të bashkëpunojë me profesionistët shëndetësor, të përfshirë në trajtimin mjekësor, në mënyrat në vijim:

a. informimi mbi të gjitha detajet e domosdoshme për përcaktimin e diagnozës, posaçërisht informimi i profesionistëve shëndetësor, për çdo sëmundje të mëhershme, trajtimin shëndetësor, përdorimin e barnave si dhe për afinitetin e tij ndaj faktorëve të rrezikshëm, që mund të dëmtojnë shëndetin;

b. informimi për çdo detaj në lidhje me sëmundjen e tij, që mund të rrezikojë sigurinë jetësore, fizike të të tjerëve, në veçanti mbi ndonjë sëmundje ngjitëse apo ndonjë gjendje që e përjashton atë nga ushtrimi i profesionit;

c. t'u përmbahet udhëzimeve, të marra në lidhje me trajtimin mjekësor;

d. respektimi i rregullave operative të Institucionit shëndetësor;

e. përmbushja e obligimeve (të pagesave) për shërbimet e pranuar;

f. prezantimi i provave të besueshme për të dhënat personale.

2. Gjatë ushtrimit të të drejtave të qytetarit, ai ose të afërmit e tij, duhet të respektojë të drejtat e qytetarëve të tjerë.

3. Gjatë ushtrimit të të drejtave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, ndalohej që qytetari ose të afërmit e tij t'i cenojnë të drejtat e personelit shëndetësorë.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (Shëndetësi) NR.19/2013
LINJA TELEFONIKE PËR ANKESAT E QYTETARËVE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 24 të Ligjit NR.2004/38 Për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr.15, 12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (Shëndetësi) NR.19/2013
LINJA TELEFONIKE PËR ANKESAT E QYTETARËVE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vënja në përdorim e linjës telefonike njëzetekatërorësh (24) falas për ankesat e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore (në vijim Linja telefonike), që do të jetë në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjes së qytetarëve nga keqtrajtimi gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore, si dhe identifikimit të profesionistëve shëndetësorë dhe institucioneve shëndetësore që bëjnë shkelje ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet në të gjitha institucionet shëndetësore pa dallim pronësie dhe niveli të organizimit.

Neni 3
Linja telefonike

1. Linja telefonike është në shërbim të të gjithë qytetarëve në Republikën e Kosovës.
2. Ministria e Shëndetësisë themelon shërbimin e veçantë për menaxhimin e Linjës telefonike në kuadër të Njesisë për të Drejtat e Njeriut.
3. Numri i Linjës telefonike do të jetë publik.
4. Të gjitha thirrjet në Linjën telefonike regjistrohen gjatë 24 orëve, shtatë (7) ditë në javë.
5. Thirrësi në Linjën telefonike mund të mbetet anonim dhe sipas dëshirës mund të shkruaj edhe në e-mail adresën: linjafalas@rks-gov.net ose on-line nw <https://www.msh-ks.org> (do të jenë publike).
6. Gjatë menaxhimit të Linjës telefonike Njësia për të Drejtat e Njeriut bashkëpunon ngusht me Inspektoratin Shëndetësor.

7. Zyrtari përgjegjës i shërbimit nga paragrafi 2 i këtij neni obligohet që secilën ankesë ta analizojë në aspektin e përmbushjes së kriterëve për procedimin e mëtejshëm, dhe ta procedoj atë tek Inspektorati Shëndetësor nëpërmjet Drejtorit të Departamentit të cilit i përgjigjet.

Neni 4 **Shkëmbimi i informative**

1. Njësitë organizative të Ministrisë së Shëndetësisë, profesionistët shëndetësorë dhe institucionet shëndetësore bashkëpunojnë gjatë shqyrtimit të ankesave të qytetarëve në shërbimet shëndetësore duke ofruar informatat e duhura kthyes brenda shtatëdhjetë (72) orëve prej parashtrimit të kërkesës.

2. Informata kthyes nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të sigurohet nga zyrtari në njësinë organizative të Ministrisë së Shëndetësisë ose në rastin e institucionit shëndetësor, nga zyrtari që këtë duhet ta ketë si përgjegjës të përcaktuar me përshkrimin e vendit të punës.

Neni 5 **Ankesa e qytetarit**

1. Qytetari ka të drejtë të parashtojë ankesë ndaj profesionistit ose institucionit shëndetësor përkitazi me shërbimet e ofruara shëndetësore në Linjën telefonike jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas shkaktimit të dëmit ose pakënaqësisë që është subjekt i ankesës.

2. Për tu proceduar në inspektoratin shëndetësor ankesa duhet të përmbushë kriteret si në vijim:

2.1. Nga telefonata duhet të kuptohet qartë se kush është subjekti i specifikuar i ankesës (profesionisti ose institucioni shëndetësor) si dhe veprimi ose mos-veprimi që është subjekt i ankesës;

2.2. Nga telefonata duhet të kuptohet qartë koha dhe vendi që ka të bëjë me subjektin e ankesës;

2.3. Duhet të ekzistojë së paku një e dhënë rrethanore përkitazi me rastin që do të mund të jetë subjekt i verifikimit nga ana e inspektoratit shëndetësor, psh., emri i profesionistit shëndetësor, emri i pacientit, ose emri i dëshmitarit të ngjarjes.

2.4. Identiteti i thirrësit në Linjën telefonike nuk është kusht për procedimin e ankesës.

3. Inspektorati shëndetësor duhet të informojë menjëherë institucionin përkatës shëndetësor përkitazi me ankesën.

4. Institucioni përkatës shëndetësor duhet të bëjë hetimin lidhur me pohimet në ankesë dhe duhet ta informoj inspektoratin shëndetësor mbi rezultatet e hetimeve me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve të punës.

5. Inspektorati shëndetësor duhet të raportoj çdo muaj tek Ministri i Shëndetësisë përkitazi me ankesat e qytetarëve, si dhe hetimet dhe masat e ndërmarra përkitazi me to.

Neni 6 **Komisioni për mbikëqyrjen e punës së shërbimit të Linjës telefonike**

1. Ministri i Shëndetësisë emëron Komisionin për mbikëqyrjen e punës së Linjës telefonike.

2. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet nga tre (3) anëtarë:

2.1. Drejtori i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë;

2.1.1. Shefi i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;

2.1.2. Kryetari i Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve, që është e përfaqësuar në Bordin Mbikëqyrës të Agjencionit të Financimit Shëndetësor.

3. Komisioni ka mandat katër (4) vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një (1) mandat.
4. Në rast të ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të Komisionit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në institucionet prej nga vijnë, zëvendësimi i tyre bëhet me vendim të Ministrit të Shëndetësisë me anëtarë të cilët i zëvendësojnë në funksionet e tyre, në pajtim me ligjin.
5. Komisioni përgatit raporte të rregullta për Ministrin e Shëndetësisë çdo tre (3) muaj dhe sipas kërkesës edhe më shpesh.
6. Komisioni nga paragrafi i 1 i këtij neni realizon veprimtarinë e tij në bazë të Rregullores së Punës të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 7 Promovimi

Ministria e Shëndetësisë obligohet që të bëjë promovimin e rregullt të Linjës telefonike çdo tre (3) muaj nëpërmjet mjeteve të informimit.

Neni 8 Raportimi dhe monitorimi

1. Zyrtari përgjegjës për Linjën telefonike raporton çdo muaj në Inspektoratin Shëndetësor dhe në Njësinë për të Drejtat e Njeriut, si dhe sipas nevojës në rast të kërkesës nga Ministri i Shëndetësisë.
2. Monitorimin e rregullt të funksionimit të Linjës telefonike e bënë Inspektorati Shëndetësor.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë.

Ferid Agani

**Ministër i Shëndetësisë i Republikës së
Kosovës**

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.03/2012 PËR MENAXHIMIN E MATERIALIT TË INKONTINENCËS
PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Ministria e Shëndetësisë,

Në mbështetje të Kushtetutës të Republikës së Kosovës neni 16, dhe nenit 22.2. të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 2004/4, Ministria e Shëndetësisë nxjerrë:

Udhëzim Administrativ Nr. 03/2012 Për Menaxhimin e Materialit të Inkontinencës Për Personat me Aftësi të Kufizuara

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ofrimi i materialit për menaxhimin e inkontinencës për personat me aftësi të kufizuara të cilët lëngojnë nga sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet të cilat e rrezikojnë seriozisht ose e vështirësojnë jetën e tyre.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet në Institucionet publike shëndetësore të:

1.1. Kujdesit parësor;

1.2. Kujdesit dytësor;

1.3. Kujdesit tretësor;

**Neni 3
Shërbimet Shëndetësore**

Personave me aftësi të kufizuara ju ofrohen të gjitha ato shërbime shëndetësore të nevojshme, të cilat i ofron Institucioni përkatës sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 4

Grumbullimi, deponimi dhe distribuimi i materialit për inkontinencë është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë.

**Neni 5
Materiali për inkontinencë**

Ministria e Shëndetësisë siguron materialin për inkontinencë për personat me aftësi të kufizuar, i cili është i bashkangjitur në Shtojcën nr. 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 6

Vlerësimi i nevojave të materialit për inkontinencë për personat me aftësi të kufizuar bëhet nga Komisioni vlerësues, ku pjesë e këtij Komisioni duhet të jetë edhe një anëtar nga Organizata e personave me aftësi të kufizuara (OPAK)

Neni 7

1. Komisioni për vlerësimin e nevojave të materialit për inkontinencë ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe plotësimin e nevojave, si dhe të kostos buxhetore të materialit për inkontinencë.
2. Kompenzimi për punën e anëtarëve të Komisionit vlerësues bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 8

Për emërimin e këtij Komisioni është kompetent Ministria e Shëndetësisë.

Neni 9

Shtojca 1 është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë,
29.06/2012

Ministri i Shëndetësisë
Ferid Agani

SHTOJCA 1

1. Kateter permanent, intermitent për moshën e të rriturve femra dhe meshkuj ;
2. Kateter permanent, intermitent për fëmijë;
3. Kondom urinar – penillex ;
4. Qese urinare, të gjata dhe të shkurtëra ;
5. Gel për kateter ;
6. Dezinfektues për kateter ;
7. Collostom, Urostom ,
8. Uji të destiluar
9. Jod në litër

(EKSTRAKT)

LIGJI NR. 04/L -249

PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është sigurimi i qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelore shëndetësore, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore; si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Qytetar** - personi me shtetësi të Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Shtetësinë e Kosovës, dhe personin e kualifikuar si refugjat në pajtim me ligjin;

1.2. **Banor** - bartësi i lejes së qëndrimit të lëshuar nga autoriteti kompetent për territorin e Republikës së Kosovës dhe personin që ka aplikuar për njohjen e statusit të refugjatit;

1.3. **Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejme Fondi)** - institucionin publik të sigurimit shëndetësor me statusin e personit juridik me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta për zbatim të këtij ligji në emër të siguruarve përfshirë mbledhjen efektive të mjeteve financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë;

1.4. **I siguruari** - personi i cili mund të dëshmoj se që është i përfshirë me sigurim shëndetësor;

1.5. **Anëtarë të familjes së ngushtë** - në kuptim të këtij ligji konsiderohen: bashkëshorti/ja, prindërit, fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përfshirë fëmijët e adoptuar, thjeshtri/a, njerku/a;

1.6. **I punësuar** – personi fizik që kryen punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin;

1.7. **Punëdhënës** - personi fizik ose juridik i cili i siguron punë të punësuarit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera;

1.8. **Kujdesi shëndetësor** - masat dhe veprimet që ndërmerren nga organizatat, institucionet, dhe profesionistët shëndetësorë, që për qëllim parësor kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve dhe të banorëve;

1.9. **Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor** - Listat e formave dhe llojeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që mbulojnë me sigurimin e obligueshëm shëndetësor nëpërmjet Fondit duke përfshi barnat dhe materialin harxhues që rimburohet;

1.10. **Lista e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Plotësues** - Listat e shërbimeve shëndetësore që nuk janë pjesë e Listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor;

1.11. **Shërbimi emergjent shëndetësor** - shërbimin shëndetësor që ofrohet në rrethanat e ndryshimit të përnjëhershëm të gjendjes shëndetësore të qytetarit ose të banorit, në mungesë të cilit rrezikohet jeta ose dëmtohet seriozisht shëndeti i tij;

1.12. **Rimbursimi** - pagesa nga Fondi për shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor të dedikuara për të siguruarit të regjistruar në të, sipas akteve normative të nxjerra nga Fondi;

1.13. **Bashkë-financimi** - bashkë-sigurimin ose pagesën e kryer në formë të pjesëmarrjes në çmimin e shërbimit shëndetësor të mbuluar me sigurim nga bartësi i policës së sigurimit shëndetësor i cili sipas ligjit nuk është i liruar nga bashkë-financimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor;

1.14. **Pagesa e premiumit** - shuma mujore, tre (3) mujore ose vjetore për sigurim shëndetësor që paguhet në Fond;

1.15. **Agjensioni i Financimit Shëndetësor** - Agjensioni ekzekutiv nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë, para-ardhës i Fondit publik të Kosovës për sigurime shëndetësore, që në emër të shtetit realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me kontraktimin dhe blerjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si edhe grumbullimin e të gjitha mjeteve financiare të Fondit për këtë qëllim, deri në themelimin e Fondit me këtë ligj;

1.16. **Periudha e pritjes** - periudha gjatë të cilës qytetari ose banori nuk arrin të paguaj premiumin e sigurimit shëndetësor gjatë tre (3) muajve radhazi;

1.17. **Emërtimi gjenerik** - emërtimi i pambrojtur ndërkombëtar i barit ose materialit shpenzues medicinal.

Neni 4 Parimet

1. Parimet themelore mbi të cilat ky ligj do të zbatohet janë:

1.1. transparenca e marrëdhënieve kontraktuale;

- 1.2. qëndrueshmëria e shërbimeve të kontraktuara shëndetësore;
- 1.3. barazia e qytetareve dhe banorëve;
- 1.4. llogaridhënia e bartësve të institucioneve të kontraktuara shëndetësore dhe autoriteteve të fondit;
- 1.5. qasja universale ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor;
- 1.6. solidariteti i qytetarëve dhe banorëve si dhe punëdhënësve;
- 1.7. reciprociteti në marrëdhëniet bilaterale me shtetet dhe fondet tjera;
- 1.8. përgjegjësia individuale me rastin e vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale;
- 1.9. qasja e lehtë deri të institucionet e kontraktuara shëndetësore;
- 1.10. efikasiteti i funksionimit të fondit;
- 1.11. mbrojtja nga rreziku financiar i qytetarëve dhe banorëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Neni 5

Format e sigurimeve shëndetësore

Sigurimet shëndetësore në Republikën e Kosovës organizohen dhe zbatohen si sigurime shëndetësore të obligueshme dhe sigurime shëndetësore vullnetare.

Neni 6

Sigurimi shëndetësor i obligueshëm

1. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm është e drejtë dhe detyrim për të gjithë qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës.
2. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor të ofruara në bazë të parimeve nga neni 4 i këtij ligji.
3. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm ofrohet vetëm nga Fondi.

Neni 7

Shërbimet e garantuara shëndetësore

1. Pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor do të ofrohen:
 - 1.1. shërbimet emergjente të kujdesit shëndetësor;
 - 1.2. shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare nga Lista e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor; si dhe,
 - 1.3. shërbimet esenciale shëndetësore për shtatzënat dhe lehonat;
 - 1.4. shërbimet e tjera esenciale të kujdesit shëndetësor të përcaktuara nga Fondi.

Neni 8

Sigurimi shëndetësor vullnetar

1. Qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës, punonjësit e huaj në Republikën e Kosovës, si dhe të gjithë të tjerët, kanë të drejtë të kenë sigurim shëndetësor vullnetar plotësues.
2. Sigurimi shëndetësor vullnetar plotësues nuk mund të zbatohet politika komplementare e dispozita që rregullojnë bashkë-financimin e sigurimit të obligueshëm shëndetësor.
3. Sigurimi shëndetësor vullnetar plotësues realizohet nëpërmjet kontratës individuale në mes të siguruarit vullnetar ose/dhe përfaqësuesit të tij të emëruar ligjor, dhe kompanisë private të sigurimeve shëndetësore, në pajtim me ligjin.
4. Regjistrimi në sigurimin shëndetësor vullnetar plotësues për shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor në agjencionet private të sigurimeve shëndetësore nuk e hjek detyrimin e obligueshëm të qytetarit, banorit, punëdhënësit dhe të punësuarit, për pagesën detyimore të premiumit për sigurimin e obligueshëm shëndetësor në Fond, në pajtim me këtë ligj.

Neni 9

Bartja e të drejtës

E drejta në sigurim shëndetësor të obligueshëm nuk mund të bartet të personi tjetër fizik dhe entiteti juridik; Nuk mund të ndryshohet me kontratë, dhe nuk mund të tjetërsohet.

Neni 10

Pjesëmarrja në shpenzime

Të siguruarit, marrin pjesë në shpenzimet e kujdesit shëndetësor themelor nëpërmjet bashkë-financimit dhe premiumeve, në pajtim me ligjin.

KREU II

Neni 11

Të siguruarit e obliguar

1. Sipas këtij ligji, të siguruar në mënyrë të obligueshme janë:
 - 1.1. të gjithë qytetarët dhe banorët, të cilët kanë bërë pagesën e premiumit për sigurimin shëndetësor të obligueshëm;
 - 1.2. anëtarët e familjes së ngushtë të qytetarëve ose banorëve të cilët kanë paguar premiumet e sigurimit të obligueshëm shëndetësor dhe të cilët janë të punësuar në sektorin publik ose janë të punësuar në sektorin privat ose publiko-private në kompanitë e regjistruara për TVSH me qarkullim vjetor prej pesëdhjetë mijë (50.000) Euro ose më shumë;
 - 1.3. qytetarëve ose banorëve të cilët janë të liruar nga obligimi për të paguar këtë premium, në pajtim me këtë ligj.
2. Personat e liruar nga pagesa e premiumit dhe bashkë-financimi janë qytetarët dhe banorët, si në vijim:
 - 2.1. familjet e varfra nën asistencë sociale - të gjithë anëtarët e familjes;
 - 2.2. të burgosurit të cilët janë dënuar;

2.3. individët të cilët janë duke jetuar në institucione shtetërore -fëmijët nën kujdes të sforcuar dhe nën kujdestari, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara të strehuar në shtëpitë për persona të moshuar si dhe në shtëpitë për integrim në komunitet;

2.4. personat e ri-atdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas ri-atdhesimit;

2.5. invalidët e luftës, bashkëshorti/ja dhe fëmijët e tyre nën tetëmbëdhjetë (18) vjet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi;

2.6. viktimat e trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin;

2.7. banorët e përhershëm të vend-banimeve joformale në Kosovë të cilët nuk janë të regjistruar ose të cilët janë në proces të regjistrimit deri në fund të procesit të regjistrimit, ose deri në një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çfarëdo realizohet e para;

2.8. viktimat e dhunës në familje gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me ligjin.

3. Qytetarët dhe banorët nga kategoritë në vijim do të lirohen nga pagesa e premiumit, bashkë-pagesave, dhe detyrimeve të tjera të bashkë-financimit vetëm nëse identifikohen si të varfër sipas kriteriumeve të testit zyrtar, të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerr bashkërisht nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Ministria e Financave, përveç në rastet kur zbatohen konventat ndërkombëtare:

3.1. pensionistët e moshës dhe ata kontribut-dhënës;

3.2. pensionistët e kompanisë "Trepça";

3.3. pensionistët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës;

3.4. anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve;

3.5. veteranët e luftës si dhe bashkëshortja/i dhe fëmijët e tyre;

3.6. ish të burgosurit politik si dhe bashkëshortja/i dhe fëmijët e tyre;

3.7. anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës;

3.8. viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi;

3.9. personat me aftësi të kufizuar;

3.10. studentët.

Neni 12 **Pagesa e premiumeve**

1. Premiumet në Fond do të fillojnë të paguhen në datën që do të përcaktohet me akt nën-ligjor të nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë, pasi që të jenë plotësuar parakushtet për zbatimin e sigurimit shëndetësor të specifikuar në nenin 38 të Dispozitave Kalimtare të këtij ligji.

2. Personi i cili nuk arrin të paguaj premiumin gjatë tre (3) muajve radhazi - "periudha e pritjes", i ndërpritet mbulesa me sigurim shëndetësor nga Fondi.

3. Për të ripërtëri mbulimin me sigurim, para se të fillohet shfrytëzimi i të drejtave nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm, premiumin duhet të paguhet me kohë për të paktën tre (3) muaj radhazi pa ndërprerje ose për gjashtë (6) muaj me ndërprerje brenda dymbëdhjetë (12) muajve të fundit.
4. Personi i cili e shfrytëzon periudhën e pritjes më shumë se tri (3) herë në pesë (5) vitet e fundit do të ndërpritet mbulimi me sigurim shëndetësor menjëherë pas dështimit për të paguar edhe një kësht të vetëm.
5. Shërbimet nga neni 7 i këtij ligji nuk janë subjekt i kushteve të përcaktuara me paragrafët 2., 3. dhe 4. Të këtij neni.

KREU III

Neni 13

Të drejtat nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm

1. Qytetarët dhe banorët me sigurim shëndetësor të obligueshëm kanë të drejtë në shërbimet shëndetësore nga Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor me kusht që të kenë paguar premiumin në pajtim me këtë ligj ose të jenë të përjashtuar nga ky obligim. Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor e miratuar nga Qeveria sipas nenit 14 të këtij ligji, nuk mund të reduktohet gjatë vitit fiskal.
2. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, obligimi për pagesën e ndonjërit apo të gjitha benefiteve nga Fondi të siguruara me këtë ligj do të mund të bëhet vetëm nëse:
 - 2.1. fondet janë parashikuar në mënyrë specifike për atë qëllim me ligjin në fuqi për buxhetin vjetor;
 - 2.2. ka fonde të mjaftueshme për këto pagesa, dhe
 - 2.3. Qeveria nuk ka marrë vendim sipas paragrafit 3. të këtij neni për reduktimin ose eliminimin e obligimit të tillë.
3. Vështirësitë e paparashikuara për gjendjen financiare të Fondit do të menaxhohen nga rezervat e Fondit ose do të zgjidhen në vitin pasues nëpërmjet procesit të përcaktimit të premiumit në pajtim me këtë ligj, megjithatë, nëse në çfarëdo kohe gjatë vitit fiskal balansi fiskal i Fondit bëhet negativ, Qeveria do të rivendosë këtë ekuilibër nëpërmjet restriksioneve në pagesën e ofruesve të shërbimeve, dhe/ose rritjen e bashkë-financimit.

Neni 14

Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor

1. Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor që mbulohen nga Fondi përcaktohet nga Qeveria bazuar në propozimin e Bordit Drejtues të Fondit në fillim të çdo viti fiskal.
2. Lista nga paragrafi 1. i këtij neni përpilohet nga komisioni teknik bazuar në politikat e Ministrisë Shëndetësisë dhe mbi parimet e kosto-efektivitetit, mundësive dhe ndikimit në shëndet dhe produktivitetit.
3. Lista i dërgohet për miratim Bordit Drejtues të Fondit së bashku me deklaratën financiare të shpenzimeve për pakon e propozuar të shërbimeve; në pajtim me Kornizën Afat-mesme të Shpenzimeve, tre (3) muaj para fillimit të çdo viti fiskal.
4. Premiumet për vitin fiskal do të miratohen nga Qeveria dhe Kuvendi nëpërmjet procesit të buxhetit.
5. Lista nga paragrafi 1. i këtij neni do të miratohet në Qeveri deri më 31 Janar të atij viti fiskal, deri në miratim zbatohet Lista nga viti paraprak.

6. Shërbimet nga paragrafi 1. i këtij neni përfshirë shërbimet nga neni 7 i këtij ligji, ofrohen në kuadër të:

6.1. kujdesit shëndetësor parësor;

6.2. kujdesit shëndetësor specialistik jashtë-spitalor, dytësor dhe tretësor;

6.3. kujdesit shëndetësor specialistik spitalor, dytësor dhe tretësor, përfshirë kujdesin shëndetësor emergjent;

6.4. trajtimit mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore, në vend dhe jasht tij, në përputhje me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

7. Kujdesi shëndetësor themelor nga paragrafi 1. i këtij neni përfshirë shërbimet nga neni 7 i këtij ligji, përfshijnë:

7.1. ruajtjen dhe përparimin e gjendjes shëndetësore të popullatës nëpërmjet parandalimit dhe zbulimit të hershëm të sëmundjeve dhe të çrregullimeve shëndetësore; përveç programeve të shëndetit publik nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë;

7.2. procedurat mjekësore me qëllim të zbulimit të hershëm të sëmundjeve, diagnostikimit, mjekimit dhe përcjelljes së gjendjes shëndetësore të qytetarit dhe banorit;

7.3. trajtimin dhe mjekimin e sëmundjeve specifike, lëndimeve, dhe çrregullimeve të tjera të veçanta shëndetësore;

7.4. rehabilitimin mjekësor spitalor dhe jashtë spitalor;

7.5. shfrytëzimin e barërave dhe materialit shpenzues medicinal nga Lista esenciale e përcaktuar nga Fondi;

7.6. shfrytëzimin e shërbimeve funksionale stomatologjike, sipas Listës së përcaktuar nga Fondi;

7.7. shfrytëzimin e pajisjeve ortopedike, ndihmesave ortoprotetike dhe materialeve shpenzuese si dhe ndihmesave të tjera, sipas Listës së përcaktuar nga Fondi;

7.8. shërbimet shëndetësore për shtatzëna dhe fëmijë.

Neni 15

Zbatimi i kujdesit shëndetësor themelor

1. Shërbimet e kujdesit themelor shëndetësor ofrohen nga institucionet e licencuara shëndetësore, publike, publiko-private dhe private, me të cilat Fondi ka lidhur kontratë.

2. Reimbursimi i barërave dhe materialit shpenzues nga neni 14 paragrafi 7.5 i këtij ligji bëhet vetëm atëherë kur bari ose materiali harxhues ka qenë i përshkruar nga ana e mjekut të licencuar, në institucionin e kontraktuar shëndetësor, në recetë zyrtare me emërtim gjenerik, dhe është dhënë në barnatore private të kontraktuar nga ana e Fondit.

3. Kontraktimi i shërbimeve nga neni 14 i këtij ligji do të fillojë në datën e përcaktuar me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 16

Barazia

1. Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor zbatohen në kushte të njëjta për të gjithë personat e siguruar.
2. Shërbimet nga neni 7 i këtij ligji, si pjesë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor do të sigurohen pa pagesë për të gjithë qytetarët dhe banorët pavarësisht nga statusi i tyre i sigurimit shëndetësor.

Neni 17

Shërbimet e përjashtuara nga Sigurimi Shëndetësor i Obligueshëm

1. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm nuk përfshinë:
 - 1.1. trajtimet eksperimentale;
 - 1.2. ndihmesat dhe barnat në fazën e hulumtimeve klinike;
 - 1.3. intervenimet estetike dhe rekonstruktive kirurgjike nëse rekonstrukcioni nuk është i domosdoshëm për përmirësimin e funksionit vital;
 - 1.4. frytnimin e asistuar, përveç për qytetarët dhe banorët e liruar nga pagesa e kontributeve të premiumit dhe bashkë-financimi të cilëve u lejohet një procedurë si çift martesor në pajtim me ligjin, ndërsa për kategorinë e të siguruarve, kushtet dhe mbulueshmëria e përfituesve do të përcaktohen me akt nënligjor të propozuar nga Bordi Drejtues dhe të miratuar nga Qeveria;
 - 1.5. ekzaminimin mjekësor dhe laboratorik që ka për qëllim sigurimin e librezave sanitare;
 - 1.6. ekzaminimin mjekësor me qëllim të marrjes së certifikatave mjekësore me kërkesë të personave fizik ose juridik;
 - 1.7. kujdesin shëndetësor me rastin e udhëtimeve private të të siguruarve, jashtë Kosovës, përveç gjendjeve emergjente sipas aktit nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.8. ekzaminimet mjekësore, me rastin e kontesteve gjyqësore dhe procedurave të tjera juridike, kur ekzaminimi mjekësor nuk është në funksion të zbatimit të kujdesit themelor shëndetësor.

Neni 18

Evidentimi i të Siguarve

1. Qytetarët dhe banorët si edhe institucionet dhe organizatat publike dhe private që janë të obliguara ta paguajnë premiumin për sigurim shëndetësor të obligueshëm sipas këtij ligji, duhet t'i paraqesin në Fond të dhënat detaje për regjistrimin dhe çregjistrimin e të gjitha kategorive të siguruarve, në afat prej nëntëdhjetë (90) ditëve nga dita kur ata bëhen të obliguar të bëjnë pagesën e premiumit.
2. Fondi, përcakton me akt normativ për procedurat e evidencës së të siguruarve.

Neni 19

Kategoritë e të Siguarve

1. Kategoritë e të siguruarve i përcakton Fondi, në pajtim me këtë ligj.
2. Statusi i sigurimit shëndetësor të personit të siguruar vërtetohet me kartelën e sigurimit ose në mënyrë tjetër të përcaktuar nga Fondi.
3. Vlefshmëria e statusit të sigurimit shëndetësor nga paragrafi 2. i këtij neni, kushtëzohet me pagesat me kohë dhe të rregullta të premieeve në Fond, sipas nenit 12 të këtij ligji.

4. Vlefshmëria e statusit të sigurimit shëndetësor nga paragrafi 2. i këtij neni, ndërpritet nga dita kur Fondi merr informacionin për çregjistrimin nga lista e personave të siguruar.

Neni 20 **E Drejta e Ankesës**

1. Procedurat e realizimit të të drejtave për sigurimin shëndetësor të obligueshëm, sigurohen në pajtim me ligjet në fuqi.
2. Çdo i siguruar ka të drejtë ankese lidhur me pretendimet e tij që kanë të bëjnë me të drejtat për sigurimin shëndetësor të obligueshëm.
3. Ankesa parashtrohet brenda afatit tridhjetë (30) ditor të komisioni për shqyrtimin e Ankesave lidhur me Sigurimin Shëndetësor të Obligueshëm.
4. Komisioni për shqyrtimin e Ankesave lidhur me Sigurimin Shëndetësor të Obligueshëm themelohet me vendim nga Bordi Drejtues i Fondit.
5. Komisioni brenda afatit tridhjetë (30) ditë, shqyrton dhe vendos lidhur me Ankesën, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
6. Kundër vendimit të komisionit i siguruari mund të hapë kontest administrativ në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
7. Përbërja, Kompetenca, Mandati dhe Puna e komisionit përcaktohet me akt normativ të cilin e nxjerr Fondi.

KREU IV

Neni 21 **Financimi i Sigurimit Shëndetësor të Obligueshëm**

1. Mjetet financiare për sigurimin shëndetësor të obligueshëm paguhen në Fond ose në organizatën e përcaktuar nga ai, si bashkëfinancim dhe si:
 - 1.1. premiume për sigurimin shëndetësor të obligueshëm bazuar në të ardhurat personale dhe kompensimet e të punësuarve në sektorin publik, të ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet të punësuarve dhe punëdhënësve;
 - 1.2. premiume për sigurimin shëndetësor të obligueshëm bazuar në të ardhurat personale dhe kompensimet e të punësuarve në sektorin privat dhe publiko-privat në ndërmarrjet e regjistruara me qarkullim pesëdhjetë mijë (50.000) Euro dhe më shumë në vit, të ndara në mënyrë të barabartë ndërmjet të punësuarve dhe punëdhënësve;
 - 1.3. premiume për sigurim shëndetësor të obligueshëm nga të gjithë qytetarët dhe banorët e tjerë, përveç anëtarëve të familjes së ngushtë të qytetarëve dhe banorëve nga nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij paragrafi;
 - 1.4. transfere financiare nga Buxheti i Kosovës në Fond në emër të pagesës së premiumeve të sigurimit shëndetësor për personat nga neni 11 paragrafi 2. i këtij ligji; për shërbimet e rregullta të kujdesit shëndetësor në nivelin dytësor dhe tretësor; si dhe për shërbimet esenciale të kujdesit

shëndetësor nga neni 7 i këtij ligji, në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor; sipas buxhetit vjetor për sektorin e shëndetësisë në pajtim me kornizën afat-mesme të shpenzimeve;

1.5. pagesa nga shtetet e tjera, sipas marrëveshjeve ndërshtetërore dhe fondet e sigurimeve shëndetësore të shteteve të tjera në bazë të marrëveshjeve bilaterale;

1.6. donacione dhe burime të tjera;

1.7. fitime nga Fondi Rezerv.

2. Nëse dy ose më shumë anëtarë të familjes janë të punësuar në institucionet nga nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. i këtij neni, të gjithë të punësuarit janë të obliguar që të bëjnë pagesën e premiumit të obligueshëm të sigurimit shëndetësor.

3. Fondi zbaton aktivitetet e tij brenda mundësive financiare në dispozicion.

4. Fondi nuk mund të merr hua dhe nuk ka të drejtë që të krijoj obligime të papaguara sipas ligjit.

5. Rregullorja për menaxhimin Financiar të Fondit miratohet nga Qeveria .

Neni 22

Shkallët e premieeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm

1. Kontributi për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për të punësuarit nga neni 21 paragrafi 1.1. dhe paragrafi 1.2. i këtij ligji do të paguhet si përqindje në të ardhurat personale para pagesës së tatimit në të ardhura e ndarë në pjesë të barabarta ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit. Premiumet bazohen në koston e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor të propozuar nga Fondi dhe të miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi, në shkallën e miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi si pjesë e procesit buxhetor.

2. Premiumi për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për qytetarët dhe banorët e tjerë sipas nenit 21 paragrafi 1.3. i këtij ligji mund të bazohet në koston e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor të propozuar nga Fondi dhe të miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi; dhe llogaritet në baza vjetore si vlerë fikse e miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi në kuadër të procesit buxhetor.

3. Fondi i propozon Qeverisë ndryshimin e premiumit nga paragrafi 1. dhe paragrafi 2. i këtij neni gjatë vitit fiskal në pajtim me indeksin e çmimeve për konsumator dhe faktorëve të tjerë relevant siç janë rrethanat e veçanta shëndetësore.

Neni 23

Pagesa e premieeve për sigurimin e obligueshëm shëndetësor

1. Premiumi për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin publik, publik-privat dhe privat nga neni 21 paragrafi 1.1. dhe paragrafi 1.2. i këtij ligji duhet të paguhet nëpërmjet sistemit të pagave dhe thesarit të shtetit, çdo muaj.

2. Pagesat e premieeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm nga qytetarët dhe banorët e përcaktuar me nenin 21 paragrafin 1.3. të këtij ligji do të bëhen përmes bankave komerciale në xhirollogarinë e Fondit, në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Mbikëqyrja e pagesave nga paragrafi 1. dhe paragrafi 2. i këtij neni do të bëhet nga Banka Qendrore të Kosovës.

4. Pagesa e premieeve nga neni 21 paragrafi 1.3. i këtij Ligji të bëhet në llogarinë e Fondit si pagesë vjetore, tre-mujore ose mujore (për person ose për anëtarë të familjes), jo më vonë se dita e 15të e muajit që i paraprin muajit prej të cilit personi është mbuluar me sigurim.

5. Pagesa e premieeve nga neni 21 paragrafi 1.4. i këtij ligji do të barten në llogarinë e Fondit nga Ministria e Financave, çdo tre (3) muaj.

6. Fondi përcakton kushtet e pagesës, me akt normativ.

Neni 24

Fondi Rezervë dhe Obligimet e Pagesave

1. Fondi krijon rezervën financiare në Bankën Qendrore të Kosovës që duhet të mirëmbahet në çdo kohë. Rregullat për kalkulimin dhe shfrytëzimin e kësaj rezerve do të specifikohen në Rregulloren për Menaxhimin Financiar të Fondit.

2. Në rastet kur mesatarja e rezervës financiare gjatë gjashtëdhjetë (60) ditëve paraprake është në nivel më të ulët se sa ajo e përcaktuar me Rregulloren për Menaxhimin Financiar të Fondit, ose në rastet kur obligimet e papaguara të Fondit e tejkalojnë këtë nivel, ose në të dyja rastet, atëherë çmimet e shërbimeve shëndetësore, dhe/ose nivelet e bashkë-financimit, do të përshtaten përderisa rezerva të arrij nivelin adekuat. Në pajtim me nenin 22 paragrafi 3. i këtij ligji Fondi mundet po ashtu të kërkojë përshtatjen e niveleve të premiumit.

Neni 25

Pagesa për shërbimet e kujdesit shëndetësor

1. Personat e siguruar në mënyrë të obligueshme do të kenë qasje pa pagesë në shërbimet nga Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor sipas nenit 14 dhe nenit 15 të këtij ligji.

2. Ofruesit e shërbimeve shëndetësore të kontraktuar nga Fondi e kanë të ndaluar ngarkesën me pagesë plotësuese të personave të siguruar për shërbimet nga Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor, mbi vlerat e përcaktuara me çmimoren e Fondit.

3. Shkalla e pjesëmarrjes në kostot nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohen nga Bordi Drejtues i Fondit bazuar në rekomandimin e komitetit teknik të emëruar nga Bordi.

4. Bashkë-financimet për shërbimet nga Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor do të mbledhen në institucionet shëndetësore dhe do të shfrytëzohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Vetëm qytetarët dhe banorët nga paragrafët 2. dhe 3. të nenit 11 të këtij ligji përjashtohen nga obligimi për të paguar premiumin dhe llojet e tjera të bashkë-financimit.

6. Qytetarët që nuk regjistrohen në skemën e sigurimit të obligueshëm shëndetësor, do të paguajnë çmimin e shërbimit shëndetësor të ofruar, në bazë të çmimorës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në propozim të Fondit.

7. Banorët që nuk regjistrohen në skemën e sigurimit të obligueshëm shëndetësor, qytetarët ose banorët e Kosovës që janë të siguruar jashtë vendit dhe shtetasit e huaj, nëse nuk ka marrëveshje Bilaterale do të paguajnë çmimin e shërbimit shëndetësor të ofruar, në bazë të çmimorës së veçantë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në propozim të Fondit.

* * * *

KREU V FONDI

Neni 33

Kompensimi i dëmeve

1. Fondi mund të kërkojë kompensimin e dëmit që personat fizik dhe juridik i kanë shkaktuar shëndetit të të siguruarit gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, në rast se ky dëmtim është shkaktuar nga moskujdesi.
2. Sipas paragrafit 1. të këtij neni, Fondi ka të drejtë që të kërkojë kompensimin e dëmeve nga shkaktuesit e tyre sa u përket shpenzimeve të lidhura me shërbimet e kujdesit shëndetësor, sipas çmimoreve të vet.
3. Kompensimi nga paragrafi 2. i këtij neni, zbatohet në pajtim me ligjet në fuqi.

* * * *

KREU VI

Neni 36 Sanksionet administrative

1. Çdo person përgjegjës fizik do të dënohet me gjobë në vlerën shtatë (7) herë më të lartë, dhe çdo person përgjegjës juridik në vlerën njëzet (20) herë më të lartë, se sa vlera e pagës minimale në Republikën e Kosovës, në rast se personi fizik ose juridik:
 - 1.1. nuk i mban shënimet e rregullta për të siguruarit;
 - 1.2. nuk i paraqet në Fond të dhënat e plota dhe me kohë, për regjistrimin dhe çregjistrimin e të siguruarve;
 - 1.3. refuzon dhënien e informatave ose jep informata të pasakta për regjistrimin dhe çregjistrimin e të siguruarve;
 - 1.4. nuk i përmirëson të dhënat e pasakta pas urdhëresës së Fondit ose pengon kontrollimin e të dhënave zyrtare lidhur me të siguruarin përkitazi me sigurimin shëndetësor të obligueshëm, në përputhje me këtë ligj.
2. Sanksionet administrative nga paragrafi 1. i këtij neni shqiptohen nga Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë.

KREU VII

Neni 37 Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

1. Premiumet për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për të punësuarit dhe punëdhënësit nga neni 21 paragrafi 1.1. dhe paragrafi 1.2. i këtij ligji, do të llogaritet fillimisht për tridhjetegjashtë (36) muajt e parë të mbledhjes së premiumeve si përqindje prej shtatë (7) % nga të ardhurat bruto të ndarë në pjesë të barabarta ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit (çdonjëri 3.5%) dhe më vonë kjo përqindje do të përcaktohet dhe aprovohet nga Qeveria dhe Kuvendi sipas nenit 22 të këtij ligji.
2. Premiumin për sigurimin shëndetësor të obligueshëm nga neni 21 paragrafi 1.3. i këtij ligji do të llogaritet për dymbëdhjetë (12) muajt e parë të mbledhjes së premiumeve në vlerë prej dy (2) Euro për person, dhe më pastaj kjo vlerë do të përcaktohet dhe aprovohet nga Qeveria dhe Kuvendi sipas nenit 22 të këtij ligji.

3. Ministria e Shëndetësisë, në afat prej tre (3) muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të themelojë Këshillin Përgatitor për themelimin e Fondit.
4. Këshilli, nga paragrafi 3. i këtij neni, ka tetë (8) anëtarë, me përfaqësim të subjekteve nga neni 31, paragrafi 3. I këtij ligji, ku pozita e Drejtorit të Fondit është e përfaqësuar me Kryeshefin e Agjencionit të Financimit Shëndetësor.
5. Këshilli kryen punët dhe detyrat e Bordit Mbikëqyrës të Fondit deri në themelimin e tij, në bazë të Rregullores së Punës të miratuar nga Qeveria në propozim të Ministrisë së Shëndetësisë, në pajtim me këtë ligj.
6. Agjencioni i Financimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë do të bartë gradualisht të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë ligj dhe Ligjin për Shëndetësi, në Fond në pajtim me vendimet e Këshillit nga paragrafi 3. i këtij neni.
7. Në pajtim me nenin 24. paragrafi 1. të këtij ligji rezerva financiare e Fondit në Bankën Qendrore të Kosovës në fund të vitit të parë pas themelimit duhet të jetë në vlerën e përcaktuar në Rregulloren e nxjerrë nga Qeveria.
8. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, obligohen të përgatisin aktet e përgjithshme, infrastrukturën dhe të gjitha kushtet e tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e punëve të Fondit.
9. Fondi do të fillojë me funksionimin e tij të plotë atëherë kur të plotësohen parakushtet për zbatimin e sigurimit shëndetësor të specifikuara në paragrafin 10. të këtij neni.
10. Grumbullimi i premieeve do të fillojë vetëm pasi që:
 - 10.1. lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare për atë vit fiskal të jetë miratuar sipas nenit 14 të këtij ligji;
 - 10.2. lista e shërbimeve pa pagesë nga neni 7 i këtij ligji të jetë e definuar;
 - 10.3. çmimi i çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor për atë vit fiskal të jetë i dakorduar;
 - 10.4. bashkëpagesat dhe nivelet e tjera të bashkë-financimit të jenë të dakorduara;
 - 10.5. së paku 75% e të punësuarve në sektorin publik dhe në ndërmarrjet e regjistruara private dhe publiko-private me TVSH të deklaruar dhe me qarkullim më të madhe se pesëdhjetë mijë (50.000) Euro të kanë marrë kartelë të sigurimit shëndetësor ose mjet tjetër të verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor;
 - 10.6. së paku 75% të individëve që u përkasin kategorive të liruara u është dhënë kartela e sigurimit shëndetësor ose mjet tjetër i verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor.
11. Data e fillimit të mbledhjes së premieeve do të specifikohet në aktin nën – ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 38

Deri në fillimin e funksionimit të Fondit sektori publik shëndetësor do të vazhdojë të financohet nga burimet e përcaktuara me Ligjin e Shëndetësisë.

Neni 39

Agjencioni i Financimit Shëndetësor dhe Këshilli përgatitor nga neni 37 paragrafi 3. i këtij ligji nxjerrë akte të brendshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L -249
10 prill 2014

Shpallur me dekretin Nr. DL-018-2014, datë 25.04.2014 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga

LIGJI Nr. 04/L – 110 PËR NDËRTIM

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR NDËRTIM

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Ky ligj rregullon ndërtimin e të gjitha objekteve ndërtimore në Kosovë, projektimin, ndërtimin, rindërtimin, rrënimin, nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Për qëllime të këtij ligji, termet e veçanta të përdorura në tekstin e këtij ligji, do ta kenë kuptimin si në vijim. Në raste të dykuptimësisë, definicionet në këtë ligj, do të interpretohen në përputhje me definicionet e njëjta apo të ngjashme të standardeve të aplikuara në Republikën e Kosovës, BE-se dhe ISO :

- 1.1. **Punë ndërtimore** – aktivitetet e krijimit të ndërtimeve apo objekteve ndërtimore.
- 1.2. **Ndërtim apo objekt ndërtimor** - çdo gjë që ndërtohet apo rezulton nga punët ndërtimore.
- 1.3. **Projektim** - hartimi i dokumentacionit tekniko-investig sipas Kodit të Ndërtimit dhe sipas dispozitave të këtij ligji.
- 1.4. **Vend ndërtimi** – sipërfaqe tokësore apo ujore ku zhvillohet punë ndërtimore ose ndonjë zhvillim tjetër që ka të bëjë me ndërtimin.
- 1.5. **Rindërtimi** – punë ndërtimore që ka për synim ndryshimin substancial të një ndërtimi, për shembull:
 - 1.5.1. ndërtim i katit të ri të një ndërtese ose largim i një kati ekzistues, si dhe ndryshim i gabaritit të ndonjërit kat për më shumë se një (1) metër;
 - 1.5.2. ndryshim i madhësisë së elementeve arkitekturore të pjesës së jashtme për më shumë se dy përqind (2 %) dhe zero presje një (0,1) metër;

1.5.3. zëvendësim, largim, ose riparim i pjesëve strukturore të ndërtimeve;

1.5.4. ndryshim i projektit ekzistues sipas të cilit paraprakisht është lëshuar certifikata e shfrytëzimit;

1.5.5. modifikim, zgjerim ose reduktim i sistemeve të shërbimeve publike për përdorim të përbashkët në ndërtim.

1.6. **Mirëmbajtja e ndërtimit** - realizimi i punëve për ruajtjen e kërkesave esenciale të ndërtimit gjatë përdorimit të tij.

1.7. **Ndërtesa** – ndërtim i projektuar për banim për njerëzit apo kafshët, strehim apo ruajtje të gjësendeve, ose përdorim për aktivitete publike apo private, dhe zhvillim të tregtisë ose prodhimit.

1.8. **Produkt ndërtimi** - çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në ndërtim.

1.9. **Ministria** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

1.10. **Ndërtimi i ri** – ndërtim që kryhet në pjesë të një parcele toke ku nuk ka ndërtim ose që zëvendëson plotësisht ndërtimin ekzistues.

1.11. **Riparimi** – kthim i një objekti në kushte të pranueshme duke bërë ripërtëritjen, zëvendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara, për shembull:

1.11.1. lëvizja e konstruksioneve të ndërtimit brenda hapësirës së brendshme të ndërtimit, shtimi ose mënjanimi i të rejave, dhe prerja e tyre për të korrigjuar defektet ose zëvendësuar sistemet e shërbimeve publike të përdorimit individual pa ndryshuar llojin dhe kapacitetin e tyre;

1.11.2. korrigjimi ose renovimi i atyre pjesëve të rrjeteve inxhinierike-komunale për përdorim individual nëpër ndërtime që janë projektuar për shërbimin e nevojave të banesave ose vendbanimeve tjera, stacioneve, ose vendeve tjera (duke përfshirë ato pjesë të sistemeve inxhinierike-komunale për përdorim të përbashkët që janë të shtrira në banesa, etj); apo

1.11.3. korrigjimi ose renovimi i sistemeve dhe pajisjeve teknologjike dhe rrjeteve inxhinierike-komunale lokale dhe pajisjeve mekanike transportuese dhe/ose renovimi dhe/ose ndryshimi i fasadës së ndërtimeve në përputhje me dokumentacionin ekzistues ndërtimor.

1.12. **Objektet e trashëgimisë historiko-kulturore** – ndërtime që trajtohen në kuadër të Ligjit të Trashëgimisë Kulturore duke përfshirë edhe ndërtimet në zonat e veçanta të mbrojtura.

1.13. **Rrënimi** – shkatërrim ose largim.

1.14. **Ndërtim peizazhi** - ndërtim i parqeve, kopshteve, bulevardeve, shesheve dhe rregullimi i natyrës në përgjithësi.

1.15. **Kushtet ndërtimore** - kushtet e përcaktuara nga plani rregullativ urban, ose në mungesë të këtij plani, të aprovuara nga organi kompetent, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit ndërtimor. Kushtet ndërtimore në këtë ligj i referohen kushteve të ndërtimit sipas Ligjit të Planifikimit Hapësinor, i cili i definon kushtet e ndërtimit si kushte që përcaktojnë llojin, madhësinë, mënyrën e ndërtimit, kushtet e sigurisë, dhe çfarëdo kushti tjetër të domosdoshëm për ndërtime.

1.16. **Dokumentacioni ndërtimor** – dokumentet e shkruara, grafike, dhe me figura, të përgatitura ose të asambлуara, me qëllim të përshkrimit të dizajnit, lokacionit, dhe karakteristikave fizike të elementeve të projektit, i domosdoshëm për të marrë lejen ndërtimore.

1.17. **Leja ndërtimore** – leje e lëshuar nga organi kompetent që shërben si bazë ligjore për realizimin e ndërtimit në përputhje me këtë ligj.

1.18. **Mbikëqyrja inspektuese** – inspektim i përputhjes së ndërtimit me dokumentacionin ndërtimor dhe kodin e aplikuar ndërtimor.

1.19. **Certifikata e përdorimit** – dokument i lëshuar nga një organ kompetent që vërteton përputhjen e ndërtimit me dokumentacionin ndërtimor dhe kodet e aplikuar ndërtimore, dhe që tregon se ndërtimi është i përshtatshëm për përdorim.

1.20. **Organi Kompetent** - autoriteti që është përgjegjës për lëshimin e lejeve ndërtimore, koordinimin e inspektimeve ndërtimore, dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit.

1.21. **Aplikuesi** – person fizik apo juridik, i cili dorëzon kërkesën për leje ndërtimore.

1.22. **Projektuesi** - person fizik ose juridik i licencuar që është përgjegjës për hartimin e dokumentacionit ndërtimor.

1.23. **Kontraktuesi** - person ose organizatë që ndërmerr punë ndërtimore në përputhje me kontratën.

1.24. **Komuna** - komuna në këtë ligj ka kuptimin e përcaktuar sipas Ligjit të vetëqeverisjes lokale.

1.25. **Kodi i ndërtimit** - akti nënligjor që parasheh vendosjen e kërkesave minimale për adresimin e fuqisë strukturore, hapësirave të emergjencës, sanitarisë, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, qasjes, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve. Do të bazohet në standardet ndërkombëtare dhe do të përfshijë norma teknike të përshtatura për Kosovën.

1.26. **Libri dhe ditari ndërtimor** - mbahet në vend punishte për përcjelljen e punëve ndërtimore që është e nevojshme për të marrë miratimin për ndërtimin dhe zhvillimin e projektit kryesor. Të gjitha proceset dhe detajet e Librit dhe Ditarit ndërtimor duhet të rregullohen me akt të veçantë nënligjor.

1.27. **Marrëveshja për infrastrukturë** - Kontratë ligjërishit e zbatueshme ndërmjet aplikuesit për leje ndërtimi dhe organit kompetent e cila specifikon afatet dhe kushtet në lidhje me financimin e infrastrukturës nga aplikuesi ose ofrimin e infrastrukturës nga aplikuesi, që mund të kërkohet në bazë nenit 17 të Ligjit për financat e pushtetit lokal.

1.28. **Heshtja është pranim** - garantimi i së drejtës së çdo personi që të ndërmerr një aktivitet apo veprim biznesor të llojit të caktuar, pa marrjen e aprovimit nga ana e organit kompetent, nëse një aprovim apo refuzim i kërkesës nuk është dhënë në kuadër të kufizimeve kohore të paraparë me këtë ligj.

KREU II PARIMET

Neni 4

Parimet e leje lëshimit dhe mbikëqyrjes

1. Lëshimi i lejes ndërtimore dhe përcaktimi i kërkesave të saj do të zbatohen në pajtueshmëri me parimet si në vijim:

- 1.1. mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë;
- 1.2. ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore;
- 1.3. mbrojtja e të drejtave pronësore;
- 1.4. transparenca në procedurat administrative;
- 1.5. parimi i një zyre shërbyese, dhe
- 1.6. heshtja është pranim.

KREU III LLOJET E NDËRTIMIT

Neni 5 Llojet e ndërtimit

1. Llojet e ndërtimit janë:

- 1.1. ndërtimi i ri (duke përfshirë instalimin);
- 1.2. rindërtimi;
- 1.3. riparimi – renovimi, sanimi, rehabilitimi-përmirësimi (nuk kërkon leje ndërtimi);
- 1.4. punët ndërtimore që kanë për synim mbrojtjen e monumenteve të palëvizshme të trashëgimisë kulturore;
- 1.5. rrënim;
- 1.6. ndërtime peizazhi, dhe
- 1.7. instalimi apo ngritja e ndërtimeve të përkohshme.

Neni 6 Kodi Unik i Ndërtimit i Republikës së Kosovës

1. Kodi Unik i Ndërtimit i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “Kodi”) do të përpilohet nga Qeveria e Kosovës bazuar në këtë Ligj. Kodi do të përpilohet në frymën e standardeve teknike të BE-së, praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rrethanave ekzistuese në Kosovë.

2. Qëllimi i Kodit është vendosja e kërkesave minimale për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë dhe mirëqenies së përgjithshme përmes rezistencës së nevojshme të strukturës së hapësirave të emergjencës, ekuilibrit dhe stabilitetit, sanitarisë, menaxhimit të mbeturinave ndërtimore, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, masave për efikasitet dhe kursim të energjisë, dhe sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri dhe rreziqeve tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor si dhe t'i krijoj siguri zjarrfikësve dhe përgjegjësve tjerë në raste të emergjencave. Kodi do të vendos çfarëdo kërkesë tjetër teknike që parimisht konsiderohet çështje relevante teknike.

3. Rregullat teknike të efijencës dhe kursimeve të energjisë së Kodit i referohen Standardeve të Kosovës mbi efijencën dhe kursimet e energjisë të aprovuara nga Agjencia për Standardizim e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

KREU IV NDËRTIMI

Neni 7 Pjesëmarrësit në ndërtim

Pjesëmarrësit në ndërtim janë aplikuesi, poseduesi i lejes ndërtimore, projektuesi, kontraktuesi.

Neni 8 Poseduesi i lejes

Nëse poseduesi i lejes ndërtimore ndryshon gjatë ndërtimit, poseduesi i ri i lejes ndërtimore është i obliguar të njoftojë me shkrim organin kompetent që e ka lëshuar lejen ndërtimore, i cili duhet ta reflektojë ndryshimin në leje ndërtimore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Neni 9 Mjetet juridike dhe parandalimi i konfliktit të interesit

1. Kundër vendimit të organit administrativ pala ka të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik në pajtim me Ligjin e Procedurës Administrative dhe të hapë konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për konfliktin administrativ.
2. Ushtrimi i mjetit juridik në vendimin e organit administrativ, ose hapja e konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e vendimit, përveç nëse nuk vendos ndryshe organi kompetent.
3. Gjatë zhvillimit të procedurës organi kompetent është i obliguar që të veprojë në pajtim me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

KREU V DOKUMENTACIONI NDËRTIMOR

Neni 10 Dokumentacioni ndërtimor

Përmbajtja e dokumentacionit ndërtimor (përfshirë rindërtimin dhe rrënimin) përcaktohet me Kod ndërtimor.

Neni 11 Monitorimi nga projektuesi

Projektuesi mund të monitoroj procesin e ndërtimit dhe përputhshmërinë e tij me dokumentacionin e aprovuar ndërtimor.

Neni 12 Validiteti i dokumentacionit të aprovuar paraprak ndërtimor

Dokumentacioni ndërtimor i aprovuar për një projekt të mëhershëm konsiderohet i vlefshëm për ndonjë projekt të ardhshëm në varësi të kërkesave të planit rregullativ urban ose kushteve ndërtimore specifike për atë projekt.

Neni 13 **Arkivimi i dokumentacionit ndërtimor**

Organi kompetent duhet të mirëmbajë, ruajë dhe t'i mundësojë qasje sipas kërkesës aplikuesit në të gjithë dokumentacionin ndërtimor dhe dokumentet tjera përcjellëse sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI **LEJA NDËRTIMORE**

Neni 14 **Llojet për të cilat lëshohet leja ndërtimore**

1. Leja ndërtimore kërkohet për aktivitetet vijuese:

- 1.1. ndërtimi i ri (përfshirë montazhet);
- 1.2. rindërtimi i objekteve ekzistuese;
- 1.3. rrënimi i objekteve ekzistuese, dhe
- 1.4. riparimi i objektit ndërtimor, nëse ndodh ndryshim thelbësor i tij krahasuar me situatën para paraqitjes së dëmit nga katastrofat natyrore, luftërat apo ngjarjet e ngjashme.
- 1.5. intervenimet në fasadat dhe strukturën (sanimet) e një objekti ekzistues.

Neni 15 **Kategoritë e ndërtimeve për lëshimin e lejes ndërtimore dhe certifikatës së përdorimit**

1. Një leje ndërtimore apo një certifikatë përdorimi lëshohet mbi bazën e klasifikimeve si në vijim:

- 1.1. Kategoria I – ndërtime me rrezikshmëri të ulët;
- 1.2. Kategoria II – ndërtime me rrezikshmëri të mesme, dhe
- 1.3. Kategoria III – ndërtime me rrezikshmëri të lartë dhe me interes nacional.

2. Karakteristikat detaje të kategorive përcaktohen nga Ministria dhe Komunat me akt nënligjor.

3. Nëse një ndërtim përmban karakteristika të më shumë se një kategorie, ndërtimi klasifikohet sipas karakteristikave korresponduese të kategorisë më të lartë.

Neni 16 **Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leja ndërtimore**

Detajet e ndërtimeve për të cilat nuk kërkohet leja ndërtimore përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria në bashkëpunim me Komunat.

Neni 17 **Procedura e përgjithshme për lëshimin e lejes ndërtimore**

1. Lëshimi i lejes ndërtimore kalon nëpër dy (2) faza:

1.1. Faza I: organi kompetent parasheh kushtet ndërtimore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës për kushtet ndërtimore për ndërtimet e kategorisë I dhe tridhjetë (30) ditë për ndërtimet e kategorive II dhe III; dhe

1.2. Faza II: leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III.

2. Në territoret për të cilat ekziston plani rregullativ urban, nuk nevojitet të kryhen procedurat e parapara për Fazën I pasi që plani rregullativ urban përcakton kushtet e nevojshme të Fazës I.

3. Planet rregullative urbane janë dokumente publike dhe çdo person duhet të ketë qasje në to përmes ueb-faqeve komunale apo përmes kërkesës së palës.

Neni 18

Përcaktimi i kushteve ndërtimore

1. Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor.

2. Në rast kur nuk ekziston plani rregullues urban, organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit.

3. Organi kompetent aprovon kërkesën e aplikuesit apo i vendos kushtet e veta ndërtimore siç parashihet me këtë ligj.

4. Në rast se organi kompetent nuk kthen përgjigje me shkrim sipas afatit të kërkuar, atëherë zbatohen kushtet ndërtimore të propozuara nga aplikuesi.

Neni 19

Kompetencat për lëshimin e lejes ndërtimore

1. Ministria ka kompetencë për lëshimin e lejeve për ndërtimet e kategorisë III, sipas Shtojcës nr. 1 të këtij ligji.

2. Komunat lëshojnë leje ndërtimore për kategoritë I dhe II të ndërtimeve. Sipas marrëveshjes së dy apo më tepër komunave në përputhje me ligjin e aplikueshëm, komunat mund të formojnë një strukturë të përbashkët që do të kishte përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore dhe koordinimin e inspektimeve ndërtimore.

Neni 20

Kërkesa për lëshimin e lejes ndërtimore

1. Kërkesa për leje ndërtimore mund të paraqitet nga aplikuesi apo personi ligjërish i autorizuar prej tij.

2. Me rastin e kërkesës për leje ndërtimore, organi kompetent do të lëshoj vërtetim për pranimin e kërkesës së aplikuesit.

3. Kërkesës për lejen ndërtimore i bashkëngjitet:

3.1. kopja e planit dhe certifikata e pronësisë të aplikuesit, siç është certifikuar nga organet kompetente;

- 3.2. akti ligjor administrativ për vendosjen e kushteve ndërtimore, nëse kërkohet sipas nenit 18 të këtij ligji;
- 3.3. tri kopje të dokumentacionit ndërtimor të përgatitur në pajtueshmëri me Kodin dhe një kopje në formë elektronike;
- 3.4. në rast se kërkohen objekte të përkohshme ndërtimore në vend ndërtim, kërkohet paraqitja e periudhës kohore për ato objekte, dhe
- 3.5. vlerësimi i ndikimit në mjedis për ato ndërtime siç kërkohet me Ligjin mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Neni 21

Procedura për lëshimin e lejes ndërtimore

1. Leja ndërtimore lëshohet nëse dokumentacioni ndërtimor përgatitet në pajtueshmëri me kushtet ndërtimore dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Kodit si dhe Ligjit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe zonat e veçanta të mbrojtura.
2. Nëse organi kompetent vlerëson se dokumentacioni ndërtimor nuk është përgatitur në përputhje me kushtet ndërtimore dhe me dispozitat e këtij ligji, Kodit si dhe Ligjit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe zonat e veçanta të mbrojtura, nuk do të lëshojë lejen ndërtimore. Në rast se kërkesa për leje ndërtimore refuzohet, organi kompetent duhet të ofrojë sqarim të mirëfilltë për arsyet e refuzimit.
3. Nëse kushtet e parapara me këtë ligj janë përmbushur dhe nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditësh për kategorinë I dhe brenda dyzet e pesë (45) ditëve për kategoritë II dhe III e lëshon lejen ndërtimore duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës. Nëse organi kompetent nuk e ka informuar aplikuesin për vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar do të konsiderohet se leja është lëshuar. Në rastin e tillë, organi kompetent e lëshon lejen ndërtimore.
4. Pas pranimit të kërkesës së pakompletuar për leje ndërtimore për ndërtim të kategorisë I, organi kompetent brenda tetë (8) ditëve e njofton aplikuesin për hapat e nevojshëm që duhet t'i ndërmerr që ta kompletoj kërkesën. Pas pranimit të kërkesës së pakompletuar për leje ndërtimore për ndërtim të kategorisë II ose III, organi kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve e njofton aplikuesin për hapat e nevojshëm që duhet t'i ndërmerr që ta kompletoj kërkesën. Nëse përmirësimet janë të nevojshme, aplikuesi i bën përmirësimet brenda tetë (8) ditëve për ndërtimet e kategorisë I dhe pesëmbëdhjetë (15) ditëve për ndërtimet e kategorisë II dhe III. Nëse aplikuesi nuk i përmbahet afateve pas njoftimit, organi kompetent mundet ta refuzoj kërkesën. Kjo kohë e shqyrtimit nuk do të ndikoj në afatin e organit kompetent për lëshimin e lejes sipas paragrafit 3. të këtij neni.
5. Në rast se leja ndërtimore është lëshuar, organi kompetent do t'ia kthejë aplikuesit një kopje të dokumentacionit, së bashku me dokumentin e lejes ndërtimore dhe do t'ia dërgojë një kopje inspektionit respektiv. Nëse refuzohet kërkesa, organi kompetent ia kthen dokumentacionin ndërtimor aplikuesit.
6. Leja ndërtimore pushon së vlejture nëse aplikuesi nuk fillon ndërtimin në afatin prej një (1) viti nga dita e fuqizimit të lejes ndërtimore.
7. Vlefshmëria e lejes ndërtimore mund të zgjatet me kërkesën e aplikuesit për një (1) vit.

Neni 22

Taksa administrative e lejes ndërtimore

1. Organi kompetent përcakton taksën e lejes ndërtimore në bazë vjetore, në konsultim me Ministrinë. Ministria do të analizoj resurset e organit kompetent sipas vlerës së tregut dhe monitorojë alokimin e resurseve nëpër të gjithë organet kompetente dhe reflektimin e tyre në taksën e propozuar dhe do të bëjë rekomandime, sipas nevojës për të siguruar që taksa e propozuar është në përputhje me formulën e përshkruar në këtë nen.

1.1. organi kompetent do t'i dorëzojë taksën e propozuar vjetore ndërtimore Ministrisë deri nga fundi i muajit shtator të vitit vijues për aplikim të saj nga data 1 janar e vitit pasues. Përndryshe, taksa e mëparshme ndërtimore do të konsiderohet e vlefshme sipas këtij ligji.

1.2. pas shqyrtimit të taksës së propozuar nga Ministria dhe pranimin nga ana e organit kompetent të çfarëdo rekomandimi nga ministria në lidhje me të, organi kompetent do të bëjë publike taksat e propozuara dhe mundësoj diskutimin publik për një periudhë gjashtëdhjetë (60) ditësh. Pas skadimit të afatit për diskutim publik, norma do të vihet në përdorim pas tridhjetë (30) ditësh shtesë të njoftimit publik.

1.3. organet kompetente në konsultim me Ministrinë, mund të propozojnë ndryshime të taksës së tyre së lejes ndërtimore sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet në lidhje me shpenzimet lidhur me dhënien e lejeve ndërtimore, por taksa nuk mund të ndryshohet para se të kalojnë gjashtë (6) muaj nga ndryshimi i fundit i taksës së lejes ndërtimore nga organi kompetent.

2. Organi kompetent me rastin e propozimit të taksës së lejes ndërtimore Ministrisë ose publikut për analizë dhe komente do të dorëzoj analizën funksionale të normës së taksës, buxhetin e vlerësuar sipas përshkrimit në nën-paragrafin 4.2. të paragrafit 4. të këtij neni, dhe numrin total bruto të metrave katrorë sipas përshkrimit në nën-paragrafin 4.1. të paragrafit 4. të këtij neni.

3. Ministria dhe organi kompetent do të bëjnë gjithmonë publike në faqet e tyre elektronike dhe do të bëjnë të mundur që çdo person sipas kërkesës të informohet lidhur me taksën e lejes ndërtimore bazuar në metër katror që nuk duhet të tejkalojë nivelin e mbulimit të kostos duke përfshirë të gjitha supozimet dhe llogaritjet e përdorura për të arritur deri te taksa e publikuar.

4. Taksa e lejes ndërtimore do të llogaritet në bazë vjetore si në vijim:

4.1. bazuar në të dhënat e kaluara, përcaktimi i numrit total bruto të metrave katrorë të lejuar me leje ndërtimi të lëshuar brenda territorit gjatë vitit të kaluar;

4.2. përcaktimi i buxhetit të domosdoshëm për organin kompetent për të lëshuar leje ndërtimore në mënyrë efektive dhe efikase dhe për të kryer mbikëqyrjen e ndërtimit, duke përfshirë edhe inspektimin;

4.3. pjesëtimi i buxhetit të referuar në nën-paragrafin 4.2. të paragrafit 4. të këtij neni me numrin total bruto të metrave katrorë të lejuar me leje ndërtimore ashtu siç është përshkruar në nënparagrafin 4.1. të paragrafit 4. të këtij neni. Herësi i këtij pjesëtimi do të jetë taksa e lejes ndërtimore së bazuar në metra katrorë për periudhën pasuese.

5. Dispozitat e këtij neni, paragrafët 1 - 4 nuk kanë efekt zbatues në Tarifat Rregullative për zhvillimin ose ruajtjen e infrastrukturës, siç është paraparë në nenin 17 të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, nr. 03/L-049.

Neni 23 **Taksa për infrastrukturë**

Komuna mund të vlerësojë një ngarkesë për aplikuesin për të rimbursuar koston e krijimit, përmirësimit, zgjerimit apo riparimit të infrastrukturës komunale vetëm aty ku është e autorizuar për të bërë këtë sipas nenit 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Nëse komuna propozon të vlerësojë një taksë

infrastrukturore, me kërkesë të aplikuesit komuna do të bëjë një Marrëveshje Zhvillimi me aplikuesin në mënyrë që të specifikojë afatet, kushtet dhe orarin sipas të cilit taksa infrastrukturore do të paguhet. Marrëveshja për Zhvillim mund të specifikojë shumën dhe afatet brenda të cilave Aplikuesi do ta rimburojë komunën ose ndryshe mund të specifikojë kushtet mbi të cilat Aplikuesi do të ndërmarrë sigurimin e infrastrukturës në lidhje me pagesën e taksës së infrastrukturës. Marrëveshja për Zhvillim do të përmendet në Lejen e Ndërtimit dhe do të regjistrohet së bashku me pronën e subjektit në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës.

Neni 24

Dokumenti i lejes ndërtimore

Dokumenti i lejes ndërtimore do të përshkruajë në mënyrë eksplicite të gjitha kushtet ndërtimore në përputhje me dokumentacionin e ndërtimit.

Neni 25

Dëmet e shkaktuara objekteve ndërtimore

1. Në rast të dëmtimit të objekteve ndërtimore nga forca madhore sipas Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, riparimi dhe rindërtimi i atyre objekteve mund të bëhet pa leje ndërtimore nëse nuk bëhen ndryshime rrënjësore nga gjendja para dëmtimit, përveç objekteve të cilat kanë qenë të ndërtuara pa leje”.

2. Në rast se riparimet dhe rindërtimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni bëjnë ndryshime qenësore në objekt, leja ndërtimore për riparim dhe rindërtim do të merret brenda dy (2) viteve nga dita e paraqitjes së dëmit. Për qëllim të këtij paragrafi, “ndryshimet qenësore” i referohen kushteve ndërtimore. Nëse riparimet dhe rindërtimet bëhen në objekt të trashëgimisë kulturore, kërkohet leja ndërtimore dhe harmonizimi me legjislacionin për trashëgimi kulturore.

3. Riparimet dhe rindërtimet e bëra sipas këtij neni mund të bëhen në bazë të vendimit që nxjerr Qeveria sipas propozimit të Institucioneve përkatëse.

KREU VII

VENDNDËRTIMI

Neni 26

Dokumentet në vend ndërtim

1. Kontraktuesi në vend ndërtim duhet të ketë dokumentet vijuese:

- 1.1. kontratën mes poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
- 1.2. lejen ndërtimore dhe dokumentacionin ndërtimor;
- 1.3. dokumentacionin për atestet e produkteve ndërtimore dhe pajisjeve;
- 1.4. dëshminë për kualitetin e përcaktuar për produktet ndërtimore të përdorura, dhe
- 1.5. librin dhe ditarin ndërtimor.

2. Forma, mënyra dhe kushtet e udhëheqjes e mirëmbajtjes së ditarit dhe librit ndërtimor në vend ndërtim përcaktohen nga Ministria me akt nënligjor.

KREU VIII

CERTIFIKATA E PËRDORIMIT

Neni 27
Certifikata e përdorimit

1. Për të gjitha objektet ndërtimore për të cilat kërkohet leja ndërtimore, merret edhe certifikata e përdorimit para se objekti të përdoret.

2. Certifikata e përdorimit lëshohet kur të plotësohen këto kushte:

2.1. kërkesat e lejes ndërtimore janë zbatuar;

2.2. poseduesi i lejes ndërtimore dhe/ose kontraktuesi kanë hequr dhe hedhur mbeturinat ndërtimore nga vend ndërtimi në deponi adekuate të mbeturinave ndërtimore, të caktuar në mënyrë specifike për këtë qëllim, dhe

2.3. masat e kursimeve dhe efijencës së energjisë janë zbatuar.

3. Për objekte ndërtimore që përbëhen nga pjesë të pavarura funksionale mund të lëshohen certifikata të ndara përdorimi për ato pjesë të pavarura funksionale kur plotësohen kërkesat e lejes ndërtimore.

Neni 28
Kërkesa për lëshimin e certifikatës së përdorimit

1. Certifikata e përdorimit lëshohet nga organi kompetent.

2. Kërkesës për lëshimin e certifikatës së përdorimit i bashkëngjitet si vijon:

2.1. protokollat e nënshkruara që verifikojnë përfundimin e të gjitha fazave të ndërtimit të përcaktuara për objektin në dokumentacionin ndërtimor, dhe

2.2. evidencën e rezultateve pozitive të testimit të kryer siç është parashikuar në Kod.

3. Inspekcioni ndërtimor ka të drejtë të bëjë inspektimin final të vend ndërtimit dhe poseduesi i lejes ndërtimore duhet t'i siguroj qasje të arsyeshme në vend ndërtim.

4. Nëse kushtet e parapara me ligj janë përmbushur, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve për kategorinë I dhe brenda tridhjetë (30) ditëve për kategorinë II dhe III prej ditës së pranimit të dokumentacionit. Në rast se organi kompetent nuk e ka informuar aplikuesin për vendimin e tij brenda afatit të paraparë, certifikata e përdorimit konsiderohet e lëshuar. Në rastin e tillë, organi kompetent e lëshon certifikatën e përdorimit.

KREU IX
MBIKËQYRJA

Neni 29
Mbikëqyrja inspektuese

Funksionin e inspektimit të paraparë me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore e kryen Inspekcioni Ndërtimor i Ministrisë dhe Inspekcioni Ndërtimor i Komunave brenda kompetencave të tyre.

Neni 30
Autorizimet e Inspektorit

1. Inspekcioni përkatës ndërtimor ka të drejtë të bëjë inspektim të çdo objekti ndërtimor brenda kompetencave të tij në pajtueshmëri me këtë ligj.

2. Poseduesi i lejes ndërtimore dhe kontraktuesi duhet t'i sigurojnë qasje të arsyeshme inspekcioni ndërtimor kur ai i kryen detyrat e tij sipas këtij ligji.

Neni 31

Inspektimi pas përfundimit të fazave ndërtimore

1. Secila fazë ndërtimi është pjesë përbërëse e kërkesave të lejes ndërtimore dhe inspektimi realizohet pas përfundimit të secilit prej këtyre fazave në kuadër të zbatimit të kërkesave të lejes ndërtimore.

2. Inspektori verifikon përputhjen e punëve të përfunduara me dokumentacionin ndërtimor dhe do të prodhojë protokoll mbi përfundimin e fazës respektiv të ndërtimit, i cili nënshkruhet nga poseduesi i lejes, kontraktuesi dhe inspektori.

3. Në rastin kur inspektori nuk e realizon inspektimin me rastin e përfundimit të ndonjë prej fazave të ndërtimit, poseduesi i lejes e prodhon protokollin mbi përfundimin e asaj faze të ndërtimit, i cili nënshkruhet nga poseduesi i lejes ndërtimore dhe kontraktuesi.

4. Poseduesi i lejes ndërtimore e njofton organin kompetent me shkrim lidhur me përfundimin e secilës fazë ndërtimi. Inspekcioni i ndërtimit do të realizojë secilin inspektim në ditën e shtatë pas pranimit të atij njoftimi.

5. Në rastin kur inspekcioni i ndërtimit konkludon se punët e kryera nuk përputhen me dokumentacionin ndërtimor, përgatitet protokoll i sqarues lidhur me mospërputhjen. Poseduesi i lejes ndërtimore korrigjon mospërputhjen brenda një kohe të arsyeshme, ashtu siç përcaktohet nga inspekcioni i ndërtimit.

Neni 32

Ndalimi i produkteve ndërtimore

1. Në rast se inspekcioni ndërtimor përcakton se materialet ndërtimore nuk përputhen me Kodin, inspekcioni mundet që verbalisht të ndaloj përdorimin e materialeve të tilla. Urdhrat verbale prodhojnë efekt të menjëhershëm.

2. Urdhrat verbale i dërgohen me shkrim poseduesit të lejes ndërtimore brenda tre (3) ditëve. Ndërtimi i afektuar nga jo-konformiteti mund të vazhdohet vetëm nëse jo-konformiteti i tillë mënjanohet.

Neni 33

Ndërprerja e ndërtimit për mospërputhje me kërkesat e lejes ndërtimore

1. Gjatë inspektimit, inspekcioni ndërtimor mund t'i urdhëroj poseduesit të lejes ndërtimore të ndërpres ndërtimin menjëherë nëse objekti ndërtimor ose një pjesë e tij ndërtohet në kundërshtim me lejen ndërtimore dhe në rastin e tillë vetëm pjesa e ndërtimit që ndërlidhet me mospërputhjen e identifikuar me kërkesat e lejes ndërtimore ndërpritet.

2. Në rast se ndërtimi ndalohet në përputhshmëri me këtë nen, inspekcioni do të ofrojë sqarim të detajizuar me shkrim për arsyet e ndaljes së ndërtimit.

3. Në rast se veprimi i përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni, ndërmerret për objektet ndërtimore të trashëgimisë kulturore, inspekcioni ndërtimor e njofton organin kompetent qeveritar.

Neni 34

Rrënimi i objektit ndërtimor

1. Gjatë inspektimit, inspekcioni ndërtimor mund të urdhëroj poseduesin e lejes ndërtimore të rrënoj objektin ndërtimor nëse është vërtetuar se ka parregullsi të riparueshme që rrezikojnë stabilitetin e ndërtimit, stabilitetin e ndërtimeve fqinje apo vë në rrezik jetën e personave.

2. Në kryerjen e inspektimit, inspektori ndërtimor me vendim mundet të urdhërojë poseduesin e lejes ndërtimore të rrënoj objektet ndërtimore të përkohshme që nuk janë rrënuar brenda afatit të përcaktuar;
3. Me vendimin nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni, inspekcioni ndërtimor do të përcaktoj kohën e mjaftueshme brenda së cilës poseduesi i lejes ndërtimore duhet ta rrënoj objektin ndërtimor apo një pjesë të tij.
4. Në rast se veprimi i përshkruar në paragrafin më lartë ndërmirret për ndërtimet apo objektet e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe ato në zonat e veçanta të mbrojtura, inspekcioni i ndërtimit e njofton organin kompetent qeveritar.
5. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, inspektori ndërtimor nuk kërkon nga poseduesi i lejes ndërtimore të rrënoj ndërtimin apo pjesë të tij nëse do të kishte rrezik për shëndetin dhe jetën e njerëzve, ndërtimet tjera apo stabilitetin e tokës përkufizuese. Në rastin e tillë, poseduesi i lejes ndërtimore përpilon planin e rehabilitimit i cili duhet të aprovohet nga organi kompetent.

KREU X GJOBAT DHE NDËSHKIMET

Neni 35 Kundërvajtjet nga pronari

1. Mënyra, procedurat, ekzekutimi dhe shumat e gjobave ndaj pjesëmarrësve në ndërtim përcaktohen nga Ministria me akt të veçantë administrativ dhe rishikohet dhe miratohet për çdo vit dhe publikohen në Gazetën Zyrtare.
2. Poseduesi i lejes ndërtimore do të gjobitet nëse:
 - 2.1. puna ndërtimore krijon rrezik për personat tjerë, dhe nëse nuk siguron, rrethon ose shënjon dukshëm me shenja treguese rreziqet që mund t'u kanosen kalimtarëve;
 - 2.2. nuk vendos në vend ndërtim tabelën informuese, apo
 - 2.3. nuk ndërmerr masa për sigurimin e ndërtimit dhe ndërtimeve fqinje.

Neni 36 Kundërvajtjet nga organet kompetente

Të gjithë punonjësit përgjegjës dhe Inspektorët në organet kompetente që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj si dhe për shkeljet e evidentuara procedurale sipas këtij ligji do të merren masa ndëshkuese financiare dhe penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

Neni 37 Kufizimet e fuqisë ligjore

Procedurat ligjore të ndërmarra si rezultat i shkeljes së këtij ligji mund të mos fillojnë më vonë se një (1) vit nga data kur një shkelje e tillë është kryer.

KREU XI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ligji i Ndërtimit, Nr. 2004/15, dhe Rregullorja e UNMIK-ut mbi Shpalljen e Ligjit për Ndërtim, Nr. 2004/37, së bashku me dispozitat ligjore në ligjet tjera që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

2. Ministria, më së largu në afat prej tre (3) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të harmonizojë Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe ligjet tjera relevante me dispozitat e këtij ligji.

3. Ministria, në koordinim me ministritë tjera, komunat, komunitetin e biznesit dhe palët tjera të interesuara, do të nxjerr Kodin Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi të këtij ligji. Kodi aprovohet nga Qeveria e Kosovës. Deri në kohën e aprovimit të Kodit Unik të Ndërtimit, referimet në këtë ligj ndaj Kodit Unik të Ndërtimit do të konsiderohen si referime ndaj standardeve ekzistuese të ndërtimit.

4. Ministria, në koordinim me ministritë tjera dhe komunat, obligohet që në afat prej gjashtë (6) muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerr udhëzimet e domosdoshme administrative për zbatimin e këtij ligji. Udhëzimet administrative do të përfshijnë:

4.1. standardet dhe procedurat minimale për shqyrtimin teknik të dokumentacionit ndërtimor që dorëzohet nga aplikuesi për të vërtetuar nëse dokumentacioni ndërtimor është përgatitur në përputhje me Kodin Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës (ose para aprovimit të Kodit, në përputhje me standardet ekzistuese të ndërtimit).

4.2. standardet dhe procedurat minimale për mbikëqyrjen inspektive ashtu siç është paraparë në Kreun IX të këtij ligji. Brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha komunat do të zbatojnë plotësisht standardet dhe procedurat të referuara në nën-paragrafët 4.1 dhe 4.2 te paragrafit 4 të këtij paragrafi.

5. Brenda një (1) muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, komunat do të vlerësojnë resurset dhe kapacitetet e tyre interne për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe propozojnë taksat e lejeve ndërtimore, sipas formulës së paraparë me këtë ligj. Ministria brenda tre (3) muajve nga pranimi i normave të taksave të lejeve ndërtimore nga organet kompetente për leje ndërtimore, vlerëson propozimet në përputhje me formulën e paraparë me këtë ligj. Pas vlerësimit nga Ministria, normat do të bëhen publike nga Ministria dhe komunat për komente publike për gjashtëdhjetë (60) ditë. Pas skadimit të periudhës së komenteve, normat e taksave të lejeve ndërtimore do të bëhen publike për njoftim nga Ministria dhe komunat për gjashtëdhjetë (60) ditë.

6. Pas tetë (8) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, normat e aprovuara do të bëhen efektive dhe procesi për aprovimin e normave do të bëhet sipas këtij ligji.

7. Udhëzimi administrativ për provimin profesional dhe licencimin e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit nr. 06/2011, mbetet në fuqi derisa i njëjti të mos ndryshohet, plotësohet dhe amendamentohet.

Neni 39 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L- 110
31 maj 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-030-2012, datë 19.06.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

SHTOJCA Nr. 1

LEJA E NDËRTIMIT

Kompetencat për dhënien e lejes së ndërtimit

1. Ministria është kompetente për dhënien e lejes së ndërtimit për objekte ndërtimore, si vijon:

1.1. digat e larta dhe akumulimet e ujit, mbetjet nga minierat ose hiri për të cilat parashihet përkujdesje teknike;

1.2. objekte nukleare dhe objektet tjera të cilat shërbejnë për prodhimin e lëndëve nukleare djegëse, radioizotopeve, rrezatimit, deponi të mbetjeve radioaktive për qëllimet e hulumtimeve shkencore;

1.3. objektet për përpunimin e naftës dhe gazit, naftësjellësit dhe gazsjellësit ndërkombëtar dhe magjistrat, tubacionet e gazsjellësit me shtypje mbi gjashtëmbëdhjetë (16) bar nëse kalon së paku nëpër dy (2) komuna, deponive të naftës, gazit dhe derivateve të naftës me kapacitet mbi pesëqind (500) tonë, ujësjellësit të ujit të nxehtë magjistrat dhe regjional, objekteve për prodhimin e biodizellit;

1.4. objektet bazike për përpunimin e industrisë kimike, metalurgjisë së zezë dhe të ngjyrosur, objektet për përpunimin e lëkurës dhe leshit, objektet për përpunimin e kauçukut, objektet për prodhimin e celulozës dhe letrës dhe objektet për përpunimin e lëndës së parë të mineraleve jometale, përveç objekteve për përpunimin primar të gurëve të çmueshëm stolisësh dhe gurëve të tjerë në pajtim me rregulloren e cila përcakton listën e projekteve për të cilat kërkohet vlerësimi i ndikimit në mjedis;

1.5. stadiumeve për dhjetë mijë (10.000) e më shumë spektatorë, silose me kapacitet mbi dhjetë mijë (10.000) m³ objektet e institucioneve ndëshkuese korrektuese;

1.6. hidrocentrale dhe termocentrale me diga përkatëse me fuqi dhjetë (10) e më shumë MW, termocentrale me fuqi dhjetë (10) e më shumë MW dhe termocentrale - ngrohtore elektrike me fuqi dhjetë (10) e më shumë MW si dhe largpërçues dhe trafostacione të tensionit njëqind e dhjetë (110) e më shumë KV;

1.7. objektet ndër regjionale dhe regjionale të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit, impianteve për përgatitjen e ujit për pije me kapacitet mbi katërqind (400) l/s dhe impianteve për pastrimin e ujërave të zeza në vendbanimet me mbi pesëmbëdhjetë mijë (15.000) banorë ose me kapacitet dyzet (40) l/s;

1.8. punëve rregulluese për mbrojtje nga ujërat e mëdha në zona urbane dhe sipërfaqe rurale më të mëdha se treqind (300) ha;

1.9. objektet me vlerë kulturore me rëndësi të veçantë, objektet me vlerë kulturore të regjistruara në listën botërore të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, objektet në zonat e mbrojtura në përputhje me Ligjin për objektet e trashëgimisë kulturore, objektet brenda kufijve të parqeve kombëtare, përveç shtëpive familjare, objekteve ekonomike dhe bujqësore dhe infrastrukturat e tyre kur ato ndërtohen në fshat;

1.10. impiantet për trajtimin e mbeturinave jo të rrezikshme, me djegie apo në mënyrë kimike me kapacitet më të madh se shtatëdhjetë (70) tonë në ditë;

- 1.11. impiantet për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme me ndezje, me metoda termike dhe/ose fizike, fiziko-kimike dhe kimike, si dhe deponitë qendrore dhe/ose deponitë për mbetje të rrezikshme;
 - 1.12. aeroportet;
 - 1.13. portet e pasagjerëve, portet dhe терминаlet;
 - 1.14. rrugëve shtetërore të rendit të parë dhe të dytë, objekteve në shërbim të rrugëve dhe hyrjeve në komunikacion në këto rrugë dhe në kalimet kufitare;
 - 1.15. infrastrukturat publike hekurudhore së bashku me lidhjet në to dhe metrotë;
 - 1.16. objektet e telekomunikacionit, përkatësisht rrjetit, sistemet ose pajisjet të cilat janë të rëndësishme ndërkombëtare dhe magjistralet si dhe ato të cilat ndërtohen në territorin e dy apo më shumë komunave;
 - 1.17. deponitë regjionale ose deponitë për deponimin e mbeturinave jo të rrezikshme për zona me mbi dyqind mijë (200.000) banorë;
 - 1.18. objektet për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritjes energjetike me fuqi dhjetë (10) e më shumë MW si dhe centralet me prodhim të kombinuar.
2. Komunat janë kompetente për dhënien e lejeve të ndërtimit për të gjitha objektet ndërtimore të cilat nuk janë përfshirë në paragrafin 1. të këtij neni.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 33/2007
PËR
KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR
QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

KREU I .

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen kushtet teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar (në tekstin e mëtejme PAK) dhe modernizimi i qasjes në objektet ndërtimore publike për destinim pune, banimi dhe banesor-afariste, si dhe kushtet dhe mënyra e përshtatshmërisë së thjeshtë të qasjes në objektin ndërtimor me destinim banimi dhe banesor-afarist.

Neni 2.

(1) Qasja, modernizimi i qasjes dhe përshtatja e thjeshtë e qasjes në objekte ndërtimore sipas neni 1 të këtij Udhëzimi Administrativ, sigurohet me projektim dhe realizim të punëve në ndërtim në mënyrë që të përmbaj elementet obligative qasëse dhe/ose që të përmbush kushtet për qasje të personave me PAK, të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

(2) Kur elementet e qasjes janë njëkohësisht edhe pjesë e rrugës për dalje në rast rreziku, atëherë duhet të plotësohen edhe kërkesat sipas rregulloreve të veçanta.

(3) Pronari i objektit ndërtimor është i obliguar që t'i mirëmbajë elementet qasëse dhe nuk guxon t'i zvogëloj kushtet e përdorimit të mjeteve ndihmëse për lëvizje të PAK.

Neni 3.

(1) Paraqitja e shenjave të qasjes me fotografi, kushtet e përdorimit të mjeteve ndihmëse dhe elementet e obligueshme të qasjes, janë të dhëna në shtojcat të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Shenjat e qasjes duhet të jenë me madhësi të përshtatshme dhe të vendosura në vendet e dukshme.

Neni 4.

Përkufizimet në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë domethënie:

1. **Personat me aftësi të kufizuara** janë personat e verbër, me shikim të dobësuar, të shurdhër, me dëgjim të dobësuar, me dëmtime trupore etj;

2. **Person me lëvizje të vështirësuar** - është personi i cili ka pengesa të përkohshme ose të përhershme gjatë lëvizjes, gjatë periudhës së shtatzënisë dhe për shkaqe tjera;

3. **Mjet ndihmës për PAK** – janë mjetet ndihmëse për orientim dhe mjetet ndihmëse për lëvizje;

4. **Mjet ndihmës për orientim** - është shkopi i bardhë dhe qeni përcjellës;

5. **Mjet ndihëms për lëvizje** – është karroca për PAK, shkopi, paterica dhe ndihmësja për ecje;

6. **Pengesa** - është pengesë komunikuese dhe orientuese e cila e pengon personin me aftësi të kufizuar ose ia pamundëson qasjen, lëvizjen, qëndrimin dhe lëvizjen gjatë punës;

7. **Qasja** - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK dhe me lëvizje të kufizuar i'u sigurohet lëvizje pa pengesë, qëndrim dhe punë në këto ndërtesa në të njëjtin nivel sikurse personave tjerë.

8. **Ndërtimi qasës** - pjesa e tij ose pajisja (rampa, shkallët, lifti, platforma vertikale ngritëse, platforma e pjerrtë e lëvizshme paluese, hapësira hyrëse, komunikimi, WC, banjoja, kuzhina, dhoma, klasa, hapësira e punës, banimi/apartamenti, kafeneja, restorani, gardëroba, dush kabina, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, dorëza e derës dhe e dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, semafori, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi): është ai objekt ndërtimor, pjesë e objektit ndërtimor ose pajisje, e cila siguron përmbushjen e elementeve të obligueshme qasëse të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

9. **Elementet e obligueshme për qasje** - janë elementet për projektimin dhe ndërtimin me të cilat përcaktohet madhësia, vetitë, instalimet, stabilimentet dhe pajisjet tjera të ndërtesës për sigurimin e qasjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punës të PAK, në të njëjtin nivel me personat tjerë .

10. **Shenjat qasëse** - janë shenjat me të cilat përcaktohen elementet e obliguara për qasje.

11. **Banesa që përshtatet lehtë** - është banesa e cila sipas nevojës mund të përshtatet për qasje pa ndikuar në kërkesat kryesore për ndërtesën e përdorur.

12. **Lajmërimi me sinjalizime të dritës** - është lajmërimi dhe paralajmërimi i personave të shurdhër dhe personave me dëgjim të dobësuar me ndihmën e sinjalizimit të dritës.

13. **Lajmërimi zanor** - është lajmërimi dhe paralajmërimi i personave të verbër dhe me shikim të dobësuar nëpërmjet zërit.

14. **Sinjalizimi zanor** - është sinjalizimi i cili ndihmon personat e verbër dhe me shikim të dobësuar për orientim në hapësirë.

15. **Harku induktiv ose rrethi transmetues** - është instalim, i cili vendoset për të larguar zhurmën nga rrethi dhe për të përmirësuar kualitetin e zërit.

16. **Ndihmësja komunikuese** - është pajisje, e cila i mundëson personave të cilët shfrytëzojnë aparatin dëgjues për pranimin e sinjaleve dëgjuese pa pengesa.

17. **Tekstofon** - është telefon i përshtatur për persona të shurdhër dhe me dëgjim të dobësuar me ç'rast dy bashkëbisedues komunikojnë me shkrim.

18. **Përpunimi taktor** - është përpunimi përfundimtar relievor i sipërfaqes së ecjes.

19. **Vija taktore drejtuese** - është përpunimi relievor i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimin të lëvizjes përcaktohet me ndërrimin e strukturës relievore me gjërsi së paku 40 cm.

20. **Vija taktore paralajmëruese** - është përpunim relievor i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave të verbër dhe shikim të dobësuar për rrezik nga komunikacioni .

21. **Fusha taktore paralajmëruese** - është përpunimi relievor i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për lajmërim dhe paralajmërim të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar për ndryshimin e nivelit të lëvizjes.

22. **Element tipik** - është element i dedikuar për ndarjen e sipërfaqes publike të ecjes nga shiritat e komunikacionit të automjeteve, shtigjet e biçikletave dhe/ose parkingjet, ndërsa mund të jetë i formës së ndryshme dhe dedikimeve të ndryshme si: vazo për lule, mure, ulëse dhe të ngjashme.

23. **Sipërfaqja publike e këmbësoreve** - është shteg për këmbësor, shesh i këmbësoreve, mbikalim dhe nënkallim i këmbësorëve, ura e këmbësoreve dhe të ngjashme.

24. **Plani taktor i kalimit** - është shenjë relievore e cila personave të verbër dhe me shikim të dobësuar i'u afron informata për gjatësinë dhe llojin e kalimit të këmbësoreve përtej shtegut të automjeteve.

Neni 5.

(1) Obligimet nga ky Udhëzim Administrativ ju referohen objekteve ndërtimore publike dhe administrative, si dhe objekteve ndërtimore të banimit dhe banesore-afariste.

(2) **Objektet ndërtimore publike dhe administrative janë:**

1) ndërtimet për shërbime tregtare, hotelerike dhe turistike: shtëpi e mallrave, qendër tregtare vetëshërbim (minimarket) me sipërfaqe shërbyese 400 m² dhe më shumë; treg, kafe bar, kafene dhe restorant me 80 e më shumë vende; diskotekë dhe klub nate , me sipërfaqe më shumë se 400m²; qendër turistike informative, zyre turistike prej 200 m² e më shumë; agjenci me sipërfaqe 200 m² e më shumë; recepcion me qëndrim të lirë; ndërtim i turizmit shkencor(nautike), hotel (dhoma/TWC) me 50 e më shumë dhoma, hotel me 50 e më shumë dhoma me njësi sanitare të përbashkët; vendbanim turistik me 50 më shumë apartamente; kamp për 500 e më shumë mysafir; restorant pran autostradës ose rrugës magjistrale; hotel me shenjë të veçantë pranë autostradës ose rrugës magjistrale, përmbajtja tregtare e pompës e të ngjashme;

2) ndërtimet postare ose/dhe me destinim telekomunikative: halla postare për punë me palë me më se paku se tri sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta; hallë postare për punë me palë me tre apo më shumë sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta; qendra tel kumunikative për ofrim të shërbimeve shfrytëzuesve, me tre apo më shumë sportele ose pulte të tipit të punëve të njëjta; ndërtimet në të cilat u ofrohet shfrytëzim telekomunikimi, telefoni, faksi publik me tri ose më shumë aparate dhe të ngjashme;

3) ndërtimet për ofrim të shërbimeve të qarkullimit të parasë dhe shërbimeve tjera financiare: filialë e bankës më pak se tri sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta; filiala e bankës më shumë se tri sportele ose pulti i tipit të punëve të njëjta; agjencioni financiar me më pak se tri sportele ose pulte të tipit të punëve të njëjta; financiar, filial e agjencion financiar me tri ose më shumë sportele ose pulte të tipit të punëve të njëjta dhe të ngjashme;

4) ndërtimet për qëllime administrative: ndërtesa për institucione të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, administratës shtetërore, qeverisë dhe kuvendit, gjykatave shtetërore, përfaqësive të personave juridik me autorizimet publike dhe të ngjashme;

5) ndërtimet për qëllime shëndetësore sociale dhe rehabilituese: zyra e shërbimit të furnizimit socialo-shëndetsor, barnatore dhe dyqan për shitjen e mjeteve ndihmëse ortopedike, ambulantë, shtëpi shëndeti, spital, shtëpi shëruese, pishina e mbyllur shëruese, pishina e hapur shëruese, banja e mbyllur publike, shtëpi për të moshuar dhe PAK me 20 apo më shumë dhoma me njësi të përbashkëta sanitare, shtëpi e tipi hotel

për të moshuar dhe PAK me 20 a më shumë dhoma (dhoma/TWC), shtëpi për persona të moshuar e tipit apartament me 20 a më shumë apartamente, byro e shërbimit të kujdesit sociale shëndetësor për punë me palë, kuzhina popullore, e të ngjashme;

6) ndërtesat në të cilat më së shpeshti qëndrojnë PAK: ndërtesat në të cilat veprojnë shoqatat, unionet ose asociacionet e PAK; institucionet për edukim dhe arsimim, rehabilitim, strehim të PAK e të ngjashme;

7) ndërtimet e dedikuara për edukim dhe arsim: çerdhe fëmijësh, kopsht fëmijësh, shkollë, shkolla e lartë, universitet, konvikt i nxënësve dhe studenteve me 50 dhe më shumë dhoma me sanitare të përbashkëta; konvikt i nxënësve dhe studentëve i llojit të hotelit(dhoma/TWC) me 50 e më shumë dhoma; vendbanim i studenteve me 50 e më shumë apartamente dhe të ngjashme;

8) ndërtimet e dedikuara për kulturë: biblioteka universitare, qendra e kulturës, qendra e kongresit, muzeu, galeria, hapësira për ekspozitë prej 300m² e më shumë; kinemaja, teatri dhe salla për koncerte me 100 e më shumë vende dhe të ngjashme;

9) ndërtimet e dedikuara për komunikacion: stacioni i autobusëve dhe hekurudhës; aeroporti, peroni hekurudhor, vendpushimi pranë autostradës dhe parkingjet publike; garazhat publike me kapacitet prej 300 e më shumë automjete; pompa e benzinës dhe të ngjashme;

10) ndërtimet e dedikuara për sport dhe rekreacion: terreni sportiv, halla sportive për 100 e më shumë vende dhe të ngjashme;

11) ndërtimet për shërbime fetare dhe sakrale: halla ceremoniale; qendra humanitare dhe të ngjashme;

12) ndërtimet e dedikuara për argëtim: parku argëtues: kopshti zoologjik dhe botanik dhe të ngjashme;

13) ndërtesat për vuajtjen e dënimeve me burg: shtëpia e korrektimit; burgu; institucioni rehabilitues e të ngjashme;

14) sipërfaqet dhe hapësirat publike: sheshi i këmbësorëve, rruga, shtegu në park, lojërat e fëmijëve, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme;

15) ndërtimet tjera: panairi dhe qendra e ekspozitave, WC-të publike, ndërtimet të cilat duhet të ketë 4 e më shumë WC njësi, kapella dhe krematoriumi, strehimorja publike dhe të ngjashme.

(3) Objektet ndërtimore banesore dhe banesore-afariste janë:

1) Objekti banesore me dhjetë e më shumë banesa, ekskluzivisht me destinim banimi.

2) Objekti banesor-afarist është objekt me destinim banimi dhe destinime tjera, që ka dhjetë apo më shumë banesa.

(4) Kur në objektin ndërtimor me destinim banimi gjendet hapësira publike për qëllime afariste atëherë në atë ndërtesë, varësisht nga lloji i aktivitetit i cili kryhet në atë hapësirë, aplikohen dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ me të cilën përcaktohen kushtet për ndërtesat nga paragrafi 2 të këtij neni.

(5) Obligimet për plotësimin e kushteve nga ky Udhëzim Administrativ, përveç ndërtimeve nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, duhet t'i plotësojnë edhe objektet tjera ndërtimore të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

KREU II.

KUSHTET PËR PËRDORIMIN E MJETEVE NDIHMËSE

Neni 6.

(1) Me kushtet për përdorimin e mjeteve ndihmëse nga PAK (në tekstin e mëposhtëm: kushtet e përdorimit të mjeteve ndihmëse) nënkuptohet:

- hapësira e nevojshme për lëvizje të PAK me karrocë (e paraqitur në fig. 2 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ);
- hapësira e nevojshme për përdorimin e shkopit, patericës, mjetit ndihmës për ecje (e paraqitur në fig. 3. të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ), dhe
- hapësira e nevojshme për përdorimin e shkopit të bardhë dhe qenit përcjellës (e paraqitur në fig. 4 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ).

(2) Nëse me këtë Udhëzim Administrativ për objektin e caktuar ndërtimor nuk është caktuar elementi i nevojshëm për qasje, zgjidhja teknike e objektit ndërtimor duhet t'i plotësoj kushtet për përdorimin e mjeteve ndihmëse.

KREU III.

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE

Neni 7.

(1) Elementet obligative për qasje janë:

- A. elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme;
- B. elementet e qasjes për jetë të pavarur;
- C. elementet për qasje në komunikacion publik.

(2) Gjatë aplikimit të elementeve obligative për qasje merret zgjidhja më e volitshme në lidhje me destinimin dhe vetitë tjera të rëndësishme të objektit ndërtimor.

Sipërfaqja taktore

Neni 8.

(1) Sipërfaqja taktore qasëse realizohet me punim relievor në lartësi deri 5 mm në mënyrë që të mos vështirësoj lëvizjen e PAK me karrocë, të jetë e njohur me prekjen e shputës ose me shkop të bardhë, të mos qëndroj uji, bora dhe mbeturinat, si dhe të mirëmbahet lehtë.

(2) Shembulli i sipërfaqes taktore qasëse, është paraqitur në fig. 5 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Dimensionet minimale të sipërfaqes taktore dhe vendi në të cilin është i obliguar aplikimi i tyre janë përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ.

(4) Vija taktore drejtuese, vija taktore paralajmëruese dhe/ose fusha taktore paralajmëruese, detyrimisht duhet të kenë karakteristikat e përcaktuara të sipërfaqeve taktore.

A. ELEMENTET PËR QASJE NË NIVELE ME LARTËSI TË NDRYSHME

Neni 9.

Për nevojat e qasjes në sipërfaqe me lartësi të ndryshme, në të cilat lëvizin PAK mund të shfrytëzohen këto elemente të nevojshme për qasje: rampa, shkallët, ashensori, platforma vertikale ngritëse dhe platforma e pjerrët ngritëse palosëse.

Rampa

Neni 10.

(1) Rampa përdoret si element për nevojat e qasjes në sipërfaqe me lartësi të ndryshme deri në 120cm, në hapësirat e jashtme dhe të brendshme.

(2) Rampa duhet të plotësoj kushtet gjegjësisht të ketë:

- pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);
- gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme;
- pushimore me gjatësi së paku 150 cm, e vendosur në çdo 6m të gjatësisë së rampës,
- sipërfaqe të fortë kundër rrëshqitëse;
- rrethojë të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur;
- dorëz mbajtëse me diametër 4 cm, e formësuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm, sipas fig. 7 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- rrethojë të rampës i cili gjendet në hapësirat e jashtme, dorëza mbajtëse e tij duhet të realizohet ashtu që të mos jetë e ndjeshme në ndryshimet termike ;
- rrethojë me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;
- shenjat qasëse sipas fig. 1 dhe atë:1.5, 1.7 dhe 1.8 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Rampa dhe kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni, janë të paraqitura në figurën 6 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(4) Përrjashtimisht për ndryshim të lartësive deri në 76 cm, pjerrtësia e lejuar mund të jetë kryesisht me 1:12(8%).

(5) Përrjashtimisht prej paragrafit 1 të këtij neni në hapësirat e jashtme kur për to ekzistojnë kushtet për qasje në ndryshim të lartësive më të mëdha se 120 cm mund të përdoret rampa sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni.

Shkallët

Neni 11.

(1) Shkallët duhet të plotësojnë këto kushte, gjegjësisht duhet të kenë:

- lartësi të shkallës deri 15 cm;
- gjerësi jo më të vogël të sipërfaqes shkelëse se 33 cm;
- gjerësi drite të hapit të shkallës në hapësira të mbyllura me së paku 110 cm;
- gjerësi drite të hapit të shkallës në hapësira të jashtme më së paku 120 cm;
- skaji i shkelëses duhet të jetë i vrazhdë (kundër rrëshqitës) dhe me kontrast vizual të përpunuar me gjerësi prej më së paku 2 cm;
- dorëz mbajtëse e rrethojës së shkallëve e cila në fillim dhe në fund të shkallëve duhet të jetë e zgjatur për 30 cm nga shtylla e fundit gjegjësisht fillimit,si dhe e njëjta të jetë e rrumbullaksuar e paraqitur si në fig. 7 në shtojcën e këtij Udhëzimi Administrativ;
- dorëz mbajtëse e rrethojës së shkallëve të realizuar në mënyrë që mund të kapen - me pëllëmbë;
- dorëz mbajtëse në rrethoj në hapësirat e jashtme të realizuara ashtu që të mos jenë të ndjeshme në ndryshimet termike;
- krahun e shkallës me gjerësi 250 cm dhe më shumë të realizuar me dorëz mbajtëse në mes, e paraqiture si në fig. 9 në shtojcën e këtij Udhëzimi Administrativ;
- hapësirë nën shkallë e rrethuar me rrethoj në lartësi prej 70 cm deri te vendi ku është lartësia e shikimit të krahut të shkallëve 210 cm ose nën krahun e shkallëve të deniveluar të ngritur më së paku 3 cm deri te vendi ku lartësia e shikimit të krahut të shkallëve është 210 cm e paraqitur si në fig. 10 në shtojcën e këtij Udhëzimi Administrativ;
- rrethoj me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;
- para shkallës së parë dhe mbas asaj të fundit realizohet fusha taktore e paralajmërimit në gjerësinë e plotë të krahut të shkallëve me gjerësi më së paku 40cm me gravime pingul në drejtim të lëvizjes në harmoni me dispozitat e nenit 8 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- shenjat qasëse sipas figurës 1 dhe atë : 1.2, 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.9 shtojcë e këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Shkallët dhe kushtet nga paragrafi 1 të këtij Udhëzimi Administrativ janë të paraqitura në fig. 8 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Ashensorët

Neni 12.

(1) Ashensorët përdoren si element për nevojat e qasjes në nivele me lartësi të ndryshme më të mëdha se 120 cm në hapësirat e jashtme dhe të brendshme.

(2) Ashensorët duhet ti përmbushin këto kushte, gjegjësisht të kenë:

- dimensione të brendshme të ashensorit më së paku 110x140 cm;
- gjerësi të derës së paku 90 cm;

- derë të ashensorit e cila hapet nga jashtë ose rrëshqitëse;
- pllakë drejtuese dhe lajmëruese e vendosur në lartësi prej 90 cm deri 120 cm;
- pllakë drejtuese dhe lajmëruese me pulla kontrast të punuara, me numra relevor të kateve dhe shenja tjera me mbishkrim në alfabetin Braille; dorëz mbajtëse në ashensor në lartësi 90 cm;
- ndriçim vizual dhe lajmërim tingëllues në kate;
- kur është në ndërtesat publike dhe me destinim pune nga neni 5 paragrafi 2 pika 8 dhe 6 të këtij Udhëzimi Administrativ ashensori ka edhe lajmërimin folës në kate;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te ashensori vendosen vijat udhëheqëse taktore me gjerësi më së paku 40 cm të gravura në drejtim të lëvizjes;
- shenjat qasëse sipas figurës 1 dhe atë : 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.10, shtojcë e këtij Udhëzimi Administrativ;
- ashensori dhe kushtet nga paragrafi 2. të këtij neni janë të paraqitura në fig. 11 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Kur qasja në nivele me lartësi të ndryshme bëhet me më shumë ashensorë, atëherë më së paku një ashensorë duhet të jetë sipas dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni.

Platforma ngritëse vertikale

Neni 13

(1) Platforma ngritëse vertikale përdoret si element për nevojat e qasjes në nivele me lartësi të ndryshme më të mëdha se 120 cm në hapësirat e jashtme dhe të brendshme, kur e njëjta nuk zgjidhet me ashensorë qasës ose elemente tjera qasëse të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

(2) Platforma ngritëse vertikale duhet ti përmbushë këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- sipërfaqe qasëse të madhësisë së platformës më së paku 110x140 cm;
- platforma boshtore anësore të mbyllura deri në 120 cm;
- derë hyrëse me gjerësi më së paku 90 cm e cila hapet nga jashtë ose rrëshqitëse;
- shenjë të qasjes sipas fig. 1.11 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- platforma ngritëse vertikale dhe kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 12 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Platforma e pjerrët ngritëse palosëse

Neni 14

(1) Platforma e pjerrët ngritëse palosëse përdoret si element qasës për nevojat e qasjes në nivele me lartësi më të mëdha se 120 cm në hapësirat e jashtme dhe të brendshme kur e njëjta nuk zgjidhet me ashensorë qasës ose element tjetër qasës të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

(2) Platforma e pjerrët ngritëse palosëse vendoset në muret anësore të shkallëve ose në rrethojën e shkallëve përgjatë gjatësisë së shkallëve dhe duhet të ketë :

- sipërfaqen minimale qasëse me dimensione 90x120 cm;
- mbrojtësen boshtore palosëse të dyshemesë me madhësi 20 cm dhe dorëzën palosëse mbrojtëse;
- shenjën qasëse sipas fig. 1.12 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ
- platforma e pjerrët ngritëse palosëse dhe kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 13 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

B. ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR

Neni 15.

Me qëllim të mundësimin të jetesës së pavarur të PAK shërbejnë këto elemente qasëse: hapësira hyrëse, komunikimi, WC, kabina për pastrim, kuzhina, dhoma, klasa, hapësira e punës, banesa, kafenet dhe restorantet, gardërobat, dush kabina, hyrja në ujë në pishinë, vendet në tribuna, telefonat, tekstafon, faks, bankomat, instalimet elektrike, dorëza e derës dhe e dritareve, sportel, pulti, tabela e shpalljeve dhe ekspozitave, plani për orientim të lëvizjes në ndërtesa dhe të ngjashme.

Hapësira hyrëse

Neni16.

(1) Hapësira hyrëse në ndërtesë është hyrja deri te e cila arrihet drejtpërdrejt nga sipërfaqja publike e këmbësoreve ose me ndihmën e elementeve qasëse në nivele me lartësi të ndryshme.

(2) Hapësira hyrëse duhet ti plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- derë një krahëshe me gjërësi së paku 110/210 cm ose derë dy krahëshe me gjërësi 2x90/210 cm;
- dera e cila hapet nga jashtë ose rrëshqitëse;
- dorëzën për qasjen sipas dispozitave të nenit 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- prag të derës me lartësi jo më të lartë se 2 cm;
- element për pastrimin e këpucëve i vendosur në nivel të dyshemesë;
- hapësirë drite më së paku 90 cm në rastet kur dera kryesore hyrëse është rrethore lëvizëse ose rrëshqitëse;
- në rastet kur dera kryesore hyrëse rrëshqitëse me hapësir drite më së paku 90/210 cm, para derës hyrëse në këtë rast sigurohet hapësira me madhësi më së paku 150x150 cm;
- shenja e hapjes së derës;
- në rastet kur dera hyrëse dhe muret ndarëse janë të punuara prej qelqi me sipërfaqe më të madhe se 1.5 m² pa transversale duhet të shënohen dukshëm në lartësinë prej 90 deri 160 cm ;
- erë mbrojtësi, me gjatësi deri në 240 cm;

- te hyrja orjentuese sigurohet edhe kalimi me rrethoj kthyses me hapësirë drite se paku 90 cm;
- ndriçimi në nivel të ndriçuarit prej 200 luxa;
- instalimet përkatëse elektrike në harmoni me dispozitat e nenit 29. të këtij Udhëzimi Administrativ,
- shenjat për qasje sipas fig. 1 dhe atë: 1.2, 1.3, 1.6, dhe 1.13, shtojcë e këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Shembulli i hapësirës hyrëse dhe kushteve nga paragrafi 2 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 4 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Komunikimi

Neni 17

(1) Komunikimet duhet të plotësojnë këto kushte, gjegjësisht duhet të kenë:

- gjerësi të korridorit më së paku 150 cm;
- sipërfaqe të ecjes të rregulluara në të njëjtin nivel;
- sipërfaqe të ecjes të cilat nuk janë në të njëjtin nivel, por të lidhura me elementet qasëse në nivele me lartësi të ndryshme në harmoni me këtë Udhëzim Administrativ;
- derë komunikimi pa prag me hapësirë drite më së paku 90cm;
- derë me dorëz qasëse sipas dispozitave të nenit 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- derë hyrëse e cila nga komunikimi orijenton në hapësira tjera të banimit dhe të ngjashme, e realizuar me prag jo më të lartë se 2 cm;
- shenja të dukshme në lartësi prej 90 deri 160 cm në rastet kur dera dhe muret ndarëse janë të punuara prej qelqi me sipërfaqe më të madhe se 1.5 m² pa transversale;
- pjesën hyrëse të ndriçuar në nivel të ndriçimit prej 100 luxa;
- vendet ku lëvizja drejtohet me anë të rrethojave, distanca ndërmjet këtyre rrethojave nuk mund të jetë më pak se 90 cm;
- të gjitha instalimet dhe pajisjet tjera më të gjëra se 10 cm të vendosura në brendi të murit (aparartet kundër zjarrit, hidrantët dhe të ngjashme);
- instalimet përkatëse elektrike në harmoni me dispozitat e nenit 29 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- shenjat për qasje sipas fig. 1 dhe atë: 1.1, 1.2, 1.3,1.6, dhe 1.8, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Shembulli i komunikimeve dhe kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni është i paraqitur në fig. 15 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 18.

(1) WC duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht duhet të ketë:

- derë me hapësirë drite më së paku 90 cm, me hapje nga jashtë;
- dorëz qasëse e derës sipas nenit 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- mekanizëm për hapjen e derës nga jashtë në raste të thirrjes për ndihmë;
- instalime përkatëse elektrike në harmoni me neni 29 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- guaskë me dërrasë për ulje në lartësi 45 deri 50 cm dhe me dy mbajtëse për duar me gjatësi 90 cm të vendosura në mure në lartësi prej 80 cm deri 90 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë;
- së paku një mbajtëse dore e cila duhet të jetë palosëse për qasje në WC-së, ndërsa tjetra mund të jetë e fiksuar në mure;
- distancë të skajit të përparmë të guaskës dhe murit më së paku 65 cm;
- pajisje për lëshimin e ujit në guaskë e vendosur në lartësi prej 70 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë ose lëshim sensorik të ujit në guaskë;
- lavaman konzoll me gjerësi së paku 50 cm në lartësi prej 80 cm me sifon të vendosur afër ose në mur ;
- krua me një dorëz ose me sensor për hapje dhe mbyllje të ujit;
- hapësirë shfrytëzuese para guaskës me gjerësi së paku 90 cm;
- hapësirë shfrytëzuese para lavamanit me gjerësi së paku 90 cm;
- hapësirë të lirë për lëvizje me karrocë për PAK me sipërfaqe me diametër të rrethit më së paku 150 cm;
- pasqyrë përkulëse rrotulluese e vendosur në lartësi prej 100 cm;
- varëse për rrobe në lartësi prej 120 cm;
- alarm elektrik për shtypje dhe litar për tërheqje, në lartësi prej 60 cm;
- të gjitha pajisjet tjera për përshtatje të PAK me karrocë e cila nuk pengon lëvizjen, të përforcuara në mur, të realizuara në kontrast në raport me dyshemenë dhe murin;
- hyrje të veçantë nga korridori në grupet sanitare për meshkuj dhe femra, në raste se WC është për shfrytëzim publik;
- vijë të udhëheqjes taktore prej derës hyrëse të ndërtesës deri te dera WC-së publike;
- shenjat për qasje sipas fig. 1.14, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;

(2) Shembull i WC-së dhe kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të paraqitura në fig16 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) WC në kuadër të banesës qasëse dhe të dhomave dhe/ose apartamenteve në ndërtesa shembull: hotel, konvikte të nxënësve dhe studentëve, shtëpi të moshuarve dhe personave të tjerë, duhet t'i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç kushteve të rregulluara nga alineat:1, 3, 19, 20, dhe 21. Dera hyrëse e WC-se gjerësia e hapjes së dritës më së paku 90 cm.

Banjo

Neni 19

(1) Banjo duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht duhet të ketë:

- kadë, me lartësi jo më të madhe se 50 cm dhe/ose hapësira për dush pa rrethoj, me dimensionet më së paku 90x90 cm;
- ngritëse për kade, përveç në rastet kur pranë kadës vendoset hapësira për dush;
- mbajtës për dorë pranë kadës e vendosur në lartësisë prej 80 deri 90 cm nga sipërfaqja e dyshemesë, gjegjësisht mbajtës pranë hapësirës për dush e vendosur në lartësi prej 75 cm;
- ulëse palosëse e vendosur në lartësi prej 45 cm deri 50 cm;
- të gjitha pajisjet të përshtatjes me karrocë për PAK e cila nuk pengon lëvizjen, e përforcuar në mure, e realizuar në kontrast me dyshemenë dhe murin;
- pajisje e përcaktuar për WC qasëse në harmoni me dispozitat e nenit 18 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe atë :lavaman, pasqyra, kroi, varëse, pajisjet e alarmit, WC guaska dhe pajisjet për lëshimin e ujit në WC guaskë, nëse banjo është e parapare me WC në të njëjtën hapësirë;
- gjerësi të derës me hapje drite më së paku 90 cm;
- gjerësi të derës me hapje drite më së paku 90 cm nëse në banjë hyhet nga komunikimi publik (shembull në spitale, ambulantë etj);
- dyer dhe dritare me dorëza qasëse në harmoni me neni 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- instalime përkatëse elektrike në harmoni me dispozitat e nenit 29 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- shenja qasëse sipas fig 1 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ, dhe atë : 1.14 dhe 1.15;

(2) Shembull i banjës dhe kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni janë paraqitur në fig. 17 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Në objektet ndërtimore shëndetësore sociale dhe rehabilituese si dhe të atyre që shpesh i shfrytëzojnë PAK duhet të kenë qasje nga tri anët në kadë.

Kuzhina

Neni 20.

(1) Kuzhina duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht duhet të ketë:

- sipërfaqe të lirë të punës me gjatësi më së paku 90 cm;
- sipërfaqe ngrohëse të punës dhe enëlarësi i realizuar konzollë në thellësi qasës më së paku 50 cm, me sipërfaqen e sipërme në lartësi më së shumti 85cm, shikimi më së paku në lartësi 70 cm;

- elementet varëse të kuzhinës janë të vendosura në lartësi prej 120 cm prej dyshemesë deri te skaji i poshtëm i tyre;
- elementet të poshtme të nxjerra jashtë;
- sipërfaqe përdorimit të hapësirës për shfrytëzimin e elementeve të kuzhinës dhe kthimin me karrocë për PAK më së paku sipërfaqja të rrethit me diametër 150 cm;
- hapësirë për lëvizje rreth mobileve (orendive) me gjerësi më së paku 120 cm;
- derë hyrëse me gjerësi të hapjes së dritës më së paku 90 cm;
- dyer dhe dritare me dorëz qasëse sipas dispozitave të nenit 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- instalime përkatëse elektrike në harmoni me dispozitat e nenit 29 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- shenja qasëse sipas fig.1.1, shtojcë e këtij Udhëzimi Administrativ, në rastet kur kuzhina qasëse gjendet jashtë banesës/apartamentit, shembull kampi e të ngjashme.

(2) Shembull i kuzhinës dhe kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 18. të shtojcës së këtij Udhëzimit Administrativ.

Dhoma, klasa, hapësira e punës

Neni 21.

(1) Dhoma, klasa, hapësira e punës duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- hapësirë të lirë për lëvizje me karrocë për PAK, me sipërfaqe minimale rrethore me diametër prej 150 cm;
- hapësirë për lëvizje rreth mobileve (orendive) me gjerësi më së paku 120 cm;
- tavolinë pune e realizuar konzoll ashtu që sipërfaqja e sipërme të jetë më së larti 85 cm, ndërsa shikimi në lartësi më së paku 70cm me thellësi qasje më së paku 50cm;
- derë hyrëse të klasës dhe hapësira të punës me gjerësi të hapjes së dritës më së paku 90 cm, ndërsa të dhomës më së paku 90 cm;
- derë dhe dritare me dorëz qasëse sipas dispozitave të nenit 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- instalimet përkatëse elektrike sipas dispozitave të nenit 29 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- shenja për qasje sipas fig. 1.1, shtojcë të këtij Udhëzimi Administrativ, përveç dhomës në kuadër të banesës- apartamentit.

(2) Shembulli i dhomës, klasës, hapësirës së punës dhe kushteve në paragrafin 1. të këtij neni janë të paraqitura në fig. 19, 20 dhe 21, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Banesa

Neni 22.

(1) Banesa duhet të përmbaj elementet për jetë të pavarur të destinuara për banim nga neni 18, 19, 20, 21, 29 dhe 30 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe deri te ajo duhet të jetë e siguruar qasja nga sipërfaqja publike e këmbësoreve e rregulluar përmes hyrjes kryesore në ndërtesë me aplikimin e zgjidhjeve të përshtatura për qasje në nivele me lartësi të ndryshme në harmoni me nenet 10,11,12,13 dhe 14 të këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Kur në ndërtesë në të cilën ndodhet banesa planifikohet hapësira për garazh atëherë, prej hapësirës për garazh e deri te banesa duhet të sigurohet komunikimi në pajtim me nenin 17 të këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Banesa që përshtatet lehtë sipas rregullave ndërtohet në përdheshë të ndërtesës, gjegjësisht në etazh nga i cili më së lehti sigurohet dalja në hapësirë të sigurtë në rast rreziku.

(4) Përveç kushtit nga paragrafi 1 të këtij neni banesa duhet të plotësoj edhe këto kushte gjegjësisht të ketë:

- derë të hyrjes me hapësirë drite më së paku prej 110 cm;
- dyer tjera me hapje me se paku prej 80 cm;
- dyer dhe dritare me dorëz qasese në harmoni me nenin 30 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- pragjet me tehe të topitura dhe jo më të lartë se 2 cm;
- korridoret me gjerësi më së paku 120 cm;
- instalimet përkatëse elektrike në harmoni me nenin 29 të këtij Udhëzimi Administrativ; shenja për qasje sipas fig. 1.1, shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(5) Shembull i banesës gjegjësisht i apartamentit dhe kushtet nga paragrafi 1. dhe 4. të këtij neni janë të paraqitura në fig. 22 dhe 23 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(6) Me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objektit nga neni 5 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ në çdo dhjetë banesa është nevojshme të sigurohet një banesë që përshtatet lehtë. Numri total i banesave në objekt caktohet me rumbullaksimimin e numrit të përgjithshëm të banesave në dhjetëshen e parë më të lartë.

(7) Banesa që përshtatet lehtë konsiderohet banesa tek e cila mund të arrihen kushtet nga paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, modifikimet e saj nuk ndikojnë në mënyrën e përmbushjeve të kushteve të lokacionit në harmoni me të cilat objekti ndërtohet dhe/ose kërkesave të rëndësishme për ndërtim. Zgjidhja teknike për përshtatje të lehtë duhet të jetë e paraqitur në projektin e objektit ndërtimor.

(8) Me rastin e projektimit dhe ndërtimit të vendbanimeve turistike me 50 e më shumë apartamente, shtëpi për të moshuar me 20 e më shumë apartamente dhe vendbanimi i apartamenteve studentore me 50 e më shumë apartamente, duhet të sigurohet numri i nevojshëm i apartamenteve qasëse dhe atë një apartament qasës në numrin minimal të përcaktuar të apartamenteve, si dhe një apartament qasës në çdo 20 apartamente të ardhëshme. Numri total i apartamenteve që përshtaten lehtë caktohet me rumbullaksimimin e numrit të përgjithshëm të apartamenteve në dhjetëshen e parë më të lartë.

(9) Elementet e nevojshme qasëse të përcaktuara për banesa përdoren edhe për apartamente.

Kafenetë dhe restorantet

(1) Kafenetë dhe restorantet duhet të kenë elementet për qasje nga neni 16. për hapësirë hyrëse nga neni 17 për komunikim dhe nga neni 18 për WC të këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Përveç kushteve nga neni 1 i këtij Udhëzimi Administrativ kafeneja dhe restoranti duhet të plotësojnë edhe këto kushte gjegjësisht të kenë:

- kalim të sigurtë ndërmjet tavolinave dhe pengesave tjera vertikale me gjerësi më së paku 100 cm për minimum 20% të sipërfaqes së shfrytëzueshme të kafenesë ose restorantit të dedikuar për shfrytëzim dhe shërbim;
- banak dhe tavolina të realizuara konzollë ashtu që sipërfaqja e sipërme të jetë në lartësi 85 cm, me lartësi shikimi me më së paku 70 cm, me thellësi qasëse me më së paku 50 cm për minimum 20% të inventarit;
- punime përfundimtare të mureve, dyshemeve dhe dyerve, të realizuara në kontrast;
- veshje të dyshemesë nga materiali i fortë, i cili nuk e vështirëson lëvizjen e karrocave të PAK;
- dyerë dhe mure ndarëse të punuara me sipërfaqe nga qelqi më të mëdha se 1.5 m² pa transversale, duhet të jetë e shënuar dukshëm në lartësi prej 90 deri 160 cm;
- dyert dhe dritaret me dorëz qasëse në harmoni me nenin 30 të këtij Udhëzimi Administrativ e cila është me ngjyrë kontraste nga pragu i derës;
- shenja qasëse sipas fig 1 dhe atë 1.13 dhe 1.16 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Shembulli i kafeneve, restoraneve dhe kushtet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni është paraqitur në fig. 24 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Kabina për ndërrim rrobash

Neni 24.

(1) Kabina për ndërrim rrobash duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- dimensionet e bazës jo më të vogla se 160x210 cm;
- derë me dorëz qasëse sipas nenit 30. të këtij Udhëzimi Administrativ, me hapje më së paku 90 cm cila hapet nga jashtë ose rrëshqitëse;
- varëse për rroba e vendosur në lartësi prej 120 cm;
- ulëse palosëse e vendosur në lartësi prej 45 deri në 50 cm;
- shenja qasëse sipas fig. 1.1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Shembull i kabinës dhe kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 25 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Në ndërtesën sipas nenit 44 të këtij Udhëzimi Administrativ e cila duhet të përmbaj kabinën për ndërrimin e rrobave, është e nevojshme të realizohen 10% kabina qasëse nga numri i përgjithshëm i kabinave, por jo më pak se një.

Dush kabina

Neni 25.

(1) Dush kabina duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- dimension të bazës më se paku 230x230 cm;
- derë me dorëz qasëse sipas nenit 30 të këtij Udhëzimi Administrativ me gjerësia të hapjes më së paku 90 cm, e cila hapet nga jashtë;
- instalime përkatëse elektrike sipas nenit 29 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- sipërfaqe afër dushit më së paku 90x90 cm, e realizuar pa prag me pjerrtësi për largimin e ujit;
- krua me një dorëz ose krua me sensor;
- pajisje alarmi me ndërprerës ose litarë për tërheqje me lartësi 60 cm;
- varëse për rroba e vendosur në lartësi prej 120 cm;
- mbajtëse për sapun e vendosur në lartësi prej 90 cm;
- shenjë qasëse sipas fig.1.15 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Shembulli i dush kabines dhe kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni janë të paraqitura në fig. 26 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Në objektet ndërtimore të cilat sipas nenit 44. të këtij Udhëzimi Administrativ duhet të përmbajnë dush kabinën është e nevojshme të realizohen 10% kabina qasëse duke llogaritur numrin e përgjithshëm të kabinave, por jo më pak se një.

Hyrja në pishinë

Neni 26.

(1) Hyrja në pishinë duhet të ketë rampën qasëse e cila arrinë fundin në thellësi prej 60 deri më së shumti 80 cm në raport me sipërfaqen e nivelit mesatar të ujit.

(2) Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni në pishina dhe banjo shëruese kur nuk mund të sigurohet qasja sipas këtij paragrafi, hyrja qasëse mund të sigurohet me karrikë lëvizëse, ashensor, dhe /ose elementet qasëse për qasje në nivel me lartësi të ndryshme.

(3) Krahas hyrjes në ujë nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të vendosen vendet për rrezitje me dimensione më së paku 90x200 cm dhe lartësi 50 cm për PAK. Numri i vendeve për rrezitje është 1% i numrit të përgjithshëm të vendeve të rrezitjes në pishine por jo më pak se një.

(4) Hyrja qasëse në pishine është treguar me shenjë qasëse sipas fig. 1.17 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(5) Shembulli i hyrjes në pishinë dhe kushtet nga paragrafi 1. dhe 3 të këtij neni, janë të paraqitura në fig. 27 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Vendet në tribuna

Neni 27.

(1) Vendet në tribuna duhet të kenë dimensione të bazës më së paku 90x140cm dhe të treguara me shenjë qasëse sipas foto. 1. 20 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Shembulli i vendeve në tribuna dhe kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 28 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Numri i nevojshëm i vendeve qasëse në tribuna, caktohet në bazë të numrit total të ulëseve dhe atë:

- për 100 deri 300 ulëse, realizohen më së paku dy vende qasëse;
- për 301 deri 1000 ulëse, realizohen më së paku 2% vende qasëse;
- për 1001 e më shumë ulëse, realizohen më së paku 1% vende qasëse.

Telefoni, tekstofoni, faksi dhe bankomati

Neni 28.

(1) Telefoni, tekstofoni, faksi dhe bankomati duhet të plotësojnë këto kushte, gjegjësisht të kenë:

- telefoni është i vendosur në lartësi prej 120 cm nga sipërfaqja e dyshemesë me dëgjuese e cila mund të kapet me dorë në lartësi prej 100 cm;
- tekstofon, faks dhe bankomat të vendosur nga skaji i poshtëm në lartësi prej 70 cm nga sipërfaqja e dyshemesë;
- pajisje të vendosura në mënyrë që të sigurojnë qasjen e funksionimit për të gjithë PAK;
- shenjat qasëse sipas fig. 1 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ dhe atë:1.2, 1.3 dhe 1.4 për telefon qasës dhe sipas fig 1.18, ndërsa për tekstofon, faks dhe bankomat qasës sipas fig. 1.19.

(2) Shembulli i telefonit, tekstofonit, faksit , bankomatit dhe kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 29 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, telefoni, tekstofoni, faksi dhe bankomati qasës për personat e verbër dhe me shikim të dobësuar , personat e shurdhët dhe me dëgjim të dobësuar, nënkuptohen pajisjet e vendosura në lartësi të zakonshme.

(4) Kur pajisjet nga paragrafi 1. i këtij neni ndodhen brenda objektit ndërtimor atëherë qasja në to për persona të verbër dhe me shikim të dobësuar bëhet përmes vijave taktore drejtuese të vendosura prej derës hyrëse të ndërtesës deri te pajisjet.

Instalimet elektrike

Neni 29.

Instalimet elektrike duhet të plotësojnë këto kushte, gjegjësisht të kenë:

- interfon të vendosur në lartësi deri 120 cm me indikacione drite;
- ndërprerës të dritës dhe ziles i vendosur në lartësi prej 90 deri 120 cm;
- prizat në kuzhinë me qasje të drejtpërdrejt mbi sipërfaqen e punës;

- prizat tjera të vendosura në lartësi prej 90 deri 120cm;
- pllakë shpërndarëse për instalim elektrik e vendosur në lartësi prej 90 deri 120cm;
- të gjitha pajisjet e instalimeve elektrike të realizuara në kontrast me murin.

Dorëza në dyer dhe dritare

Neni 30.

(1) Dorëza në dyer dhe dritare duhet të ketë formë jo të vrazhdë të vendosur në lartësi prej 90 cm për dyer, ndërsa për dritare në lartësi prej 90 cm deri 120 cm.

(2) Përdorimi i dorëzës për lëvizjen e mekanizmit për hapje dhe mbyllje të derës/dritares nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë i lehtë.

(3) Shembull i formës së dorëzës dhe kushtet nga paragrafi 1 të këtij neni janë të paraqitura në fig. 30 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Sporteli

Neni 31.

(1) Sporteli për PAK, shfrytëzues të karrocave duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- sipërfaqen e sipërme të realizuar në lartësi më së shumti 85 cm, me lartësi shikimi prej më së paku 70 cm, i realizuar në forme konzolle, thellësin e qasjes prej më paku se 50cm;
- shenja qasëse sipas fig. 1.23 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Sporteli qasës për persona të shurdhër, me dëgjim të dobësuar, persona të verbër dhe me shikim të dobësuar, nënkuptohet sporteli me lartësi të rëndomt, i cili duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- mjetin komunikues ndihmës;
- prej derës hyrëse në ndërtesë deri te sporteli vendosen vijat taktore drejtuese në kahje të lëvizjes;
- shenja qasëse sipas fig.1 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ dhe atë:1.2., 1.3, 1.4, 1.6 dhe 1.21.

(3) Shembull i sportelit dhe kushtet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni janë dhënë në fig. 31. të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(4) Kur në sallë ndodhen tri ose më shumë sportele të llojit të njëjtë të punës, njëri prej tri sporteleve duhet të plotësoj kushtet e qasjes për PAK– shfrytëzues të karrocave, dhe një për persona të shurdhër, me dëgjim të dobësuar, persona të verbër dhe me shikim të dobësuar.

(5) Kur me rregullore të veçanta të cilat rregullojnë mbrojtjen në punë me para të gatshme dhe letra me vlerë janë të caktuara kushtet për sportele, sporteli qasës duhet të siguroj plotësimin e kushteve të asaj rregulloreje.

Pulti

Neni 32.

(1) Pulti për PAK – shfrytëzues të karrocave duhet të jetë, gjegjesisht të ketë:

- i vendosur afër hyrjes në hapësira dhe /ose në hapësirën ku ofrohen shërbimet;
- i vendosur në lartësi prej 80 cm, me lartësi shikimi prej më së paku 70 cm;
- formë konzolle me thellësi qasje prej më së paku 50 cm;
- qasje të sigurtë prej më së paku 120 cm;
- shenja treguese qasëse sipas fig. 1.23 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Pult qasës për persona të shurdhër me dëgjim të dobësuar, persona të verbër dhe me shikim të dobësuar, nënkuptohet pulti me lartësi të rëndomtë, i cili duhet të plotësojë këto kushte, gjegjesisht të ketë:

- elemente ndihmëse komunikuese;
- vijat taktore drejtuese në drejtim të lëvizjes prej derës hyrëse në ndërtesë deri te pulti ;
- shenja qasëse sipas fig.1 të Shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ dhe atë; 1.2, 1.3, 1.4, 1.6 dhe 1.21.

(3) Kur në sallë ndodhen tri ose më shumë pulte të llojit të njëjtë të shërbimit, njëri prej tri pulteve duhet të plotësojë kushtet qasëse për PAK shfrytëzues të karrocave, dhe një për persona të shurdhër, persona me dëgjim të dobësuar, për persona të verbër dhe me shikim të dobësuar.

Zona induktive ose rrethi transmetues

Neni 33.

(1) Zona induktive ose rrethi transmetues instalohet në hapësirat me sipërfaqe më të mëdha se 500 m², gjegjesisht në hapësirat të cilat në të njëjtën kohë mund të shfrytëzohen nga më shumë se 100 persona dhe në të cilat fjalimi transmetohet me ndihmën e zmadhuesit të zërit.

(2) Hapësira në të cilën vendoset zona induktive ose rrethi transmetues shënohet me shenjë për qasje sipas fig. 1.22 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Tabela e shpalljeve

Neni 34.

(1) Tabela e shpalljeve duhet të vendoset në lartësi prej 120 deri 160 cm.

(2) Tabela e shpalljeve tregohet me shenjë qasje sipas fig. 1.24 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Plani orientues për lëvizje në ndërtesa

Neni 35.

Plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievore që të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë i vendosur horizontalisht deri në lartësi prej 90 cm gjegjësisht vertikalisht deri në lartësi prej 180 cm;
- të jetë i vendosur pranë hyrjes në ndërtesë;
- të përmban informata në shkrimin Braille;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vij taktore drejtuese në kahje të lëvizjes;
- të shënohet me shenjë qasëse sipas fig.1. të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ dhe atë: 1.2 dhe 1.3.

C. ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACION PUBLIK

Neni 36

Për sigurimin e kushteve për lëvizje të pavarur të PAK në komunikacionin publik nevojiten elementet qasëse si në vazhdim: vendndalja dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqet publike për këmbësorë, semafori, vendkalimi i këmbësorëve, ishujt e këmbësorëve dhe udhëkryqet.

Vendndalja dhe peroni

Neni 37.

(1) Vendndalja dhe peroni duhet të plotësojnë këto kushte, gjegjësisht të kenë:

- gjatësi të vendndaljes, gjegjësisht të peronit, të njëjtë me gjatësinë e mjetit transportues (autobusit, tramvajit dhe trenit) i cili ndalet në atë vendndalje gjegjësisht peron, dhe gjerësi më së paku 200 cm;
- lartësi të trotuarit në nivel të shkallës hyrëse të mjetit të komunikacionit, përjashtimisht kur në përdorim janë mjetet e komunikacionit me shkallë të parë më të lart, trotuari mundë të jetë edhe më i ulët nga shkalla e parë por jo më shumë se 18 cm nën nivelin e shkallës hyrëse të mjetit të komunikacionit nëse nuk është rregulluar ndryshe me rregullore të veçantë me të cilën rregullohen kushtet për objekte të infrastrukturës hekurudhore;
- në vendndaljen e autobusit dhe/ose tramvajit, në vendbanimet në të cilat realizohet trotuari për këmbësor, në vendin e hyrjes së parë në mjetin e komunikacionit duhet të realizohet vija taktore drejtues normal në shirit të komunikacionit /hekurudhës;
- vendndalja e cila gjendet afër ndërtesës ku kryesisht qëndrojnë PAK duhet të ketë vijë taktore drejtuese të vendosur në tërë gjerësinë e trotuarit;
- në peronin e trenit në distancë prej 80 cm nga skaji i peronit përgjat peronit duhet vendosur vija taktore paralajmëruese me gjerësi 20 cm me gravura normal në drejtim të hyrjes në tren.

(2) Shembulli i vendndaljes dhe peronit, si dhe kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të paraqitura në fig. 32, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Vendparkingu

Neni 38.

Vendparkingu duhet të jete i vendosur me afër hyrjes në ndërtesë dhe duhet të plotësoj këto kushtë, gjegjësisht të ketë:

- vendparking për një automobil kur parkingu gjendet në varg, normal, pjerrtas, për së gjati në raport me trotuaret për këmbësor, madhësi 370x500 cm,
- të paraqitura në fig. 33, shtojcs së këtij Udhëzimi Administrativ ;
- vend parking për dy automobila kur parkingu gjenden në varg, normal, pjerrtas, për së gjati, në krahasim me trotuaret për këmbësor, madhësi 590x500cm, me distancë ndërmjet tyre prej 150 cm, të paraqitura në fig. 34, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- dalje nga vend parkingu në trotuarët e këmbësorëve të siguar me gurin skajor me pjerrtësi më të madhe të mundshme 10% dhe gjerësi me së paku prej 120 cm;
- sipërfaqe të vend parkingut, e cila duhet të punohet prej materialit i cili nuk e pengon lëvizjen e karrocave të PAK (zhavorri, rëra, sipërfaqet e gjelbëruara, e tjera) ;
- të shënuar me shenjë qasje sipas fig. 1.25, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ ose me shenje përkatëse, respektivisht me shenja në harmoni me rregulloret e veçanta.

Sipërfaqja publike – shtegu për kombësor

Neni 39.

(1) Sipërfaqja publike- shtegu për këmbësor duhet të jetë:

- e ngritur në krahasim me gurin skajor më së paku për 3 cm ose e ndarë me elemente tipike, e nëse është në nivel të shiritit atëher ndahet me rrethojë;
- me gjerësi më së paku 150 cm;
- e lidhur me sipërfaqet tjera publike pa pengesë;
- e mbrojtur me rrethojë me lartësi 90 cm nga komunikacioni kur ndodhet në zonën e këmbësoreve me frekuencë të madhe.

(2) Ndryshimet e nivelit të sipërfaqeve publike - shtegu janë të lidhura në mes veti me elementet përkatëse qasëse për ndryshimi të lartësive sipas këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Ndryshimet e nivelit të sipërfaqeve publike nga paragrafi 2 të këtij neni të lidhur me ashensorin qasës ose me platformën ngritëse vertikale, detyrimisht duhet të jenë të lidhura me shkallët qasëse.

(4) Të gjitha pajisjet komunale (banka, tavolina, shenja, shtylla ndriçuese, shportë, mbajtës për biçikletë , pano për reklama dhe të ngjashme) vendosen pranë skajit të sipërfaqes publike – shtegu për këmbësorë, ashtu që të mos pengoj personat e verbër dhe me shikim të dobësuar.

(5) Të gjitha ekspozimet në murin e ndërtesës pranë sipërfaqes publike për këmbësorë, si dhe ekspozimet tjera në këto mure të cilat ndodhen në lartësinë prej 70 deri 220cm dhe të dalura më shumë se 10cm, duhet të jenë të realizuara në tërë gjatësinë e tyre deri te sipërfaqja për këmbësorë ose të jenë të shënuara në mënyrë që sipërfaqja e këmbësorëve nën to të jetë e ngritur më së paku 3cm në krahasim me nivelin rrethues.

(6) Kur së bashku me sipërfaqet publike të këmbësorëve parashikohet shtegu i biçikletave ose parkingu, është e nevojshme realizimi i kufizimit prej sipërfaqeve publike të këmbësorëve me denivilim më së paku 3cm, ose sipërfaqe të gjelbër, elemente tipike edhe të ngjashme.

(7) Shembull i sipërfaqeve publike për këmbësorë dhe kushtet nga paragrafi 1, 4, 5, të këtij neni janë të paraqitura në fig. 35, të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Semafori

Neni 40.

Semafori duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- planin taktor të kalimit në semafor të cilët ndodhen në kalimin e rrugës me më shumë se dy shirita të qarkullimit në një drejtim;
- sinjalizimin zanor i cili ndodhet në zonat ku kryesisht qëndrojnë personat e verbër dhe me shikim të dobësuar;
- te semaforët në udhëkryq, sinjalizimi zanor i vendosur në semafor të një drejtimi qarkullues i cili nuk përputhet me sinjalizimin zanor i vendosur në semaforin e drejtimit tjetër qarkullues;
- sinjalizimin zanor i vendosur në semafor i cili lajmëron vetëm ndërrimin e dritës në semafor;
- shpërndarsin e zërit të sinjalizimit zanor i vendosur në semafor, i cili lajmëron personat e verbër ose me shikim të dobësuar të cilët kalojnë rrugën.

Vendkalimi i këmbësorëve

Neni 41.

(1) Vendkalimi i këmbësorëve duhet të plotësoj këto kushte, gjegjësisht të ketë:

- vendkalimin nga trotuari në nivel të rrugës i siguruar me gurin skajor me pjerrtësinë më të madhe të lejuar për 10% dhe me gjerësi jo më të vogël se 120 cm ;
- gurin skajor me pjerrëtsi dhe fushë taktore paralajmëruese, e cila përfundon në vijë me skajin e shiritit të rrugës dhe nga ajo është e larguar sa gjersia e gurit skajor por jo më pak se 15 cm sipas fig. 36 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- në raste kur lartësia minimale e trotuarit është 3 cm, realizohet fusha taktore paralajmëruese me strukturë të thepisur me gjerësi më së paku 40 cm, sipas fig. 37. të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- në rastet kur vendkalimi i rrugës është jashtë udhëkryqit, vija taktore drejtuese duhet të jetë me gjerësi më së paku 40cm dhe me gravime normal me rrugën, e realizuar deri te fillimi i pjerrtësisë së gurit skajor në kalim dhe me gjatësi më së paku 110 cm sipas fig. 38. të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Elementet qasëse nga paragrafi 1. i këtij neni aplikohen në mënyrë përkatëse në vendkalimet e këmbësorëve në rrugë, hekurudhë , binarë të tramvajit, si dhe shtigjeve të biçikletave.

Ishulli i këmbësorëve

Neni 42

Ishulli i këmbësorëve duhet të mundësoj përmbushjen e këtyre kushteve:

- të jetë i realizuar në harmoni me nenin 41. paragrafi 1. alineja 1, 2 dhe 3 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- në rastet kur ishulli i këmbësorëve ndodhet në nivel me rrugën ose niveli i tyre në vendkalim lëshohet në nivel të rrugës, atëherë 15 cm nga fillimi dhe 15cm prej fundit shënohet vija taktore paralajmëruese me gravurë normal në drejtim të lëvizjes, gjerësia më së paku 40 cm, të lidhura në mes veti me vijën taktore drejtuese me gravurë normal në drejtim të lëvizjes më së paku 40 cm, sipas paraqitjes në fig. 39 së shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- në raste kur ishulli i këmbësorëve është i ngritur në krahasim me nivelin e rrugës, kalimi nga rruga në ishullin e këmbësorëve realizohet me pjerrtësi sipas fig. 40 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ;
- në rastet kur ishulli i këmbësorëve në vendin e kalimit është i lëshuar në nivel të rrugës, ndërsa në pjesën e ngritur është vendndalja për autobus dhe tramvaj, detyrimisht duhet realizohet pjerrtësia për qasje në vendndalje, sipas nenit 41. alineja 1 dhe 2.

Udhëkryqi

Neni 43.

(1) Udhëkryqi duhet të përmbajnë elementet qasëse të kalimit të këmbësorëve nga neni 41. dhe ishullin qasës nga neni 42 i këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Në udhëkryq i cili ndodhet në zonat e vendbanimeve ku qëndrojnë personat e verbër dhe me shikim të dobësuar, vendkalimi për këmbësor duhet të ketë semaforin qasës me sinjalizim zanor dhe vijat taktore drejtuese. Vija taktore paralajmëruese realizohet deri te skaji i pjerrtësisë së kalimit në gjatësi prej më së paku 110 cm, sipas paraqitjes në fig. 41 të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Kur në udhëkryq nuk mund të evitohen pengesat në nivel të njëjtë, realizohen nënkalime ose mbikalime me aplikimin e elementeve qasëse për qasje në nivele me lartësi të ndryshme sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ.

KREU IV.

REALIZIMI I OBLIGUAR I ELEMENTEVE PËR QASJE

Neni 44.

(1) Ndërtesat publike me destinim pune duhet të projektohen dhe të realizohen varësisht nga destinimi. Duhet të kenë elementet qasëse nga nenet si në vazhdim të këtij Udhëzimi Administrativ.

1. ndërtimet për shërbime tregtare, hotelerike dhe turistike:

- shtëpia e mallrave nga nenet: 16, 17, 18, 32, 34. dhe 35;
- qendra tregtare nga nenet: 16, 17, 18, 32, 34. dhe 35;
- vetëshërbimet me sipërfaqe shërbyese prej 400m² dhe më shumë nga nenet: 16, 17, 18. dhe 32;
- treg nga nenet: 16 dhe 17;

- kafe bar, kafenetë dhe restorantet me 80 dhe më shumë vende nga nenet: 16, 17, 18 dhe 23 ;
- diskotekat dhe klubet e natës, me sipërfaqe prej 400 m² dhe me shume nga nenet: 16, 17 dhe 18;
- qendra informative turistike nga nenet: 16 dhe 17;
- zyra e bashkësisë turistike me sipërfaqe prej 200 m² dhe më shumë nga nenet: 16 dhe 17;
- agjencioni për udhëtim me sipërfaqe prej 200 m² dhe më shumë nga nenet: 16 dhe 17;
- recepcioni i veçantë nga nenet: 16 dhe 34;
- ndërtimet të turizmit shkencor nga nenet: 16, 17, 18, 19 (ose 25.) dhe 34;
- hoteli me 50 e më shumë dhoma (dhoma/TWC) nga nenet: 16, 17, 19 (ose 25+18.) 21 dhe 34;
- hoteli me 50 e më shumë dhoma me njësi sanitare të përbashkët nga nenet: 16, 17, 18, 21, 19 (ose 25) dhe 34;
- vendbanim turistik me 50 dhe më shumë apartamente nga nenet: 16, 17, 22 dhe 34;
- kampi për 500 e më shumë mysafir nenet: 16, 17, 19 (ose 25), 20 dhe 34;
- restorant i cili qëndronë pranë rrugës nga nenet: 16, 17 dhe 18;
- hoteli me shenjë të veçantë- motel cili qëndronë pranë rrugës nga nenet: 16, 17 dhe 18;
- kompleks tregtaro-hotelier me pompë benzine nga nenet: 16, 17 dhe 18;

2. ndërtimet postare ose/dhe me destinim telkomunikativ:

- hallë postare për punë me palë më pak se tri sportele ose pulte për qëllime të ngjajshme nga nenet: 16 dhe 17;
- hallë postare për punë me palë me tre apo më shumë sportele ose pulte për qëllime të ngjajshme nga nenet: 16, 17 dhe 31;
- qendra telekomunikative për ofrim të shërbimeve shfrytëzuesve më pak se tri sportele ose pulte për qëllime të ngjajshme nga nenet: 16 dhe 17;
- qendra telekomunikative për ofrim të shërbimeve të shfrytëzuesve më shumë se tri sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta nga nenet: 16, 17 dhe 31;
- ndërtimet ku ofrohen shërbime telekomunikimi, telefon, faks dhe të ngjashme, me tre ose më shumë pajisje nga nenet: 16, 17 dhe 28;

3. ndërtimet për ofrim të shërbimeve të qarkullimit të parasë dhe shërbimeve tjera financiare:

- filial banke me më pak se tre sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta nga neni 16.1 dhe 28;
- filial banke me tre ose më shumë sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta nga nenet: 16, 17 dhe 31;

- filial agjencie financiare më pak se tre sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta nga nenet: 16, 17 dhe 28.;

- filial agjencie financiare me tre ose me shume sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta nga nenet: 16, 17 dhe 31;

4. ndërtimet për qëllime administrative dhe të ngjashme:

- ndërtimet në të cilat veprojnë institucionet e vetëqeverisjes lokale, administratës shtetërore, Qeverisë dhe Kuvendit, gjykatës shtetërore, përfaqësive të personave juridik me autorizimet publike: nenet:16, 17, 18, 34 dhe 35;

5. ndërtimet për qëllime sociale, shëndetësore dhe rehabilituese:

- zyre shërbimi të kujdesit social-shëndetësor nga nenet: 16, 17, 18, 31, 33, 34 dhe 35;

- barnatore dhe dyqan për paisje ortopedike sipas neni 16;

- barnatore dhe dyqan për paisje ortopedike me tre ose më shumë sportele ose pult të tipit të punëve të njëjta nga nenet: 16, 17, 31 (ose 32);

- ambulante nga nenet: 16, 17, 18, 33 dhe 34;

- shtëpi shëndeti nga nenet:16, 17, 18, 31, 33, 34 dhe 35;

- spital nga nenet: 16, 17, 18, 19, 21, 24, 25, 31, 34 dhe 35;

- shtëpi shëruese nga neni: 16, 17, 18, 19, 21, 24, 25, 31, 34 dhe 35;

- pishinë e mbyllur në shtëpitë shëruese nga nenet: 16, 17, 18, 24, 25, 26, 31 dhe 34;

- pishinë e hapur në shtëpitë shëruese nga nenet: 16, 17, 18, 24, 25, 26 dhe 34;

- banjë e mbyllur publike shëruese nga nenet:16, 17, 18, 24, 25, 26, 31, 34 dhe 35;

- banje e hapur nga nenet: 16,17, 18, 24, 25;

- shtëpi për të moshuar dhe për PAK me 20 apo më shumë dhoma me njësi të përbashkëta sanitare nga nenet: 16, 17, 18, 19 (ose 25), 21, 31 dhe 34;

- shtëpi e tipit hotel për të moshuar dhe për PAK me 20 a më shumë dhoma (dhoma - tualet me WC) nga nenet: 16, 17, 19 (ose 25+18) 20, 21, 31 dhe 34;

- shtëpi për persona të moshuar e tipit apartament me 20 a më shumë apartamente - nenet:15, 16, 21 dhe 34;

- zyre e shërbimit të kujdesit social shëndetësor për pune me palë e tjera nga nenet: 16, 17, 22, 31 dhe 34;

- kuzhinë popullore nga nenet: 16, 17, 18 dhe 34.;

6. ndërtesat në të cilat më së shpeshti qëndrojnë PAK::

- ndërtesat në të cilat veprojnë shoqatat, unionet ose asociacionet e PAK nga nenet: 16, 17, 18, 20, 21, 28, 29, 30, 33, 34 dhe 35;

- institucionet për edukim dhe arsimim të PAK e të ngjashme nga nenet: 16, 17, 18, 21, 24, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35;
- institucionet për rehabilitim nga nenet: 16, 17, 18, 19, 20 , 21, 24, 25, 28, 29, 30, 31, 32, 34 dhe 35;
- institucionet për strehimin e PAK nga nenet: 16, 17, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 28, 29, 30, 31, 32, 34 dhe 35;

7. ndërtimet e dedikuara për edukim dhe arsim

- çerdhe fëmijësh nga nenet: 16 dhe 17;
- shkolla, institucionet për edukim të personave të rritur, shkolla të larta, nga nenet: 16, 17, 18, 21 dhe 34;
- konvikt i nxënësve dhe studenteve me 50 dhe më shumë dhoma me njësi sanitare të përbashkëta nga nenet: 16, 17, 18, 19 (ose 25), 20, 21 dhe 34;
- konvikti i nxënësve dhe studentëve e llojit të hotelit (dhoma/tualeti WC) me 50 dhe më shumë dhoma nga nenet: 16, 17, 19 (ose 25+18), 21 dhe 34;
- vendbanimi me apartamente i studenteve për 50 dhe më shumë apartamente nga nenet: 16, 17, 22 dhe 34.

8. ndërtimet të dedikuara për kulturë:

- biblioteka universitare nga nenet: 16, 17, 18, 32, 34 dhe 35;
- qendra e kulturës nga nenet: 16, 17, 18, 34 dhe 35;
- muzeu, galeria, koleksion dhe ekspozita në hapësirë prej 300m² dhe më shumë nga nenet: 16, 17, 18, 32 dhe 34.;
- kinemaja, teatri dhe hall për koncerte 100 dhe më shumë vende në hall nga nenet: 16, 17, 18, 27, 33 dhe 34;

9. ndërtimet e dedikuara për komunikacion:

- aeroporti nga nenet: 16, 17, 18, 31 (ose 32), 33 dhe 34;
- stacioni i autobusëve dhe hekurudhës nga nenet: 16, 17, 18, 31 ose 32 , 33, 34, 37 dhe 39;
- vendndalja e tramvajit, autobusëve, peroni hekurudhor, nga nenet: 34, 37 dhe 39;
- vend pushimi pran autostradës nga nenet: 18, 28, 38 dhe 39;
- parkingjet publike nga neni 38;
- garazha publike me kapacitet prej 300 e më shumë automjete nga nenet: 16, 17, 18 dhe 38;
- pompë benzine nga neni: 16;

10. ndërtimet e dedikuara për sport dhe rekreacion:

- terrenet sportive nga nenet: 16, 17, 18 dhe 24;
- hallat sportive nga 100 vende e më shumë dhe të ngjashme nga nenet: 16, 17, 18, 24, 25, 27 dhe 34;

11. ndërtimet për shërbime fetare dhe sakrale:

- hallat ceremoniale nga nenet: 16, 17, 33 dhe 34;
- qendrat fetare dhe të ngjashme nga nenet: 16, 17, 18, 21 dhe 34;

12. ndërtimet e dedikuara për argëtim:

- parqet nga nenet: 16,17,18, 34 dhe 39;
- kopshti zoologjik dhe botanik nga nenet: 16, 17, 18, 34 dhe 39;

13. ndërtesat për vuajtjen e dënimeve:

- shtëpi korrektimi nga nenet: 16, 17, 18, 19, 21 dhe 31;
- burg nga nenet: 16, 17, 18, 19, 21 dhe 31;
- institut edukimi nga nenet: 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 31;

14. sipërfaqet dhe hapësirat publike:

- sheshet e këmbësorëve, rrugët, shtigjet në parqe, lojërat e fëmijëve dhe shëtoret nga neni: 39;
- nënkalime, mbikalime dhe ura për këmbësorë nga neni: 39;
- vendkalimi nga nenet: 40, 41, 42 dhe 43;

15. ndërtimet tjera:

- panaiet dhe qendra të ekspozitave nga nenet: 16, 17, 18 dhe 34;
- parku teknologjik nga nenet: 16, 17, 18 dhe 34;
- WC publike nga nenet: 16, 17 dhe 18;
- ndërtimet në të cilat është e nevojshme të ketë 4 apo më shumë WC për përdorim publik nga nenet:16, 17 dhe 18 ;
- kapellë nga nenet: 16, 17 dhe 34;
- strehimore publike nga nenet:16, 17 dhe 18;

(2) Ndërtimet me qëllime banesore dhe banesore-afariste duhet të projektohen dhe të realizohen e varësisht nga destinimi i tyre të përmbajë elementet qasëse nga neni i mëposhtëm i këtij Udhëzimi Administrativ:

1. objektet banesore nga nenet:16, 17 dhe 22;

2. objektet banesore-afariste nga nenet: 16, 17 dhe 22.

(3) Përveç elementeve qasëse në pjesët e objektit me destinim pune duhet të përfshijë edhe elementet qasëse varësisht nga destinimi punës në atë pjesë dhe atë më së paku sipas përcaktimit të paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 45.

Te portat hyrëse në ndërtesat si në vijim: shtëpi shëndeti,spitalet shëruese, pishinat e mbyllura shëruese, banjë e mbyllur publike shëruese, shtëpi për të moshuar dhe persona të pafuqishëm me 20 dhe më shumë dhoma me njësi sanitare të përbashkëta, shtëpi për të moshuar dhe persona të pafuqishëm e tipit hotel(dhoma/TWC) 20 dhe më shumë dhoma, shtëpi për të moshuar dhe për persona të pafuqishëm e tipit apartament 20 e më shumë apartamente, zyre për shërbime sociale-shëndetësore, për punë me palë, institucione për edukim të PAK, institucionet për rehabilitim dhe strehim të PAK, është e nevojshme të realizohet sporteli qasës.

Neni 46.

(1) Të gjitha dhomat e spitalit, institucionet shëruese për rehabilitim dhe strehim të PAK duhet të realizohen si qasëse.

(2) Numri i nevojshëm i dhomave qasëse në shtëpitë për të moshuar dhe për PAK të tipit hotel (dhoma/TWC) dhe shtëpitë për të moshuar dhe për PAK të cilët kanë njësi sanitare të përbashkët, caktohen ashtu që në njëzet dhomat e para realizohet një dhomë qasëse e nevojshme në dhjetëshen e parë më të lartë .

(3) Numri total i dhomave qasëse caktohet me rumbullaksim të numrit të dhomave në dhjetëshen e parë më të lartë.

(4) Numri nevojshëm i dhomave qasëse, për banimin e nxënësve dhe studenteve në shtëpi të tipit hotel (dhoma/TWC), të banimit të nxënësve dhe studentëve ku gjenden njësitë sanitare të përbashkëta, caktohen në mënyrë që në 50 dhomat e para realizohet një dhomë qasëse e nevojshme dhe atë në çdo dhjetëshen e parë më të lartë. Numri total i dhomave qasëse caktohet me rumbullaksim të numrit të dhomave në dhjetëshen e parë më të lartë.

(5) Numri i nevojshëm i njësisë të vendosjes së personave në ndërtesa për vuajtje të dënimit me burg është 5% por jo më pak se një.

Neni 47.

(1) Numri i obligueshëm i WC-së dhe banjës qasëse në shtëpitë për të moshuar dhe për persona të pafuqishëm me njësi të përbashkëta sanitare, përcaktohet ashtu që në çdo të dhjetëshen e parë është e obligueshme që të realizohet një WC dhe një banjo qasëse.

(2) Në hotel, në konvikte nxënësish dhe studentësh me njësi të përbashkëta sanitare është e obligueshme që në çdo 50 dhoma të realizohet një WC qasëse dhe një banjo qasëse.

Neni 48.

Kur në ndërtesë është paraparë punësimi i PAK duhet të sigurohet hapësira e punës dhe WC qasëse.

Neni 49.

(1) Kafe bar, kafene dhe restorante më pak se 80 vende; diskotekat dhe klubet e natës me sipërfaqe më pak se 400m²; muze,galeri,hapësira e ekspozitave me sipërfaqe me më pak se 300m²; kinema, teatro

dhe salla e koncertit me më pak se 100 vende në publik, duhet të sigurohet qasja në ndryshim të lartësive sipas përcaktimit të këtij Udhëzimi Administrativ dhe duhet të ketë WC qasëse.

(2) Kur me rregullore të veçanta me të cilat janë përcaktuar kushtet për kryerjen e veprimtarive në objektet ndërtimore nga paragrafi 1 i këtij neni, është e lejuar heqja dorë nga ato kushte ku nuk është i nevojshëm realizimi i WC-se, atëherë nuk qëndron obligimi i realizimit të WC-së qasëse.

(3) Nëse në harmoni me rregulloret e veçanta nga paragrafi 2. i këtij neni është i nevojshëm realizimi i vetëm një WC-je për femra dhe për meshkuj, atëherë ajo duhet të realizohet si WC qasëse.

(4) Në rastet e rindërtimit të objektit ndërtimor nga paragrafi 1. i këtij neni, me leje të lokacionit mund të lejohet shmangia prej elementeve qasëse nga ky paragraf, për shkak të kushteve të hasura në ndërtim ose kushteve jo qasëse në sipërfaqe publike nga e cila hyhet në ndërtesë.

Neni 50.

(1) Në parkingjet publike dhe garazhat publike realizohen 5% vend parkime qasëse në raport me numrin total të vend parkimeve, por jo me pak se një vendparkim.

(2) Pran objekteve ndërtimore, gjegjësisht në objektet ndërtimore nga neni 5 i këtij Udhëzimi Administrativ, realizohen 5% vend parkime qasëse në krahasim me numrin total të vende parkimeve, por jo me pak se një vendparkim.

Modernizimi i qasjeve në objekte ndërtimore

Neni 51.

(1) Pjesët e objekteve ndërtimore publike me destinim pune nga neni 44 paragrafi 1 i këtij Udhëzimi Administrativ, të cilat rindërtohen ose do të rindërtohen, duhet të projektohen dhe të realizohen ashtu që, varësisht nga destinimi i tyre të përmbajnë elementet qasëse të përcaktuara me këtë nen.

(2) Hapësira hyrëse dhe e komunikimit deri në pjesët e objektit ndërtimor nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet që me rastin e rindërtimit të projektohet dhe të realizohet ashtu që të përmbajnë elementet qasëse nga neni 16 dhe 17 i këtij Udhëzimi Administrativ.

(3) Paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni vlen edhe për objektet ndërtimore të cilat pas rindërtimit të paraparë të mbesin objekte ndërtimore nga neni 44. paragrafi 1. të këtij Udhëzimi Administrativ, si dhe në pjesën afariste të objekteve ndërtimore banesore afariste, që kanë madhësinë, gjegjësisht kapacitetin e ndërtesave afariste të cekura në nenin 44. paragrafi 1. të këtij Udhëzimi Administrativ ose të ketë kapacitet pas rindërtimit të paraparë .

(4) Neni 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 aplikohen edhe në rindërtim të objekteve ndërtimore nga këto nene.

(5) Dispozitat e këtij neni aplikohen edhe në rastet e ndryshimit dhe/ose plotësimit të lejes së ndërtimit për objektet ndërtimore të cekura.

Heqja dorë nga elementet e përcaktuara për qasje

Neni 52.

(1) Nëse në rastet e rindërtimit të objektit ndërtimor nga neni 5 të këtij Udhëzimi Administrativ, i cili ndodhet në tërësi urbanistike e cila është e regjistruar në regjistrin e monumenteve kulturore të Kosovës, nuk mund të sigurohen elementet e përcaktuara qasëse të parapara, që të mos prishen vlerat e monumentit kulturor, është e lejuar përjashtimisht heqja dorë nga elementet e përcaktuara për qasje, me kusht që për heqjen dorë të sigurohet pëlqimi i MMPH –së .

(2) Së bashku me propozimin për dhënien e pëlqimit nga paragrafi 1. të këtij neni, i bashkëngjitet edhe mendimi i organit kompetent për mbrojtjen e monumenteve kulturore për shkatërrimin e vlerave të objekteve kulturore të cilat do të ndodhnin me rastin e realizimit të zgjidhjes teknike të projektuar për qasjen në objektin ndërtimor.

(3) Pëlqimi nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk është akt juridik.

Neni 53.

(1) Në pjesët e vendbanimit dhe objekteve ndërtimore për të cilat është përcaktuar mbrojtja në harmoni me rregulloret e veçanta të lëmisë së mbrojtjes së natyrës, nuk do të aplikohen dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ., nëse me aplikimin e tyre do të cenohen vlerat e përcaktuara të mbrojtjes së natyrës.

(2) Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni si zëvendësim për elementet qasëse për qasje në nivele me lartësi të ndryshme, duhet të shfrytëzohen pajisjet montuese dhe demontuese dhe të tjera, të cilat nuk i cenojnë vlerat e përcaktuara të mbrojtjes së natyrës .

KREU V.

PËRMBAJTJA OBLIGATIVE PROJEKTIT

Neni 54.

(1) Projektet e objekteve ndërtimore nga neni 5 i këtij Udhëzimi Administrativ, duhet të përmbajnë zgjidhjen teknike me të cilën caktohen elementet për qasje në këto objekte në (tekstin e mëtejme: zgjidhja teknike).

(2) Zgjidhja teknike sipas paragrafit 1 të këtij neni paraqitet , varësisht nga niveli i punimit të projektit, në mënyrë të njejtë si projekti ideor, projekti kryesor dhe projekti realizues i objektit ndërtimor.

Përmbajtja e projektit ideor

Neni 55.

(1) Në projektin ideor të ndërtesës, zgjidhja teknike paraqitet me përshkrimin teknik dhe vizatimet.

(2) Përshkrimi teknik varësisht nga lloji i ndërtesës, kryesisht përmban:

- përshkrimin e hapësirave të ndërtesës në të cilën sigurohet qasja;
- përshkrimin e hapësirave dhe sipërfaqeve të komunikacionit publik, si dhe lidhshmëria ndërmjet tyre;
- të dhënat teknike dhe funksionale për zgjidhjet arkitektonike dhe ndërtimore të cilat sigurojnë qasje;
- përshkrimin dhe funksionin e produkteve ndërtimore dhe produkteve tjera, instalimeve dhe pajisjeve të montuara me qëllim të sigurimit të qasjes, si dhe mënyra e ndërtimit gjegjësisht vurjes në vepër.

(3) Përshkrimi teknik i objektit banesor, përveç përmbajtjes nga paragrafi 2 i këtij neni përmban dhe përshkrimin e përshtatshmërisë së lehtë më së paku të një banese në çdo dhjetë banesa.

(4) Projekti për objekt banesor dhe banesoro – afarist kryesisht përmbanë:

- situacionin me shenjë qasëse për vendparkim dhe elementet tjera të përcaktuara për sigurimin e qasjes në ndërtesë;
- planin e katit karakteristik, prerje dhe fasadë me paraqitjen e një banese të përshtatur në çdo dhjetë banesa dhe vizatimet e komunikimit qasës me të cilën sigurohet qasja e PAK deri te këto banesa ;
- skemën e instalimeve dhe montimin e pajisjeve të cilat e ndihmojnë qasjen.

(5) Projekti për ndërtesa publik dhe afariste, varësisht nga lloji i ndërtesës përmban:

- situacionin me shenjë të vendparkimit qasës dhe elementet tjera të përcaktuara për sigurimin e qasjes në ndërtesë;
- vizatimet tjera të nevojshme për lloje të caktuara të ndërtesës me hapësira të shënuara komunikimi dhe pjesët tjera të ndërtesës të destinuara për lëvizje, qëndrim ose punët të PAK të rëndësishme për sigurimin e qasjes.

Përmbajtja e projektit kryesor

Neni 56.

(1) Në projektin kryesor të objektit ndërtimor zgjidhja teknike paraqitet në lëmi të ndara :

- projekti arkitektonik;
- projekti ndërtimorë;
- projekti elektroteknik dhe makinerik nëse zgjidhja teknike e qasjes përfshin ndërtimin e stabilimenteve të veçanta të destinuara për PAK.

(2) Të dhënat e objektit ndërtimor respektivisht pjesëve të tij, zgjidhja teknike me të cilën sigurohet përmbushja e kushteve të përcaktuara, varësisht nga lloji i projektit, janë të përfshira në përshkrimin teknik, me llogaritjet përkatëse dhe sipas nevojës në programin e kontrollimit dhe sigurimit të kualitetit, me kushtet e veçanta teknike etj.

(3) Përshkrimi teknik, varësisht nga lloji ndërtesës përmban të dhënat për zgjidhjen teknik për punët ,vurja në vepër e produkteve të ndërtimit dhe produkteve tjera, konstruksionit, instalimeve dhe pajisjeve me të cilit sigurohet përmbushja e kushteve të përcaktuara për qasje të dhëna nga elaborati , studimet dhe ndikimet që kanë në përmbushjen e kërkesave për qasje.

(4) Përshkrimi teknik për ndërtesë banesore dhe ndërtesa banesoro -afariste kryesisht përmban:

në projektin arkitektonik:

- përshkrimi i hapësirës dhe zgjidhjes së formës, si dhe punëve me të cilin sigurohet qasje në banesa për të cilat është paraparë përshtatja ;
- përshkrimi i pjesëve të ndërtesës të përfshira në zgjidhjen teknike për qasje duke pas parasysh ndërtimin dhe produktet tjera ndërtimore (përshkrimi i përpunimit përfundimtar të sipërfaqeve kundër rrëshqitëse dhe të ngjashme);
- përshkrimi i punëve përfundimtare dhe mënyrës së vurjes në vepër të produkteve ndërtimore dhe produkteve tjera në lidhje me qasjen.

në projektin ndërtimorë:

- përshkrimi i pjesëve të konstruksionit të përfshira në zgjidhjen teknike të qasjes në raport me produktet ndërtimore dhe produktet tjera;
- përshkrimi i përfshirjes së punëve të cilat janë të nevojshme të kryhen me rastin e përshtatjes së ndërtesës;

në projektin elektroteknik dhe të makinerisë:

- përshkrimi i përfshirjes së punëve të cilat janë të nevojshme të kryhen me rastin e përshtatjes së banesave;
- përshkrimi i pajisjeve, instalimeve dhe funksioni i tyre, si dhe mënyra e kyçjes (ashensori, platforma etj.)

(5) Përshkrimi teknik për ndërtesat publike dhe me destinime pune, kryesisht përmbajnë:

në projektin arkitektonik:

- përshkrimi i zgjidhjes hapësinore dhe formës me të cilin sigurohet qasja e PAK në hapësirat e ndërtesave të destinuara për lëvizje, qëndrim ose punë;
- përshkrimi i pjesëve të ndërtesës e përfshirë në zgjidhjen teknike të qasjes në lidhje me produkte ndërtimore dhe të tjera (përshkrimi i përpunimit përfundimtar të sipërfaqes kundër rrëshqitëse dhe të ngjashme);
- përshkrimi i punëve përfundimtare dhe mënyra e vurjes në vepër të produkteve ndërtimore dhe produkteve tjera në lidhje me qasje;
- përshkrimi i formës dhe zgjidhjes funksionale të të gjitha elementeve dhe pajisjeve të jashtme për mundësim të qasjes.

në projektet ndërtimore:

- përshkrimi i formës dhe zgjidhjes funksionale me të cilin sigurohet qasja e PAK në hapësirat e ndërtimit të destinuara për lëvizje, qëndrim ose punë;
- përshkrimi i pjesëve të konstruksionit të përfshira në zgjidhjen teknike të qasjes duke pas parasysh produktet ndërtimore dhe produktet tjera.

në projektet elektroteknike dhe makinerike:

- përshkrimi i pajisjeve , instalimeve dhe funksioni i tyre, përshkrimi i mënyrës së kyçjes (ashensor, platformë ngritëse vertikale lëvizëse, platforma të pjerrëta paluse ngritës dhe tjera).

(6) Llogaritjet ,varësisht nga lloji i ndërtimit, duhet të përmbajnë të dhënat për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara .

(7) Paramasa dhe parallogaritja për ndërtesa me destinim banesor dhe banesor- afariste, përmban:

në projektin arkitektonik:

- llogaritja e gjatësisë së rampës qasëse me paraqitje të pjerrtësisë gjatësore dhe tërthore.

në projektin ndërtimore:

- llogaritje e pjesëve mbajtëse të konstruksionit të përfshira në zgjidhjen e qasjes;
- llogaritja e konstruksionit mbajtëse për gjendjen para dhe pas përshtatjes së banesës, nëse përshtatja nënkupton ndryshimin e konstruksionit.

në projektin elektroteknik dhe makinerik:

- llogaritja e instalimeve për pajisje, pjesëve të makinerisë dhe pajisjeve të PAK.

(8) Llogaritja e ndërtesës me destinim publik dhe afarist përmban:

në projektin arkitektonik:

- llogaritja e gjatësisë së rampave qasëse me vizatim të pjerrtësisë gjatësore;
- llogaritja e elementeve për qasje (numri i vendeve të shfrytëzuara nga PAK) të lidhura për destinim të ndërtesës;
- llogaritja e pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore e shtigjeve për këmbësor dhe rrugëve, si dhe gjatësia e rampës qasës me vizatimin e pjerrtësisë gjatësore dhe tërthore.

në projektin ndërtimor:

- llogaritje e pjesëve mbajtëse të konstruksionit të përfshira në zgjidhjen e qasjes;
- llogaritja e gjatësisë së rampës qasës me vizatim të pjerrtësisë gjatësore dhe tërthore;
- llogaritja e elementeve qasëse nëse ato llogariten.

në projektin e elektroteknikës dhe makinerisë:

- llogaritja e instalimeve për pajisje, llogaritja e pjesëve makinerike të stabilimenteve të destinuara për PAK;

(9) Vizatimet varësisht nga lloji i ndërtesës, në përpjesë të përshtatshme duhet të tregohen në zgjidhjen teknike të qasjes në situacion, planin dhe prerjet, si dhe kuotat e lartësisë të elementeve të përcaktuara të qasjes nga ky Udhëzim Administrativ me skemat e instalimit dhe montimit të pajisjeve.

(10) Vizatimet për ndërtesa banesore dhe banesore-afariste përmbajnë:

- situacionin me përpjesë përkatëse me numrin e vizatimeve të caktuar dhe numër të vendeve për qasje dhe parking, si dhe me vizatime për komunikim qasës nga sipërfaqet publike të këmbësorëve deri te hyrja qasëse në ndërtesë;
- bazat, prerjet dhe fasadat e kateve karakteristike, me shenjë të një banese me përshtatje në çdo të dhjetën banesë dhe shenjat e shënuara ose të vizatuara të komunikimit qasës me të cilin bëhet qasja e PAK deri te këto banesa sipas paragrafi 2 të neni 44 të këtij Udhëzimi Administrativ;
- skemat e instalimeve dhe montimeve të pajisjeve që kanë të bëjnë me qasjen.

(11) Vizatimet për ndërtesat me destinime publike dhe administrative përmbajnë:

- situacionin në përpjesë të duhur me paraqitjen planore të numrit të vendparkingjeve, si dhe planin e komunikacionit nga sipërfaqet publike deri te hyrja qasëse në ndërtesë;
- bazat, prerjet dhe kuotat e lartësisë për të gjitha elementet e qasjes për cdo lloj ndërtese në harmoni me dispozitat e paragrafit 1 të neni 44 të këtij Udhëzimeve Administrative.
- skema instalimeve dhe montimi i pajisjeve që kanë të bëjnë me qasjen.

Përmbajtja e projektit realizues

Neni 57.

Përpunimi i zgjidhjes teknike për plotësimin e kërkesave të përcaktuara sipas këtij Udhëzimi Administrativ në përpjesë të përshtatshme janë të përfshira në projektet e lëmijve të veçanta, të cilat kryesisht përmbajnë:

në projektin arkitektonik:

- bazat e të gjitha hapësirave të destinuara për lëvizje, pushim dhe punë të PAK me kuotat relevante të cilat tregojnë sigurimin e qasjes;
- detalet e të gjitha elementeve të qasejes të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ.

në projektin ndërtimor:

- bazat e të gjitha hapësirave të destinuara për lëvizje, pushim dhe punë të PAK dhe kuotat relevante të cilat tregojnë sigurimin e qasjes;
- planet e kallëpeve të pjesëve të konstruksioneve të përfshira në zgjidhjen e qasjes;
- planet e armaturës me specifikacion për pjesët konstruktive të përfshira në zgjidhjen e qasjes.

në projektin e elektroteknikës dhe makinerik:

- detalet e instalimit dhe pajisjeve të montuara për nevojat e sigurimit të qasjes.

KREU VI.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 58

Në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ do të jepet leja e ndërtimit nëse kërkesa për dhënien e kësaj leje së bashku me projektin kryesor është dorëzuar pas aprovimit të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 59

(1) Ndërtesat publike afariste duhet të plotësojnë kushtet për qasje të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ në afatin prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

(2) Përveç ndërtimet nga paragrafi 1. i këtij neni, shkallët në hapësirat e jashtme për përdorime publike duhet të plotësojnë kushtet për qasje të përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 alineja 5 dhe 12 të këtij Udhëzimi Administrativ në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi.

HYRJA NË FUQI

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Prishtinë, më
18.06.2007

Ardian Gjini

Ministër

SHTOJCA

PARAQITJA E FOTOGRAFIVE ME SHENJA QASËSE, KUSHTET E PËRDORIMIT TË ELEMENTEVE NDIHMËSE PËR QASJE

Në vijim do të paraqiten shenjat qasëse nga neni 3. paragrafi 1. i këtij Udhëzimi Administrativ. Dimensionet dhe ngjyra e të gjitha shenjave qasës, si dhe lloji i materialit nga i cili është punuar përcaktohen në raport me:

- bazën në të cilën vendoset shenja;
- forma e hapësirave të jashtme dhe/ose të mbrendshme dhe
- distanca nga cila PAK duhet të vërejn shenjën .

Me rastin e zvogëlimit dhe/ose zmadhimit të ndonjë shenje qasëse nuk ndërrohet përpjesa e elementeve grafike të shenjës, mirëpo shenja realizohet në harmoni me shembujt nga këto fotografi.



Fig 1.- Shenjat e qasjes për PAK




Fig 2.- Kushtet e përdorimit të ndihmesës në hapësira për lëvizje me karroca të personave me aftësi të kufizuara - PAK




Fig 3.- Kushtet e përdorimit të ndihmëses: hapësira e nevojshme për levizje të personave me shkop, paterica dhe shëtitore.




Fig. 4. – Kushtet e përdorimit të mjeteve ndihmëse: hapësira e nevojshme për lëvizje të personave me shkop të bardhë dhe qeni përcjellës .




Fig. 5.- Sipërfaqja taktore- nga neni 8. i këtij Udhëzimi Administrativ.





Fig. 6.- Rampa – nga neni 10. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 8.- Shkallët – nga neni 11. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 9.- Hapësira e shkallëve me gjerësi të krahut të shkallëve prej 250 e më shumë- nga neni 11. paragrafi 1. alineja 9. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 12. - Platforma ngritëse vertikale- nga neni 13. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 13. – Platforma e pjerrtë ngritëse palosëse- nga neni 14. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 14. – Hapësira e hyrjes - nga neni 16. i këtij Udhëzimi Administrativ.



Fig. 17.- Banjo-ja- nga neni 19. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 18.- Kuzhina- nga neni 20. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 19.- Dhoma- nga neni 21. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 20.- Klasa- nga neni 21. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 23.- Banesa/ Apartamenti- nga neni 22. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 24.- Kafeneja dhe restoranti- nga neni 23. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 25.- Kabina për ndërrimin e rrobave(Zhveshtorja)- nga neni 24. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 26.- Dush Kabina - nga neni 25. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 27.- Hyrja në ujë - nga neni 26. i këtij Udhëzimi Administrativ .




Fig. 28.- Vendi në sallë të shfaqjes - nga neni 27. i këtij Udhëzimi Administrativ .




Fig. 29.- Telefoni, tekstofoni, fakti, bankomati - nga neni 28. i këtij Udhëzimi Administrativ .




Fig. 30.- Dorëzat në dyer dhe dritare - nga neni 30. i këtij Udhëzimi Administrativ .



Fig. 31.- Sporteli - nga neni 31. i këtij Udhëzimi Administrativ .

Fig. 32.- Vendndalja dhe peroni - nga neni 37. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 33.- Vendi i parkimit në varg - nga neni 38. paragrafi 1. alineja 1. i këtij Udhëzimi Administrativ .




Fig. 34. - Vendi i parkimit me hapsirë në mes - nga neni 38. paragrafi 1. alineja 2. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 35.- Sipëfaqja publike për ecje për këmbësor - nga neni 39. i këtij Udhëzimi Administrativ .




Fig. 36.- Vendëkalimi i këmbësorëve- - nga neni 41. paragrafi 1. alineja 2. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 37.- Vendkalimi i këmbësorëve në vendin me lartësinë më të vogël të shtegut (trotuarit) - nga neni 41. paragrafi 1. alineja 2. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 38. - Vendëkalimi i këmbësorëve jashtë udhëkryqit - nga neni 41. paragrafi 1. alineja 4. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 39.-Ishulli për këmbësorë në nivel të sipërfaqes së rrugës - nga neni 41. paragrafi 1. alineja 4. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 40. – Ishulli për këmbësorë - nga neni 42. paragrafi 1. alineja 3. i këtij Udhëzimi Administrativ.




Fig. 41. - Udhëkryqi - nga neni 42. paragrafi 1. alineja 3. i këtij Udhëzimi Administrativ.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 10/2013 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDUARVE DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR KUSHTET NDËRTIMORE SI DHE PËR LEJE NDËRTIMORE

(EKSTRAKT)

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 4. të Ligjit për Ndëtim, Nr. 04/L-110, - GZRK Nr. 18, dhe nenit 8 nënparagrafi 1.4. të Rregullores Nr.02/2011 mbi Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministri I Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor, nxjerr

UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDUARVE DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR KUSHTET NDËRTIMORE SI DHE PËR LEJE NDËRTIMORE

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore si dhe për leje ndërtimore, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e ndërtimeve në të ardhmen me kushtet ndërtimore dhe me Kodin Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Termet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë domethënjet vijuese:

1.1. **“Pronari”** – nënkupton personin fizik ose juridik që është i regjistruar si pronar i pasurisë së paluajtshme në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme;

1.2. **“Agjent”** – nënkupton personin fizik ose juridik që e përfaqëson pronarin siç është përcaktuar në formularin e marrëveshjes dhe përfshin një kontrator ose zhvillues që do të kryej punë ndërtimore;

1.3. **“Formulari i marrëveshjes”** – nënkupton dëshmi të shkruar të një marrëveshjeje të nënshkruar nga të gjithë pronarët e regjistruar në Regjistrin për të Drejtat në Pronë të Paluajtshme.

1.3.1. Një mostër e Formularit të Marrëveshjes që përmban minimumin e kushteve të marrëveshjes të cilat duhet të përfshihen është e bashkëngjitur si Shtojca 10;

1.3.2. Formulari i Marrëveshjes mund të autorizoj një kompani që të veprojë në emër të Pronarit. Në këtë rast, çdo individ që demonstroi se e përfaqëson atë kompani do të konsiderohet se vepron në emër të asaj kompanie dhe mund të aplikojë për leje.

1.4. **“Aplikuesi”** – nënkupton personin fizik ose juridik që dorëzon një kërkesë për kushtet e ndërtimit. Aplikuesi mund të jetë pronari i pronës ose agjenti i autorizuar i pronarit siç është përcaktuar në Formularin e Marrëveshjes;

1.5. **“Poseduesi i Lejes Ndërtimore”** – nënkupton aplikuesin të cilit i është dhënë leja ndërtimore;

1.6. **“Kodi”** – nënkupton Kodin Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës;

1.7. **“Kushtet Ndërtimore”** – nënkupton kushtet që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumenteve të ndërtimit. Kushtet Ndërtimore për qëllim të dorëzimit kërkesës për Kushtet Ndërtimore përfshijnë të dhënat e listuara në nenin 6, paragrafi 3. të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.8. **“Kërkesa për Kushtet Ndërtimore”** – nënkupton kërkesën për kushtet ndërtimore që parashtrohen në pajtim me Nenin 17, nënparagrafi 1.1. i Ligjit për Ndërtim (Faza I);

1.9. **“Kërkesa për Leje Ndërtimore”** – nënkupton kërkesën për leje ndërtimore të parashtuar në pajtim me nenin 17, nënparagrafi 1.2. i Ligjit për Ndërtim (Faza II);

1.10. **“Kartela e inspektimeve të miratuara”** – nënkupton kartelën që i lëshohet aplikuesit nga organi kompetent, me rastin e lëshimit të lejes ndërtimore. Kartela identifikon numrin e lejes, llojin e ndërtimit dhe lokacionin e vendndërtimit. Sipas kryerjes së punëve inspektimet dhe miratimet shënohen me datat përkatëse në kartelë. Mostra është e bashkangjitur në Shtojcën 9;

1.11. **“Numri i Referencës i Lejes”** – nënkupton numrin e veçantë të lëshuar nga organi kompetent për të identifikuar një projekt përmes të cilit ndërlidhen të gjitha inspektimet, shënimet, certifikatat e përdorimit dhe dokumentet tjera përkatëse;

1.12. **“Destinimi i shfrytëzimit të tokës”** – nënkupton shfrytëzimin e një parcele kadastrale (të destinuar për banim, shfrytëzim komercial, industrial, etj.), të përcaktuar në Hartën Zonale, siç është përkufizuar në këtë Nen;

1.13. **“Dokumenti i Planifikimit Hapësinor”** – nënkupton Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës, Planin Hapësinor për Zona të Veçanta, Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe Planin Rregullues të Hollësishëm, siç përkufizohen me Ligjin për Planifikimin Hapësinor;

1.14. **“Sistemi i Vrojtimit të Lejes”** – nënkupton sistemin e organit kompetent për vrojtimin e shqyrtimit të lejes së paraparë me nenin 18, nënparagrafi 2.2. të këtij Udhëzimi Administrativ, në të cilën publiku ka qasje në përcjelljen e zhvillimit dhe shqyrtimit të kërkesës për leje ndërtimore dhe inspektimeve;

1.15. **“Plani Rregullues Urban”** – nënkupton dokumentet e planifikimit hapësinor ose **“Planin Rregullues të Hollësishëm”** të nivelit lokal që përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësisrës për zonë urbane dhe rurale, duke përfshirë kushtet ndërtimore;

1.16. **“Harta Zonale”** – nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor që miratohet në nivel qendror ose lokal i cili përcakton destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe kushteve ndërtimore;

1.17. **“Njoftimi mbi Synimin për Fillimin e Ndërtimit”** – nënkupton njoftimin me shkrim që paralajmëron organin kompetent për ditën që aplikuesi synon ta fillojë ndërtimin;

1.18. **“Agjencia për Menaxhim Emergjent”** – nënkupton Agjencinë për Menaxhim Emergjent të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

1.19. **“Zyrtari përgjegjës”** – nënkupton një punonjës të organit kompetent që është përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesës për leje përgjatë procesit të shqyrtimit dhe që është ndërlidhja kryesore me kërkuesin e lejes. Detyrat e zyrtarit përgjegjës janë të përcaktuara më hollësisht në nenin 12.

2. Terminologjia që përdoret në këtë Udhëzim Administrativ është pjesë e Ligjit për Ndërtim, Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe Kodit.

1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin dhe lëshimin e vendimeve mbi kërkesat për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.
2. Procedurat e parapara me këtë Udhëzim Administrativ zbatohen vetëm pasi që aplikuesi të konfirmoj se shfrytëzimi i synuar për parcelën kadastrale është në pajtim me destinimin e shfrytëzimit të tokës për parcelën kadastrale.
3. Procedurat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen vetëm pasi aplikuesi të ketë pranuar miratimet tjera të nevojshme ose lejet për projektin, siç janë ato për lidhje në shërbimet publike, ndikimi në mjedis, mbrojtja nga zjarri, etj.
4. Të gjitha kërkesat, që janë subjekt i këtij Udhëzimi Administrativ duhet të shqyrtohen për të vërtetuar nëse propozimi është në pajtim me normat teknike dhe ato të planifikimit të parapara me dokumentet në fuqi për planifikimin hapësinor, ligjet, aktet nenligjore dhe Kodin e Unifikuar të Ndërtimit të Kosovës dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njeriut, mbrojtjes së mjedisit, stabilitetin e ndërtesave fqinje dhe instalimet e infrastrukturës teknike, publike dhe sociale.

Neni 4

Përgjegjësitë e Aplikuesit në Parashtrimin e Kërkesës

1. Nëse destinimi i synuar për parcelën kadastrale është i ndryshëm nga destinimi i shfrytëzimit të tokës për atë parcelë, aplikuesi duhet të ndjekë procedurat e parapara me ligj për ndryshimin e destinimit para se të aplikoj për kushte ndërtimore ose për leje ndërtimore.
2. Nëse për punët ndërtimore kërkohen miratime nga organet ose subjektet tjera qeveritare, aplikuesi duhet të marrë këto miratime të nevojshme para se të aplikojë për leje ndërtimore.
3. Aplikuesi duhet të sigurojë që dokumentacioni i dorëzuar për leje ndërtimore:
 - 3.1. Përmban të dhëna të mjaftueshme për të dëshmuar që punët ndërtimore të propozuara janë në pajtim me kushtet ndërtimore dhe Kodin;
 - 3.2. Përmban adresën, nëse ka, dhe numrin kadastral në secilin dokument dhe vizatim;
 - 3.3. Dëshmon që punët ndërtimore të propozuara janë përbrenda kufijve të parcelës kadastrale; dhe
 - 3.4. Përmban të dhëna konsistente në mes të fasadave, prerjeve dhe bazave.
4. Me rastin e dorëzimit të kërkesës për kushte ndërtimore aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet e renditura në nenin 6 të këtij Udhëzimi Administrativ.
5. Me rastin e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimore, aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet e renditura në nenin 10 të këtij Udhëzimi Administrativ.

KREU II

PROCEDURAT E FAZËS I

Neni 5

Ndërtimet për të cilat duhet të parashtrohet kërkesa për kushte ndërtimore

1. Nëse ka Plan Rregullues Urban, Plan Rregullues të Hollësishëm, ose Hartë Zonale që përcakton kushtet ndërtimore për parcelën kadastrale në të cilën aplikuesi synon të ndërtoj, dorëzuesi i kërkesës për

kushte ndërtimore nuk është i nevojshëm. Në këtë rast, aplikuesi duhet të dorëzoj kërkesën vetëm për leje ndërtimore.

2. Aplikuesi do të dorëzoj kërkesën për kushte ndërtimore nëse:

2.1. Nuk ka Plan Rregullues Urban, Plan Rregullues të Hollësishëm, ose Hartë Zonale që përcakton kushtet Ndërtimore;

2.2. Nëse Plani Rregullues Urban, Plani Rregullues i Hollësishëm ose Harta Zonale nuk përcaktojnë të gjitha kushtet e nevojshme ndërtimore; ose

2.3. Kërkesa është për punë ndërtimore të kategorisë së III.

Neni 6

Kërkesa për Kushte Ndërtimore

1. Kërkesa për kushte ndërtimore duhet të bëhet duke përdorur formularin e bashkangjitur në Shtojcën 1.

2. Kushtet e propozuara ndërtimore duhet të jenë të arsyeshme në dritën e karakteristikave të rrethinës brenda pesëdhjetë (50) metrave nga kufijtë e parcelës kadastrale, ku aplikuesi propozon të ndërtoj, në pajtim me Ligjin për Ndërtim, neni 18, paragrafi 1.

3. Kushtet ndërtimore që do të propozohen duhet të përfshijnë të dhënat vijuese:

3.1. Numri rendor i parcelës kadastrale dhe zonës kadastrale;

3.2. Destinimi i shfrytëzimit të tokës ose destinimi i propozuar për shfrytëzimin e tokës vetëm nëse për parcelën kadastrale nuk është destinuar ndonjë shfrytëzim i përcaktuar përmes ndonjë dokumenti të planifikimit hapësinor, akti ligjor ose nënligjor;

3.3. Vija rregulluese;

3.4. Vija ndërtimore;

3.5. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike;

3.6. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasëm i parcelës kadastrale;

3.7. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale;

3.8. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për përshkueshmëri nga reshjet atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale;

3.9. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale së lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale;

3.10. Përqindja e sipërfaqes nëntokësore e shfrytëzueshme në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale;

3.11. Kërkesat minimale për vendparkingje;

3.12. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese;

- 3.13. Materialet që lejohen të përdoren në sipërfaqet e jashtme të ndërtimeve të reja;
 - 3.14. Qasja e pakufizuar në rrugë dhe infrastrukturë publike;
 - 3.15. Kufizimet e ndotjes mjedisore dhe të zhurmës sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 3.16. Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore; dhe
 - 3.17. Për kategoritë II dhe III çfarëdo kushte ndërtimore të nevojshme të përcaktuar nga agjenci tjera, si Agjencia për Menaxhimin Emergjent.
4. Në përkrahje të kërkesës për kushtet ndërtimore aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:
- 4.1. Formularin e plotësuar dhe të nënshkruar;
 - 4.2. Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë nga kadastra, jo më të vjetra se gjashtë muaj;
 - 4.3. Nëse aplikuesi nuk është pronar i regjistruar i parcelës kadastrale, dëshmia që aplikuesi është i autorizuar nga pronari për t'a dorëzuar kërkesën;
 - 4.4. Inçizimi digjital gjeodezik i parcelës kadastrale për të cilën aplikohet dhe parcelave kadastrale të bashkëngjitura si dhe ndërtesave ekzistuese përbrenda diametrit prej pesëdhjetë (50) metrash;
 - 4.5. Fotografitë e mjedisit rrethues të parcelës kadastrale për të cilën është dorëzuar kërkesa dhe fotografi të ndërtesave ekzistuese përbrenda diametrit prej pesëdhjetë (50) metrash;
5. Për kategoritë II dhe III të ndërtimeve, aplikuesit do të takohen me Ministrinë para se të dorëzojnë kërkesën për kushte ndërtimore për të përcaktuar nëse nevojiten kushte të tjera ndërtimore për mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë publike ose mjedisit.

Neni 7

Pranimi i kërkesave për kushtet ndërtimore

1. Në kohën kur aplikuesi dorëzon kërkesën për kushte ndërtimore, organi kompetent duhet të verifikoj se kërkesa është e kompletuar dhe përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.
2. Nëse kërkesa nuk është e kompletuar me rastin e dorëzimit, organi kompetent duhet të informoj aplikuesin që kërkesa nuk është e kompletuar dhe duhet të kërkoj nga aplikuesi plotësimin e të dhënave që mungojnë, duke u bazuar në listën kontrolluese për dokumentacionin e nevojshëm, që rendit të dhënat që mungojnë. Kërkesa nuk pranohet dhe i rikthehet aplikuesit për të kompletuar atë.
3. Nëse kërkesa është e kompletuar, organi kompetent duhet që menjëherë të lëshoj një vërtetim me shkrim dhe datën kur kërkesa për kushte ndërtimore është pranuar, dhe brenda një (1) dite duhet t'ia përcjellë kërkesën personave përgjegjës për shqyrtim sipas Nenit 8 të këtij Udhëzimi Administrativ. Mostrën e vërtetimit të pranimit e gjeni të bashkëngjitur në Shtojcën 4.
4. Organi kompetent duhet të vendos përmbajtjen digjitale të kërkesës për kushte ndërtimore në portalin e vet në pajtim me nenin 20, nënparagrafi 1.5. i këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Shqyrtimi i kërkesave për kushte ndërtimore dhe komentet e publikut

1. Brenda pesë (5) ditësh nga data e pranimit të aplikacionit të kompletuar për Kushte Ndërtimore, organi kompetent do të:

1.1. Vendos njoftime publike në rrugët publike që bien brenda pesëdhjetë (50) metrash nga kufijtë e parcelës kadastrale për të cilën kërkohen kushtet ndërtimore. Njoftimi publik do të jetë në fomën që është e bashkëngjitur si Shtojca 11;

1.1.1. Për Kategorinë I të ndërtimeve njoftimi duhet cekur që qytetarët kanë së paku pesë (5) ditë kohë nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e komenteve për kushtet e propozuara ndërtimore përmes dorëzimit të një letre apo letre elektronike organit kompetent; dhe

1.1.2. Për Kategoritë II dhe III të ndërtimeve në njoftim duhet të ceket se qytetarët kanë së paku njëzet (20) ditë kohë nga data e publikimit të njoftimit për dorëzimin e komenteve për kushtet e propozuara ndërtimore përmes dorëzimit të një letre ose letre elektronike organit kompetent;

1.2. Japë pronarëve të parcelave kadastrale fqinje me parcelën kadastrale për të cilën kërkohen kushtet ndërtimore një kopje të njoftimit të përshkruar në nënparagrafin 1.1. të këtij neni, duke:

1.2.1. Dorëzuar një kopje pronarit;

1.2.2. Lënë një kopje të shtëpia e pronarit një personi mbi 18 vjeq, ose nëse shtëpia është e banueshme por askush nuk është aty, lënja e njoftimit në një vend të dukshëm;

1.2.3. Lënë një kopje në zyrën e pronarit, nëse dihet zyra, nëpunësit apo personit tjetër përgjegjës, ose nëse nuk është askush aty, të lihet në një vend të dukshëm në zyre; ose

1.2.4. Dërgimi me postë i një kopjeje në adresën e pronarit të listuar në Kadastër ose në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme;

1.2.5. Thirrja në telefon e pronarit nëse numri i telefonit është i shafqur në pronë; ose

1.2.6. Nëse pronari nuk mund të lokalizohet në asnjërën nga këto mënyra, postimi i njoftimit në faqen e internetit të komunës do të përbëjë njoftim të pronarit.

1.3. Vizitohë vendndërtimin për të cilin është parashtruar kërkesa me qëllim të vërtetimit që të dhënat e dorëzuara, janë në përputhje me gjendjen ekzistuese, dhe që kushtet ndërtimore të propozuara nuk janë në kundërshtim me ndërtimet ekzistuese që ndoshen përbrenda diametrit prej pesëdhjetë (50) metra nga vija kufizuese të parcelës kadastrale.

2. Organi kompetent do të sqjyrtoj të gjitha ankesat që janë pranuar gjatë periudhës shqyrtuese dhe do të vendos ato në portalin e organit kompetent brenda dy (2) ditëve nga pranimi.

3. Brenda pesë (5) ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve organi kompetent do të ofrojë përgjigje me shkrim për të gjitha komentet e pranuar, dhe do t'i paraqesë në portalin e organit kompetent.

4. Përbrenda kohës së përcaktuar sipas Ligjit për Ndërtim, Neni 7, nënparagrafi 1.1. organi kompetent do të:

4.1. Miratojë kushtet ndërtimore të propozuara nga aplikuesi; ose

4.2. Përpunojë kushtet ndërtimore të propozuara nga aplikuesi në mënyrë që të jenë në pajtim me ndërtimet ekzistuese që gjenden përbrenda diametrit prej pesëdhjetë (50) metra, nga vija kufitare e parcelës kadastrale duke e marrë parasysh natyrën e ndërtimit, të gjitha komentet e pranuar nga publiku dhe politikat planifikuese relevante që kanë ndikim në marrjen e vendimit.

5. Organi kompetent do të përdorë një listë kontrolli sikur ajo në Shtojcën 6 për të ndihmuar në shqyrtim.

6. Vendimi si dhe përcaktimi i kushteve ndërtimore do të përcaktohen në mënyrë të saktë me shkrim dhe poashtu do të përfshijnë bazën e vendimit, duke përfshirë diskutimin e faktorëve të listuar në nënparagrafin 4.2. të këtij neni. Vendimi gjithashtu do të publikohet sipas kohës së paraparë në ortalin zyrtar të organit kompetent në pajtim me nenin 19, nënparagrafi 1.5. të këtij Udhëzimi Administrativ.

7. Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo sipas veprimit të ligjit do të jenë të vlefshme për një (1) vit.

KREU III PROCEDURAT E FAZËS II

Neni 9 Ndërtimet për të cilat kërkohet leja ndërtimore

1. Leja ndërtimore kërkohet për llojet e ndërtimit të përcaktuar me Ligjin për Ndërtim, neni 14.
2. Objektet ndërtimore për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimore janë të përcaktuara në një Udhëzim Administrativ të veçantë.
3. Në rast se riparimet apo punët ndërtimore, për të cilat kërkohet leje ndërtimore duhet të kryhen në raste emergjente, aplikuesi duhet të njoftojë organin kompetent brenda ditës së punës të ardhme dhe brenda pesë (5) ditëve të dorëzojë kërkesën për leje organit kompetent. Organi kompetent do të marrë parasysh rrethanat për të përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm në mbështetje të kërkesës.

Neni 10 Kërkesa për leje ndërtimore

1. Kërkesat për leje ndërtimore duhet të dorëzohen duke përdorur formularin për aplikim i bashkëngjitur në Shtojcën 2.
2. Përjashtimisht nga rastet kur kërkohen ndryshe nga organi kompetent, aplikuesi përpos kërkesës për leje ndërtimore duhet të bashkëngjisë edhe dokumentacionet të renditura në vijim:
 - 2.1. Formularin për aplikim të plotësuar dhe nënshkruar;
 - 2.2. Kopja e planit dhe e çertifikatës së pronësisë nga Kadastra jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse aplikuesi nuk është pronar i regjistruar i parcelës kadastrale, aplikuesi duhet të ofrojë autorizimin nga pronari për të dorëzuar kërkesën;
 - 2.3. Akti ligjor administrativ për vendosjen e kushteve ndërtimore, nëse kërkohet;
 - 2.4. Kopjet e licencave profesionale të arkitektëve, inxhinierëve të ndërtimit, inxhinierëve të elektrikes, inxhinierëve të makinerisë dhe konsulentëve tjerë që kanë përgatitur dokumentacionin ndërtimor. Kjo kërkesë është e detyrueshme vetëm pasi licencat e tilla të jenë në dispozicion përmes ligjeve përkatëse dhe akteve nenligjore në Republikën e Kosovës. Deri në atë kohë, aplikuesit duhet të sigurohen se profesionistët e projektimit dhe ndërtimit të cilit i angazhojnë të jenë të kualifikuar;
 - 2.5. Aprovimet për kyçe në shërbimet publike të infrastrukturës teknike;
 - 2.6. Miratimet e nevojshme nga organet ose subjektet qeveritare, siç janë ato për ndikim në mjedis, ujë dhe siguri nga zjarri;
 - 2.7. Aprovimet që kërkohen me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore për ndërtimet brenda perimetrit të trashëgimisë kulturore;

2.8. Tri (3) kopje fizike dhe një kopje digjitale në formatet pdf dhe dwg, të dokumentacionit të kompletuar ndërtimor, dhe të dhënave tjera plotësuese të kërkuara sipas Kodit; dhe

2.9. Në rast se kërkohen objekte të përkohshme ndërtimore në vendndërtim, periudha kohore për të cilën do të kërkohen këto punë ndërtimore.

3. Të gjitha kërkesat për leje ndërtimore dhe dokumentacioni plotësues ndërtimor duhet të janë në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 11

Pranimi i Kërkesave për Leje Ndërtimore

1. Në kohën kur aplikuesi dorëzon kërkesën për leje ndërtimore, organi kompetent do të vërtetojë nëse kërkesa është e kompletuar dhe përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Organi kompetent mund të shfrytëzojë listën kontrolluese për dokumentet e nevojshme, sikurse Shtojca 3, për të vërtetuar se kërkesa është e kompletuar me të gjitha vizatimet teknike të nevojshme dhe të dhënat tjera plotësuese.

2. Nëse kërkesa nuk është e kompletuar kur dorëzohet, organi kompetent do të informojë aplikuesin që kërkesa nuk është e kompletuar dhe duhet t'ia ofrojë aplikuesit listën kontrolluese për dokumentacionin e nevojshëm të bashkëngjitur si Shtojca 3, ku tregohen dokumentet të cilat mungojnë dhe t'ia kthejë kërkesën aplikuesit për t'a kompletuar dhe për ta ri-dorëzuar kërkesën.

3. Nëse kërkesa është e kompletuar, organi kompetent do të pranojë kërkesën për leje ndërtimore dhe:

3.1. Do të lëshojë menjëherë një vërtetim me shkrim dhe me datë, siç kërkohen nga Ligji për Ndërtim, neni 20, paragrafi 2 dhe nga Udhëzimi Administrativ mbi Taksat Administrative për Leje Ndërtimore dhe Tarifatat për Rregullimin e Infrastrukturës Nr. 22/2012, neni 7, paragrafi 2. Një konfirmim mostër është i bashkëngjitur si Shtojca 4. Në këtë konfirmim, organi kompetent do të informojë aplikuesin për:

3.1.1. Shumën dhe metodën e llogaritjes së taksës për leje ndërtimore (sipas Udhëzimit Administrativ Mbi Taksat Administrative për Leje Ndërtimore dhe Tarifatat për Rregullimin e Infrastrukturës Nr. 22/2012, Nenet 7 & 8); dhe

3.1.2. Tarifën rregullative për rritjen e destinimit të infrastrukturës, nëse ka (sipas Udhëzimit Administrativ mbi Taksat Administrative për Leje Ndërtimore dhe Tarifatat për Rregullimin e Infrastrukturës Nr. 22/2012, Neni 10).

3.2. Përcakton numrin e referencës të lejes për kërkesën;

3.3. Vendosë kërkesën në sistemin e vrojtimit të lejes të paraparë në Nenin 20, nënparagrafin 1.3. të këtij Udhëzimi Administrativ;

3.4. Percjellë, kërkesën brenda një (1) dite te zyrtari përgjegjës për të filluar procesin e shqyrtimit.

4. Nëse një kërkesë është pranuar, por më vonë dëshmohet se është e pakompletuar, do t'i kthehet aplikuesit dhe do të trajtohet në pajtim me Ligjin për Ndërtim, neni 21, paragrafi 4.

Neni 12

Emërimi i zyrtarit përgjegjës

1. Organi kompetent do të emërojë një zyrtar përgjegjës për të mbikëqyrë kërkesën për leje ndërtimore gjatë procesit të shqyrtimit të lejes.

2.Zyrtari përgjegjës është përgjegjës për shmangien e vonesave dhe për sigurimin se procesi i shqyrtimit është duke u kryer në mënyrë sa më efikase që është e mundur.

3.Zyrtari përgjegjës do të jetë pika kryesore e kontaktit dhe do të jetë përgjegjës për komunikim me aplikuesin për leje gjatë procesit të shqyrtimit të lejes.

4.Zyrtari përgjegjës do të bashkërendoj të gjithë profesionistët dhe agjencitë që do të bëjnë shqyrtimin e lejes dhe do të sigurojë se çdo pjesë e listës së kontrollit që përdoret për shqyrtim të lejes nënshkruhet nga indididi që ka bërë shqyrtimin.

5.Zyrtari përgjegjës ka autoritetin për të organizuar takim të profesionistëve, institucioneve tjera dhe aplikuesit për të zgjidhur çfarëdo problemi që mund të ngritët gjatë procesit të shqyrtimit të lejes.

6.Para lëshimit të lejes, zyrtari përgjegjës do të nënshkruaj Listën e Kontrollit që përdoret për Shqyrtimin e Lejes, duke konfirmuar s etë gjitha shqyrtimet e nevojshme janë kryer.

7.Zyrtari përgjegjës do të sigurojë se rezultati i secilës fazë të procesit të shqyrtimit të lejes futet në Sistemin e Vrojtimit të Lejes.

Neni 13

Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimore për përputhshmëri me kushtet ndërtimore

1. Organi kompetent do të vërtetojë nëse ndërtimet e propozuara janë në pajtim me kërkesat hapësinore të përcaktuara nga kushtet ndërtimore për parcelën kadastrale.

2. Gjatë shqyrtimit të përputhshmërisë së kërkesës me kushte ndërtimore dhe ligjet përkatëse organi kompetent do të përdorë formularin e vlerësimit të bashkëngjitur në Shtojcën 7.

3.Nëse punët ndërtimore të propozuara janë në pajtim me kushtet ndërtimore, shqyrtuesi do të shënojë ditën dhe inicialet e shqyrtuesit në sistemin vrojtues të lejeve në internet duke treguar që kjo fazë e shqyrtimit është përfunduar dhe brenda një (1) dite do të t'ia përcjellë kërkesën shqyrtueseve që janë përgjegjës për të bërë shqyrtimin sipas nenin 13 të këtij Udhëzimi Administrativ.

4.Nëse kërkesa nuk është në oajtim me kushtet ndërtimore, organi kompetent do të refuzojë kërkesën për shkak të mospërputhshmërisë duke përdorur procedurat e përcaktuara në nenin 15 të këtij Udhëzimi Administrativ. Zyrtari përgjegjës do t'i japë aplikuesit një refuzim me shkrim ku do të ceken në mënyrë specifike arsyet pse kërkesa nuk është në pajtim me kushtet ndërtimore.

Neni 14

Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimore për përputhshmëri me Kodin e Ndërtimit

1.Pas shqyrtimit të përputhshmërisë të kërkesës me kushtet ndertimore, organi kompetent do të shqyrtojë kërkesën për të vërtetuar se punët ndërtimore të propozuara janë në përputhje me Ligjin për Ndërtim dhe Kodin.

2.Qëllimi i këtij shqyrtimi është që të vërtetojë nëse punët ndërtimore të specifikuara përmbushin kërkesat thelbësore për:

2.1. Qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e konstruksionit;

2.2. Instalimet mekanike;

2.3. Instalimet elektrike;

2.4. Përgatitjen e vendndërtimit dhe hidroizolimet;

2.5. Izolimin e zërit;

2.6. Hidro-instalimet;

2.7. Eficienca e energjisë;

2.8. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (vetëm për objekte të caktuara ndërtimore të kategorive II dhe III siç kërkohet me Ligjin mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis);

2.9. Norma teknike për qasjen e personave me aftësi të kufizuara (vetëm për ndërtimet komerciale të kategorisë I dhe objektet ndërtimore të kategorive II dhe III); dhe

2.10. Siguri nga zjarri (vetëm për Kategoritë II dhe III të objekteve ndërtimore).

3. Gjatë shqyrtimit të përputhshmërisë së kërkesës me Kodin dhe ligjet përkatëse, organi kompetent do të përdorë listat kontrolluese si ato të bashkëngjitura në Shtojcën 7.

* * * * *

Neni 23
Shtojcat

Shtojcat 1 – 11 janë pjesë të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i MMPH-së.

Dardan Gashi

Ministër i Ministrisë Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Data:

Prishtinë

SHTOJCA Nr.3

Dokumentet teknike të nevojshme për aplikacionet për leje ndërtimore

	Po	Jo	N/A
I. Kushtet ndërtimore			<input type="checkbox"/>
<p>1. Plani i lokacionit 1:2500 ose 1:1000, që tregon qartë:</p> <p>1.1. Kufijtë dhe numri i parcelave kadastrale;</p> <p>1.2. Kulmet e ndërtesave ekzistuese;</p> <p>1.3. Së paku dy nga rrugët më të afërta publike;</p> <p>1.4. Objektet më të afërta ekzistuese të infrastrukturës teknike për shërbime publike; dhe</p> <p>1.5. Konturat topografike, relievi dhe drunjtë ekzistues.</p>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<p>2. Plani i strategjisë për qasje në përpjesë 1:1000 ose 1:500, shënuar me dimensione dhe kontura topografike, që tregon qartë masat për:</p> <p>2.1. Aranzhimet e propozuara për kyçje në një rrugë ekzistuese publike dhe nëse nuk ka qasje të menjëhershme në një rrugë publike ekzistuese propozimin për zgjerimin e rrjetit ekzistues të rrugëve publike për parcelën kadastrale;</p> <p>2.2. Qasjen e personave me aftësi të kufizuara në rrugët publike dhe transport, siç janë stacionet dhe platformat, parkingjet e automjeteve, rrugët dhe vendkalimet për këmbësorë, semaforët, ishujt e komunikacionit dhe udhëkryqet.</p> <p>2.3. Lëvizjen e automjeteve dhe këmbësorëve deri në atë vend dhe prej atij vendi;</p> <p>2.4. Hapësirat ndarëse për mbrojtje të ndërtimeve fqinje nga zjarri dhe rrugë për qasje të makinave të zjarrëfikjes dhe shërbimeve emergjente;</p> <p>2.5. Hapësira parkimi për automjete;</p> <p>2.6. Marrëveshjet për kyçje në infrastrukturën teknike ekzistuese të shërbimeve publike dhe zgjerimet e rrjetit ekzistues, nëse ka</p> <p>2.7. Mbledhjen e mbeturinave;</p> <p>2.8. Ndryshimet e konfiguracionit ekzistues të tokës;</p> <p>2.9. Pozita dhe përhapja e ndërtesave dhe drunjëve ekzistues brenda 50 metrave të punëve ndërtimore të propozuara.</p>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<p>3. Plani i lokacionit 1:200 ose 1:500, i shënuar me dimensione të shkruara dhe kuota të lartësisë, që tregon qartë:</p> <p>3.1. Kufijtë e parcelës kadastrale dhe hapësirën totale të sipërfaqes;</p> <p>3.2. Vijën rregulluese;</p>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

<p>3.3. Vijnë e ndërtimit;</p> <p>3.4. Largësia e mureve të jashtme të katit përdhes nga kufijtë e parcelës kadastrale;</p> <p>3.5. Largësia e perimetrit të kulmit nga kufijtë e parcelës kadastrale;</p> <p>3.6. Pika më e lartë me metra e ndërtimit të propozuar;</p> <p>3.7. Sipërfaqja e përgjithshme e gjelbërimit për depërtueshmëri të reshjeve atmosferike;</p> <p>3.8. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale; dhe</p> <p>3.9. Hapësirat e brendshme dhe të jashtme të ndara për parkim të automjeteve;</p>			
<p>4. Planet e katit përdhes dhe kulmit, dukjet dhe prerjet 1:200 ose 1:100, e ndërtimit të propozuar në kontekst me ndërtimet fqinje që janë në distancë prej pesëmbëdhjetë (15) metra nga kufijtë e parcelës kadastrale, që tregojnë qartë:</p> <p>4.1. Ndërtesat ekzistuese ose muret që do të rrënohen;</p> <p>4.2. Klasifikimi i jashtëm i rezistencës ndaj zjarrit të elementeve të ndërtimit, siç janë kulmi, muret, dyert dhe dritaret;</p> <p>4.3. Materialet e propozuara për sipërfaqet e jashtme të mureve, kulmit, dritareve dhe dyerve;</p> <p>4.4. Marrëdhënia ndërmjet ndërtesës ekzistuese dhe ndërtesave fqinje ekzistuese, ku tregohet lartësia, detajet dhe pozitat e hapjeve për dritare;</p> <p>4.5. Ndarjet e brendshme të hapësirave;</p> <p>4.6. Punët ndërtimore të jashtme si janë, rrethojat, portat, asfaltimet, reliefi, bimët, etj.</p>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
<p>5. Raporti teknik i hulumtimit të vendndërtimit, që përbëhet prej:</p> <p>5.1. Raporti/Elaborati i studimit gjeodezik;</p> <p>5.2. Raporti/Elaborati i studimit gjeomekanik; (të dorëzohet vetëm për llojet e ndërtimit të Kategorisë II dhe III).</p> <p>5.3. Kushtet ekzistuese sizmike, meteorologjike, klimatike dhe raporti për ndotjen e mjedisit dhe nga zhurmas;</p> <p>5.4. Raporti për kërcënimet natyrore dhe mjedisore, siç janë zjarret e pyjeve, vërshimet, erozioni i tokës, rrëshqitja e gurëve, ortekët, tharja e tokës bujqësore, ndotja e ajrit, ndotja e ujit dhe kontaminimi.</p> <p>5.5. Vlera e paraparë e kostos për punët ndërtimore;</p> <p>5.6. Kostoja e paraparë e marrëveshjes për zhvillimin e infrastrukturës.</p>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

VIII. Qasja e njerëzve me aftësi të kufizuara (vetëm për kategorinë II & III)			<input type="checkbox"/>
1.Specifikacionet teknike të materialeve:	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
2.Paramasat, përfshirë udhëzimet teknike për ekzekutimin e punëve ndërtimore;	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
3.Bazat e kateve dhe kulmit, bazat e reflektuara të tavanit, dukjet dhe prerjet 1:100 ose 1:50 shënuar me dimensione të shkruara dhe me kuotat e lartësisë ku tregohet qartë pozita, madhësia, hapësira e dispozitave të qasjes për: 3.1.Sipërfaqet me ndryshime në lartësi, siç janë rampat, shkallët dhe parrakët e tyre, ashensorët dhe platformat e ngritjes; 3.2.Veprimtaritë e pavarura, siç janë hyrjet, hollët, hapsira e qarkullimit, banesat, baret dhe restorantet, dhomat e zhveshjes, dushet, pishinat, vendi për qëndrim të spektatorëve, telefonat publikë dhe tekstofonët, fakset, makinat ATM, telefonat publik, pajisjet elektrike të kontrollit, dorëzat e dyerëve dhe dritareve, sportelet e shërbimit dhe tavolinat, tabelat e njoftimit, tabelat e udhëzimeve dhe shenjat, etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
4.Vizatimet e detajuara të elementeve të ndërtimit.			

* * * * *

SHTOJCA Nr. 7

Mostër e Listës së Kontrollit për Shqyrtim të Aplikacioneve për Leje Ndërtimore

Shqyrtimi i Aplikacionit për Leje Ndërtimore					
Aplikuesi: _____		Numri i vrojtimit i lejes: _____			
Adresa: _____					
Përshkrimi i projektit: _____					
Data e pranimit të aplikacionit: _____			Data kur lëshohet vendimi: _____		
I. Kushtet ndërtimore					
	Kërkohet	Propozohet	Në përputhje?		
			Po	Jo	N/A
1. Destinimi për shfrytëzimin e tokës			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Vija rregulluese			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Vija e ndërtimit			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Lartësia e lejuar në proporcion me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9. A janë aranzhimet e propozuara për kyçje në një rrugë ekzistuese publike dhe nëse nuk ka qasje të menjëhershme në një rrugë publike ekzistuese ose propozimi për zgjerimin e rrejtës ekzistues të rrugëve publike deri në parcelën kadastrale në pajtim me dokumentin e planifikimit hapësior?			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

10. A është propozimi për qasje të personave me aftësi të kufizuara në rrugë publike dhe në transport, siç janë stacionet dhe platformat, parkingjet e automjeteve, rrugët dhe vendkalimet për këmbësor, semaforët, ishujt e komunikacionit dhe udhëkryqet në pajtim me Kodin e Ndërtimit?			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--	--	--	--------------------------	--------------------------	--------------------------

* * * * *

VIII. Qasja për njerëzit me aftësi të kufizuara				
SHËNIM: Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me Kodin, sigurohuni të shqyrtoni specifikacionet teknike, paramasën, udhëzimet teknike dhe vizatimet.	Në përputhje?			Komente
	Po	Jo	N/A	
1. A janë informatat që përmbajnë specifikacionet teknike të materialeve dhe pajisjeve, paramasave me udhëzimet teknike për ekzekutimin e punëve ndërtimore, vizatimeve, vizatimeve të detajuara korrekte dhe të bashkërenduara?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
2. A janë sipërfaqet me ndryshime në lartësi, siç janë rampat, shkallët dhe parrakët e tyre, ashensorët dhe platëformat e ngritjes, korrekte dhe në përputhje?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
3. A janë dispozitat për hyrjet, lobin, hapësira e qarkullimit, WC-të, banjot, kuzhinat, dhomat, klasat e mësimi, hapësirat e punës, banesat, baret dhe restorantet, dhomat e zhveshjes, dushet, pishinat, vendi për qëndrim të spektatorëve, telefonat publikë dhe tekstofonët, fakset, makinat ATM, telefonat publik, pajisjet elektrike të kontrollit, dorëzat e dymve dhe dritareve, sportelet e shërbimit dhe tavolinat, tabelat e njoftimit, tabelat e udhëzimeve dhe shenjat, etj, korrekt dhe në përputhje?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
4. A janë vizatimet e detajuara të elementeve të ndërtimit korrekt dhe në përputhje?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Komente:				

Nënshkrimi i shqyrtuesit:

Data:

LIGJI Nr. 05/L-088 PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 05/L-088

PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugor, kushtet bazë që duhet t'i plotësojnë rrugët nga aspekti i sigurisë rrugore, sistemin e sinjalizimit të trafikut rrugor, shenjat që i japin personat e autorizuar zyrtarë, detyrat në rast aksidenti në trafikun rrugor, kushtet për drejtim të mjetit, pajisjet dhe pajimet të cilat duhen t'i kenë mjetet, dimensionet, masën më të madhe të lejuar, ngarkesën boshtore të mjetit, si edhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojë mjeti në trafikun rrugor.

2. Ky ligj transponon pjesërisht Direktivën 2014/37/EU të datës 27.2.2014, e cila e amendamenton Direktivën e Këshillit 91/671/EEC në lidhje me përdorimin e detyrueshëm të rripave të sigurisë dhe sistemin e sigurisë për fëmijët në veturë, Direktivën 2014/47/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 3.4.2014 mbi inspektimet teknike në rrugë të automjeteve komerciale që qarkullojnë dhe e shfuqizon Direktivën 2000/30/EEC, Direktivën 91/671/EEC të datës 16.12.1991 për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me përdorimin e detyrueshëm të rripave të sigurisë për automjete neni 3.5 T.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1 Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, për subjektet e autorizuar dhe për pjesëmarrësit në trafik.

2 Institucionet shtetërore, njësitë qendrore dhe lokale të qeverisjes, personat fizikë dhe juridikë, si dhe pjesëmarrësit në trafik, janë të obliguar që, duke vepruar sipas dispozitave të këtij ligji, ta kenë parasysh sigurinë, ta zhvillojnë solidaritetin, humanitetin dhe marrëdhëniet etike ndërmjet pjesëmarrësve në trafik, ta mbrojnë shëndetin dhe jetën e personave të tjerë, në veçanti të fëmijëve, të personave me invaliditet, të moshuarve dhe të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të përkujdesen për mbrojtje të ambientit.

2 Ministria e Arsimit është e obliguar të zhvillojë programe edukativo-arsimore që kanë për qëllim aftësimin për pjesëmarrje të sigurt në trafik, si dhe ngritjen dhe zhvillimin e nivelit të kulturës së

trafikut, dhe atë duke filluar nga institucionet parashkollore, e duke vazhduar me të gjitha grupmoshat, varësisht prej nivelit të tyre psikofizik.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1.1. **Agim** – drita e parë e mëngjesit para lindjes së diellit;

1.2. **Aksident trafiku** – ngjarje në rrugë në të cilën merr pjesë së paku një mjet në lëvizje, në të cilin si pasojë një apo më shumë persona kanë vdekur deri tridhjetë (30) ditë pas aksidentit, ose janë lënduar, ose është shkaktuar dëm material. Aksident i trafikut nuk konsiderohet kur makina e punës, motokultivatori, traktori apo karroca gjatë kryerjes së punëve rrëshqet, rrokulliset, ndeshet me ndonjë pengesë natyrore gjatë lëvizjes nëpër rrugë të pa kategorizuar apo nëpër punishte ku nuk merr pjesë ndonjë mjet tjetër ose këmbësor dhe në këtë ngjarje personit tjetër nuk i shkaktohet dëm material;

* * * * *

1.22. **Këmbësor** - pjesëmarrës në trafik që nuk drejton mjet rrugor, as që transportohet nga ndonjë mjet rrugor, apo person i cili me fuqinë e vet shtyn apo tërheq karrocë dore, qerre kafshësh apo ndonjë mjet me lëvizje me veprim motorik, ndonjë mjet transportues të fëmijëve, biçikletë apo karrocë lëvizëse për njerëz të paaftë, apo person me karrige lëvizëse, i cili e lëviz mjetin me fuqinë e vet ose me fuqinë e motorit nëse lëviz me shpejtësi të njeriut që ec, apo person i cili rrëshqet me patina, me ski, me sajë apo me rrotëza etj;

* * * * *

1.35. **Ministria**- Ministria përkatëse për transport;

* * * * *

1.46. **Mjet rrugor** - çdo mjet transporti që lëviz nëpër rrugë, përveç karrocave lëvizëse pa motor për persona me aftësi të kufizuara dhe mjeteve transportuese të fëmijëve;

* * * * *

Neni 20 Semafori për këmbësorë

1. Për rregullimin e trafikut të këmbësorëve mund të përdoret semafori me drita dyngjyrëshe dhe pajisjet me zë.

2. Drita dyngjyrëshe e kuqe dhe e gjelbër vendosen vertikalisht njëra nën tjetrën: drita e kuqe lart, kurse drita e gjelbër poshtë dhe në to është e vendosur figura e këmbësorit: drita me ngjyrë të kuqe në pozitë të ndalur, ndërsa ngjyra e gjelbër në pozitë të lëvizjes.

3. Dritat me ngjyra nga paragrafi 2. i këtij neni nuk lejohet të ndizen njëkohësisht.

4. Këmbësori i cili nuk ndalet në shenjën e dritës së kuqe në vendin ku trafiku rregullohet me semaforë, dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh.

* * * * *

KAPITULLI V RREGULLAT E TRAFIKUT

Neni 33

Obligimet themelore të pjesëmarrëseve në trafik

1. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar t'iu përmbahen rregullave të trafikut, shenjave të trafikut të vendosura në rrugë, si dhe shenjave dhe urdhrave të personit të autorizuar.
2. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë në përputhje me shenjat e trafikut të vendosura në rrugë edhe kur me këtë shmangen nga dispozitat e përgjithshme të trafikut.
3. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë në përputhje me semaforët edhe kur kjo dallon nga dispozitat e trafikut për përparësinë e kalimit të shprehur në të njëjtin vend me shenjë tjetër të trafikut.
4. Pjesëmarrësit në trafik janë të obliguar të veprojnë sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrave që i japin personat e autorizuar, edhe kur me këtë shmangen nga dispozitat e caktuara të trafikut ose nga domethënia e shenjave të trafikut të vendosura në rrugë ose në semaforë.
5. Pjesëmarrësit në trafik janë të detyruar që t'i shmangen çdo veprimi që shkakton rrezik ose pengesë në trafik, që sjell në rrezik për pjesëmarrësit në trafik ose që i shkakton dëm pronës private ose publike si dhe janë të obliguar që ta lajmërojnë policinë për çdo dukuri që mund ta rrezikojë sigurinë rrugore.
6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëdhjetë (50) eurosh, shoferi i mjetit me veprim motorik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëzet (20) eurosh, çdo pjesëmarrës tjetër në trafik, përveç të shoferit të mjetit me veprim motorik, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

* * * * *

Neni 36

Pjesëmarrja në trafik e personit të verbër

1. Kur personi i verbër merr pjesë në trafik pa praninë e personit përcjellës, ai duhet ta mbajë si shenjë identifikimi shkopin e bardhë, ose një shenjë dalluese, ose të jetë nën përcjellje të qenit të aftësuar për udhëheqje.
2. Shoferi e ka për detyrë të ketë kujdes të veçantë ndaj personave të verbër, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 37

Shënjimi i mjetit të personit me aftësi të kufizuara

1. Mjeti i cili është i përshtatur për t'u drejtuar nga personi me aftësi të kufizuara, me kërkesë të tij mund të shënohet me shenjë të veçantë.
2. Shenjë të veçantë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përdorë vetëm personi me aftësi të kufizuara.

3. Shenja e veçantë lëshohet në emër të personit me aftësi të kufizuara, gjegjësisht në emër të shoqatës së personave me aftësi të kufizuara për mjetet e saj. Pamjen e shenjës, kushtet për marrjen e saj, mënyrën e shënimit të vendeve për parking dhe të drejtat e personit me aftësi të kufizuara, i rregullon Ministria me akt të veçantë nënligjor.

4. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro, personi zyrtar i cili ia jep shenjën e qasjes personit që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë nen.

5. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) eurosh, personi i cili e përdor shenjën e qasjes, por që nuk është person me aftësi të kufizuara në kuptim të paragrafit 2 të këtij neni.

* * * * *

Neni 92

Vendet ku ndalohet ndalja e mjetit

1. Është e ndaluar ndalja e mjetit në këto vende:

* * * * *

1.11. në shtegun e këmbësorëve, përkatësisht në pjesën e trotuarit i cili është i paraparë për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara;

* * * * *

1.15. në vendin e rezervuar për parkim të mjetit për personat me aftësi të kufizuara;

* * * * *

6. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, shoferi i mjetit i cili e ndal ose e parkon mjetin në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

7. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëqind e pesëdhjetë (150) deri në katërqind e pesëdhjetë (450) euro, shoferi i mjetit taksitaxi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 4. të këtij neni.

* * * * *

Neni 140

Dispozitat për lëvizje të këmbësorëve

1. Këmbësorit nuk i lejohet të lëvizë as të ndalet në rrugë.

* * * * *

7. Gjatë qarkullimit në rrugë publike, këmbësorët janë të obliguar të lëvizin njëri pas tjetrit, përveç personit i cili e shoqëron fëmijën më të ri se shtatë (7) vjeç ose personit në përcjellje të personit me aftësi të kufizuara.

8. Dënohet përkundërvajtje, me gjobë prejnjëzet (20) eurosh, personi i cili vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 të këtij neni.

* * * * *

Neni 148

Shtyrja e mjeteve me dy rrota

1. Këmbësori i cili e shtyn karrocën, biçikletën, mopedin a motoçikletën; personi i cili lëviz me ndihmën e karriges për persona me aftësi të kufizuar; personi i cili e shtyn apo e tërheq karrocën e dorës; - të gjithë këta presona duhet të lëvizin pranë skajit të djathtë të rrugës në kah të lëvizjes.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tridhjetë (30) eurosh, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

* * * * *

Neni 151

Kujdesi i shoferit ndaj pjesëmarrësve të veçantë

1. Në rastin kur rruga kalohet nga persona me aftësi të kufizuara, nga persona të moshuar ose nga fëmijë, shoferi detyrohet ta ndalë mjetin, në mënyrë që t'ua mundësojë atyre personave që ta kalojnë rrugën.
2. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyzet (40) eurosh, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat këtij neni.

* * * * *

Neni 189

Personat të cilët lirohen nga përdorimi i rripit të sigurisë

1. Ndryshe nga dispozitat e neneve 187 dhe 188 të këtij ligji, detyrimi për ta përdorur rripin e sigurisë nuk zbatohet për këta persona:

1.1. për personin që posedon certifikatë mjekësore me të cilën vërtetohet se i shfaqen efekte anësore negative po qe se e përdor rripin e sigurisë;

* * * * *

1.7. për personin e sëmurë që bartet në lesë apo në ulëse të invalidëve.

* * * * *

Neni 264

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -088

5 gusht 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-034-2016, datë 23.08.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 03/L-212

I PUNËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) dhe nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke pasur parasysh Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të ekonomisë së hapur dhe të tregut të punës;

Me qëllim të krijimit të një baze ligjore funksionale, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për marrëdhënien e punës,

Miraton

LIGJ TË PUNËS

KREU I DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.
3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët janë të punësuar tek punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
4. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhëniet e punësimit brenda misioneve ndërkombëtare, misioneve diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare.

* * * * *

Neni 5 Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.
2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.
3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.
4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kriteret dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj.
5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.

* * * * *

Neni 8 Konkursi Publik

1. Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.
2. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.

* * * * *

Neni 10 Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.
2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:
 - 2.1. një periudhë të pacaktuar;
 - 2.2. një periudhë të caktuar;dhe
 - 2.3. për punë dhe detyra specifike.
3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.
4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.
5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.
7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

8. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës.

9. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me këtë ligj.

Neni 11 Përmbajtja e Kontratës së Punës

1. Kontrata e Punës përmban;

- 1.1. të dhënat për punëdhënësin (emërtimi, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit);
- 1.2. të dhënat për të punësuarin (emri, mbiemri, kualifikimi dhe vendbanimi);
- 1.3. emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës;
- 1.4. vendin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme,
- 1.5. orët dhe orarin e punës;
- 1.6. datën e fillimit të punës;
- 1.7. kohëzgjatjen e Kontratës së Punës;
- 1.8. lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër,
- 1.9. kohëzgjatjen e pushimeve;
- 1.10. përfundimin e marrëdhënies së Punës;
- 1.11. të dhëna të tjera për të cilat punëdhënësi dhe punëmarrësi i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës;
- 1.12. kontrata e Punës mund të përmbajë të drejta dhe detyra të tjera të parashikuara me këtë ligj;
- 1.13. të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;

2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për nevojat e punëdhënësve do të përgatisë mostra të kontratave të punës sipas standardeve minimale, për periudhë të pacaktuar, të caktuar dhe për punë specifike.

* * * * *

KREU III SISTEMIMI I TË PUNËSUARIT NË VENDIN E PUNËS

Neni 17 Caktimi i të punësuarit në vendin e punës

1. I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune.

2. Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuar i pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës.

3. I punësuar sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive.

4. E punësuar gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë, e punësuar me fëmijë deri në moshën tri (3) vjeç, prindi i vetëm me fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç, prindi i punësuar me fëmijë me pengesa të rënda në zhvillim, i punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç si dhe i punësuar me aftësi të kufizuara, nuk mund të sistemohen jashtë vendbanimit të tyre, pa pëlqimin e tyre.

* * * * *

Neni 22 Orari i shkurtuar i punës

1. Orari i shkurtuar i punës caktohet për punët dhe detyrat e punës, për të cilat edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse, punëtori nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij.

2. Orari i punës shkurtohet në përpjesëtim me rrezikshmërinë për shëndetin dhe aftësinë punuese të punëtorit.

3. Orari i shkurtuar i punës mund të reduktohet më së shumti deri në njëzet (20) orë në javë, për punët me shkallë të lartë të rrezikshmërisë.

4. Punët dhe detyrat e punës nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohen në bazë të analizës profesionale nga organi kompetent, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësi.

5. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxjerrë akt nënligjor për klasifikimin dhe sistemimin e punëve të rrezikshme për të punësuarit të cilat dëmtojnë rëndë shëndetin e tyre.

6. I punësuar i cili punon në punët dhe detyrat e punës nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk mund të punojë në punë dhe detyra të njëjta jashtë orarit të punës.

7. I punësuar i cili punon me orar të shkurtuar të punës, sipas paragrafit 1. të këtij neni, i gëzon të gjitha të drejtat, sikurse të kishte punuar me orar të plotë të punës.

8. Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit.

9. Punëdhënësi është i obliguar të shpallë orarin e punës në vend të dukshëm.

Neni 26 Ndalimi i zgjatjes së orarit të punës

1. Ndalohet zgjatja e orarit të punës për të punësuarin i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

2. Punëdhënësi nuk mund të bëjë zgjatjen e orarit të punës për të punësuarën gjatë kohës së shtatzënisë, dhe prindin vetushqyes me fëmijë më të ri se tri (3) vjeç, ose me fëmijë të hendikepuar.

Neni 27 Puna e natës

1. Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate.
2. Në qoftë se puna është e organizuar me ndërrime, është e domosdoshme që të sigurohen ndërrime të atilla që i punësuarit të mos punojë natën pa ndërprerë më gjatë se një (1) javë të punës.
3. Ndalohet puna e natës për personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe të punësuarat shtatzëna dhe gratë gjdhënëse. Ndërrimet e natës mund të kryhen nga prindërit e vetëm dhe gratë me fëmijë më të rinj se tri (3) vjeç, ose me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, vetëm me pëlqimin e tyre.
4. Në qoftë se të punësuarit gjatë punës së natës, për shkak të punës së bërë sipas vlerësimit të organit kompetent shëndetësor, i përkeqësohet gjendja shëndetësore, punëdhënësi është i detyruar ta caktojë në punë të përshtatshme gjatë orarit të ditës.

* * * * *

Neni 32 Pushimi vjetor

1. I punësuarit gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.
2. Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një ditë pune.
3. I punësuarit i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje së paku prej tridhjetë (30) ditësh pune, për vitin kalendarik.
4. Nënata me fëmijë deri në tri (3) vjeç si dhe prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për dy (2) ditë pune shtesë.
5. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit.
6. Punët dhe detyrat e punës sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MPMS-ja.

* * * * *

KREU VI MBROJTJA DHE SIGURIA NË PUNË

Neni 42 Mbrojtja e përgjithshme në punë

1. I punësuarit ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.
2. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.
3. Punëdhënësi detyrohet ta informojë punëtorin me shkrim para angazhimit të tij, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohet t'i marrë.
4. Punëdhënësi obligohet të japë udhëzime që tregojnë rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të merren në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

5. Punëdhënësi është i detyruar t'i zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës.

6. I punësuar është i detyruar t'i përmbahet rregullave për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e vet, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë.

* * * * *

Neni 44

Mbrojtja e të rinjve, femrave dhe e personave me aftësi të kufizuara

Femra e punësuar, i punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe personi me aftësi të kufizuara, gëzojnë mbrojtje të veçantë në përputhje me këtë ligj.

* * * * *

Neni 47

Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara

1. I punësuar tek i cili paraqitet aftësia e kufizuar, ka të drejtë të punojë në punën e tij ose sipas përshkrimit të punës ose punë tjera përkatëse, nëse sipas aftësisë së mbetur për punë mund ta kryejë atë punë pa rehabilitim profesional.

2. I punësuar të cilit i është zvogëluar aftësia shëndetësore për punë pas rehabilitimit profesional është aftësuar të kryejë punë të caktuara, konsiderohet i aftë për kryerjen e atyre punëve;

3. Në rastet si në paragrafin 2. të këtij neni, punëdhënësi ka për detyrë që të punësuarit t'ia sigurojë atë lloj pune për të cilën është aftësuar pas rehabilitimit profesional.

4. Në qoftë se i punësuar refuzon t'i pranojë punët sipas këtij neni, punëdhënësi me paralajmërim mund t'ia shkëpusë kontratën e punës të punësuarit.

Neni 48

Mbrojtja e amësisë

1. Femra e punësuar gjatë kohës së shtatzënisë, nëna me fëmijë nën moshën tri (3) vjeç, nuk mund të obligohet të punojë më gjatë se orari i rregullt i punës, dhe punë gjatë natës.

2. Prindi vetushqyes, me fëmijë të moshës deri tri (3) vjeç dhe me fëmijë me invaliditet të rëndë, nuk mund të detyrohet të punojë më gjatë se orari i rregullt i punës dhe punë gjatë natës.

3. Të drejtat nga paragrafi 1. i këtij neni, mund t'i shfrytëzojë edhe adoptuesi i fëmijës, përkatësisht personi tjetër që kujdeset për fëmijën, në rast të vdekjes së dy prindërve të fëmijës ose nëse prindi e braktis atë.

* * * * *

Neni 52

Mungesa nga puna për përkujdesje të veçantë të fëmijës

1. Fëmija i cili domosdo ka nevojë për përkujdesje të veçantë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, respektivisht fëmija i cili është me aftësi të kufizuara të përhershme, njëri prej prindërve me skadimin e pushimit të lehonisë ka të drejtë, që të punojë me gjysmë orari të punës derisa fëmija t'i mbushë dy (2) vjeç.

2. Mbrojtjen dhe të drejtat nga paragrafi 1. i këtij nenin, mund t'i shfrytëzojë adoptuesi, përkatësisht kujdestari i fëmijës, në rast të vdekjes së të dy (2) prindërve ose nëse prindërit e braktisin fëmijën.

3. Mënyra dhe procedura e realizimit të të drejtave nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, bëhet sipas dispozitave të Ligjit për Përkujdesje Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara.

Neni 53

Ndalimi i shkëputjes së kontratës

Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji.

Neni 54

Lajmërimi për paaftësinë e përkohshme për punë

1. Në rast të sëmundjes ose paaftësisë së përkohshme për punë, i punësuarit është i obliguar të informojë punëdhënësin menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna;

2. Në rast të sëmundjes ose lëndimit serioz që parandalon të punësuarin për ta informuar punëdhënësin sipas paragrafit 1. të këtij neni i punësuarit duhet të bëjë përpjekje për të informuar punëdhënësin sa më shpejt që është e mundur;

3. Nëse i punësuarit nuk mund të dëshmojë se ka bërë përpjekje të arsyeshme për të informuar punëdhënësin për mungesën e tij për vonesa të paarsyeshme, punëdhënësi mund të thirret në shkelje të kontratës;

4. Nëse mungesa e lajmëruar nga puna zgjat më shumë se tri (3) ditë, punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë nga i punësuarit certifikatën mjekësore që arsyeton mungesën nga puna.

* * * * *

KREU IX

PROCEDURAT PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

Neni 78

Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

1. I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.

2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.

3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

Neni 79

Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .

Neni 80

Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjukata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

Neni 81

Mbrojtja e të drejtave përmes ndërmjetësimit

1. I punësuar dhe punëdhënësi mund ti zgjidhin mosmarrëveshjet nga puna dhe në bazë të punës përmes ndërmjetësimit.

2. Rregullat dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga puna përmes ndërmjetësimit përcaktohen me dispozitat e ligjit për ndërmjetësim si dhe me dispozitat tjera ligjore të aplikueshme.

Neni 82

Mbrojtja e të punësuarit nga Inspektorati i Punës

1. I punësuar në çdo kohë mund t'ia dorëzojë ankesën Inspektoratit të Punës për çështje të cilat bien nën kompetencat e këtij organi.

2. Inspektorati i Punës duhet të nxjerrë vendime lidhur me ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve ose ta informojë parashtruesin e ankesës lidhur me zgjatjen e afatit brenda të cilit duhet të merret vendimi.

Neni 83

Masat ndëshkuese

Për shkeljen e dispozitave të këtij ligji nga ana e punëdhënësit, Inspektorati i Punës do t'i shqiptojë masat ndëshkuese bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës.

* * * * *

Neni 100

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-212

1 nëntor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-077-2010, datë 18.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 03/L-149

PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) dhe nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale.
2. Për qëllim të këtij ligji, institucionet e administratës qendrore dhe komunale, që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji përfshijnë: administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale.
3. Ky ligj përcakton rregullat për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, rregullat për pranimin në të, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimin në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë.
4. Institucionet e administratës qendrore, të cilat rregullohen me ligj të posaçëm, do t'iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji, përveç rasteve kur ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme nga ai.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
 - 1.1. **Shërbimi civil** - i tërë trupi i personelit administrativ të punësuar, në institucionet e administratës qendrore dhe komunale të parapara me këtë ligj, të cilët zbatojnë politikat dhe sigurojnë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse.
 - 1.2. **Nëpunës civil** - personi i punësuar për ushtrimin e autoritetit administrativ publik në bazë të aftësisë dhe kapacitetit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.
 - 1.3. **Merita** – veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes dhe e

cila i jep nëpunësit civil të drejtën e avancimit në karrierë, në bazë të rezultateve të dëshmuara gjatë ushtrimit të detyrave administrative.

Neni 3

Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës

1. Shërbimi civil është i përbërë nga nëpunës civil, të paanshëm, profesional, të përgjegjshëm dhe që reflekton shumë etnicitetin dhe barazinë gjinore.
2. Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore.
3. Nëpunësit e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës janë pjesë e Shërbimit civil të Kosovës. Kushtet specifike për orarin e punës dhe kompensimet rregullohen me akt të veçantë të Kryesisë së Kuvendit
4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
5. Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
6. Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, me përjashtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
7. Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi.
8. Fjalët e një gjinie të përdorura në këtë ligj përfshijnë edhe gjininë tjetër.
9. Rekrutimi, organizimi, gradimi dhe menaxhimi i Shërbimit Civil të Kosovës bëhet në bazë të parimit të *meritës*; që do të thotë emërim i personit më të mirë për një pozitë në administratën publike si dhe njohje e rezultateve të nëpunësve civilë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

* * * * *

Neni 5

Parimet themelore të shërbimit civil

1. Nëpunësit civilë ushtrojnë detyrën në bazë të parimeve në vijim:
 - 1.1. **Ligjshmëria** – Nëpunësit civilë ushtrojnë të gjitha detyrat në bazë të Kushtetutës, instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare si dhe legjislacionit në fuqi.
 - 1.2. **Jodiskriminimi** - Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
 - 1.3. **Detyrimi për t'iu përgjigjur kërkesave** - Nëpunësit civilë duhet t'u përgjigjen dhe të reagojnë shpejt ndaj kërkesave, iniciativave ose ankesave të dorëzuara nga individët, organizatat private ose organe të tjera të administratës publike;

1.4. **Efektshmëria dhe efikasiteti** - Nëpunësit civilë duhet të sigurojnë zbatimin e thjeshtë dhe ekonomik të rregullave dhe procedurave administrative për përmbushjen e objektivave të administratës dhe në interesin publik dhe në të mirë të administratës publike dhe të qytetarëve;

1.5. **Përgjegjësia** - Nëpunësit civilë janë të detyruar që të raportojnë, shpjegojnë dhe të përgjigjen për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre administrative.

1.6. **Paanësia dhe pavarësia profesionale** - Nëpunësve civilë nuk u lejohet njëanshmëria, që do të thotë të ketë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një situatë, duke shkaktuar si rrjedhojë një dëm të pajustificueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtën e palëve të tjera të interesuara;

1.7. **Transparenca** - Nëpunësit civilë ruajnë konfidencialitetin e informacionit, që kanë në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që dalin nga legjislacioni që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike. Proceset në shërbimin civil janë të hapura për publikun.

1.8. **Shmangia e konfliktit të interesit** - Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit.

1.9. **Parimi i mundësive të barabarta për komunitete dhe gjini** – Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në organet e administratës publike kanë pjesëtarët e dy gjinive.

* * * * *

KREU III PRANIMI, EMËRIMI DHE KUSHTET E PUNËSIMIT

Neni 11 Pranimi në Shërbimin Civil

1. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.

2. Komunitet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

3. Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë.

4. Brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministria përgjegjëse për administratën publike nxjerr legjislacionin dytësor që rregullon procedurat për të siguruar përfaqësim të drejtë proporcional të komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës në nivel qendror dhe lokal, siç parashihet paragrafin 3 të këtij neni.

5. Brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministria përgjegjëse për administratën publike nxjerr legjislacionin dytësor mbi procedurat e shërbimit civil: rekrutimi, puna provuese, përshkrimi i punës, vlerësimi i punës, procedurat disiplinore, procedurat e ankimit, orari i punës dhe vijueshmëria në punë, procedurat e pushimit, shënimet e personelit, procedurat për mundësitë e barabarta, si dhe ndërprerja e punësimit.

* * * * *

Neni 13

Kërkesat e përgjithshme për pranim në shërbimin civil

1. Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.
2. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të kryhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit.
3. Në përputhje me parimet evropiane të lëvizjes së lirë të punëtorëve dhe mos-diskriminimit, të huajt të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme për vendin e punës mund të pranohen në Shërbimin Civil të Kosovës. Qeveria përcakton disa funksione themelore shtetërore (që kanë të bëjnë me sovranitetin e shtetit), të cilat mund të kufizohen vetëm për shtetasit e Kosovës.
4. Në Shërbimin Civil të Kosovës mund të lejohet puna vullnetare-pa pagesë e nëpunësve civilë pas pensionimit, deri në moshën shtatëdhjetë (70) vjeçare. Mënyra e punës vullnetare rregullohet me Rregullore të nxjerrë nga Qeveria.

* * * * *

Neni 18

Kriteret bazë për pranim në shërbimin civil

1. Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës.
2. Institucionet janë të detyruara të përgatisin planet e pranimit të burimeve njerëzore në institucion.
3. Pranimi në shërbimin civil në pozicionet e karrierës është i hapur për të gjithë kandidatet për të gjitha pozicionet jo drejtuese në çdo institucion. Për pozicionet drejtuese dhe pozicionet e larta drejtuese, pranimi kryhet nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë ekzistues. Në rast se nuk ka kandidatura nga nëpunësit civilë ekzistues, apo kandidatët kanë rezultuar të pa përshtatshëm në përfundim të procesit të konkurrimit, pranimi hapet për të gjithë të interesuarit.
4. Pranimi në shërbimin civil në pozicione të jo karrierës është i hapur për të gjithë kandidatët pa përjashtim.
5. Për pozita menaxheriale, pranimi bëhet me anë të avancimit të nëpunësve ekzistues civil.
6. Pranimi në shërbimin civil u mundësohet edhe kandidatëve të jashtëm:
 - 6.1. për pozita që kërkojnë shkathtësi dhe aftësi të specializuara, e që nuk janë brenda shërbimit civil;
 - 6.2. nëse nuk ka aplikacione të nëpunësve ekzistues civil;
 - 6.3. kur asnjë prej kandidatëve të brendshëm nuk i plotëson kriteret për pranim në fund të procesit të përzgjedhjes.
7. Për procesin e pranimit për të dy llojet e pozicioneve, institucioni krijon një komision *ad hoc* për zhvillimin e konkursit.

8. Procedurat e pranimit organizohen, menaxhohen dhe zbatohen nga institucioni, i cili ka për qëllim të plotësojë pozita të lira, në bashkëpunim dhe pajtueshmëri me departamentin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, i cili është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Shërbimin Civil të Kosovës.

9. Pranimi në shërbimin civil për pozita me afat të pacaktuar në fillim bëhet në gradën më të ulët të kategorisë përkatëse funksionale. Pranimi i kandidatëve për pozita të lira të shpallura, të klasifikuara në nivele më të larta fillestare mund të bëhet vetëm në gradën në të cilën është klasifikuar pozita

10. Procedurat e hollësishme për zhvillimin e pranimit miratohen nga Qeveria, me rregullore të veçantë.

Neni 19

Marrëdhënia e punës në shërbimin civil

1. Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil.

2. Nëpunësit civilë në pozitat e karrierës pranohen në punë pa afat. Nëpunësit civilë në pozita të jo karrierës pranohen në punë me afat të caktuar.

3. Nëse shkresa e punësimit nuk kthehet e nënshkruar nga kandidati i pranuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e njoftimit, atëherë punësimi i ofrohet kandidatit tjetër me radhë në listën e kandidatëve, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parapara me akte nënligjore

* * * * *

KREU V

KUSHTET E PUNËS TË NËPUNËSVE CIVIL

Neni 36

Orari i punës

1. Orari i punës së nëpunësve civilë nuk do të tejkalojë dyzet (40) orë në javë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

2. Çdo nëpunës civil ka të drejtë një (1) orë pushim gjatë tetë (8) orëve të punës në ditë dhe, pos kësaj, një periudhë javore të pushimit së paku dyzetetë (48) orë.

3. Femrave shtatzëna, nënave me fëmijë deri në moshën tre (3) vjeçare dhe nëpunësve civilë me aftësi të kufizuara, nuk u kërkohet të punojnë natën dhe më shumë se dyzet (40) orë në javë.

4. Kur kërkohet puna me ndërrime, modelet e ndërrimeve i përcakton institucioni punëdhënës në pajtim me udhëzimet administrative që nxjerr ministria përgjegjëse për administratë publike.

* * * * *

Neni 39

Pushimi vjetor

1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pushim vjetor dhe në pushim për festa zyrtare në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë me kohëzgjatje minimale prej tetëmbëdhjetë (18) ditë pune, në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësimit.

3. Kohëzgjatja e pushimit vjetor do të përcaktohet në bazë të përvojës së punës dhe me këtë rast çdo dy (2) vjet përvojë pune e rrisin pushimin vjetor për një (1) ditë pune.
4. Nëpunësit civilë nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për pushim vjetor. Pushimi vjetor merret brenda vitit kalendarik që fitohet.
5. Nëpunësi civil mund t'i bartë në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) ditë pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor duhet të shfrytëzohen brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik.
6. Anulimi ose shkurtimi i pushimit vjetor nuk mund të përdoret si masë disiplinore.
7. Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar.

* * * * *

Neni 41

Kushtet shëndetësore

1. Organi i punësimit mund të saktësojë kushtet shëndetësore të nëpunësve civilë, duke përfshirë edhe kërkesën për vlerësim mjekësor, ku një kusht i caktuar shëndetësor ose i përshtatshmërisë shëndetësore kërkohet për kryerjen efikase të punës në fjalë dhe nuk ka mundësi të përshtatjes së punës së kërkuar apo të kushteve të punës. Kjo dispozitë nuk duhet të zbatohet në mënyrën e cila do të cenonte parimet e mosdiskriminimit të përcaktuara me Ligjin Kundër Diskriminimit.
2. Nëse pas një sëmundje të gjatë ose paaftësisë fizike gjendja shëndetësore e nëpunësit civil e lejon atë të rifillojë kryerjen e detyrave të tij apo të saj, siç dëshmohet nga komisioni mjekësor, organi i punësimit duhet të përpiqet të sigurojë një ambient pune apo një vend tjetër pune për t'i mundësuar nëpunësit civil që të veprojë në atë mënyrë.

KREU VI

TË DREJTAT E NËPUNËSVE CIVILË

Neni 42

E drejta për kushte të përshtatshme pune

1. Çdo organ i punësimit duhet të garantojë që nëpunësit civilë të kenë një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune. Ankesat dhe pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës duhet t'i drejtohen menjëherë të burimeve njerëzore të organit të punësimit.
2. Organi i punësimit siguron kushte me të cilat mbrohet integriteti fizik dhe moral i nëpunësit civil.

Neni 43

E drejta për trajtim të barabartë dhe mundësi të barabarta për zhvillim të karrierës

1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike.
2. Është detyrë e administratës publike që t'i heqë të gjitha pengesat administrative, të cilat i kufizojnë liritë dhe barazinë e nëpunësve civilë, të cilat e pengojnë zhvillimin e tyre profesional dhe i kufizojnë mundësitë për pjesëmarrje efektive në realizimin e qëllimeve të vendosura për shërbimin civil.
3. Nëpunësit civilë do të trajtohen nga eprorët e tyre me respekt ndaj dinjitetit të tyre njerëzor dhe nuk do t'u kërkohet që të kryejnë detyra të cilat mund ta dëmtojnë atë.

4. Nëpunësit civilë kanë të drejtë që të inkurajohen dhe të përkrahen në avancimin e karrierës dhe zhvillimit të tyre profesional përmes trajnimit dhe mënyrave të tjera.

* * * * *

Neni 50 **E drejta për ankesë**

1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës.

2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike.

* * * * *

KREU IX **PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL**

Neni 83 **Ndërprerja e marrëdhënies së punës**

Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të pezullohet, ndërpritet dhe të përfundojë sipas kushteve të parapara me këtë ligj

Neni 84 **Ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të paaftësisë për të vepruar**

1. Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil ndërpritet për shkak të paaftësisë për ushtrimin e detyrës në shërbimin civil, e cila është dëshmuar dhe certifikuar nga komisioni mjekësor. Marrëdhënia e punës ndërpritet për shkak të paaftësisë vetëm në rast kur shkalla e paaftësisë nuk e mundëson transferimin në ndonjë pozitë tjetër në shërbimin civil.

2. Në administratën publike nuk është e lejueshme ndërprerja e marrëdhënies së punës e nëpunësve civilë për shkak të problemeve të vogla ose joserioze shëndetësore, të cilat nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave nga nëpunësi civil.

3. Nëpunësit civilë, marrëdhënia e punës së të cilëve ndërpritet për shkak të paaftësisë fizike ose problemeve shëndetësore që nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave të tjera pas ricaktimit në një funksion dhe punë tjetër, mund të ankohen kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

4. Nëpunësit civilë, marrëdhënia e punës së të cilëve ndërpritet për shkak të paaftësisë fizike ose problemeve shëndetësore të shkaktuara si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, janë në përkujdesje të Qeverisë dhe rregullohen me akte nënligjore.

* * * * *

Neni 105 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-149
13 maj 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-022-2010, datë 14.06.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

RREGULLORJA NR. 31/2012 PËR PROCEDURAT E PËRKUJDESJES PËR NËPUNËSIT CIVIL PËR SHKAK TË PAAFTËSISË FIZIKE APO MENDORE OSE PROBLEMEVE SHËNDETËSORE

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim të nenin 84, paragrafi 4 të Ligjit nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011,

Nxjerr:

RREGULLORE Nr. 31/ 2012 PËR PROCEDURAT E PËRKUJDESJES PËR NËPUNËSIT CIVIL PËR SHKAK TË PAAFTËSISË FIZIKE APO MENDORE OSE PROBLEMEVE SHËNDETËSORE

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurën për përkujdesjen ndaj nëpunësve civil të cilëve u ndërpritet marrëdhënia e punës apo transferohen/ricaktohen në vend tjetër të punës, për shkak të paaftësisë fizike ose problemeve shëndetësore të shkaktuara gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për nëpunësit civilë në rastet e paaftësisë fizike apo mendore, ose problemeve shëndetësore të shkaktuara gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Neni 3 Përkufizimet

1. **Komisioni Mjekësor** - nënkupton komisionin e përbërë prej ekspertëve mjekësor, që është themeluar dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

2. **Paaftësi e plotë fizike apo mendore ose probleme shëndetësore të shkaktuara si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare** - nënkupton paaftësinë e plotë për shkak të dëmtimeve të funksioneve fizike apo psikike të konstatuar nga Komisioni Mjekësor, në pajtim me parimet e definuar sipas klasifikimit ndërkombëtar për funksione trupore, invaliditet dhe shëndet, të cila janë shkaktuar te nëpunësi civil, si rezultat i lëndimit apo sëmundjes gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, e që nuk mund të përmirësohen me shërim ose me masa të rehabilitimit mjekësor dhe si pasoj e kësaj nuk mund të ushtroj asnjë detyrë zyrtare në Shërbimin Civil;

3. **Paaftësi e pjesshme fizike apo mendore ose probleme shëndetësore të shkaktuara si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare** - nënkupton paaftësinë e pjesshme për shkak të dëmtimeve të funksioneve fizike dhe psikike të konstatuar nga Komisioni Mjekësor, në pajtim me parimet e definuar sipas klasifikimit ndërkombëtar për funksione trupore, invaliditet dhe shëndet, të cila janë shkaktuar te nëpunësi civil, si rezultat i lëndimit apo sëmundjes gjatë kryerjes së detyrës zyrtare;

4. **Përkujdesje** - nënkupton kompensimin material për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, apo përshtatje të kushteve dhe ambientit të punës, në rast të transferimit/ricaktimit në vend tjetër të punës, ndaj nëpunësit civil për paaftësi të konstatuar nga Komisioni Mjekësor me vendim të plotfuqishëm, që është shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të nëpunësit civil.

5. Termat tjera që nuk janë përfshirë në përkufizime të kësaj Rregulloreje, kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (tutje: Ligji) dhe legjislacionin në fushën e shëndetësisë.

Neni 4

Inicimi i procedurës

1. Nismën për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të nëpunësit civil, pranë Komisionit Mjekësor mund ta ndërmerret nëpunësi civil apo institucioni ku është i punësuar nëpunësi.
2. Kërkesa për vlerësimin e gjendjes shëndetësore dorëzohet në njësinë e personelit të çdo institucioni, sipas Formularit 1 të kësaj Rregulloreje, të cilit i bashkëngjiten Fletëlëndimi (Formulari 2) dhe dëshmitë e certifikuara.
3. Pas kompletimit të lëndës, njësia e personelit në afat prej 5 ditëve të punës, e dërgon lëndën në zyrën e komisionit mjekësor.
4. Shpenzimet e komisionit mjekësor i mbulon ministria përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale.

Neni 5

Komisioni përgjegjës për konstatim të paaftësisë për punë të nëpunësit civil

1. Komisioni Mjekësor sipas dëshmimeve të certifikuara dhe të konstatuara me vendim të plotfuqishëm në pajtim me legjislacionin në fuqi, e përcakton shkallën e paaftësisë së përkohshme, përhershme apo aftësisë të mbetur për punë ose të problemeve shëndetësore të shkaktuara gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të nëpunësit civil.
2. Nëpunësi civil i pa kënaqur me konstatimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë ka të drejtë të ankohet në shkallën e dytë të komisionit mjekësor sipas ligjit për procedurë administrative.

Neni 6

Ndërprerja e marrëdhënies së punës të nëpunësit civil

1. Institucioni në të cilin është i punësuar nëpunësi civil, i ndërpret marrëdhënien e punës në bazë të vendimit të plotfuqishëm të Komisionit Mjekësor të përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
2. Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të nëpunësit civil sipas paragrafit 1 të këtij neni institucioni nxjerr vendim me të cilin caktohet shkaku dhe dita e ndërprerjes.
3. Zbatimi i vendimit të plotfuqishëm të Komisionit Mjekësor është i detyrueshëm.

Neni 7

Përkujdesja ndaj nëpunësve civil me paftësi

1. Nëpunësi civil të cilit i është zvogëluar aftësia e përhershme për punë e shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare e që nuk e pengon ushtrimin e detyrave tjera sipas konstatimit të Komisionit Mjekësor të përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, duhet t'i mundësohet:
 - 1.1. transferimi/ricaktimi në vend tjetër adekuat sipas aftësisë së mbetur për punë dhe sipas përgatitjes së tij profesionale, brenda institucionit ku ai punon.
 - 1.2. transferimi/ricaktim në ndonjë vend tjetër të punës brenda institucioneve të Shërbimit Civil.
 - 1.3. të punoj me orar të shkurtuar të punës në vendin e tij të punës apo vend tjetër sipas aftësisë së mbetur për punë.
2. Kategoritë e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2. dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, gëzojnë të drejtën për pagë të njëjtë të cilën e kanë realizuar deri në momentin e humbjes së aftësisë.

3. Institucioni është i obliguar që kësaj kategorie t'i përshtat kushtet dhe ambientin për punë, pas humbjes së aftësisë.
4. Në rastet kur nëpunësi civil bëhet i aftë për kryerjen e detyrës të cilën e ka kryer deri në momentin e humbjes së aftësisë, obligohet institucioni që ta kthejë nëpunësin në pozitën e njëjtë ose ekuivalente.
5. Obligohet Qeveria që t'i mbulojë shpenzimet e shërimit mjekësor për kategoritë e përcaktuara në nënparagrafët 1.1, 1.2. dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni.
6. Nëpunësi civil i pakënaqur me masat e ndërmarra sipas këtij neni ka të drejtë ankese në Komisionin për Konteste dhe Ankesa.

Neni 8

Përkujdesja për nëpunësit civil me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të paaftësisë për punë

1. Nëpunësit civil, që i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të paaftësisë fizike të plotë ose problemeve shëndetësore të shkaktuara gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të konstatuar nga Komisioni Mjekësor, i njihet nga institucioni ku punon, e drejta për përkujdesje:

1.1. në pagë të plotë deri në 12 muaj nga momenti i konstatimit të paaftësisë të plotë për punë nga Komisioni Mjekësor, sipas vendimit të plotfuqishëm.

1.2. në mbrojtje shëndetësore, këto kategori duhet të lirohen nga pagesa-bashkëpagesa, bazuar në legjisllacionin për shëndetësi.

2. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në nënparagrafin 1.1 të këtij neni, nëpunësit civil i njihet e drejta në pagë mesatare në Shërbim Civilë, të cilën obligohet ta realizojë Qeveria deri në moshën e pensionimit.

3. Nëpunësi civil gëzon të drejtën në pagë sipas rregullatave ligjore në fuqi, deri në momentin e marrjes së vendimit të plotfuqishëm nga Komisioni Mjekësor.

Neni 9

Dispozitat kalimtare

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, obligohet Ministria përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale që të bëjë plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2009 për themelimin, organizimin dhe funksionimin e zyrës së komisioneve mjekësore, në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Hashim Thaçi

Kryeministër i Republikës së Kosovës
Prishtinë, më 14.12.2012

(EKSTRAKT)

LIGJI NR. 03/L-073

PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

(I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-256)

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës, dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes demokratike në Kosovë,

Miraton:

LIGJ PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË KOSOVË

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë:

- a) sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- b) financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- c) njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret për pranueshmërinë e votës;
- d) mirëmbajtjen e listës së votuesve;
- e) regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike;
- f) përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- g) krijimin dhe funksionimin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;
- h) organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve;
- i) rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- j) kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar;
- k) mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat;
- l) kodin e mirësjelljes së subjekteve politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve;
- m) procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve;
- n) sanksionet dhe gjobat e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

Neni 2

Parimet Themelore

Mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga parimet në vijim:

- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së.
- Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave në zgjedhjet e njëjta.
- Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
- Organet e administrimit të zgjedhjeve ndërmarrin aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore. Për këtë qëllim, organet e administrimit të zgjedhjeve vejnë në dispozicion materialin edukues në gjuhët e komuniteteve në ato zona gjeografike ku ato komunitete ndodhen dhe përmes mediave që veprojnë në gjuhët e pakicave.
- Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.
- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës.
- Të gjitha subjektet politike janë të lira të bëjnë fushatë dhe të bëjnë propagandë zgjedhore në media, përmes organizimit të ngjarjeve politike dhe botimit e shpërndarjes së materialeve për fushatë në çfarëdo mënyre ligjore në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi.
- Subjektet politike kanë mundësi të barabartë për emisione në radio dhe televizion, fonde publike dhe forma të tjera të mbështetjes.
- Përdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal me qëllim të mbështetjes së një subjekti politik në zgjedhje është rreptësisht e ndaluar.
- Subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civil që përdorin pozitën, burimet, ose personelin për fushatë gjatë zgjedhjeve.
- Të gjitha subjektet politike dhe organet zgjedhore janë të obliguara t'i respektojnë kërkesat për kuotën e gjinisë siç përcaktohet me këtë ligj.
- Të gjitha subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë nen dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të këtij ligji,

“Aktiviteti i Fushatës Politike” do të thotë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet i përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet;

“Borxhi” do të thotë të gjitha shumat monetare të cilat subjekti politik është i detyruar t'ua paguajë personave të tjerë;

“**Burime**” përfshijnë artikujt e prekshëm dhe të paprekshëm siç janë përcaktuar në rregullat e një institucioni, sikurse janë automjetet, materialet shpenzuese, fotokopja, telefoni, telefoni celular, pajisjet e zyrës, objektet;

“**Fletë bilanci**” do të thotë deklarimi financiar i subjekteve politike i pasurive, detyrimeve dhe kapitalit siç është e përkufizuar në këtë nen;

“**Formulari i Përputhjes së Rezultateve**” (**FPR**) do të thotë formulari i miratuar nga KQZ-ja para çdo zgjedhjeve për qëllim të përputhjes së votave në një vendvotim;

“**Kandidati**” do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili garon në emër të një partie politike apo nisme qytetare;

“**Kandidati i pavarur**” do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili nuk i takon asnjë partie politike ose nisme qytetare dhe nuk garon në emër të asnjë subjekti tjetër politik;

“**Kapitali**” do të thotë ndryshimi ndërmjet pasurive dhe borxheve;

“**Koalicioni**” do të thotë koalicioni i dy ose më shumë subjekteve politike;

“**Komisioni Komunal i Zgjedhjeve**” (**KKZ**) është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës;

“**PZAP**” do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor;

“**Komuna**” ka kuptimin e termit sipas nenit 124 të Kushtetutës së Kosovës;

“**Komuniteti**” do të thotë banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar, etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës;

“**Kontributi**” do të thotë dhurata, ndihma ose donacioni i cilitdo lloj që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo në të mira materiale, dhe përfshinë pagesën e borxheve të subjektit dhe sigurimin jo në baza komerciale, të pasurisë, të huas, të shërbimeve dhe të objekteve për shfrytëzim ose përfitim të subjektit. Shërbimet që i ofrohen subjektit politik nga individë në mënyrë vullnetare jashtë orarit të tyre të punës dhe pa pagesë nuk konsiderohen kontribute. Kontributi realizohet atëherë kur subjekti politik përfiton nga kontributi;

“**KQZ**” do të thotë **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, organ i pavarur i ekspertëve përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve;

“**Kushtetuta**” do të thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

“**Kuvendi**” do të thotë Kuvendi i Kosovës;

“**Lista përfundimtare e votuesve**” (**LPV**) do të thotë lista e votuesve ashtu siç përcaktohet në nenin 8.6 të këtij ligji;

“**Lista Përfundimtare e Votuesve të Vendvotimit**” (**LPV VV**) do të thotë lista e votuesve të cilët janë caktuar të votojnë në një VV të rregullt, e cila mban nënshkrimin e atyre anëtarëve të cilët kanë hedhur votat e rregullta në atë VV;

“**Lista e votuesve me kusht**” (**LVK**) do të thotë lista e zbrazët e votuesve që do të përdoret në VV-të ku hidhen fletëvotimet me kusht;

“**Lista e Votuesve**” (**LV**) do të thotë lista e të gjithë votuesve me të drejtë vote për zgjedhje siç përcaktohet në nenin 7.1 të këtij ligji;

“Media” do të thotë të gjitha televizionet dhe radiostacionet që transmetojnë në territorin e Kosovës dhe të cilët janë të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Mediave, duke përfshirë edhe mediat e shkruara;

“Ngjarje” do të thotë tubim politik në mjedis të mbyllur ose të hapur, mbledhje, marsh ose vargan, fjalim ose ndonjë aktivitet tjetër i ngjashëm i caktuar për të shpërndarë mesazh politik në mënyrë që të fitohet mbështetje nga votuesit;

“Nisma Qytetare” do të thotë grupi i personave të cilët bashkohen vullnetarisht mbi bazën e një ideje, interesi ose pikëpamje të përbashkët, me qëllim zgjedhjen e kandidatëve të tyre, por që nuk dëshirojnë të formojnë parti politike;

“Organizata Jo-Qeveritare” (OJQ) do të thotë çdo organizatë jo-qeveritare e regjistruar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

“Pagesa” do të thotë transferimi i pagesës me vlerë, përfshirë dhe pagesën në formë të mallrave dhe shërbimeve. Pagesa bëhet në kohën kur merret përfitimi nga pagesa;

“Parti politike” do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në zyrë publike, ose siç e përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi;

“Pasuria” do të thotë e tërë pasuria e paluajtshme ose e luajtshme në pronë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, përfshirë paratë e gatshme në dorë ose depozitat bankare, si dhe të ardhurat që burojnë prej tyre nga shitja, kalimi në posedim të një personi të tretë apo marrëveshje tjetër, vlera e bizneseve në pronësi dhe çdo send në zotërim që ka vlerë më të madhe se pesëqind euro (500 €) dhe me jetëgjatësi ekonomike më të gjatë se tri (3) vjet;

“Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit” do të thotë periudha kohore pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e Votuesve në vendet e caktuara nga KQZ-ja dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e themeluara nga KQZ-ja;

“Periudha e fushatës” do të thotë periudha prej tridhjetë (30) ditëve për fushatën zgjedhore të subjekteve politike e cila përfundon një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve;

“Personi kontaktues” do të thotë personi i cili është i autorizuar të komunikoj në emër të subjektit politik me zyrën për çështje jo-financiare;

“Përfaqësuesi financiar” do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik, duke siguruar pajtueshmërinë e subjektit me këtë ligj dhe duke komunikuar me Sekretariatën e KQZ-së lidhur me raportet për deklarimin e financave të fushatës së subjektit;

“Pikë publicitare politike” do të thotë një reklamë e vetme e natyrës politike që përfaqëson pikëpamjet e subjektit politik të certifikuar që transmetohet nga transmetuesi medial;

“Nëpunësi publik” përfshinë, por nuk kufizohet në, personin në marrëdhënie pune me departamentin e administratës qeveritare, administratës komunale apo ndonjë organi të ngjashëm, paga e të cilit bëhet nga fondet e siguruar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës;

“Qasja e drejtë” do të thotë qasje e drejtë dhe e përpjesshme në media të shkruara dhe elektronike në kuptim të periudhave kohore të mbulimit nga mediat, vendosjes së numrit të rreshtave në mediat e shkruara, pa diskriminim për ose kundër cilitdo subjekt të veçantë të certifikuar;

“Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve” (QNR) do të thotë lokacioni ku numërohen fletëvotimet me kusht(FK-të), fletëvotimet jashtë Kosovës, dhe çdo fletëvotim i rregullt siç kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) apo Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, FPR-të nga secili VV auditohen dhe tabelohen, dhe rezultati përfundimtar përpilohet;

“Qendra e Votimit” (QV) do të thotë ndërtesa ku ndodhen një apo më shumë vendvotime për qëllim të votimit në zgjedhje dhe përfshinë një hapësirë publike brenda rrezes 25 metra nga dera e hyrjes në ndërtesë;

“Regjistri Qendror Civil” do të thotë regjistri i banorëve të përhershëm, sipas Ligjit për Shtetësinë dhe sipas këtij ligji;

“SKQZ” do të thotë Sekretariati i KQZ-së;

“Subjekti politik” do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

“Subjekti(et) i certifikuar politik” do të thotë subjekti politik, që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;

“Shpenzimi” do të thotë pagesa e bërë për mallra ose për blerje të mallrave, materialeve, punës, ose shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme. Shpenzimi bëhet në datën kur bëhet pagesa ose blerja ose në datën kur sigurohen mallrat, materialet, puna ose shërbimet, cilado që bëhet më parë;

“Shpenzimi për fushatë” do të thotë çdo pagesë e bërë për mallra ose blerje të mallrave, materialeve, punës, shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme, me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në zgjedhje, pavarësisht nëse bëhen për mbështetje të kandidatit të posaçëm, partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare, siç janë shpenzimet për reklamim në mediat e shtypura; prodhimin e spoteve transmetuese; materialet e fushatës, përfshirë pamfletet, posterët, butonat; ekspozim të reklamave, përfshirë standat e afishimit dhe prodhimin e tyre; kontributet bamirëse. Këto nuk përfshijnë shpenzimet e bëra në mbështetje të veprimtarive të rregullta të subjektit politik. Mallrat ose shërbimet për të cilat pagesat janë bërë para ose pas periudhës së fushatës, për përdorim gjatë periudhës së fushatës, po ashtu konsiderohen si shpenzime për fushatë;

“Shtetasi i Kosovës”/banor i përhershëm i Kosovës është ai individ që i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit për Shtetësinë;

“Të ardhura” do të thotë çdo shumë monetare e pranuar si kuotë anëtarësie ose tarifë; qiraja; kontributet nga jashtë nga individët, bizneset ose organizatat e çfarëdo lloji; donacionet; vlera e kontributeve në formë të mallrave dhe shërbimeve (bamirëse) kontributet dhe çfarëdo pagese për subjektin politik;

“Transmetuesi në shërbim publik” do të thotë organizata e transmetuesit publik jofitimprurës të Kosovës, siç përcaktohet me Ligjin për Radio-Televizionin e Kosovës;

“Transmetuesi privat” do të thotë transmetuesi i cili nuk është në pronësi publike;

“Tribunali” do të thotë Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ);

“Vendvotimi” (VV) do të thotë një dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm për qëllim të votimit në Ditën e Zgjedhjeve dhe që, po ashtu, përfshinë hapësirën publike me rreze prej 25 metra të hyrjes në ndërtesë në të cilën ndodhet vendvotimi;

“Vëzhguesi i akredituar” do të thotë përfaqësuesi i një subjekti të certifikuar politik, organizate joqeveritare, qeveritare ose ndërqeveritare, organizate ndërkombëtare të specializuara dhe të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendi të huaj, ose media, që ka dorëzuar kërkesën për vëzhgim të zgjedhjeve dhe ka marrë miratimin nga KQZ-ja në pajtim me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;

“Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta” (VPNV) do të thotë marrëveshjet e bëra dhe procedurat e ndjekura për ata votues me të drejtë vote në Kosovë të cilët nuk mund të votojnë personalisht në VV-në në të cilën janë caktuar për Ditën e Zgjedhjeve;

“Votuesi jashtë Kosovës” do të thotë aplikuesi i suksesshëm nga jashtë Kosovës që përdor një nga mënyrat e votimit jashtë territorit të Kosovës, siç është e saktësuar në rregullat e KQZ-së;

“Zgjedhje” do të thotë zgjedhje për Kuvendin e Kosovës;

“Zyra” do të thotë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në kuadër të KQZ-së që vepron ashtu siç është e saktësuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 4 **Data e Shpalljes së Zgjedhjeve**

4.1 Pas konsultimit me partitë politike, Presidenti i Kosovës cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.

4.2 Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në ditën e diel çdo katër (4) vjet. Zgjedhjet nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë dhe mbahen në jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit.

4.3 Sipas kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se katër (4) muaj dhe jo më vonë gjashtë (6) muaj para datës së zgjedhjeve. Vendimi përmban datën e zgjedhjeve.

4.4 Kuvendi i Kosovës zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.

4.5 Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës zgjedhjet e parakohshme caktohen nga Presidenti jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe me vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme rregullohen nga ligjet dhe rregullat e njëjta të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës në pajtim me rrethanat.

4.6 Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në ‘Gazetën Zyrtare të Kosovës’.

KREU II

E DREJTA PËR TË VOTUAR, LISTA E VOTUESVE DHE PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT PËR LISTËN SË VOTUESVE

Neni 5 **E drejta për të votuar**

5.1 Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese:

- a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
- b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo
- c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;

5.2 Asnjë person nuk mund të votojë nëse:

- a) është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Tribunali”);
- b) është i akuzuar nga Tribunali dhe ka dështuar t'i bindet urdhrorit për t'u paraqitur para Tribunalit; ose

c) është shpallur mentalisht i paaftë me vendim të prerë gjyqësor.

Neni 6 **Votimi brenda dhe jashtë Kosovës**

6.1 Çdo person me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në zonën zgjedhore ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil ose është regjistruar si qytetar i Kosovës në një datë të caktuar nga KQZ-ja.

6.2 Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht banon jashtë, ose është zhvendosur nga, Kosova ka të drejtë të votojë në zgjedhje sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 7 **Lista e Votuesve**

7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban:

a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë;

b) të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës.

7.2. Të gjithë votuesit me të drejtë vote, të shënuar në mënyrë të kërkuar nga KQZ-ja. Informatat personale të ofruara për secilin votues janë: emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar.

7.3 Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistra, të dhëna për vendbanim dhe të dhëna të tjera zyrtare.

7.4 Lista e Votuesve është në dispozicion për të pasur qasje në të ashtu siç parashihet me rregullat eKQZ-së.

7.5 Të gjitha aktivitetet dhe dokumentet e organeve shtetërore, të gjitha paraqitjet dhe të dhënat lidhura me qytetarët e regjistruar në Listën e Votuesve lirohen nga pagesa e tarifave dhe taksave.

7.6 Të dhënat personale të qytetarëve në Listën e Votuesve shënohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat shënimet origjinale mbahen në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë.

7.7 Gjykata kompetente duhet të dorëzoj të dhënat në KQZ për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna dorëzohen ashtu siç kërkohet nga KQZ-ja.

7.8 Regjistri Qendror Civil pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim më afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.

7.9 KQZ-ja u ofron Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (këtu e tutje: KKZ) një kopje elektronike të të gjithëLV-së dhe një kopje të shtypur të LV-së për komunën e tyre.

* * * * *

Neni 27 **Kuotat Gjimore**

27.1 Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.

27.2 Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.

* * * * *

KREU X

KQZ

Neni 59

KQZ

59.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (këtu e tutje "KQZ") i themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës, është një organ i përhershëm dhe i pavarur në kuptim të këtij ligji.

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.

59.3 Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja, inter alia:

- a) ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit për, dhe pjesëmarrjen në zgjedhje;
- b) ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;
- c) krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe
- d) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.

59.4 Selia e KQZ-së ndodhet në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.

59.5 Komisioni mund të lidhë marrëveshje teknike dhe mirëkuptimi të cilat mund të kërkohen për funksionimin dhe përgjegjësinë e tij.

59.6 KQZ-ja krijon dhe mban një llogari të ndarë bankare në emër të KQZ-së, që përdoret vetëm për grumbullimin dhe kthimin e depozitave siç kërkohet me ligj.

59.7 KQZ-ja i konsideron konfidenciale të gjitha të dhënat personale të mbledhura për kandidatët dhe votuesit, përveç asaj që kërkohet me këtë ligj, dhe i ndërmerr të gjitha masat për ruajtjen e këtyre të dhënave, përveç kur kërkohen nergut nga agjencitë e zbatimit të ligjit.

* * * * *

Neni 64

Përgjegjësitë dhe Funkcionet e KQZ-së

64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

64.2 KQZ-ja i:

- a) përgatitë dhe shpallë rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj;
- b) publikon të gjitha rregullat e miratuara, rregullat, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bën ato të arritshme për opinionin;
- c) krijon dhe mban listën e personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;
- d) mban Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj;
- e) përpilon dhe miraton fletëvotimet dhe materialet tjera zgjedhore;
- f) akrediton vëzhguesit zyrtarë të zgjedhjeve;
- g) certifikon listën votuese lidhur me zgjedhjet;
- h) certifikon rezultatet e zgjedhjeve;
- i) publikon rezultatet e zgjedhjeve;
- j) themelon komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimeve;
- k) cakton ekipet e numërimit për çdo këshill të vendvotimit për aq sa garantojnë rrethanat.

* * * * *

KREU XI

KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE

Neni 67

Përbërja e KKZ-ve dhe Kualifikimi i Anëtarëve

67.1 Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në përgjithësi ka shtatë (7) anëtarë, ky numër mund të rritet nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh. Secili Komision Komunal i Zgjedhjeve është i përbërë nga:

- a) Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-së i punësuar nga KQZ-ja dhe i cili do të jetë kryesues i KKZ-së; dhe
- b) nga një anëtar i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor;

67.2 Anëtarët e KKZ-së janë persona me të drejtë vote në komunë dhe me qëndrime të larta profesionale e morale, me përvojë administrative ose zgjedhore dhe njohuri të mjaftueshme që i mundëson KKZ-së të kryejë me efektivitet detyrën e vet.

67.3 KQZ-ja duhet të përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

67.4 KQZ-ja emëron KKZ-të brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Emërimet përfundojnë 15 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet.

67.5 Asnjë person nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KKZ-së, ose të vazhdojë të shërbejë pasi që është caktuar, po qe se ai/ajo:

- a) është kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik;
- b) është zotërues i një posti të lartë publik;
- c) nuk ka të drejtë të qëndrojë si kandidat në zgjedhje;
- d) është zotërues i një posti të lartë publik ose i një posti të lartë në parti të politike të certifikuar;
- e) është shpallur mendërisht i paaftë me vendim përfundimtar gjyqësor; ose
- f) paraprakisht ka qenë i anuluar nga anëtarësia në KKZ nga KQZ-ja; ose
- g) i është ndaluar shërbimi në cilësinë e anëtarit të KKZ-së nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.

67.6 Asnjë person nuk mund të shërbej, në të njëjtën kohë, në më shumë se në një KKZ.

67.7 Anëtari i Administratës Komunale i caktuar të shërbejë si anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor shërben me respekt ndaj detyrave të tij/saj si anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor, nën autoritetin e KQZ-së dhe Zyrtarit Ekzekutiv të KKZ-së gjatë periudhës derisa është i emëruar.

67.8 Emërimi i një anëtari të KKZ-së i nënshtrohet betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes së KQZ-së të miratuar nga KQZ-ja, para fillimit të punës.

67.9 Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKZ-së të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni.

Neni 68 **Përgjegjësitë e Komisionit Komunal Zgjedhor**

68.1 Të gjitha KKZ-të i administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. Pa e kufizuar parimin e përgjithshëm të përgjegjësisë të tyre, secili nga KKZ duhet të:

- a) themelojë një zyrë brenda godinës së administratës komunale për kryerjen e detyrave të veta;
- b) sigurojë informata të gjithë votuesve, për të gjitha komunitetet dhe të përhapë informata të nevojshme për administrimin e zgjedhjeve;
- c) sigurojë informata të paanshme për partitë politike, nismat qytetare, koalicionet dhe kandidatët e pavarur lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre ndaj zgjedhjeve;
- d) marr pjesë në çfarëdo seance trajnimi të kërkuar nga KQZ-ja;
- e) ndihmojë në caktimin dhe trajnimin e cilitdo person i cili ndihmon në administrimin e zgjedhjeve përfshirë edhe këshillave të vendotimeve;
- f) ndihmojë marrëveshjet teknike në Vendvotime dhe çdo përgatitje tjetër teknike për zgjedhje përfshirë pranimin e të gjithë materialit jo të ndjeshëm;
- g) sigurojë mbajtjen e përshtatshme të votimit dhe të numërimit dhe përmbledhjen e rezultateve të zgjedhjeve brenda juridiksionit të tyre;
- h) grumbullojë dhe ruajë materiale zgjedhore pas zgjedhjeve; dhe
- i) kryejë detyra tjera të cilat kërkohen nga legjislacioni në fuqi ose Rregullat e KQZ-së.

68.2 Secili ZKZ i dërgon raporte Sekretariatit të KQZ-së, çdo javë, lidhur me punën e KKZ-ve siç është e caktuar nga SKQZ-ja. Nëse Sekretariati i KQZ-së kërkon nga një ZKZ të shkruajë raport të menjëhershëm, ai duhet ta bëjë atë. ZKZ kryen detyra tjera të caktuara nga KQZ-ja.

68.3 Komisioni Komunal Zgjedhor mban shënime të rregullta për punën, përfshirë procesverbalet e mbledhjeve, vendimet e bëra, dhe raportet javore të KQZ-së dhe informatat tjera relevante.

* * * * *

KREU XIII

QENDRAT E VOTIMIT DHE VOTIMI

Neni 82

Dispozitat e Përgjithshme

82.1 LPV-ja e votuesve të caktuar në të njëjtën QV përgatitet në mënyrën e përkufizuar nga KQZ-ja në mënyrë që asnjë VV brenda QV-së nuk tejkalon 750 votues. Përfshirjet nga kjo rregull mund të autorizohen nga KQZ-ja.

82.2 Një VV duhet të jetë mjaft i madh për të siguruar mbajtjen e drejtë të votimit duke vendosur të gjitha stacionet e punës siç janë përkufizuar në këtë ligj dhe duke siguruar fshehtësinë e votës, pamjen e lirë dhe kontrollin e kutive të votimit, dhe qasje të papenguar për vëzhgues.

82.3 Personat në vijim janë të autorizuar të jenë të pranishëm në vendvotim ose Qendër të Votimit:

- a) personat e pranishëm me qëllim të votimit;
- b) anëtarët e Këshillit të Vendvotimit dhe stafi i Qendrës së Votimit;
- c) anëtarët e KQZ-së dhe personeli i SKQZ-së;
- d) anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;
- e) vëzhguesit e akredituar të procesit zgjedhor;
- f) policia, kur thirren për të vendosur rregull; dhe
- g) përkthyesit për personat e shënuar në pikat (c) (e) dhe (f) të këtij nën-paragrafi.

Neni 83

Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrave të Votimit

83.1 Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve, i publikon lokacionet e sakta të të gjitha QV-ve.

83.2 Secilit votues të regjistruar i caktohet Qendra e Votimit që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.

83.3 Sa më shumë që të jetë e mundur asnjë votues nuk duhet të udhëtoj më tepër se 3 km deri në vendin e tij apo saj të votimit.

83.4 Ndryshimet pasuese të lokacioneve të QV-ve lejohen në rastet e force majeure, ose arsye tjera objektive dhe të paparashikueshme që do të bënin QV-në të papërshtatshme për qëllime të votimit. Sekretariati i KQZ-së e informon menjëherë KQZ-në për këto ndryshime.

83.5 Nëse lokacioni i QV-së është ndryshuar, KKZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes burimeve në dispozicion të mediave lokale. Si shtesë, KKZ-ja vendos lajmërim në lokacionin origjinal të QV-së duke këshilluar votuesit për lokacionin e ri të QV-së.

83.6 VV-të janë në vend të qasshëm për të mundësuar votuesit të formojnë dhe të qëndrojnë në rresht dhe duhet, kur është e mundur, të kenë qasje të niveluar që personat me aftësi të kufizuara të kenë hyrje dhe dalje të papenguar. VV-të kanë ndriçim adekuat dhe mbrojtje nga aksidentet elementare.

83.7 Një QV ose VV nuk duhet të jetë në një vend të kultit, ndërtesë e cila është pronë apo seli e subjektit politik, ose hapësira në të cilat shërbehet apo konsumohet alkooli.

* * * * *

Neni 85

Materiali për Fushatën Zgjedhore dhe Materiali për Informim të Votuesve në VV dhe QV

85.1 Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në KZAP për shkelje të këtij ligji.

85.2 Materiali i shtypur, i prodhuar nga Sekretariati i KQZ-së në emër të KQZ-së, duke shënuar emrat e të gjithë kandidatëve të të gjitha subjekteve të certifikuara politike dhe procedurat e votimit duhet të paraqiten në VV për përfitim nga votuesit. Këto lista duhet, po ashtu, të paraqiten në derën kryesore të hyrjes të secilës QV.

85.3 Shenjat informuese në ndërtesë duhet të paraqesin në mënyrë të qartë numrin e QV-së. Brenda QV-së, veçanërisht kur ka më tepër se një VV, shenjat për të drejtuar votuesit në VV-në e duhur duhet të paraqiten dukshëm. Secila VV duhet të shënjohej qartë me shenja që tregojnë numrin e VV-së dhe shkronjat nga LPV-ja të atyre votuesve të caktuar në atë VV.

85.4 Asnjë informatë e fushatës zgjedhore nuk duhet të emetohet në çfarëdo pajisje komunikuese në Qendër të Votimit, dhe as brenda distancës së dëgjimit.

* * * * *

Neni 89

E Drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës

89.1 Votuesi më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

89.2 Askush nuk e parandalon ose orvatet të parandalojë një votues me të drejtë për të votuar nga ushtrimi i së drejtës së tij/saj për të votuar.

89.3 Askush nuk lejohet të votojë në emër të një votuesi tjetër, përveç në përputhje me dispozitat e nenit 89.5 të këtij ligji.

89.4 Secili votues e plotëson fletëvotimin e vet në fshehtësi mbrapa kabinës së votimit. Vetëm një person lejohet mbrapa kabinës së votimit gjatë një intervali të caktuar kohor përveç nëse votuesi ka kërkuar ndihmë nga personi tjetër, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.

89.5 Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin dhe/ose është analfabet mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar.

89.6 Personi i miratuar për të ndihmuar votuesin shkruan dhe nënshkruan emrin e tij/saj në Listën e duhur të Votuesve ose Zarin për Fletëvotim me Kusht, afër emrit ose një hapësire tjetër të ofruar nga votuesi i cili është ndihmuar.

89.7 Anëtarët e KVV-së nuk mund në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit.

89.8 Anëtarët e Këshillit të Vendvotimit dhe/ose stafi i Vendvotimit shpjegojnë procedurën e votimit vetëm nëse u kërkohet nga zgjedhësi.

89.9 Anëtarët e KVV-së kujdesen veçanërisht për të siguruar që zgjedhësi nuk shqetësohet nga askush përderisa shënjon fletën e tij të votimit, dhe se fshehtësia e votimit është plotësisht e siguruar.

* * * * *

KREU XV

VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 99

Dispozitat e Përgjithshme

99.1 KQZ-ja përcakton rregullat për votim për personat me nevoja të veçanta:

a) votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, mjekësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;

b) votuesit me të drejtë vote me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mendore në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit; ose

c) votimi në rrethana të veçanta: votuesit që jetojnë në bashkësitë, të cilat, për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

Neni 100

Procesi i Vendosjes

100.1 KKZ-ja lëshon një njoftim me shkrim të dhënë nga KQZ-ja duke informuar kështu çdo votues me të drejtë vote ose grup të votuesve të cilëve u është mohuar kërkesa për VPNV, duke i informuar për të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë pranë gjykatës së shkallës së parë deri në datën e caktuar në njoftim.

100.2 Gjykata e shkallës së parë shqyrton secilën parashtresë që e merr në përputhje me Rregullat e Procedurës dhe afatet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së.

100.3 Gjykata e shkallës së parë mund të urdhërojë KKZ-në që të përfshijë ose të përjashtojë votuesit me të drejtë vote nga lista e votuesve e VPNV-së, në bazë të autoritetit të saj.

* * * * *

KREU XVII

INFORMIMI I VOTUESVE DHE MEDIA

Neni 107
Dispozitat e përgjithshme

107.1 KQZ-ja, në kohë të duhur, organizon dhe sponsorizon fushatën për edukimin e votuesve. Ajo shpërndan nëpër të gjithë vendin, sipas Ligjit për përdorim të gjuhëve, informatat për:

a) procedurat e votimit; dhe

c) të drejtat e votuesve dhe procedurat për mbrojtjen e tyre, përfshirë edhe mekanizmat për ankesë.

107.2 Në secilin vendvotim, në ditën e zgjedhjeve, materiali i shtypur, i dizajnuar dhe i përgatitur në emër të KQZ-së, me emra të numëruar të subjekteve politike dhe emrave të kandidatëve, e po ashtu edhe të procedurave të votimit, nxirret, ekspozohet ose publikohet nga Sekretariati i KQZ-së në dobi të votuesve. Emrat e kandidatëve në materiale të tilla të shtypura ose të ekspozuara renditen në të njëjtën mënyrë siç paraqiten në listën e regjistrimit të kandidatëve, të certifikuar nga KQZ-ja në lidhje me subjektet politike të cilat i kanë paraqitur.

107.3 Gjatë bërjes së fushatës për edukimin e votuesve, SKQZ-ja i kushton vëmendje të veçantë votuesve në viset rurale, me aftësi të kufizuara dhe analfabet.

Neni 108
Transmetimi i informatave për votuesit

109.1 KQZ-ja përgatit material të përshtatshëm për transmetim në radio dhe televizion për informimin e publikut për procesin zgjedhor në Kosovë.

108.2 Materiali informues i përgatitur nga KQZ-ja për emetim në televizion përmban mënyrë për transmetimin simultan për njerëzit me dëgjim të dëmtuar në gjuhën adekuate për nevojat e grupeve gjuhësore të cilat shërbejnë nga transmetuesi.

* * * * *

Neni 129
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-0735 qershor 2008

RREGULLA ZGJEDHORE NR.04/2013
VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA DHE RRETHANA TË VEÇANTA

(EKSTRAKT)

Në bazë të nenit 99.1 100 dhe nenit 64.2 pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-258 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Neni 25 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 02.07.2013, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE NR.04/2013
VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA DHE RRETHANA TË VEÇANTA

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1. Kjo rregull ka për qëllim të përcaktoj mënyrën e regjistrimit dhe të evidencimit të votueseve me nevoja dhe rrethana të veçanta dhe procesin e votimit të tyre.
- 1.2. Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta do të zbatohet në ditën e zgjedhjeve nga Komisioni i Vendvotimit dhe Ekipet Lëvizëse (KVVEL), të organizuara nga KKZ-të dhe komunat e tyre.
- 1.3. Çdo ekip i Votimit të personave me nevoja dhe rrethana të veçanta do të ketë një libër të votimit në të cilin do të shënohen të dhënat e rëndësishme përkitazi me zhvillimin e VPNRV-së.
- 1.4. Ekipet e Votimit të personave me nevoja dhe rrethana të veçanta do të punojnë prej orës 09:00 deri 21:00 gjatë ditës së zgjedhjeve, duke u nisur nga KKZ-ja dhe duke u kthyer në KKZ.
- 1.5. Të gjithë anëtarët e ekipit të KVVEL-së të do të votojnë në VV-në e tyre të rregullt para orës 09:00 në ditën e zgjedhjeve.
- 1.6. Gjykata kompetente duhet të dorëzojë të dhëna te KQZ-ja për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna dorëzohen ashtu siç kërkohet nga KQZ-ja.
- 1.7. Çdo votues i regjistruar si votues me nevoja dhe rrethana të veçanta në KKZ, si rezultat i ndryshimit të rrethanave të caktuara, mund të kërkojë nga KKZ-ja të rikthehet si votues i rregullt në vendvotim, por jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1. **Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta (VPNRV)**, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, do të thotë marrëveshjet e bëra dhe procedurat e ndjekura për ata votues me të drejtë vote në Kosovë të cilët nuk mund të votojnë personalisht në vendvotim (VV) në të cilën janë caktuar në ditën e zgjedhjeve.
- 2.2. Votuesit e paraparë në këtë kategori janë siç vijojnë:

- a) **votuesit e ngjuar në shtëpi:** votuesit me zotësi juridike të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;
- b) **votuesit me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion:** votuesit me zotësi juridike në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mentale në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit, ose
- c) **votuesit në rrethana të veçanta:** votuesit me zotësi juridike që jetojnë në bashkësitë, të cilat për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ).

Neni 3

Votimi i personave të ngjuar në shtëpi

- 3.1. votuesi me zotësi juridike i cili dëshiron të regjistrohet si votues i ngjuar në shtëpi, duhet të dorëzojë në KKZ-në përkatëse në periudhën kohore në mes gjashtëdhjetë (60) ditë dhe pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve këto dokumente:
 - a) formularin e plotësuar, një kopje e të cilit është si shtojca I;
 - b) kopje të dokumentit të identifikimit (letërnjoftimi i vlefshëm, dokumenti i udhëtimit i vlefshëm, pasaportë e vlefshme);
 - c) një kopje të certifikatës së paaftësisë ose të diagnozës mjekësore në mbështetje të aplikimit të tij/saj.
- 3.2. Organizatat joqeveritare (OJQ-të) të cilat janë të regjistruara dhe të specializuara për ndihmën e personave të ngjuar në shtëpi, mund të pranojnë formularë për regjistrim dhe t'i paraqesin në Sekretariatit e KQZ-së, të plotësuar me emrat e personave për t'u përfshirë në programin e votuesve të personave të ngjuar në shtëpi.
- 3.3. Formularët për regjistrim mund të merren në zyret e KKZ-së dhe në ueb faqen e KQZ-së në internet.
- 3.4. KKZ-ja brenda dy (2) ditëve nga parashtrimi i kërkesës do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet duke i krahasuar me kriteret e përcaktuara në nenin 3.1. të kësaj rregulle dhe do t'i informojë me shkrim të gjithë aplikantët nëse u janë pranuar ose refuzuar aplikacionet e tyre.
- 3.5. KKZ-ja duhet t'i informojë ata aplikonte të cilëve u janë refuzuar kërkesat se ata, ose mund të votojnë personalisht në vendvotimin e caktuar, mund të kërkojnë korrigjim ligjor brenda afatit të dhënë në njoftim në pajtueshmëri me nenin 7 të kësaj rregulle.
- 3.6. Pas afatit përfundimtar për paraqitjen e aplikacioneve për të qenë votues i ngjuar në shtëpi, KKZ-ja do të:
 - a) përpilojë listën e të gjithë votuesve të ngjuar në shtëpi të regjistruar të asaj komune, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin e tyre, datën e lindjes, numrin personal të letërnjoftimit dhe adresën e shtëpisë të secilit votues të ngjuar në shtëpi;
 - b) dorëzojë një kopje të votuesve të ngjuar në shtëpi të regjistruar, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ);

- c) bëjë ndarjen e listës sipas adresave në atë mënyrë që njerëzit nga një zonë e njëjtë gjeografike të vizitohen nga i njëjti Komisionin i Vendvotimit Ekipi Lëvizës (KVVEL), dhe
- d) bëjë të gjitha përgatitjet adekuate, përfshirë transportimin e KVVEL-së ose kompensimin e shpenzimeve të transportit.
- e) Jo më vonë se një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve, do t'i shënojë (vulosë) në listën përfundimtare të votuesve dhe të bëjë të qartë që votuesi nuk mund të votojë në vendvotim.

3.7. KVVEL-ja do të përbëhet nga një kryesues dhe dy anëtarë. KKZ-ja do të vendosë numrin e KVVEL-ve të nevojshëm për të udhëhequr procesin e Votimit të personave të ngjuar në shtëpi dhe do t'i plotësojë këto poste nga radhët e anëtarëve rezervë të këshillave të vendvotimeve (KVV-ve), siç është vendosur në nenin 79 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Jo më shumë se një person nga një subjekt politik mund të emërohet anëtar i KVVEL-së. Me rastin e zëvendësimit të një anëtari të KVVEL-së, do të zbatohen procedurat e caktuara në nenin 74.7 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

3.8. KKZ-ja do t'i informojë paraprakisht vëzhguesit e akredituar për drejtimet nga do të shkojnë KVVEL-të dhe me orarin e planifikuar për t'u mundësuar vëzhguesve që t'i shoqërojnë ata në vizitat e tyre të votuesit e ngjuar në shtëpi. Do të jetë obligim i vëzhguesve të jenë prezentë në kohën dhe vendin e caktuar me qëllim që të shoqërojnë KVVEL-të.

Neni 4 **Procesi i votimit**

4.1. Para nisjes, duke u parë qartë nga KKZ-ja dhe çdo vëzhgues i akredituar i pranishëm, KVVEL-ja:

- a) mbyll kutinë e fletëvotimeve dhe do të shënojë numrin e shiritit mbyllës të sigurisë në Formularin e përrputhjes të VPNRV-së (FPVPNRV), një kopje e të cilit është bashkëngjitur si Shtojcë II;
- b) merr nga KKZ-ja pakon e lidhur me nga 50 fletëvotime për secilën palë zgjedhje dhe do të shkruaj në FPVPNRV-në përkatëse numrin e gjithmbarshëm të fletëvotimeve të pranuar, dhe
- c) merr nga KKZ-ja listën e votuesve të ngjuar në shtëpi (LVNSH) e cila do të përfshijë emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të dokumentit të vlefshëm identifikues, si dhe adresat e personave të ngjuar në shtëpi të shënuar sipas radhës së vizitave nga KVVEL-ja.

4.2. Te shtëpia e votuesit të ngjuar, KVVEL-ja:

- a) duhet të tregojë distinktivët identifikues të dhënë dhe të vulosur nga KKZ-ja gjatë gjithë kohës sa zgjatë procesi;
- b) kërkon nga votuesi që të identifikohet duke përdorur një dokument identifikimi të pranueshëm siç parashikohet në nenin 90 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mbi dokumentet e pranueshme të identifikimit;
- c) pas identifikimit të votuesit dhe pasi që të dhënat e votuesit të jenë shënuar në Listen e Votuesve të ngjuar në shtëpi me kusht (LVLSHK), anëtarët e KVVEL-së duhet shënuar të dhënat e votuesit në zarfet e fletëvotimeve me kusht, pastaj do t'i jepet votuesit fletëvotimi(et) dhe do të udhëzohet votuesi për procedurat e votimit;
- d) ia mundëson votuesit që t'i ndihmojë për të votuar çdo person i pranishëm, por jo anëtari i KVVEL-së e as vëzhguesi i akredituar;

- e) kërkojë nga të gjithë personat e pranishëm, me përjashtim të personit të përcaktuar në nenin 4.2 (d) të kësaj rregulle, që të dalin nga dhoma, për t'ia bërë të mundur votuesit të ngujuar në shtëpi që të shënojnë fletëvotimet;
- f) jep votuesit një fletëvotim tjetër nëse ai/ajo e ka dëmtuar fletëvotimin e parë, të mbaj fletëvotimin e dëmtuar dhe ta shënoj si “i dëmtuar”, dhe
- g) siguron që pas shënimit të fletëvotimit(eve) personi i ngujuar në shtëpi të fus fletëvotimin(et) në Zarkin(at) e Fshehtësisë brenda Zarkit të Fletëvotimeve me Kusht (ZFK). Pas lidhjes së ZVK, votuesi do ta vendosë atë në kutinë e votimit nën vështrimin e çdonjërit nga vëzhguesit e akredituar të pranishëm.

4.3. Nëse KVVEL-ja arrin të shtëpia e votuesit të ngujuar në shtëpi dhe votuesi nuk është në shtëpi apo refuzon që KVVEL-ja të hyjë në shtëpi, në LVLSHK, para emrit të votuesit të shënohet se “nuk është i pranishëm” ose “refuzon”, dhe të gjithë anëtarët e KVVEL të nënshkruhen pranë hapësirës “refuzon”. Pastaj KVVEL-ja do të largohet nga shtëpia e Votuesit të ngujuar në shtëpi.

4.4. Në fund të procesit të votimit, KVVEL-ja do ta mbyllë vrimën e kutisë së votimit dhe do ta dërgojë materialin të KKZ-ja ku, në praninë e KKZ-ve ose të vëzhguesve që janë prezentë, KVVEL-ja bën llogaritjen e fletëvotimeve të papërdorura dhe dëmtuara, plotëson Formularin e përputhjes dhe e dorëzon materialin të KKZ-ja.

* * * * *

Neni 7

Procesi i gjykimit

7.1. KKZ-ja duhet të njoftojë me shkrim çdo votues me zotësi juridike ose grupit të votuesve të cilëve u është mohuar kërkesa për VPNRV, jo më vonë se tre (3) ditë pas parashtrimit të kërkesës, duke i informuar për të drejtën e tij për të kërkuar korrigjim ligjor në gjykatën e shkallës së parë në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

7.2. Nëse gjykata e shkallës së parë brenda tre (3) ditëve nga pranimi i ankesës, vendos se votuesi ka të drejtë të marrë pjesë në programin e VPNRV-së, mund të urdhërojë KKZ-në ta inkuadrojë votuesin në listën e VPNRV-së.

Neni 8

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

8.1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore numër 04/2008 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, e datës 25.06.2009.

8.2. Pjese përbërëse e kësaj rregulle është edhe shtojca:

Shtojca – I Formulari për regjistrimin e votueseve me nevoja të veçanta

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi me datë 02.07.2013.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



FORMULAR PËR REGJISTRIMIN E VOTUESVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Programi për regjistrimin e personave me Nevoja të Veçanta ka të bëjë me evidencimin e votuesve me të drejtë vote, të cilët për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në Vendvotimin e zakonshëm.

I. SHËNIME LIDHUR ME VOTUESIN

MBIERMI/ PREZIME

EMRI/ IME

GJINIA/ POL M F

DATA E LINDJES/
DATUM RODENJA Dita Muaji Viti

ADRESA/

KOMUNA/OŠTINA

II. LLOJI I PAAFTËSISË:

Këtij formulari duhet t'i bashkëngjiten:

- fotokopja e certifikatës së paaftësisë ose diagnozës mjekësore dhe
- një kopje të letërnjoftimit

Nënshkrimi/ Potpis

Data/ Datum _____ 16. Nënshkrimi/ Potpis _____

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 04/L-017 PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të krijoj një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Me këtë ligj përcaktohen, llojet, shtrirja, shfrytëzuesit dhe ofruesit e ndihmës juridike falas, themelimi i Këshillit dhe Agjencisë për ndihmë juridike falas, kompetencat, procedura dhe kushtet për realizimin e ndihmës juridike falas, dhe financimi i ndihmës juridike falas.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ndihmë juridike falas** - e drejtë në shërbime profesionale juridike falas për qytetarët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj;

1.2. **Kërkuesi** - personi i cili kërkon ndihmë juridike falas;

1.3. **Përfituesi** - personi i cili e realizon të drejtën në ndihmë juridike falas në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj;

1.4. **Ofrues** - çdo person fizik apo juridik i cili në përputhje me këtë ligj ofron ndihmën juridike falas, si i punësuar apo i kontraktuar nga Agjencia ose në partneritet me të;

1.5. **Avokat** - anëtar i Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës.

1.6. **Lista e avokatëve** - nënkupton listën e avokatëve të përgatitur nga Oda e Avokatëve të Kosovës;

1.7. **Të ardhura të përgjithshme familjare** - të ardhurat e kërkuesit dhe të gjithë anëtarëve të familjes së tij, duke përfshirë të ardhurat e realizuara nga puna dhe angazhimet tjera profitabile, shitja e pasurisë, trashëgimia, dhuratat dhe të gjitha të ardhurat apo përfitimet tjera të fituara në Kosovë ose jashtë saj, por duke përjashtuar pasurinë e cila sipas Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore është e liruar nga përmbartimi i detyrueshëm apo tjetërsimi;

1.8. **OJQ në partneritet** - organizatë jo-qeveritare që hynë në partneritet me Agjencinë.

KREU II DISPOZITAT THEMELORE

Neni 4 Shtrirja dhe llojet e ndihmës juridike falas

1. Ndihma juridike falas ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ndihma juridike falas ofrohet në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.
3. Ndihma juridike falas jepet për këto lloje:
 - 3.1. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
 - 3.2. përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës; dhe
 - 3.3. përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Neni 5 Shërbimet e autorizuara

1. Shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas ofrohen në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare.
2. Ndihma juridike primare përfshin shërbimet vijuese:
 - 2.1. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
 - 2.2. përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;
 - 2.3. përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;
 - 2.4. mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;
 - 2.5. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse;
 - 2.6. informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit ashtu siç është paraparë me ligjet në fuqi.
3. Ndihma juridike sekondare mbulon shërbimet të cilat janë paraparë në nën-paragrafin 2.2. dhe 2.3. të paragrafit 2. të këtij neni.

KREU III SHFRYTËZUESIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Neni 6
Kriteret për dhënien e ndihmës juridike falas

1. Ndhurma juridike falas i ofrohet të gjithë personave të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara si në vijim:

- 1.1. kriteri kualifikues;
- 1.2. kriteri financiar; dhe
- 1.3. kriteri juridik.

Neni 7
Kriteri kualifikues

1. Sipas kriterit kualifikues, në ofrimin e ndihmës juridike falas kanë të drejtë:

- 1.1. shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët janë me vendbanim në territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.2. të gjithë personave me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës;
- 1.3. personat e tjerë të përcaktuar me ligj, apo me rregullat e të drejtës ndërkombëtare, të cilat e obligojnë Republikën e Kosovës;
- 1.4. personat të cilëve ju ofrohet ndihma juridike falas në bazë të reciprocitetit.

Neni 8
Kriteri financiar

1. Sipas kriterit financiar, ofrohet ndihma juridike:

- 1.1. primare; dhe
- 1.2. sekondare.

2. Ndhurma juridike primare u ofrohet të gjithë personave të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me personat që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale.

3. Ndhurma juridike sekondare u ofrohet të gjithë personave, të ardhurat e përgjithshme familjare të të cilëve janë më të vogla se sa të ardhurat mesatare familjare.

Neni 9
Kriteri juridik

1. Sipas kriterit juridik, ofrohet ndihma juridike duke vlerësuar bazueshmërinë e rastit si;

- 1.1. vlerën reale të kërkesës;
- 1.2. fuqia argumentuese e provave të prezantuara nga kërkuesi; dhe
- 1.3. mundësia e suksesit të kërkesës.

Neni 10
Ndhurma juridike falas e menjëhershme

Përrjashtimisht në rastin urgjent, ndihma juridike falas e menjëhershme ofrohet për të gjithë personat e arrestuar apo të ndaluar, në polici, pavarësisht përmbushjes së kritereve të cilat kërkohen me këtë ligj.

* * * * *

KREU V THEMELIMI, PËRBËRJA DHE ORGANIZIMI I AGJENCISË

Neni 19 Themelimi dhe Statusi i Agjencisë

1. Me këtë ligj themelohet Agjencia për ndihmë juridike falas (në tekstin e mëtejme Agjencia).
2. Agjencia është institucion i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj.
3. Agjencia është institucion i vetëm në territorin e Republikës së Kosovës përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas.
4. Organet e Agjencisë janë:
 - 4.1. drejtori Ekzekutiv;
 - 4.2. zyrat rajonale për ndihmë juridike falas (në tekstin e mëtejme Zyrat rajonale), të cilat përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit.
5. Selia e Agjencisë është në Prishtinë.

* * * * *

Neni 22 Zyrat rajonale për ndihmë juridike falas

1. Zyrat rajonale, mbulojnë dhënien e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Zyrat rajonale janë të obliguara që të ofrojnë ndihmë juridike falas në komunat të cilat i mbulon ajo zyrë rajonale, përmes zyrave mobile.
3. Kompetencat e Zyrës rajonale janë:
 - 3.1. pranimit i kërkesave për ndihmë juridike falas;
 - 3.2. angazhimi i ofruesve të ndihmës juridike falas;
 - 3.3. ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në pajtim me autorizimet e përcaktuara me këtë ligj;
 - 3.4. mbajtja e evidencës për kërkuesit, përfituesit dhe shërbimet juridike të ofruara;
 - 3.5. koordinimi me institucionet lokale për ofrimin e ndihmës juridike efikase;
 - 3.6. organizimi i fushatave për vetëdijesimin juridik.
4. Kompetencat e përcaktuara nga paragrafi 3. i këtij neni kryhen nga zyrtarët, kualifikimi i të cilëve përcaktohet me akt nënligjor.

5. Zyrat rajonale për punën e vet i përgjigjen Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 23

Personeli i Agjencisë

1. Personelin civil të Agjencisë e përbëjnë nëpunësit civil në pajtim me Ligjin për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës.
2. Personelin Civil të Agjencisë, e zgjedh dhe e shkarkon Drejtori i Agjencisë në pajtim me Ligjin për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës.

Neni 24

Parimet e Punës

Puna e Këshillit dhe Agjencisë, bazohet në parimet në të cilat bazohet puna e organeve të shërbimeve shtetërore si ligjshmërisë, transparencës, publicitetit, përgjegjësisë, efikasitetit, ekonomicitetit, dhe paanshmërisë profesionale.

Neni 25

Mosdiskriminimi dhe Konfidencialiteti

1. Përfituesi i ndihmës juridike falas ka të drejtë në ndihmën juridike të garantuar sipas këtij ligji, pa marrë parasysh origjinën e tij kombëtare, përkatësisht etninë, racën, ngjyrën, gjuhën, religjionin apo përkatësinë politike, identitetin gjinor, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar, shtetësinë apo vendbanimin.
2. Zyrtarët e ndihmës juridike dhe ofruesit e ndihmës juridike falas nuk shprehin në opinion , mendimet e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me rastin që është duke u trajtuar apo mbetet për t'u trajtuar para organit Gjyqësor apo Administrativ. Ata po ashtu përmbahen nga bërja e komenteve publike që mund të cenonte privatësinë e njërit apo tjetrit subjekt.

KREU VI

OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Neni 26

1. Ofruesit e ndihmës juridike falas janë:
 - 1.1. zyrat Rajonale;
 - 1.2. zyrat Mobile për ndihmë Juridike Falas;
 - 1.3. avokatët;
 - 1.4. organizatat jo-qeveritare në rastet kur hyjnë në partneritet me Agjencinë.

Neni 27

Zyrat Rajonale

Zyrat rajonale janë organe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 28

Zyrat mobile për ndihmë juridike falas

1. Zyrrat mobile për ndihmë juridike falas themelohen nga Këshilli me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv.
2. Zyrrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, veprojnë në Komunat në të cilat zyrrat e ndihmës juridike falas nuk janë themeluar.

Neni 29 Avokatët

1. Avokatët ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare.
2. Oda e Avokatëve të Kosovës përgatitë dhe dorëzon tek Agjencia listën e avokatëve të cilët shprehin gatishmërinë për ofrimin e ndihmës juridike falas.
3. Agjencia lidhë kontratë individuale me avokatët e gatshëm për ofrimin e ndihmës juridike falas.
4. Avokatët ofrojnë shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas sipas tarifës mbi kompensimet e përcaktuara nga Agjencia me akt nënligjor.
5. Zyrrat rajonale për rastet të cilat duhet ti përfaqësojnë pranë gjykatave dhe organeve tjera, përfituesit e ndihmës juridike falas, caktojnë avokatin nga lista e azhurnuar prej Odës së Avokatëve.
6. Procedura për angazhimin e avokatëve rregullohet me akt nënligjor.
7. Shërbimet e autorizuara të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në procedura gjyqësore ofrohen vetëm nga avokatët.

Neni 30 Organizatrat Jo-Qeveritare

OJQ-të ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në bazë të kritereve të përcaktuara nga Këshilli, me propozim të Drejtorit të Agjencisë.

KREU VII PROCEDURA PËR REALIZIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Neni 31 Inicimi i Procedurës

1. Procedura për realizimin e ndihmës juridike falas iniciohet me paraqitjen e kërkesës në zyrën më të afërt për ndihmë juridike falas.
2. Forma dhe përmbajtja e formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas rregullohet me akt nënligjor.
3. Paraqitësi i kërkesës ka për obligim që të ofrojë dokumentacionin e kërkuar për të provuar bazueshmërinë e kërkesës për ndihmë juridike falas.
4. Në mungesë të dokumentacionit përkatës për kategorinë e viktimave të dhunës, si bazueshmëri e kërkesës merret deklarata me shkrim e mbrojtësit të viktimave.
5. Zyrtarët e zyrës për ndihmë juridike falas obligohen që të këshillojnë paraqitësin e kërkesës për të parashtruar kërkesën e ndihmës juridike falas.
6. Formulari i kërkesës plotësohet nga zyrtarët e zyrës për ndihmë juridike falas.

7. Në rast se kërkuesi i ndihmës juridike paraqet deklarata jo të vërteta, mbi bazën e të cilave bazohet ndihma juridike falas, zyrtarët e ndihmës juridike falas kanë të drejtë që të hulumtojnë gjendjen financiare të përfituesit, duke kërkuar pranë çdo organi publik dhënien e informacioneve mbi gjendjen financiare të tij.

Neni 32 Vendimi

1. Vendimi lidhur me kërkesën për ndihmë juridike falas merret në zyrën për ndihmë juridike falas në të cilën është parashtruar kërkesa.
2. Në rastin e marrjes së vendimit për ndihmë juridike falas, zyrtarët e ndihmës juridike falas vlerësojnë kriteret e parapara me këtë ligj.
3. Zyra për ndihmë juridike falas merr vendim për lejimin ose refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike falas.
4. Vendimi për lejimin ose refuzimin e kërkesës merret brenda pesë (5) ditëve pune nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar.
5. Vendimi për lejimin e ndihmës juridike falas përcakton shërbimet e autorizuara për ndihmë juridike falas të cilët ofrohen në lidhje me kërkesën e aprovuar.
6. Shërbimet e autorizuara të përfaqësimit apo të mbrojtjes para gjykatës, referohen te avokati.
7. Përfituesi i ndihmës juridike falas obligohet që menjëherë të njoftojë zyrën për ndihmë juridike falas për ndryshimin e rrethanave të përcaktuara me këtë ligj, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit për lejimin e ndihmës juridike falas.
8. Nëse konstatohet që përfituesi i ndihmës juridike falas në mënyrë të kundërligjshme ka përfituar ose vazhdon të përfitojë nga ndihma juridike falas, zyra për ndihmë juridike falas me vendim ndërpre në menjëherë shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas dhe obligon përfituesin që të kompensojë të gjitha shpenzimet e krijuara nga ofrimi i ndihmës juridike falas, ku të gjitha këto të hyra kalojnë në Buxhetin e Kosovës.

Neni 33 Aplikimi subsidiar

Në qoftë se me këtë ligj nuk është rregulluar në tërësi procedura e vendosjes sipas kërkesës për lejimin e ndihmës juridike falas, aplikohen dispozitat e Ligjit të procedurës administrative.

Neni 34 Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike falas

1. Kundër vendimit me të cilën refuzohet kërkesa për lejimin e ndihmës juridike falas, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë ankesë, komisionit për ankesa (më tej Komisioni).
2. Ankesa i paraqitet Komisionit në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e pranimi të vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike falas.
3. Komisioni vendos në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të ankesës për ndihmë juridike falas.
4. Vendimi i Komisionit është përfundimtar.

5. Komisioni duke vendosur për ankesën merr vendim si në vijim:

5.1. hedhë ankesën si të palejuar;

5.2. aprovon ankesën si të bazuar, prish vendimin me të cilin është refuzuar ndihma juridike falas dhe lejon ndihmën juridike falas, dhe

5.3. refuzon ankesën si të pabazuar.

Neni 35

Ankesa kundër ofruesit të ndihmës juridike falas

1. Përfituesi i ndihmës juridike falas ka të drejtë ankese kundër shërbimeve juridike joprofesionale dhe jo etike të ofruara nga ofruesit e ndihmës juridike falas.

2. Procedura ankimore sipas këtij neni zhvillohet pranë Komisionit për ankesa të Këshillit ashtu siç është paraparë në nenin 13 paragrafi 3. i këtij ligji.

3. Komisioni vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të ankesës në zyrën e pranimit të ankesave të ndihmës juridike falas.

4. Komisioni pas shqyrtimit të ankesës vendos si vijon:

4.1. nëse ankesa e aprovuar është drejtuar kundër avokatit, Këshilli e njofton Odën e Avokatëve të Kosovës për ndërmarrjen e masave disiplinore në përputhje me rregulloret e brendshme të Odës së Avokateve;

4.2. nëse ankesa e aprovuar është drejtuar kundër zyrtarit të zyrës për ndihmë juridike falas, Këshilli autorizon veprimet disiplinore të përcaktuara me akt nënligjor të Agjencisë;

4.3. nëse ankesa e aprovuar është drejtuar kundër organizatës jo-qeveritare, Këshilli autorizon masat e përcaktuara me kontratën për shërbime me organizatën përkatëse si dhe të njoftojë Ministrinë e Administratës Publike.

KREU VIII

FINANCIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 36

Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës

1. Agjencia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

2. Agjencia menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 37

Donacionet

Agjencia mund të pranojë donacione shtesë nga donacionet vendore dhe ndërkombëtare. Fondet e pranuar nga donacionet i raportohen Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore, në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 39
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut nr.2006/36.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-017

2 shkurt 2012

Shpallur me dekretin Nr. DL-005-2012, datë 14.02.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

LIGJI Nr. 04/L-57
PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATAT JOQEVERITARE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimet dhe fushëveprimi i këtij ligji

1. Ky ligj rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe çregjistrimin e personave juridik të organizuar si organizata joqeveritare në Kosovë.
2. Ky ligj nuk vlen për parti politike, sindikata dhe organizata sindikale, e as për qendra të besimit fetar, apo faltore dhe fusha tjera që rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Organizatë Joqeveritare (OJQ)** - çdo shoqatë dhe fondacion të vendit, siç përkufizohet me nenin 5 të këtij ligji, si dhe çdo organizatë të huaj dhe ndërkombëtare, siç përkufizohet me nenin 7 të këtij ligji.

1.2. **Ministria** - Ministria e Administratës Publike.

1.3. **Ministër** - Ministri i Ministrisë së Administratës Publike.

1.4. **Organ kompetent** - organi kompetent për regjistrim dhe çregjistrim.

1.5. **Person** - çdo person juridik apo fizik të vendit, ose të huaj.

1.6. **Përfaqësues i Autorizuar** - individi që banon në Kosovë, që ka moshë madhore dhe zotësi të veprimit, që është i autorizuar për ta përfaqësuar një OJQ dhe për të pranuar njoftime dhe hetime zyrtare.

1.7. **Anëtar i familjes** – Bashkëshorti/ja, fëmijët, prindërit, gjyshërit, nipat, mbesat, vëllezërit dhe motrat, fëmijët e tyre dhe bashkëshortët si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të bashkëshortit/es (vjuhërrinë, kunetët dhe fëmijët e tyre);

1.8. **Situatat e jashtëzakonshme** duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të OJQ-së dhe në të vërtetë pamundësojnë OJQ-në nga kompletimi dhe dorëzimi i raportit siç, parashihet me nenin 18 të këtij ligji.

Neni 3
Liria e Asociimit

1. Çdo person në Kosovë gëzon të drejtën e plotë për t'u asociuar dhe themeluar OJQ-në.
2. Asnjë person nuk obligohet që të asociohet kundër vullnetit të tij dhe asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociuar apo për të mos u asociuar.

Neni 4
Mos shpërndarja e të ardhurave

1. OJQ-ja nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person.
2. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën.
3. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je nuk mund të përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donatorë të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën.

KREU II
THEMELIMI I OJQ-SË

Neni 5
Nocioni i OJQ-së në Kosovë

1. OJQ-ja vendore është shoqatë ose fondacion e themeluar në Kosovë për realizimin e qëllimit bazuar në ligj, për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.
2. Shoqata është një organizatë e anëtarësisë. Shoqatën mund ta themelojnë të paktën tre (3) ose më shumë persona, ku të paktën njëri prej tyre ka vendbanimin ose zyrën në Kosovë.
3. Fondacioni është organizatë pa anëtarësi, i krijuar për menaxhimin e pronave dhe pasurive. Një fondacion mund të krijohet nga një ose më shumë persona, në rast se të paktën njëri prej tyre ka vendbanimin ose zyrën në Kosovë.

Neni 6
Themelimi i Shoqatave dhe Fondacioneve në Kosovë

1. Shoqata ose fondacioni themelohet nëpërmjet aktit themelues që përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1. emrin zyrtar, shkurtesën zyrtare si dhe simbolin zyrtar të organizatës;
 - 1.2. formën organizative (shoqatë, fondacion);
 - 1.3. adresën e organizatës;
 - 1.4. qëllimet e organizatës dhe aktivitetet;
 - 1.5. emrat dhe adresat e themeluesve;
 - 1.6. emrin, adresën dhe informata tjera kontaktimi të përfaqësuesit të autorizuar, dhe
 - 1.7. afatin kohor për të cilin organizata themelohet, nëse ka një të tillë.

2. Fondacioni mund të themelohet edhe me testament, apo me lënie të trashëgimisë, në qoftë se ai përmban informatat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Shoqata ose fondacioni ka statutin, i cili duhet t'i përmbajë të dhënat në vijim:

3.1. emrin e organizatës, selinë dhe simbolin e saj;

3.2. qëllimet e organizatës;

3.3. emrin e organit më të lartë udhëheqës;

3.4. nëse OJQ-ja është shoqatë, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kushtet për anëtarësim si dhe nëse organizata vendos të ketë një bord, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të bordit dhe ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësiive ndërmjet Kuvendit të Përgjithshëm të anëtarëve dhe Bordit;

3.5. nëse OJQ-ja është fondacion, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të Bordit;

3.6. kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, nëse ka;

3.7. mënyrën e marrjes së vendimeve;

3.8. rregullat dhe procedurat për:

3.8.1. ndryshimin e aktit themelues dhe statutit;

3.8.2. bashkimin, ndarjen ose shuarjen e organizatës dhe

3.8.3. shpërndarjen e mjeteve që mbesin pas shuarjes.

4. Statuti mund të përmbajë çdo rregull, dispozitë apo procedure tjetër, që nuk është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë ligj.

5. Rregullat dhe procedurat për udhëheqje të brendshme që i përmban statuti i OJQ-së, duhet të jenë në pajtim me parimet demokratike.

6. Shoqata apo fondacioni ka vetëm ato kompetenca dhe ka të drejtë angazhimi vetëm në ato aktivitete dhe qëllime, që janë në përputhje me aktin themelues dhe statutin dhe që lejohen me ligj.

Neni 7

OJQ-të e vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare

OJQ-ja e vendit të huaj dhe ajo ndërkombëtare janë persona juridik të themeluar jashtë Kosovës, sipas legjislacionit që përmbush në thelb kushtet e parapara me nenin 4 të këtij ligji.

Neni 8

Asociimi i Personave Juridik

Personat Juridik, duke përfshirë edhe OJQ-të, mund të themelojnë shoqata, fondacione për të përparuar qëllimin e tyre të ligjshëm, qoftë për përfitim publik apo të ndërsjellë, në përputhje me nenin 5 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 9

Regjistrimi

1. Çdo person, pavarësisht nga përkatësia, në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ka të drejtë të regjistrojë OJQ, në pajtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me këtë ligj. Asnjë person nuk ka nevojë të regjistrojë OJQ-në për të ushtruar të drejtën e lirisë në asociim.

2. OJQ-ja regjistrohet pranë departamentit përkatës në Ministrinë e Administratës Publike.

3. OJQ-ja, kërkesës për regjistrim duhet t'ia bashkëngjës një kërkesë-formular, aktin e themelimit dhe statutin e saj.

4. OJQ-ja cakton me shkrim Përfaqësuesin e Autorizuar. Të gjitha fletëkërkesat për regjistrim duhet t'i nënshkruajë Përfaqësuesi i Autorizuar i OJQ-së. Aktin e themelimit e nënshkruajnë të tre themeluesit.

5. OJQ-ja e vendit të huaj dhe ajo ndërkombëtare regjistrohen duke i dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

5.1 një kërkesë-formular;

5.2. dëshminë që është person juridik në një vend tjetër;

5.3. adresën e organizatës në Kosovë; dhe

5.4. një deklaratë me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i OJQ-së, me autorizim për të dhënë një deklaratë të këtillë, dhe që tregon:

5.4.1. qëllimet e OJQ-së;

5.4.2. një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve që OJQ-ja planifikon t'i kryejë në Kosovë, dhe

5.4.3. emrin, adresën dhe kontakt-informata tjera të përfaqësuesit të autorizuar.

6. Fletëkërkesat për regjistrimin e OJQ-ve i dorëzohen dhe pranohen nga organi kompetent. Vendimet në lidhje me regjistrim si dhe numrat e regjistrimit i cakton organi kompetent.

7. Dokumentet që i dorëzon OJQ-ja në mbështetje të kërkesës për regjistrim duhet të jenë në gjuhët përkatëse në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

8. Pavarësisht nga paragrafi 7. i këtij neni, dokumentet që i dorëzon OJQ-ja e huaj dhe ajo ndërkombëtare për të dëshmuar se është person juridik në një shtet tjetër, duhet të jenë në gjuhën origjinale të atij vendi, së bashku me përkthimin e dokumentacionit në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Përkthimi duhet të jetë nga përkthyesi i autorizuar – licencuar. Çdo dallim përmbajtësor apo mashtrues ndërmjet gjuhës së origjinalit dhe dokumentit të përkthyer është arsye për tërheqjen e regjistrimit të organizatës.

9. Organi kompetent i lëshon OJQ-së certifikatën për regjistrim, ose një vendim me shkrim me të cilin refuzohet regjistrimi brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës për regjistrim, përpos, nëse organi kompetent bën kërkesë me shkrim gjatë rrjedhës së afatit, për informata të mëtutjeshme, ose për qartësim. Nëse regjistrimi refuzohet, organi kompetent përfshinë në vendimin për refuzim një arsyetim të bazave ligjore në bazë të të cilave regjistrimi refuzohet dhe të drejtën e ankesës.

10. Nëse organi kompetent bën kërkesë me shkrim për informacione plotësuese, ose për qartësim lidhur me kërkesën për regjistrim, afati gjashtëdhjetë (60) ditor brenda të cilit organi kompetent duhet të lëshojë Certifikatën për regjistrim, ose vendimin me shkrim me të cilin refuzohet regjistrimi ndalet së rrjedhuri nga data e kërkesës me shkrim. Me pranimin e informacioneve plotësuese, ose të qartësimeve të kërkuara,

organi kompetent lëshon Certifikatën për Regjistrim, ose vendimin për refuzim të regjistrimit brenda afatit prej:

10.1. numrit të ditëve të mbetura nga afati gjashtëdhjetë (60) ditësh për lëshimin e vendimit;

10.2. katërbëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i informatave plotësuese, ose qartësimit, cilido nga këto afate të jetë më i gjatë.

11. OJQ-ja informon organin kompetent brenda tridhjetë (30) ditësh lidhur me çdo ndryshim që pësojnë informatat që kërkohen sipas paragrafëve 1. dhe 3. të nenit 6 dhe paragrafit 5. të këtij neni. Ndryshimet në regjistrim u nënshtrohen procedurave, standardeve dhe afateve të njëjta kohore, sikur ato që janë zbatuar me rastin e regjistrimit fillestar. Ndryshimet që i pranon organi kompetent mbahen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion të publikut sipas nenit 12 të këtij ligji.

Neni 10 **Refuzimi i regjistrimit**

1. Organi kompetent refuzon një kërkesë në qoftë së:

1.1. dokumentet e regjistrimit janë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji;

1.2. në qoftë se statuti i OJQ-së shkel dispozitat e ligjit në fuqi;

1.3. organizata që kërkon regjistrimin ka të njëjtin emër apo shkurtesë ose një emër shumë të ngjashëm me OJQ-në e regjistruar ose të themeluar më parë, saqë mund të shkaktonte konfuzion;

1.4. nëse me statut dhe me program të OJQ-së promovohen pabarazia në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Neni 11 **Statusi ligjor**

1. OJQ-ja vendore ka statusin e personit juridik me regjistrim në përputhje me këtë ligj.

2. Me regjistrim, OJQ-të e vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare janë të autorizuara të veprojnë si persona juridik në Kosovë.

3. OJQ-të vendore, të vendit të huaj, dhe ato ndërkombëtare u nënshtrohen të gjitha ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Çdo njoftim, letër, ftesë, apo akt tjetër ligjor konsiderohet se i është dorëzuar në mënyrë valide OJQ-së, nëse i dorëzohet personalisht, ose me postë përfaqësuesit të autorizuar, ose në adresën e theksuar sipas nën-paragrafit 1.3. paragrafi 1. i nenit 6 dhe nën-paragrafit 5.3. paragrafi 5. i nenit 9 të këtij ligji.

5. Zyrtarët, drejtorët dhe punëtorët e OJQ-së së regjistruar nuk janë personalisht përgjegjës për borxhet apo obligimet e OJQ-së, por janë personalisht përgjegjës për shkeljet që shkaktohen me dashje, me pakujdesi ose me moskryerje të detyrës.

Neni 12 **Regjistri i OJQ-ve**

1. Organi kompetent mbanë një regjistër të OJQ-ve.

2. Regjistri përmban: emrin, adresën, formën e organizimit dhe qëllimet, themeluesit e çdo OJQ-je, emrin dhe informacionin tjetër të kontaktit të përfaqësuesit të autorizuar si dhe të dhënën nëse OJQ-ja ka status të përfituesit publik.
3. Organi kompetent është përgjegjës për përditësimin e të dhënave të regjistrit publik.
4. OJQ-të vendore, të vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare janë të obliguara që një herë në vit të dorëzojnë në organin kompetent një deklaratë, e cila konfirmon se informatat që kërkohen sipas paragrafit 2. të këtij neni janë ende të vlefshme, ose kanë ndryshuar.
5. Dështimi për të dorëzuar këtë deklaratë për dy (2) vite me radhë obligon organin kompetent që të ndërmarrë procedurat e rregjistrimit të OJQ-së. Organi kompetent obligohet që gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të afatit tre (3) vjeçar për të dorëzuar këtë deklaratë, të njoftojë me shkrim OJQ-në për pasojat e dështimit për të plotësuar këtë obligim.
6. Regjistri i vihet në dispozicion publikut në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BRENDSHËM I OJQ-SË

Neni 13 Udhëheqja e brendshme e Shoqatave dhe Fondacioneve

1. Organi më i lartë drejtues i shoqatës është Kuvendi, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës. Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë pjesëmarrjeje në takimet e Kuvendit.
2. Organi më i lartë drejtues i një fondacioni është Bordi i Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga të paktën tre anëtarë.
3. Organi më i lartë drejtues ka përgjegjësi të plota për çështje të politikës dhe financave të organizatës dhe takohet të paktën një herë në vit, në mbledhjen ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
4. Organi më i lartë drejtues i OJQ-së, nuk delegon:
 - 4.1. detyrat sipas paragrafit 3. të këtij neni;
 - 4.2. zgjedhjet e zyrtarëve në pozita udhëheqëse të OJQ-së;
 - 4.3. ndryshimet në aktin themelues apo Statut dhe
 - 4.4. vendimet për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e OJQ-së.

Neni 14 Konflikti i interesave dhe detyrimi në lojalitet

1. Asnjë anëtar i organit drejtues nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i organit drejtues konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.
2. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-

në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.

3. Zyrtarët dhe anëtarët e bordit të një OJQ-je e kanë detyrë që të tregojnë lojalitet ndaj OJQ-së, të mbrojnë fshehtësinë e informatave jopublike të OJQ-së dhe interesat e OJQ-së, si dhe të ushtrjnë përgjegjësitë e OJQ-së me mirëbesim dhe kujdes.

Neni 15

Ndalimi i mbledhjes së fondeve, fushatave dhe mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike

OJQ-të nuk mund të angazhohen në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike, dhe as nuk mund të propozojnë, regjistrojnë ose në ndonjë mënyrë të mbështesin kandidatët për poste publike.

Neni 16

Pasuria dhe mjetet

1. Të ardhurat e OJQ-së përfshijnë: donacionet në të holla, letrat me vlerë, kontributet në mall, trashëgimitë, anëtarësinë, dhuratat, grantet, pasurinë e tundshme dhe e patundshme si dhe të ardhurat e fituara përmes çfarëdo aktiviteteve të ligjshme të OJQ-së me pasurinë dhe mjetet e saja.

2. OJQ-ja mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me nenin 4, dhe me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në statutin e OJQ-së.

3. OJQ-ja mund të ketë dhe të menaxhojë pronë dhe pasuri për të realizuar qëllimet e veta jofitimprurëse.

4. Me ligj ndalohet financimi i organizatave, veprimtaria e të cilave nuk përkon me rendin juridik në Republikën e Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare.

KREU IV

STATUSI PËR PËRFITIM PUBLIK I OJQ-së, RAPORTIMI FINANCIAR DHE PEZULLIMI I TIJ

Neni 17

Statusi për Përfitim Publik

1. OJQ-ja e regjistruar sipas këtij ligji mund të paraqesë kërkesë për status për përfitim publik, nëse OJQ-ja është e organizuar dhe vepron për të ndërmarrë një apo më shumë aktivitete si aktivitete parësore si: ndihmë dhe përkrahje humanitare, përkrahje personave me aftësi të kufizuara, aktivitete bamirëse, arsim, shëndetësi, kulturë, rini, sport, ruajtje dhe përparim të mjedisit, rindërtim dhe zhvillim ekonomik, mbrojtje dhe përparim të të drejtave të njeriut, mbështetje të praktikave demokratike dhe shoqërisë civile, apo çfarëdo veprimtarie tjetër që është në funksion të së mirës së publikut.

2. Veprimtaria e OJQ-së arsimore dhe shëndetësore përfshinë veprimtari për të mirën e publikut, vetëm në rast se përfitimet të konsiderueshme sigurohen falas ose më lirë se vlera reale e tregut për grupe ose individë në kushte të pavolitshme. Veprimtaria e OJQ-së për zhvillim ekonomik përfshinë veprimtari për të mirën e publikut, vetëm nëse ndërmerret, në radhë të parë për të mirën e individëve dhe grupeve në kushte të pavolitshme

3. OJQ-ja mund të paraqesë kërkesë për status për përfitim publik me rastin e regjistrimit fillestar të OJQ-së ose më vonë. Organi kompetent i lejon OJQ-së statusin për përfitim publik, nëse dokumentet e regjistrimit dëshmojnë se qëllimet dhe veprimtaria e OJQ-së i plotëson kërkesat e paragrafit 1. Dhe paragrafit 2. të këtij neni.

4. OJQ-të me status të përfituesit publik gëzojnë të drejtën për lirim nga tatimi dhe lehtësi tatimore dhe fiskale sipas legjislacionit në fuqi me përjashtim të atyre që në esencë janë detyrime për shërbimet publike komunale.

5. Për zbatimin e këtij neni, Ministria propozon aktin nënligjor, i cili aprovohet nga Qeveria.

Neni 18

Obligimet për raportim financiar dhe të aktivitetit për OJQ-të me status për përfitim publik

1. OJQ-ja, të cilës i është lejuar statusi për përfitim publik, duhet t'i paraqesë organit kompetent çdo vit një raport vjetor për veprimet dhe aktivitetet e saj në Kosovë. Raportet duhet të dorëzohen deri në fund të muajit mars të secilit vit për vitin raportues që përfundon me 31 dhjetor të vitit paraprak.

2. Raporti vjetor duhet nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së. Përfaqësuesi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave që i përmban raporti.

3. Raporti vjetor domosdo përbëhet nga tri pjesët në vijim:

3.1. pjesa për menaxhment dhe administratë;

3.2. raporti për aktivitete dhe të arritura;

3.3. raporti financiar.

4. Pjesa për menaxhment dhe Administratë duhet të përmbajë:

4.1. emrin, shkurtësën (emërtimin me iniciale), adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike (e-mail) të OJQ-së;

4.2. emrin e zyrtarit kryesor ekzekutiv (p.sh. përgjegjës apo drejtor ekzekutiv);

4.3. emrat e anëtarëve të organit udhëheqës, si dhe emrat e titujt e të gjithë zyrtarëve në pozita udhëheqëse.

5. Raporti i aktiviteteve dhe të arriturave duhet të përmbajë:

5.1. një deklaratë për misionin dhe qëllimin mirëbërës shoqëror të OJQ-së;

5.2. identifikimin e programeve kryesore dhe aktiviteteve që kanë për qëllim realizimin e atyre programeve. Deklarata duhet të jetë e mjaftueshme për të dëshmuar mënyrën si organizata i realizon qëllimet e veta mirëbërëse shoqërore përmes aktiviteteve të veta;

5.3. një deklaratë për arritjet kryesore të programeve;

5.4. nëse OJQ-ja merr përsipër aktivitete të tjera, përveç atyre që shkojnë në dobi të shoqërisë, siç është përcaktuar me paragrafin 1. të nenit 17 të këtij ligji, një deklaratë, e cila i përshkruan ato aktivitete;

5.5. një deklaratë se OJQ-ja nuk ka mbledhur fonde dhe nuk ka bërë fushatë për përkrahjen e partive politike apo për emërimin dhe zgjedhjen e kandidatëve në detyra të ndryshme publike, apo për regjistrimin dhe përkrahjen e kandidatëve të emëruar apo të zgjedhur në funksione publike gjatë periudhës për të cilën raportohet;

5.6. OJQ-ja që është e angazhuar në aktivitete mirëbërëse shoqërore, në lëmin e arsimit apo të shëndetësisë, dorëzon edhe një deklaratë për:

5.6.1. llojin e grupeve ose individëve në kushte të pavolitshme, të cilët i shërben;

5.6.2. llojin e dobive që organizata u ofron grupeve ose individëve në kushte të pavolitshme;

5.6.3. një deklaratë se ato dobi ofrohen falas, apo, së paku më lirë se vlera e tyre në treg;

5.7. OJQ-ja, e cila angazhohet në aktivitete mirëbërëse shoqërore në sferën e zhvillimit ekonomik, dorëzon edhe një deklaratë për llojin e individëve dhe grupeve në kushte të pavolitshme që u shërben.

6. Raportet financiare përgatiten në formularë, të cilët i siguron organi kompetent, dhe të cilët përmbajnë, së paku:

6.1. një fletë-bilanc, ku shihen pasuria dhe përgjegjësitë financiare të organizatës;

6.2. raportin financiar mbi burimin e të hyrave, ku të hyrat dhe të dalat e OJQ-së paraqiten ndarazi për pjesën për menaxhment dhe administratë, dhe atë programore.

7. Organi kompetent me kërkesën e OJQ-së mund ta caktojë një afat shtesë për dorëzimin e raportit vjetor, nëse këtë e kanë imponuar situatat e jashtëzakonshme, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e kalimit të këtyre rrethanave.

8. Deklaratat financiare përgatitën deri më ditën e fundit të muajit mars për periudhën prej një viti, që përfundon me datën 31 dhjetor të vitit paraprak.

9. Raportet financiare të përgatitura dhe të dorëzuara nga OJQ-të vendore, me të hyra vjetore ose me shpenzime mbi njëqindmijë (100.000) euro, nga OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare me të hyra ose shpenzime vjetore për veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre brenda Republikës së Kosovës mbi njëqindmijë (100.000) euro, duhet të prezantojnë pasqyrën financiare të vitit fiskal si në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe raportin e auditimit për vitin paraprak, të nënshkruar nga auditori i licencuar në Republikën e Kosovës, në mënyrë që aspektet materiale dhe pozita financiare e organizatës për atë periudhë raportimi të jetë e drejtë.

10. Raporti vjetor duhet të përfshijë:

10.1. një deklaratë, e cila i përfshinë të gjithë veprimtarinë si dhe pagesën e pagave të punonjësve të OJQ-së, duke përfshirë përshkrimin e punës së të angazhuarve dhe marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet OJQ-së dhe palës tjetër në kryerjen e asaj pune; ose

10.2. një vërtetim se OJQ-ja nuk ka zhvilluar veprimet e parapara sipas nën-paragrafit 10.1. të këtij paragrafi, gjatë periudhës për të cilën raportohet.

11. Raportet e dorëzuara në pajtim me këtë nen, vihen në dispozicion publikut. OJQ-ja ka mundësi t'i veçojë informatat apo pasurinë, të cilën ajo e konsideron konfidenciale në raportin e saj dhe të kërkojë që organi kompetent t'ia fshijë ato të dhëna para se raporti të bëhet publik. Informatat apo pasuria, e cila mund të konsiderohet konfidenciale për qëllime të këtij neni përfshinë informatat personale ose financiare të punonjësve të organizatës. OJQ-ja duhet të paraqesë një kërkesë për mos publikim të informatave të këtilla atëherë kur ia dorëzon raportin organit kompetent, si dhe duhet të paraqesë arsyet për trajtim konfidencial të informacioneve. Përveç kësaj, OJQ-ja duhet të paraqesë informatën konfidenciale në mënyrë të ndarë nga pjesa tjetër e raportit, dhe domosdo duhet që në mënyrë të qartë të theksojë se raporti përfshinë kërkesën për mospublikim të informacionit. Organi kompetent i përgjigjet me shkrim kërkesës për mospublikim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas dorëzimit të kërkesës.

12. Publikimi i paautorizuar dhe kundër ligjor, nga organi kompetent, i cili disponon të dhënat përkatëse ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

13. Organi kompetent, pas plotësimit me sukses të obligimit për raportim të OJQ-së me status për përfitim publik, siç parashihet me këtë nen, OJQ-së i lëshon certifikatën e re të statusit për përfitim publik në afat një (1) vjeçar.

Neni 19

Pezullimi, revokimi dhe tërheqja vullnetare e Statusit për Përfitim Publik

1. Organi kompetent pezullon statusin e përfituesit publik të një OJQ-je, e cila nuk paraqet raport të plotë vjetor, ashtu siç kërkohet me nenin 18. OJQ-ja që dështon të paraqesë raportin e kërkuar me këtë ligj brenda afatit të paraparë me paragrafin 1. të nenit 18 të këtij ligji, ose paraqet raport jo të plotë, njoftohet me shkrim për dështimin nga ana e organit kompetent. Njoftimi me shkrim udhëzon OJQ-në që të paraqesë raportin që mungon, ose atë jo të plotë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit, si dhe e informon OJQ-në, që dështimi në përmbushjen e kësaj kërkesë ka për pasojë pezullimin e statusit të përfituesit publik dhe të gjitha përfitimeve që rrjedhin nga ai.

2. OJQ-ja që dështon të paraqesë raport të plotë, siç kërkohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit me shkrim, në bazë të paragrafit 1. të këtij neni, njoftohet me shkrim nga organi kompetent se statusi i saj i përfituesit publik, së bashku me të gjitha përfitimet që rrjedhin nga ai status janë pezulluar, dhe se, nëse OJQ-ja dështon të sigurojë raportin brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas njoftimit, organi kompetent nxjerr vendim për revokimin e statusit për përfitim publik. OJQ-ja është e detyruar që në mënyrë retroaktive t'i kryejë të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësitë tatimore dhe doganore të Statusit për Përfitim Publik, për periudhën për të cilën ka dështuar të raportojë në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pranimit të vendimit.

3. Organi kompetent pezullon statusin për përfitim publik të një OJQ-je, nëse pas shqyrtimit të raportit vjetor të dorëzuar nga OJQ-ja, verifikon se OJQ-ja nuk plotëson më tutje kërkesat për status për përfitim publik të parapara me nenin 17 të Ligjit. Pas një verifikimi të këtillë, organi kompetent e njofton me shkrim OJQ-në për arsyet e pezullimit të statusit për përfitim publik dhe përfitimeve që rrjedhin nga ai status. OJQ-ja ka mundësi që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, që nga dita e pranimit të njoftimit, t'i sigurojë organit kompetent informata me shkrim, që e mbështesin të drejtën e saj për status për përfitim publik. Nëse OJQ-ja nuk siguron informata të bazuara brenda afatit të paraparë, organi kompetent nxjerr vendim për revokimin e statusit për përfitim publik. OJQ-ja është e detyruar që në mënyrë retroaktive t'i kryejë të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësitë tatimore dhe doganore të Statusit për Përfitim Publik, për periudhën për të cilën janë konstatuar shkeljet në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pranimit të vendimit. Organi kompetent i njofton me shkrim organet tatimore dhe doganore për vendimin e marrë.

4. OJQ-ja së cilës i është revokuar statusi për përfitim publik, ka të drejtë të kërkojë përsëri të njëjtin pas kalimit të afatit trevjeçar nga data e revokimit.

5. OJQ-ja me status për përfitim publik mund të bëjë kërkesë për tërheqjen nga ky status pas përfundimit të vitit financiar për të cilin i ka gëzuar lehtësirat që i ka garantuar statusi për përfitim publik. Kërkesa për tërheqje nga ky status për vitin e ardhshëm duhet të bëhet të paktën dyzet e pesë (45) ditë para përfundimit të vitit kalendarik gjatë të cilit OJQ-ja është duke e gëzuar statusin për përfitim publik. Organi kompetent është i obliguar që për tërheqjen nga statusi për përfitim publik të vendosë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit të kërkesës, duke i njoftuar për vendimin të gjitha organet tatimore dhe doganore. OJQ-ja që tërheq vullnetarisht statusin për përfitim publik, ka të drejtë që të kërkojë përsëri këtë status, sipas procedurave të parapara me ligj.

KREU V

SHUARJA DHE ÇREGJISTRIMI I OJQ-së

Neni 20
Shuarja e OJQ-së

1. OJQ - ja shuhet:

- 1.1. me vendim vullnetar për shuarjen e OJQ-së të marrë nga organi më i lartë udhëheqës në pajtim me statutin e saj;
- 1.2. kur OJQ-ja bëhet josolvente sipas ligjit në fuqi;
- 1.3. me kalimin e afatit për të cilin është themeluar, nëse një afat i tillë është i përcaktuar në aktin themelues;
- 1.4. në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor.

Neni 21
Çregjistrimi i OJQ-së

1. Organi kompetent çregjistron OJQ-në:

- 1.1. në njërën nga rastet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 20 të këtij ligji;
- 1.2. nëse OJQ-ja për tri (3) vite me radhë dështon të paraqesë deklaratën vjetore të paraparë në paragrafin 5. të nenit 12 të këtij ligji.

2. Organi kompetent i jep OJQ-së njoftim me shkrim për arsyet e çregjistrimit si dhe mundësinë që të përgjigjet para se të merret vendimi për çregjistrimin e OJQ-së.

3. Në rast të shuarjes ose çregjistrimit të OJQ-së, e cila ka shfrytëzuar lehtësi tatimore ose fiskale, donacione publike, ose grante nga qeveria, e gjithë pasuria e mbetur pas shlyerjes së borxheve të OJQ-së i jepet OJQ-së tjetër me qëllime të njëjta apo të ngjashme. Kjo OJQ identifikohet në bazë të statutit të OJQ-së, ose me propozim të organit më të lartë udhëheqës të OJQ-së. Ministria themelon Komisionin për Shpërndarjen e Pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar dhe të çregjistruar, me përfaqësues edhe të OJQ-ve, duke u bazuar në aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

4. Në të gjitha rastet tjera, çdo pasuri e mbetur pas pagesës së borxheve shpërndahet në bazë të statutit apo të vendimit të organit më të lartë udhëheqës, dhe në të gjitha rastet në përputhshmëri me nenin 4 të këtij ligji.

5. OJQ-ja me status të përfituesit publik që është shpërbërë, është çregjistruar, ose pushon së vepruari në Kosovë brenda afatit të raportimit paraqet raport për atë periudhë, në përputhshmëri me nenin 4 dhe 18 të këtij ligji. Në raportin e saj, OJQ-ja thekson datën e shpërndarjes, shuarjes, çregjistrimit, dispozitat për përfundimin e punës së saj, si dhe shumën e mjeteve të mbetura pas përmbushjes së obligimeve, mënyrën e planifikuar të disponimit me mjete, si dhe mënyrën në të cilën është marrë vendimi për disponim me mjete (konkretisht, me dispozitë të përcaktuar në Statutin e organizatës, me vendim të organit më të lartë udhëheqës, apo me vendim të organit kompetent).

6. Përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së ka përgjegjësi juridike para organit kompetent për regjistrim dhe organeve tjera.

7. Pas shterjes së të gjitha të drejtave për ankesë, dhe në bazë të vendimit për çregjistrim, organi kompetent e heq OJQ-në nga regjistri i OJQ-ve.

Neni 22
Institucionet e Republikës së Kosovës dhe OJQ-të

Institucionet e Republikës së Kosovës përkrahin, por nuk ndërhyjnë në veprimtaritë e OJQ-ve, dhe bëjnë publike të gjitha format e bashkëpunimit dhe përkrahjes. Dhënia e çfarëdo fondi publik për OJQ nga institucionet e Republikës së Kosovës bëhet në bazë të kriterëve të paracaktuara dhe publike.

Neni 23
Ankesat

1. Nëse OJQ-ja është e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së parë ka të drejtë t'i drejtohet me ankesë organit të shkallës së dytë.
2. Ankesa i drejtohet organit të shkallës së dytë përmes organit të shkallës së parë.
3. Ministria përkatëse themelon organin e shkallës së dytë, i cili duhet të jetë i pavarur.
4. Mënyra e krijimit dhe funksionimit të këtij organi rregullohet me rregullore të veçantë që e nxjerr Ministria përkatëse.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24
Aktet nënligjore

1. Ministria propozon aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit.
2. Qeveria nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji më së largu nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 25
Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 03/ L-134 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare dhe çdo dispozitë të legjislacionit që bie në kundërshtim me këtë ligj që ka të bëjë me lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Neni 26
OJQ-të e regjistruara sipas Ligjit 03/L134 për Lirinë e Asociimit në OJQ në Kosovë

Çdo OJQ e regjistruar sipas Ligjit 03/L134 për Lirinë e Asociimit në OJQ në Kosovë konsiderohet e regjistruar në Kosovë sipas këtij ligji.

Neni 27
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Shpallur me dekretin Nr.DL-034-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**

UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK - NR. 02/2014 PËR REGJISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim të nenit 24 (2), të Ligjit Nr.04/L- 057 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (GZ, Nr.14, 09.09.2011), në pajtim me nenin 4.2 (2.2.) të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, Nr.15, 12.09.2011),

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK - NR. 02/2014 PËR REGJISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen rregullat dhe procedurat e regjistrimit, përditësimit të të dhënave në Regjistrin Publik, shuarjes dhe çregjistrimit të organizatave joqeveritare (më tej: OJQ) nga Regjistri i OJQ-ve.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për të gjitha format e organizimit të regjistruara si OJQ që funksionojnë sipas Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (më tej: Ligji), të cilat janë të regjistruara në Departamentin përkatës në MAP (më tej: Departamenti).

**Neni 3
Përkufizimet**

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në nenin 2 të Ligjit.

**Neni 4
Kërkesa për regjistrim**

1. Për regjistrimin e OJQ-ës, çdo person sipas nenit 9 (1) të Ligjit, duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Departamentit.

2. Kërkesa (Shtojca 2) duhet të përmbajë informatat në vijim:

2.1. emrin zyrtar të OJQ-së;

2.2. shkurtesën zyrtare të OJQ-së;

2.3. informatën nëse OJQ-ja regjistrohet si shoqatë apo fondacion;

2.4. emrin mbiemrin, adresën dhe informatat kontaktuese të përfaqësuesit të autorizuar;

2.5. adresën dhe të dhënat tjera kontaktuese të OJQ-së.

3. Kërkesës për regjistrim duhet t'i bashkëngjiten dokumentet në vijim:

- 3.1. akti themelues i OJQ-së (Shtojca 1);
- 3.2. fotokopjet e dokumentit të identifikimit të themeluesve;
- 3.3. vendimi për caktimin e përfaqësuesit të autorizuar;
- 3.4. simbolin zyrtar të OJQ-së;
- 3.5. statuti i OJQ-së;
- 3.6. lista për fushat e veprimtarisë të profilizohet sipas misionit (Shtojca 3);
- 3.7. lista e anëtarëve të kuvendit për Shoqatat;
- 3.8. lista e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për fondacionet.

4. Me kërkesë të OJQ-së dokumentet sipas, paragrafit 3.7 dhe 3.8 , të nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ dorëzohen në pliko të ndarë dhe të mbyllur, në të cilën shënohet " Lista e anëtarëve e OJQ-së emri zyrtar i OJQ-së dhe shkurtesa dhe numri i regjistrimit i cili i ndahet OJQ-së nga organi kompetent. Qasje në këto dokumente mundë të ketë vetëm udhëheqësi i organit kompetent apo personi i autorizuar nga ai/ajo, në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së, dhe vetëm me kërkesë të OJQ-së, në raste të kontestimit të legjitimitetit të organit drejtues të OJQ-së.

5. Në rastet kur themelues janë persona juridik, dokumenteve duhet t'i bashkëngjitet edhe:

- 5.1 dëshmia që themeluesit janë të regjistruar si persona juridik;
- 5.2 vendimin për caktimin e përfaqësuesit të personave juridik për themelimin të OJQsë.

Neni 5 **Akti themelues**

1. Shoqata ose fondacioni themelohet nëpërmjet aktit themelues që përmban të dhënat e mëposhtme:

- 1.1. vendin dhe datën e themelimit të OJQ-së;
- 1.2. emrin zyrtar, shkurtesën zyrtare si dhe simbolin zyrtar të organizatës;
- 1.3. formën organizative: shoqatë apo fondacion;
- 1.4. adresën e organizatës;
- 1.5. qëllimet e organizatës dhe aktivitetet;
- 1.6. emrat mbiemrat dhe adresat e themeluesve dhe përkatësia kombëtare;
- 1.7. emrin, adresën dhe informata tjera kontaktimi të përfaqësuesit të autorizuar, dhe
- 1.8. afatin kohor për të cilin organizata themelohet, nëse ka një të tillë.

2. Akti themelues duhet të nënshkruhet nga themeluesit e OJQ-së.

3. Përdorimi i modelit të Aktit Themelues të ofruar nga Departamenti nuk është i domosdoshëm dhe Departamenti pranon forma tjera të Aktit Themelues, përderisa i përmban të dhënat sipas paragrafi 1 dhe 2, të këtij neni dhe nuk janë në kundërshtim me ligjet në fuqi. Akti themelues mund të përmbajë edhe të dhëna tjera të cilat nuk janë në kundërshtim me Ligjin dhe legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 6 Statuti i OJQ-së

1. Secila OJQ duhet të ketë statutin, i cili paraqet dokumentin kryesor qeverisës të OJQ-së.

2. Statuti i OJQ-së duhet të përmbajë të dhënat në vijim:

2.1. emrin e organizatës, selinë dhe simbolin e saj;

2.2. qëllimet dhe aktivitetet e organizatës;

2.3. emrin e organit më të lartë udhëheqës;

2.4. procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të strukturave udhëheqëse;

2.5. nëse OJQ-ja është shoqatë, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kushtet për anëtarësim si dhe nëse organizata vendos të ketë një bord, procedurat për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit dhe ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësiive ndërmjet Kuvendit të Përgjithshëm të anëtarëve dhe Bordit;

2.6. nëse OJQ-ja është fondacion, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të Bordit;

2.7. kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, nëse ka;

2.8. mënyrën e marrjes së vendimeve;

2.9. rregullat dhe procedurat për:

2.9.1. ndryshimin e statutit;

2.9.2. bashkimin, ndarjen ose shuarjen e organizatës dhe

2.9.3. shpërndarjen e mjeteve që mbesin pas shuarjes.

3. Departamenti, në rast të kërkesës, ju ofron një model të statutit të shoqatës (Shtojca 4) dhe fondacionit (Shtojca 5). Përdorimi i modelit të statutit të ofruar nga Departamenti nuk është i domosdoshëm dhe Departamenti pranon forma tjera të Statutit, për deri sa i përmban të dhënat sipas paragrafi 2, të këtij neni dhe nuk janë në kundërshtim në ligjet në fuqi.

4. Rregullat dhe procedurat për udhëheqje të brendshme që i përmban statuti i OJQ-së duhet të jenë në pajtim legjislacionin dhe me parimet demokratike. Përgjegjës për interpretim e tyre është Departamenti.

Neni 7 Informacionet plotësuese për regjistrimin e OJQ-së

1. Departamenti, në rastet kur konsideron që informatat e ofruara nga OJQ-ja nëpërmjet kërkesës për regjistrim nuk janë të kompletuara ose të qarta, mund të kërkojë informacione, dokumente plotësuese apo sqarim me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së.

2. Kërkesën për informacione plotësuese organi kompetent ia dërgon me shkrim përfaqësuesit të autorizuar, duke specifikuar se cilat dokumente plotësuese apo sqarime janë të nevojshme.

3. Përfaqësuesi i autorizuar obligohet që të përgjigjet me shkrim në kërkesën e Departamentit, bazuar në kërkesën sipas paragrafit 2 të këtij neni. Në përgjigjen me shkrim, përfaqësuesi i autorizuar duhet të ofrojë të gjitha sqarimet e kërkuara dhe të specifikojë qartë se cilat dokumente shtesë dorëzohen së bashku me përgjigjen me shkrim.

4. Në qoftë se përfaqësuesi i autorizuar nuk përgjigjet brenda 30 ditësh pas pranimit të kërkesës së organit kompetent, Departamenti refuzon kërkesën për regjistrim të OJQ-së.

Neni 8

Regjistrimi i OJQ-ës të vendit të huaj apo ndërkombëtare

1. Për regjistrimin e OJQ-së së vendit të huaj apo ndërkombëtare duhet të plotësohet kërkesa e bashkangjitur (Shtojca 6).

2. Të gjitha dokumentet duhen të jenë të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare sipas Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, nga përkthyesi i certifikuar.

3. OJQ-ja e vendit të huaj apo ndërkombëtare duhet të ofrojë dëshmi se organizata është e themeluar në një vendtjetër. Dëshmia duhet të jetë në gjuhën origjinale, si dhe e përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare sipas Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.

4. Selia qendrore e organizatës së huaj ose ndërkombëtare përmes një shkrese të adresuar tek Departamenti duhet të emëroi një person për të vepruar si përfaqësues i autorizuar në Kosovë. Dëshmia e identitetit të jetë e bashkangjitur për përfaqësuesin e autorizuar.

5. Përfaqësuesi i autorizuar në selinë qendrore të organizatës është i obliguar të dërgon deklaratën zyrtare e cila konfirmon:

5.1. Qëllimet e përgjithshme të organizatës për degën në Kosovë;

5.2. Një përshkrim i përgjithshëm i aktiviteteve të planifikuara të realizohen në Kosovë;

5.3. Detajet kontaktuese të përfaqësuesit të autorizuar të kësaj organizate në Kosovë (adresa në Kosovë, aty ku përfaqësuesi vepron). Nëse përfaqësuesi OJQ-së në Kosovë, nuk është shtetas i Kosovës, duhet që ta dëshmon se është lajmëruar më parë në zyrën kompetente për të huaj;

5.4. Të deklaroj se OJQ-ja që aplikon për regjistrim, nuk do të përdor pasurinë dhe ardhurat e OJQ-së për të siguruar përfitime, direkt ose tërthorazi për ndonjë themelues, drejtor, nëpunës, anëtar, punonjës ose donatorë të OJQ-së.

5.5. Të deklaroj se, nëse ka shfrytëzuar lehtësi tatimore ose fiskale, donacione publike ose grante nga Qeveria, në rast të shpërbërjes së gjithë pasuria mbetet e OJQ-së pas shlyerjes së borxheve të OJQ-së do t'i jepet një OJQ-je me qëllime të njëjta ose të ngjashme në Republikën e Kosovës.

Neni 9

Ndryshimi i të dhënave të OJQ-së

1. OJQ-ja informon organin kompetent brenda tridhjetë (30) ditësh lidhur me çdo ndryshim që pësojnë:

1.1. Emri zyrtar, shkurtesa zyrtare si dhe simboli zyrtar i organizatës;

1.2. Adresa dhe informatat e kontaktit të organizatës;

1.3. Qëllimet e organizatës dhe aktivitetet;

1.4. Emri, adresa dhe informatat e kontaktit të përfaqësuesit të autorizuar;

1.5. Statuti i OJQ-së duhet të jetë në përputhje me ligjin në fuqi.

2. OJQ-ja informatën për ndryshimet i dërgon me shkrim, duke i përshkruar të gjitha ndryshimet dhe duke i bashkëngjitur dëshmitë e nevojshme për ndryshimet e bëra (Shtojca 9).

3. Nga momenti i pranimit të kërkesës, brenda tridhjetë (30) ditësh, organi kompetent i aprovon ndryshimet e bëra të përcaktuara në nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni dhe e përditëson regjistrin publik të OJQ-ve.

Neni 10

Njohja dhe rinjohja e Statusit për Përfitim Publik

1. OJQ- parqet kërkesë me shkrim për Statusin e Përfitimit Publik (me tutje: SPP) në momentin e regjistrimit ose me vonë, në përputhje me dispozitat e nenit 17 të Ligjit.

2. Departamenti përgatit një formular të cilin OJQ-ja e plotëson me rastin e parashtrimit të kërkesës për SPP (Shtojca 7).

3. Nëse kërkesa për njohjen e Statusit për përfitim publik bëhet që pasi OJQ-ja është regjistruar më parë, kërkesën për njohjen e statusit për përfitim publik OJQ-ja ia bashkëngjit:

3.1. një raport për projektet e realizuara;

3.2. përshkrim të shkurtër të projekteve që parashikon për t'i realizuar në periudhën e ardhshme ose planin e punës për vitin pasues;

3.3. vërtetimin nga ATK-ja që ka kryer obligimet tatimore.

4. Lidhur me zbatimin e nenit 19 paragrafi 4 të Ligjit, që ka të bëjë me rinjohjen (rikthimin) e SPP-ës, përveç dokumenteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, OJQ-ja është e obliguar të dëshmojë se i ka kryer obligimet sipas paragrafit 3 të nenit 19 të Ligjit, sipas kërkesave të formularit të përcaktuar nga Departamenti (Shtojca 7).

Neni 11

Obligimet për raportim financiar dhe të aktivitetit për OJQ-të me SPP

1. OJQ-ja, të cilës i është lejuar SPP-ja, duhet t'i paraqesë organit kompetent çdovit një raport vjetor për veprimet dhe aktivitetet e saj në Kosovë. Raportet duhet të dorëzohen deri në fund të muajit mars të secilit vit për vitin raportues që përfundon me 31 dhjetor të vitit paraprak, ndërsa duhet të përmbajnë të gjitha informatat e përcaktuara në Nenin 18 të Ligjit (Shtojca 8).

2. Raportet e dorëzuar në pajtim me këtë nen, vihen në dispozicion publikut, përveç nëse OJQ-ja parqet kërkesë për mos publikim të informatave të këtilla atëherë kur ia dorëzon raportin organit kompetent, në të cilën duhet të paraqesë arsyet për trajtim konfidencial të informacioneve (Shtojca 8a).

3. OJQ-ja duhet të paraqesë informatën konfidenciale e cila veçohet sipas paragrafit 2 të këtij neni në mënyrë të ndarë nga pjesa tjetër e raportit, dhe domosdo duhet që në mënyrë të qartë të thekësojë se raporti përfshinë kërkesën për mospublikim të informacionit.

4. Organi kompetent i përgjigjet me shkrim kërkesës për mospublikim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas dorëzimit të kërkesës.

5. Organi kompetent, pas plotësimit me sukses të obligimit për raportim të OJQ-së me SPP, siç parashihet me këtë nen, OJQ-së i lëshon certifikatën e re të statusit për përfitim publik me afat një (1) vjeçar.

Neni 12

Deklarata vjetore dhe përditësimi i regjistrin publik të OJQ-ve

1. Organi kompetent mban regjistër të OJQ-ve, i cili i vihet në dispozicion publikut në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. OJQ-të vendore, të vendit të huaj dhe ato ndërkombëtare janë të obliguara që një herë në vit të dorëzojnë në organin kompetent deklaratën vjetore për regjistrin publik të OJQ-ve, e cila konfirmon se informatat e kërkuara sipas Nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ janë ende të vlefshme ose kanë ndryshuar, siç përcaktohet në shtojcën 11.
3. Deklaratë duhet të dorëzohet për vitin paraprak, jo më vonë se deri më 28 shkurt të vitit vijues.
4. Organi kompetent përditëson regjistrin publik të OJQ-ve bazuar në të dhënat e ofruara me rastin e regjistrimit, njoftimet mbi ndryshimin e të dhënave dhe Deklaratën vjetore për regjistrin publik të OJQ-ve.

Neni 13

Procedura në rast të dështimit të dorëzimit të deklaratës vjetore për regjistrin publik të OJQ-ve

1. Departamenti mban evidencë adekuate për dorëzimin nga ana e OJQ-së të Deklaratës vjetore për regjistrin publik të OJQ-ve.
2. Dështimi për të dorëzuar këtë deklaratë për dy (2) vite me radhë obligon organin kompetent që të ndërmarrë procedurat e çregjistrimit të OJQ-së. Procedurat e ndërmarra nga Departamenti duhet të përfundojnë brenda 12 muajsh pas skadimit të afatit dy (2) vjeçar. Departamenti obligohet që jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas skadimit të afatit dy (2) vjeçar, gjatë se cilës OJQ-ja nuk ka dorëzuar këtë deklaratë, ta njoftojë me shkrim OJQ-në për pasojat e dështimit për të dorëzuar Deklaratën vjetore për regjistrin publik të OJQ-ve për 3 vite më radhë.
3. Njoftimi nga Departamenti për OJQ-në është valid në rast të dërgimit me shkrim në adresën fizike dhe elektronike të OJQ-së apo përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së, sipas të dhënave të fundit të dërguara nga OJQ në Departament.
4. Dështimi për të dorëzuar Deklaratën vjetore për regjistrin publik të OJQ-ve për tre (3) vite me radhë sipas Nenit 12 të Ligjit, obligon Departamentin që të ndërmarrë procedurat e çregjistrimit të OJQ-së.

Neni 14

Njoftimi për shuarjen vullnetare të OJQ-së

1. OJQ-ja e shuar në mënyrë vullnetare obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e vendimit për shuarje vullnetare të njoftojë organin kompetent për këtë vendim (Shtojca 10).
2. Njoftimi për shuarjen vullnetare të OJQ-së duhet të përmbajë:
 - 2.1. Datën dhe vendin e marrjes së vendimit për shuarje vullnetare;
 - 2.2. Bazën juridike për shuarjen vullnetare;
 - 2.3. Arsyet kryesore për shuarjen vullnetare;

2.4. Emri dhe të dhënat tjera të OJQ-së përfituese të pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar.

3. Njoftimit duhet t'i bashkëngjiten:

3.1. Vendimi i organit më të lartë drejtues të OJQ-së për shuarje vullnetare, bashkë me procesverbalin e nënshkruar (përfshirë emrin dhe mbiemrin, numrin personal dhe nënshkrimin e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës dhe të gjitha dispozitat e shpërndarjes së pasurisë së OJQ-së së shuar);

3.2. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së në original;

3.3. Nëse ka SPP, certifikatën origjinale për SPP-ën dhe raportet vjetore të kompletuara për periudhën e pambuluar me raportin e fundit të dorëzuar në Departament, deri në datën kur është marr vendimi mbi shuarjen e OJQ-së;

3.4. Raportin bankar dhe vendimi i bankës për mbylljen e xhirollogarive bankare në emër të OJQ-së;

3.5. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që konfirmon se OJQ-ja ka kryer të gjitha obligimet deri në datë kur është marr vendimi për shuarje;

4. OJQ-të të cilave i'u është revokuar SPP, janë të detyruara që në mënyrë retroaktive t'i kryej të gjitha detyrimet tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësirat tatimore dhe doganore të SPP, deri në datën kur është marrë vendimi mbi shuarjen e OJQ-së.

Neni 15

Shpërndarja e pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar

1. Në rast të shuarjes ose çregjistrimit të OJQ-së, e cila ka shfrytëzuar lehtësi tatimore ose fiskale, donacione publike, ose grante nga Qeveria, e gjithë pasuria e mbetur pas shlyerjes së borxheve të OJQ-së i jepet OJQ-së tjetër me qëllime të njëjta apo të ngjashme. OJQ identifikohet në bazë të statutit të OJQ-së, ose me propozim të organit më të lartë udhëheqës të OJQ-së.

2. Në të gjitha rastet tjera, çdo pasuri e mbetur pas pagesës së borxheve shpërndahet në bazë të statutit apo të vendimit të organit më të lartë udhëheqës, dhe në të gjitha rastet në përputhshmëri me nenin 4 të Ligjit.

3. OJQ-ja me status të përfituesit publik që është shpërbërë, është çregjistruar, ose pushon së vepruari në Kosovë brenda afatit të raportimit paraqet raport për periudhën e pambuluar me raporte, në përputhshmëri me nenin 4 dhe 18 të Ligjit.

4. Në raportin e saj të cilin e dorëzon në DRNOJQ (Shtojca 9), OJQ-ja thekson datën e shpërndarjes, shuarjes, çregjistrimit, dispozitat për përfundimin e punës së saj, si dhe shumën e mjeteve të mbetura pas përmbushjes së obligimeve, mënyrën e planifikuar të disponimit me mjete, si dhe mënyrën me të cilën është marr vendimi për disponim me mjete konkretisht, me dispozitë të prcaktuar në Statutin e organizatës, me vendim të organit më të lartë udhëheqës, apo me vendim të organit kompetent.

Neni 16

Komisioni për shpërndarjen e pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar

Sa herë që konsiderohet e nevojshme, Ministri formon Komisionin për shpërndarjen e pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar, në përbërje të të cilit ka përfaqësues nga departamenti dhe nga OJQ-ja e shuar. Ministria miraton një akt nënligjor të veçantë për themelimin dhe rregullat e procedurat e punës së këtij komisioni si dhe mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve.

Neni 17
Çregjistrimi i OJQ-ës

Departamenti njofton publikun dhe të gjitha institucionet përgjegjëse relevante për çregjistrimin e OJQ-së, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas largimit të OJQ-së nga regjistri i OJQ-ve.

Neni 18
Pezullimi i veprimtarisë së OJQ-ës

1. Me kërkesën me shkrim dhe arsyetim të institucioneve të autorizuara të sigurisë, Departamenti nxjerrë Vendimin për pezullimin e veprimtarisë së OJQ-së, për të cilat dyshohet se veprimtaria e tyre nuk përkon me rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare.
2. Departamenti njofton me shkrim institucionet e sigurisë dhe organet tatimore dhe doganore për vendimin e marrë.
3. Departamenti e bën publik Vendimin për pezullimin e OJQ-së dhe e paraqet në Regjistrin e OJQ-ve.
4. Pezullimi zgjatë deri në marrjen e një Vendimi tjetër, por jo më shumë se një vit.
5. OJQ-së së cilës i është pezulluar veprimtaria ka të drejtë ankese në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve, në pajtim me Rregulloren nr. 02/2012 MAP.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

03.09.2014

Shënim: Shtojcat e këtij Udhëzimi Administrativ mund t'i gjeni në këto vegëza: <http://map.rks-gov.net/Departments/DOJQ/Divizioni-i-regjistrimit-te-OJQ-ve.aspx> dhe <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=1&InstID=3&CatID=22>

(EKSTRAKT)

LIGJI Nr. 05/L -028

PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj vendos sistemin e Tatimit në të Ardhurat Personale në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Aktiviteti ekonomik** - çdo aktivitet i prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra ose shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, si dhe aktivitetet e profesioneve. Eksploatimi në baza të vazhdueshme i pasurive të prekshme dhe paprekshme me qëllim të sigurimit të të ardhurave në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik;

1.2. **Pasuri kapitale** - pasuri e prekshme apo e paprekshme që kushton më shumë se njëmijë euro (1.000 €) me afat të përdorimit më gjatë se një (1) vit;

* * * * *

1.4. **I punësuar** - personi fizik, i cili e kryen punën për pagë nën drejtimin dhe kontrollin e punëdhënësit, pavarësisht se a kryhet puna sipas kontratës ose ndonjë forme tjetër të marrëveshjes, qoftë e bërë me shkrim apo jo;

1.5. **Person i vetëpunësuar** - çdo person fizik i cili punon për përfitim personal, me para të gatshme ose me mallra, i cili nuk përfshihet në përkufizimin e të punësuarit sipas këtij ligji. Personi i vetëpunësuar e përfshin ndërmarrjen afariste personale dhe ortakun e angazhuar në aktivitet ekonomik;

1.6. **Punëdhënës** – çdo person afarist apo entitet që paguan paga, përfshirë edhe:

1.6.1. Autoritetin Publik;

1.6.2. Njësinë e përhershme të personit jo-rezident;

1.6.3. Organizatën jo qeveritare;

1.6.4. Organizatën ndërkombëtare, duke përfshirë KFOR-in dhe EULEX-in, me përjashtim të Kombeve të Bashkuara, Agjencitë e Specializuara të saj dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike;

1.6.5. Përfaqësitë diplomatike, konsullore dhe zyrat ndërlidhëse të shteteve të huaja në Kosovë kur ato pajtohen që të marrin përsipër përgjegjësitë e një punëdhënësi në Kosovë; dhe

1.6.6. Bashkësitë fetare - të parapara me Ligjin për Lirinë Fetare në Kosovë.

1.7. **Punëdhënës kryesor** - punëdhënës i përcaktuar nga i punësuar si i tillë në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri;

1.8. **Pagat** - kompensimi financiar ose llojet e tjera të kompensimit, duke i përfshirë mallrat, bonuset, favorët, shërbimet ose shkëmbimet që paguhen në lidhje me punësimin në Kosovë;

1.9. **Pagat e tatueshme** – pagat e paguara sipas nenit 9, paragrafi 1, të këtij ligji, duke zbritur shumat e lejueshme sipas këtij ligji;

1.10. **E ardhura nga burimi i jashtëm** – e ardhura bruto që nuk është e ardhur me burim në Kosovë;

1.11. **E ardhura me burim në Kosovë** - e ardhura bruto që krijohet në Kosovë;

1.12. **Person** - për qëllime të këtij ligji do të përfshijë:

1.12.1. **Person fizik** – për qëllime të këtij ligji konsiderohet:

1.12.1.1.- personi fizik jo afarist, që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi;
dhe

1.12.1.2.- personi fizik afarist, që ka të regjistruar një biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt biznesor.

1.12.2. **Person juridik** - shoqëri tregtare e themeluar sipas legjislacionit përkatës për Shoqëritë Tregtare personat e tjerë të themeluar sipas këtij legjislacioni të cilat ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në Republikën e Kosovës, si dhe persona të tjerë të themeluar ose të njohur si të tillë me ligje të veçanta;

* * * * *

1.15. **Autoritet publik** - një autoritet qendror, rajonal, komunal ose lokal, organ publik, ministri, departament apo ndonjë autoritet tjetër që ushtron pushtet publik ekzekutiv, ligjvënës, rregullator, administrativ ose pushtet gjyqësor;

* * * * *

1.18. **Rezident** - nënkupton:

1.18.1. një person fizik i cili ka një vendqëndrim kryesor në Kosovë ose fizikisht është i pranishëm në Kosovë mbi njëqind e tetëdhjetë e tre (183) ditë në çdo periudhë kohore dymbëdhjetë (12) mujore;

1.18.2. një ndërmarrje afariste personale, ortakëri apo shoqëri e personave e cila është themeluar në Kosovë ose ka vendin e tij të menaxhimit efektiv në Kosovë.

1.19. **Rezidencë kryesore ose Rezidencë e përhershme** - vendi ku një person fizik ka vendin e tij të zakonshëm të banimit apo rëndom jeton; vendi ku personi fizik tërësisht i nënshtrohet tatimit në të ardhura për arsye të rezidencës apo vendbanimit;

1.20. **Jo-rezident** - çdo person ose entitet që nuk është rezident i Kosovës;

* * * * *

Neni 3 Tatimpaguesit

Tatimpagues janë personat fizikë rezident dhe jo rezident, ndërmarrja personale afariste, ortakëritë dhe shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto të përshkruara në nenin 7 të këtij ligji gjatë periudhës tatimore.

Neni 4 Objekti i tatimit

1. Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës.
2. Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

Neni 5 Të ardhurat e tatueshme

Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas këtij ligji lidhur me të ardhurat e tilla bruto.

Neni 6 Shkallët e tatimit

1. Tatimi në të ardhura personale vjetore, ngarkohet sipas shkallëve në vijim:
 - 1.1 Për të ardhurat e tatueshme nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) ose më pak, zero për qind (0%);
 - 1.2. Për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) deri në tremijë euro (3.000 €), duke përfshirë edhe shumën tremijë euro (3.000 €), katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €);
 - 1.3. Për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë euro (3.000 €), deri në pesëmijë e katërqind (5.400 €), duke përfshirë edhe shumën pesëmijë e katërqind (5,400 €), Tetëdhjetë e një pikë gjashtë euro (81.6 €) plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë euro (3.000 €); dhe
 - 1.4. Për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €), dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë euro (273.6 €) plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €).

Neni 7

Të ardhurat bruto

1. Përveç për të ardhurat që janë të liruara sipas këtij ligji, të ardhurat bruto nënkuptojnë të gjitha të ardhurat që janë pranuar vërtet apo në mënyrë konstruktive nga burimet vijuese:

1.1. Pagat;

1.2. Qiratë;

1.3. Përdorimi i pasurisë së paprekshme;

1.4. Interesi, përveç interesit i cili është i lejuar sipas këtij ligji;

1.5. Të ardhurat zëvendësuese, sikurse ato të përmendura në nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të këtij ligji;

1.6. Fitimet kapitale që rezultojnë nga shitjet e pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e tundshme, të patundshme dhe letrat me vlerë;

1.7. Pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë;

1.8. Fitoret në lotari dhe fitoret në lojërat e fatit;

1.9. Veprimtaria afariste e gjeneruar nga bizneset me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetë mijë euro (50.000 €) apo më pak, përveç nëse ato biznese kanë zgjedhur të mbajnë libra dhe regjistrime siç kërkohet në nenin 33 të këtij ligji.

2. Përveç siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni, të ardhura bruto, po ashtu nënkuptojnë të gjitha të ardhurat e lindura (akruara) nga burimet vijuese:

2.1. veprimtari afariste që janë objekt i tatuarjes në të ardhura reale;

2.2. fitimet kapitale, përveç atyre fitimeve kapitale të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni;

2.3. çdo e ardhur tjetër e tatueshme që nuk është e përfshirë në këtë nen apo çdo e ardhur tjetër që do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 8

Të ardhurat që përjashtohen

1. Nga tatimi në të ardhura personale përjashtohen të ardhurat në vijim:

1.1. Rrogat e përfaqësuesve të huaj diplomatik e konsullor dhe personeli i jashtëm i Ambasadave apo Zyrave të Ndërlidhjes së shteteve të huaja në Kosovë, siç është përcaktuar në legjislacionin e aplikueshëm mbi vendosjen dhe funksionimin e zyrave ndërlidhëse dhe shërbimeve diplomatike në Kosovë;

1.2. Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik sipas legjislacionit të tillë;

* * * * *

1.12. pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori;

1.13. pagesat e pensioneve dhe asistencat sociale të paguara nga Qeveria e Kosovës;

* * * * *

Neni 51
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2015.

Ligji Nr. 05/L -028
22 korrik 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-020-2015, datë 07.08.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës,
Atifete Jahjaga

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2016
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L-028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

(EKSTRAKT)

Ministri i Financave,

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale (Gazeta Zyrtare, Nr.22/14.08.2015), nenit 8, nënparagrafit 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr.15/12.09.2011),

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01 / 2016 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L-028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës dhe për të gjithë personat që janë në fushëveprimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Neni 3
Përkufizimet

1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.
2. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, përveç përkufizimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, përdoren edhe përkufizimet e mëposhtme:

2.1. Punëdhënës kryesor – punëdhënës i përcaktuar nga i punësuar si i tillë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;

2.2. Të ardhurat e tjera – të gjitha të ardhurat që nuk janë cituar në mënyrë specifike në nenin 7 të Ligjit dhe që përfshijnë shpërblime të dhëna jo në para si gjësende, falja e borxhit dhe të ngjashme, të cilat e rrisin pasurinë e tatimpaguesit;

2.3. Ligji – Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale;

* * * * *

Neni 6
I punësuar

1. Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, ashtu siç është përcaktuar me Ligj, i punësuar konsiderohet personi fizik jo afarist, i cili kryen punë kundrejt pagesës sipas urdhrorit dhe nën kontrollin e një punëdhënësi. Personi fizik jo afarist pavarësisht thirrjes, si: “drejtor”, “zyrtar”, “parlamentar”, “ministër”, “nëpunës” etj., konsiderohet se është i punësuar nëse përmbush së paku dy nga kushtet, si në vijim:

- 1.1. I punësuari nuk është në rrezik për marrjen e pagesës, pavarësisht rezultatit afarist të punëdhënësit,
- 1.2. I punësuari nuk ka nevojë të investojë në instrumentet e punës, mjetet dhe pajisjet,
- 1.3. I punësuari nuk e përcakton vendin dhe kohën e punës, dhe
- 1.4. Si rregull i përgjithshëm, një i punësuar ka të përcaktuar një punëdhënës kryesor.

* * * * *

Neni 11 **Të ardhurat e përjashtuara**

1. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 deri 1.5 të Ligjit, përcaktojnë se pagat për personelin e huaj, përfaqësuesit e huaj, zyrtarët e huaj, etj., përjashtohen nga Tatimi në të Ardhurat Personale.
2. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit, përjashton nga Tatimi në të Ardhurat Personale, rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike. Të njëjtat përjashtime vlejnë për institucionet ndërkombëtare financiare ndërqeveritare që kanë të drejtë dhe që janë të autorizuara të veprojnë në Kosovë;

* * * * *

5. Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 i Ligjit, përcakton se paga e personit me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori, është e ardhur e përjashtuar nga Tatimi në të Ardhura Personale.

5.1. Paragrafi 5 i këtij neni aplikohet vetëm në rastet kur i punësuari posedon dëshminë nga autoriteti kompetent, e cila vërteton statusin e tij.

* * * * *

Neni 49 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë ditë pas nënshkrimit.

AVDULLAH HOTI

Ministër i Financave
Datë: 15/03/2016

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
ZYRA E KRYEMINISTRIT/URED PREMIJERA/OFFICE OF THE PRIME MINISTER

ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË / KANCELARJA ZA DOBRO UPRAVLJANJE / OFFICE FOR GOOD
GOVERNANCE

**STRATEGJIA NACIONALE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS
2013-2023**

Prishtinë, 2013

PËRMBAJTJA

1. LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE
2. FALËNDERIMET
3. PSE ESHTË E RËNDESISHME STRATEGJIA NACIONALE PER TE DREJTAT E PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUARA NE REPUBLIKEN E KOSOVES 2013-2023
4. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
5. HYRJE
6. VIZIONI DHE MISIONI
7. PARIMET
8. METODOLOGJIA
9. SFONDI
10. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE
11. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të brabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara

Objektiva Strategjike 4: Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesmarrje si dhe krimimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuar

12. MEKANIZMAT PËR MONITORIM, RAPORTIM DHE ZBATIM
13. DOKUMENTET E REFERUARA

1. LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ASK- Agjencioni i Statistikave të Kosovës

EJL - Evropa Juglindore

DKA - Departamenti Komunal i Arsimit

DPBZH/MPJ- Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë

MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

MPB- Ministria e Punëve të Brendshme

MPMS- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MPJ- Ministria e Punëve të Jashtme

MKRS- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MSH- Ministria e Shëndetësisë

MI- Ministria e Infrastrukturës

MTI- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MSH- Ministria e Shëndetësisë
MZHR - Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MBZHR- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MAP- Ministria e Administratës Publike
MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MD- Ministria e Drejtësisë
MDi- Ministria e Diasporës
MF- Ministria e Financave
PKVPAK- Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2009-2011
PAK- Personat me Aftësi të Kufizuar
PIA - Plani individual i edukimit
KASH- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
NJDNJ- Njësitë për të Drejtat e Njeriut
KDPAK- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Kombet e Bashkuara KE-Komisioni Evropian
OJQ- Organizata Joqeveritare
OBSh- Organizata Botërore e Shëndetësisë
OPAK- Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuar
DUDNJ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
SZHAPU- Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar 2007-2017
ISCED- Kualifikimi standard ndërkombëtar i edukimit
ZKM/ZQM - Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Jo Diskriminim

Qeveria e Republikës së Kosovës prezanton **Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2022**, dokument ky që paraqet udhërrëfyesin drejt avancimit, fuqizimit mbrojtjes dhe promovimit të mëtutjeshëm të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar si qytetar të respektuar dhe me të drejta të barabarta në vend.

2. FALËNDERIMET

Hartimi i Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 ishte përpjekje e përbashkët e Institucioneve Qeveritare të Republikës së Kosovës si dhe një spektri shumë të gjerë të partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë nën udhëheqjen dhe koordinimin e Zyrës së Kryeministrit /Zyrës për Qeverisje të Mirë.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës/ Zyra për Qeverisje të Mirë shpreh mirënjohjen e thellë për bashkëpunimin e ngushtë dhe ndihmën e ofruar nga të gjithë zyrtarët e institucioneve qeveritare qendrore dhe komunale.

Qeveria e Republikës së Kosovës falënderon, për sugjerimet dhe rekomandimet e tyre të vlefshme të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile, ekspertët e fushave të të drejtave të njeriut, institucionet dhe organizatat joqeveritare të Kosovës që përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara.

Në zhvillimin e Strategjisë kontribut të veçantë kanë dhënë edhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që përfaqësojnë interesat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë. Me këtë rast ne falënderojmë të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe në mënyrë të veçantë falënderojmë Italian Cooperation Development, Drejtorinë e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë si dhe Ambasadën e Italisë në Republikën e Kosovës , për ofrimin e përkrahjes së vazhdueshme në realizimin e projekteve madhore të Institucioneve të Republikës së Kosovës të cilat si pikësynimi të tyre kanë mbrojtjen dhe respektimin e plotë të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

3. PSE ESHTË E RËNDESISHME STRATEGJIA NACIONALE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NE REPUBLIKEN E KOSOVES 2013-2023

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 synon të ofrojë një kornizë të qëndrueshme të veprimeve që ka për qëllim të adresojë sfidat dhe pengesat si dhe të promovon një shoqëri gjithëpërfshirëse.

Strategjia do të përcaktojë një vizion që do të mbështetet me veprime konkrete dhe rezultate të arritshme. Strategjia do të shërbej procesit të koordinimit dhe integritit të të gjitha politikave dhe nismave relevante në fushën e Aftësisë së Kufizuar

Dhe në fund fare por jo për nga rëndësia, Strategjia do të jetë një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që parimet të cilat janë të mishëruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara janë inkorporuar në politikat dhe programet që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës.

4. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Neni 1.

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj konvente është që të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuar, si dhe të kontribuojë në respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore të cilat në bashkëveprim me pengesa të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
Kombet e Bashkuara

Mbi bazën e këtij Neni të KDPAK të KB, Republika e Kosovës prezanton **Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023**, dokument ky që paraqet udhërrëfyesin drejt avancimit, fuqizimit dhe mbrojtjes së mëtutjeshme të Personave me Aftësi të Kufizuar si qytetarë të respektuar dhe me të drejta të barabarta në vend. Përkufizimi i aftësisë së kufizuar në të gjitha dokumentet qeveritare do të jetë në përputhje me përkufizimin e dhënë më lartë.

Strategjia përbën një dokument të rëndësishëm në kuadër të përpjekjeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila do të shërbej si katalizator për të krijuar politika më efikase, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Me anë të këtij dokumenti strategjikë synohet përmirësimi i gjendjes aktuale në këto fusha: Shëndetësia; Mirëqenia Sociale; Punësimi; Edukimi; Mbrojtja Ligjore; Pjesëmarrja, Informimi Komunikimi, Qasje dhe Statistika. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale nga fushat prioritare të përzgjedhura në Strategji, janë përcaktuar objektiva strategjike të cilat do të detajohen dhe specifikohen edhe me veprime konkrete, tregues të matshëm, specifik, të arritshëm dhe real. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet do të kenë një afat kohor të përcaktuar dhe linjë buxhetore për mbulimin e aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit për zbatimin e strategjisë .

Për më tepër strategjia do të shërbej si një udhërrëfyes për institucionet e Republikës së Kosovës për të punuar brenda parimeve mos-diskriminuese, duke respektuar dinjitetin e lindur, autonominë individuale duke përfshirë lirinë për t'i marrë vet vendimet dhe pavarësinë e personave, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies, pjesëmarrjen e plotë dhe efektive dhe gjithëpërfshirjen në shoqëri. Pranimin e personave me aftësi të kufizuar si vlerë shoqërore, pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit, dhe barazimin e mundësive, barazinë midis burrave dhe grave, respektimin e aftësive evoluese të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'i ruajtur identitetet e veta, që njëherit janë edhe parimet bazë të Konventës për të Drejtat e PAK.

Në këtë kuptim, një theks të veçantë i vemi bashkëpunimit me organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar si pjesë e partneritetit ndërmjet Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të shoqërisë civile të cilat kanë kontribuar shumë në hartimin e këtij dokumenti dhe vazhdojnë të jenë një nga promotorët më të rëndësishëm në të gjitha aspektet e vet Personave me Aftësi të Kufizuar në mbar vendin.

Kjo dëshmon edhe njëherë se Republika e Kosovës, politik bërjen për personat me aftësi të kufizuara e ka të mbështetur në standardet ndërkombëtare, duke përfshirë parimet themelore të të drejtave të njeriut të tilla si parimi i mbrojtjes dhe mos-diskriminimit.

5. HYRJE

Gjendja e tanishme e Personave me Aftësi të Kufizuar nuk përmbush realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Andaj si rrjedhojë të gjitha subjektet janë përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte e cila arrihet vetëm duke eliminuar çdo lloj pengese dhe barriere që krijon vështirësi në respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Bazuar në këtë të vërtetë, i gjithë spektri ndërkombëtar ka ndërmarr hapa të duhur drejt jetësimit të kësaj të drejte me, konventa, standarde, ligje, rregullore etj, të cilat obligojnë shtetet për ti përvetësuar dhe plotësuar ato. Për më tepër kjo kornizë e tanishme që mbron të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ka ndërruar politikat nacionale të vendeve duke e vendosur dhe trajtuar çështjen e të drejtave të

Personave me Aftësi të Kufizuar si çështje e të Drejtave të Njeriut një e arritur kjo që nuk mund të mohohet nga askush.

Gjithsesi jo gjithherë këto politika kanë dhënë rezultat dhe kjo shoqëri ka reaguar drejt ndaj këtij lloji, andaj për pasqyrën e dëshiruar në këtë çështje jemi dëshmitare se mbetet akoma shumë punë për të bërë.

Në këtë kontekst e theksojmë se shteti i sapoformuar i Republikës e Kosovës gjegjësisht institucionet e saj kanë akoma shumë punë dhe përpjekje për të bërë, prandaj duke u thirrur në aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e saj, dhe në Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Kombeve të Bashkuara si instrumentin më të lartë ndërkombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, Republika e Kosovës prezanton **Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023**.

Me këtë hap Republika e Kosovës shpreh gatishmërinë dhe vullnetin politik, dhe rikonfirmon përgjegjësinë që t'i respektoj dhe ti përmbushë obligimet ndërkombëtare të cilat sigurojnë realizimin e të gjitha të drejtave themelore, universale e të patjetërsueshme për të gjithë qytetarët në vend, si dhe të raportojë para mekanizmave ndërkombëtar për zbatimin e këtyre dokumenteve dhe politikave.

Andaj edhe Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023 është e hartuar në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut të cilat njohin dinjitetin e lindur dhe të drejtat e barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore, si bazë të lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.

Strategjia për më tepër do të jetë unike dhe e zbatueshme sepse në kuadër të saj është bërë planifikimi shumë real dhe shumë objektiv për tu zbatuar në praktikë.

Ky dokument Strategjikë do të kontribuon procesit të harmonizimit të të gjitha politikave të veprimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara me standardet e arritura në nivel global, ku tendenca e saj përqipet për të hapur dhe të bëjë që të gjitha fushat e jetës të jenë të arritshme për Personat me Aftësi të Kufizuar në vendin tonë.

6. VIZIONI DHE MISIONI

VIZIONI

Shoqëri gjithëpërfshirëse në të cilën persona me aftësi të kufizuara realizojnë potencialin e plote të tyre dhe jetojnë jete të dinjitetshme si qytetarë të barabartë.

MISIONI

Të përcaktojë objektivat dhe prioritetet strategjike për një periudhë afat gjate me qëllim që të rrisë cilësinë e jetës dhe mirëqenies së Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës si dhe përmbushja obligimeve shtetërore drejte respektimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

7. PARIMET

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 është e hartuar mbi bazën e respektimit dhe garantimit të **tetë parimeve të përgjithshme** të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si vijon:

- Respekt për dinjitetin e lindur, autonomi individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësi e personit;

- Mos-diskriminim;
- Pjesëmarrje dhe përfshirje e plotë dhe efektive në shoqëri;
- Respekt për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- Barazi e mundësive;
- Qasje;
- Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respekt për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

Politikat publike të Kosovës do të jenë në përputhje me këto parime, përfshirë politikat për gjithëpërfshirje dhe mos-diskriminim.

Politikat dhe praktikët e zhvilluara nga qeveria e të dala nga kjo strategji, përfshirë edhe fushat e përgjithshme, do të reflektojnë dhe fuqizojnë qasjet në vijim:

- **Involvimi i personave me aftësi të kufizuara** – pikëpamjet e personave me aftësi të kufizuara janë qendrore në përpilimin, financimin, realizimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve që i ndikojnë ata, me përkrahjet e duhura dhe përshtatjet për pjesëmarrje.

- **Angazhimi i komunitetit** – angazhimi i të gjithë komunitetit të gjerë është i nevojshëm për të larguar barrierat dhe për të përkrahur gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e komuniteteve të tyre.

- **Qasja universale** – produktet, shërbimet, ambientet dhe komunitetet janë të qasshme dhe të shfrytëzueshme nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara në masën më të madhe të mundshme pa nevojë për modifikime të veçanta.

- **Qasja me kahje jete** – merr në konsiderim nevojat dhe aspiratat e mundshme të personit gjatë gjithë jetës, me vëmendje të veçantë në periudhat kyçe jetësore dhe kohët e tranzicionit.

- **Me-personin-në-qendër** – politikat, programet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara janë përpiluar për t'iu përgjigjur nevojave dhe dëshirave të çdo individi.

- **Jeta e pavarur** – ofrimi i shërbimeve dhe pajisjeve që lehtësojnë nivelin më të lartë të pavarësisë dhe gëzimit e jetës që reflekton zgjidhjet e personave me aftësi të kufizuara.

- **Ndërlidhshmëria** – institucionet qeveritare punojnë së bashku për të siguruar ndërlidhshmërinë e politikave dhe programeve.

8. METODOLOGJIA

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është rezultat i koordinimit dhe bashkëpunimit të ngushtë midis Zyrës së Kryeministrit / Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe punës së përbashkët me përfaqësues institucionesh nga nivelin qendror dhe lokal, përfaqësues nga shoqëria civile si dhe agjencionet vendore e ndërkombëtare.

Analizat paraprake për hartimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kanë filluar me projektin e përbashkët në mes të ZKM/ZQM dhe Bashkëpunimit Italian Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë të cilët kanë mbështetur këtë nismë fillimisht duke sjellë në vend ekspertë të ndryshëm të fushave të ndryshme dhe specifike për nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuara duke përfshirë ekspertë nga këto institucione si: Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar, Forumit Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Klasifikimin Ndërkombëtare të Funkcionalitetit në Udine, Itali etj. Ekspertë të shumët të cilët për një periudhë njëvjeçare kanë analizuar gjendjen

ekzistuese, në këtë mënyrë duke reflektuar për të dhënë udhëzime dhe rekomandime në hartimin e dokumentit strategjik.

Pas marrjes së kontributit dhe ekspertizës me shumë vlerë ZKM/ZQM ka vazhduar procesin duke përcjell propozimin e saj në Zyrën për Planifikime Strategjike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për tu siguruar që dokumenti strategjik adreson një apo më shumë prioritete të Qeverisë dhe është në përputhje me to, si dhe nuk është në konflikt apo që duplikon strategjitë ekzistuese ose të propozuara të Ministrive të tjera.

Në fazën e ardhshme është marrë aprovimi nga ana e Sekretareve të Përgjithshëm në Ministrinë e linjës për identifikimin e kontakt personave në të gjitha departamentet përgjegjëse në institucionet relevante, me aranzhimin e takimeve specifike të punës në ministrinë gjegjëse. Në këtë drejtim janë realizuar dhjetë takime pune për secilën fushë prioritare me aktorët përgjegjës institucional. Po ashtu janë realizuar pesë punëtori konsultative që i janë dedikuar nivelit qendrorë, tri punëtori konsultative që i janë dedikuar nivelit lokal, një punëtori e përbashkët e institucioneve të nivelit lokal dhe qendror si dhe punëtorja e fundit tri ditore përmblylëse me të gjithë akterët e përfshirë në proces.

Për më tepër gjatë procesit të hartimit janë konsultuar të gjithë përfaqësuesit qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, shoqërisë civile, e në veçanti është marrë në konsideratë roli i Organizatave për Personat me Aftësi të Kufizuara si burim ekspertize dhe si partnerë kompetent në hartimin e politikave strategjike si dhe ndërgjegjësimi sa më i lartë lidhur me nevojën e zbatimit të tij.

Pjesëmarrës në këto punëtori kanë qenë përfaqësues të institucioneve qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, shoqërisë civile, organizatave jo qeveritare dhe agjensioneve vendore dhe ndërkombëtare që punojnë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Qëllimi kryesor i punëtorive ishte krijimi i hapësirës për të diskutuar dhe për tu pajtuar mbi objektivat dhe aktivitetet që do të duhej të përfshihen në dokumentet në fjalë, si dhe mbi treguesit për grumbullimin sa më cilësorë të të dhënave të disponueshme. Proces ky që do të lehtësojnë punën institucionale në monitorimin e zbatimit të objektivave që adreson Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.

Për gjatë gjithë rrugëtimit në procesin e hartimit dhe realizimit të punëtorive me aktorët relevant të udhëhequr dhe koordinuar nga ZKM/ZQM, kemi pranuar përkrahje dhe mbështetje nga Bashkëpunimi Italian /Italian Cooperation / Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë.

9. SFONDI

Bazuar në hulumtimet e fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë konsiderohet se rreth 15% e popullsisë së botës kanë një aftësi të kufizuar. Studimet tregojnë se në shoqëritë e zhvilluara, ofrimi i përkujdesit shoqëror konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i rolit të shtetit dhe përfitimet nga përkujdesja janë pjesë e të drejtave të individit. Qasje kjo që anasjelltas ofron suksesin ose dështimi i përkujdesit ndaj personave me aftësisë së kufizuar, e që për shumë arsye është vendimtare për mirëqenien e shoqërisë.

Në këtë kontekst në Prill 2009 Qeveria e Republikës së Kosovës aprovoi PKVPAK dokumentin më të rëndësishëm i cili ka synuar në mënyrë të vazhduar në ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të përfituesve për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritit të Personave me Aftësi të Kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore.

Në rrjedhat e implementimit të këtij dokumenti është publikuar edhe Raporti i parë mbi zbatimin e PKVPAK i cili pasqyron angazhimin e të gjithë akterëve me qëllim të përfshirjes sociale dhe përmirësimit e jetës së të gjithë PAK. Në këtë mënyrë duke arritur një sërë rezultate të rëndësishme, si plotësimi i një legjislacioni bashkëkohor, në përputhje me standardet e vendeve të përparuara, legjislacioni i cili garanton një nivel të kënaqshëm për plotësimin e nevojave të këtyre kategorive; njohja me vendimin qeveritar për gjuhën e shenjave si një të drejtë të patjetërsueshme për PAK; krijimi i ambienteve të përshtatshme për

mësim nxënien e fëmijëve me nevoja të veçanta; ndihma e ofruar përmes politikave sociale për PAK si dhe Familjeve të Fëmijëve me aftësi të kufizuara bazuar në ligjet në fuqi; mbrojtja dhe përkrahja e shumë Shoqatave që përfaqësojnë PAK etj.

Më tutje, një progres i konsiderueshëm është bërë edhe në lehtësimin e qasjes në shërbimet për PAK, dhe në këtë pjesë ne mund të theksojmë disa shembuj nga fusha të ndryshme si vijon:

i. Për shembull në arsimin parashkollor dhe fillor përçindja e nxënësve me aftësi të kufizuara është rritur me shpejtësi dhe në mënyrë të qëndrueshme. Ku sistemi aktual i arsimit për nxënësit me aftësi të kufizuara arsimore gjithnjë e më tepër po shkon drejt hapjes ndaj arsimit të rregullt, me qëllim që nxënësit me aftësi të kufizuara arsimore gjithnjë e më tepër të jenë pjesë e shkollave dhe klasave të rregullta. Gjithsesi në vargun e këtyre aktiviteteve është punuar edhe në hartimin e dokumenteve bazë që sigurojnë arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë.

ii. Progres i dukshëm është bërë edhe në përmirësimin e qasjes në shërbimet e strehimit për PAK, të pasqyruara në fushën e mirëqenies sociale nga MPMS si dhe niveli komunal. Ku aktualisht në Kosovë janë duke u ofruar shërbime në komunitet përmes 9 shtëpive të cilat kanë bërë që procesi i de-institucionalizmit të bëjë hapa para dhe në Institutin e Shtimes të mbesin vetëm edhe 58 PAK

Duke qenë të ndërgjegjshëm dhe vetëdijshëm se, me gjithë progresin e shënuar në drejtim të plotësimit të nevojave të kësaj kategorie të qytetareve që janë arritur përmes zbatimit të PKVPAK, ende kanë mbet mjaft çështje dhe detyrime për tu përmbushur .

Andaj si rrjedhojë për të fuqizuar përpjekjet tona në drejtim të zbatimit më të mirë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara , u hartua Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e cila ka për qëllim që ti qojë proceset përpara në mënyrë që ti fuqizoj Personat me Aftësi të Kufizuara. Që PAK të mund të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të plotë, dhe të përfitojnë plotësisht në të gjitha sferat e jetës në baza të barabarta me të tjerët.

Gjithashtu Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2012-2023 do të shoqërohet edhe nga Plani i Veprimit i cili synon të mbështes promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetë së të gjithë Personave me Aftësi të Kufizuara.

LEGJISLACIONI VENDORE

Respektimi i parimeve dhe standardeve të të drejtave të njeriut e veqanërisht të Personave me Aftësi të Kufizuara është një ndër parakushtet themelore për sundimin e ligjit dhe demokracisë në vend.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbetur e angazhuar dhe e përkushtuar në maksimum për të hartuar dhe krijuar infrastrukturë të nevojshme ligjore, politika, programe të qëndrueshme dhe mekanizma institucional për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal të qeverisjes.

Në këtë kontekst përmbledhjen e legjislacionit për Personat me Aftësi të Kufizuara e kemi ndarë në tri fusha si vijon:

- Ligjet specifike të dedikuara për PAK;
- Ligjet, të cilët përmbajnë dispozita që i përkasin PAK;
- Udhëzime administrative dhe rregulloret për PAK;

Ligjet më të rëndësishme të dedikuara në mënyrë specifike për PAK janë:

- Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara, Nr. 2003/23
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, Nr. 03/L-022
- Ligji për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara, Nr. 03/L-019
- Ligji për Personat e Verbër Nr.04/L-092

Ligjet që përmbajnë provizione relevante lidhur me PAK janë:

- Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125
- Ligji i Punës, Nr. 03/L-212
- Ligji mbi Ndërtimin, Nr. 2004/15
- Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3
- Ligji për Skemën e Asistencës Sociale, Nr. 2003/15
- Ligji mbi Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032
- Ligji për Sportin Nr. 04/L-075

Për më tepër ka edhe tre akte legjislative të rëndësishme për PAK:

- Rregullorja Nr. 2000/66 mbi Beneficionet e Invalidëve të Luftës të Kosovës dhe për më të Afërmit e Tyre që Kanë Vdekur si Pasoje e Konfliktit të Armatosur në Kosovë;
- Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 07/2007
- Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Aplikimit për Njohjen e të Drejtave për Aftësim, Ri aftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 03/2010

10. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia Nacionale për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023) do të paracaktoj politikat, veprimet dhe strategjitë sektoriale të të gjitha institucioneve dhe vetë shoqërisë për një dekadë. Si rrjedhojë ka për qëllim të transmetojë synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e të drejtave të njeriut, jo diskriminimit, shanseve të barabarta, të drejtave civile dhe pjesëmarrjes së plotë të Personave me Aftësi të Kufizuara në një kuadër evropian të aftësisë së kufizuar për dekadën në vazhdim.

Përzgjedhja e fushave prioritare në Strategji është bërë duke marrë parasysh mangësitë ekzistuese për përmbushjen e nevojave elementare të Personave me Aftësi të Kufizuara, siç janë shërbimet shëndetësore joadekuate, mungesa e planifikimit të mirëfilltë të skemave sociale për përmirësimin e mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara, mungesa e mekanizmave implementues për zbatimin e legjislacionit për punësim dhe arsim të personave me aftësi të kufizuara, diskriminimi i heshtur ndaj personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e shoqërisë, qasja jo e mjaftueshme dhe jo e përshtatshme në jetën sociale, politike dhe ekonomike e personave me aftësi të kufizuara, mungesa e të dhënave të sakta për numrin e personave me aftësi të kufizuara, situatës jetësore dhe nevojave të tyre.

Strategjia është e strukturuar në pesë (5) fusha të cilat përfshijnë të gjitha aspektet kryesore të jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara me fokus në fushat si në vijim: Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Punësim, Arsimi, Mbrojtje Ligjore, Qasja (informimi, komunikimi, pjesëmarrja) Statistikat.

Këto fusha janë të bazuara në çështjet të cilat janë ngritur dhe theksuar si problematike për Personat me Aftësi të Kufizuara gjatë gjithë kohës, ku vërtet ka një dobësi dhe pabarazi e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në jetën e këtij komuniteti. Fushat e lartë përmendura janë të përshkruara me objektiva strategjike të cilat do të specifikohen edhe me veprime konkrete dhe afate specifike në kuadër të planeve të veprimit të cilat vazhdimisht do ta shoqërojnë këtë dokument.

Për përmirësimin e gjendjes aktuale nga fushat prioritare të përzgjedhura në Strategji, janë përcaktuar objektiva strategjike të cilat do të detajohen dhe specifikohen edhe me veprime konkrete, synime, tregues të matshëm, specifik, të arritshëm, real, institucione përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet, afate kohore dhe linja buxhetore në kuadër të planeve të veprimit.

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të brabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara

Objektiva Strategjike 4: Qasje e barabarte në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara.

11. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Udhëzuar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Republika e Kosovës përmes kësaj Strategjie synon realizimin e plotës të së drejtës për personat me aftësi të kufizuar që të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit pa diskriminim mbi bazë aftësisë së kufizuar.

Për përmbushjen e këtij synimi është përcaktuar objektiva strategjike, përmes të cilës planet e veprimit në kuadër të Strategjisë do të fokusohen në një politikë koherente për përkujdesjen ndaj personave me aftësi të kufizuara. Politikë që në radhë të parë synon parandalimin e shkaktarëve dhe pasojave të aftësisë së kufizuar, zbulimin e hershëm dhe identifikimin e aftësisë së kufizuar prej kohës prenatale, natale, dhe në fazën e mëvonshme.

Shërbimet shëndetësore të duhura, të qasshme dhe të përballueshme në nivelin primar, sekondar dhe terciar janë esenciale në barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuara. Shërbime e tilla duhet të përfshijnë shërbime shëndetësore mjekësore dhe të infermierisë në kujdesin hospitalor, ambulator apo në shtëpi të bazuar në komunitet, dhe në ndihmë shëndetësorë profesionale të specializuar. Kur aftësia e kufizuar lejon, format e veçanta të ndihmës të ofruara qoftë në ambulantë apo në shtëpi janë të preferuara karshi shërbimit hospitalor.

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të procesit të reformës legjislativ me Ligjin e ri të Shëndetësisë Nr. 04| L-125, si dhe pas miratimit të ligjit për Sigurime Shëndetësore dhe Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale i jep një dimension të ri përkujdesjes shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ndryshimi i bazës ligjore, e në veçanti krijimi i Fondit për sigurime shëndetësore në të ardhmen e afërt, krijon një realitet tjetër edhe në fushën e financimit të shëndetësisë, që do të reflektoj në përmirësimin e kujdesit shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe përmbushjen e kësaj objektivë për vitet në vijim.

Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfillt për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të brabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar thekson qartë obligimet e shteteve palë mbi njohjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar për një standard adekuat jetese, përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin, punësimin si dhe sigurimin e pensionit, të cilat pra përbëjnë një standard dhe obligim ndërkombëtarë.

Me këtë parim objektiva strategjike vë në pah që Mbrojtja Sociale të mbështet të gjithë personat në nevojë duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kjo e drejtë dhe nevojë do të jetë sigurisht më e theksuar tek Personat me Aftësi të Kufizuara, e në veçanti tek femrat dhe të moshuarit me aftësi të kufizuar, si kategori e cila konsiderohet më e rrezikuar në shoqëri.

Për më tepër ushtrimi i të drejtave sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar do të ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e varfërisë. Në këtë kontekst dhe mbi këtë parim është hartuar edhe objektiva strategjike.

Pjesa e dytë e objektivës strategjike siguron të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të punuar në baza të barabarta me të tjerët. Me këtë të drejtë Personave me Aftësi të Kufizuar iu mundësohet zhvillimi i jetesës duke bërë punë të zgjedhur lirishëm apo të pranuar në tregun e punës, dhe ambientin e punës që është i hapur dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuar.

Aktualisht, punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuar në vend është shumë i ulët, në këtë drejtim është tejet i nevojshëm hartimi dhe fuqizimi i politikave për rritjen e punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuar, në përputhje me potencialin e tyre fizik e intelektual. Andaj me këtë objektiv synohet që punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës të prioritetizohet si një ndër elementet kyçe për përfshirjen sociale dhe pavarësinë ekonomike të të gjithë PAK në moshë pune.

Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara

E drejta për edukim është e drejtë elementare e çdo njeriu. Që kjo e drejtë të realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shteti duhet të sigurojë një sistem edukimi gjithë përfshirës në të gjitha nivelet dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të realizuar këtë të drejtë, shteti duhet të sigurojë se personat me aftësi të kufizuar nuk janë përjashtuar nga sistemi i edukimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuar nuk janë përjashtuar nga arsimimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimit mesëm. Është obligim shtetëror që personave me aftësi të kufizuar të ju mundësojë aftësimin për zhvillim të potencialit të tyre për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në edukim.

Duke ditur obligimet e njohura ndërkombëtarisht tanimë Republika e Kosovës ka filluar të marrë masat e duhura që mundësojnë jetësimin e këtyre kriterëve, filluar me mësimin sipas planit individual të arsimit (PIA), identifikimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara, arsimin profesional, të mësuarit gjatë gjithë jetës, trajnime adekuate dhe mbështetjen për profesionistët që punojnë në të gjitha nivelet e arsimit me nxënësit me Aftësi të Kufizuar.

Me zbatimin e kësaj objektivë strategjike Republika e Kosovës do të përmbushë të gjitha nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuar për një edukim adekuat.

Objektiva Strategjike 4: Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Republika e Kosovës ka qenë në vazhdimësi e fokusuar në kompletimin e legjislacionit vendor në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në baza të barabartat me të gjithë qytetarët, megjithatë mbetet akoma për të përmbushur.

Veprimet të cilat duhen të ndërmerren në përmbushjen e kësaj objektivë strategjike janë si vijon: promovimi, vetëdijësimi dhe pranimi i të drejtave të PAK, rishikimi i legjislacionit nga perspektiva e të drejtave të njeriut, sigurimi që legjislacioni është në përputhshmëri me detyrimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, etj.

Për më tepër kërkohet edhe qasje e barabartë në organet e drejtësisë për PAK, procedurat ligjore të përshtatshme me qëllim që të lehtësohet roli i tyre efektiv si pjesëmarrës direkt dhe jodirekt apo dhe si dëshmitarë, në të gjitha procedurat ligjore.

Si rrjedhojë, mbi bazën e parimit të mos-diskriminimit është paraparë kjo objektivë strategjike.

Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesmarrje si dhe krimimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuar

Kjo objektivë ka për qëllim që Personave me Aftësi të Kufizuara të ju mundësohet qasje, në bazë të barabartë me të tjerët, në ambientin fizik, transport, informatë dhe teknologji e sisteme informative, dhe në lehtësira dhe shërbime të tjera.

Dhe e gjithë kjo duke pasur parasysh se në vendin tonë ekzistojnë pengesa të mëdha në të gjitha këto fusha të cilat i pengojnë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë mundësitë e barabarta me qytetarët e tjerë. Të tilla janë: barrierat strukturore në objektet e ndërtuara, mungesa në planifikim urbanistik, enterierët e planifikuar gabimisht, ueb-sajtet që nuk plotësojnë standardet e qasshmërisë, mungesa e programeve me titra, mungesa e programeve të mjaftueshme në gjuhën e shenjave dhe me audio-përshkrim, mungesa e dokumenteve dhe librave në audio-format apo shkrimin brailë, apo në formatin për lexim të lehtë, etj. Qasja është parakusht për pjesëmarrje në shoqëri dhe në ekonomi.

Për më tepër Personat me Aftësi të Kufizuar kanë të drejtë të plotë që të jenë pjesë e jetës politike, publike, kulturore dhe sportive mbi baza të barabartë me të tjerët, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për të votuar dhe për tu zgjedhur. Gjithashtu pjesëmarrjen në organizatat jo-qeveritar dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend si dhe krijimin apo pjesëmarrjen në organizata për personat me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Personat me Aftësi të Kufizuara duhet të gëzojnë qasje në vendet për performancë apo shërbime kuturore, të tilla si teatrot, muzeumet, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët, të kenë mundësinë për të zhvilluar dhe përdorur potencialin e tyre kreativ, artistik, dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin e shoqërisë. Apo të jenë pjesë e jetës politike, publike, kulturore dhe sportive mbi baza të barabartë me të tjerët, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për të votuar dhe për tu zgjedhur.

Dhe tani për të qenë e realizueshme kjo objektivë për personat me aftësi të kufizuar që të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shteti duhet të marr masat e duhura për të siguruar qasje në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë ndër të tjera: ndërtesa, rrugë, transport në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat si dhe strehimin apo vendet (ambientet) e punës.

Statistikat

Mungesa e të dhënave statistikore është një nga sfidat dhe pengesat më të mëdha në hartimin dhe zbatimin e politikave efektive në favor të Personave me Aftësi të Kufizuar në vendin tonë.

Me qëllim të planifikimit të mirëfilltë të strategjive, politikave, shërbimeve dhe shpërndarjes së resurseve është qenësore ekzistimi i të dhënave dhe hulumtimeve mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet dhe natyrën e aftësive të kufizuara, nevojat dhe gjendjen e tyre ekonomiko-sociale e shëndetësore.

Tani nga regjistrimi i fundit neve kemi statistika zyrtare për çështjen e Aftësisë së Kufizuar mirëpo edhe kjo e dhënë duhet të thellohet dhe analizohet më tutje sepse në këtë fazë nuk është e mjaftueshme. Ndërsa sa i përket hulumtimeve të realizuara ad-hoc për çështje të caktuara, ato kanë ndihmuar institucionet relevante kanë ngritur problematika mirëpo asnjëherë nuk kanë qenë të koordinuara në të gjithë vendin dhe të cilat do të jepnin një analizë dhe pasqyrë reale në nivel kombëtar.

Andaj objektiva strategjike fuqishëm ngrit nevojën e një angazhimi më të fort të institucioneve përgjegjëse në mënyrë që të pasqyrojnë sa më mirë pengesat dhe sfidat që ky komunitet hasin në ushtrimin e të

drejtave të tyre. Gjithsesi pjesë e rëndësishme e statistikave do të jetë monitorimi i situatës në vazhdimësi si dhe plotësimi i saj me punë të shumta kërkimore të cilat duhet të jenë sa më të zgjeruara duke përfshirë të gjitha fushat e veprimit të këtij dokumenti si dhe të koordinuara në të gjitha nivelet për të promovuar dhe siguruar zbatimin efektiv të kësaj objektivave strategjike.

12. MEKANIZMAT PËR MONITORIM, RAPORTIM DHE ZBATIM

Monitorimi dhe raportimi kundrejt Strategjisë është jetike për të siguruar se jeta e Personave me Aftësi të Kufizuara është vërtet duke u përmirësuar. Monitorimi dhe raportimi gjithmonë do të shkojnë paralelisht dhe do të përgjigjen të arriturave dhe sfidave të Planeve që do të hartohen për zbatimin e Strategjisë.

Përgjegjësia për hartimin e Planeve të Veprimit i takon të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe lokal të cilat kanë marr pjesë në hartimin e Strategjisë në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Në këtë mënyrë në përputhje me të gjitha objektivat strategjike të çdo fushe të veprimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2012-2023, Planet e Veprimit trevjeçare do të reflektojnë dhe përcaktojnë masat specifike dhe konkrete për secilin institucion së bashku me indikatorët resurset financiare dhe afatet kohore të zbatimit.

Mekanizmi monitorues dhe raportues:

Këshilli Nacional për Aftësinë e Kufizuar

Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar është themeluar të punoj për krijimin e mundësive të barabarta, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar, të siguroj që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime për diçka që ndikon në gjendjen e personave me aftësi të kufizuar.

Si rrjedhojë Këshilli Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar përcjellë, monitoron dhe shqyrton kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar, si dhe rrjedhimisht këshillon Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kualitet jetësor më të mirë për personat me aftësi të kufizuar. Dhe si përfundim e gjithë puna e këtij mekanizmi do të jetë në përputhje dhe përmbushjen e objektivave strategjike të këtij dokumenti.

Komisioni për Monitorimin Raportimin dhe Vlerësimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Komisioni si një mekanizmi monitorues do të rimandatohet nga Zyra e Kryeministrit për periudhën 2013 - 2023, me përbërjen dhe fushëveprimin e njëjtë me Komisionin paraprak i cili në përbërjen e tij ka të gjithë përfaqësuesit e ministrive kryesore përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit si dhe përfaqësuesit e organizatave që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Ky mekanizëm koordinues udhëhiqet nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, mban takime të rregullta me qëllim të monitorimit të gjithë procesit të zbatimit të Strategjisë dhe Planeve të Veprimit që do të dalin nga ky dokument.

Raportimi: në fazën e raportimit obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse (ministrinë, komunat agjencionet si dhe institucionet e tjera relevante në vend) që në baza gjashtë mujore ti raportojnë Zyrës për Qeverisje të Mirë/ Zyrës së Kryeministrit për përparimin dhe barrierat e hasura në implementimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për të drejtat e PAK.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me këtë obligohet që në baza vjetore të publikoj raportin mbi gjendjen e paraqitur.

Zbatimi: Të gjitha institucionet e vendit mbajnë përgjegjësi për zbatimin e Strategjisë si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal, dhe në veçanti ato janë përgjegjëse për zbatimin e Planeve të Veprimit të cilat dalin nga kjo Strategji dhe janë të përbëra nga veprimet specifike të përcaktuara në secilën fushë të veprimit.

Institucionet përveç që kanë përgjegjësi ti bashkërendisin të gjitha veprimet specifike që dalin nga objektivat strategjike të këtij dokumenti ato duhet gjithashtu të vlerësojnë dhe sigurojnë që të gjitha programet dhe planet sektoriale në kuadër të institucionit të jenë në linjë me këto objektiva.

Nga ky vlerësim do të arrijmë të kemi të kalkuluar edhe resurset financiare të cilat do ti kemi në dispozicion për zbatimin e Strategjisë. Në këtë kontekst gjithmonë e kemi parasysh mundësin e bashkëpunimit me Organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës dhe janë akterë të besueshëm që synojnë gjithashtu zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023.

Gjithsesi në fund duhet cekur se Strategji Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është e hartuar për një periudhë dhjet vjeçare mirëpo, gjatë zbatimit sipas vlerësimeve dhe rekomandimeve mbi fakte, gjithmonë mund të shihet mundësia që të rishqyrtohet dhe përmirësohet duke marrë parasysh nevojat, rrethanat dhe zhvillimet aktuale në Kosovë.

13. DOKUMENTET E REFERUARA

1. Kushtetutat e Republikës së Kosovës
2. Plani Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës (2009-2011)
3. Strategjia Evropiane për Aftësinë e Kufizuar (2010-2020)
4. Strategjia Nacionale për Aftësinë e Kufizuar (2010-2020)
5. Strategjia për gjithpërfshirjen e fëmijëve me nevoja te veçanta në arsimin parauniversitar (2010 -2015)
6. Plani zhvillimor Strategjik i ASK-së (2009-2013)
7. Strategjia Kombëtare për Mundësi të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kroacisë (2007-2017)
8. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
9. Konventa Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut
10. Konventa Ndërkombëtar për të Drejtat e Fëmijës
11. Strategjia e Unionit Evropian për Personat me Aftësi të Kufizuar 2010-2020
12. Plani i Veprimit për të promovuar të drejtat dhe pjesëmarrjen e plotë në shoqëri të Personave me Aftësi të Kufizuar : Përmirësimi i cilësisë së jetës së Personave me Aftësi të Kufizuar në Evropë 2006-2015
13. Karta e të Drejtave Themelore të Unionit Evropian
14. Rekomandimet e Këshillit (4 qershor 1998) Karta e parkimit për personat me aftësi të kufizuar 98/376/EC;
15. Rezoluta e Këshillit (17 qershor 1999) mbi mundësitë e barabarta të punësimit për personat me aftësi të kufizuar (1999 / C 186/02);

16. Rezoluta e Këshillit (15 korrik 2003) mbi promovimin e punësimit dhe integritit social e personave me aftësi të kufizuar (2003 / C 175/01);
17. Rezoluta e Këshillit (5 maj 2003) për mundësi të barabarta për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara në arsim dhe trajnim (2003 / C 134/04);
18. Rezoluta e Këshillit (6 maj 2003) mbi qasshmërinë në infrastrukturën kulturore dhe aktivitetet kulturore të Personave me aftësi të kufizuara etj.
19. Plani individual i arsimit PIA dhe Udhëzuesi për zbatimin e PIA- Pilotimi
20. Drejtësia e mohuar: Gjendja e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovën e pasluftës- UNICEF
21. Përshatja e Objekteve Publike për Personat me Aftësi të Kufizuar -2005- Finnish-OHCHR Human Rights Support Programme –Kosova
22. Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215
23. Ligji kundër diskriminimit nr. 2004/3
24. Tom Shakespeare, “Disability Rights and Wrongs”
25. Michael Oliver “Understanding Disability”
26. Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar 33/2007
27. Korniza e kurrikulit të Kosovës
28. Strategjia sektoriale e arsimit

Nr.06/65
Datë:23.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. Dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 09/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara

1. Themelohet Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara në këtë përbërje:

1.1. Zëvendës Kryeministër,	Kryesues;
1.2. Kryetari i Forumit të Aftësisë së Kufizuar,	Bashkë-kryesues;
1.3. Ministri pa protofol,	Zëvendës-kryesues;
1.4. Drejtori i ZKM/ZQM,	Zëvendës-kryesues;
1.5. Zëvendës ministër i MPMS,	Anëtar;
1.6. Zëvendës ministër i MASHT,	Anëtar;
1.7. Zëvendës ministër i MSH,	Anëtar;
1.8. Zëvendës ministër i MAPL,	Anëtar;
1.9. Zëvendës ministër i MMPH,	Anëtar;
1.10. HANDIKOS,	Anëtar;
1.11. HANDICAP KOSOVA,	Anëtar;
1.12. Shoqata Kosovare e të Shurdhërve,	Anëtar;
1.13. Shoqata e të Verbëve të Kosovës,	Anëtar;
1.14. Down Sindrom Kosova,	Anëtar;
1.15. Shoqata Autizmi, Anëtar,	Anëtar.
2. Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara është organ këshillëdhënës dhe orientues mbi prioritetet dhe politikat nacionale në fushën e Aftësisë së Kufizuar.
3. Këshilli varësisht nga nevojat e dala dhe me qëllim të avancimit të punës së tij, mund të krijoj grupe pune si dhe mund të zgjeroj anëtarësinë, bashkëpunimin dhe koordinoj aktivitetet me akterë të tjerë vendor dhe ndërkombëtar.
4. Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara do të punoj në zbatimin dhe monitorimin e politikave nacionale për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
5. Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara mund të inicoj dhe marrë pjesë aktive në hartimin dhe zhvillimin e politikave të reja që kanë të bëjnë me çështjen e aftësisë së kufizuar.
6. Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara, me iniciativën e vetë mund t'i propozoj rekomandime Qeverisë së Republikës së Kosovës.
7. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, shërben si Sekretariat për të koordinuar ushtrimin e mandatit të Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara.
8. Obligohen të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces për zbatimin e këtij Vendimi.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/46 i datës 03.12.2008 dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/36 i datës 07.09.2011.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Anëtarëve të Këshillit
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

RREGULLORJA E PUNËS SË

KËSHILLIT NACIONAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores Nr.09/2011 së punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 23.12.2015 nxjerr vendimin nr. 06/65 për themelimin e Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar është organ këshillëdhënës dhe orientues mbi prioritetet dhe politikat nacional në fushën e Aftësisë së Kufizuar.

QËLLIMI

Qëllimi i Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar është të punoj për krijimin e mundësisë së barabartë, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar, të siguroj që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime për diç që ndikon në gjendjen dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;

Rekomandimet e Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar, do të jenë në pajtueshmëri me Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe instrumentet tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut;

Këshilli gjithsesi do të punoj në kuadër të objektivave dhe vizionit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023, planeve të veprimit që zbatojnë këtë dokument si dhe politikave të tjera në fushën e aftësisë së kufizuar

MANDATI I KËSHILLIT NACIONAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Kohëzgjatja dhe mandati i anëtarëve të Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar është katër vite, me mundësi vazhdimi.

ROLI DHE FUNKSIONET E KËSHILLIT NACIONAL MBI AFTËSINË E KUFIZUAR

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar përcjellë, monitoron dhe diskuton (shqyrton) kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar, si dhe do të këshilloj Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kualitet jetësor më të mirë për personat me aftësi të kufizuar;

Këshilli Nacional do të monitoroj punën të arriturat dhe sfidat e gjitha institucioneve për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-

2023 dhe planeve të veprimit që janë të hartuara nën objektivat strategjike të këtij dokumenti si dhe politikave të tjera që prekin të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në vend

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar mund të inicioj dhe të marrë pjesë aktive në hartimin dhe zhvillimin e politikave të reja që kanë të bëjnë me çështjen e aftësisë së kufizuar;

Për të siguruar se kushtet jetësore të personave me aftësi të kufizuar janë marrë parasysh në planifikimin e shoqërisë, të gjitha autoritetet publike dhe private mund të drejtohen Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe të marrin këshilla mbi çështjet që u përkasin personave me aftësi të kufizuar;

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar, me iniciativën e vetë mund të, i propozoj rekomandime Qeverisë së Republikës së Kosovës;

ANËTARËT E KËSHILLIT NACIONAL MBI AFTËSINË E KUFIZUAR

Kryeministri me vendim në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës themelon Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar, i cili do të shërbejë si trup këshillëdhënës për të gjithë institucionet Qeveritare, përfshirë edhe Kuvendin Republikës së Kosovës;

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar përbëhet nga: Kryesuesi, dy zëvendës Kryesues, bashkë kryesuesi dhe njëmbëdhjetë (11) anëtar. Kryesues është njëri nga zëvendës Kryeministrat, zëvendës kryesues janë Ministri pa Protokol dhe drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ndërsa bashkë kryesues është Kryetari i Forumit të Aftësisë së Kufizuar që i përket shoqërisë civile .

Pesë (5) anëtarë janë zëvendës ministrat e Ministrive si vijon: Ministria e Punës dhe Mirëqene Sociale (zv. ministër/e) anëtarë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (zv. ministër/e) anëtarë; Ministria e Shëndetësisë (zv. ministër/e) anëtar; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (zv. ministër/e) anëtar; Ministria e Administrimit Pushtetit Lokal (zv. ministër/e) anëtar; Konsiderohet se këto ministri janë ministri më të rëndësishme në përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar .

Gjashtë (6) anëtarë janë nga shoqëria civile përkatësisht shoqatave që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar si vijon: Shoqata HANDIKOS anëtarë, Shoqata HANDICAP KOSOVA anëtarë, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve anëtarë, Shoqata e të Verbërve të Kosovës anëtarë, Down Syndrome Kosova anëtarë si dhe Shoqata e Autizimit anëtarë.

Në Këshillin Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar sugjerohet të jenë femra tridhjetë përqind (30 %) e këtij mekanizmi

Në Këshillin Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar mund përfaqësojnë të gjithë personat e emëruar pa dallim gjuhe, përkatësie etnike, gjinie, moshe, religjioni, kulture, besimi, apo aftësie të kufizuar ;

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar varësisht nga nevojat e dala dhe me qëllim të avancimit të punës së tij, mund të krijoj grupe pune si dhe mund të zgjerojë anëtarësinë nga institucionet dhe shoqëria civile, të bashkëpunojë dhe koordinoj aktivitetet me aktorë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtar.

TAKIMET

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar takohet sa herë që ka nevojë, por së paku dy herë në vit, apo kur 1/3 e anëtarëve të Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar kërkojnë që Kryesuesi të thërrasë takimin;

Takimet e Këshillit Nacional për Personat Aftësinë e Kufizuara mund të jenë të hapura për publikun nëse këshilli paraprakisht vendos;

VENDIMET

Vendimet mund të merren me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizua; Vendimet mund të merret edhe kur kryesuesi dhe së paku shtatë anëtarë të Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar janë të pranishëm në mbledhjen e Këshillit;

SEKRETARIA KOORDINUESE

Sekretaria Koordinuese e Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar është Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Sekretaria Koordinuese e Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar është përgjegjëse për përgatitjen e takimeve të Këshillit Nacional mbi Aftësi të Kufizuar.

Sekretaria Koordinuese do të ndihmoj Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar në organizimin dhe koordinimin e ushtrimit të mandatit;

Sekretaria Koordinuese përgatit procesverbalin e çdo takimi dhe ju paraqet anëtarëve të Këshillit Nacional Mbi Aftësinë e Kufizuar dhe asistentëve teknik jo më vonë se një muaj pas mbajtjes së takimit në fjalë ;

Procesverbali do të shqyrtohet dhe miratohet në çdo takim. Anëtarët e Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar mundë të parashtrojnë komente rreth procesverbalit në afat brenda 15 ditëve;

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

VENDIMI PËR CAKTIMIN E TARIFAVE

EKSTRAKT (TAKSAT PËR PAJISJE ME DOKUMENTE)

Nr.106/2014
Datë: 27/03/2014

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21,22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe shtojcën 3 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-099 për Letërnjoftimin, në nenin 36 të Ligjit Nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit, në Ligjin Nr.02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, në nenin 3 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, në Ligjin Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, Në nenin 30 të Ligjit Nr. 04/L-143 Për aRMë, Në Ligjin 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë, në Ligjin Nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozive, nxjerr:

V E N D I M P Ë R C A K T I M I N E T A R I F A V E

Për pajisje me letërnjoftim, pasaportë, patentë-shoferë, regjistrim i automjeteve, vulë verifikuese, për fitimin dhe rifitimin të shtetësisë me natyralizim, humbjen e shtetësisë me lirim, lejeqëndrimin e përkohshëm, lejeqëndrimin e përhershëm, për pajisje me letërnjoftim për të huaj, për armë, shërbime private të sigurisë dhe përdorim civil të eksplozivëve janë si në vijim:

1. Taksat për pajisje me letërnjoftim të Republikës së Kosovës janë:

1.1. Për pajisje me letërnjoftim biometrik për herë të parë, ripërtëritje, korrigjim, ndërrim të të dhënave, humbjes, dëmtimit dhe të gjitha rastet kur procedurat e aplikimit e parashohin detyrimisht ndërrimin e letërnjoftimit biometrik është.....**10 Euro.**

2. Taksat për pajisje me pasaportë të Republikës së Kosovës janë:

2.1. Për pajisje me pasaportë për herë të parë, ripërtëritje, korrigjim, ndërrim të të dhënave dhe kur fletët në pasaportë janë të plotësuara me vula dhe viza, për personat mbi moshën 18 vjeçare.....**30Euro;**

2.2. Për pajisje me pasaportë në rast të humbjes ose dëmtimit, për personat mbi moshën 18 vjeçare.....**50 Euro;**

2.3. Për pajisje me pasaportë për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (për të gjitha llojet e aplikimit).....**20 Euro;**

2.4. Për pajisje me pasaportë për pensionistët (për të gjitha llojet e aplikimit).....**15 Euro;**

2.5. Për pajisje me pasaportë diplomatike.....**50 Euro;**

2.6. Për pajisje me pasaportë zyrtare.....**35 Euro.**

3. Taksat për pajisje me patentë shoferë të Republikës së Kosovës janë:

3.1. Për pajisje me patentë shoferë dhe shtim të kategorisë.....**20 Euro;**

3.2. Për pajisje me patentë shoferë në rast të humbjes, dëmtimit, korigjimit, ndërrimit dhe ripërtirjes.....**15 Euro.**

4. Taksat për pajisje me letërnjoftim, pasaportë dhe patentë shoferë të Republikës së Kosovës me procedurë të përsheptuar janë:

4.1. Për pajisje me letërnjoftim biometrik për herë të parë, ripërtëritje, korigjim, ndërrim të të dhënave, humbje, dëmtim dhe në të gjitha rastet kur proceduar e aplikimit e parashohin detyrimisht ndërrimin e letërnjoftimit është.....**60 Euro;**

4.2. Për pajisje me pasaportë për herë të parë, ripërtëritje, korigjim, ndërrim të të dhënave dhe kur fletët në pasaportë janë të plotësuara me vula dhe viza, për personat mbi moshën 18 vjeçare.....**80 Euro;**

4.3. Për pajisje me pasaportë në rast të humbjes ose dëmtimit, për personat mbi moshën 18 vjeçare.....**100 Euro;**

4.4. Për pajisje me pasaportë për fëmijë deri në moshën 18 vjeçare (për të gjitha llojet e aplikimit).....**70 Euro;**

4.5. Për pajisje me pasaportë për pensionistët.....**65 Euro;**

4.6. Për pajisje me patentë shofer dhe shtim të kategorisë.....**70 Euro;**

4.7. Për pajisje me patentë shoferë në rast të humbjes, dëmtimit, korigjimit, ndërrimit dhe ripërtëritjes.....**65 Euro;**

4.8. Personat që kanë aplikuar me procedurë të rregullt për tu pajisur me letërnjoftim, pasaportë dhe patentë shoferë, e ndërkohë kërkojnë të procedohen me procedurë të përsheptuar duhet të bëjnë pagesën shtesë.....**50 Euro;**

* * * * *

11. Lirohen nga pagesa e taksës me rastin e pajisjes me Pasaportë, Letërnjoftim dhe Patentë-shofer personat me aftësi të kufizuara të kategorizuar sipas ligjit përkatës në fuqi. Pala duhet të paraqesë dëshminë adekuate të lëshuar nga organi kompetent.

* * * * *

31. Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit.

Bajram Rexhepi

Ministër i Punëve të Brendshme



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSOLOVA / MINISTRY OF
INTERNAL AFFAIRS

DEPARTAMENTI LIGJOR / PRAVNI DEPARTAMENT / LEGAL DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:	DL – MPB – 2014				
PËR/ZA/TO:	Për Qendrat për Pajisje me Dokumente QPD (QKRC)				
CC:	z. Bajram Rexhepi Ministër i MPB-së				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Driton Gashit Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së.				
NGA/OD/FROM:	Blerim Camaj Kryeshef i Agjencisë së Regjistrimit Civilë				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër-Qarkore për zbatimin e pikës 11 të Vendimit për Tarifa nr. 106 të datës 27.03.2014				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Kati i III 303	Lokacioni: Kucni: Extension:	Objekti Ndërtesa e Re e MPB-së	Data: Datum: Date:	28.05.2014
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION	X				
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION	X				
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Të nderuar ,

Me qëllim të zbatimit të pikës 11 të Vendimit për Caktimin e Tarifave nr. 106 datë 27.03.2014

Faqe 1 nga 2

Ju sqarojmë si më poshtë:

1. Me rastin e aplikimit të personave me aftësi të kufizuara për pajisje me letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer duhet të ofrohen dëshmitë si në vijim:

1.1. Vendimin për njohjen e personit me aftësi të kufizuara sipas kategorisë të lëshuar nga Departamenti i Pensioneve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ose

1.2. Kartela e anëtarësimit nga HANDIKOS-i

2. Këtë letër-qarkore obligohen ta zbatojnë Qendrat për Pajisje me Dokumente QPD (QKRC).

3. Kjo letër-qarkore vlen deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Me respekt !

Faqe 2 nga 2

Adresa: objekti – ish Gërmia ,kati përdhese, 10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon/Faks: + 377 44 34 58 71
<http://www.mpb-ks.org>, E-mail: @ks-gov.net